

E FOLMJA SHQIPE E KARADAKUT TË SHKUPIT

ASLLAN HAMITI



ASLLAN HAMITI

**E FOLMJA SHQIPE
E
KARADAKUT TË SHKUPIT**

PASQYRA E LËNDËS

Parathënie	
Metoda e punës	
Shenjat plotësuese dhe shkurtime	

I. HYRJE

1.1. Të dhëna të përgjithshme për Karadakun	
1.1.1. Përdorimi paralel i dy toponimeve	
1.1.2. Mali i Zi i Shkupit në Fjalorin enciklopedik shqiptar	
1.1.3. Pozita gjeografike	
1.1.4. Popullsia	
1.1.5. E kaluara përgjashme dhe e lavdishme e Karadikut	
1.1.6. Karadaku në Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe	

II. TIPARET FONETIKE E FONOLOGJIKE

2. 1. Theksi	
2.1.1. Fjalët me theks në rrokjen parafundore	
2.1.2. Fjalët me theks në rrokjen fundore	
2.1.3. Fjalët me theks në rrokjen tejfundore	
2.1.4. Palëvizshmëria dhe lëvizshmëria e theksit	
2.1.5. Theksi i fjalëve në fjali	
2.2. Gjatësia fonetike dhe fonologjike e zanoreve	
2.2.1. Përndarja e zanoreve të shkurtra	
2.2.2. Përndarja e zanoreve me gjatësi të mesme	
2.2.3. Përndarja e zanoreve të gjata	
2.2.4. Zanoret e patheksuara	
2.3. Hundorësia e zanoreve	
2.3.1. Hundorësia si dukuri fonetike dhe vlera fonologjike e saj	
2.3.2. Zanoret e hundorëzuara dhe fonemat hundore	
2.3.3. Përndarja dhe denduria e përdorimit të zanoreve me hundorësi	
2.4. Sistemi i zanoreve	
2.4.1. Identifikimi i fonemave	
2.4.2. Inventari i fonemave zanore	
2.4.3. Zanorja [a]	
2.4.4. Zanorja [e]	
2.4.5. Zanorja [ë]	
2.4.6. Zanorja [o]	
2.4.7. Zanorja [i]	
2.4.7.1. Diftongimi i [í]-së së theksuar	
2.4.8. Zanorja [u]	
2.4.8.1. Diftongimi i [ú]-së së theksuar	
2.4.9. Konsonantizimi i zanoreve të patheksuara [i, u]	

2.4.10. Zhbuzorëzimi i [y]-së dhe diftongimi dytësor i saj	
2.4.11. Diftongimi, mosdiftongimi dhe monoftongimi	
2.4.12. Togjet e zanoreve	
2.5. Sistemi i bashkëtingëlloreve	
2.5.1. Bashkëtingëlloret dybuzore	
2.5.2. Bashkëtingëlloret buzore-dhëmbore	
2.5.3. Bashkëtingëlloret ndër dhëmbore	
2.5.4. Bashkëtingëlloret paragjuhore.....	
2.5.4. Bashkëtingëlloret qiellzore	
2.5.5. Bashkëtingëlloret prapagjuhore	
2.5.6. Prirja për ekonomizimin e gjuhës dhe lehtësimin e shqiptimit	
2.5.7. Togje bashkëtingëlloresh	
2.5.7.1. Reflektimi i grupeve të moçme [kl] dhe [gl]	
2.5.7.2. Grupet e bashkëtingëlloreve [mb], [nd] dhe [ng]	
2.5.7.3. Togjet [tj] dhe [dj]	
2.5.7.4. Grupet [pj], [mj] dhe [vj]	
2.5.7.5. Togjet e bashkëtingëlloreve [pl], [bl] dhe [fl]	
2.5.8. Inventari i fonemave bashkëtingëllore	

III. VEÇORITË MORFOLOGJIKE

3.1. Emri	
3.1.1. Gjinia e emrit	
3.1.2. Numri i emrit	
3.1.3. Shquarsia e emrit	
3.1.4. Rasat e emrit	
3.2. Mbiemri	
3.2.1. Formimi i mbiemrave	
3.2.2. Format e mbiemrave nëpër rase.....	
3.2.3. Numri i mbiemrit	
3.2.4. Përshtatja e mbiemrit me rasën e emrit.....	
3.2.5. Kategoria e shkallës së mbiemrit	
3.3. Numërori	
3.4. Përemri	
3.4.1. Përemrat vetorë	
3.4.2. Përemrat vetvetorë	
3.4.3. Përemrat dëftorë	
3.4.4. Përemrat pronorë	
3.4.5. Përemrat pyetës	
3.4.6. Përemrat lidhorë	
3.4.7. Përemrat e pacaktuar	
3.5. Folja	
3.5.1. Mënyra dëftore	
3.5.1.1. Koha e shkuar	
3.5.1.2. Koha e ardhme	
3.5.1.3. Koha e ardhme e dytë	

3.5.2. Mënyra lidhore	
3.5.3. Mënyra urdhërore	
3.5.4. Mënyra dëshirore	
3.5.5. Mënyra habitore	
3.5.6. Pjesorja	
3.5.7. Paskajorja	
3.5.8. Përcjellorja	
3.6. Ndajfolja	
3.7. Parafjala	
3.8. Lidhëza	
3.9. Pjesëza	
3.10. Pasthirrma	

IV. VEÇORITË FJALËFORMUESE

4.1. Formimi i fjalëve me parashtesim	
4.2. Formimi i fjalëve me prapashtesim	
4.3. Formimi i fjalëve me paranyjëzim dhe prapashtesim	
4.4. Kompozimi dhe përngjitja	

V. TIPARET LEKSIKORE

5.1. Sinonimia leksikore	
5.2. Dygjuhësia dhe huazimi leksikor.....	
5.2.1. Huazimet sllave	
5.2.2. Huazimet turke	
5.3. Përshtatja e huazimeve sllave e turke	
5.4. Fjalor i të folmes	

VI. VEÇORITË SINTAKSORE

6. Tiparet sintaksore të së folmes së Karadakut të Shkupit	
Përmbyllje	
Conclusion	
Tekste nga e folmja	
Literatura e konsultuar	
Harta	

PARATHËNIE

Studimet e të folmeve tona kanë vlerë të madhe për njohjen e larmisë gjuhësore të shqipes, historisë së gjuhës dhe falësve të asaj gjuhe, marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera në takim si dhe për shqipen standarde në përgjithësi. Dialektet janë burime më autentike për studimin e së kaluarës dhe të tashmes së një gjuhe, ndërsa dialektologjia paraqet mjetin më të sigurt të gjuhësisë bashkëkohore.

Me këtë monografi synojmë të përshkruajmë gjendjen e sotme të të folmes shqipe të Karadakut të Shkupit, duke bërë fjalë për tiparet fonetike e fonologjike të saj, për veçoritë morfologjike, fjalëformuese, leksikore dhe tiparet sintaksore. Gjatë përshkrimit jemi përpjekur jo vetëm të pasqyrojmë e të shpjegojmë veçoritë gjuhësore të këtij areali, por ndonjëherë edhe të krahasojmë atë me të folmet përreth, me të folme të tjera të gegërishtes qendrore, me makrosistemin dialektor si dhe me shqipen standarde në përgjithësi.

Veprën “E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit” e botuam si monografi në shtëpinë botuese Logos-A, Shkup, 2014, 500 faqe me përkrahjen materiale të Ministrisë së Kulturës të Republikës së Maqedonisë. Vepra mbështetet në punimin e doktoratit, por versionin për botim e kemi ripunuar, rishikuar, plotësuar me punime e vepra të reja të botuara edhe pas mbrojtjes (vitit 1999) e deri në botim; thjesht punimin e doktoratit e kemi përditësuar. Pasi kishim siguruar edhe dy vëllimet e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe (Napoli, 2007, 2008) me shumë dëshirë, vullnet e pasion shfrytëzuam të dhënat e prurjet e reja të kësaj vepreje madhore të gjeografisë gjuhësore të shqipes për të pasuruar monografinë për të folmen e Karadakut të Shkupit.

Edhe pas daljes në dritë të kësaj monografie dialektore, kemi shkëputur e ripunuar tema të veçanta për të folmen në fjalë, duke marrë pjesë e më pas botuar në përmbledhjet e punimeve të konferencave shkencore në Maqedoninë e Veriut, Kosovë e Shqipëri. Interesimi ynë për këtë të folme si dhe për të folmet e tjera të gegërishtes qendrore dhe përgjithësisht të folmet e shqipes na ka nxitur të hartojmë edhe një tekst mësimor për studentët e Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare (në bashkautorësi).

Tekstin e kësaj monografie e kemi rilexuar para ribotimit dhe kemi bërë disa ndryshime, përmirësime e përditësime të nevojshme, ndër to edhe emrin Maqedoni e kemi shënuar me variantin zyrtar, Maqedonia e Veriut. Kemi hequr edhe jo pak çështje të përgjithshme e teorike.

E vlerësojmë shumë të dobishme punën e deritashme kërkimore, hulumtuese, botuese e në mbajtjen e konferencave shkencore të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

Me projektin që ka ndërmarrë për ribotimin e punimeve e të monografive për të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut në disa vëllime ITShKSh po dëshmon përkushtim ndaj veprimtarisë shkencore në fushën e dialektologjisë shqiptare te ne.

Një pjesë e madhe e monografive janë botuar në pak kopje e nga shtëpi botuese të vogla. Fjala vjen, në punën e deritashme edhe pse kam dashur të siguroja të gjitha punimet a monografitë për të folmet shqipe në Maqedoni, ndonjë sosh nuk kemi arritur ta gjenim. Me vështirësi të tillë jam përballur edhe gjatë përpjekjes për të hartuar një bibliografi të plotë të punimeve për të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut.

Duke i grumbulluar e sjellë në një seri botimesh (në letër dhe në formë elektronike), lexuesi do ta ketë shumë më të lehtë të sigurojë veprat e shpërndara, ndonjë sosh edhe të paarrtshme. Gjithnjë e më tepër interneti po zë vendin e bibliotekave.

Një punë e tillë sjell dobi të shumëfishta, jo vetëm për t'u njohur me studimet e deritashme në fushën e dialektologjisë të ne, por edhe për zgjerimin e thellimin e tyre, si dhe për zhvillimin e mëtejshëm të studimeve dialektore, të gjuhësisë, të shkencës e të kulturës shqiptare në përgjithësi.

Me botimin (pse jo edhe me ribotimin) e punimeve dialektore, onomastike, folklorike, etnografike, historike, kulturore e të fushave të tjera që kanë të bëjnë me trashëgiminë shpirtërore e materiale të shqiptarëve në Maqedoni do të dëshmohet, argumentohet e fuqizohet e vërteta (shpeshherë e mohuar) e vazhdimësisë së pandërprerë historike, gjeografike, gjuhësore e kulturore e shqiptarëve në këto troje, uniteti dhe kontinuiteti gjuhësor në shtrirjen hapësinore të shqiptarëve në Gadishullin Ilirik, pavarësisht kufijve të sotëm administrativë.

Të gjithë pajtohemi se duhet vazhduar dhe intensifikuar gjurmimin, mbledhjen dhe studimin e leksikut dialektor e krahinor të shqipes. "Fjala shqipe - thotë profesor Jani Thomai (në veprën "Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme", AShSh, IGjL, Tiranë, 2001, f. 82) - është një nga krijesat e pavdekshme të popullit, e cila, duke kapërcyer shekujt, ka hyrë në kohën tonë më e pastër e më e fuqishme, sepse në të krijuesi i madh popull ka vënë dorën e dashurinë e vet. Gjuhëtari e gjurmoi me ngulm dhe ia zbuloi vlerat, shkrimtari e lëmoi dhe e zbukuroi, poeti e futi në këngë dhe ia shtoi forcën. Në fjalën shqipe ka hyrë e ngjeshur tërë jeta shumëshekullore e popullit tonë të lashtë e luftarak, kultura e tij e gjerë dhe e ruajtur mirë, një histori e lavdishme plot beteja. Tek ajo janë kthyer përherë sytë e brezave dhe kanë gjetur armë të fuqishme për mbrojtjen e njëjtësisë së vet si popull e komb. Gjurmimi, mbledhja e studimi i fjalës shqipe me kohë është kthyer në detyrë jo vetëm shkencore, por edhe atdhetare ..."

METODA E PUNËS

Në vjeljen e materialit dialektor kemi zbatuar metodën e vëzhgimit të drejtpërdrejtë, ndërsa në përpunimin e materialit dhe mbarështimin e punimit kemi shfrytëzuar metodën e përshkrimit të të folmes në gjendjen e sotme, me shpjegime të herëpashershme teorike të gjuhësisë së sotme e historike, metodën e analizës, të sintezës, të krahasimit etj.

Materialin dialektor e mblodhëm me ekspedita gjatë viteve 1995-1997 nëpër të gjitha fshatrat e kësaj krahine të banuara me shqiptarë, me pyetje të tërthorta të mbështetura në pyetësor dhe me biseda të lira e tematike me informues tipikë të moshuar e të paarsimuar, të cilët kanë lindur, jetojnë (ndonjë prej tyre edhe mund të ketë ndërruar jetë) dhe nuk kanë qëndruar për një kohë të gjatë jashtë vendbanimit të tyre.

Gjithkund ku kemi qenë në Malin e Zi të Shkupit na kanë pritur me bujari, zemërgjerësi dhe me mikpritje të njohur shqiptare. Thjesht, ata janë vënë në shërbimin tonë për të kryer misionin. Me këtë rast, falënderoj drejtorët e shkollave, arsimtarët, informatorët, fshatarët, shoqëruesit e mi (anëtarët e grupit anketues), si dhe anëtarët e komisionit recensues e vlerësues të librit.

Para se të shkonim në terren, bëmë disa parapërgatitje: mblodhëm të dhëna për historinë e vendit, u njohëm me veçoritë etnografike, kulturore, ekonomike, zejtarinë, klimën, arsimimin, pozitën gjeografike etj., veçmas me gjuhën e kësaj krahine. Kontaktet e mia me folës të kësaj zone kanë qenë e janë të përditshme. Kam fqinj, shokë, miq e studentë nga Karadaku. Përditë flas me ta dhe dëgjoj gjuhën e tyre. Nga ana tjetër, jam i lindur në Karadakun e Gjilanit, jetoj në zonën e rrafshët jugore rrëzë Karadakut të Shkupit, ku pjesa më e madhe e banorëve të këtij vendbanimi janë nga Mali i Zi i Shkupit, sidomos nga fshatrat Luboten, Brezë, Malinë e Grushinë.

Gjatë punës së mbledhjes së lëndës së parë gjuhësore nga kjo e folme (korpusit gjuhësor), jemi udhëhequr nga udhëzimet e përgjithshme të pranuar e të njohura për vjeljen e materialit dialektor me anë të vrojtimit të drejtpërdrejtë. Gjatë ekspeditave kërkimore kemi udhëtuar me makinë, zakonisht me 2-3 shoqërues: njëri e mësoi mirë mjeshtërinë e parashtrimit të pyetjeve në mënyrë të tërthortë (duke u mbështetur në pyetësor), ndërsa i dyti u trajnuar mirë në incizimin e materialit me magnetofon. Unë rëndom e koordinoja gjithë punën dhe shënoja në notes gjithçka që më dukej e nevojshme dhe e dobishme.

Kontaktet e para për ekspeditë i vinim me miq tanë, në të shumtën e rasteve arsimtarë të shkollave filllore të fshatrave përkatëse. Takoheshim në shkollë dhe ata na ndihmonin për çdo gjë që kishte të bënte me organizimin e ekspeditës dialektore. Në katundet më afër qytetit të Shkupit herë pas here shkonim në mëngjes e ktheheshim në mbrëmje për disa ditë rresht, derisa e vilnim materialin e nevojshëm dialektor, ndërsa në katundet malore qëndronim për 4-5 ditë dhe anketonim 5-6 banorë. Në fshatin Brezë të hënën në mëngjes shkua me furgonin që bartte arsimtarët dhe atje në shkollën e fshatit ku kishte edhe dhoma bujtjeje qëndrova deri të premten pasdite.

Nga secili informator kemi mbledhur gjithë materialin gjuhësor të fshatit përkatës, me qëllim që materiali i çdo informatori të jetë i krahasueshëm me materialin e informatorit tjetër. Dihet se ndonjëherë mund të ndodhë që njeriun që zgjedhim për informator të ketë veçori individuale shqiptimore, të folurit e tij të mos e përfaqësojë besueshëm të folmen vendore dhe

rrjedhimisht gjuhëtari mund të arrijë në përfundime të gabueshme.

Të anketuarit tanë janë nga brezi i vjetër, pak ose aspak të arsimuar, që rrallë kanë lëvizur nga fshati apo krahina e tyre dhe, natyrisht, duke mos pasur kontakte intensive me të folmet e tjera dhe gjuhët e huaja, në mënyrë më autentike kanë ruajtur të folmen e tyre deri në gjendjen e sotme.

Vjeljen e materialit e kemi bërë me pyetësor, me pyetje të tërthorta. U jemi shmangur pyetjeve të drejtpërdrejta me qëllim që informatori të mos ndikohet nga gjuha e pyetjeve dhe të mos përgjigjet me po ato fjalë që do t'i bëhej pyetja. Parashtronim edhe pyetje të papërfshira në pyetësor, me qëllim që të mund të përfshinim më shumë dukuri që na interesonin.

Pasi merrnim gjithë përgjigjet e planifikuara nga pyetësori (i plotësuar edhe me pyetje për veçori gjuhësore tipike të gegërishtes qendrore), atëherë materialin gjuhësor e vlnim edhe përmes bisedës së lirë, nëpërmjet rrëfimeve për përjetime të ndryshme, përrallave, ngjarjeve historike, legjendave, bisedave për punën e tyre të përditshme etj. E kemi zbatuar edhe parapëlqimin tjetër, që: edhe ne vjelësit të flasim në gjuhën e tyre popullore (të ngjashme a të përafërt me të folmen vendore) dhe jo në gjuhën standarde, me qëllim që gjuha e normuar të mos ndikojë që informatori të ndihet inferior e të mundohet që edhe ai të flasë “me gramatikë”, më “mirë”. Jemi përpjekur dhe shpresoj se ia kemi dalë mbanë që informatorin të mos e bezdisnim e të mos e lodhnim. Nuk na ka ndodhur asnjëherë të na dështojë bashkëpunimi me bashkëbiseduesit. Materialin e vjelë e kemi analizuar e rishikuar në mbrëmje, që ta dinim ç’kemi bërë e çfarë duhet të bëjmë të nesërmen.

Pasi përfunduar vjeljen e materialit dialektor në të gjitha katundet e Karadakut, kemi analizuar, përpunuar, klasifikuar materialin e siguruar në dukuri të veçanta. Për mëdyshjet që kemi pasur për ndonjë gjë, i kemi dëgjuar e ridëgjuar edhe incizimet zanore.

Për mbarështrimin e punimit, përshkrimin e këtij areali gjuhësor, të shoqëruar shpeshherë edhe me përpjekje për shpjegimin e dukurive gjuhësore, kemi shfrytëzuar artikujt tonë e veprat e studiuesve të tjerë si dhe literaturë teorike ndihmëse. Atlasin dialektologjik të shqipes nuk e kemi hequr për asnjë çast nga tavolina e punës.

Edhe pas hartimit të disertacionit të doktoratit për të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit (1999), botimin e monografisë (Logos-A, Shkup, 2014, 500 faqe) interesimi im për këtë të folme nuk ka pushuar. Vjeljen e materialit dialektor dhe onomastik nga të folmet e tyre studentët tanë e kanë detyrë të nevojshme e të domosdoshme për të plotësuar parakushtin për t’iu nënshtruar provimit të Dialektologjisë shqiptare. Kështu, përveç materialit të vjelë nga ne, kemi siguruar edhe lëndë gjuhësore të vlefshme nga të folmet shqipe, kryesisht në Maqedoni e më pak në Kosovë, por veçmas nga të folmet e Karadakut. Disa studentë, jo vetëm që me zell vjelin material dialektor e onomastik, por ndonjë prej tyre me përkushtim e përpunojnë materialin dhe shkruajnë ndonjë punim seminari ose punim diplome me vlerë për një të folme të caktuar. Ndonjë nga ta këtë punë fillestare mund ta vazhdojë, ta zgjerojë e ta thellojë në fushën e kërkimeve dialektologjike e onomastike në studimet e ciklit të dytë e të tretë, përkatësisht si punim magjistrature e disertacioni doktorati, madje mund të ngriten edhe në studiues të ardhshëm.

SHENJAT PLOTËSUESE DHE SHKURTIMET

Në studimet dialektore si dhe në tekstet e dialektologjisë deri më tani janë përdorur sisteme të ndryshme transkriptimi. Që nga shkrimet e vjetra shqipe e deri vonë zanoret e gjata shkruheshin me dyzimin e tyre ose me një vizë lart: si *vllaa* ose *vllā*, *njerii* a *njerī*, *deet* a *dēt* ... Në shkrimet e sotme mbizotëron transkriptimi fonetik, si më poshtë:

Transkriptimi i shkronjave të shqipes me Alfabetin Fonetik Ndërkombëtar (anglisht: IPA = I(internacional) P(honetic A(lphabet))]

alfabeti i shqipes	a	b	c	ç	d	dh	e	ë	f	g	gj	h	i	j	k	l	ll	m
<i>transkriptimi</i>	a	b	ɬ	ɟ	d	ð	ɛ	ə	f	g	ɟ	h	i	j	k	l	ɫ	m

alfabeti i shqipes	n	nj	o	p	q	r	rr	s	sh	t	th	u	v	x	xh	y	z	zh
<i>transkriptimi</i>	n	ɲ	ɔ	p	ç	r	r	s	ʃ	t	θ	u	v	ɖ	ɟʒ	y	z	ʒ

Shkronjat janë shenja grafike që përfaqësojnë fonemat e gjuhës. Shkrimi *fonemor* përdoret për të dhënë jo gjithë nuancat fonetike të gjuhës së folur, por vetëm përbërjen fonemore të fjalëve. Në të vërtetë, për të shkruar shqipen standarde përdorim pikërisht këtë shkrim fonematik, sipas parimit një fonemë = një shkronjë (njëshe apo dyshe): 36 shkronja për të shkruar 36 fonemat e shqipes (me pak përjashtime).

Me shkrimin fonemor nuk mund të regjistrojmë të folurit në mënyrë të përpiktë. Në mënyrë më besnike të folurit paraqitet me anë të transkriptimit, përkatësisht me përdorimin e disa shenjave plotësuese (diakritike) që vihen mbi, nën ose anash shkronjave të rëndomta si dhe me përdorimin e disa shkronjave të veçanta për tingujt që nuk i ka gjuha standarde.

Në këtë libër, për lehtësi shkrimi e leximi, për të shënuar fonemat (tingujt) e të folmes në shqyrtim kemi përdorur alfabetin e shqipes, duke e plotësuar atë me disa shenja të nevojshme si dhe me disa shkronja të veçanta për fonema që nuk i ka shqipja standarde.

Shenja plotësuese dhe diakritike të dallueshme nga ato të alfabetit të gjuhës shqipe

ŋ - bashkëtingëllore mbylltore, prapagjuhore, sonante, hundore (p.sh. ngat > ŋat)

[] - kllapa katrore për të shënuar tingujt (p.sh. tingulli [a])

// - kllapa të pjerrëta për të shënuar fonemat (p.sh. fonema /p/)

< > - shenjë konvencionale për të shënuar shkronjat (p.sh. shkronja <t>)

~ - kundërvënie fonologjike midis dy gjymtyrëve të kundërvënies (p.sh. /a/ ~ /e/: dash ~ desh)

[...] - forma shqiptimore e fjalës (p.sh. shkruhet: <pedagogia>, lexohet [pedagog-ja])

> - forma në të majtë kalon fonetikiht në formën në të djathtë (p.sh. shtëpi > shpi)

- < - forma në të djathtë kalon fonetikisht në formën në të majtë (p.sh. rryp < rrip)
- / - shënon një ndërprerje të shkurtër në rrjedhën e të folurit (presjen), si (p.sh. Agroni/ shoku im ...)
- // - shënon një pushim të gjatë, të ngjashëm me pikën (p.sh. Unë jam student//)

Shenja diakritike

ˇ = zanore e shkurtër	→	ă , si <i>kăm</i> “kam”
: = zanore e gjatë	→	a:, si <i>pla:k</i> “plakë”
. = zanore e mesme	→	a., si <i>pla.ki</i> “plaku”
~ = zanore hundore	→	ã, si <i>nã:n</i> “nënë”
î = gjysmëzanore	→	i, si <i>ai</i> “ai”
^ = diftong	→	âi, si <i>shpâi</i> “shtëpi”
í = zanore e theksuar	→	lirí
ì = zanore me theks dytësor	→	lirìdâshës

Zanoret	
i	u
y	
e ə	o
æ	a
ə = ë	→ nənə “nënë”
ø = y e hapur	→ vø “ve, vezë”
æ = a e përparme, më e mbyllur	→ præp “prapë”

Shkurtime për emrat e fshatrave shqiptare të Karadakut të Shkupit:

Bll. – Bllacë
Br. – Brezë
Mal. – Malinë
Gr. – Grushinë
Orll. – Orllancë
Moj. – Mojancë
Str. – Straçincë
Lub. – Luboten
Tan. – Tanushë

I. HYRJE

1.1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR KARADAKUN


Fushëgropa e Shkupit (me sipërfaqe prej 1818 km² që përbën 7% të sipërfaqes së përgjithshme të Maqedonisë së Veriut), paraqet tërësi natyrore më vete dhe është zona më e populluar në Maqedoni, me trafik më të dendur dhe me Shkupin si kryeqytet është rajoni më i zhvilluar në pikëpamje ekonomike.

Kjo fushëgropë ka strukturë specifike të reliefit, e cila e ka kushtëzuar lokalizimin hapësinor dhe topografik të lagjeve, kështu që rrjeti i lagjeve nuk ka kompozicion të njëjtë. Kur bëhet fjalë për mjedisin rural, ai përfshin një sipërfaqe prej 1.535 km² apo 84,4% të gjithë sipërfaqes së fushëgropës.¹

Karadaku është krahinë kodrinore e malore që shtrihet në pjesën veriore të Maqedonisë dhe në pjesën jugore të Kosovës. Malet ngrihen përjetë nga fushëgropa e Shkupit (në jug), lugina e Kumanovës (në lindje), lugina e Gjilanit (në veri) si dhe rrjedha e lumit Lepenc. Në ultësitrat e Karadakut gjenden katër qytete: Shkupi (në jug), Kumanova (në lindje), Kaçaniku (në perëndim) dhe Gjilani (në veri).²

¹ Проф. Д-р Митко Панов, *Селата во Република Македонија*, Скопје, 1993, ф. 246.

² http://hr.wikipedia.org/wiki/Skopska_Crna_Gora.



1.1.1. PËRDORIMI PARALEL I DY TOPONIMEVE

Në këtë monografi kemi përdorur dy format e emërimit të kësaj krahine: **Karadaku i Shkupit** dhe **Mali i Zi i Shkupit**. Është e njohur se që nga shekulli III para erës sonë Shkupi ishte i banuar nga dardanët, ndërsa më vonë u pushtua nga romakët. Gjatë periudhës ilire Shkupi ishte kryeqendra e Dardanisë dhe njihej me emrin Scupi. Siç dihet, dardanët shtriheshin në trekëndëshin Nish-Sofje-Shkup.

S'do mend se toponimi Mali i Zi duhet të jetë forma më e vjetër e këtij emërvendi. Meqë fisi i njohur ilir, dardanët ishin banorët e parë të këtij territori, rrjedhimisht ata si banorët e parë, për të parën herë e kanë emërtuar këtë krahinë me Mal i Zi, në bazë të ngjyrës që kanë malet e kësaj zone. Sllavët pasi u dyndën dhe u vendosën në këto vise këtë toponim e përkthyen a kalkuan nga Mali i Zi në Crna Gora. Përcaktori i Shkupit (скопска – skopska) tregon pjesën e kësaj krahine që gjendet më afër Shkupit.

Me shtrirjen e perandorisë Osmane në Gadishullin Ilirik, emrin e vjetër ilir, Mali i Zi osmanët e kalkuan a përkthyen në Karadağ. Ky emër i turqishtes u përhap ndër shqiptarët dhe tani këtë krahinë e njohin me emrin Karadak.

Nga ana tjetër, me emrin Karadak kuptojmë një krahinë të gjerë midis Shkupit, Kumanovës, Gjilanit, Preshevës dhe Kaçanikut; ndërsa me emërvendin Mali i Zi i Shkupit emërtohet vetëm një pjesë e këtij territori, përkatësisht zona në afërsi të Shkupit, pra vetëm pjesa e kësaj zone që administrohet nga Shkupi, që i takon qarkut (komunës) së Shkupit. Por, toponimet Karadaku i Shkupit dhe Mali i Zi i Shkupit emërtojnë po të njëjtin territor, d.m.th. zonën kodrinore-malore që fillon nga Shkupi e shtrihet në veri deri në kufi me Kosovën.

Në këtë monografi më shpesh e kemi përdorur toponimin Karadaku i Shkupit e më rrallë Mali i Zi i Shkupit. Përveç si toponim, emri Karadak-u përdoret dendur edhe si patronim ndër

shqiptarët e kësaj krahine e më gjerë.

1.1.2. MALI I ZI I SHKUPIT NË FJALORIN ENCIKLOPEDIK SHQIPTAR

Në Fjalorin enciklopedik shqiptar³ në sythin përgatitur nga Gjovalin Gruda dhe Asllan Selmani për Karadakun e Shkupit ose Malin e Zi të Shkupit shkruan:

“**Mali i Zi** (ose Karadagu) **i Shkupit**. Zonë kodrinore-malore në JL të *Fushës së Kosovës* (shih), në kufi midis Kosovës, Maqedonisë dhe Serbisë. Pjesa më e madhe i përket Maqedonisë. Kufiri VP dhe JL shënohet nga lugina e Moravës së *Binçit* (shih), ndërsa ai JL dhe VL përkatësisht nga *gryka e Kaçanikut* dhe e *Konçulit* – (shih). Shtrihet rreth 45 km në drejtimin VL-JP dhe deri 11 km në drejtimin VP-JL; ka lartësinë 800-1490 m mbi nivelin e detit. Në ndërtimin litologjik mbizotërojnë shistet e gneiset e Paleozoit, magmatikët dhe *flishi* (shih) i Mesozoit dhe më pak *molasa* (shih) e Paleogjenit. Rrjeti i dendur i degëve të *Moravës së Binçit* (shih), që ushqehen kryesisht nga ujërat e borës së shkrirë, e ka copëtuar relievin e M. Z. Sh. në një varg luginash e kurrizesh. Lartësinë më të madhe (1490 m) e shënon maja e Kopilancës. Në relievin e malit mbizotërojnë format erozive (gryka të çara thellë nga përrrenjtë malorë, shpate të thepisura), si dhe format karstike sipërfaqësore e nëntokësore (gjenden shumë shpella, por me përmasa të vogla). Në brezin e rrëzës së malit janë gjetur 5-6 nivele tarracash liqenore pliokuaternare nga 780 m më e larta, deri 300 m më e ulëta. Klima e M. Z. Sh. Dallohet për dimër të ashpër dhe reshje bore, kurse vera është relativisht e freskët dhe e thatë. Temperatura mesatare e janarit është 0, 9⁰ C, e korrikut 0, 20.7⁰ C, ndërsa sasia mesatare e reshjeve rreth 600 mm. Mbulesa bimore zë rreth 50% të sipërfaqes dhe përfaqësohet nga kati i dushkut dhe i ahut. Dallohet si zonë bujqësore (toka e punueshme zë rreth 31% të sipërfaqes) dhe pjesërisht për shfrytëzimin e pyjeve. Qendrat kryesore të banimit janë: qyteti i *Kaçanikut* (shih), fshatrat Letnicë, Stumbë, Lubishtë, Pogragje etj.”

1.1.3. POZITA GJEOGRAFIKE

Gjykoj se në ribotimin e ardhshëm të “Fjalorit enciklopedik shqiptar” do të ishte mirë të bëheshin përmirësimet e nevojshme në sythin e Karadakut. Në bazë të të dhënave që kemi arritur të sigurojmë, na del se ndërmjet Shkupit, Kumanovës, Gjilanit, Preshevës dhe Kaçanikut shtrihet një krahinë malore që quhet Karadak. Këto vargmale ngjiten përpjetë nga lugina e Shkupit (në jug), lugina e Kumanovës (në lindje), Lugina e Gjilanit (në veri) dhe rrjedha e lumit Lepenc (në perëndim). Ky masiv malor shtrihet në drejtimin jugperëndim - verilindje, me majën më të lartë Ramno që ka 1.651 metra lartësi mbidetare.⁴ Varësisht cilin qytet e ka më afër, apo nën administrimin e cilit qytet është edhe quhet: Karadaku i Kumanovës, Karadaku i Gjilanit, Karadaku i Shkupit ose rrethi i Kumanovës, rrethi i Gjilanit, rrethi i Shkupit. Pra, Karadaku është krahinë që ndahet në rrethe varësisht se cilin qytet ka më afër. Rrjedhimisht, nuk është e saktë

³ AShSh, *Fjalor enciklopedik shqiptar* 2, Tiranë, 2008, f. 1609.

⁴ http://hr.wikipedia.org/wiki/Skopska_Crna_Gora.

ajo që thuhet në Fjalor se “qendrat kryesore të banimit janë: qyteti i *Kaçanikut* (shih), fshatrat Letnicë, Stumbë, Lubishtë, Pogradje etj.”, por, i saktë është pohimi se qendra kryesore a më të mëdha ekonomike janë Shkupi, Gjilani e Kumanova. Qytetet më të afërta të Karadakut të Shkupit janë Shkupi, Kumanova e Kaçaniku. Emri i fshatit “Stumbë” është i gabueshëm, por duhet të jetë Stubëll. Në të vërtetë, ndërmjet Vitisë dhe Letnicës që gjenden në Kosovë (më saktësisht në rrugën që çon nga Vitia për Letnicë, në krahun e majtë, nja 5-6 km në brendinë e shpateve malore) gjenden dy fshatra që quhen saktësisht Stublla e Epërme dhe Stublla e Poshtme (unë kam qenë shumë herë në këto dy katunde).

Në tekstin e Fjalorit enciklopedik shqiptar përmendet toponimi “lugina e Moravës së Binçit”, ndërsa kjo te ne si lum botërisht njihet si Morava e Binçës, ndërsa lugina e saj si lugina e Moravës së Binçës. Po kështu nuk quhet “maja e Kopilancës”, por maja e Kopilaçës.

Karadaku i Shkupit (që e quajmë edhe Mali i Zi i Shkupit, *maq.* Скопска Црна Гора (Skopska Crna Gora), *anglisht* Black Mountain of Skopje); shtrihet në pjesën veriore të Maqedonisë dhe në skajin jugor të Kosovës. Në lindje kufizohet me fshatrat e Kumanovës dhe të Likovës, ndërsa në perëndim si kufi natyror mund të merret lumi Lepenec si edhe rruga magjistrale Shkup – Prishtinë.

Karadaku i Shkupit shtrihet në pjesën veriperëndimore të Fushëgropës së Shkupit, përkatësisht në koordinatat 42⁰17'N21⁰43'E. Nga veriu, perëndimi si dhe nga lindja është mbyllur me kurorë mali si gjysmërreth ose me pjesë malore më të ulëta. Vetëm në pjesën jugore kufiri i Karadakut të Shkupit nuk është plotësisht i përcaktuar, meqë është rrafshinë me sipërfaqe të valëzuar edhe me ndonjë kodrinë.⁵

Malet e Karadakut (ose Malit të Zi të Shkupit, Karadakut të Shkupit) të cilat njihen shpesh si Karadaku i Shkupit, shtrihen nga Gryka e Kaçanikut, gjegjësisht nga lumi Lepenc në perëndim e deri te Gryka e Konçulit tek lumi Morava e Binçës në jug-lindje, me një gjatësi prej rreth 50 km, ndërmjet Anamoravës në veri, Luginës së Preshevës në jug-lindje dhe fushës së Shkupit në jug.

Struktura e relievit është mjaft e copëtuar. Këtë e bëjnë luginat e lumenjve si pjesët më të ulëta dhe majat e maleve si pjesët më të larta të relievit. Sedimentet e reja në pjesën perëndimore, mesozoike në pjesën e mesme dhe ato të vjetra të paleozoikut në lindje tregojnë një larmi në ndërtimin gjeologjik. Në formimin e relievit kanë ndikuar rrjedhat e lumenjve që i kanë dhënë kësaj pjese një strukturë të copëtuar. Ata, duke zbritur prej zonave të larta, kanë thelluar shtratin e tyre dhe kanë bartur material të gërryer me vete. Lumenjtë më të rëndësishëm të kësaj krahine janë: Golemareka, Letnica, Karadaku, Lashtica, Pasjani, Llapushnica etj. Të gjithë këta derdhen në Moravën e Binçës.

Relievi i lartë i kësaj zone pengon depërtimin e erërave të nxehta të jugut, ndërsa ndaj veriut ai është i hapur. Zona e maleve të Karadakut të Shkupit ka një izotermë vjetore 9° C ose 10° C, ndërsa reshjet mesatare vjetore janë ndërmjet 700 e 800 mm.

Kushtet e tilla natyrore kanë ndikuar në fizionominë e pejsazhit. Sipërfaqet më të mëdha janë pyjet, të cilët përfshijnë më shumë se gjysmën e territorit të trevës. Sipërfaqet e shfrytëzuara nga bujqësia përfshijnë 31% të territorit. Kullotat dhe livadhet përbëjnë rreth 11% të sipërfaqeve të tokave. Një strukturë e tillë e tokave ka kushtëzuar që popullsia të merret me shfrytëzimin e tokave të punës dhe të sipërfaqeve pyjore. Blegtoria është për shkak të bazës së vogël ushqyese më e kufizuar. Malet e larta janë prej 700 - 1.500 m. Pikat më të larta të tyre janë: Maja e

⁵ Бојко Стојановски, *Љубанци и Скопско Црногорие*, Скопје, 1994, f. 167.

Kopilaqës me 1.490 m, Maja e Zezë me 1.219 m dhe Maja Tupan me 1.178 m.⁶

Brenda krahinës së Malit të Zi i Shkupit (Karadakut), vendbanimet që i takojnë trevës të Kumanovës janë: Komuna e Likovës: Nikushtak, Vishticë, Ropalcë, Mateç, Hotël, Strimë, Goshincë, Dumanoc, Gllazhnjë, Hërkoc, Likovë, Orizare, Sllupçan, Allashec, Runicë, Izvor, Bellanoc, Zllakuçan, Strazhë, Vaksincë dhe Llojan; Komuna e Preshevës: Miratoc dhe Bukuroc; Komuna e Bujanocit: Llukarcë.


Brenda krahinës Malit të Zi i Shkupit (Karadakut), vendbanimet që i takojnë trevës të Preshevës janë: Komuna e Preshevës: Preshevë, Tërnavë, Norçë, Kurbali, Rahovicë, Ilincë, Gosponicë, Bukoc, Shoshaja e Epërme, Shoshaja e Poshtme, Corroticë, Raincë, Gare dhe Berçec; Komuna e Bujanocit: Letovicë, Gramadë, Verban, Nesalcë, Osllarë, Lluçan dhe Levosojë.⁷

Pjesa veriore e Malit të Zi të Shkupit (në bazë të veçorive gjuhësore) përkon me kufirin ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës. Në lindje kufizohet me fshatrat e Kumanovës: Goshincë, Strimë dhe Nakushtak; ndërsa në perëndim si kufi natyror mund të merret lumi Lepenec, por edhe rruga magjistrale Shkup - Prishtinë.

Duke filluar nga pjesa jugperëndimore e duke shkuar nga pjesa verilindore e më pas duke vazhduar nga jugu në Karadakun e Shkupit sot gjenden këto fshatra: Brazdë (maqedonisht Бразда), Glluvo (maq. Глуво), Çuçer (maq. Чучер), Gornjane (maq. Горњане), Banjane (Бањане), Bllacë (maq. Блаце), Tanushë (maq. Танушевци), Brezë (maq. Брест), Brodec (maq. Бродец), Pobožhje (maq. Побожје), Kuçevishtë (maq. Кучевиште), Mirkovc (maq. Мирковци), Lubancë (maq. Љубанци), Luboten (maq. Љуботен), Rashtak (maq. Раштак), Bullaçan (maq. Булачани), Creshevë (maq. Црешево), Straçincë (maq. Страчинци), Grushinë (maq. Грушино), Orllancë (maq. Орëанци), Moјancë (maq. Мојанци) dhe Bërnjancë (maq. Брњарци). Shih hartën topografike të Karadakut të Shkupit:

⁶ http://sq.wikipedia.org/wiki/Malet_e_Karadakut, shkarkuar më 01. 07. 2020

⁷ Jovan Trifunovski, *Kumanovsko-Preševska Crna Gora*, Srpska Akademija Nauka, Beograd, 1952, f. 58-60, 83-84.



1.1.4. POPULLSIA

Në Karadaku e Shkupit jetojnë popullsi me përkatësi të ndryshme kombëtare: shqiptarë, maqedonas, serbë, myslimanë, turq, romë dhe të tjerë.

Në këtë monografi do të përshkruajmë gjendjen e tanishme të të folmes shqipe të Karadakut të Shkupit, përkatësisht të folmen e 11 fshatrave me mbi 25 mijë banorë, pra të katundeve Tanushë, Brezë, Malinë,⁸ Bllacë, Luboten, Straçincë, Orllancë, Mojcancë, Grushinë. Për shkak se pjesa më e madhe e banorëve të fshatrave Haraçinë (maq. Арачиново) dhe Hasanbeg (maq. Сингелиќ), që gjenden në jug të zonës, janë të ardhur nga katundet përreth, në aspektin dialektor edhe këto dy fshatra i takojnë këtij areali.

Sipas ndarjes së re territoriale të vitit 1996 të komunave të Maqedonisë, katundet e

⁸ Malina dikur ka qenë mëhallë e fshatit Brezë, por tani ajo llogaritet si fshat më vete. Kjo ndarje si dy fshatra më vete shënohet edhe në dokumentet personale (certifikatë të lindjes, letërnjoftim, pasaportë). Edhe banorët e këtyre vendbanimeve e bëjnë dallimin: njëri thotë unë jam i Brezës (jam pi Breze), ndërsa tjetri thotë unë jam i Malinës (jam pi Maline). Në pikëpamje të veçorive gjuhësore, këto dy fshatra i takojnë një të folmeje të vetme, meqë nuk kanë asnjë dallim gjuhësor.

banuara me shqiptarë në krahinën e Karadakut të Shkupit u përkasin disa komunave (bashkive): fshati Luboten i përket komunës së Çairit; fshati Straçincë dhe Hasanbeg i takojnë komunës së Gazi Babës; Tanusha, Bllaca dhe Breza administrativisht i takojnë komunës së Çuçer-Sandevës; Haraçina është ndarë komunë më vete dhe përfshin fshatrat Mojancë, Orllancë dhe Grushinë.⁹

Në vijim do të paraqesim disa të dhëna statistikore nga regjistrimi i popullatës, familjeve dhe të mirave materiale i vitit 1994, ndërsa për disa fshatra të dhënat e vitit 1981.¹⁰ Që moti në Maqedoninë e Veriut nuk është kryer ndonjë regjistrim i besueshëm i popullsisë, amvisërive dhe banesave. Regjistrimi i fundit u bë më vitin 2002, ndërsa ai i vitit 2012 u ndërpre në gjysmë dhe nuk përfundoi me sukses.

katundi	numri i banorëve	lartësia mbidetare	sipërfaqja e përgjithshme në km ²	tokë e punueshme në ha	kulloso në ha	pyje në ha
1. Mojancë	1531	580	8.8	236	345	268
2. Orllancë	683	400	4.1	195	176	9.5
3. Grushinë	1007	460	9.0	634	181	36
4. Tanushë	805	950	22.3	632	254	1314
5. Bllacë	1077	770	6.9	172	334	1843
6. Brezë	1142	1200	47.3	1277	834	2548
7. Luboten	1613	-	13.3	635.9	323.3	253.5
8. Straçincë	650	-	6.7	253.9	318.8	72.4
Gjithsej banorë të këtyre fshatrave: 8.508						

Tabela 1. Të dhëna statistikore për fshatrat e Malit të Zi të Shkupit

Të dhënat statistikore me të dhënat e marra drejtpërdrejt në terren nga informatorët tanë gjatë ekspeditave brenda dy vitesh (1995-1996), si dhe informatat e siguruar më vonë nga studentët, lidhur me numrin e banorëve, për shumë katunde nuk përkojnë. Të dhënat e dëgjua nga informatorët tanë i kanë konfirmuar e pohuar edhe njerëz të tjerë të fshatrave përkatës. Prova saktësie për këto të dhëna kemi gjetur edhe më vonë nëpërmjet studentëve tanë që studiojnë në Katedrën e Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare në Shkup. Si titullar i lëndës së Dialektologjisë shqiptare (ky kurs mbahet në semestrin V, VI; përkatësisht në dy semestra në vitin e tretë të studimeve katërvjeçare) me vite rresht i kam angazhuar studentët që të sjellin material dialektor ose material onomastik të vjelë drejtpërdrejt nga fshatrat e tyre të lindjes apo të prejardhjes së tyre familjare.


Do theksuar se për shkak të kushteve të vështira ekonomike, katundet malore të Karadakut janë zbrazur gjithnjë me kalimin e kohës, meqë janë dyndur në vendbanimet e rrafshëta të krahinës, kështu që numri i banorëve të përhershëm në këto vendbanime është zvogëluar, por numri i popullsisë është rritur sidomos në fshatrat e qytetet përreth Malit të Zi të

⁹ Панов, Митко - Митев, Младен: *Општините во Република Македонија според новата поделба во 1996 година – основни просторни, демографски и аграрно-структурални обележја*, Скопје, 1997, f. 240-265.

¹⁰ Të dhënat statistikore për fshatrat Mojancë, Grushinë, Orllancë, Bllacë, Brezë dhe Tanushë janë marrë nga libri i bashkautorëve Митко Панов - Младен Митев: *Општините во Република Македонија според новата поделба во 1996 година...*, f. 240-257; ndërsa për fshatrat e tjera nga libri проф. д-р Митко Панов, *Селата во Република Македонија I*, Скопје, 1993, f. 253-254.

Shkupit. Nga informatat e marra, na dalin këto të dhëna:

1. Luboteni ka 3000 banorë me 500 shtëpi, nga të cilat 30 shtëpi janë maqedonas.
2. Orllanca ka 700 banorë me 100 shtëpi.
3. Mojanca ka 900 banorë me 160 shtëpi.
4. Breza, bashkë me Malinën, kishte 600 banorë me 65 shtëpi. Banorët thonë se para vitit 1945 ka pasur 400 shtëpi me 4000 banorë.
5. Tanusha kishte 100 shtëpi me 850 banorë.
6. Bllaca ka 115 shtëpi me 1000 banorë.
7. Grushina ka 122 shtëpi me 1500 banorë.
8. Stračinca ka 150 shtëpi me 750 banorë (10 shtëpi janë maqedonas).



Skica 1. Pikat dialektore të eksploruara

Nga kjo del se në katundet e Karadakut të Shkupit afërsisht jetojnë 9.300 banorë shqiptarë, pa llogaritur katundet Haraçinë (që me regjistrimin e 2002 kishte 7.351 banorë e që llogaritet fshati më i madh në Maqedoni) e Hasanbeg që ka afër 2.700 shtëpi dhe 9.000 banorë, ku kanë zbritur e tani jetojnë një numër i madh i karadaklinjve. Nga këto të dhëna del se numri i përgjithshëm i popullatës rezidente në katundet e Karadakut si dhe në fshatrat e kësaj zone (Haraçinë e Hasanbeg), pa përfshirë të shpërngulurit në Turqi si dhe në vende të tjera të Maqedonisë së Veriut, Kosovës, Evropës e botës është mbi rreth 25.600 veta. Pra, 25.000 veta që nuk kanë migruar jashtë krahinës së tyre flasin shqipen e Malit të Zi të Shkupit.

Krahina e Malit të Zi të Shkupit në sajë të konfiguracionit tokësor dhe lartësisë mbidetare mund të ndahet në zonë malore, kodrinore dhe zonë e sheshtë (zonë fushore). Në Karadak maja më e lartë është Ramno që arrin 1.651 metra lartësi mbidetare.

Klima në Karadak dallon dukshëm nga vendi në vend, nga rrafshina e deri në pyjet më të larta. Deri më 1000 m lartësi mbidetare mbizotëron klimë e butë kontinentale, ndërsa në zonat mbi 1000 m klimë e ftohtë malore.

Fshatra tipike malore janë Breza, Malina e Tanusha; kodrinore-malore janë Mojanca e Orllanca; ndërsa kodrinore janë Luboteni, Straçinca e Bllaca. Katundet e Karadakt të Shkupit të banuara me shqiptarë mund të grupohen në dy tipa kryesorë: fshatra me shtëpi të tipit të grumbulluar (të ngjeshur) dhe fshatra me shtëpi të tipit të shpërndarë. Tipit të parë i përkasin shumica e fshatrave, përveç fshatrave Brezë e Tanushë.

Në varësi nga madhësia, katundet e Karadakt të Shkupit përbëhen prej më pak ose më shumë mëhallësh. Emrat e mëhallëve rëndom lidhen me emrat familjarë (patronimet) ose me emrat e fiseve: Mahalla e Rrokve (Straçincë), Mahalla e Çajanve (Orllancë); Fera, Kovaçi, Doda, Tusha, Arnori, Lusjani, Bardhi, Shehi, Doçi, Koka, Imishti, Amati, Luçi, Sali Hasi, Muça, Çajani, Toçi, Rruka (Bllacë); Alimet, Morriz, Du:rr, Hoxht, Molie (Brezë); Memishallar, Trakalaç, Hodalla:r (Tanushë); Rukoll, Imisht, Veshnjan, Koxhobexh (Grushinë). Emra mëhallësh sipas vendit të ndodhjes (vendndodhjes) a pozitës gjeografike kemi më pak, si Mahalla e Epër, Mahalla e Poshtër (Orllancë); Mahalla e Poshtër, Mahalla e Na:lt (Straçincë). Të pakta janë edhe emrat e mëhallëve që kanë për bazë kohën e ardhjes së tyre në një vend: Doshlaki (Bllacë), si edhe ato që lidhen me ndonjë llogar: Mahalla e Tenxherve (Brezë), Çele (Tanushë).

Si rëndom në fshatrat e tjera shqiptare, po edhe në gjithë Ballkanin, edhe në Malin e Zi të Shkupit katundet kanë qendrën e tyre shoqërore - sheshin, ku zakonisht kemi ndonjë shkollë, xhami, çezmë apo krua ose ndonjë objekt tjetër me rëndësi shoqërore. Rrjeti i rrugëve përvijohet lirshëm nëpër terren, duke ndjekur konfiguracionin tokësor. Rrugët janë të ngushta dhe në të shumtën e rasteve të çojnë në qendrën e fshatit. Ato lidhen edhe me peizazhin përreth, përkatësisht mundësojnë vajtje-ardhjen e fshatarëve në tokat e tyre.

Karadaku është i pasur me bimë barishtore. Përveç barit që përgjithësisht e mbulon këtë krahinë, rritet shumë fieri, hithrat, luleshtrydhja, çaji i malit, kamomili etj. Nga drunjtë rritet ahu, bungi, qarri, shkoza, dëllinja, mështekna, frashri, lajthia, thana etj.

Në pyjet e kësaj krahine shihen shpesh dhelpra, ujku, derri i egër, lepuri, ketri, vjedulla, dreri, ariu etj. Nga shpezët vërehen pula e egër, mullizeza, laraska, skifteri, shqiponja, dallëndyshja, qyqja, huti, gjeli i egër, pupëza, turreci, qukapiku, pëllumbi, trumcaku etj.

Kushtet e ndryshme klimatike, terreni i shumëllojtë, materiali ndërtimor në dispozicion, madhësia e familjeve dhe mundësitë e tyre ekonomike ka bërë që të vërejmë ndërtime të ndryshme shtëpish: nga më të rëndomt, më të thjeshtat deri në shtëpi moderne me përmbajtje dhe me formë bashkëkohëse. Në fshatrat fushore dhe kodrinore, ku mban më ngrohtë dhe nuk fryjnë erëra të ftohta, më shpesh ndërtohen godina të tipit të shtëpive të hapura, shtëpi me çardak, njëkatëshe e dykatëshe. Tani shohim jo pak shtëpi të ndërtuara me material bashkëkohor, shumëkatëshe e me shumë tarraca. Klima e ashpër malore kushtëzon ndërtimin e shtëpive të tipit të mbyllur, kryesisht të ndërtuara me gurë. Brenda shtëpisë ose përbri saj shpeshherë kemi edhe oda, ahur, plevicë, garazh ose ndonjë objekt tjetër shoqërore.¹¹

Brendësia e shtëpive të dikurshme të fshatrave malore, sidomos e fshatrave Brezë, Malinë e Tanushë është e ngjashme me enterierin e shtëpive të moçme, tradicionale shqiptare. Oxhaku është elementi më i rëndësishëm i brendisë së shtëpisë. Në oda gjejmë dërrasa të mbështetura

¹¹ Крум Томовски, *Населби и народна архитектура*, Етнологија на Македонците, МАНУ, Скопје, 1996, 84.

brinjazi në faqe të murit, që përdoren si dollap, rafte etj., që shërbejnë për të vënë dhe ruajtur enë të amvisërisë, si gjyma, gota, ibrikë, filxhanë, xhezve, tabaka, ndonjë enë zbukurimi ose edhe diçka të varur në mur, e që të gjitha, përveç anës praktike për përdorim, kanë edhe funksion estetik.

Pranë shtëpive që kanë zënë pozicione të ndryshme në oborr, gjejmë edhe objekte të tjera bujqësore e blegtorale, si hambar, pleme, kosh, kotec, garazh ose edhe ndonjë objekt tjetër. Oborret zakonisht janë të rrethuara me material ndërtimor që gjendet në vendin përkatës, më shpesh me gurë e më rrallë me blloqe.

Në të ushqyerit shfrytëzohet çdo gjë që natyra ua dhuron dhe që mund ta sigurojnë nga veprimtaria e tyre themelore - bujqësia e blegtoria.¹² Buka e grurit është ushqimi kryesor dhe themelor i tyre. Konsumohen edhe gatesa të ndryshme nga brumi. Ushqimi plotësohet edhe me mish kafshësh e shpesësh shtëpiakë, ndonjëherë edhe me mish gjahu, kryesisht mish lepuri, qumësht dhe bulmet. Vend të rëndësishëm në ushqimin e banorëve të Karadakut të Shkupit zë fasulja, patatja dhe orizi. Nga kulturat kopshtare hahen shumë domatet dhe specat. Nga perimet në tryezën e karadakasve servohet shpesh shalqiri, pjepra e luleshtrydhet; ndërsa nga pemët kultivohet e hahet molla, kumbulla, dardha, rrushi etj.

Marrë në përgjithësi, me sundimin pesëshekullor të perandorisë Osmane në Maqedoni, edhe te shqiptarët e Karadakut të Shkupit mbizotëron kultura orientale e kuzhinës. Për shkak të kushteve të vështira për jetesë, migrimi fshat - qytet, apo nga fshatrat malore në fshatrat fushore është shumë i madh. Valë të tilla të lëvizjes së popullatës nga vendet malore në vende të rrafshëta ka pasur qëmoti, por kanë qenë më intensive pas Luftës së Dytë Botërore dhe nuk kanë të ndalur edhe sot.

Pas konfliktit të armatosur më vitin 2001, fshatrat Brezë, Malinë e Tanushë thuajse u zbrazën plotësisht. Shumë fshatarë lanë shtëpitë e tokat për të shpëtuar familjet dhe zbritën në Haraçinë, Hasanbeg, Inxhikovë, Kumanovë e Gjilan; disa edhe u strehuan në fshatrat e Vitisë e të Letnicës. Edhe sot e kësaj dite ka refugjatë nga Breza që ende jetojnë në ndonjë nga shtëpitë e Letnicës (afër Vitisë) në Kosovë dhe nuk janë kthyer ende në vendlindje. Disa banorë të këtyre vendeve malore, edhe pse kanë ndërtuar shtëpi në katundet më afër qyteteve ose në Shkup, nuk i kanë shkëputur plotësisht lidhjet me vendlindjen. Ndonjë prej tyre shkon herë pas here në katund për të punuar tokën, ndokush e kalon verën larg timit, zhurmës, stresit e mjedisit të ndotur të qytetit, në natyrën e pastër e të paprekur të kësaj malësie.

Por, përgjithësisht numri i banorëve të përhershëm (rezidentë) në katundet malore të Malit të Zi të Shkupit, në Brezë, Malinë e Tanushë është shumë i vogël. Shpërngulja e popullsisë shqiptare ka qenë dhe është e vrullshme jo vetëm nga fshatrat e izoluara malore, por edhe nga fshatrat kodrinore-malore. Shumë banorë të fshatrave Luboten, Bllacë e Grushinë tani më jetojnë në Shkup, në Hasanbeg e Haraçinë. Jo pak shqiptarë nga Karadaku i Shkupit punojnë e jetojnë në shtetet e Evropës e të botës, shumë kanë migruar edhe në Turqi.

1.1.5. E KALUARA PËRGJAKSHME DHE E LAVDISHME E KARADAKUT

Historia e shqiptarëve të rajonit të Karadakut është sa e lavdishme aq edhe e përgjakshme dhe e dhembshme. Në këto vise janë zhvilluar luftëra të ashpra që nga koha e ilirëve dardanë të lashtë, kanë vazhduar në kohën e mesjetës e deri në kohën më të re, me luftën për të drejta të njëjta të shqiptarëve me maqedonasit, që u zhvillua më vitin 2001.

¹² Бранислава Пауновска, *Народна исхрана*, Етнологија на Македонците, МАНУ, 1996, 133.

Se kanë ndjenjë kombëtare të zgjuar, se janë kundër çdo pushtuesi dhe se luftojnë për mbrojtjen e kufijve etnikë, karadaklinjtë e kanë dëshmuar edhe në kohën e sundimit osman nën udhëheqjen e Idriz Seferit.¹³

Idriz Seferi ishte atdhetar i dalluar, udhëheqës ushtarak popullor i Lëvizjes Kombëtare që bashkë me Isa Boletinin u shndërruan në legjendat e asaj kohe, dhe jo vetëm. Që në moshë të re mori pjesë në qëndresën popullore kundër shtypjes ekonomike e kombëtare që sollën reformat e Tanzimatit. Më 1875 u burgos nga autoritetet osmane. Mori pjesë në kuvendet e në veprimet luftarake të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe të asaj të Pejës. Jeta dhe vepra e Idriz Seferit është e lidhur gjithëherë me ngjarjet e mëdha të historisë shqiptare të kohës, që prej Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e deri në ngritjen e flamurit në Vlorë më 1912.¹⁴

Krahina e Karadakut (aso kohe kishte rreth 40 fshatra) jo rrallë kishte ngritur krye kundër reformave shtypëse të Portës së Lartë. Aty tagrambledhësit shkonin, të shoqëruar me ushtri të tëra, ngase populli fukara nuk kishte ç'të jepte. Kësisoj, vit pas viti, nëpër malet e lira të Kaçanikut, shkruheshin faqe të reja të epopesë së qëndresës. Në fillim të viteve 40 të shekullit XIX, Porta e Lartë dërgoi disa fermanë në trevën e Karadakut. Por, ndërsa fermanët shkonin e vinin, malësorët e Karadakut nuk pranonin ndikimin e tyre. Është pikërisht kjo arsyeja që në pranverën e vitit 1843, forca të mëdha ushtarake osmane të mësyjnë drejt Karadakut, duke marrë qindra familje që kundërshtonin këtë reformë në dobi të disa bejlerëve që synonin zgjerimin e çifligjeve të tyre.¹⁵

Janë të njohura luftërat e drejta të shqiptarëve të kësaj ane për të mbrojtur “pragun e shtëpisë” dhe qenien e tyre kombëtare nga shfrenimet partizane: serbe e bullgare gjatë Luftës së Dytë Botërore. Si rezultat i qëndresës heroike të shqiptarëve të Karadakut, dhe si rrjedhojë e humbjeve të mëdha që pësuan forcat armike, çdoherë që tentonin të shuanin përpjekjet liridashëse të shqiptarëve, herë pas herë u hakmorën, dogjën, shkatërruan, por edhe masakruan popullatën e pafajshme.¹⁶

Patriotët e kësaj ane, gjatë Luftës së Dytë Botërore u bënë veprimtarë të shquar antikomunistë, me veprimtari të koordinuar për çlirim dhe bashkimin kombëtar. Më vitin 1944 Karadaku kishte rreth 3.600 luftëtarë vullnetarë të Ballit Kombëtar, të gatshëm për të luftuar ideologjinë komuniste, për të mbrojtur lirinë dhe kufijtë etnikë.

Në bazë të shënimeve historiografike, rezistenca kombëtare e Karadakut do të shuhet e fundit nga të gjitha trevat e Maqedonisë, si republikë e ish-Federatës Jugosllave. Kësaj rezistence i prinë Sulë Hotla (komandant i Ballit Kombëtar për viset e Kumanovës), Ali Sylë Staneci, Sami Shabedini nga Orizarja, Hamzë Bilalli - Bellanoca me të birin Arifin, Ajet Emiri nga Breza me katër djemtë: Aliun, Shefkun, Isenin dhe Rasimin; Mulla Sadik Sllupçani; Ajet Rainca, Musa Mustafa, Abdyl Durra, Hasan Remniku, Ibrahim Kelmendi, Ali Sylë etj. Më 15 e 16 gusht 1945 në Kopilaçë mbi Tanushë të Karadakut u mbajt një kongres, i quajtur Kongresi i Kopilaçës, apo edhe Kuvendi i Karadakut, ku Balli Kombëtar dhe Organizata Nacional-Demokratike Shqiptare bashkohen nën emërtimin e ri: Lëvizja për Lirimin e Tokave Shqiptare

Në të gjitha rastet kur armiku pësonte humbje në luftërat guerile që u zhvilluan në këtë krahinë, ata hakmerreshin pamëshirshëm e në mënyrë më çnjerëzore, duke vrarë e masakruar popullatën e pafajshme. Si hakmarrje ndaj rezistencës së fuqishme të luftëtarëve trima të Sulë

¹³ Idriz Seferi lindi më vitin 1847 në fshatin Sefer të Karadakut të Gjilanit, vdiq më 25 mars 1927.

¹⁴ http://sq.wikipedia.org/wiki/Idriz_Seferi

¹⁵ http://sq.wikipedia.org/wiki/Idriz_Seferi

¹⁶ Sevdail Demiri, *Flakadani i rezistencës karadakiane*, Kumanovë, 2006, f. 101.

Hotlës, partizano-çetnikët sllavë në periudhën nëntor-dhjetor 1944, kryen masakra të pamëshirshme ndaj popullatës shqiptare në fshatrat Sopot, Allashec, Runicë e Izvor; ndërsa katundin shqiptar Barë (Ba:r) e fshinë nga faqja e dheut që në Luftën e Parë Botërore dhe ai nuk ekziston më.

Fshati Barë, me një histori rreth trishekullore, gjatë ekzistimit të tij dy herë ka përjetuar katastrofa nga dora e njeriut. Më vitin 1912 fshati u dogj nga hordhitë serbe, ndërsa më pas edhe ndërmjet viteve 1914-18 është shkatërruar nga forcat e shfrenuara bullgare. Sipas mbamendjes së banorëve të kësaj ane, fshati për herë të dytë u dogj më vitin 1915. Banorët e Barës, pjesa më e madhe të fisit Shalë, deri më vitin 1918 kanë vizituar tokat dhe malin e këtij vendi, por më pas fshati u braktis përgjithmonë. Bara ka qenë një nyje lidhëse ndërmjet fshatrave përreth: Straçincës, Creshovës, Bullaçanit, Matejçit, Vishticës, Nikushtakut, Mojancës dhe Bërnjarcës. Pas përjetimit të dy shkatërrimeve e djegieve, banorët e këtij fshati (barali:t, baralitë) shtegtuan në Turqi (pjesa më e madhe), disa u shpërndanë nëpër Shkup, Straçincë, Mojancë, Nikushtak dhe Opajë.

Brenda muajve shtator dhe nëntor të vitit 1944, në shenjë hakmarrjeje që kishin pësuar forcat partizane maqedono-bullgare në përpjekje për të pushtuar Preshevën (lanë të vranë 74 ushtarë), ata torturuan e vranë 64 civilë në f. Sopot të Kumanovës, që nga fëmija 11 vjeç, e deri në plakun 95 vjeç.¹⁷ Më 16 e 17 nëntor 1944 në fshatin Bllacë të Karadakut u vranë e u masakruan 111 shqiptarë të pafajshëm. Me rastin tubimit përkujtimor të 60-vjetorit të masakrës së Bllacës (më vitin 2004), në qendër të fshatit, u ngrit një Qendër Memoriale.¹⁸

Publicisti i njohur Emin Azemi ua kushtoi një libër të arratisurve nga Kosova më 1999 për t'i shpëtuar dhunës në përmasa gjenocide që po ushtronte makineria vrasëtare serbe e Millosheviqit. Në të pasqyrohen vuajtjet e mijëra refugjatëve shqiptarë në kampin e Bllacës e të Stankovecit (afër Shkupit), por edhe solidarizimin e miliona shqiptarëve të tjerë me këtë tragjedi kolektive.¹⁹

Diskriminimi ndaj shqiptarëve në të gjitha sferat e jetës shoqërore, e cila ishte e pranishme edhe në sistemin e mëparshëm të Federatës Jugosllave, edhe më shumë u shfaq pas ndarjes së Maqedonisë nga Serbia e Mali i Zi (Sllovenie e Kroacia ishin shkëputur më parë). Pjesëmarrja e shqiptarëve në institucionet shtetërore ishte minimale. Mospërfaqësimi, sidomos në strukturat e sigurimit (policia dhe armatë), te shqiptarët shkaktoi një ndjenjë mosbesimi në këto institucione. Kjo sidomos do të shfaqet gjatë ngjarjeve të Dit-Pazarit (në Shkup) dhe në Gostivar (protestat për shkak të pamundësisë të përdorimit të simboleve etnike), ku gjatë përlëshjeve me policinë mbeten të vranë dhe të persekutuar shumë shqiptarë.

Për shkak se në Maqedoni mungonin institucionet e arsimit sipëror në gjuhën shqipe, shqiptarët më vitin 1994 themeluan Universitetin e Tetovës. Si rezultat i intervenimit policor, në ditën e hapjes, disa shqiptarë e humbën jetën.

Partitë politike të shqiptarëve në Kuvend nuk arritën që t'i institucionalizojnë kërkesat e tyre, sepse çdo herë ishin të mbivotuar nga deputetët maqedonas. Nga ana tjetër, mospërfilljen e kërkesave të shqiptarëve, të cilët llogariteshin si qytetarë të rendit të dytë, politikanët maqedonas e arsyetonin nën pretekstin se me ndryshimin e statusit të shqiptarëve në vend do të federalizohej Maqedonia, ndërsa më vonë edhe do të ndahej. Kriza kosovare e vitit 1999 dhe roli i UÇK-së

¹⁷ Sevdail Demiri, *Flakadani i rezistencës karadakiane*, Kumanovë, 2006, f. 105.

¹⁸ Këshilli redaktues: Shemsi Bardhi, Rahman Selmani, Xhelal Jusufi, Hazbi Lusjani, Sami Tusha, Idaete Sinani, Ismail Sinani, Rakip Doçi, Abaz Islami, Qerim Lita, *Bllaca mes dhembjes dhe krenarisë*, Logos-A, Shkup, 2004.

¹⁹ Emin Azemi, *Bllaca – dhimbja e lirisë*, ITShKSh, Shkup, 2019.

ishin shkak për rritjen e vetëbesimit dhe të bashkimit të shqiptarëve në rezistencën ndaj institucioneve të Maqedonisë.


Për shkak të represionit sistematik nga ana e sistemit, ideja për kryengritje të shqiptarëve kulmoi me konfliktin e armatosur në fillimin e vitit 2001. Si palë në konflikt paraqiten, nga njëra anë, forcat e bashkuara të sigurimit të Maqedonisë (ARM dhe policia) dhe Ushtria Çlirimtare Kombëtare, nga ana tjetër.

Konflikti filloi në fshatin Tanushë të Karadakut, diku kah mesi i shkurtit të vitit 2001 dhe u zgjerua edhe në fshatrat e Tetovës, në disa pjesë të qytetit, në rajonin e Likovës, rrethina e Kumanovës dhe në disa fshatra të Shkupit (Haraçinë, Radushë dhe Luboten). Lufta e 2001-shit në Maqedoni filloi dhe përfundoi në Karadak (u nis në Tanushë, përfundoi në Haraçinë).

Popullata shqiptare moralisht dhe materialisht përkrahte UÇK-në, kurse popullata maqedonase përkrahte armatën e Maqedonisë dhe policinë. Gjatë konfliktit, armata dhe policia granatuan shumë fshatra shqiptare. Si pasojë e këtyre aksioneve ushtarako-policore, u vranë shumë civilë shqiptarë, si p.sh.: familja Zymberi e cila i humbi 10 anëtarë. Qytetarë të pafajshëm shqiptarë u vranë edhe në fshatin Luboten, në lagjen e Çairit dhe në shumë vende të tjera.²⁰

1.1.6. KARADAKU NË ATLASIN DIALEKTOLOGJIK TË GJUHËS SHQIPE

²⁰http://sq.wikipedia.org/wiki/Lufta_në_Ish_Republikën_Jugoslave_të_Maqedonisë_në_2001.



Për të folmen shqipe të Karadikut të Shkupit deri më tani nuk kemi punime të botuara, as edhe material folklorik, përveç një skice dialektore për të folmen e fshatit Tanushë.²¹ Në hartën krahinore të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe²² është paraqitur edhe Karadaku i Shkupit:

Do përmendur se për nevojat e hartimit të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe (ADGjSh) nga krahina e Karadikut të Shkupit material dialektor është vjelë nga e folmja e fshatit Tanushë.²³ Në hartën E, në faqen 60 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe,²⁴ ku janë dhënë emrat e rrjetit të pikave të ADGjSh, Tanusha është shënuar me numrin 60, me emrin Tunishevc. Vlerësojmë se kjo pikë dialektore është shënuar gabimisht, meqë deri më tani këtë variant emri nuk na e ka zënë syri e as dëgjuar veshi. Për emrin e këtij katundi përdoren disa variante të tjerë emrash: Tanushë, Tanishec, Tanushec, Tanushevc (e quajnë vendasit),


²¹ Mehmet Halimi, *Skicë e së folmes së fshatrave Mjak dhe Tanishec*, Kërkime dialektologjike, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1985, f. 353-374.

²² AShSh, IGjL, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vëllimi I, Napoli, 2007, f. 56.

²³ Prof. dr. Bahri Beci, *Vendi i të folmeve shqipe të Maqedonisë në strukturën dialektore të dhqipes*, Jehona 1-2, Shkup, 1994, f. 45-55.

²⁴ AShSh, IGjL, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, Vëllimi I, Napoli, 2007, f. 60.

Tanushevci (Танушевци, maqedonasit), por jo Tunishevc.



Në bazë të të dhënave që na siguron Atlasi për punën e secilit anëtar të grupit hartues të ADGjSh për anketat në terren, në Tanushë anketimi është kryer në vitin 1986 nga dy dialektologë e gjuhëtarë të shquar shqiptarë, Jorgji Gjinari e Gjovalin Shkurtaç; ndërsa skedimin e materialit të anketave si dhe hedhjen e të dhënave të anketave në hartat e punës për Atlasin e ka bërë prof. Gjovalin Shkurtaç.²⁵

1.2. VENDI I TË FOLMES SË KARADAKUT TË SHKUPIT NË STRUKTURËN DIALEKTORE TË SHQIPES

Sipas veçorive gjuhësore, që përkojnë me shtrirjen gjeografike, e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit mund të cilësohet si **e folme më skajore verilindore e gegërishtes qendrore**. Me fjalë të tjera, të folmet e fshatrave të Malit të Zi të Shkupit, si për nga shtrirja hapësinore, ashtu edhe për nga tiparet gjuhësore, përfaqësojnë kufirin më verior të grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore. Pjesa veriore e kësaj krahine në një farë mënyre është përvijuar me kufirin shtetëror të Maqedonisë me Kosovën: fshatrat Tanushë, Bllacë dhe Brezë kufizohen me të folmet e gegërishtes verilindore (afër kufirit të Maqedonisë së Veriut me Kosovën), ndërsa vendbanimet e tjera shtrihen diçka më në jug të kësaj zone kufitare.

Në strukturën dialektore të shqipes, e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit i përket *gegërishtes qendrore*, por në të gjejmë të gërshetuara mjaft tipare gjuhësore të gegërishtes verilindore. Si përfundim mund të thuhet se kjo e folme përfaqëson një izoglosë “**ndërkaluese nga gegërishtja qendrore në gegërishten verilindore e anasjelltas.**”

²⁵ ASHSh, IGjL, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, Vëllimi I, Napoli, 2007, f. 60-64.

II. TIPARET FONETIKE E FONOLOGJIKE

2.1. THEKSI

1. Edhe në të folmen shqipe të Karadakut theksi është dinamik, i palëvizshëm në paradigmat e eptimit dhe i ngulitur në njërën nga dy rrokjet e fundit të fjalës, rëndom në rrokjen parafundore ose në rrokjen fundore, si p.sh.: *fú:sh* - *fúsha* - *fúshat* - *fúshave*; *lúle* - *lúlje* - *lúlja* - *lúles* - *lúlen* - *lúlet* - *lúleve* etj.

2. Në këtë të folme, si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore, kur diftongohen zanoret e mbyllura të theksuara /í/ ose /ú/, atëherë theksi rregullisht qëndron mbi të njëjtën rrokje, përkatësisht në zanoren e parrëgjuar të diftongut. Krahaso shembujt: *kusí* > *kusái*, *burrním* > *burrnêim*, *stërníp* > *stërnâip*, *koleshník* > *koleshnêik*, *núse* > *nâuse*, *arúshê* > *arâush*, *katúnd* > *katâun*, *kërcúng* > *kërcâung* etj. Theksi bie mbi rrokjen e njëjtë edhe kur diftongu dytësor monoftongohet, sipas tipit: *arúshê* > *arâush* > *ará:sh*; *núse* > *nâuse* > *ná:se*; *katúnd* > *katâun* > *katá:n*...

3. Sipas rregullave, bartës i theksit në gjuhën shqipe, si dhe në të folmen e Karadakut të Shkupit, është tema e fjalës (me disa përjashtime), ndërsa shumë rrallë mbaresat rasore, mbaresat e shumësit, nyjet e përparme ose të prapme etj.²⁶

4. Lidhur me dendurinë e përdorimit të zanoreve të theksuara në këtë të folme, kemi vënë re se të gjitha fonemat zanore janë bartëse të theksit: /á/, /é/, /í/, /ó/, /ú/, qofshin ato gojore apo hundore pavarësisht nga gjatësia. Përjashtim nga ky rregull bën zanorja [ë] (që gjithnjë shqiptohet e shkurtër dhe nuk e ka statusin e fonemës, por të tingullit), e cila pothuajse asnjëherë nuk shfaqet në pozitë të theksuar (në Karadak vetëm në pak fjalë),²⁷ si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes.

5. Te fjalët njërrrokëshe e theksuar është zanorja e vetme, si *dí*, *búk*, *drú:*, *hú:*, *sái* (< *sí* < *sy*), *nâuk* (< *núk*), *frâi* (< *fríj* < *fryj* < *fryej*) 'fryj (zjarrit)', *dréjt*, *shtrémt* 'shtrembër', *pé:s* 'pesë', *vén* 'vend' etj.

6. Në këtë kontekst duhet vënë në dukje se me inovacionin e përgjithshëm të të folmeve të gegërishtes, që ka ndodhur këto 3-4 shekujt e fundit, me rënien e zanores fundore të patheksuar [ë], rrjedhimisht edhe zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse, fjalët dyrrrokëshe në këtë të folme, si edhe në të folmet e tjera geqe janë shndërruar në njërrrokëshe. Rënie më të shpeshta të [ë]-së si në mbarë gegërishten kemi te:

- emrat e gjinisë femërore në trajtë të pashquar, si *fu:sh* < *fushë*, *da:rdh* < *dardhë*, *mo:ll* < *mollë*, *lo:p* < *lopë*, *dri:t* < *dritë*, *pu:l* < *pulë*, *a:r* < *arë*, *fa:r* < *farë*, *shko:ll* < *shkollë* etj. Në shembujt e sjellë fjalët njërrrokëshe, dikur të mbarë shqipes, tani me [ë] fundore vetëm në toskërishte; në të folmet geqe, përfshirë edhe të folmen e Karadakut të Shkupit, janë bërë njërrrokëshe.
- shkurtim fjalësh për një rrokje kemi edhe te forma e shumësit të disa fjalëve për shkak të rënies së [ë]-së patheksuar në fundin absolut. Krahaso shembujt: *oxha:k* < *oxhakë*, *baxhana:k* < *baxhanakë*, *dishe:k* < *dishekë*, *fishe:k* < *fishekë*, *ve:sh* < *veshë* etj.

²⁶ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 33.

²⁷ Zanorja [ë] në këtë të folme shqiptohet e theksuar te një numër i kufizuar huazimesh orientale e sllave, si në fjalët *hafëz*, *ërrz*, *ërrsk*, *hëzër*; *tërll*, *kërp*, *sërb* etj., meqë në përbërjen e fjalëve të tilla nuk ka ndonjë zanore tjetër.

7. Vendi i theksit te fjalët shumërokëshe në gjuhën shqipe (standarde dhe dialektore) lidhet para së gjithash me kategorinë morfologjike si dhe me përbërjen morfematike të fjalës, përkatësisht me përbërjen fjalëformuese të saj. Për vendin e theksit në fjalët e gjuhës shqipe, përfshirë edhe të folmen e Karadakut të Shkupit, vlejné rregullat e përgjithshme, se:

- në fjalët e parme theksi bie në rrënjën e fjalës (e jo në mbaresë); khs. *djá:l, djál-i, djál-in, djál-it, djém, djém-t, djémsh, djém-ve; úk-i, úk-it, úk-in, úç-it, úç-ve, úç-ish; çén-i, çén-in, çén-it, çén-të, çénsh, çén-ve* etj.);
- në fjalët me prejardhje prapashtesore, theksi vendoset në prapashtesë; khs. *lavërtár, gojtár, lojtár, gjuetár, mretné:sh, ahí:sht* etj.;
- në fjalët me prejardhje parashtesore, theksi vendoset në rrënjë; khs. *përplás, përpunój, stërgjítsh* etj.;
- në fjalët e përbëra (kompozita), theksi vendoset në elementin e dytë formues; khs. *mirsjéllje, kryeqítét, jetgátë, vetshërbím, syshkrúar, udhhéks, zavéns* etj.;
- në fjalët e përngjitura, theksi bie në elementin e fundit formues; khs. *tungatjéta, athé:r, farefís, dalkadá:l, najhé:r, xhithmó:n, athé:r, menihé:r, shkeleshkó*; numërorët prej 11 deri më 19 (*nimdháit, dimdháit, ...*) etj.;
- fjalët e huazuara i janë përshtatur natyrës së shqipes: ato shqiptohen ose me theks parafundor ose me theks fundor.²⁸

8. Që të përftohet një pasqyrë më e qartë për vendin e theksit në të folmen e Karadakut të Shkupit, analizuam disa fjalë nga materiali dialektor në dispozicion.

2.1.1 FJALËT ME THEKS NË RROKJEN PARAFUNDORË (me theks paroksiton)

9. Në gjuhën shqipe te fjalët shumërokëshe vendi i theksit të fjalës lidhet me përkatësinë morfologjike të fjalës. Marrë në përgjithësi, tek emrat dhe te mbiemrat theksi bie më shpesh mbi zanoren parafundore ose tejfundore, ndërsa te foljet në zanoren fundore.²⁹

10. Kështu, e theksuar shqiptohet zanorja parafundore e fjalëve të gjinisë femërore, si: *létër, kóðër, flútër, kúmëll, shpátëll, sétëll* 'sjetull' etj., të cilat në trajtën e shquar bjerrin [ë]-në e rrokjes fundore dhe marrin mbaresën [-a]: *létra, kóðra, flútra, kúmlla, shpátlla, sétlla* etj., duke ruajtur theksimin parafundor.

11. Paroksitone janë edhe fjalët (pa dallim gjinie, si edhe disa mbiemra me -ëm), të cilët në trajtën e pashquar mbarojné me temë në -ëm, -ën, -ër dhe -ëll, si p.sh.: me -**ëm**: *dársëm, básëm, hásëm* etj. Me theks parafundor janë edhe mbiemrat: *i pásëm, i méçëm* 'i mençur', *i vétëm* 'i vetmuar', *i hécëm, i hëshëm, i nérshëm, i knúshëm, i ngúshëm* etj. Me -**ën**: *drápën, pépën, xhárpën, émën, kráhën, úrdhën* etj.; -**ër**: *lépër, hékër, dhándërr, sétër* 'sako', *áhër, sábër* etj.; -**ëll**: *grúmëll, kúnjëll, pópëll, vétëll, pétëll, shémëll* etj.

12. Në këtë të folme (si në të gjitha të folmet e tjera të gegërishtes) disa emra që në toskërishte shqiptohen me theks në rrokjen fundore: *verí, qirí, njerí* etj., të njëjtat shqiptohen me

²⁸ Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 60-61.

²⁹ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike ...*, f. 34-35.

theks parafundor, si *véri, çiri, një:r*.

13. Prirja e përgjithshme për të theksuar rrokjen parafundore të emrave në të folmen në shqyrtim shprehet edhe te një numër i konsiderueshëm huazimesh orientale, që kanë depërtuar nëpërmjet turqishtes, dhe nga burimi te ne kanë ardhur me theks fundor. Të tilla janë fjalët: *káfe, páre, xhézve, tenxhére, tenéçe, téçe, mináre, matáre, çáre, kadífe, déve, feréxhe, xháde, zérde, zahíre* etj.; si dhe disa emra me burim oriental: *Fatíme, Makfíre, Zahíde, Náíle, Hatíxhe, Halíme, Ájshhe* etj. Kjo zhvendosje theksi me pa të drejtë është quajtur rregullim mekanik i theksit. Në të vërtetë, kjo lëvizje e theksit nga rrokja fundore në rrokjen parafundore është bërë për shkak të përshtatjes së fjalëve të huazuara me tipin më të përgjithshëm të theksit parafundor të kësaj të folmeje, si edhe të të gjitha të folmeve e tjera geqe.

14. Fjalë paroksitone me burim oriental janë edhe fjalët *babá > bábë > bá:b, agá > ágë > á:g, bakllavá > bakllávë > bakllá:v, mushamá > mushámë > mushá:m, sarmá > sármë > sá:rm, budallá > budállë > budá:ll, Mustafá > Mustáfë > Mustá:f* etj., te të cilat zanorja [a] në fundin absolut të fjalës si e patheksuar me kalimin e kohës është shndërruar në [ë] e më pastaj është bjerrë krejtësisht, duke lënë gjurmë në zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse. Kësisoj, fjalët oksitone janë bërë paroksitone, njëkohësisht dyrrokëshet janë bërë njërrokëshe.

15. Megjithëkëtë, në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit një numër i madh fjalësh të huazuara nga turqishtja, të tipit: *sefá:, belá:, sevdá:, e xhumá:, fukará:, xhamâi, maná:, ilá:, dunjá:, havá:, xhezá:, hatá:* e shumë të tjera kanë mbetur me theks në rrokjen fundore.

16. Te fjalët me prapashtesat turke **-xhí, -lí** theksi bie në prapashtesë: *strujaxhí:, papuçexhí:, hajgarexhí:, bojaxhí:, kunraxhí:, daullxhí:, teneqexhí:, dairxhí:, specaxhí:, sheherlí:, rahmetlí:, parelí:, hujlí:, kuvetlí:, gurbetlí:* etj.

2.1.2. FJALËT ME THEKS NË RROKJEN FUNDORË (me theks oksiton)

17. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, si edhe në të folmet e tjera geqe, me theks në rrokjen fundore artikuloohen shumica e emrave të gjinisë mashkullore në trajtën e pashquar, qofshin ato fjalë anase ose të huazuara. Të tilla janë fjalët: *kufâi, katâund, kushrâi, mullâi, kaprá:ll, gjujtá:r, katuná:r, puntó:r, shullá:, tërhán, duhán, nallbán, shofé:r, kovác, baxhanák, kallambóç, iríç, livádh, patlixhán, oxhák, oríz, bilmét, rasát, janxhêik, saballêik, askér, mindér* etj.

18. Oksitone nyjëtohen edhe disa emra femërorë në trajtën e pashquar, si: *tërkú:z, kusâi, kutâi, temcâi, lethâi, shamâi, mutâi, kacâi, çatâi, gjurshâi* ‘qershi’, *malsâi, unsâi, rakí, burí, gurabí, mushknâi* etj. Fjalët e këtij tipi në trajtën e shquar marrin mbaresën -a (-ja) dhe rrjedhimisht nga fjalë oksitone bëhen fjalë paroksitone, sipas skemës: *kusâi-a, kutâi-a, temcâi-a, rakí-ja*.

19. Edhe te sllavizmat (para së gjithash maqedonizmat dhe serbizmat) si dhe tek huazimet e tjera joslave, bëhet rregullimi mekanik i theksit, gjegjësisht ato përshtaten me natyrën e theksit të shqipes. Këto fjalë në trajtën e pashquar më së shpeshti na dalin me theks fundor. Krahaso shembujt: *koçnicë > koçní:c, kolicë > kollí:c, bollnicë > bollní:c, bullicë > bullí:c > bullâic, kovác, varanicë > varanâic, slluzhbeník, opshtinë > opshtí:n, fllaník, popllavë > popllá:v,*

direktór, sekretá:r, çuvá:r, shumá:r, (mesna) zaední:c etj.

20. Përgjithësisht (me disa përjashtime) foljet në gjuhën shqipe shqiptohen me theks në zanoren fundore të temës, përkatësisht në mbaresën foljore, si *punój, punón; punó:jm, punóni, punó:jn; laró:jm, laróni, laró:jn* etj. Oksitone nyjëtohen edhe pjesoret e shkurtuara të foljeve: (kam) *punú:, punáu, puná:; shkrú:, shkráu, shkrá:; mcú:, mcáu, mcá:; (jam) largjú:, idhnú:, idhnáu, idhná:* etj.

21. Në këtë areal gjuhësor ka edhe disa mbiemra që shqiptohen me theks fundor. Më saktësisht, mbiemrat e panyjshëm të gjinisë mashkullore, të prejardhur e të formuar me prapashtesim, që shpesh përdoren edhe në funksion të emrave, përgjithësisht shqiptohen me theks në rrokjen fundore. Të tilla janë fjalët edhe emra edhe mbiemra: *azgán, besnâik, zengín, sakát, topáll, tamaqá:r, bardhán, vetán* etj. Mbiemrat e tillë për gjininë femërore marrin mbaresën -e, rrjedhimisht shndërrohen me theks në rrokjen parafundore, sipas tipit *azgán-e, besnâik-e, sakát-e* etj.

22. Gjatë krijimit të fjalëve me prapashtesim në gjuhën shqipe, përfshirë edhe të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, formohen fjalë me theks në rrokjen fundore. Pra, shumica e prapashtesave fjalëformuese (por jo edhe mbaresat gramatikore) tërheqin me vete theksin e fjalës dhe në këtë mënyrë theksohet zanorja e fundit e parrëguar e fjalës.

Të përkujtojmë se në shqipen standarde me theks fundor shqiptohen fjalët e prejardhura, të formuara me anë të prapashtesimit (me prapashtesat -ár, -tár, -ór, -tór, -íst, -í, -ít, -iót, -sí, -rí, -ím, -úk, -ëshë, - úshë, -ác, -áč, -ák, -án (-ján), -ér (-iér), -ó-, -só, -zó, -ós; -atë, - ore, -tore, -ishte, -ishtë, -ajë, -najë, -icë, -izëm, -azëm, -itet, -imisht, -avec etj., të cilat marrin mbi vete theksin e fjalës):³⁰ *fshát - fshatár, qytét - qytetár, dét - detár, údhë - udhëtár, lúftë - luftëtár, lákër - lakrór, dásëm - dasmór, mál - malór, ákull - akullóre, rrégull - rregullóre, bótë - botëror; púnë - puním, punëtór, punëtorí; árt - artíst, futbóll - futbollíst, spórt - sportíst, mjéshtër - mjeshtrí, drejtór - drejtorëshë, zónjë - zonjúshë, i ëmbël - ëmbëlsí, djálë - djalëri, rrúgë - rrugaç, Dúrrës - durrsák, Rómë - romák, Díbër - dibrán, Shkódër - shkodrán, ménd - mendój, flákë - flakëroj, shtég - shtegtój, frikë - frikësój, dórë - dorëzój, fúnd - fundós, hékur - hekurós, fjälë - fjalós, alkoól - alkoolík* etj.³¹

23. Por theksi nuk kalon te prapashtesat: -më (-ëm), -je, -ës, -të, -as, -e, -shëm. Krahaso: *klíth - klíthmë, dal - dálje, mblédh - mblédhës, flákë - i fláktë, fýyt - fýtas, mík - míke, kënáq - i kënáqshëm, vénd - véndas, Maqedóni - maqedónas, Gjilán - gjilánas; nxë - nxënës, prés - prítës, bléj - blérje, ndjék - ndjékje, përcjél - përcjélje* etj.

24. Në arealin gjuhësor të Karadakut me theks fundor shqiptohen fjalët e formuara me prapashtesat: -ár, -tár, -ór, -tór, -íst, -í, -sí, -ní, -ó-, -ró, -só, -zó, -ós.³² Nga materiali i vjelë, po

³⁰ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe, vëllimi I, Morfologjia*, Tiranë, 1995, f. 100; Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 130.

³¹ Ndonjëherë, fjalët e formuara me prapashtesim merren si shembull për të mbështetur pohimin se përveç karakterit bazë të palëvizshmërisë së theksit në gjuhën shqipe, ai shpeshherë është i lëvizshëm. Kjo nuk na duket e drejtë, sepse gjatë fjalëformimit përftohen njësi leksikore e semantike të ndryshme, megjithëse të një rrënje (khs. shembujt e dhënë: *fshát - fshatár, alkoól - alkoolík*). Palëvizshmëria dhe lëvizshmëria e theksit duhet të trajtohet në kufijtë e paradigmes së të njëjtës fjalë, përkatësisht në format e ndryshme që merr e njëjta pjesë emërore gjatë lakimit ose e njëjta folje gjatë zgjedhimit. Lëvizshmëri të theksit në gjuhën shqipe kemi vetëm në një numër të vogël fjalësh me lëvizshmëri gramatikore, të cilat në numrin njëjës theksin e kanë në temë, kurse në shumës theksi zhvendoset në mbaresë (sipas tipit *dhëndër - dhëndurë*) ose me lëvizshmëri fonologjike, kur theksi gjatë lakimit ose zgjedhimit bie në rrokje të ndryshme ose në tinguj të ndryshëm të së njëjtës morfemë (të tipit *njerí - njerëz*).

³² Anastas Dodi - Jorgji Gjinar, *Fonetika ...* f. 130.

sjellim disa shembuj të tillë: *magjá:r, samá:r, bakërdá:r, beqá:r, zagjá:r, arsimtá:r, shkrimtá:r, shiptá:r, udhtë:r, gjujtá:r, laknó:r, puntó:r, komunist, traktorist, mashinist, zotsái, burrnái, trimnái* etj.

2.1.3. FJALËT ME THEKS NË RROKJEN TEJFUNDORE (me theks proparoksiton)

25. Do përmendur se numri më i madh i fjalëve që ndonjëherë dalin me theks në pozitë tejfundore, fjalët e njëjta në format e tyre përfaqësuese, në format bazë (trajta e pashquar e rasës emërore e numrit njëjës në lakimin emëror; veta e parë numër njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore në zgjedhimin foljor) janë fjalë me theks në rrokjen parafundore ose fundore. Por, në saj të palëvizshmërisë së theksit, meqë ai qëndron në të njëjtën rrokje edhe kur fjalës i shtohen rrokje të tjera, fjalët fundore ose parafundore shndërrohen në fjalë me theks tejfundor.

26. Kur shtohen rrokjet që kanë funksion gramatikor, në saj të palëvizshmërisë së theksit në paradigmën e eptimit, nga fjalët me theks fundor ose parafundor përftohen forma fjalësh me theks tejfundor. P.sh.: *mál, máli, mále, málet, máleve; lís, lísi, lísat, lísave; fabrí:k, fabríka, fabríkat, fabríkave; shkó:ll, shkólla, shkóllat, shkóllave; vné:sht, vnéshta, vnéshtat, vnéshtave; avtobús, avtobúsi, avtobúsit, avtobúsat, avtobúsave* etj.

27. Do ta paraqesim paradigmen emrit *fushë*, për të parë vendin e theksit në të gjitha format e mundshme gramatikore të kësaj fjale:

	<i>njëjës</i>		<i>shumës</i>	
<i>rasat</i>	<i>trajta e pashquar</i>	<i>trajta e shquar</i>	<i>trajta e pashquar</i>	<i>trajta e shquar</i>
E.	fú:sh	fúsha	fúsha	fúshat
Gj.	i, e fúshe	i, e fúshës	i, e fúshave	i, e fúshave
Dh.	fúshe	fúshës	fúshave	fúshave
K.	fú:sh	fúshën	fúsha	fúshat
Rrj.	fúshe	fúshës	fúshash	fúshave

Shënim:

Fjalë më të shpeshta me theks tejfundor janë emrat femërorë në trajtën e shquar në shumës të rasat e zhdrejta (në gjinore, dhanore dhe rrjedhore).

2.1.4. PALËVIZSHMËRIA DHE LËVIZSHMËRIA E THEKSIT

28. Disa prej gjuhëve e lëvizin theksin gjatë procesit të eptimit (lakimit dhe zgjedhimit), pasi theksi nuk mbetet mbi të njëjtën rrokje të fjalës, por e ndryshon vendin, duke kaluar nga tema mbi mbaresën ose anasjelltas. Të tilla janë italishtja, spanjishtja, rusishtja etj. Këto quhen gjuhë *me theks të lirë të lëvizshëm*. Rusishtja, p.sh. e lëviz theksin në lakimin e emrave: khs. *gollová*,

góllovu, gollóv dhe në zgjedhimin e foljeve: khs. *pishú, píshesh*. Në spanjishte: paskajore *cantár* “me këndue”, e tashme *cánto* “këndoj”, aorist *cantó* “këndoi”; në italishte: paskajore *parláre* “me folë”, e tashme *parlo* “unë flas”, aorist *parló* “foli”.³³

29. Ndërkaq, në disa gjuhë të tjera theksi qëndron i palëvizshëm në procesin e eptimit. Këto quhen gjuhë ***me theks të lirë të palëvizshëm***. E këtillë është gjuha shqipe, anglishtja, gjermanishtja etj. Theksi i fjalëve në gjuhët me theks të palëvizshëm qëndron në të njëjtën rrokje edhe kur fjalës së njëjtë i shtohen rrokje të tjera.

30. Kështu, theksi i shqipes qëndron i palëvizshëm në procesin e eptimit të fjalëve, duke ruajtur pozicionin e tij të formave përfaqësuese (formave bazë të fjalëve), përkatësisht duke e ruajtur pozitën e tij të rasës emërore numër njëjës në lakimin emëror dhe atë të vetës së parë numër njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore në zgjedhimin foljor. P.sh.: *mál, máli, i málit, málin, mále, málet, málesh, máleve; flútur, flútura, flúturat, flúture, flúturash, flúturave; qytetár, qytetári, qytetárit, qytetárin, qytetárë, qytetárët, qytetárësh, qytetárëve; láj, lán, lájme, láni, lájne; láva, láve, láu, lája, (kam, jam) lárë; punój, punón, punójme, punóni, punójne; punója, punóje, punónte, punónim, punónit, punónin; punóva, punóve, punói, punúam, punúat, punúan; kam punúar* etj.³⁴

Pra, **karakteristikë themelore e gjuhës shqipe është se ajo ka theks të palëvizshëm** (të qëndrueshëm), meqenëse gjatë lakimit ose zgjedhimit të fjalëve, theksi mbetet në po atë rrokje.

31. Përjashtim nga ky rregull i përgjithshëm paradigmatic për ruajtjen e theksit të palëvizshëm në një rrokje të caktuar (në këtë të folme dhe në gjithë shqipen), bëjnë pak (dhjetëra) emra gjatë formimit të shumësit. Kështu, në formën e njëjësit theksi bie mbi zanoren e temës, ndërsa në formën e shumësit theksi bartet mbi prapashtesën e shumësit. Krahaso shembujt:

<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>
xharpën	xharpêi, xharpnêi
drápën	drapêi, drapnêi
shkóp	shkopí, shkopâi
lépër	leprí, leprâi
kállli	kallí, kallêi
dhánër, dhándër	dhanú:r, dhandú:r

2.1.5. THEKSI I FJALËVE NË FJALI

32. Theksi dinamik luan rol të rëndësishëm edhe në fjali. Në ligjërimin e lidhur fjalët nuk kanë të njëjtën peshë; si rrjedhim ato nuk shqiptohen me të njëjtën forcë. Disa prej tyre bartin kuptime kryesore, duke emërtuar gjallesa, objekte, veprime a tipare; kurse disa të tjera kanë vetëm funksione shërbyese për të shprehur marrëdhënie të ndryshme.

33. Rrjedhimisht, fjalët nuk duhen vështruar të veçuara, por sipas pozicionit të tyre

³³ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 117.

³⁴ Te togjet e zanoreve, theksi bie mbi elementin e parë të togut: *i edukúar, grúa, përrúa, thúa, mësúes, i dëgjúeshëm, díell, qíell, fýell, përkthýes* etj.

brenda sintagmës, fjalisë a periudhës. Në këtë kompleks, ritmi i shpejtë i ligjërimin, duke i lidhur fjalët me njëra-tjetrën, shkakton ndryshime fonetike në trajtën dhe në theksin e tyre. Ndryshimet vërehen më shumë në ato fjalë, që në fjali kryejnë funksione shërbyese, siç janë parafjalët, lidhëzat, trajtat e shkurtra etj.; të cilat, duke qenë qemoti në pozicion të patheksuar, kanë ndryshuar nyjëtimin e zanoreve, gjatësinë e tyre etj. Dinamizmi i theksit ka sjellë në to të njëjtat ndryshime, si në rrokjet e patheksuara të fjalëve.

34. Por, këtyre ndryshimeve u nënshtrohen edhe fjalët emërtuese, kur hyjnë në lidhje të ngushta me një fjalë tjetër, për të formuar togfjalësh, duke marrë në këtë rast edhe një theks të vetëm. Togfjalësh të tillë janë sidomos bashkimet *nyjë e trajtës së pashquar + emër* (një-lis, një-pulë), *përemër + emër* (ai-djalë, im-bir), *numëror + emër* (dy-ditë, tri-pata) etj.; të cilat kanë lidhje të qëndrueshme të elementeve të sintagmës.

35. Ndryshime janë krijuar edhe në lidhje të tjera sintagmatike me dy gjymtyrë emërtuese, siç janë bashkimet *emër + mbiemër* (djalë-i-mirë, lopë-e-kuqe), *emër + emër* (mish-viçi, mish-qengji) etj. Vetëm me një vështrim të tillë, duke i parë fjalët në lidhjet e tyre sintagmatike, mund të kuptohet raporti i: nyjës së pashquar me emrin, përemrit dëftor me nyjën shquese, i numërorit me nyjën shquese, i ndajfoljes me parafjalën dhe i kësaj të fundit me parashtesën, i nyjës së prapme me nyjën e përparme; shfaqja e nyjave para mbiemrit dhe emrave të rasës gjinore etj.³⁵

36. Pra, në ligjërimin tonë, disa fjalë e ruajnë theksin (të tillat quhen fjalë akcentogjene, tonike), ndonjëra bëhet fjalë e patheksuar (atone, klitike), ndonjëra shqiptohet me theks të dobësuar, ndërsa ndonjë tjetër me theks dytësor.³⁶

37. Mund të përfundohet se në ligjërim theksi i fjalëve shkallëzohet. Ky shkallëzim varet drejtpërdrejt nga desemantizimi i fjalëve. Kështu, fjalët shërbyese njërrrokëshe e humbin plotësisht theksin dhe bëhen të patheksuara, fjalët shërbyese shumërrrokëshe që deri diku e ruajnë edhe kuptimin, shqiptohen me theks të dobësuar; ndërsa në fjalët e përbëra dhe të përngjitura theksin kryesor e bart pjesa e fundit, e të tjerat bëhen me theks dytësor.

38. Krahas fjalëve me theks të mëvetësishëm, të quajtura edhe si fjalë akcentogjene, ka edhe fjalë që nuk kanë theks, që quhen fjalë klitike ose fjalë joakcentogjene.³⁷

39. Fjalë të patheskuara në gjuhën shqipe janë fjalët shërbyese, fjalëza që nuk kanë kuptim të mëvetësishëm, por shërbejnë për të lidhur e për të vënë raporte të ndryshme ndërmjet fjalëve të kuptimshme. Të tilla janë parafjalët, lidhëzat, pjesëzat, foljet ndihmëse, nyjet e përparme etj., por edhe disa fjalëza njërrrokëshe.³⁸ Pra, fjalët e patheksuara shqiptohen me fjalët e theksuara sikur të jenë një fjalë e vetme, krijojnë një fjalë fonetike, një tërësi theksore.

40. Edhe në të folmen e Karadakut të Shkupit, si edhe në të gjitha të folmet e tjera gege e toske e në shqipen standarde, - varësisht nga pozicioni që ka fjala e patheksuar ndaj fjalës së theksuar me të cilën lidhet fonetikisht (e patheksuara gjendet para ose pas fjalës së theksuar), - fjalët që e humbin theksin mund të jenë proklitike ose enklitike.

³⁵ Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 285.

³⁶ Kostaq Cipo në veprën *Fonetika*, Tiranë, 2003, f. 39 thotë se “fjalët ndahen në këto tri kategori: **orthotonike**, **proklitike** dhe **enklitike**”.

³⁷ Стојка Бојковска, Лилјана Минова – Ѓуркова, Димитар Пандев, Живко Цветковски, *Македонски јазик* (за средно образование), Скопје, 1997, f. 81.

³⁸ Anastas Dodi - Jorgji Gjinari, *Fonetika ...*, f. 131.

FJALËT PROKLITIKE

41. Si fjalë proklitike në të folmen në spikamë, si edhe përgjithësisht në mbarë shqipen, nyjëtohen:

a) nyjet e përparme (e paravendosura) **i, e, t'** (< të), **s'** (< së) në përdorim sintagmatik shumë shpesh elidohen, si në shembujt: *mali shpe:sh* (< mali i shpeshë), *Gjuri Zi* (< Guri i Zi) 'toponim në f. Brezë e Malinë', *Lúgji Vol* (< Lugi i Vogël) 'toponim në f. Bllacë'; *Prroj Livadheve* (< Përroi i Livadheve) 'toponim në f. Bllacë', *Kepi Shipes* (< Kepi i Shqipes) 'toponim, f. Bllacë', *uki madh* (< uki i madh, ujku i madh), *uji ftoft* (< uji i ftohtë), *duhani sert* (< duhani i sertë), *njeri mir* (< njeri i mirë), *qaki smut* (< plaki i smut, i sëmurë), *frengi derës* (< frengi i derës); *koha mâir* (< koha e mirë), *dora mâisht* (< dora e majtë), *nusja madhe* (< nusja e madhe), *pula kuçe* (< pula e kuçe), *maja gjeshkës* (< maja e bjeshkës), *caca gjalit* (< cuca e djalit), *lopa zez* (< lopa e zezë), *Gjurra Ba:rdh* (Gúrra e Bardhë) 'toponim' etj.³⁹

Në fshatrat Bllacë dhe Tanushë mbizotërojnë format ku nyja e përparme **e** i prapangjitet gjymtyrës së parë të togfjalëshit. Supozojmë se format e sotme të këtyre togfjalëshave kanë dalë nga trajta e pashquar e emrit + mbiemër i gjinisë femërore, sipas tipit: derë e madhe > de:r e madhe > *dere*∪*mádhe*. Është e njohur se zanorja [ë] nuk shqiptohet në pozitë fundore absolute në gegërishten dhe në këtë rrugë janë krijuar kushte në situata të këtilla që nyja e përparme **e** (edhe ajo e patheksuar) t'i prapavihet emrit që gjendet para nyjes. Në këtë lidhje të ngushtë sintagmatike me dy gjymtyrë emërtuese (emër + mbiemër) në pikëpamje fonetike kemi vetëm një fjalë e jo dy, pra kemi një fjalë fonetike, një vargua i pandërprerë tingujsh e që shqiptohet me një theks të vetëm. Në të mirë të këtij shpjegimi, po sjellim disa shembuj nga e folmja në vëzhgim: *dore*∪*gjátht* (do:r e gjatht, dorë e gjatht, dorë e djathtë), *cuce*∪*gjálit* (cú:c e gjalit, cúcë e gjalit, djalit), *kohe*∪*mâir* (ko:h e mâir, kohë e mâir, kohë e mirë), *pule*∪*kúçe* (pu:l e kuçe, pulë e kuçe), *udhe*∪*má:r* (u:dh e mar, udhë e mbarë), *pune*∪*má:r* (pu:n e ma:r, punë e mbarë) etj.

b) Proklitike janë edhe trajtat e shkurtra përemërore, si **m'** (< më), **t'** (< të) **i, na, vu** (< ju), **va** (< ua), **ja** (< ia) etj. P.sh.: *M'tha se do t'vâie nesër*. 'Më tha se do të vijë nesër'. *I thash me vu kallxu: atâine*. 'I thash me ju kallxu: atyne'. *Va za: për t'madhe...* 'Ua zë për të madhe...' *Sha:m mâir vu tha, nër sâi*. 'Shumë mirë u tha, ndër sy'. *Na lipi shâum pare*. 'Na kërkoi shumë para.' *Ja bana mâir*. 'Ia bëra mirë' etj.

c) Në vargun e ligjërimin, theksin e humbasin edhe parafjalët, si: **mbâi** (< mbi), **me, nër** (< ndër), **n'** (< në), **për, prej, te** etj. P.sh.: *Her mbâi*∪*ú:dh e her nër*∪*ú:dh*. 'Herë mbi udhë e herë nën udhë'. *Me*∪*ra shâi, grúni bahet ma*∪*mâir*. 'Me ra shi, gruni bahet ma i mirë; 'në versionin standard: Po të bjerë shi, gruri bëhet më i mirë.' *N'punën teme s'du me mu përzi*. 'Në punën time s'du me mu përzi; stand. Në punën time nuk dua të më përzihen. *Për i mâir, i mâir asht*. 'Stand. Për i mirë, i mirë është.' *Prej k'tu e teri n'Shkup i ka di sahat u:dh*. 'stand. Nga këtu e deri në Shkup ka dy orë rrugë'. *Musha u:j te kroni*. 'stand. Mbusha ujë te kroi.' etj.

ç) Bëhen proklitike rëndom edhe disa pjesëza njërrrokëshe: **u, mu, do t'** (< do të), **për t'** (< për të) etj., si në fjalitë *U mca: me shkra*. 'U msue me shkruet. Stand. U mësua të shkruajë.' *M'u rrâit gjali*. 'M'u rrit djali.' *Do t'shkoj n'mal*. 'Do të shkoj në mal. *Për t'ngra:n kam boll*. 'Për të ngrënë kam mjaft.' etj.

42. Si në të gjitha të folmet e tjera shqipe, në shqipen standarde, ashtu edhe në këtë areal

³⁹ Format e sotme të emrave të parë të theksuar në sintagmat e tipit *pula kuçe* me të drejtë mendohet se rrjedhin nga emri përkatës në trajtën e pashquar: *pulë e kuçe* > *pula kuçe* me shkrirjen (krasisin) e **ë** + **e** > **a**. Shih: Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I dhe II), Prishtinë, 1980, f. 86.

gjuhësor, proklitike përdoren edhe përemrat lidhorë si edhe foljet ndihmëse (kam, jam) që shërbejnë për formimin e formave analitike të foljeve.

FJALËT ENKLITIKE

43. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, si dhe përgjithësisht në mbarë shqipen, enklitike janë trajtat e shkurtra të përemrave që u prapavihen foljeve. Trajtrat e tilla të shkurtra edhe fonetikisht edhe morfologjikisht njësohen me foljet dhe shqiptohen e shkruhen si një fjalë e vetme, bashkë. Të tilla janë format pohore të foljeve të mënyrës urdhërore. Krahaso shembujt: *fugje!*, *fuge!* (forma mohore: mos e fugj!) 'hudhe!'; *haje!* (mos e ha!) ([j] -ja është e ndërfutur, epetentike); *pagjúja!* (mos **ia** pagjúj!) 'paguja!', *shkova!* (mos **va** shko) 'shkoju!', kapërceju!' e të ngjashme.

2.2. GJATËSIA FONETIKE DHE FONOLOGJIKE E ZANOREVE

44. Mbizotëron mendimi se në një fazë të hershme të zhvillimit, gjuhët indoevropiane në pikëpamje fonologjike dallonin zanore të shkurtra ~ zanore të gjata. Gjatë rrugës së zhvillimit të shqipes, ky dallim në gjatësinë e fonemave zanore ka pësuar ndryshime, që ka sjellë edhe ndryshimin e inventarit të fonemave zanoreve. Thjesht, gjuhët indoevropiane me gjatësi fonologjike janë shndërruar në gjuhë me gjatësi fonetike. Si rrjedhojë e kësaj, gjatësia e dikurshme fonologjike në gjuhën shqipe është trashëguar vetëm pjesërisht.

45. Në fazën e shqipes së shkruar (në fazën literale) në tekstet e vjetra gjejmë të shënuara zanore të shkurtra dhe zanore të gjata.⁴⁰ Në studimet albanologjike, përgjithësisht është e njohur se në gjendjen e sotme, në të folmet toske si dhe në shqipen standarde gjatësia e zanoreve nuk ka vlerë fonologjike.

46. Përgjithësisht, si në të folmet e tjera të gegërishtes, ashtu edhe në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, në rrokje të theksuar në pikëpamje fonetike dallohen tri shkallë gjatësie: zanore të shkurtra, të mesme dhe të gjata. Megjithëkëtë, në pikëpamje fonologjike vetëm të shkurtrat kundërvihen me të gjatat.

47. Gjatësia në të folmet e gegërishtes (si dhe në disa krahina skajore të toskërisë: në Labëri, në Bregdet, në Çamërishten, tek Arbëreshët e Italisë e të Greqisë së sotme),⁴¹ edhe sot e kësaj dite përdoret për të diferencuar kuptimin e fjalëve dhe të formave gramatikore. Të tri gjatësitë fonetike (të shkurtra, të mesme dhe të gjata) përbëjnë vetëm një opozicion: të shkurtra e të mesme ~ të gjata. Pra, në aspektin fonologjik dallohen dy shkallë: **të shkurtra ~ të gjata**, nga se kuptimi i fjalëve apo i formave gramatikore të disa çifte minimale fjalësh dallohen vetëm nga

⁴⁰ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 47.

⁴¹ Kjo gjë tregon se dallimi fonologjik i gjatësisë së zanoreve ka qenë karakteristikë e vokalizmit të mbarë shqipes. Mungesa e saj në pjesën më të madhe të të folmeve toske, nga kjo pikëpamje, shihet si një inovacion, zhvillim i këtyre katër-pesë shekujve të fundit, meqë Arbëreshët e shpërngulur nga toskëria e kanë pasur dhe e ruajnë ende gjatësinë fonologjike të zanoreve, ashtu si të folmet periferike.

ky tipar. Zanoret me gjatësi të mesme, në të vërtetë janë neutrale, ato nuk kundërvihen.⁴² Bëhet fjalë për një asnjësim të gjatësisë së zanoreve të theksuara, sepse gjatësia e tyre fonetiki është e kushtëzuar.

48. Kështu, gjatë eptimit të disa fjalëve, gjatësia e caktuar e zanores e bjerr funksionin semantik ose gramatikor dhe këtë funksion e marrin mbaresat. P.sh.: Fjalët *plak* dhe *plakë* në toskërishten dhe në shqipen standarde dallohen fonetiki me anë të zanores fundore [-ë]. Në të folmet gege rënia e [-ë]-së fundore ka shkaktuar zgjatje kompensatore të zanores paraprirëse, në këtë rast të [a]-së. Kështu, emri i gjinisë mashkullore në trajtën e pashquar shqiptohet me [ã] të shkurtër (plāk), ndërsa ai i gjinisë femërore me [a:] të gjatë (pla:k). Në trajtën e shquar kemi [pla.k-u, (-i) ~ pla.k-a] ku edhe zanorja e shkurtër edhe zanorja e gjatë shndërrohen në zanore me gjatësi të mesme, nga shkak se gjatësitë më nuk kanë asnjë rol të bartjes së informacionit (nuk është më tregues distinktiv i gjinisë), por rolin e tyre e kryejnë morfemat (mbaresat), përkatësisht fonemat /u/ ose /i/ për gjininë mashkullore dhe /a/ për gjininë femërore. Kalimet e të shkurtrave në të mesme dhe të gjatave në të mesme e anasjelltas, për shkak të kushteve të jashtme fonetike, e lëkundin dhe e ngatërrojnë vlerën fonologjike të gjatësisë.

49. Kundërvënia e gjatësisë është rezultat i rënies së [ë]-së tek emrat që dikur e kanë formuar shumësin me këtë zanore. Rënia e [ë]-së është shoqëruar me një zgjatim të zanores së temës, të cilën edhe prof. E. Çabej e ka quajtur gjatësi kompensatore. Si rrjedhim, ka lindur një kundërvënie morfonologjike e temave të njëjësimit me temat gjegjëse të shumësit. Në një kundërvënie të tillë njëjës shumës hyjnë emrat që në njëjës mbarojnë me *-ak, -ik, -ek, -osh, -ec, -oç* dhe ndonjë me *ar*.⁴³

50. Është e njohur se në të folmet e gegërishtes, gjatësia fonologjike më e shprehur është në të folmet veriore, përkatësisht më e shprehur në nëndialektin e gegërishtes veriore sesa në gegërishten jugore. Pra, duke zbritur më nga jugu, në përputhje me shtrirjen gjeografike të të folmes hetohet defonologjizimi i gjatësisë, ashtu që në të folmet e toskërishtes veriore kjo kundërvënie më nuk është e pranishme.⁴⁴ Në këtë drejtim, në të folmet e gegërishtes qendrore e të Shqipërisë së Mesme hetohet prirja e rrafshimit a njësimi të gjatësisë, por prapëseprapë në gjendjen e sotme ajo është e pranishme.⁴⁵

51. Gjatë analizës së materialit burimor të të folmes shqipe të Karadakut të Shkupit hetuam disa çifte fjalësh me prirje për njësimin e gjatësisë së zanoreve. Krahaso shembujt:

<i>në nëndialektin e gegërishtes veriore</i>	<i>në të folmen e Karadakut të Shkupit (si edhe në tërë gegërishten jugore)</i>	<i>në toskërishte dhe në shqipen standarde</i>
(ni) dīt ~ (shu:m) di:t	(ni) dit ~ (shu:m) dit	(një) ditë - (shumë) ditë
(ni) gu:r ~ (shu:m) gūr	(ni) gūr (gjur) ~ (shu:m) gurzi (gjurzi)	(një) gurë - (shumë) gur
(ni) malōk ~ (shu:m) malo:k	(ni) malōk ~ (shu:m) malōk	(një) malok - (shumë) malokë

⁴²Rexhep Ismajli, *Rreth kuantitetit të zanoreve të theksuara në gjuhën shqipe*, Artikuj mbi gjuhën shqipe, Prishtinë, 1987, f. 193-200.

⁴³Ismet Osmani, *Ndërrimet morfonologjike në gegërishte*, Shkup, 2010, f. 40-41.

⁴⁴Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Prespës*, Shkup, 1996, f. 19; Jorgji Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 110.

⁴⁵Bahri Beci, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987, f. 16.

shtāt ~ shta:t	boj ~ shta:t	shtat - shtatë
----------------	--------------	----------------

52. Megjithëkëtë, edhe përskaj shembujve të sjellë me defonologjizimin e kuantitetit, gjatësia e zanoreve në të folmet Veriore të shqipes shërben shpesh si mjet fonologjik për të dalluar kuptimin e disa çifteve minimale fjalësh, e sidomos për diferencimin e formave morfologjike të fjalëve. Po sjellim disa shembuj nga e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit ku gjatësia ka vlerë fonologjike, sepse kuptimi i fjalëve dhe i formave dallohet vetëm nga ky tipar. Pra, te disa çifte minimale fjalësh zanorja e shkurtër me kundërvënien që krijon me zanoren përkatëse të gjatë ka:

1. **Funksion leksikor** (semantik, kuptimdallues): *māz ~ ma:z* 'mëz - mazë', *gjēta ~ gje:ta* 'bleta - gjeta (diçka të humbur)', *dī ~ di:* 'dy - di, njoh (diçka)', *kī ~ ki:* 'ky - ke (ti)', *çāj ~ ça:j* 'çaj (pije) - çaj (dru)', *rrās! ~ rra:s* 'ha! (në pezhorativ) - rrasë (pllakë guri)'; *kōs ~ ko:s* 'kos (bulmet) - kosë (mjet për prerjen e barit)', *bōll ~ bo:ll* 'mjaft - bollë (lloj gjarpëri)', *lūgj ~ lu:gj* 'lug, koritë - lugë (për të ngrënë)', *kōt ~ ko:t* 'kot, pa dobi - dremit', *shpāt ~ shpa:t* 'shpat, tatëpjetë, pjerrtësi e malit' - shpatë, pallë, mjet lufte', *māll ~ ma:ll* 'mall (për treg) - mallëngjim', *hāll ~ ha:ll* 'brenjë - hallë, motra e babait' etj.

2. **Funksion gramatikor**. – Më të shumta janë fjalët, në përbërjen e të cilave kundërvënia e zanores së shkurtër ndaj zanores së gjatë bart me vete funksion gramatikor sesa funksion leksikor. Kështu, disa emra dallohen sipas gjinisë apo numrit, si dhe disa folje dallohen në mënyrë, kohë dhe vetë. Përgjithësisht, në çiftet e fjalëve me kundërvënie fonologjike të gjatësisë së zanoreve të theksuara, emrat në numrin njëjës dhe ata të gjinisë mashkullore shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa shumësi i tyre dhe gjinia femërore përkatëse me zanore të gjatë.⁴⁶ Edhe disa folje në mënyrën dëftore njëtohen me zanore të gjatë, ndërsa po këto folje me formë të njëjtë në mënyrën urdhërore dalin me zanore të shkurtër. Në të mirë të këtij konstatimi mund të sjellim disa shembuj nga areali gjuhësor i Karadakut të Shkupit:

a) **dallim në gjini** (mashkullore ~ femërore): *plāk ~ pla:k* 'plak - plakë', *kunāt ~ kuna:t* 'kumat - kumatë', *krūshk ~ kru:shk* 'krushk - krushkë' etj.;

b) **dallim në numër** (njëjës ~ shumës): *vēsh ~ ve:sh* 'vesh - veshë', *dhām ~ dha:m* 'dhëmb - dhëmbë', *fishēk ~ fishe:k* 'fishëk, gëzhjojë - fishekë', *dishēk ~ dishe:k* 'dyshek - dyshekë', *oxhāk ~ oxha:k* 'oxhak - oxhakë', *dollāp ~ dolla:p* 'dollap - dollapë', *baxhanāk ~ baxhana:k* 'baxhanak - baxhanakë' etj.;

c) **dallim në mënyrën e foljes** (dëftore ~ urdhërore): - Siç dihet, mënyra urdhërore ka forma gramatikore vetëm për vetën e dytë njëjës e shumës. Në vetën e dytë shumës të gjitha foljet dalin me të njëjtën formë si në vetën e dytë shumës të kohës së tashme të mënyrës dëftore. Këto dy forma homonime dallohen midis tyre vetëm nga intonacioni.⁴⁷

Megjithë përputhjet e këtilla të formave të foljeve në këto dy mënyra në aspektin morfologjik, vështruar nga ana fonetike e fonologjike në të folmet gege format e njëjta dallohen sipas gjatësisë së zanores së theksuar: zakonisht zanorja e gjatë që shfaqet në përbërjen e foljes së mënyrës dëftore korrespondon me zanoren e njëjtë të shkurtër të mënyrës urdhërore. Falë

⁴⁶ Çifte leksikore me dallim kuptimor dhe dallime gramatikore të fjalëve në bazë të gjatësisë së zanoreve në gegërishten janë krijuar sidomos **me rënien e /ë/-së fundore**. Në dialektin e Veriut rënia e /ë/-së fundore ka shkaktuar **zgjatje kompensatore të gjatësisë** në zanoren që gjendej para saj. Prandaj, emrat në numrin njëjës dhe të gjinisë mashkullore shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa po të njëjtë emra në shumës dhe në gjininë femërore dalin me zanore të gjatë.

⁴⁷ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëllimi I, Morfologjia, Tiranë, 1995, f. 297.

kësaj dukurie, te foljet e këtilla pamundësohet homofonia e tyre në format e mënyrës urdhërore me gjegjëset e tyre të mënyrës dëftore.⁴⁸ Krahaso shembujt e sjellë nga e folmja në shqyrtim:

<i>mënyra dëftore</i>	<i>mënyra urdhërore</i>
(ti) he:c	hec!
ma:t	mat!
me:rr	merr!
hi:p	hip!

53. Me metodën e fonetikës eksperimentale, prof. Bahri Beci në të folmen e Shkodrës ka analizuar një numër të madh fjalësh njërrrokëshe e shumërrrokëshe në rrethime të ndryshme tingullore të zanoreve. Sipas kësaj monografie, zanoret e shkurtra shqiptohen në intervalin prej 20 deri më 8 të qindta të sekondës, ndërsa të gjatat midis 42-20 qs. Vlerësim i përgjithshëm është se raporti i gjatësisë fizike të zanoreve të gjata përkundër zanoreve të shkurtra në të folmen e Shkodrës, si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes, është 2:1. Me fjalë të tjera, zanorja e shkurtër është njëmorëshe, ndërsa e gjata dymorëshe.⁴⁹ Po i njëjti studiues konstaton se në shqipen standarde raporti ndërmjet zanoreve të theksuara e të patheksuara është 10/7.⁵⁰

54. Përgjithësisht dihet se zanoret e gjata shqiptohen si më të mbyllura sesa të shkurtrat, por përveç këtij dallimi, sidomos në nëndialektin e gegërishtes veriore, të gjatat realizohen edhe si më të prapme.⁵¹ Gjatë nyjëtimit të zanoreve të gjata, aparati i të folurit është më i tendosur sesa gjatë artikulimit të zanoreve të shkurtra.⁵²

55. Dallimi fonologjik i gjatësisë së zanoreve ka qenë karakteristikë e vokalizmit të mbarë shqipes. Mungesa e saj në pjesën më të madhe të të folmeve toske, nga kjo pikëpamje, shihet si një inovacion, zhvillim i këtyre katër-pesë shekujve të fundit, meqë arbëreshët e shpërngulur nga Toskëria e kanë pasur dhe e ruajnë ende gjatësinë fonologjike të zanoreve, ashtu si të folmet periferike.

56. Si përfundim, nga gjithë sa u tha, del se gjatësia e tingujve të shqipes së sotme (dialektore dhe standarde) është përzierje e sistemit të vjetër me gjatësi fonologjike të zanoreve me tipin e ri të gjatësisë së shkaktuar nga faktorë të jashtëm fonetikë (gjatësi fonetike). Në ndërgjegjen e folësve nuk është gjithnjë e qartë vlera e gjatësisë. Kjo tregon se shqipja në çështjen e gjatësisë së zanoreve gjendet në një fazë kalimtare: toskërishtja dhe shqipja standarde kanë evoluar në tipin fonetik të gjatësisë, ndërsa gegërishtja (edhe pse me mbizotërim të gjatësisë fonetike) ende e ruan tipin fonologjik të gjatësisë. Edhe atje ku ruhet dallimi fonologjik i gjatësisë së zanoreve në sajë të traditës, vlera fonologjike po zbehet. Në mjaft krahina të gegërisë gjatësitë e tilla janë rrafshuar. Fjalët janë kthyer në homofone, duke ia lënë kontekstit diferencimin e kuptimit.⁵³

57. Me synimin që të përftohet pasqyrë më e qartë për gjatësinë e zanoreve në arealin

⁴⁸ Zakonisht, përveç me gjatësi të zanoreve dhe me intonacion, këto dy mënyra të foljeve (dëftorja dhe urdhërorja) dallohen edhe me ritmin (tempon) e të folurit. Rëndom, në mënyrën dëftore ritmi i të folurit është më i ngadalshëm, ndërsa në mënyrën urdhërore ritmi është më i shpejtë.

⁴⁹ Shih: Bahri Beci, *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe ...*, f. 232.

⁵⁰ Bahri Beci, *Sistemi fonologjik ...*, SF 1, Tiranë, 1985, f. 93-109.

⁵¹ Jorgji Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 118.

⁵² Rexhep Ismajli, *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1987, f. 197.

⁵³ Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005 e 2011, f. 142.

gjuhësor të Karadakut të Shkupit do të përmendim veç e veç rastet më të shpeshta të rrethimit tingullor (fonetik) të tyre, duke sjellë jo pak fjalë me zanore të shkurtra, zanore të gjatësisë së mesme dhe zanore të gjata, që të dalë në pah edhe përndarja (distribuimi) e tyre.

2.2.1. PËRNDARJA E ZANOREVE TË SHKURTRA

58. Zakonisht të shkurtra realizohen zanoret tek emrat që mbarojnë me bashkëtingëllore. Më të shpeshta janë rastet kur zanoret gjenden:

- Në pozicion para prapagjuhores së shurdhët mbylltore [k], si në fjalët: *xhāk* 'gjak', *shōk*, *ūk* 'ujk', *gjīks* 'gjoks', *koçāk* 'koçak, kotec', *dirēk*, *bilīk* 'bylyk, tufë' etj.

- Para prapagjuhores së zëshme mbylltore [g] dhe mesgjuhores [gj]: *brēg*, *brēgj* 'breg', *lūg*, *lūgj* 'lug, koritë'; *zōg*, *zōgj* 'zog' etj.

- Para lëngëzores sonore [l]: *gjël*, *māl*, *kūlm*, *kōl* 'kuaj', *ēlb*, *dāl*; por kam *da:l* etj. Emrat *gja:l* 'djalë', *ka:l* 'kalë' nyjëtohen me zanore të gjatës për arsye se rrjedhin nga latinishtja ballkanike dhe se rënia e tingujve ka lënë gjurmë në zgjatjen kompensatore të vokaleve që i kanë qëndruar kohës.⁵⁴ Edhe pse emra të gjinisë mashkullore, në shqipen standarde këta dy emra shkruhen me [ë] fundore. Rënia e [ë]-së fundore në të folmet e Veriut ka shkaktuar zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse.

- Të shkurtra janë edhe zanoret kur gjenden para paragjuhores mbylltore të shurdhët [t] ose para grupeve të bashkëtingëlloreve [rt], [kt], [sht], [ft] etj., si në fjalët: *msīt* 'mësit, shkues', *plōt*, *qōt* 'plot', *mrēt* 'mbret'; *īrt* 'yrt', *fōrt* 'fort'; *i*, *e* *vōkt* 'i, e vakët'; *gīsht*, *gjīsht* 'gisht', *bīsht*; *plēsht*, *qēsht*; *nxēft* 'nxeht', *ftōft* 'ftoht' etj.

- Para dybuzores mbylltore të shurdhët [p]: *plēp*, *qēp*; *shkōp*, *Shkūp*, *gjēp* 'djep'; *cāp*, *sqāp*; *qīp* 'qyp' ...

- Para shtegores së shurdhët [sh] dhe afrikates [ç] te disa emra të gjinisë mashkullore të tipit: *kōsh*, *dāsh*, *prēsh*, *çōsh*, *lēsh*'; *mīsh*, *māish*; *kapūç*, *irīç* ...

- Përgjithësisht të shkurtra në këtë të folme shqiptohen edhe zanoret kur gjenden para paragjuhoreve shtegore [s] e [z], si në fjalët: *kōs*, *līs*; *māz* 'mëz', *brēz* etj.

- Dëgjoen të shkurtra zanoret e theksuara te një numër i konsiderueshëm fjalësh kur ato gjenden para bashkëtingëlloreve [h], [j], [dh]: *krāh*, *āh*; *plēh*, *qēh*; *fāj*, *ftōj* 'ftua, ftonj (për njëjës e për shumës)', *thōj* 'thua, thonj', *vōj* 'vaj (peshku)', *hūj* 'ves', *būjk*; *ēdh*, *livādh*, *gjārdh* 'gardh' e në fjalë të tjera.

- Para sonoreve hundore [m], [n] si dhe para grupeve të përngjashmuara (asimiluara) [mb], [nd] në [m], [n]: *gjīm* 'gjym', *gabīm*, *ishīm* 'ushqim', *kalēm* 'kalem, laps', *çilīm* 'qilim'; *gjīn*, *xhīn* 'njerëz'; *qēn*, *çēn*; *tlīn* 'tëlyen, gjalpë', *çobān* 'çoban, bari', *filxhān*; *dhām* 'dhëmb', *shkām* 'shkëmb'; *plūm*, *qūm* 'plumb; *vēn* 'vend', *fūn* 'fund', *katūn* 'katund', *kurkūn* 'kurkund, askund' e në fjalë të tjera.

- Zanorja e theksuar e rrënjës së foljes në mënyrën dëftore të kohës së tashme, në vetën e parë njëjës në këtë areal, si edhe në të folmet e tjera shqipe, realizohet e shkurtër, sipas tipit: *punōj*, *dāl*, *shkōj*, *msōj* 'mësoj', *vrās*, *prēs* e të ngjashme; ndërsa te foljet ku zanorja është përfutur

⁵⁴ Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1987, f. 53.

nga monoftongimi i togzanorshit [ue], kjo zanore e monoftonguar në [u:] rregullisht shqiptohet e gjatë: *shkru:j* (< shkruaj) 'shkruaj', *gatu:j* (< gatuej) 'gatuaj', *blu:j* (< bluej) 'bluaj'; *pagu:j*, *pagju:j* (< paguej) 'paguaj' etj.

- Po kështu, te disa mbiemra që mbarojnë në rrokje të mbyllur, zanorja e theksuar dëgjohej e shkurtër: *i, e ftoft* 'i, e ftohtë'; *i, e ngröft* 'i, e ngrohtë'; *i, e sprëht* 'i, e mprehtë'; *i, e përllömt* 'i, e përlyer' ...

- Edhe te disa ndajfolje dhe përemra zanoret na dalin të shkurtra: *gjïms, gjïmc* 'gjysmë', *söt, k'tũ* 'këtu'; *tĩ, äj* (< ai); *kĩt* 'këtë'; *xhĩt, dixhĩt* 'çka, diçka' ...

- Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, si edhe në shumë të folme të tjera,⁵⁵ përveç në rrokje të mbyllur, e shkurtër realizohet zanorja [i] te jo pak emra vetjakë (personalë) me burim oriental,⁵⁶ që në trajtën e pashquar mbarojnë në këtë zanore, si në emrat: *Xhezmi, Ruzhdĩ, Samĩ, Alĩ, Salĩ, Balĩ, Kadri, Barĩ, Fari, Nuri, Sadi, Shukri* etj., por kur emri shquhet, e njëjta zanore ndërron gjatësinë: nga e shkurtër shqiptohet me gjatësi të mesme, sipas tipit: *Xhezmi.ja, Ruzhdi.ja, Sami.ja...* Emrat e gjinisë femërore në të pashquarën shqiptohen me zanore të gjatë: *Nuri:, Fari:, Sadi:, Shukri:...*, ndërsa në të shquarën gjatësia e zanores asnjësohet, përkatësisht e gjata bëhet e mesme, sipas tipit *Nuri.ja, Fari.ja, Sadi.ja, Shukri.ja...* Rrjedhimisht, tek emrat e tillë e të ngjashëm, në dallim nga trajta e pashquar ku gjatësia e zanores është tregues gramatikor (zanorja e shkurtër për meshkuj dhe e gjata për femra), në trajtën e shquar në të dy gjinitë emrat bëhen homofone, pra me gjatësi të mesme zanoresh (ki ã:sht Shukri.ja - kjo ã:sht Shukri.ja 'ky është Shukriu - kjo është Shukria').

- Zanoret mund të jenë të shkurtra edhe në rrokje të hapur në fundin absolut të fjalës,⁵⁷ rëndom në fjalëzat njërrrokëshe (meqë janë fjalë të patheksuara, proklitike), si p.sh.: *nã* 'ne', *kĩ* 'ky', *nĩ* 'një', *dĩ* 'dy', *kũ, sĩ, k'tũ* 'këtu', *tẽ, mẽ, põ, jõ* etj.

2.2.2. PËRNDARJA E ZANOREVE ME GJATËSI TË MESME

59. Edhe pse në pikëpamje fonetike në të folmet e gegërishtes, përfshirë edhe të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, zanoret realizohen me tri lloj gjatësish: të shkurtra, të mesme dhe të gjata ([ã, a., a:]), në pikëpamje fonologjike kemi kundërvënien e dy segmenteve: zanore të shkurtra ~ zanore të gjata, meqë zanoret me gjatësi të mesme janë asnjëso (neutrale) dhe paraqiten si arkifonema.

60. Dihet se gjatësia e mesme fonetkisht kushtëzohet nga natyra dhe përbërja e rrokjes, pozita e saj në fjalë e në fjali. Përgjithësisht, me gjatësi të mesme në shqipen na dalin zanoret në pozita të ndryshme në fjalës, me përjashtim të fundit absolut të fjalës. Pra, si zanoret e gjata ashtu edhe zanoret e shkurtra të theksuara gjatë eptimit (lakimit dhe zgjedhimit) të fjalës shndërrohen në të mesme, duke bërë rregullimin mekanik të gjatësisë.

61. Edhe pse trajtohen si zanore të gjatësisë së mesme, megjithatë ato për nga kuantiteti janë më afër të gjatave sesa të shkurtrave, meqenëse, në përgjithësi, me rregullimin mekanik të gjatësisë formohen fjalë që mbarojnë në rrokje të hapur. Po kështu, zanoret e mesme në pikëpamje të hapjes: e hapur ~ e mbyllur janë më afër të gjatave (në shqipen zanoret e gjata janë

⁵⁵ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 53-56.

⁵⁶ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997, f. 38.

⁵⁷ Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 79.

më të hapura sesa të mbyllurat).⁵⁸ Në këtë mënyrë, tek emrat e trajtës së pashquar, zanorja e theksuar qoftë e gjatë apo e shkurtër, në trajtën e shquar shndërrohet në zanore me gjatësi të mesme. Për shembull:

- Zanore e shkurtër > zanore e gjatësisë së mesme: *līs* > *li.si*; *i*, *e li.sit*, *li.sit*, *li.sin*; *li.sat*; *i*, *e li.save*, *li.save*, *li.sat*, (prej) *li.save*; *plūm*, *qūm* > *qu.mi*; *i*, *e qu.mit*, *qu.mit*, *qu.min*; *qu.mat*; *i*, *e qu.mave*, *qu.mave*, *qu.mat*; *brēz* > *bre.zi*; *i*, *e bre.zit*, *bre.zit*, *bre.zin*; *bre.zat*; *i*, *e bre.zave*, *bre.zave*, *bre.zat*; *kōs* > *ko.si*; *i*, *e ko.sit*, *ko.sit*, *ko.sin*; *kīngj* > *ki.ngji*; *i*, *e ki.ngjit*, *ki.ngjit*, *ki.ngjin*; *ki.ngja*; *i*, *e ki.ngjave*, *ki.ngjave*, *ki.ngjash* 'qengj' etj.

- Zanore të gjata > zanore e gjatësisë së mesme: *u:dh* > *u.dha*, *u.dhat*, *u.dhën*, *u.dhës*; *i*, *e u.dhës*, *u.dhave*; *u:r* > *u.ra*, *u.rat*, *u.rën*; *i*, *e u.rës*, *u.rave*, *u.rash*; *gri:k* > *gri.ka*, *gri.kat*, *gri.kën*; *i*, *e gri.kave*, *gri.kave*, *gri.kash*; *katuna:r* > *katuna.ri*, *katuna.rit*, *katuna.rin*, *katuna.rve* etj.

- Rregullimi mekanik i shndërrimit të gjatësisë së zanoreve gjatë marrje së formave të ndryshme gramatikore sipas analogjisë me fjalët anase, bashkë me përshtatjen e vendit të theksit sipas natyrës së shqipes (nga rrokja e tretë në rrokjen e fundit a të parafundit) në këtë të folme bëhet edhe te huazimet me burim nga gjuhët sllave (maqedonishtja e serbishtja), sipas tipit: *плáта* > *pllátë* > *pllá:t* > *pllá.ta*, *pllá.tën*, *pllá.tës*, *pllá.tave*; *липа* > *lípë* > *lí:p*, *lí.pa*, *lí.pën*, *lí.pës*, *lí.pave* 'bli'; *домаќин* > *domaćín* 'nikoqir', *наместај* > *nameshtáj* 'mobilje', *пијавица* > *pijavâic* 'ushujzë', *слаткарница* > *sllatkarníc* 'ëmbëltore' etj.

- Te një sasi e konsiderueshme foljesh, zanoret e theksuara (qofshin ato të shkurtra ose të gjata), gjatë zgjedhimit shndërrohen në zanore të gjatësisë së mesme: *punōj* > *puno.jm*, *puno.ni*, *puno.jn*; *dāl* > *da.lim*, *da.lin*; *shkōj* > *shko.jm*, *shko.jn*.

62. Duhet vënë në pah se rregulli i përgjithshëm i rregullimit mekanik të gjatësisë së zanoreve në sistemin foljor ka edhe disa përjashtime. Si shembull mund të përmendim disa situata: a) foljet që në trup të fjalës dikur në mbarë gegërishten kishin grupe zanoresh (më shpesh [ue], [ye]), sot në Karadakun e Shkupit përdoren në tri forma fonetike: me monoftong të gjatë [u:], me diftong dytësor [âu], ose me [a:] të gjatë (të përfutur nga monoftongimi i diftongut [âu]). Vetë e përbashkët e këtyre zanoreve ([u:], [a:]), por edhe e diftongjeve⁵⁹ është se ato gjithnjë shqiptohen të gjata, si: *blu:j* (< bluej) 'bluaj', *pagu:j*, *pagju:j* (< paguej) 'paguaj', *shkra:j*, *shkrâuj* (< shkru:j, shkruiej) etj.

63. Po kështu, foljet e mënyrës dëftore me zanore të shkurtër të theksuar, të tipit: *punoj*, *shkoj*; *dal*, *mjel*, *pres*; *marr* etj., pjesoret e këtyre foljeve shqiptohen me zanore të gjatë: (kam) *punu:* (puna:, punâu) (kam) 'punuar', *shku:* 'shkuar', *da:l* 'dalur', *mje:l* (*me:l*) 'mjelë', *pre:* 'prerë', *ma:rr* 'marrë'.

64. Kuantiteti i zanores në rrënjë të foljes nuk ndryshon në mënyrën urdhërore as edhe kur ndryshon përbërja rrokjesore, duke i shtuar foljes trajta të shkurtra të përemrave vetorë. Krahaso: *gërko!*, *gërkoje!*, *gërkoni!* 'kërko!', 'kërkoje!', 'kërkoni!'; *laro!*, *laroje!*, *laroni!* 'lëvro!', 'lëvroje!', 'lëvroni!'; *puno!*, *punoje!*, *punoni!*.

⁵⁸ Kolec Topalli, *Theksi ...*, f. 80.

⁵⁹ Nga pikëpamja e kohëzgjatjes së nyjetimit, diftongjet llogariten si dymorëshe, ashtu si edhe zanoret e gjata. Zanoret e shkurtra janë njëmorëshe.

2.2.3. PËRNDARJA E ZANOREVE TË GJATA

65. Në veprat e shkrimtarëve të vjetër midis shekujve XVI-XVIII, zanoret e gjata janë shënuar me dyzimin (dyfishimin) e dy shkronjave të njëjta.⁶⁰ Prof. Bahri Beci me metodën e fonetikës eksperimentale (e para e këtij lloji në dialektologjinë shqiptare) ka hartuar një monografi për të folmen e Shkodrës,⁶¹ ku studiuesi ka analizuar një numër të madh fjalësh njërrokëshe e shumërokëshe me zanore në rrethime të ndryshme fonetike. Sipas këtij autori, zanoret e shkurtra në të folmen e Shkodrës shqiptohen në intervalin kohor prej 20 deri më 8 të qindtat e sekondës (qs), ndërsa zanoret e gjata ndërmjet 42-20 qs. Vlerësim i përgjithshëm është se raporti i gjatësisë fizike të zanoreve të gjata ~ zanoreve të shkurtra është në përmasat 2:1.

66. Në pamundësi që të masim me saktësi gjatësinë e zanoreve e më pas të nxjerrim vlerat mesatare të tyre, meqë te ne nuk kemi laborator të fonetikës eksperimentale (as që më është dhënë mundësia të shfrytëzoj mjetet teknike të ndonjë laboratorit fonetik), mund të mjaftohemi tani për tani me konstatimin se edhe për të folmen e Karadakut të Shkupit (si edhe për të folmet e tjera të Veriut) vlen barazimi i njohur: *një zanore e gjatë = dy zanore të shkurtra*.

67. Mbështetur në të dëgjuarit e vëmendshëm gjatë vjeljes së materialit dialektor si dhe në kontaktet e mia pesëdhjetëvjetëshe të përditshme me folës të Karadakut të Shkupit, të gjitha zanoret (të gjatat, të mesmet e të shkurtrat) në këtë areal gjuhësor janë diçka më të shkurtra sesa në grupin e të folmeve të gegërishtes veriperëndimore (me qendër në Shkodër, si qyteti më i madh) dhe në gegërishten verilindore (e njohur edhe si kosovarishte). Megjithëkëtë, raporti 2:1 mbetet i pranueshëm e i mundshëm edhe për këtë të folme, meqë të gjitha zanoret na dalin pak më të shkurtra, kështu që raporti saior i gjatësisë mbetet i pandryshueshëm, po i njëjti.

68. Në bazë të kësaj që u tha, po të përpiqemi të japim një vlerësim përgjithësues, atëherë mund të themi se kundërvënia fonologjike që realizohet në gjatësinë e zanoreve në të folmet e gegërishtes bashkëpërkon me shtrirjen gjeografike: sa më në veri që gjendet e folmja aq më shumë realizohet kundërvënia zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë (përfshirë edhe kundërvënien zanore gojore ~ zanore hundore). Duke zbritur më nga jugu nëpër Gegëri, funksioni i gjatësisë dhe i hundorësisë së zanoreve zvogëlohet, zbehet; ashtu që çiftet minimale të fjalëve me opozicion fonologjik zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë si dhe zanore gojore ~ zanore hundore janë më të rralla e më të rralla.⁶²

69. Sido që të jetë, dy gjatësitë fonologjike të zanoreve (e shkurtër ~ e gjatë) në vetëdijen komunikuese të folësve shqiptarë të Karadakut të Shkupit kanë funksion kuptimdallues e më shpesh funksion gramatikor, në mungesë të ndonjë treguesi tjetër për të bërë dallimin midis dy çiftesh minimale fjalësh. I njohur në shumë gjuhë të botës është edhe fakti se ndërmjet dy izoglosave që kanë dallime të thella njëra me tjetrën, sidomos në fushën e fonetikës, shpeshherë gjendet një ‘zonë e mesme, e ndërmjetme, kalimtare, tranzitive’, ashtu që kalimi nga një tip izoglose në tipin tjetër bëhet në mënyrë të shkallëshkallshme, graduale, me ndërthurje e gërshetime, duke u shuar një dukuri e duke u shfaqur një dukuri tjetër.⁶³

70. Nga kjo pikëpamje, pozita gjeografike e Karadakut të Shkupit (në jug të Kosovës dhe në veri të Maqedonisë) ka bërë që edhe në pikëpamje gjuhësore të jetë një zonë e ndërmjetme, izoglosë ndërkaluese nga grupi i të folmeve të gegërishtes qendrore në gegërishten verilindore

⁶⁰ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 52.

⁶¹ Bahri Beci, *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik...*, f. 179-187; 232.

⁶² Pothuajse në çdo rregull të përgjithshëm ka përjashtime.

⁶³ N. S. Trubeckoi, *Parime të fonologjisë*, Prishtinë, 1985, f. 475.

(kosovarishte). Në të vërtetë, fshatrat që shtrihen pikërisht në zonën kufitare me Kosovën, Tanusha dhe Bllaca edhe gjuhësisht na dalin si të folme tipike ndërkaluese, ndërsa të folmet e tjera që shtrihen më në jug kanë më shumë elemente të gegërishtes qendrore.

71. Shpjegimet e mësipërme na japin të drejtë të pohojmë se këtu e gjen arsyen e fillimit të shprehisë nyjëtimore të këtij areali⁶⁴ për të defonologjizuar dhe denazalizuar zanoret në krahasim me të folmet e nëndialektit të gegërishtes veriore.⁶⁵ Këtë proces, sipas gjithë gjasash, e ndihmojnë edhe ndikimi i shqipes standarde si edhe ndikimi i gjuhëve të tjera në takim (maqedonishtja, që nuk njeh gjatësi e hundorësi fonologjike të zanoreve as në ligjërimin popullor e as në varietetin standard).

72. Në bazë të materialit burimor të vjelë në terren, në këtë të folme, si dhe në të folmet e tjera të gegërishtes, zanoret e gjata gjenden në këto raste:

- Si rezultat i gjatësisë së trashëguar historike, kur nga fjalë të gjata me rënie tingujsh e rrokjesh janë përfutur fjalë më të shkurtra, si: *ku:t* < lat. cubitus, *de:t* < lat. deubetos, *mje:k* < lat. medicus, *ka:l* < lat. cabalus.⁶⁶

- Nga rënia e [ë]-së së patheksuar në fundin absolut të fjalës është shkaktuar zgjatja kompensatore e zanores paraprirëse, ashtu që zanorja që gjendet para saj tani shqiptohet e gjatë. Zanore të tilla kemi sidomos tek emrat e gjinisë femërore në trajtën e pashquar, sipas tipit: *na:n* 'nanë', *do:r* 'dorë', *a:r* 'arë', *fa:r* 'farë', *pu:n* 'punë', *mo:ll* 'mollë', *fu:sh* 'fushë', *pu:l* 'pulë', *ça:f* 'qafë', *ma:c* 'mace, macë', *o:d* 'odë', *fla:k* 'flakë', *pu:shk* 'pushkë' etj.

- Mosshqiptimi i [ë]-së te disa emra ka bërë të mundur të dallohet forma e njëjësit nga shumësi. Krahaso: *fishëk* - *fishë:k* 'fishëk - fishëk', *dishëk* - *dishe:k* 'dyshek - dyshekë', *jelëk* - *jele:k* 'jelek - jelekë', *jastëk* - *jaste:k* 'jastëk - jastëkë', *lejlëk* - *lejle:k* 'lejlek - lejlekë'.

73. Rast të njëjtë kemi edhe te pak emra të gjinisë mashkullore (që shqiptohen me zanore të shkurtër dhe emra përkatës të gjinisë femërore (që shqiptohen me zanore të gjatë, që janë përfutur nga rënia e [ë]-së fundore), si: *plāk*, *qāk* - *pla:k*, *qa:k* 'plak - plakë'; *kunāt* - *kuna:t* 'kunat - kunatë'; *krūshk* - *kru:shk* 'krushk - krushkë' etj.

- Po kështu, zgjatje kompensatore të zanores paraprirëse kemi edhe te mbiemrat e nyjshëm, si p.sh.: *i*, *e mair* (< i mi:r < i mirë); *i*, *e gja:n* (< i gjanë); *i*, *e gja:t* (< i, e gjatë); *i*, *e le:t* (< i, e lehtë); *i*, *e kfe:llt*, *fke:llt* (< i, e kthjelltë) ...

- Rastet më të shpeshta e me gjatësi më të shprehur qartë na dalin kur zanorja gjendet në pozitë absolute fundore të fjalës (qoftë kur ruhet si monoftong apo në formë të diftonguar), si: *brī:*, *hī:*, *mullī:*, *mullāi*; *kusī:*, *kusāi*, *drī:*, *gīā:*, *kurgjā:*, *shullā:*, *zā:*, *gra:*, *frē:*, *drū:*, *hū:*, *dhe:*, *ka:*, *vlla:*, *shpāi*, *kutāi*, *shāi*; kam (kom) - *la:*, *pa: gje:* 'ble:;', *pre:*, *da:* 'nda:' ...

74. Kjo gjatësi maksimale e zanoreve në pozitë fundore absolute mund të shpjegohet me kushtet ideale për t'u zgjatur, për t'u nyjëtuar për një kohë më të gjatë, pa u ndërprerë nyjëtimi nga tinguj të tjerë pasues. Te fjalët e shënuara më lart, disa zanore ose diftongje shqiptohen me hundorësi. Hundorësia e tyre është gjurmë e ekzistencës së [n]-së që ka pasur dikur në rrënjë të fjalës në trajtën e pashquar, pas zanores së sotme hundore ose diftongut hundor (në të kaluarën: tr. e pashq. *pēn* – tr. e shq. *pēni*; sot: tr. e pashq. *pē* – tr. e shq. *pēni*).

- Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit zanore të gjata dëgjuam edhe në rrokje të mbyllur. Zakonisht, përveç për shkaqe historike, të gjata janë edhe zanoret kur pas tyre përdoren tingëllueset [l], [ll]; [r], [rr]: *gja:l* 'djalë', *va:l* 'valë', (kam) *da:l* 'dalë', (jam) *fa:l* 'falë', *ba:ll*

⁶⁴ Bahri Beci, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987, f. 14-18.

⁶⁵ Bahri Beci, *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i ...*, f. 35-43.

⁶⁶ Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1987, f. 119.

'ballë', *musa:ll* 'tregim, përrallë', *mura:ll* 'mullar', *i rra:ll* 'i rrallë', *ma:ll* 'mallë', *i xha:ll* 'i gjallë', *katuna:r* 'katundar', *buna:r* 'bunar, pus', *shipta:r* 'shqiptar', *malso:r* 'malësor', *bu:rr* 'burrë', *vo:rr* 'vorr', *ke:rr* 'qerre' etj. Sigurisht se te fjalët me [ë] fundore të patheksuar, gjatësia është rrjedhojë e zgjatjes kompensatore të zanores paraprirëse.

- Do theksuar se në këtë të folme, si dhe në të folme të tjera shqipe në Maqedoninë e Veriut, fjala vjen në të folmen e Dervenit,⁶⁷ ka raste ku zanorja edhe pse gjendet në pozicion para sonanteve [r] ose [rr] nuk shqiptohet e gjatë, si në: *asker* 'ushtar', *minder*, *shofer*, *sheqer*, *Baftjar*, *terr* etj.

- Në këtë të folme si e gjatë shqiptohet edhe zanorja [i:] tek emrat që kanë prapashtesën sllave - *ica* (icë, i:c), sipas tipit: *magjari:c* 'gomare', *bulli:c*, *bullâic* 'buallicë'.

- Po kështu, [i:]-ja artikullohet e gjatë edhe te patronimet e gjinisë femërore të formuar nga emrat e burrave të tyre, duke shtuar prapashtesën sllave -i:c. Kjo mënyrë e tillë e formimit të patronimeve (tregues i patriarkatit të skajshëm) është karakteristikë e shumë të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut.⁶⁸ P.sh.: *Dauti:c*, *Hasani:c*, *Arifi:c*, *Murati:c* etj. (gruaja a bashkëshortja e Dautit, Hasanit, Arifit, Muratit). Shprehi nyjetimore e këtij areali gjuhësor është edhe shqiptimi me [i:] të gjatë i toponimeve *Runi:c*, *Goshi:nc*, *Corroti:c*, *Zhuni:c*, *Presni:c*, *Vaksi:c*, *Përlepni:c*, *Reçi:c* etj., që si emra të gjinisë femërore (Runica, Goshinca, Corrotica, Zhunica, Presnica, Vaksica, Përlepnica, Reçica) kanë bjerrë [ë]-në fundore në trajtën e pashquar dhe kjo ka shkaktuar zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse.

- Të gjata janë edhe zanoret e përfutuara nga monoftongimi i togjeve vokalike ose diftongjeve [ue], [ie], [ye]. Krahaso shembujt: (kam) *shku:* (< shkue), *bu:ll* (< buell), *ftu:* (< ftue), *kru:* (< krue), *knu:s* (< knues, këndues), *tru:ll* (< truell), *du:* (< due), *di:ll* (< diell), *çi:ll* (< qiell), *mi:ll* (< miell), *dhe:t* (< dhjet, dhjetë), *pe:k* (< pje:k, pjekë), *pe:shk* (< pje:shk, pjeshkë), *fi:ll*, *fâill* (< fyell), *di:r* (< dyer), *di:ll* (< dyell) etj.

- Në këtë areal gjuhësor kemi vërejtur një dukuri fonetike mjaft interesante, veçmas në fshatrat Brezë, Malinë e Grushinë: zanorja [u:] e theksuar e gjatë së pari është shpërbërë në diftongun dytësor [âu], e pastaj ky dytingullsh është monoftonguar në [a:] të gjatë, nëpërmjet disa fazave kryesore: *arúshë* > *arú:sh* > *arâush* > *ara^ush* > *ara^esh* > *ará:sh*. Raste të tilla kemi edhe në format e fjalëve: *ca:c* (< câuc < cu:c < cucë), (kam me) *puna:* (< punâu < punu: < punue), *u mashtra:m* (< u mashtrâum < u mashtru:m < u mashtruem) etj.

- Zanore të gjata ndeshim edhe në sintagmat që fonetikiht përbëjnë një fjalë të vetme (sandhi), gjatë takimit të dy zanoreve të njëjta, të tipit: *ujti:çkrojt* (< ujt i krojt) 'uji i kroit', *gjali:çjem* (< djali i jem) 'djali i im, djali im', *kali:çvet* (< kali i vet), *dele:çbardh* (< dele e bardhë) etj. Në të vërtetë te këto sintagma si dhe te togfjalëshit e tillë të ngjashëm kemi një tërësi theksore, fonetikiht një fjalë të vetme, një fjalë fonetike; në pikëpamje morfologjike të formuar nga një emër + përcaktor ose emër + përemër pronor.⁶⁹

75. Nga shembujt e sjellë, duket qartë se edhe për të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, lidhur me kuantitetin e zanoreve vlejné rregullat e gjuhësisë së përgjithshme, siç janë konstatimet se: gjatësia e zanores është në raport të drejtë me hapjen ~ mbylljen e saj: sa më e hapur është zanorja aq është edhe më e gjatë, dhe sa më e mbyllur të jetë ajo është më e shkurtër.⁷⁰ Zanorja [ë] është më e shkurtra dhe nuk shfaqet në rrokje të theksuar në të folmet e

⁶⁸ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 371.

⁶⁹ Ирена Савицка – Људмил Спасов, *Фонологија на современиот македонски...*, 1997, f. 195-205.

⁷⁰ N. S. Trubeckoi, *Parime të fonologjisë*, Prishtinë, 1985, f. 162.

gegërishtes, ajo përdoret vetëm si e shkurtër dhe nuk e ka fituar statusin e fonemës. Në të folmen tonë, si edhe në të folmet e tjera të dialektit të Veriut, kjo zanore ka frekuencë dhe distribuim të vogël,⁷¹ me tendencë të humbjes.⁷²

2.2.4. ZANORET E PATHEKSUARA

76. Nga këndvështrimi fonologjik, d.m.th. nga ana strukturore dhe funksionale, në sistemin e zanoreve të patheksuara, të folmet shqipe janë më unike sesa në sistemin e zanoreve të theksuara. Kjo mund të paraqitet në dy parametra:

a) së pari, unitetin e mbështesim në faktin se të gjitha të folmet kanë të njëjtën seri zanorësh të patheksuara – serinë e zanoreve të shkurtra;

b) së dyti, ngjashmëria del edhe në atë se [ë]-ja e patheksuar përdoret në të gjitha të folmet e shqipes, përkundër [ë]-së së theksuar që e kanë vetëm të folmet e Jugut.⁷³

77. Po të krahasohen zanoret e theksuara nga të patheksuarat del se të patheksuarat kanë prirje të bëhen më qendrore, më të hapura dhe më të prapme. Kjo dëshmon se të patheksuarat shqiptohen me tendosje më të vogël të organeve të të folurit sesa të theksuarat. Zanoret e theksuara janë afërsisht dy herë më të gjata sesa të patheksuarat.⁷⁴

78. Sipas kësaj që u tha, është e qartë se e folmja e Karadakut të Shkupit ka vetëm një seri zanorësh të patheksuara, të përbërë nga 6 zanore:

[a], [e], [ë], [o], [i] dhe [u].

79. Kjo e folme, si edhe shumë të folme të tjera të gegërishtes qendrore, në inventarin vokalik nuk e ka fonemën /y/ as në rrokje të theksuar e as në rrokje të patheksuar, meqë ajo është zhburorëzuar në /i/ (pastaj edhe është diftonguar).

2.3. HUNDORËSIA E ZANOREVE

80. Për gjendjen e sotme të studimeve dialektore në përgjithësi mund të thuhet se shkalla e hundorësisë së zanoreve bashkëpërkon me shtrirjen gjeografike të tyre: sa më në veri që janë, hundorësia është aq më e madhe dhe anasjelltas. Kështu, në të folmet e nëndialektit verior të gegërishtes kemi një hundorësi me intensitet të lartë, ndërsa në nëndialektin e gegërishtes jugore kemi një shkallë më të ulët hundorësie. Zaten, po të duam të krahasojmë të folmet e Kosovës me të folmet shqipe të Maqedonisë, sipas një shkallëzimi hundorësie, duke filluar nga një shkallë më e lartë e përfunduar me një shkallë më të ulët, afërsisht do të kishim edhe një zbritje gjeografike

⁷¹ Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1988, f. 50-51.

⁷² Bahri Beci, *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës ...*, f. 101.

⁷³ Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1988, f. 43-44; *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 127-129.

⁷⁴ Anastas Dodi - Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 42.

veri - jug: të folmet e Kosovës, të Preshevës e Bujanovcit, të folmet e Kumanovës, të Shkupit, të Tetovës, të Gostivarit, të Kërçovës, të Dibrës⁷⁵ dhe të Strugës.⁷⁶ Në këto dy të folmet e fundit pothuajse nuk dëgjojmë fare zanore me timbër hundor. Por, ashtu si për gjatësinë e zanoreve, edhe për shkallën e hundorësisë fjalën e fundit mund ta thotë vetëm analiza laboratorike, ndërsa vlera e tyre fonologjike duhet provuar me metodën e zëvendësimit (komutacionit).

81. Sido që të jetë, mendojmë se çështja e shtrirjes së hundorësisë së zanoreve, e përcaktimit të inventarit të këtyre fonemave nëpër të folme të veçanta, e intensitetit të saj, e vlerës fonologjike të hundorësisë si dhe shumë dukuri të tjera kërkojnë studime të mëtejme.

82. Në Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe I (në hartat 8, 9, 10, 11, 12)⁷⁷ është paraqitur përndarja e fonemave hundore /ã/, /ẽ/, /ĩ/, /ỹ/, /ũ/ në të gjitha të folmet shqipe të trungut e të diasporës nëpërmjet fjalëve *bãn* ‘bën’, *ẽn* ‘end’, *u pĩ* ‘u mpi’, *sỹ* ose *sø* ‘sy’, *hũ* ‘huri’. Më pastaj, në hartën përgjithësuese nr. 19 është paraqitur numri i serive të fonemave zanore të theksuara. Sipas kësaj harte përgjithësuese mund të përfundohet se kemi tri areale:

1. **Areal me një seri fonemash zanore të theksuara:**

a) **vetëm me serinë e zanoreve gojore të shkurtra**, që përfshin të folmet toske (me përjashtim të një rripi të folmesh përgjatë bregdetit të Jonit në Labëri e në Çamëri, të arbëreshëve të Greqisë e disa të folme arbëreshe të Italisë);

2. **Areal me dy seri fonemash zanore të theksuara:**

a) me serinë e zanoreve gojore të shkurtra, dhe

b) me serinë e zanoreve gojore të gjata, që përfshin të folmen e Dibrës, rripin e të folmeve përgjatë bregdetit të Jonit në Labëri e në Çamëri, të arbërishten e Greqisë e disa të folme arbëreshe të Italisë);

3. **Areal me tri seri fonemash zanore të theksuara:**

a) me serinë e zanoreve gojore të shkurtra,

b) me serinë e zanoreve gojore të gjata, dhe

c) me serinë e zanoreve hundore, që përfshin të gjitha të folmet e gegërishtes, përveç të folmes së Dibrës.

2.3.1. HUNDORËSIA SI DUKURI FONETIKE DHE VLERA FONOLOGJIKE E SAJ

83. Konstatimi se të folmet gege në gjendjen e sotme kanë fonema zanore hundore është i diskutueshëm. Duhet **rishqyrtuar vlera fonologjike e zanoreve hundore të gegërishtes**. Mendojmë se kundërvënia e gjatësisë së zanoreve dhe hundorësia e tipit fonetik është mbarëdialektore gege; por, hundorësia në pikëpamje fonologjike nuk ka vlerë absolute. Gjykojmë se hundorësia e zanoreve tani më është defonologjizuar jo vetëm në nëndialektin e gegërishtes jugore, por edhe në shumë të folme të nëndialektit të gegërishtes veriore. Për ta përdëftuar këtë, përshtkrimi i sistemit vijor (segmentor, linear) veçmas të të folmeve gege në të ardhmen duhet bërë si nga aspekti fonetik, ashtu edhe nga ai fonologjik.

84. Të folmet gege në çështjen e hundorësisë së zanoreve tani gjenden në një fazë kalimtare. Te të gjitha ka prirje për defonologjizimin e hundorësisë së zanoreve. Nga punimet

⁷⁵ Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 143.

⁷⁶ Ajten Qamili, *E folmja shqipe e Strugës (në kontekstin ballkanik)*, arkivi i Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup, 2012, f. 60.

⁷⁷ AShSh, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, Vëllimi I, Napoli, 2007.

dialektore që na kanë rënë në dorë, kemi fituar bindjen se të folmet e nëndialektit jugor të gegërishtes po shkojnë drejt çhoundorëzimit dhe në këtë proces prijnë të folmet shqipe të Maqedonisë, ku hundorësia e zanoreve është defonologjizuar, ndërsa gjatësia e tipit fonologjik ende ruhet (sidomos në saje të mosshqiptimit të [ë]-së fundore). Në nëndialektin verior të gegërishtes aty-këtu (por jo gjithkund) vlera fonologjike e hundorësisë së zanoreve ende ruhet.

85. Për morfonologjinë e gegërishtes me interes është të shqyrtohet edhe hundorësia e zanoreve. Marrë në përgjithësi, në dialektin e Veriut kemi të folme që: a) kanë **zanore të hundorëzuara** dhe b) kanë **fonema zanore hundore**. Të arriturat teorike dhe praktike të dialektologjisë shqiptare si dhe të gjuhësisë shqiptare e të gjuhësisë së përgjithshme duhet zbatuar edhe në përshkrimet dialektore. Në përshkrimin dialektor të çdo të folmeje geqe kundërvënia e fonemave zanore të theksuara hundore me fonemat gojore duhet parë në çifte minimale fjalësh, si p.sh.:

- /a:/ ~ /ã:/: *ha:n* (ata hanë) ~ *hã:n* “hënë”, *va:th-i* ~ *vã:th-t* “vëthët”;
- /ã:/ ~ /a/: *kã:m* “këmbë” ~ *kam* (unë), *hã:n* “hënë” ~ *han* (ai ha), *atã* “atë” ~ *ata*, *ktã* “këtë” ~ *kta* “këta”;
- /ã/ ~ /ã/: *lãm* (ne) “lam” ~ *lã:m* “lëmë”, *kãn* “kanë” ~ *kã:n* “kënë”;
- /e:/ ~ /ê:/: *ve:* “vezë” ~ *v ê:* “(unë) vë”;
- /i/ ~ /î:/: *mi* (djemt e) “mi” ~ *mî:* “miu” etj., por ato mund të jenë të ndryshme nga një e folme në një të folme tjetër.

2.3.2. ZANORET E HUNDORËZUARA DHE FONEMAT HUNDORE

86. Në qoftë se një e folme ka çifte të tilla fjalësh ose të ngjashme, atëherë mund të nxirret përfundimi se ajo e folme, përveç gojoreve, ka fonema të veçanta hundore, që krijojnë edhe seri fonemash më vete, të cilat mund t’i quajmë zanore hundore. Nga ana tjetër, nëse nuk kemi çifte fjalësh të tilla, rrjedhimisht realizimet e zanoreve me timbër hundor janë variante kombinatorë të fonemave përkatëse gojore, ato nuk krijojnë seri të posaçme fonemash dhe mund të quhen zanore të hundorëzuara.

a) **Zanore të hundorëzuara** janë ato që nuk kanë vlerë fonologjike dhe që nuk krijojnë seri më vete në inventarin e fonemave zanore. Dihet se disa të folme të gegërishtes nuk kanë fonema zanoresh hundore. Hundorësia në to ka karakter fonetik, pra lidhet me pozicionin e zanores para një bashkëtingëlloreje hundore, ka shkallë më të ulët hundorësia dhe ç’është më e rëndësishmja, janë zanore të hundorëzuara ato që nuk krijojnë seri më vete në sistemin vokalik të asaj të folmeje, d.m.th. nuk kemi serinë e zanoreve hundore që të krijojnë kundërvënien fonologjike me zanoret gojore. Për të folme të tilla është thënë se nuk kanë zanore hundore. Deri më tani dihet se fonema zanore hundore nuk kanë e folmja e Dibrës,⁷⁸ e Ulqinit,⁷⁹ e folmja e Prilepit dhe e Krushevës,⁸⁰ e folmja e Tërnovcit (afër Bujanovcit e Preshevës),⁸¹ e Kërçovës,⁸² e

⁷⁸ Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 137-221.

⁷⁹ Jorgji Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 121.

⁸⁰ Mustafa Ibrahim, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Interlingua, Shkup, 2005.

⁸¹ Dr. Idriz Ajeti, *Rreth disa vecorive të ë folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit*, Kërkime gjuhësore, Prishtinë, 1978, f. 184 - 187.

⁸² Abedin Zenku, *Disa karakteristika të krahinës së Kërçovës*, Jehona, 1968, 3, f. 83.


folmja e zonës së Maçellarës, Plloshtanit, Cerenit e Radomirës,⁸³ sigurisht edhe ndonjë e folme tjetër e gegërishtes.

Në të folmet e gegërishtes qendrore çiftet minimale të fjalëve me kundërvënie fonologjike zanore gojore ~ zanore hundorë është zvogëluar me procesin e diftongimit të zanoreve hundore /i/, /ũ/ në /ai/, /au/. Në këtë kuptim, edhe te diftongjet e përfuara nga diftongimi i zanoreve hundore dëgjohet një timbër hundor, por kjo hundorësi është më e vogël, si dhe më i rëndësishëm është fakti se vështirë se mund të gjejmë më çifte minimale fjalësh me kundërvënie fonologjike zanore gojore ~ zanore hundore që kanë vlerë kuptimdalluese ose gramatikore. Fjala vjen, kundërvënia /i/ ~ /ĩ:/: *mi* (djemt e) “mi” ~ *mĩ*: “miu”, nuk realizohet, meqë kemi homofoni të të dy fjalëve: (djemt e) *mâi* “mi” - *mâi* “miu” etj.

b) **Zanore hundore** që krijojnë seri më vete si fonema të veçanta, d.m.th. që kanë vlerë fonologjike, nga punimet dhe monografitë e kosultuara del se kemi në shumicën e të folmeve të nëndialektit të gegërishtes veriore, si në grupin veriperëndimor ashtu edhe në grupin verilindor, si në të folmen e Shkodrës,⁸⁴ Nikaj-Mërturit, të Krasniqes, të Gashit e Bytyçit, të Tropojës, të Hasit,⁸⁵ të Rugovës, në të folmen e Lugut të Drinit të Bardhë, të Zhurit të Prizrenit,⁸⁶ të Opojës,⁸⁷ të Anadrinit,⁸⁸ të Drenicës, të Shalës së Bajgorës,⁸⁹ të Gollakut, të Ferizajt, të Gjilanit, të Kaçanikut⁹⁰ etj. Sipas tyre del se në nëndialektin verior të gegërishtes vlera fonologjike e hundorësisë së zanoreve ende ruhet.

87. Gjatë analizës së materialit të vjelë dialektor në zonën e Karadakut të Shkupit, lidhur me hundorësinë e zanoreve kemi ardhur në përfundim se në këtë areal gjuhësor kemi zanore të hundorëzuara, por meqë arritëm të gjenim pak çifte minimale fjalësh me kundërvënie fonologjike zanore gojore zanore hundore, atëherë konstatojmë se përveç fonemave gojore, ka edhe fonema zanore hundore me kuantitet të ndryshëm. Por, shkalla e hundorësisë nuk është aq e lartë, ose së paku është më e ulët sesa në të folmet e nëndialektit të gegërishtes veriore.

88. Në Karadakun e Shkupit identifikojmë katër fonema zanore hundore: /ĩ/, /ũ/, /ẽ/ dhe /ã/, të cilat krijojnë një kundërvënie sipas hapjes a ngritjes (lëvizjes vertikale të gjuhës): 2 të ngushta dhe 2 të hapura; dhe sipas vendit të formimit në hapësirën e gojës (lëvizjes horizontale të gjuhës): 2 të përparme dhe 2 të prapme. Ky sistem zanoresh hundore mund të paraqitet në formë katërkëndëshi:



⁸³ Shefqet Hoxha, *E folmja e Lumës dhe disa çështje rreth shtrirjes së nëndialektit verilindor të gegërishtes*, Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 12 - 18 janar 1968, III; Tiranë, 1969, f. 261.

⁸⁴ Bahri Beci, *Të folmet veriperëndimore të shqipës dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, Tiranë, 1995.

⁸⁵ Prof. dr. Imri Badallaj, *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2001, f. 40-47.

⁸⁶ Imri Badallaj, *Disa veçori fonetike të së folmes së Zhurit*, Gjurmime albanologjike, nr. 5, Prishtinë, 1975.

⁸⁷ Dr. Naser Pajaziti, *E folmja e Opojës*, Prishtinë, 2005, f. 35-39.

⁸⁸ Dr. Naser Pajaziti, *E folmja e Anadrinit*, Prishtinë, 2008, f. 46-47.

⁸⁹ Latif Mulaku - Mehdi Bardhi, *Mbi të folmen shqipe të Peshterit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 275 - 325.

⁹⁰ Fadil Raka, *E folmja e qytezës së Kaçanikut*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 503-544.

89. Si zanoret gojore, ashtu edhe hundoret në pikëpamje fonetike realizohen si të shkurttra, të mesme dhe të gjata; por te zanoret hundore gjatësia nuk ka vlerë funksionale, fonologjike, kuptimvalluese. Sipas vlerësimit tonë, edhe brenda arealit gjuhësor të Karadakut të Shkupit hetohet një dallim në intensitetin e hundorësisë së zanoreve. Në këtë pikëpamje, përvijohen dy nënizoglosa: a) e folmja e fshatrave Tanushë e Bllacë, dhe b) e folmja e fshatrave Straçincë, Orllancë, Mojancë, Grushinë, Luboten, Brezë e Malinë.

90. Në dy fshatrat e parë (Tanushë e Bllacë) dëgjohej një timbër më i lartë i hundorësisë së zanoreve, ndërsa në katundet e tjera hundorësia është disi më e ulët. Kjo mund të shpjegohet me faktin se fshatrat e dhënë në a) janë në kufi e në kontakt me të folmet e gegërishtes verilindore, ku hundorësia është e lartë. Banorët e këtyre dy fshatrave kanë pasur e kanë marrëdhënie intensive familjare, ekonomike, arsimore e kulturore sidomos me fshatrat e qytetet e afërta të Kosovës. Në të vërtetë, e gjithë zona e Karadakut ka marrëdhënie të shkëlqyeshme me pjesëtarët e gegërishtes verilindore, por megjithatë, më të vullshme janë pikërisht raportet e dy fshatrave që gjenden në zonën kufitare.

2.3.3. PËRNDARJA DHE DENDURIA E PËRDORIMIT TË ZANOREVE ME HUNDORËSI

91. Në arealin gjuhësor të Karadakut të Shkupit, në gjendjen e sotme, zanoret hundore i dëgjojmë në këto pozicione:

a) Në pozitë fundore absolute të disa emrave në trajtën e pashquar, ku dikur kishte /n/ në rrënjë të fjalës dhe është shqiptuar si, *pën, drün, zân, frën, shullâ:n, brîn* ... Në trajtën e shquar edhe sot rishfaqet hundorja /n/, si në emrat: *p:ë* (pë-n-i, në f. Luboten **pën**), *drë:* (dr-ë-ni), *frë:* (frë-n-i), *drÛ:* (drÛ-n-i), *zâ:* (zâ-n-i), *shullâ:* (shulla-n-i), *brÿ:* (< brÿ-n-i), *drÿ:* (drÿ-n-i, dryni), *blÿ:* (blÿ-n-i), *gjÛ:* (gjÛ-n-i, gluni).⁹¹ Hundorësia është më e fuqishme kur zanorja gjendet në rrokje të hapur, sesa kur pas saj kemi një bashkëtingëllore hundore.⁹² Me fjalë të tjera, në trajtën e pashquar të këtyre emrave zanoret kanë shkallë më të lartë hundorësie, sesa në trajtën e shquar.

92. Vlen të vihet në pah edhe ajo se kur zanoret e theksuara hundore /ĩ/ ose /ũ/ diftongohen, ngjyrimi hundor bartet edhe te diftongjet,⁹³ si në fjalët: *sâi-ni* (< sî:-ni, syni), *mâi-ni* (< mî:-ni), *mullâi* (< mullî:, mullîni), *kallâi* (< kallî:, kallîni), *mutâi* (< mutî:, mutîni), *kufâi* (< kufî:, kufîni) por edhe *mullêi, kallêi, kufêi, sêi*.

b) Zanoret [ĩ], [ũ], [ê] dhe [ã] në pozitë para bashkëtingëlloreve hundore (n, m, nj) shqiptohen me hundorësi. Zanorja [ê] as nuk është hundore e as e hundorëzuar, në dallim nga zanorja [o], që ndonjëherë dëgjohej me intensitet të ulët hundorësie, por dihet se kjo nuancë hundorësie është dytësore (sekondare), meqë [o]-ja e hundorëzuar është përfutur nga /ã/-ja hundore e mbarë gegërishtes. Krahaso: *hona* < *hâna*, *bona* < *bâna*, *nona* < *nâna*, *lo:m* < *lâ:m*, *kom* < *kâm*, *zoni* < *zâni* etj.

Rrjedhimisht, zanore të mirëfillta hundore janë /ĩ/, /ũ/, /ê/, /ã/, si në fjalët: *nâ:n*, *hâ:nz*, (*jam*) *kâ:n*, *kâ:n* 'kënë', *vrâ:nt*, *i gjâ:n*, *thâ:n*, (*kam*) *thâ:n*, *vÿ:n* 'venë', *bÿ:n* (< mbinë), *ukÿ:n*

⁹¹ Eqrem Çabej, *Për historinë e strukturës dialektore të shqipes*, Dial. shqip. II, Tiranë, 1974, f. 4.

⁹² Shaban Demiraj, *Fonologjia historike ...*, f. 73.

⁹³ Remzi Nesimi, *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe ...*, f. 334.

'ujkinë, ulkonjë', *i ĩ:m; hũ:n* 'hundë', *grũ:n, ĩ:, ũ:n* 'unë'; *i ũ:nt* 'i unët, i uritur'; *flë:n, e ë:jte* (< e enjte), *grë:nz, brë:n* 'lesë', *rrë:n* 'rrenë, gënjeshtër' etj.

93. Hundore janë zanoret edhe kur gjenden para grupeve të bashkëtingëlloreve: [mb], [nd] dhe [ng], qoftë kur grupet janë të qëndrueshme, qoftë kur përngjashmohen, si: *llã:m* 'llambë'; *nãn, nãnd* 'nëntë'; *parmë:n, parmë:nd* 'parmendë'; *më:n* 'mend'; *xhĩn* 'njerëz', *vẽn* 'vend', *përkũ:n* 'përkund', *mrëna* 'mbrenda, brenda', *fũn* 'fund'; *kuñëll, kungëll* 'kungull'; *cung, cuñ;* *shllu:ng, shllu:ñ* 'shtëllungë', *kãjk* < *kãng* 'këngë'; *apãñ, opãng* 'opingë' etj.

c) Me hundorësi ndonjëherë shqiptohen disa zanore në fjalë ku në gjendjen e sotme nuk ka kushte fonetike për t'u shqiptuar me hundorësi. Rastet e tilla shpjegohen me fonetikën historike, pra, dikur duhet të kishte pasur pas tyre ndonjë bashkëtingëllore hundore, sidomos /n/, si në fjalët: *flã:z* < *flãnz, flãnx*; *mãz* < *mãnz*; *ã:* < *ãst* < *ãsht* < **en esti*;⁹⁴ *gjã:* < *gjãn* 'gjã, gjë, kafshë', *qeremĩde* < *qeremĩnde*; *ukĩ:* < *ukĩn, ulkĩn, ulkĩnj, ulkoj*; *flĩke* < *flĩnke, flĩntke, flĩnte*; *fshĩ:s* < *fshĩ:ns* < *fshĩnsë*; (ka) *bĩ:* < *bĩn* < *mbĩn, mbim, mbimun*; *urĩth* < *urĩnth, mĩxh* < *minxh*.

94. Te fjalët *ashtãu, kshtãu, çekshtãu, ktãu* kemi hundorësi meqë fjalët e tilla shpesh përdoren edhe me fjalët deiktike *ũne, ũ:n* 'unë' e pasvënë. Në këtë mënyrë si një fjalëz e prapavendosur formon fjalët: *ashtãune* (*ashtãu + une* < *ashtu + une*); *kshtãune* (*kshtãu + une* < *kështu + une*); *ktãune* (*ktãu + une* < *këtu + une*); *çekshtãune* (*çe + kshtãu + une* < *çe + kështu + une*).

95. Bashkëtingëllorja hundore, si rregull i përgjithshëm, nuk ndikon në hundorëzimin e zanores që vjen pas.⁹⁵ Megjithëkëtë, si në të folme të tjera të gegërishtes,⁹⁶ ashtu edhe në të folmen e Karadakut të Shkupit, rrallëherë, si hundore mund të dëgjohet edhe ndonjë zanore që shqiptohet pas bashkëtingëllores hundore, si: *dunjã:, njã; n'Fu:sh t'Dullãjës*⁹⁷ (< Dëllinjës, mikrotoponim në f. Bllacë) etj.

96. Nga gjithë kjo që u tha, mund të përmbylim se e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit në gjendjen e sotme, përveç zanoreve gojore, ka edhe zanore hundore. Hundorësia e zanoreve buron nga bashkëtingëlloret hundore, përkatësisht është pasojë e akomodimit nyjetimor të zanoreve nën ndikimin e bashkëtingëlloreve hundore në kontakt të drejtpërdrejtë. Në këtë pikëpamje, në të shumtën e rasteve kjo hundorësi është rrjedhojë e përshtatjes nyjetimore, përkatësisht e ndërndikimit të tingujve në takim, sidomos e përngjashmimit paravajtes në takim. Kjo thjesht mund të paraqitet me barazimin: **zanore gojore + bashkëtingëllore hundore = zanore hundore (a + n = ã)**.

97. Edhe pse zanoret hundore janë pjesë përbërëse e shprehisë nyjetimore të folësve të Karadakut të Shkupit, **prania e pak çifteve minimale fjalësh** me kundërvënie fonologjike zanore gojore zanore ~ zanore hundore dëshmon për prirjen e folësve të këtij areali, si edhe e gjithë folësve gegë (më e shprehur në nëndialektin e gegërishtes jugore sesa në gegërishten veriore) për humbjen e vlerës funksionale të hundorësisë, përkatësisht për prirjen e defonologjizimit të zanoreve hundore.

Në këtë kuptim, nga materiali i vjelë dialektor e patëm shumë vështirë të gjejmë çifte leksikore të tilla ku kuptimi i fjalës do të identifikohet me mungesën apo praninë e hundorësisë së zanores. Pas një përpjekjeje serioze, arritëm të veçonim disa fjalë të tilla, si më poshtë:

⁹⁴ Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1987, f. 120

⁹⁵ Shaban Demiraj, *Fonologjia ...*, f. 79.

⁹⁶ Jorgji gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f.191.

⁹⁷ Hundorësia e /ã/-së te ky toponim është bartur nga periudha para shndërrimit të [n] > [j].

fonema zanore gojore		kundërvënie fonologjike	fonema zanore hundore	
në Karadak	në shqipen standarde		në Karadak	në shqipen standarde
rrâi	rri	/âi/ ~ /aj/	rrã:j	(geg. rrãnjë), rrënjë
lam	(ne) lamë	/a/ ~ /ã:/	lã:m	lëmë
jan	jan, qilim	/a/ ~ /ã:/	jã:n	janë (ata)
tan	tanë (djemtë)	/a/ ~ /ã:/	tã:n	e tund
kan	kanë (ata)	/a/ ~ /ã:/	kã:n	qan, këne ⁹⁸

98. Një gjendje të tillë a të ngjashme e kemi edhe në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore,⁹⁹ veçmas në të folmet shqipe në Maqedoni, si në të folmen e Tetovës,¹⁰⁰ të Gostivarit,¹⁰¹ të Dervenit,¹⁰² Karshiakës,¹⁰³ Kërçovës,¹⁰⁴ Prilepit e Velesit,¹⁰⁵ të Strugës¹⁰⁶ etj.

⁹⁸ Përveç kundërvënies zanore gojore ~ zanore hundore, këtu realizohet edhe kundërvënia zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë.

⁹⁹ Bahri Beci, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, DSh V, Tiranë, 1987, f. 5.

¹⁰⁰ Fadil Sulejmani, *E folmja e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Tetovë, 2006.

¹⁰¹ Izmit Durmishi, *Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit*, Gostivar, 2008, f. 83-89..

¹⁰² Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit ...*, f. 61.

¹⁰³ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e ...*, f. 44.

¹⁰⁴ Lulzim Aliu, *E folmja shqipe e rrethit të Kërçovës*, Tetovë, 2011, f. 19.

¹⁰⁵ Mustafa Ibrahimimi, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Shkup, 2005, f. 59-60.

¹⁰⁶ Ajten Qamili, *E folmja shqipe e Strugës (në kontekstin ballkanik)*, arkivi i Fakultetit të Filologjisë "Bllazhe Koneski" në Shkup, 2012, f. 60.

2.4. SISTEMI I ZANOREVE

2.4.1. IDENTIFIKIMI I FONEMAVE

99. Analiza fonetike tregon se nuk mund të gjenden kurrë dy tinguj plotësisht të njëjtë si nga ana fiziologjike, ashtu edhe akustike. I njëjti folës nuk mund të shqiptojë dy herë njëloj një zanore ose bashkëtingëllore, qoftë edhe në të njëjtën fjalë, pa folur pastaj për rastet kur këto dalin në rrethime të ndryshme fonetike. Si rrjedhim, lartësia, forca, gjatësia dhe timbri i tingujve ndryshojnë nga një realizim në tjetrin. Për shembull, në fjalët *kap*, *kánë*, *ka*, *ára* etj. [a]-të janë tinguj akustikisht të ndryshëm: [a]-ja e fjalës *ka* është më e gjatë se [a]-ja e fjalës *kánë*, [a]-ja e theksuar e fjalës *ára* është më e gjatë dhe më e nderë se [a]-ja e patheksuar e kësaj fjale etj.

100. Cilësitë akustike të tingujve ndryshojnë edhe nga një folës te tjetri, në varësi të veçorive anatomike të aparatit të folurit të secilit, shprehive nyjetimore, përkatësisë territoriale etj. Me fjalë të tjera, ka dallime midis tingujve të shqiptuar nga meshkujt dhe nga femrat, nga të rriturit dhe fëmijët, nga pjesëtarët e të folmeve e dialekteve të ndryshme etj.

101. Po t'i shënojmë me numra të gjitha [a]-të që nyjetojnë folësit e shqipes, do të kemi formulën: /A/ => [a₁, a₂, a₃, a₄ a_n] dhe, në përgjithësi, për çdo tingull: /X/ => [x₁, x₂, x₃, x₄ x_n], ku n (x_n) tregon një madhësi të pafund.

102. Funkzioni dallues i fonemave duket qartë në çifte fjalësh, që në përbërjen e tyre dallohen vetëm nga një element. Të tillat quhen çifte minimale fjalësh. Për të provuar funksionin dallues të fonemave, përdoret metoda e zëvendësimit (komutacioni)¹⁰⁷ të një fonemeje me një tjetër. Po sjellim disa kundërvënie fonemash në disa çifte minimale fjalësh që realizohen në shqipen:

/i/ ~ /y/: di ~ dy, si ~ sy, pikë ~ pykë, mik ~ myk;

/e/ ~ /u/: pelë ~ pulë, ke ~ ku, te ~ tu, je ~ ju, era ~ ura, enë ~ unë, verë ~ vurë;

/b/ ~ /d/: borë ~ dorë, bimë ~ dimë, bac ~ dac;

/m/ ~ /v/: mes ~ ves, muaj ~ vuaj, mi ~ vi, meshë ~ veshë, mjelë ~ vjelë, mjet ~ vjet,
mend ~ vend;

/f/ ~ /v/: faj ~ vaj, fashë ~ vashë, fise ~ vise;

/f/ ~ /g/: fushë ~ gushë, furrë ~ gurrë;

/t/ ~ /d/: tash ~ dash, tru ~ dru, ti ~ di, tu ~ du, tel ~ del;

/d/ ~ /sh/: di ~ shi, derr ~ sherr, duaj ~ shuaj, desh ~ shesh, dënim ~ shënim,
dëmtoj ~ shëmtoj;

/d/ ~ /v/: derë ~ verë, duaj ~ vuaj, degë ~ vegë, desh ~ vesh;

/n/ ~ /m/: nënë ~ nëmë, han ~ ham, ne ~ me, kan(ë) ~ kam;

/r/ ~ /rr/: ara ~ arra, ruaj ~ rruaj, rasë ~ rrasë;

/s/ ~ /z/: sot ~ zot, sanë ~ zanë;

¹⁰⁷ Zëvendësimi zbatohet për gjuhë që i njohim mirë. Por përdorimi i tij është i vështirë, pasi gjetja e gjithë çifteve minimale të nevojshme të sistemit fonologjik të një gjuhe kërkon mjaft punë, sidomos kur është fjala për inventarizimin e bashkëtingëlloreve, të cilat janë të shumta në numër. Një teknikë tjetër për inventarizimin e fonemave të një gjuhe, është metoda e *përndarjes* (distribucionit), e ndjekur nga fonologët amerikanë në përshkrimin e sistemeve fonologjike të gjuhëve të pashkruara të indianëve të Amerikës. Në të vërtetë, zëvendësimi dhe përndarja janë dy teknika që plotësojnë njëra-tjetrën. Metoda e përndarjes përdoret atje ku nuk mund të gjenden çifte minimale. Shih: Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 109-110.

/s/ ~ /sh/: masë ~ mashë, pres ~ presh, situr ~ shitur;
 /s/ ~ /l/: sot ~ lot, sopatë ~ lopatë;
 /c/ ~ /l/: copë ~ lopë;
 /c/ ~ /gj/: cak ~ gjak;
 /ç/ ~ /b/: çatall ~ batall, çaj ~ baj, çeli ~ beli;
 /xh/ ~ /sh/: xhami ~ shami;
 /l/ ~ /ll/: plakë ~ pllakë, pulë ~ pullë, mal ~ mall, palë ~ pallë;
 /l/ ~ /p/: lus ~ pus, lis ~ pis;
 /ll/ ~ /k/: llullë ~ kullë;
 /th/ ~ /dh/: thi ~ dhi etj.

103. Në çiftet e fjalëve të sjella, këmbimet e fonemave dallojnë njëren fjalë nga tjetra dhe kanë vlerë kuptimdalluese. Por, përveç vlerës leksikore, kundërvënira fonologjike shpeshherë është mjet i vetëm gramatikor me të cilat bëhet dallimi i numrit të emrave, i vetës së foljeve etj., te disa fjalë, si p.sh.:

/a/ ~ /e/: dash ~ desh, dal ~ del, marr ~ merr;
 /k/ ~ /q/: mik ~ miq, fik ~ fiq, armik ~ armiq, bujk ~ bujq, ujk ~ ujq, ka ~ qe;
 /r/ ~ /j/: flamur ~ flamuj, lepur ~ lepuj;
 /ll/ ~ /j/: kungull ~ kunguj, grumbull ~ grumbuj etj.¹⁰⁸


104. Numri i çifteve minimale që ekzistojnë në gjuhë përcakton *ngarkesën funksionale* (ose rendimentin funksional) të kundërvënies. Sa më tepër çifte minimale të ekzistojnë, aq më e madhe është ngarkesa funksionale e kundërvënies.

105. Të gjithë tingujt e ndryshëm që realizojnë të njëjtën fonemë quhen variante fonetike të fonemës. Tingujt konkretë që paraqiten në ligjërim në të vërtetë janë simbole të thjeshta materiale të fonemave. Nga kjo del se një fonemë mund të realizohet prej shumë tingujsh të ligjërimin që dallohen njëri prej tjetrit. Por, të gjitha këto lloje tingujsh kanë një funksion të përbashkët, që i lidh të gjitha së bashku. **Tërësia e të gjitha alofoneve përbëjnë fonemën.** *Nga kjo mund të përfundohet se ligjërimi ynë ka numër të pakufizuar tingujsh, por gjuha ka numër të caktuar fonemash* (p.sh. shqipja standarde ka 36 fonema).

106. Siç dihet, fonemat realizohen në formën e varianteve apozicionale, kombinatorë, krahinore, individuale dhe stilistike. Në këtë kuptim, çdo fonemë (zanore e bashkëtingëllore) ka një zonë të caktuar artikulative dhe akustike brenda së cilës realizohen variantet e saj. Kjo quhet fushë e përhapjes (frëngjisht *champ de dispersion*) së fonemave.¹⁰⁹ Kjo mund të paraqitet kështu:

¹⁰⁸ Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011, f. 185-195.

¹⁰⁹ Bahri Beci, *Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe norma fonetike*, Studime filologjike 1, Tiranë, 1985, f. 104; Ирена Савицка - Лудмил Спасов, *Фонологија на современиот македонски стандарден јазик...*, Скопје, f. 10.



Fusha e përhapjes së varianteve të fonemave zanore: $[a_1] + [a_2] + [a_3] + [a_4] \dots = /a/$, ku $[a_1], [a_2] \dots$ përbëjnë variantet e fonemës (alofonet), ndërsa $/a/$ -ja është fonemë.

107. Dihet se nëpër të folme, fonemat realizohen nëpërmjet varianteve krahinore (territoriale), në alofone. Këto variante fonemash kushtëzohen nga një varg faktorësh: 1. nga përkatësia territoriale e folësit; 2. nga veçoritë individuale të shqiptimit, shkalla e arsimit; 3. nga vendi i theksit (nëse zanorja është e theksuar apo e patheksuar dhe sa është larg theksit); 4. nga rrethimi tingullor (veçmas çfarë tingujsh ka para e pas tij); 5. nga pozita e tingullit në fjalë (gjendet në fillim, në mes ose në fund të fjalës); 6. nga numri i tingujve në fjalë (fjalë e shkurtër apo e gjatë); 7. nga karakteri i rrokjes (rrokje e hapur apo e mbyllur); 8. nga ritmi i të folurit (flasim shpejt apo ngadalë); 9. nga gjendja emocionale e folësit; 10. nga qëllimi i thënies (çfarë dëshiron të arrijë me atë ligjërim, nga theksi logjik) etj.¹¹⁰

108. Fqinjësia e drejtpërdrejtë e cilësdo fonemeje me fonemat e tjera, siç dihet, ndikon në modifikimet fonematike, përkatësisht në variantin e saj. Këto përshtatje fonemash në ligjërimin e folur janë përshtatje të domosdoshme automatike nyjetimore të shqiptimit nga një fonemë në tjetrën në fjalë e fjali.³

109. Lidhur me alofoninë dhe përndarjen (distribucionin) e zanoreve e bashkëtingëlloreve ka dallime. Te fonemat zanore kemi alofone të panumërta, ndërsa bashkëtingëlloret realizohen në më pak variante. Zanoret e bashkëtingëlloret dallohen edhe me tiparin e bashkueshmërisë: zanoret mund të bashkohen me më shumë zanore e bashkëtingëllore, ndërsa te bashkëtingëlloret kemi më shumë kufizime.

110. Përveç zanoreve të mirëfillta (të thjeshta, monoftongje, njëzëshe), ngjyra akustike e të cilave për veshin e njeriut mbetet gjithnjë e njëjtë gjatë kohës së artikulimit, të folmet e gegërishtes qendrore, përfshirë edhe të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, kanë edhe diftongje (dyzëshe) e diftongoide, që gjatë nyjetimit ndryshojnë ngjyrimin. Në fillim të diftongut dëgjohet timbër i një zanoreje, ndërsa nga fundi timbër i një zanoreje tjetër. Gjuhët, dialektet e të folmet që kanë diftongje karakterizohen me artikulum të shtendosur, përkundër gjuhëve që nuk kanë diftongje, që dallohen me artikulum të tendosur. Diftongje të tilla dytësore të përfuara nga shpërbërja e zanoreve të mirëfillta $/i/$ dhe $/u/$ ka edhe areali ynë gjuhësor: $[\hat{a}i]$, $[\hat{e}i]$ dhe $[\hat{a}u]$.¹¹¹

111. Në studimet dialektore është e nevojshme, e arsyeshme dhe e dobishme që të folmet

¹¹⁰ Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011 në kapitujt: Variantet e fonemës, f. 191-213; Fonetika kombinatorë, f. 235-263; Theksi i fjalës, theksi logjik, theksi emocional, f. 281-318; Fonostilistikë, f. 319-331.

³ Ирена Савицка – Лудмил Спасов, *Фонологија на современиот македонски стандарден јазик*, Скопје, 1997, f. 51.

¹¹¹ Gjuhë tipike me diftongje është anglishtja, po edhe gjermanishtja. Në rrafshin dialektor diftongje kemi në të folmet e grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore.

të përshkruhen në pikëpamje fonetike e fonologjike. Duke dashur që të përshkruajmë sistemin fonetik e fonologjik të të folmes shqipe të Karadakut të Shkupit, do të përpiqemi të paraqesim tiparet themelore të çdo tingulli bazë, që e konsiderojmë si variantin përfaqësues të fonemës, alofoninë dhe përndarjen e tyre, duke dhënë disa nga shndërrimet më të shpeshta tingullore, por edhe kundërvëniet e tyre fonologjike.

112. Me rëndësi për përshkrimin fonologjik është koncepti i pozicionit të fonemës në fjalë, që quhet *rrethim fonetik* a *rrethim tingullor*. Tërësia e rrethimeve fonetike (tingullore) në të cilat realizohen variantet e fonemës, përbën përndarjen (distribucionin) e saj.

2.4.2. INVENTARI I FONEMAVE ZANORE

113. Zanoret /a, i, e, o, u/ në gjuhën shqipe janë trashëguar nga gjuha mëmë indoevropiane, ndërsa /y, ë/ janë krijuar më vonë gjatë zhvillimit historik të shqipes.¹¹²

114. **Tri shkallët e hapjes, tri radhët e formimit dhe mungesa ose prania e buzorëzimit** të zanoreve në gjuhën shqipe përbëjnë **tipare dalluese të qëndrueshme**, që nuk varen as nga pozicioni as nga përndarja e tyre. Në mënyrë të përgjithësuar, vështruar nga pikëpamja fonetike dhe fonologjike, kjo e folme ka një sistem zanorësh me kundërvëniet fonologjike të gjatësisë (zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë) dhe të hundorësisë (zanore gojore ~ zanore hundore). Rrjedhimisht, kjo e folme ka një inventar me 14 fonema zanore të theksuara (10 gojore dhe 4 hundore), nga të cilat:

- a) fonema zanore të shkurtra (5): / **ǎ** /, / **ě** /, / **ǒ** /, / **ĩ** /, / **ũ** /;
- b) fonema zanore të gjata (5): / **a** : /, / **e** : /, / **o** : /, / **i** : /, / **u** : /;
- c) fonema zanore hundore (4): / **ã** /, / **ẽ** /, / **ĩ** /, / **ũ** /.

115. Në rrokje të patheksuar përdoret edhe zanorja e shkurtër [ɛ] (ə) që ka statusin e tingullit, por jo edhe të fonemës.

116. Këto 14 fonema zanore kanë fushë të gjerë përhapjeje, përkatësisht realizohen nëpërmjet modifikimeve të ndryshme si alofone, deri sa edhe si diftongje gjatë shpërbërjes së /i/-së dhe të /u/-së në dyzanorësh: /i/ në [âi], [êi], [êi]: *shpâi*, *shpêi* (< shpi, shtëpi), dhe të /u/-së në [âu]: *nâuse* si dhe në formë të monoftonguar *na:se* (< nuse); diftongoide [a^ë]: *ca^ëng* (< cung), *rra^ësh* (< rrush); [u^o]: *ku^odër* (< kodër), *mu^otër* (< motër), *i vu^ogël* (< i vogël); sekuenca diftongore [ie]: *gjieth*, *liëpër*, *liëtër*, *vjega* (< gjeth, lepur, letër, vegë) etj.

Këto fonema në rrokje të theksuar në trekëndëshin akustik mund të paraqiten kështu:

a) të shkurtra

b) të gjata

c) hundore

¹¹² Shaban Demiraj, *Fonologjia historike ...*, f. 47-48.

/i/	/u/	/i:/	/u:/	/ĩ/	/ũ/
/e/	/o/	/e:/	/o:/	/ã/	/ã/
/a/		/a:/			

117. Zanoret e theksuara janë afërsisht dy herë më të gjata sesa të patheksuarat. Këtu na dalin 6 zanore në rrokje të patheksuar:

[a], [e], [ë], [o], [i] dhe [u].

2.4.3. ZANORJA [a]

118. Në të folmen e Karadakut të Shkupit, si edhe në të folmet e tjera të dialektit të gegërishtes, kjo zanore realizohet nëpërmjet varianteve të panumërta. Por, në pikëpamje fonologjike, gjatësia dhe hundorësia e [a]-së ka bërë që të dallojmë tri fonema: /ã/ **e shkurtër** ~ /a:/ **e gjatë** ~ /ã/ **hundore**. Kundërvënia fonologjike e gjatësisë ~ shkurtësisë të kjo zanore, si edhe të të gjitha zanoret e tjera, realizohet te shumë çifte minimale fjalësh (plāk ~ pla:k ‘plak plakë’), ndërsa kundërvënia zanore gojore ~ zanore hundore (lam ~ lã:m ‘ne lam ~ lëmë’) është e kufizuar, realizohet vetëm në pak fjalë.

119. Në rrjedhën e të folurit fonemat realizohen si nuanca fonemash përkatëse. Në fjalë duke u përdorur në afërsi bashkëtingëlloresh ose zanoresh, zanoret mund të modifikojnë radhën, hapjen, shkallën e buzorëzimit; kohën e nyjetimit (gjatësinë), ato mund të hundorëzohen e të jenë fonema hundore. *Artikulimi i tingujve në pozitën e izoluar* (kur shqiptohen më vete) *quhen nuanca themelore ose variante themelore*. Kurdo që përshkruhet nyjetimi i fonemave zanore, zakonisht merret parasysh **nyjetimi i varianteve themelore të tyre**.

120. Gjatë përshkrimit të tingujve në këtë monografi, do të bëhet fjalë për variantet themelore të zanoreve e të bashkëtingëlloreve. Të gjitha variantet e fonemave, përfshirë edhe variantin themelor, do t’i shënojmë midis kllapave katrore [x], ndërsa fonemat midis kllapave të pjerrëta /x/.

121. Varianti themelor i zanores [a] shqiptohet si **e hapur, qendrore** dhe **e pabuzorëzuar**. Atë e dëgjojmë në të gjitha pozitat e fjalës, si në pozitë nistore: *a:r, a:rr, a:nërr, ah, ajo, agje, ati ‘aty’,...* Në mes të fjalës: *na:n, ba:b, ka:l, çaj, da:rk, na:t, tambël* etj. Në fundin absolut të fjalës: *ka:, gja:, vlla:, pa:ta, mrapa, mrena, dishka, shullã:, zã:, tërma:* etj.

122. Zanorja [a] përdoret rregullisht si mbaresë e trajtës së shquar tek emrat femërorë, si: *buk-a, dor-a, moll-a, der-a, lop-a, pun-a, dardh-a, pem-a, zemr-a, kumll-a, peshk-a...*

123. Po kështu, [a]-ja shfaqet në pozitë fundore si prapashtesë shumësi të një sasi e madhe emrash mashkullorë (po edhe femërorë), të tipit: *pllug-a, bokall-a, lam-a, shkam-a, msus-a, gisht-a, gjisht-a; çels-a, kingj-a, burr-a, qip-a; fãill-a, fëill-a, kërmëill-a, vëiç-a...*

124. Kjo zanore si mbaresë foljore përdoret rregullisht për të formuar të kryerën e thjeshtë të foljeve, si: *fola, punova, shkova, gjujta, gjeva; mbãilla, mella; hika, u lodha, u gjazmova, kalla...*

125. Në fundin absolut e gjejmë edhe te disa emra, kryesisht me prejardhje orientale: *ila:, hala:, fukara:, e xhuma:, hava:, bela:, dunja:, sefa:, rixha:, sevda:* etj.

126. Në trajtën e pashquar të disa emrave të huazuar nga gjuhët orientale, të tipit: *ba:b < babë < turqisht baba, baklla:v < bakllavë < tur. bakllava, da:d < dadë < tur. dada, (h)a:llv < allvë*

< tur. allva; *ta:v* < tavë < tur. tava etj., në këtë të folme, si dhe në të gjitha të folmet e dialektit të Veriut, duke u gjendur në pozitë të patheksuar fundore [a]-ja është shndërruar në [ë] e më pas në rrjedhë të kohës ka rënë plotësisht, duke lënë gjurmë në zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse (zanorja që ka mbetur para saj tani shqiptohet e gjatë).

127. Gjatë analizës së materialit dialektor, vumë re edhe disa ndërrime fonetike të [a]-së me disa zanore të tjera, nga të cilat më të shpeshta janë këmbimet: [a] > [e] dhe [a] > [o].

128. **Metafonia e /a/-së në /e/.**¹¹³ – Në pozitë të theksuar /a/-ja, në këtë të folme, si dhe në gjithë shqipen dialektore e standarde, në një fazë të zhvillimit të saj ka pësuar një ndërrim morfonologjik të /a/ ~ /e/, që njihet me termin metafoini, e që shfaqet sidomos në formimin e shumësit të disa emrave: *dash* ~ *desh*, *plak* ~ *pleq*, *kunat* ~ *kune:t*; si dhe në format flektive të disa foljeve në kohën e tashme (veta I ~ veta II): *dal* ~ *del*, *marr* ~ *merr*, *vras* ~ *vret* etj.

129. **Buzorëzimi i [ã]-së në [o].** – Në të folmen e Karadakut të Shkupit dukuri e shpeshtë është buzorëzimi i [ã]-së hundore (dikur të mbarë shqipes) tani vetëm të gegërishtes në [o] të hundorëzuar. Kjo [o] e përfutur nga [a]-ja hundore ruan një pjesë të hundorësisë, por me shkallë më të ulët, andaj ajo nuk konsiderohet fonemë hundore, por e hundorëzuar.


130. Sipas asaj që na paraqitet në terren, denduria e shfaqjes dhe përndarja e buzorëzimit nuk është gjithkund njësoj. Në këtë kuptim, gjatë vrojtimit të 20 fjalëve të njëjta me forma fonetike jo të njëjta nëpër fshatrat e këtij areali gjuhësor, kur ka kushte për labializimin e [ã]-së në [o] veçuan tri izoglosa:

a) **me buzorëzim të shpeshtë:** fshati Luboten (me 15 shembuj të kalimit [a] > [o]), Straçinca (13 shembuj) dhe Grushina (9 shembuj);

b) **me buzorëzim të rrallë:** të tilla janë të folmet e f. Bllacë (ku gjetëm 4 shembuj), Mojancë (4) dhe Orllancë (2);

c) **pa buzorëzim të [ã] > [o]:** f. Tanushë (1), Brezë e Malinë (asnjë):

¹¹³ Metafonia është ai shndërrim historik i fonemave, si pasojë e të cilit fitohet një zanore e përparme. Pra, shndërrimi i /a/-së në /e/ dhe i /e/-së në /i/ (kjo e fundit quhet metafoinizim i mëtejme. Këto alternime fonologjike historike të shqipes, ashtu si edhe këmbimet e tjera historike të fonemave, janë morfologjizuar.



Skica 2. Ruajtja ose buzorëzimi i [ã]-së në [o]

131. Po sjellim disa fjalë më të shpeshta që buzorëzojnë [ã]-në në [o]: *nona* < nãna, *bon* < bãn, (jam) *kon* < (jam) kãn; *e bona* < e bãna, *boj* < bãj, *zoni* < zãni, *honza* < hãnza, *o kon* < ã kãn < ãsht kãn, *ondërr* < ãndërr, *tonde* < tãnde, *nond* < nãnd, *hongra* < hãnra < hãngra, *hongji* < hãngji, *loma* < lãma, *koma* < kãma, kãmba; *lloma*, *llomba* < llãma, llãmba; *tombël*, *tomël* < tãmël, tãmbël; *dhom* < dhãm, dhãmb etj.

132. Nga shembujt e dhënë lehtë mund të nxirret një rregull i përgjithshëm: buzorëzimi i [ã]-së në [o] bëhet në pozicion para [n]-së alveolare (apo grupit [nd], [n] të ruajtur ose të asimiluar), para dybuzores [m] (ose grupit [mb], rrallëherë edhe para mesgjuhoreve [j] e [nj]).

133. Dukuria e buzorëzimit të [ã]-në [o] është e njohur edhe në të folme të tjera përreth Shkupit e më gjerë, si në të folmen e Dervenit,⁵ Karshiakës,⁶ Kërçovës,¹¹⁴ Tetovës,¹¹⁵ Prilepit e Krushevës,¹¹⁶ të Strugës¹¹⁷ etj., po edhe në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore, në gegërishten verilindore¹¹⁸ e në mbarë dialektin Verior në përgjithësi (Tirana > Tirona).

134. Dëgjuam edhe pak raste të shndërrimit të [a]-së në zanore të tjera, si [a] > [u] ne *kum* da:l (< kam) në fshatrat Tanushë e Bllacë; disimilimit [a] > [i]: *kaçimak* (< kaçamak) etj.

⁵ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 69.

⁶ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, ..., f. 47-48.

¹¹⁴ Qemal Murati, *E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit* ..., f. 9.

¹¹⁵ Remzi Nesimi, *Mbi disa veçori të sistemit vokalik* ..., f. 335.

¹¹⁶ Mustafa Ibrahim, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit e Krushevës*, Shkup, 2005, f. 64.

¹¹⁷ Ajten Qamili, *E folmja shqipe e Strugës (në kontekstin ballkanik)*, arkivi i Fakultetit të Filologjisë "Bllazhe Koneski" (punim doktorati në dorëshkrim), Shkup, 2012.

¹¹⁸ Imri Badallaj, *E folmja e Hasit*, Prishtinë 2001, f. 54.

2.4.4. ZANORJA [e]

135. Edhe zanorja /e/ për shkak të kundërvënieve fonologjike, si edhe /a/-ja, na del si fonemë gojore e shkurtër ~ gojore e gjatë ~ hundore, pra /ẽ/ ~ /e:/ ~ /ē/. Në të folmen e Karadakut të Shkupit edhe [e]-ja në të shumtën e rasteve realizohet si johundore, në pozitë para bashkëtingëlloreve hundore si zanore e hundorëzuar, ndërsa në fare pak çifte fjalësh si fonemë hundore; në pikëpamje fonetike e shkurtër, e mesme dhe e gjatë; por në disa çifte minimale fjalësh kundërvënia e shkurtër ~ e gjatë ka vlerë gramatikore (sidomos në dallimin e njëjësit nga shumësi, me rënien e [ë]-së fundore, si lejlek ~ lejle:k), ndaj janë dy fonema më vete (shih kapitujt: gjatësia e zanoreve, hundorësia e zanoreve),

136. Varianti themelor i zanores [e] mund të karakterizohet si **gjysmë e hapur, e përparme, e pabuzorëzuar**.

137. Atë e gjejmë në çdo pozicion të fjalës, para e pas çdo zanoreje e bashkëtingëlloreje. Gjuhësia sasiore ka llogaritur se /e/-ja është fonemë që përdoret më shpesh në shqipen standarde, duke zënë vendin e parë, me 10.67% denduri përdorimi (në ligjërimin e folur, ndërsa në të shkruar /ë/-ja përdoret më shpesh se çdo tingull tjetër). Në të folmen tonë e dëgjojmë në çdo pozicion të fjalës, si: *e ejte, ene* 'edhe', *elb, edh, emën, epja!, eshja* (< etja), *e zez, e pekme, drejt, dret; dre:k, tenxhere, the:rr; breg, bregj; xhezve, kafe, lule, dele, çagje, une, dhe, pare, shoçe, punojshë, me, kie ...*

138. Zanorja [e] në arealin e Karadakut të Shkupit realizohet edhe me timbër hundor: *pẽ:, pěj, pẽn* (në të folmen e Lubotenit) (< penj), *frẽ:, mrẽna, vẽn, sẽn* etj., që te fare pak çifte leksikore fjalësh prania e hundorësisë tek [ẽ]-ja dhe mungesa e hundorësisë te një fjalë tjetër ka për rrjedhojë që këto dy realizime të ndryshme zanorësh të jenë edhe fonema të veçanta /e/ ~ /ẽ/.

139. Në kontakt të drejtpërdrejtë me zanore të tjera, ajo merr pjesë në formimin e togjeve të zanoreve, duke formuar më shpesh grupet: [ie], [ae] dhe [oe], si në fjalët: *kie* 'qe', *kie* 'ke', *bie* (be) 'be-ja, betimi', *pae* 'pe', *lae* 'lë', *voe* 've-zë' etj.

140. Në të folmen shqipe të këtij areali, si dhe në të folmet e tjera që gjenden në veri të lumit Mat, dukuri që është shumë më e përhapur në të folmet e nëndialektit verior të gegërishtes,¹¹⁹ përdoret edhe një variant më i hapur dhe më i prapmë i [e]-së sesa varianti i saj kryesor, si në fjalët: *zëmër; vën, vënd; pë:s, pëtëll, vëtëll, fëmën, i vëtëm, fkellet, lëtër* etj.

141. **Reduktimi i grupit [je] në [e]**. - Një dukuri e përgjithshme e të folmeve të kësaj krahine është thjeshtimi i grupit [je] në [e], përkatësisht rënia e [j]-së para [e]-së, si p.sh.: *pepën* (< pjepën), *pe:shk, qe:shk* (< pjeshkë), *dhe:t* (< dhjetë), *melli* (< mjelli, mbjelli), *vet* (< vjet), *vel* (< vjel), *pe:ll* (< pjellë), *mushtell, mbushtell* (< mbështjellë), *se:ll* (< sjellë), *setëll* (< sjetull), *megëll* (< mjegull), *vehërr* (< vjehërr), *verri* (< vjehri), *mekërr* (< mjekërr, por *njekërr* në f. Brezë e Malinë), *ve:sht* (< vjeshtë); *e pek, e qek* (< e pjek), *veshe* (< veshje) etj.

142. **Përdorimi i diftongoidit [je] në vend të zanores [e]**. Një variant kombinator i [e]-së së shkurtër gojore në këtë areal realizohet si sekuencë diftongore apo si diftongoid ngjitës [je], që rëndom shfaqet para mesgjuhores [q], anësore [l], para buzore-dhëmbore [v], alveolare [d] ose prapagjuhores [k]. Në arealin tonë gjuhësor diftongoid të tillë dëgjojmë në të folmet e fshatrave Straçincë, Mojancë, Orllancë dhe Tanushë, si: *gjjet* (< gjeth), *gjjet* (< gjel), *qief* (< qef), *lijepër* (< lepur), *lijetër* (< letër), *vjeg* (< vegë), *diele* (< dele), *kijeçe* (< keçe, plis) etj. Megjithatë, kjo

¹¹⁹ Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare, ..., f. 74.*

sekuencë diftongore nuk është aq e shpeshtë në të folmet lindore sa në të folmet veriperëndimore të gegërishtes qendrore si dhe të folmet perëndimore të gegërishtes së Shqipërisë së Mesme.⁸

143. Me opozicionin /ë/ e shkurtër ~ /e:/ e gjatë në të folmen e Karadakut, si dhe në të dialektin e Veriut, në disa çifte minimale fjalësh dallojnë një numër i kufizuar emrash formën e njëjësit nga forma e shumësit, pra gjatësia në çiftet e tilla ka funksion gramatikor. Përgjithësisht, [ë]-ja e shkurtër është pjesë përbërëse e emrit në njëjës, ndërsa /e:/-ja e gjatë pjesë e emrit në shumës. Krahaso emrat në njëjës e shumësin e tyre: *dishek* ~ *dishe:k*, *vesh* ~ *ve:sh*, *fishek* ~ *fishe:k*. Siç dihet, shumësi na del me /e:/ të gjatë për shkak të rënies së [ë]-së fundore, që ka shkaktuar zgjatjen e zanores pararendëse të fjalës.

2.4.5. ZANORJA [ë]

144. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit [ë]-ja shqiptohet ngjashëm si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes. Në përgjithësi varianti themelor i kësaj zanoreje realizohet si **qendrore, gjysmë e hapur dhe e pabuzorëzuar**. Gjatë artikulimit të saj kur është e patheksuar kemi zvogëlimin e dridhjeve të tejzave të zërit në krahasim me shqiptimin e zanoreve të tjera të theksuara.⁹ Pra, [ë]-ja e patheksuar shqiptohet si më e dobët, më e errët dhe më e shkurtër.¹²⁰

145. Ajo konsiderohet si zanorja më e lëvizshme, më e paqëndrueshmja, që shpeshherë nuk shqiptohet ose edhe bie plotësisht. Kjo zanore ka përdorim shumë të dendur në dialektin jugor (edhe në shqipen standarde),¹²¹ ndërsa përdorim të rrallë në dialektin verior. Ajo ka rënë edhe në toponiminë e Gegërisë.¹²² Denduria e kësaj zanoreje është ndryshme edhe në të folmet gege, të folmet kalimtare (të qytetit) dhe ato toske të Strugës.¹²³ Sipas analizave të bëra nga prof. Bahri Beci me sonograme e mengograme në shqipen standarde, zanorja [ë] në pozitë të patheksuar është më e shkurtra nga të gjitha të tjerat, vetëm 4.5 të qindtat e sekondës.¹⁰

146. Si në të folmet e tjera të gegërishtes, edhe në të folmen tonë realizohet si **e shkurtër dhe e patheksuar**. Ajo nuk bën kundërvënie fonologjike as për nga gjatësia e as për nga mungesa e prania e hundorësisë. Në këtë kontekst, është tingull (jo fonemë) që realizohet i shkurtër e i patheksuar, me përdorim të kufizuar (si në të folmet e tjera gege).

147. Zanorja [ë], sipas prof. Shaban Demirajt, ka burim të ndryshëm nga [ë]-ja e theksuar. Kështu, [ë]-ja në rrokje të theksuar është një inovacion i përfutur vetëm në dialektin toskë para shekullit V dhe VI të erës sonë, nëpërmjet evoluimit të zanoreve /ã/ dhe /ë/ të theksuara para bashkëtingëlloreve hundore. Zanorja [ë] e patheksuar rrjedh nga reduktimi i zanoreve në rrokje të patheksuara.¹²⁴

⁸ Jorgji Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 135-136.

⁹ Vacllav Cimohovski, *Gjuha shqipe*, Prishtinë, 1988, f. 28.

¹²⁰ Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011, f. 122.

¹²¹ Shkronja <ë> në formën e shkruar të shqipes standarde është grafema më e shpeshtë në ligjërimin e lidhur. Në shkrim ka denduri shumë të madhe, në ligjërim ka denduri dukshëm më të vogël.

¹²² Izmit Durmishi, *Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit*, Gostivar, 2008, f. 83-89.

¹²³ Ajten Qamili, *E folmja shqipe e Strugës (në kontekstin ballkanik)*, arkivi i Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup (punim doktorati në dorëshkrim), 2012, f. 71.

¹⁰ Bahri Beci, *Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare ...*, f. 108.

¹²⁴ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike ...*, f. 67-72, 81.

148. Mikrosistemi i të folmes së Karadakut përpunet me sistemet e tjera dialektore më të mëdha edhe në çështjen e zanores [ë]. Por, në këtë areal gjuhësor në pak fjalë [ë]-në e kemi dëgjuar edhe në rrokje të theksuar, si te disa parafjalë: *për, nëpër; nër, ndër* etj., veçmas kur këto parafjalë janë bartëse të theksit logjik. Por, në ligjërimin asnjans (neutral) parafjalët nuk janë bartëse të theksit logjik, këto si fjalëza shërbyese (jokuptimplota) e humbin theksin dhe shndërrohen në fjalë proklitike, sipas tipit: *për*ʔ *ngrá:n*, *nëpër*ʔ *ára*, *nër*ʔ *sétëll*, *ndër*ʔ *ú:dh* (këto shqiptohen bashkë e me një theks të vetëm: [përtngrán, nëpërára, nërrsétëll, ndërú:dh]) etj.

149. **Raste të përdorimit të [ë]-së në rrokje të theksuar.** - Në fjalët ku nuk kemi asnjë zanore tjetër, por vetëm bashkëtingëllore; pra në mungesë të ndonjë zanoreje tjetër, në këtë të folme [ë]-në e gjejmë edhe në rrokje të theksuar te fjalët kuptimplota, që e ruajnë theksin edhe në vargun e ligjërimin:

a) në pak fjalë të huazuara nga gjuhët sllave, si *shtërk* 'lejlek', *tërll* 'vathë bagëtish', *gërb* 'shpinë, kurriz', *sërb* 'serb';

b) në pak huazime orientale: *hëz*, *hafëz*, *ërrz*, *ërrsk* (*rrësk*);

c) te disa shprehje onomatopeike, si: *turreci ban tërr-tërr*, *s'ka këk-mëk*, *zogi tërr fjaroj*, *zilja ban xërr*, *përr tiki-tiki* (ndjellen pulat), *hërrp e piv kafën*, *miza ban bëz-bëz* etj.;

ç) në të folmen e fshatit Grushinë në gjendjen e tashme [ë] të theksuar gjejmë edhe te fjalët: *trëp*, *cëng* 'trup, cung'; *katën* 'katund', *rrësh* 'rrush'. Fjalëformat e tilla me [ë] të theksuar janë rezultat i diftongimit të /ú/-së së theksuar në [êu] e më pas shndërrimit të diftongut në diftongoid [ë^u], ndërsa në gjenden e tanishme tani rrjedhojë e monoftongimit në [ë] të mirëfilltë të theksuar. Pra, kemi /ú/ > [êu] > [ë^u] > [ë].

2.4.5.1. Përdorimi i [ë]-së së patheksuar në trup të fjalës

150. Në këtë të folme, si dhe në gegërishten në përgjithësi, nuk mund të gjejmë fjalë me [ë] as në fillim e as në fundin absolut të fjalës. Në të vërtetë, hetuam vetëm dy fjalë me [ë] nistore, si rezultat i disa dukurive të caktuara fonetike, njëra formë e përfutur nëpërmjet protezës (shtimit të [ë]-së në fillim të fjalës) dhe tjetra nëpërmjet aferezës (rënies së [p]-së në fillim të fjalës): *ërrnon* (< rnon, jeton) në f. Straçincë dhe *ërfuni* (< përfundi, nën) në të folmen e fshatrave Brezë, Malinë, Tanushë, Luboten dhe Grushinë.

151. Në trup të fjalës gjejmë jo pak fjalë me [ë], si edhe në të folmet e tjera të dialektit të Veriut (sidomos tek emrat e gjinisë femërore në trajtën e pashquar), në pozitë para sonanteve [r], [rr]; [l], [ll]; [n] dhe [m]: *motër*, *zemër*, *letër*, *kodër*, *sofër*, *ahër*, *kërshlak* (lepur i vogël), *kokërr*, *mekërr*, *vehërr*, *i vogël*; *i ambël*, *i amël*; *tambël*, *tamël*; *netëll*, *sekëll*, *darsëm*, *i vetëm*, *i mbushëm*, *i thoshëm* (i thojsha, i thoja, i thosha), *shkojshëm*; *emën*, *femën*; *preën* (< prehën), *kraën* (< krahën), *rrënaim* (< rrënim). Por, në trajtën e shquar, [ë]-ja e rrokjes fundore bie, si në mbarë shqipen (motra, zemra, kodra, sofra, tamli). Zanozja [ë] në trup të fjalës përdoret edhe tek emrat e gjinisë femërore në rasën kallëzore: *arën*, *bukën*, *dorën* etj.

152. Veç para tingëllueseve, zanozja [ë] në mes të fjalës përdoret edhe në rrethime të tjera fonetike, si:

- Rregullisht përdoret tek emrat e gjinisë femërore në të shquarën në gjinore e në rrjedhore: (*i, e*) *derës*, (prej) *derës*, *arës*, *babës*, *nanës*, *punës*, *pulës*, *mollës*, *kumllës*, *dardhës*...

- Zanozja [ë] e patheksuar na del edhe në kombinime të tjera tingullore, si në fjalët: *iftohët*, *vakët*, *i sprehët*, *ôudhhekës*, *shkëpôu* (f. Straçincë); *lotët*, *mbështell*, *hanëz*, *tërhan*, *tërku:z*,

tërma:, gështej, e amël; kërkuj, gërkoj etj.

2.4.5.2. Rënia e [ë]-së

153. Si në përndarje (distribucim), ashtu edhe në dendurinë e përdorimit (frekuencë), në të folmet e gegërishtes, përfshirë edhe të folmen shqipe të Malit të Zi të Shkupit, ka mjaft kufizime. Dihet mirëfilli (e kemi thënë edhe më parë) se ajo nuk gjendet në pozitë nistore e as në fund të fjalës, ndërsa në trup të fjalës jorrallë pëson ndërrime cilësore e sasiore (kualitative e kuantitative).¹² Do të japim disa fjalë nga e folmja e Karadakut me rënie të zanores [ë]:

154. Duke u gjendur në pozitë të dobët fonetike, përkatësisht e patheksuar në pozicionin fundor absolut të fjalës, në rrjedhë të kohës është shqiptuar gjithnjë si më e dobët e më e dobët, aq sa tanimë nuk e gjejmë në asnjë të folme geqe, përkatësisht në këtë pozicion në gjithë Gegërinë [ë]-ja ka rënë plotësisht. Kjo rënie e saj, nuk ka mbetur pa lënë gjurmë, meqë ka zgjatur zanoren paraprirëse të fjalës përkatëse ose siç jemi mësuar ta lexojmë: ka bërë zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse, sipas tipit: *a:r* < arë, *do:r* < dorë, *fa:r* < farë, *bu:rr* < burrë, *mo:ll* < mollë, *pla:k* < plakë, *u:dh* < udhë, *pu:n* < punë, *lo:p* < lopë, *ve:sh* < veshë, *ba:b* < babë, *na:n* < nanë, *va:l* < valë, *n'fu:sh* < në fushë, *n'u:j* < në ujë, *m'a:n* < më anë; ***t'amën e s'amës*** < të ëmën e së ëmës (fjala *amë* në gegërishte në kuptimin themelor të saj, për të emërtuar 'nënë' ende gjallon, por vetëm në sharje në dy forma të ngurosura: *Ta ... t'amën e s'amës!* Ose vetëm: *Ta ... t'amën!* Siç dihet, fjala *amë* në kuptimin për të emërtuar 'amën e bletës' është e përhapur në gjithë Gegërinë.

155. Zanorja e patheksuar [ë] elidohet edhe te pjesëzat (të >) *t'*, (më >) *m'*, (në >) *n'* të përdorur si fjalëza proklitike: *une do t'shkoj* < unë do të shkoj; *si t'bjere shâi, drithi do t'bahet ma i mâir* < si të bjerë shi, drithi do të bëhet më i mirë; *de t'dalsh* < do të dalësh; *de shkoj* < do të shkoj, *m'vet* < më vet, më pyet; *me m'nimu* < me më ndihmu, ndihmuar; *aj m'tha* < ai më tha; *punoj n'a:r* < punoj në arë; *n'besk* < në bjeshkë... Kjo zanore e patheksuar ka rënë plotësisht edhe në toponiminë dhe antroponiminë shqiptare të Veriut.¹²⁵

156. Nuk shqiptohet [ë]-ja e patheksuar shpeshherë edhe në mes të fjalës, si në fjalët: *tlin* < tëlyen, *gzim* < gëzim, *e gxofsh* < e gëzofsh, *i vokt* < i vokët, *malsâi* < malësi, *udhtar* < udhëtar, *msus* < mësues, *nxans* < nxënës, *lkur* < lëkurë, *kmêish* < këmishë, *i vol* < i vogël (f. Billacë), *dalldâish* < dallëndyshe, *msit* < mësit, shkues; *kta* < këta, *knus* < këndues, gjel; numrat nga 11-19, si *nimdhe:t* < njëmbëdhjetë, *dimdhe:t* < dymbëdhjetë, *tremdhe:t* < trembëdhjetë, ... *nanmdhe:t* < nëntëmbëdhjetë etj.

2.4.5.3. Shndërrimi i [ë]-së në zanore të tjera

157. Në këtë të folme denduria e përdorimit të zanores [ë] zvogëlohet në të mirë të shtimit të dendurisë së disa zanoreve të tjera, më së shpeshti të zanoreve [e], [i] dhe [u], si:

¹² Nga prof. Eqrem Çabej mësojmë se reduktimi i [ë]-së në të folmet e gegërishtes ka filluar para tre shekujsh (tani mund të thuhet para tre – katër shekujsh). Shih: Eqrem Çabej, *Për historinë e zanores ë në gjuhën shqipe*, BShSh 1, 1956, f. 123-144.

¹²⁵ Izmit Durmishi, *Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit*, Gostivar, 2008, f. 85.

158. [ë] > [e]: *llambe* (< llambë), *ket* (< këtë), *une* (< unë), *gelba:z* (< këlbazë) etj. Në pozitë fundore, te foljet e të gjitha zgjedhimeve në vetën e tretë të kohës së tashme të lidhore, si dhe te format e kohës së ardhme, [ë]-ja alternohet në [e]. Këtë dukuri e gjejmë edhe në të folmen e Dervenit,¹⁵ të Karshiakës¹⁶ e më gjerë në të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut. P.sh.: *aj duhet t'lidhe* (< ai duhet të lidhë), *t'marre* (të marrë), *t'dale* (të dalë), *t'hape* (të hapë), *t'doje* (të dojë); *t'kallxoje* (të kallëzojë); ndërsa te foljet në kohën e ardhme: *aj do lidhe* (ai do të lidhë), ose me pjesëzën *de 'do'*: *aj de lidhe*, e cila në këtë të folme shfaqet më rrallë sesa forma *do: do marre* (do të marrë), *do dale* (do të dalë), *do hape* (do të hapë) etj.

159. **Qiellzorizimi i [ë] > [i]**, si: *likur* (lëkurë), *çindroj* (qëndroj), *çi* (që), *ni* (një) etj. Nga shembujt e dhënë mund të konstatohet se zanorja [ë] nën ndikimin e bashkëtingëlloreve paragjuhore [l], [ç] dhe [n] fiton një nyjëtim më të përpamë dhe më të hapur, përkatësisht ajo shndërrohet në [i].

160. **Velarizimi [ë] > [u]**: *mbushtell*, *mushtell* (< mbështjellë) në f. Luboten; *rrumâisht* (< rrëmisht, rrëmbimisht, me rrëmbim) në f. Luboten; *mushkerr*, *mushjtjerr*, *mushqerr* (mështjerrë); *muzat* (mëzat) në fshatrat Brezë, Malinë, Mojancë, Orllancë, Bllacë, Tanushë, Grushinë, Straçincë, Luboten.¹²⁶

2.4.6. ZANORJA [o]

161. Kjo zanore në këtë të folme nyjëtohet si në të folmet e tjera të gegërishtes: ***gjysmë e hapur, e prapme, e buzorëzuar***. Realizohet si fonemë e shkurtër dhe e gjatë (kës ~ ko:s ‘kos, qumësht i thartuar ~ kosë, vegël për prerjen e barit’), por jo si hundore. Hundorësia e saj është rrjedhojë e shndërrimit të /ã/-së hundore të mbarë gegërishtes në /o/ të hundorëzuar. Timbri hundor është dytësor, në shkallë më të ulët sesa te zanoret e tjera hundore, si: *nona* < *nāna*, *hona* < *hāna*, *koma* < *kāma*. Kjo /o/ e hundorëzuar nuk krijon kundërvënie fonologjike me /o/-në gojore. Rrjedhimisht, në të folmen e Karadakut të Shkupit kemi dy fonema zanore: /õ/ ~ /o:/. Vlera fonologjike e gjatësisë së /o/-ve mund të provohet (përveç me emrat *kos* ~ *ko:s*, ku gjatësia ka vlerë kuptimore) me çiftet minimale të fjalëve: *böll* ~ *bo:ll* ‘mjaft ~ bollë, lloj gjarpëri; *konõp* ~ *kono:p* ‘konop – konopë’, *malõk* ~ *malo:k* ‘malok ~ malokë’ (te dy shembujt e fundit gjatësia ka vlerë gramatikore, përkatësisht shenjë dalluese e njëjësit dhe shumësit të emrit, përkatësisht zanorja e shkurtër është tregues gramatikor i njëjësit, ndërsa zanorja e gjatë tregues i shumësit të emrit përkatës).

162. Shfaqet në pozitë të theksuar e të patheksuar, në të gjitha pozitat e fjalës. *oriz*, *oxhak*, *o:d*, *openj*; *ogiq*, *ogjiq*, *Osman*; *qosh*, *motër*, *i vocërr*, *do:r*, *vo:rr*, *plot*, (ai) *don*, *voj*, *vo:rb*, *njoh*, *shoh*, *lo:p*; *do* (disa), *po*, *jo*, *do t'shko:jm*, *ato*, *k'to*, *aso burrash* ...

Zanorja [o] gjendet edhe në togun [oe], kur ajo shqiptohet e pandryshuar, që del te pak fjalë: *voe*, *droe* etj.

163. Në të folmen e këtij areali, veçmas në fshatrat Straçincë, Tanushë, Mojancë e Orllancë, në vend të [o]-së ndonjëherë dëgjohet diftongoidi [ʷo], si në fjalët *kʷodër*, *kʷorb*,

¹⁵ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*,..., f. 85.

¹⁶ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e ...*, f. 170.

¹²⁶ Dybuzorje [m] (mb) ka ndikuar në labializimin dhe shqiptimin më të prapmë të [ë]-së.

m^uotër, v^uotër, i v^uogël, v^uo:rb, gr^uop, fl^uok, gr^uo:sh.

164. **Ndërrimet fonetike.** – Ndërrimi i [o]-së në [a] dëgjohej te disa fjalë në të folmen e Karadakut të Shkupit. Kemi regjistruar këto raste të tilla: *kampir* (< kompir, patate) në f. Brezë e Malinë; *nat* (< not) në f. Bllacë; *aborr* (< oborr), *ksa grash* (< këso grash), *aja* (< ajo), *kja* (< kjo), *çaja* (< çe + ajo) në Bllacë; *u vanova* (< u vonova) në f. Mojancë e Orllancë. Në fjalët e dhëna kanë vepruar disa dukuri fonetike, si zhbuzorëzimi, shqiptimi më i hapur e më i përparmë, asimilimi, disimilimi etj.

2.4.7. ZANORJA [i]

165. Zanorja [i] në të folmen shqipe të Malit të Zi të Shkupit si dhe në të folmet e tjera është e ***mbyllur*** (e ngritjes së lartë), e ***përparme*** dhe e ***pabuzorëzuar***. Ajo haset në rrethana të ndryshme fonetike, në rrokje të theksuar dhe të patheksuar, si zanore e shkurtër, e mesme dhe e gjatë; gojore ose hundore. Si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore, në rrokje të theksuar realizohet shumë shpesh si diftong [âi, êi].

166. Si monoftong [i], mund të dëgjohej në të gjitha pozicionet e fjalës, si p.sh: a) në fillim të fjalës: *i i:m, ishna, iki, ibrik, iriç...*; te emrat vetjakë: *Izet, Ibish, Isuf, Ibadet, Igball*; fjalët turke: *izaret, ikram, iftiaç, isharet, iftibar, ilaç* etj.; b) në trup të fjalës: *bisht, gjiz, tlin, gjisht, xhin* (< njerëz, si emër përmbledhës, kolektiv), *xhit?* (< çka?), *ki:sh* (< kishë), *di:ll, qi:ll, dit, lip, bin, ship, drishk, brisk, gjimc, mi:xh, midis, kingj, grani:c* (< kufi), *misir* (< biban, çuran), *misi:rk* (< bibë, çurë), *e britht* (< e shkriftë), *saki:c* (< sopatë); tek emrat personalë: *Dilaver, Maliq, Bislim, Binaz...* etj.; c) në fundin absolut të fjalës: *hi:, dri:, raki:, lethi:, gji:, bri:, i zi, vi* (hulli), *bli, ki*; emrat orientale të banorëve të kësaj krahine e më gjerë, sipas tipit: *Bari, Sami Xhezmi, Shukri, Avdi* etj. Në pozicionin fundor [i]-ja përdoret si mbarese shquese e emrave të gjinisë mashkullore, të tipit: *lis-i, çen-i, qep-i, qum-i, zo-n-i, breg-i, ah-i, krah-i, zog-i* etj.

2.4.7.1. DIFTONGIMI I [i]-SË SË THEKSUAR

167. Përgjithësisht zanoret e shqipes standarde, pavarësisht nga rrethimi tingullor (edhe sikur para ose pas tyre të kenë cilëndo zanore ose bashkëtingëllore që lejon parimi i bashkëlidhjes) karakterizohen me qëndrueshmëri (stabilitet) nyjëtimore. Për këto zanore thuhet se kanë stadium gojor dhe janë zanore të thjeshta. Por megjithkëtë, nganjëherë ka edhe raste kur ndonjëra nga zanoret në kontakt me zanoren tjetër e humb stadiumin gojor. Stadium gojor do të thotë të qëndruarit për një kohë të caktuar (disa të qindta të sekondës) në një formë e pozitë të caktuar të aparatit të të folurit. Kjo është veçori e përgjithshme e zanoreve të mirëfillta.

168. Mungesa e stadiumit gojor është tipar i diftongjeve dhe i diftongoideve. Gjatë kohës së nyjëtimit të diftongjeve kemi ndërrimin e pozitës së organeve të të folurit (sidomos të gjuhës), gjatë së cilës në këtë tërësi artikulesh shfaqen dy faza të shkrira nyjëtimi, rrjedhimisht edhe dy fragmente tingullore. Zakonisht në fillim të diftongut dëgjohej një timbër i një zanoreje, ndërsa në fund një timbër i ndonjë zanoreje tjetër.¹²⁷

¹²⁷ Ирена Савицка - Људмил Спасов, *Фонологија на современиот македонски стандарден јазик*, Скопје,

169. Pra, nga pikëpamja nyjetimore diftongjet janë tinguj të përbërë. Për prodhimin e tyre, organet e të folurit kalojnë me rrëshqitje nga pozicioni i nyjetimit të një zanoreje në pozicionin e nyjetimit të zanores tjetër. Ndryshimi i vëllimit dhe i formës së rezonatorit të gojës në këto lëvizje bëjnë që gjatë prodhimit të diftongut të përkapen dy timbre të ndryshëm. Si gjithë tingujt e përbërë, diftongjet në disa gjuhë mund të funksionojnë si fonema më vete, krahas fonemave të tjera zanore. Në gjuhën shqipe diftongjet janë variante kombinatorë (alofone) të fonemave zanore përkatëse dhe nuk konsiderohen si fonema të veçanta.

170. Të folmet shqipe nga pikëpamja fonetike kanë diftongje, sidomos gegërishtja qendrore. Denduria e diftongjeve në të folmet e gegërishtes qendrore, në dallim nga të folmet e tjera të shqipes, qëmoti është shtuar nga shpërbërja (diftongimi) e zanoreve të theksuara të mbyllura (/i, u, y/) në një numër të madh fjalësh në rrethime të caktuara fonetike. Kështu, në pozitë të theksuar, /i/-ja e gjatë e theksuar (í:) shpërbëhet në variante dytësore diftongore *âi, êi, êi, ôi*: *shpí* > *shpâi, shpêi, shpêi, shpôi*; /ý/-ja është zh buzorëzuar në /í/ dhe më vonë ka pasur të njëjtën rrugë zhvillimi, është diftonguar si edhe /i/-ja parësore: *sý* > *sí* > *sâi, sêi, sêi, sôi*; ose /ú/-ja në *âu, ôu, ôu*: *núse* > *nâuse, nôuse, nôuse* e në shumë fjalë të tjera.¹²⁸

171. Gjuhët me ndërndikim të theksuar ndërmjet tingujve, veçmas në zgjatjen dhe shkurtimin e tingujve, kanë prirje të posaçme t'i realizojnë fonemat zanore me zhvillim të plotë nëpërmjet diftongjeve.¹²⁹

172. Të folmet e gegërishtes qendrore lidhur me nyjetimin e zanoreve të mbyllura [i] dhe [u] karakterizohen me modelet:

- a) që kanë stadium gojor (stabilitet nyjetimor) dhe
- b) që nuk kanë stadium gojor (jostabilitet nyjetimor).

173. Pra, zanoret [i] dhe [u] në të folmet e gegërishtes qendrore, përfshirë edhe të folmen e Karadakut të Shkupit përdoren si: a) monoftongje (njëzëshe), te të cilat ngjyrimi në pikëpamje akustike mbetet i pandryshueshëm gjatë gjithë kohës së artikulimit dhe b) si diftongje (dyzëshe), në artikulimin e të cilave ndryshon ngjyrimi i zërit. Thjesht, në fillim të diftongut dëgjohet një ngjyrë zanoreje, ndërsa nga fundi një ngjyrë tjetër.¹³⁰

174. Diftongimi i zanoreve të mbyllura /í/ dhe /ú/ në [âi], [êi], [êi] dhe [ôi]; përkatësisht [âu], [ôu] paraqet një ndër inovacionet më qenësore të gegërishtes qendrore. Në këtë të folme, përveç diftongjeve që dëgjohen shumë shpesh, ndonjëherë dëgjojmë edhe diftongoide (k^uodër, m^uotër, fl^uok), por nuk kemi dëgjuar triftongje.

175. Në gjuhësi, sipas analizës së materialit gjuhësor të shumë gjuhëve, është provuar e konstatuar se diftongohen zanoret gjata në rrokje të theksuar.¹³¹ Prof. Remzi Nesimi e ka trajtuar hollësisht diftongimin e zanoreve në të folmen e Dervenit. Meqë në gjendjen e sotme të diftonguar e gjejmë jo vetëm [i:]-në e gjatë, por edhe atë me gjatësi të mesme e të shkurtër, për kronologjinë e diftongimit prof. Remziu shprehet se: “së pari është diftonguar [i:] -ja e gjatë, pastaj [i.] -ja me gjatësi të mesme dhe në fund [i] -ja e shkurtër.”¹³²

176. Një gjë është e rregullt dhe gjithëpërfshirëse: zanoret [í] dhe [ú] diftongohen vetëm rrokje të theksuar, sidomos kur kanë kushte të volitshme kontekstuale për nyjetim të plotë dhe të

1997, f. 24.

¹²⁸ Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011; f. 131-132.

¹²⁹ N.S. Trubeckoi, *Parime të fonologjisë*, Prishtinë, 1985, f. 305.

¹³⁰ Bertil Malmberg, *Fonetika*, Sarajevo, 1974, f. 38.

¹³¹ N. S. Trubeckoi, *Parime të fonologjisë*, ..., f. 195.

¹³² Remzi Nesimi, *Diftongimi i i-së dhe i u-së së theksuar në të folmen e Dervenit*, ..., 1997, f. 88.

papenguar, e pikërisht të tilla janë zanoret e gjata. Megjithëkëtë, në gjendjen e sotme gjejmë edhe përjashtime. Në këtë kuptim, gjejmë jo pak fjalë ku zanorja e gjatë e mbyllur [i:] apo [u:] nuk është diftonguar, por nga ana tjetër edhe ku zanorja e shkurtër [ɪ] ose [ú] është diftonguar. P.sh.: zanore të gjata të padiftonguara kemi në fjalët: *hi:*, *bli:*, *gji:*, *hi:rr*, *bri:*, *hu:*, *dru:*, *pu:n*; zanore të shkurtra të diftonguara: *mâik* (< mík), *krâip* (< kríp), *rrâip* (< rríp), *nâip* (< níp) etj.

177. Izoglosa e diftongimit të zanoreve të mbyllura [í, y, ú], siç dihet, është gegërishtja qendrore. Kjo dukuri fonetike inovuese ka përhapje të gjerë në gjithë gegërishten qendrore. Sipas njohurive të derisotme, vetëm pak të folme të kësaj izoglose nuk e kanë këtë dukuri risimtare të shpërbërjes.¹³³ Sipas studimeve dialektore del se diftongimi është i pranishëm në të folmet e Lurës, Lumës, Krujës, Mirditës, Matit, Peshkopisë¹³⁴ (në Shqipëri); në të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut, si: në disa fshatra të Kumanovës,¹³⁵ në të folmen e luginës së Shkupit,¹³⁶ të folmet e Pollogut: Tetovë me rrethinë,¹³⁷ Gostivar (përjashtim bën e folmja e Rekës së Epërme);¹³⁸ Strugë (me përjashtim të të folmeve toske),¹³⁹ Dibër,¹⁴⁰ diftongohet edhe në Kërçovë,¹⁴¹ Karshiakë,¹⁴² Prilep, Krushevë,¹⁴³ si dhe në disa fshatra në jug të Kaçanikut.¹⁴⁴

178. Sipas analizës së materialit dialektor, e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit [ɪ]-në e theksuar e shpërbën në tri variante diftongjesh: [âɪ], [êɪ] dhe [êi], nga të cilat dy të parat janë më të përhapura, ndërsa varianti i tretë shfaqet në mënyrë sporadike. Në këtë pikëpamje, hetuam se në një pikë dialektore zakonisht mbizotëron një variant diftongu, ndërsa varianti i dytë e ndonjëherë edhe i treti shfaqen më rrallë. Kjo dukuri fonetike është në përputhje me gjendjen e larmisë së diftongjeve edhe në të folmet e tjera të krahinës diftonguese.¹⁴⁵ Përndarja dhe

¹³³ Të tilla janë tri të folme të fshatrave të Kumanovës: Vaksincë, Llojan dhe Izvor. Shih: Remzi Nesimi, *Çështje gjuhësore ...*, f. 86; disa fshatra të rrethit të Shkupit (me prejardhje nga Reka e Epërme e Gostivarit): Nerezi, Krushopeku, Grçeci, Sveta Petka, Jabollca, Patishka Reka, Černi Vërvi, Jabollçishti i Epërm dhe i Poshtëm; Shih: Haki Imeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997, f. 31; e folmja e Rekës; e folmja e f. Sallarevë dhe Gurgunicë – rrethi i Tetovës; e folmja e f. Koritë – rrethi i Gostivarit; f. Buzallkovë e Jabollçishtë në rrethin e Velesit; fshatrat Radolishtë, Frëngovë, Kalishtë, Zagraçan dhe Shum në qarkun e Strugës. Shih: Ajten Qamili, *Të folmet shqipe të rrethit të Strugës (në kontekstin ballkanik)*, disertacioni doktorati në dorëshkrim, Fondi i Fakultetit të Filologjisë, Shkup, 2011, f. 72-74.

¹³⁴ Bahri Beci, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987, f. 23.

¹³⁵ Haki Ymeri, *Veçoritë morfologjike të së folmes së Kumanovës me rrethinë*, Jehona 1-2 Shkup, 1982.

¹³⁶ Petar Skok, *Hulumtime gjuhësore te popullsitë josllave të luginës së Shkupit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 80. Carlo Tagliavini, *Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 120-121.

¹³⁷ Remzi Nesimi, *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987, f. 176; *Përdorimi dhe diftongimi i vokaleve i dhe u në të folmen shqipe të rrethit të Tetovës*, Jehona 2, Shkup, 1972; *Diftongimi i i-së dhe i u-së së theksuar në të folmen e Dervenit*, Shkup, 1997, f. 85-104. Fadil Sulejmani, *E folmja e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Tetovë, 2006..

¹³⁸ Fehim Reçani, *Të folmet shqipe të Pollogut*, Shkup, 2001; Feim Reçani, *E folmja e rrethit të Gostivarit* (punim magjistrature në dorëshkrim), Prishtinë, 1977.

¹³⁹ Ajten Qamili, *Të folmet shqipe të rrethit të Strugës (në kontekstin ballkanik)*, disertacioni doktorati në dorëshkrim, arkivi i Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup, 2011, f. 72-74.

¹⁴⁰ Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 148.

¹⁴¹ Lulzim Aliu, *E folmja shqipe e rrethit të Kërçovës*, Tetovë, 2011, f. 28-19.


¹⁴² Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997, f. 51-63; *Diftongu dytësor i grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore* (shikuar sipas së folmes shqipe të Markova-Rekës), Jehona 3, Shkup, 1994, f. 79-87.

¹⁴³ Mustafa Ibrahimimi, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Shkup, 2005, f. 67-70.

¹⁴⁴ Fadil Raka, *E folmja e qytezës së Kaçanikut*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 516.

¹⁴⁵ Haki Ymeri, *Diftongu dytësor i grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore* (shikuar sipas së folmes shqipe të Markova Rekës), Jehona 3, Shkup, 1994, f. 79-87.

denduria e përdorimit të këtyre varianteve diftongore në Karadakun e Shkupit është si më poshtë:



Skica 3. Diftongimi i [í]-së së theksuar

Nga materiali i vjelë në terren kemi arritur të nxjerrim këto të dhëna:

a) Diftongu [âi] shfaqet në fshatrat Brezë e Malinë (pa asnjë variant tjetër); në f. Grushinë (kemi dëgjuar shtatë fjalë me [êi]), f. Mojançë (me tri fjalë me [êi]), f. Orllancë (regjistruam 5 fjalë me [êi] dhe një me [êi]), f. Luboten (me 8 fjalë me [êi], një me [êi] dhe një me [ôi]).

b) Diftongu [êi] dëgjohej në f. Straçincë (me 5 fjalë me [âi]), në f. Bllacë (me 19 shembuj me [âi] dhe 8 shembuj me [êi]), f. Tanushë (me 3 shembuj në [âi]).

179. **Mosdiftongimi i /i/-së në fillim të fjalës.** - Lidhur me pozitën e /i/-së së diftonguar në fjalë, përkatësisht të pozitës së diftongjeve në fjalë, konstatoam se /i/-ja diftongohet në fundin e fjalës dhe në trup të saj, ndërsa asnjëherë në pozitë nistore. Kjo mund të shpjegohet me atë se pozita nistore e tingujve në fjalë llogaritet si pozicion i fuqishëm. Me fjalë të tjera, artikulimi i fuqishëm (nyjëtimi i fortë, tendosja e organeve të të folurit) në zanoren nistore është dukuri e natyrshme, që shpjegohet me çlirimin e energjisë së akumuluar dhe mospasjes së kohës dhe e mundësisë për akomodim, për shkak të nevojës që të shqiptojmë tinguj të tjerë vijues.

180. **Diftongimi i /i/-së së theksuar në mes dhe në fundin absolut të fjalës.** - Zanorja e theksuar /i/ në Karadakun e Shkupit shumë shpesh realizohet si diftong në trup të fjalës dhe në fund të saj, në rrokje të hapur, si: *shâi, shêi* < shí::; *trâi, trêi* < tri::; *rrâ, rrêi* < rrí::; *pâi, pêi* < pí::; *hullâi, hullêi* < hullí::; *mullâi, mullêi* < mullí::; *janâi, janêi* < jahní::; *tâi, têi* < tí, tý; *shtâi, shtêi* < shtí; *mâi, mêi* < mí; *thâi, thêi* < thí; *po vâi, po vêi* < po ví; *fâi, fêi* < fi::; *përmâi, përmêi* < përmbi; *dhâi, dhêi* < dhi::; *kutâi, kutêi* < kuti: ...

181. Diftongu ruhet edhe kur fjalëve u shtohen tregues gramatikorë, si *shâi-vi, sâi-ni, mullêi-ni, mâi-ni*, që do të thotë se diftongu mbetet i pandarë dhe i qëndrueshëm në tërë

strukturën e gjuhës. Në bazë të vlerësimit tonë, kur diftongohet /i/-ja hundore, atëherë timbri hundor bartet e ruhet edhe te diftongu, por me shkallë më të ulët, sipas tipit mullī > *mullâj*, *mullêj*.

182. Dihet se pozita fundore në rrokje të hapur është ideale për nyjetim të plotë, zhvillim të papenguar dhe zgjatje të zanoreve, parakushte të favorshme edhe për shpërbërje (diftongim). Megjithëkëtë, edhe përkundër këtyre kushteve optimale për diftongim, shpeshherë edhe në këtë pozitë /i/-ja shfaqet e padiftonguar, si edhe në trup të fjalës. Kjo na jep të drejtë të gjujkojmë se faktor kryesor i diftongimit të zanoreve të mbyllura në gegërishten qendrore është rrethimi tingullor, sidomos tingulli që gjendet para zanores /i/. Përgjithësisht, në pozitë fundore ose në mes të fjalës (me pak përjashtime) /i/-ja nuk diftongohet kur gjendet pas mbylltoreve [d, b, k, g]; mesgjuhoreve [q, gj], afrikateve [ç, xh]; laringales [h] dhe shtegores [z].¹⁴⁶ P.sh.: *di:* (< di, dy), *kadi:*, *çudi:*; *bi:r* (< birë, vrimë), *habi:*; *raki:*, *vaki:*, *baski:* (gozhdë), *përkiti* (mbi, përmbi); *xhigim* (gjym), *zengin* (i pasur); *qime*, *ogiq*, *ogji*; *gjisht*; *çiçe* (qyqe, qyqe), *çilim* (qilim); *xhi:* (gji-ri), *mullixhi*, *hanxhi*, *hi:* (hiri), *hi:se*, *mihir* etj.

183. Duhet thënë se pas grupeve të bashkëtingëlloreve [mb] dhe [nd], qoftë kur janë të ruajtura ose të reduktuara në [m], [n]; zanorja /i/ diftongohet, si *mbâj* < mbi, *përmâj*, *e mbâiti*, *mbâill*, *mâill* < mbjell; *çendâisi*; *iqindâi*, *iqinâi* etj.

184. Zanorja /i/ e theksuar shumë shpesh shpërbëhet (diftongohet) kur gjendet në këto rrethime tingullore:

a) Pas sonanteve [ll], [r], [rr], [m] dhe [n]. P.sh.: pas [ll]-së: *bullâic*, *xixllâim*, *pazarllâik*, *i shllêisht* 'i njelmët'; pas [r]-së: *krâip*, *krêimb*, *trêim*, *u frâina*, *e prâita*, *frâigem*, *u ngrâita*, *u ngrâi*, *krâisi*, *furâik*, *krâje*, *e ndrêiqi* etj.; pas shumëdridhëses [rr]: *rrâip*, *rrâim*, *murrêiz*, *kurrêiz* etj.; pas hundores [m]: *mêik*, *mâixh*, *mêir*, *t'mâiat*, *mâill*, *mêiz*, *mâini* etj.; në pozitë pas [n]-së: *koleshnêik*, *u nâisëm*, *nâip*, *stërnâip*, *granêim*, *burrnêim* ...

Është me rëndësi të themi edhe atë se si në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore,¹⁴⁷ pas dhe para tingëlleses /l/ zanorja /i/ asnjëherë nuk diftongohet, si në fjalët: *lis*, *qilim*, *lidhi*, *fli:*; *hajmali:*, *çeteli:*, *jeshil*, *fital*, *pestil*, *kopil* etj.

185. Të shpeshta janë fjalët me diftong ndërmjet dy sonanteve, si: *xixllâim*, *mumrâim*, *trêim*, *rrâim*, *granâim*, *mêir*, *u frâina*, *krêimb*, *u shkrêin* etj.

186. Zakonisht në çdo rregull gjejmë edhe përjashtime. Kështu, në këtë kuptim, ka raste kur /i/-ja edhe pse gjendet pas një bashkëtingëlloreje sonante, si në fjalët: *dri:t*; *misir*, *misirk*; *brisk*, *ibrik*, *drishk*, *grik*, *gri:sh*, *gjin* etj. ajo ruhet si monoftong, pra e padiftonguar.

187. I shpeshhtë është diftongimi i /i/-së pas bashkëtingëlloreve [th], [dh], [v], [s], [sh], [ç], [f], [c], [p] dhe [t]: *thâik*, *thâirr*, *kthâim*, *lethâia*, *thâith*, *thâiri*; *u mërdhâif*, *nimdhâit*, *dimdhâit*, ..., *nanmdhâit*; *vêiç*; *shkusovâic*, *gllavêin*; *unsâia*, *sâipri*, *kosâit*; *bakshâish*, *shâi*, *çershâi*, *fshêim*, *Groshêin*; *leçâit*, *kaçêit* 'copë', *kaçâik* 'kofshë', *Haraçêin*; *fêis*, *kufâi*, *fêill*; *cêjca*; *e pâiti*, *çerpêik*, *shpâirt*, *tâim*, *ftêir*, *bërtâim*, *çatâi*, *tâir*, *tâim*, *vetâim*, *bërtâim*, *Fatêime*, *jetâim*, *fitâim*, *pshtâim* etj.

188. Konsiderojmë se diftongimi i /i/-së lidhet para së gjithash me karakterin e rrethimit tingullor të tij. Kjo gjen mbështetje edhe te rregulli i njohur për të gjitha gjuhët se rrethimi me bashkëtingëllore sonante dhe shtegore zgjat artikulimin e zanoreve,¹⁴⁸ dhe kështu në këto

¹⁴⁶ Remzi Nesimi, *Diftongimi i i-së dhe i u-së së theksuar* ..., Çështje gjuhësore, ..., f. 91-93.

¹⁴⁷ По аты, f. 92.

¹⁴⁸ Ирина Савицка – Лудмил Спасов, *Фонологија*..., f. 131; A. Dodi - J. Gjinari, *Fonetika* , ..., f. 57-58; Bahri Beci, *Sistemi fonologjik* ..., f. 104; N. S. Trubeckoi, *Parime* ..., f. 308.

rrethana fonetike zanoret në të folmen tonë realizohen si të gjata, parakusht për zhvillim të mëtejshëm, përkatësisht kusht për diftongim. Në këtë kuptim, për rrethimin fonetik të ruajtjes së /i/-së dhe të diftongimit të saj (si monoftong apo si diftong) kanë bërë fjalë deri më tani shumë gjuhëtarë, si Bahri Beci, Remzi Nesimi, Haki Ymeri (në vepra të cituara) etj., por, megjithëkëtë shkaqet e diftongimit si dhe shumë çështje të tjera rreth diftongimit kanë mbetur për t'u zgjidhur në të ardhmen.

189. Kemi vënë re prirjen e monoftongimit të diftongjeve të përfuar nga /i/-ja, si: *calli* < câilli < cili (e gjejmë në tërë arealin e Karadakut); *mbëllshna* < mbëjllshna < mbillshna (f. Straçincë) // *po be she si n'she:k* // (she < shêi < shi) në f. Bllacë; ndërsa monoftongimi i [âu]-së ose i [êu] në zanore të mirëfilltë [a:] ose [ë] është dukuri më e shpeshtë dhe më e përhapur.

190. Në gjendjen e tanishme, në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, e hetuar edhe në të folme të tjera të gegërishtes qendrore, vërehet prirja e shqiptimit të dyfishtë të të njëjtës fjalë: në formë të diftonguar dhe të padiftonguar. Kjo na jep të drejtën të themi se procesi i diftongimit ka pushuar së vepruari, e tani vepron procesi i monoftongimit të diftongjeve. Në të vërtetë, shpeshherë i njëjti informator fjalën e njëjtë e shqipton në dy forma (me diftong dhe pa diftong), si *sêi* - *si* (sy), *temcêi* - *tepsi*, *mullêi* - *mulli*, *mêi* - *mi*, *dhêi* - *dhi*, *pêi* - *pi*, *shpâi* - *shpi*, *kusâi* - *kusi* etj. Ky proces ndihmohet nga të folmet e tjera që nuk kanë diftongim zanoresh (në të shumtën e rasteve për shkak të martesave të përziera, lidhjeve familjare, kontakteve të drejtpërdrejta midis folësve krahinash të ndryshme etj.), por sigurisht se ndikim në këtë ka edhe shqipja standarde (nëpërmjet shkollës, mjeteve të informimit etj.) si dhe gjuhët e tjera në takim.

191. Po kështu, format e diftonguara të fjalëve ruhen më mirë te gjenerata e moshuar sesa te mosha e mesme dhe e re. Një dallim tjetër lidhur me diftongimin hetohet edhe ndërmjet gjinive: burrat janë të prirë të përdorin më shpesh format e monoftonguara, ndërsa gratë format e diftonguara. Kjo dukuri jo aq shumë e shprehur, por megjithatë e pranishme mund të shpjegohet me faktorët sociolinguistikë, siç janë: femrat janë të lidhura më shumë me shtëpinë dhe vendlindjen, shkollohen e lëvizin më pak e dalin më rrallë nga areali i tyre gjuhësor sesa meshkujt dhe në të shumtën e rasteve martohen brenda regjionit të tyre me diftongim.

192. Lidhur me ruajtjen e zanoreve në formë të padiftonguar ose me diftongimin e tyre në huazimet leksikore, kemi hetuar se në këtë të folme gjejmë forma dyshe. Materiali dialektor na jep prova të konstatojmë se huazimet e hershme janë diftonguar (latinizmat, greqizmat, sllavizmat e moçme të përhapura edhe në të folmet e tjera shqipe, disa fjalë orientale), ndërsa huazimet e reja përdoren me zanore të mbyllura të padiftonguara.

193. Në këtë kontekst do të japim disa shembuj me huazime sllave të diftonguara: *kosâiti*, *vêrtâiti*, *koçâiti*, *gllavêin*, *stêrvâin*, *avâitem*, *mutâin*, *koshnâic*, *varanâic*, *opshtâin*, *vêrsnâik*, *vunêic*, *greshâiti* etj. Siç duket, dukuritë gjuhësore nuk ndërpriten përnjëherë e në tërësi, por siç thotë populli aty ku ka rrjedhë, do të pikojë (në këtë rast së paku për një periudhë), dhe sipas analogjisë janë diftonguar edhe një sasi e vogël sllavizmash të vonshëm, si *opshtâin* (sllav. opshtina, komunë, bashki) e ndonjë tjetër.

194. Në të folmen e Karadakut të Shkupit në formë të padiftonguar ruhen shumica e huazimeve më të reja, si: *raki:c*, *bolni:c* 'spital', *stani:c* 'stacion', *grani:c* 'kufi', *vikat* 'bërtet', *magjari:c* 'gomare', *kni:shk*, *bukfi:c* 'librezë'; *nadni:c* 'mëditje', *protif* 'kundër', *novi:n* 'gazetë', *rabotnik* 'punëtor', *domaqin* 'nikoqir', *kori:t* 'lug', *si:t* 'sitë', *stoli:c* 'karrige', *cigëll* 'tullë', *cari:n* 'doganë', *sudi* 'gjuqtar', *sli:k* 'fotografi', *spomenik* 'përmendore', *mornari:c* 'detari, marinë', *utakmi:c* 'lojë, përballje në sport', *sijali:c* 'poç elektrik', *grejali:c* 'nxehëse ajri' etj.

195. Në këtë kontekst të mos mbetemi pa përmendur se edhe prapashtesa sllave *-icë* (me

formë në sllavishte -ica), na del në dy forma fonetike: e padiftonguar dhe e diftonguar: *-i:c, -âic*. Kështu paraqitet edhe kur kjo prapashtesë i prapavitet emrit personal të bashkëshortit për të emërtuar bashkëshorten e tij, e përhapur te të gjithë shqiptarët e Maqedonisë së Veriut. Se në çfarë forme do të përdoret kjo prapashtesë, varet nga kushtet fonetike në të cilat gjendet ajo, përkatësisht nga tingulli fundor i emrit të burrit. Thjesht edhe këtu veprojnë rregullat e njëjta si te rrethimet tingullore e cilëso fjale tjetër. Fjala vjen, diftongohet mbaresa *-i:c* në *-âic* tek emrat që mbarojnë me sonante, si për shembull pas /m/-së: Beram - *Beramâic*, Adem - *Ademâic*, Azem - *Azemâic*; pas tingëllueses /n/: Hasan - *Hasanâic*; pas /v/-së: Bilall - *Bilallovâic* etj.; por edhe te diçka emra të përveçëm të gjinisë mashkullore të cilët mbarojnë në *-at* dhe *-et*: Berzat - *Berzatâic*, Esat - *Esatâic*, Shefket - *Shefketâic* etj. Nuk diftongohet mbaresa *-i:c* te emrat që mbarojnë në /h/, /l/, /r/, /p/, /z/; si *Rizahi:c, Xhelali:c, Gafuri:c, Rexhepi:c, Abazi:c* etj.¹⁴⁹

196. Edhe te huazimet turke kemi forma dyshe: të padiftonguara, si *jeshil, katil, metil, pestil, gjigjim, gjigim; singji:r, sifir, biti:s, kurtali:s, daldi:s, terezi:, kafexhi:, bozaxhi:, hanxhi:, teneqexhi:, kojshi:* etj., dhe të diftonguara: *jacâi, xhamâi, munafâik, pazarllâik, begenâisi, insanllêik, iqindâi, askerllâik, jabanxhêi, temcâi, çivâi, axhamâi, saballâik* ...

197. Folësit e këtij regjioni toponimet i shqiptojnë në forma dyshe: ndonjë prej tyre në formë të diftonguar e ndonjë në formë të padiftonguar, varësisht nga forma burimore (ashtu siç i thonë banorët e atij vendi). P.sh: *Haraçâin, Grushâin, Traçêic, Goshâic, Strâim; Brenêic* (arë në f. Bllacë) etj. Emrat e shteteve rregullisht shqiptohen në formë të padiftonguar, si *Gjermani, Turki, Itali, Makedoni, Gërci, Sërbi, Shipni* etj.

198. Nga shembujt e sjellë, mund të nxirret si përfundim i përgjithshëm se fjalët e huazuara orientale dhe sllave në këtë areal gjuhësor përdoren në dy forma fonetike: në formë të padiftonguar (që janë më të shumtë) dhe në formë të diftonguar.

199. Po kështu, shembujt e dhënë na bindin se në formë të diftonguar përdoren huazimet e hershme turke e sllave, ndërsa huazimet e padiftonguara janë më të reja. Kjo na jep të drejtën të supozojmë se procesi i diftongimit të zanoreve të mbyllura të theksuara (si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore) ka pushuar së vepruari që në kohën e sundimit Osman në Ballkan, ose më saktësisht në periudhën e huazimeve intensive të turqizmeve dhe sllavizmave në shqipen dialektore. Thjesht, mendojmë se diftongimi ka pushuar së vepruari në periudhën kohore të gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX. Ky konstatim gjen mbështetje edhe në huazimet sllave në shqipen, meqë sllavizmat më të vjetër përdoren në formë të diftonguar, ndërsa fjalët e reja sllave në formë të padiftonguar.

200. Krahas përpjekjes dhe supozimit për të përcaktuar kohën e shuarjes së dukurisë së diftongimit në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit (sipas analogjisë edhe në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore), një është e sigurt: ***diftongimi në gegërishten qendrore tanimë tërësisht ka pushuar së vepruari***. Për të përdëftuar këtë konstatim, mund të sjellim disa argumente:

a) Format e diftonguara të fjalëve që ende përdoren (më shumë te gjenerata e vjetër, e më pak te rinia) janë trashëguar historikisht nga brezi në brez. Ndonjë fjalë sporadike e diftonguar sipas analogjisë, në këto 50 vitet e fundit, nuk e përjashton konstatimin e përgjithshëm se diftongimi në gegërishten qendrore tanimë tërësisht ka pushuar së vepruari. Nga ana tjetër, me këtë dëshmohej se dukuritë dhe rregullat në gjuhë nuk kanë karakter absolut, por veprojnë në një periudhë të caktuar e në një territor të caktuar.

¹⁴⁹ Remzi Nesimi, *Diftongimi* ..., f. 99.

b) Përveç sllavizmave dhe turqizmave të reja që përdoren në formë të padiftonguar, me pasurimin e fondit leksikor të të folmeve me fjalë të reja (neologjizma) ku ka kushte të volitshme për diftongim, fjalët e tilla përdoren të padiftonguara, ashtu siç vijnë nga burimi, si *demokraci*., *parti*..

c) Dukuria jo e rrallë e monoftongimit të diftongjeve (veçmas e [âu]-së) është një tregues i rëndësishëm për të nxjerrë në shesh dobësimin e prirjes nyjetimore të shqiptimit të diftongjeve.

ç) Përdorimi i dyzuar (në dy forma fonetike: me dhe pa diftong) të një fjale të vetme (edhe te i njëjti folës) flet për lëkundjen e këtij inovacioni fonetik. Gegërishtja qendrore, në njëfarë mënyre, është oazë gjuhësore (izoglosë e veçantë që dallon nga të folmet shqipe e joshqipe), rrjedhimisht ndaj saj kanë ndikim të fuqishëm të folmet përreth si dhe forma standarde.

2.4.8. ZANORJA [u]

201. Varianti themelor i zanores [u] në të folmen për të cilën po shkruajmë shqiptohet si *e prapme dhe e mbyllur*. Ajo është gojore, ndërsa në rrethime të caktuara variant i hundorëzuar, e në disa fjalë edhe fonemë hundore. Sipas gjatësisë mund të jetë edhe e gjatë, e mesme dhe e shkurtër.

202. Mund të gjendet në pozitë të theksuar ose të patheksuar. Sipas përndarjes mund të gjendet në fillim, në mes dhe në fund të fjalës, për shembull: a) në pozitë nistore *u:dh, u:j, ũ:(üne), ũ:ja* (uria), *i u:rt, u:fëll, uk*, (da:rdh) *ujse, udhta:r* etj.; b) në mes të fjalës: *çu:ll, liku:r, bu:rr, ku:sht; kërkun, kërkund; katun, bu:ll, gatu:n, plum, laknu:r, fun, flutër, kumëll, sumëll, grumëll, dushk, mushk, tru:ll, gru:n, murall* (< mullar), *nuk, fu:rr, fortu:n, mu:j, tërku:z, buk, fu:g, k'pu:t* etj.; c) në fund të fjalës: *drū:, prū:, hū:, mu:, gju:* etj. Rregullisht përdoret te pjesëza *tu* (tuj, duke) e përcjellores: *tu livru:, tu punu:, tu shkru:, tu shku:...*; te paskajorja geqe: *me punu:, me shku:, me laru:, me shkru:, me msu:...* Te fjalët e tilla pjesorja mbaron me [u:] të gjatë si pasojë e monoftongimit të togut zanor [ue], pra *ue > u:*.

Në fundin absolut të fjalës, zanorja [u] përdoret edhe te format pasive të mënyrës urdhërore, në vetën e dytë njëjës me pjesëz në pozicion enklitik, sipas tipit *laju!, fshâju!, ngrâitu!, qasu!, frâju!, çitju!, shtrâju!, fkatu!, bërtâitu!*.

203. Siç u tha (në kreun për gjatësinë e zanoreve), [u]-ja e gjatë në kundërvënie me të shkurtrën, në mungesë të ndonjë treguesi tjetër dallues mes dy njëjësive gjuhësore, fiton vlerë funksionale, si *buk ~ bu:k* (leksema e parë emërton pjesë të bukës, ndërsa leksema e dytë emërton një ose më shumë bukë, si tërësi); *kërkun ~ kërkun:n* ‘askund – shëtitën’; *shkun ~ shku:n* ‘shkund (diçka) – shkuan (disa në një vend)’ etj.

Shndërrimi i [u]-së në ndonjë zanore tjetër

204. Si në shumë të folme të gegërishtes, ashtu edhe në këtë të folme, në pozitë të patheksuar [u]-ja këmbëhet me ndonjë zanore tjetër, prej të cilave më të shpeshta janë këmbimete tingujve:

205. [u] > [o]: *bollâjc* (< bullicë, buallicë), *gorobija* (< gurabija) në f. Brezë, Malinë e Grushinë; *kosêj* (< kusi), *dohan* (duhan) në f. Straçincë; *orith* (urith) në f. Bllacë.

206. [u] > [i]: *misko:j* < mushkonjë, *bilmet* < bylmet, bulmet; *ishim* < ushqim etj. Emrat

që mbarojnë me [k], [g] e [h] në vend të [u]-së së zakonshme në toskërishte e në shqipen standarde (si edhe në pak të folme të gegërishtes), në këtë të folme shquhen me [i], si: *plak-i, mâik-i, xhak-i, zog-i, breg-i, shteg-i, ah-i, krah-i, qeh-i ...*

Me *-i* na dalin edhe disa folje në mënyrën dëftore në aorist në vetën e tretë të njëjësit, si: *aï e gjeg-i, e prek-i, e pakërce-ï* < kapërcei, kapërceu, kaloi (në fjalën e fundit [i]-ja del e konsonantizuar).

207. [u] > [ë]: Në krahasim me fjalëformat e gjuhës standarde, të dialektit toskë dhe të pak të folmeve gege mund të thuhet se zanorja [u] në të folmen tonë alternohet në [ë] pothuajse çdo herë në pozitë të patheksuar, kur gjenden para sonoreve [ll] dhe [r], si: *kumëll* (kumbull), *megëll* (mjegull), *setëll* (sjetull), *petëll* (petull), *vetëll* (vetull), *rrotëll* (rrotull), *grumëll*, *gjrumëll* (grumbull), *kujëll* (kungull), *mashkëll* (mashkull), *flutër* (flutur), *lepër* (lepur), *hekër* (hekur) etj.

150

E natyrshme për këtë të folme është edhe shndërrimi i [u]-së në [ë] te mbiemrat prejpjesorë (prejfoljorë): *i hecëm* (i hecur), *i pasëm* (i pasur), *i lagët* (i lagur), *i dashëm* (i dashur), *i meçëm* (i mençur), *ftohët* (i ftohur)...

208. Ndërrimi fonetik më karakteristik në lidhje me variantet e fonemës [u], si dhe për [i], është diftongimi sekondar në pozitë të theksuar.

2.4.8.1. DIFTONGIMI I /ú/-SË SË THEKSUAR

209. Fonema zanore /ú/ (si edhe /í/-ja) në rrokje të theksuar në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, si dhe në pjesën më të madhe të të folmeve të gegërishtes qendrore, realizohet shpeshherë si diftong dytësor.

210. Në krahasim me diftongimin e /i/-së së theksuar, diftongimi i /u/-së na del në më pak fjalë, ndërsa sipas shtrirjes territoriale mund të shfaqet vetëm atje ku diftongohet /i/-ja e theksuar. Megjithatë, ka disa të folme të caktuara që e diftongojnë /i/-në, por e ruajnë të pashpërbërë /u/-në, siç janë të folmet e Matit, Kalisit, Lumës etj.¹⁵¹

211. Pas analizës së fjalëve me diftongim sekondar të /ú/-së së theksuar në arealin gjuhësor të Karadakut të Shkupit, hetuam se diftongimi i /ú/-së ndodh në kushte e rrethime të njëjta fonetike si edhe shpërbërja e /í/-së. Rastet më të shpeshta e më tipike të diftongimit të /ú/-së së gjatë i vërejmë kur ajo gjendet në kontakt të drejtpërdrejtë me bashkëtingëlloret sonore.

212. Në këtë areal gjuhësor, fonemën /ú/ të diftonguar e dëgjojmë në mes e në fund të fjalës, ndërsa në pozitë nistore dëgjohet vetëm në të folmen e fshatit Straçincë: *ôudh* (< udhë), *ôudhhekës* (< udhëheqës), *ôuk* (< uk, ujk).

213. **Diftongimi i /ú/-së në mes të fjalës:** *arâush* < aru:sh (kuptohe me variantet e diftongjeve *ôu*, *êu* ose në monoftongun [a:]: *arôush*, *arêush*, *ara:sh*), *nâuse*, *na:se* < nu:se, *shâum*, *sha:m* < shu:m; *câull*, *ca:ll* < cu:ll (fëmijë); *rrâush*, *rra:sh* < rru:sh; *katâun*, *kata:n* < katu:n; *kërcâung* < kërcunj; *trâup*, *tra:p* < trup; *prâush* < prush; *shkrâun*, *shkra:n* < shkru:n, shkruen;

¹⁵⁰ Nga pikëpamja historike, kur gjendet para [ll]-së, ndonjëherë edhe para [r]-së, primare është [ë]-ja, ndërsa sekondare është [u]-ja, e fituar me velarizimin e zanores së reduktuar [ë]. Shih: Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 64.

² Remzi Nesimi, *Diftongimi i i-së dhe i u-së së theksuar ...*, f. 100.


knâus, kna:s < *knu:s*, këndues, këndes; *tâund, ta:n* < *tund*; *thâupër, thapër* < *thupër*, (pula) *kllâuk* < *kllu:k*, *klluqe*; *u gjazmâum, u gjazma:m* < *u gjazmu:m*, *u gjazmuem*, *u gëzuem*; *thâuj, tha:j* < *thu:j*, *thuej*; *krâue, kra:* < *krue*; *trâuku, traku* < *truku* (rri i qetë, qetësi); *ftôurk, fta:rk* < *turk*, *sfurk* etj.

214. **Diftongimi i /u/-së në fund të fjalës:** *thâu* < *thu:*, *thue*; *krâu* < *kru:*, *krûe*; *k'tâu* < *ktu:*, *këtu*; *kshtâu* < *kshtu:*, *kështu*; *çekshâu, çekshtâu* < *çe + kshu*, *kshtu*, *kështu*; *çekshtâune* < *çe + kshu + une*; disa pjesore të foljes, si: (kam) *shkâu* < *shku:*, *shkue*; *punâu* < *punu:*, *punue*; *larâu* < *laru:*, *larue*; *kundâu* < *këndu:*, *këndue*; (jam) *gjazmôu* < *gjazmu:*, *gjazmue*, *gëzue*; *rrâu* < *rru:*, *rrue*; *mcâu* < *mcu:*, *mësue* etj.

215. Diftongjet e tilla dytësore (sekondare), të përfutuara nga fonema e mbarë shqipes /u/ (si dhe diftongjet e prejardhura nga diftongimi i /i/-së) i trajtojmë si **monofonematike**, si **variante kombinatorre krahinore** (të gegërishtes qendrore) të fonemës /u/, meqë:

- këta tinguj të përbërë (dyzanorësh, diftongje) nuk mund të ndahen në dy rrokje, d.m.th janë të pandashëm në strukturën gjuhësore;
- shqiptohen me lëvizje të vetme e të pandashme artikulative;
- nyjëtimi i tyre nuk zgjat më shumë sesa nyjëtimi i zanoreve të gjata (sipas kohëzgjatjes së artikulimit, në të folmen tonë, si dhe në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore: një diftong = një zanore e gjatë).

216. Çështje të rëndësishme për dialektologjinë e gjuhës shqipe paraqet vrojtimi i përndarjes së varianteve fakultative të diftongjeve. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit gjejmë dy variante themelore të diftongut dytësor të /ú/-së së theksuar: [âu] dhe [ôu] dhe monoftongu [a:]. Sipas pikëpamjes se cili variant diftongu mbizotëron, në të folmet e këtij areali përvijohen tri izoglosa:



Skica 4. Variantet diftongore të fonemës /ú/

1. **Me mbizotërimin e diftongut [âu]:** f. Mojancë dhe Orllancë (me pak fjalë të

monoftonguara të [a:]; f. Luboten dhe Tanushë (me disa raste të [ôu]-së). Në të folmen e f. Tanushë vërejmë edhe dhjetëra fjalë të padiftonguara, që në të folmet tjera të këtij regjioni të njëjta diftongohen. Kjo mund të shpjegohet me ndikim e të folmeve të Kosovës.

2. **Me mbizotërimin e diftongut [ôu]:** f. Straçincë (me numër të vogël fjalësh me [âu] dhe [a:]; f. Bllacë (me disa fjalë të padiftonguara, të cila zakonisht shqiptohen me diftong në të folmet e tjera fqinj, nën ndikimin e të folmes së Kosovës) dhe

3. **Me monoftongimin e diftongjeve në zanore të pastër [a:] ose [ë].** Në katundet Brezë e Malinë dëgjojmë vetëm forma të monoftonguara të diftongut dytësor në zanore të gjatë [a:] (nâuse > na:se). Në aspektin historik, në rrjedhë të kohës që kur /ú/-ja është shndërruar në diftong, ajo si pjesë përbërëse e diftongut kuptohet se është shqiptuar si gjysmëzanore [âu], ngjashëm si [v]-ja (âu ≈ av). Duke u gjendur në pozitë të patheksuar dhe si gjysmëzanore, [u]-ja e diftongut me kalimin e kohës ka pësuar reduktim sasior (në gjatësi, kuantitativ) dhe shndërrim cilësor (kualitativ), gjithnjë me kahje drejt [ë]-së, me nyjetim gjithnjë më të paktë e më të paktë të [ë]së gjeneratë pas gjenerate, që tani të ketë dhënë [a:] të pastër. Në këtë pikëpamje, po të përpiqemi me shkrim të paraqesim rrugën e monoftongimit, përkatësisht disa nga fazat e zhvillimit fonetik, do të kishim: /ú/ > [âu] > [a^u] > [a^u] > [a^ë] > [a^ë] > [a:]. Rrugë të njëjtë zhvillimi fonetik duhet të ketë ndjekur edhe monoftongimi i /u/-së në [ë]: /ú/ > [êu] > [ê^u] > [ê^u] > [ê^ë] > [ë].¹⁵²

Ky proces fonetik me pikënisje /u/-në e mbarë shqipes, me shndërrim në diftong e në fazën e tanishme në zanore të pastër /ë/ ose /a: ka zgjatur me shekuj. Me këtë rrugë duhet të jetë përfutur nga /ú/-ja monoftongu /á:/ në të folmen e Brezës e të Malinës, dhe /ë/-ja në të folmen e Grushinës. Në fshatin Grushinë, po kështu diftongun e gjejmë të monoftonguar, me disa fjalë ku ruhet diftongu [âu] ose me monoftongun [ë] (që është përfutur nga diftongu êu): *katën, rrësh, trëp, cëng*.

217. Deri më tani, në punime e monografi dialektore për të folmet e gegërishtes qendrore janë vënë në pah raste sporadike të monoftongimit të diftongjeve, por jo edhe në përmasat e tri fshatrave të Karadakut të Shkupit: Brezë, Malinë e Grushinë (me përjashtim të vogël të fshatit të fundit). Siç u tha edhe më parë, në këto pika dialektore kemi shndërrimin e plotë të diftongut [âu] në monoftong [a:] ose [ë]. Krahaso format e fjalëve: *sha:m* (< shâum, shu:m, shumë), *tra:p* (< trâup, trup), *ca:ll* (< câull < cu:ll), *kapra:ll* (< kaprâu:ll, kapruell), *rrash* (< rrâush, rrush), *katan* (< katâun, katun), *ara:sh* (< arâush, aru:sh, arushë), *na:se* (< nâuse, nuse); *ca:c* (< câuc, cu:c, cucë); *lakna:r* (< laknu:r, laknâur, laknuer), *ftark* (< ftâurk, fturk), *prra:e* (< prrâue, prrue, përrue), *shkra:j* (< shkrâuj, shkru:j, shkruer), *fërta:n* (< fërtâun, fërtu:n, furtunë), *mashtrae* (< mashtrâue, mashtrue), *çekshta*: (< çe + kshtâu, kshtu, kështu), *çekshtane* (< çe + kshtâu, kshtu, kështu + une), *fta*: (< ftâu, ftu:, ftue); te pjesorja e disa foljeve (që dikur kanë mbaruar me togun zanor úe > ú > âu > a:), si (me) *puna*: (< punâu, punu:, punue), *msa*: (< msâu, msu:, mësue), *shtra*: (< shtrâu, shtru:, shtrue) etj.

218. Në lidhje me kronologjinë, gjegjësisht me periudhën kohore të fillimit të veprimit të procesit të diftongimit të zanoreve të ngushta në të folmet e gegërishtes qendrore janë marrë disa gjuhëtar, si K. Talavini, Mladenovi, Desnickaja, Beci, Nesimi etj. Talavini diftongimin e sheh si dukuri të re.¹⁵³ Prof. Beci duke u bazuar mbi materialin toponimik, si dhe në disa dokumente të

¹⁵² Është e njohur se /ë/-ja historikisht është përfutur nga zanoret e tjera që janë gjendur në pozita të patheksuara. Ky shndërrim i diftongut [âu] në [ë] është edhe një dëshmi shtesë për të vërtetuar konstatimin e mëparshëm.

¹⁵³ Carlo Tagliavini, *Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 120.

shkuara, konstaton se diftongimi është dukuri relativisht e re, ajo ka vepruar në fillimin e shekullit XV.¹⁵⁴ Të këtij mendimi janë edhe shumë gjuhëtarë të tjerë.¹⁵⁵

219. Shikuar nga pikëpamja e vendit të theksit, në të folmet shqipe të Karadakut të Shkupit, nga dy elementet zanore të diftongut, e theksuar shqiptohet zanorja e parë e diftongut, pra janë diftongje zbritëse,¹⁵⁶ të tipit: zanore e theksuar + gjysmëzanore = [âi], [ôi], [êi], [ëi]; [âu] dhe [ôu].

2.4.9. KONSONANTIZIMI I ZANOREVE TË PATHEKSUARA [i, u]

220. Krahas tipareve të rëndësishme fonetike e fonologjike të zanoreve të mbyllura, që i shtjelluam deri më tani, në arealin gjuhësor të Malit të Zi të Shkupit; si dhe në gjithë dialektin e Veriut, e në mbarë shqipen dialektore dhe formën e folur standarde; e shpeshtë është dukuria e konsonantizimit të zanoreve [i] dhe [u] kur gjenden në rrokje të patheksuar. Siç dihet, në rrokje të patheksuar, kur pranë tyre gjendet një zanore tjetër më e zëshme (më e fuqishme), për të lehtësuar shqiptimin (për të shmangur shqiptimin e dy zanoreve të njëpasnjëshme), zanoret e ngritjes së lartë i shqiptojmë si gjysmëzanore, ose siç themi i konsonantizojmë (nga zanore i shndërrimë në bashkëtingëllore, i bashkëtingëllorëzujmë), përkatësisht [i] në e shqiptojmë ngjashëm si [j]-në, ndërsa [u]-në e nyjëtojmë si [v]-në. Në dukurinë e konsonantizimit të zanoreve të ngritjes së lartë në rrokje të patheksuar vepron “ligji i të fortit”: tingulli më i fuqishëm e nënshtron tingullin më të dobët.

221. Shndërrimi i [i]-së së patheksuar në [j] bëhet sidomos kur në fqinjësi të [i]-së ka cilëndo zanore më të zëshme, si p.sh.: aï > aj, çai > çaj (çe + ai), shkoï > shkoj, punoï > punoj, lexoï > lexoj etj.

222. Konsonantizimi i [i] ndodh edhe te foljet në të kryerën e thjeshtë (në aorist), në vetën e tretë të njëjësit të dëftores, sipas tipit: aj shkoj < aï shkoï, aj msoj < aï mësoï, aj laroj < aï lavroï, aj çinroj < qëndroï, knoj < këndoï, maroj < mbaroï. Në ratet e këtilla [i]-ja e konsonantizuar është variant pozicional (në fund të fjalës) i fonemës /i/.

223. Shndërrimin e [i] > [j] e gjejmë edhe te disa trajta të shkurtra të bashkuara të përemrave vetorë: ja < ɣa (< ɣa = i + e), si në fjalitë // ja dhash Ali:s // 'Ia dhash Aliut'; T'ja kallxojsht t'drejten // 'T'ia tregosh të drejtën, të vërtetën. // Ja bana mâir // 'Ia bëra mirë'; ose te trajta ju < iu, si // Ju thash atâine // 'Iu thashë atyre' // Juve ju prâita ... // 'Ju ju prita'.

224. Zanorja [i] e patheksuar konsonantizohet edhe në vargun e fjalisë (në kushtet e sand'hisë sintaksore), si në pozicion enklitik, ashtu edhe në pozicion proklitik. Kështu ndodh edhe në të folmen shqipe të Karshiakës,¹⁵⁷ sipas tipit // ... kaj cigare e pijshëm // 'Nga një cigare e pinim', // vllaj maj madh // 'vëllai më i madh' etj.

225. E ngjashme na paraqitet gjendja edhe me humbjen e aftësisë rrokjeformuese të zanores [u], përkatësisht me konsonantizimin e [u] > [v]. Kjo dukuri fonetike na paraqitet te disa folje në të kryerën e thjeshtë në vetën e tretë njëjës, si: e pëiv < e piu, e dav < e ndau, e shav < e

¹⁵⁴ Bahri Beci, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, ..., f. 19-20.

¹⁵⁵ Remzi Nesimi, *Diftongimi i i-së dhe i u-së* ..., f. 88.

¹⁵⁶ Diftongjet zbritëse trajtohen si diftongje të mirëfillta: R. Simeon, 1969, 233-234; Савицка - Спасов, 1997, f. 36; Dodi - Gjinari, 1983, f. 57-58 etj.

¹⁵⁷ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e ...*, f. 66.

shau, *e çav* < e çau, *e prev* < e preu, *e thev* < e theu, *e thav* < e thau, *e kthev* < e ktheu etj. Trajta e shkurtër e bashkuar **ua** në arealin tonë gjuhësor, rregullisht përdoret me [u] të konsonantizuar, në formën **va**. P.sh.: *va thash* < ua thash, *va di* < ua di, *mâir va bani* < mirë ua bani, *d'va kallxojsh* < t'ua kallëzosh ...

226. Ky konsonantizim, në të vërtetë, që ndodh për shkak të lehtësimit të shqiptimit (për të shmangur shqiptimin e njëpasnjëshëm të dy zanoreve) bëhet jo vetëm në gjithë shqipen dialektore (në Veri e në Jug), por edhe në formën e folur të ligjërimin letrar. Por, me të drejtë konsonantizmi, si dhe një varg dukurish të tjera fonetike, nuk pasqyrohet në shkrim; d.m.th. nuk zbatohet parimi fonetik: siç flasim të shkruajmë, por me të drejtë përfillet parimi morfologjik, që synon ruajtjen e qëndrueshme të formave morfologjike të fjalëve, pavarësisht shqiptimit. Kjo ka bërë që në shqipen standarde të dallohet (në shkrim) veta e parë me mbaresën vetore -j, nga veta e tretë me -i, duke shmangur homofoninë.¹⁵⁸

2.4.10. ZHBUZORËZIMI I [Y]-SË DHE DIFTONGIMI DYTËSOR I SAJ

227. Dihet se në shumë të folme të shqipes si dhe në shqipen standarde ka një zanore (që ka statusin e tingullit e të fonemës) që në variantin themelor të saj realizohet si e mbyllur, e përparme dhe e buzorëzuar [y]. Kjo zanore është pak më e hapur dhe më e prapme se zanorja [i].

228. Brendapërbrenda sistemit të fonemave zanore të shqipes realizohen tri kundërvënie: *kundërvënia e shkallës së hapjes*, *kundërvënia e vendit të formimit* (apo e radhës së formimit) dhe *kundërvënia e buzorëzimit*.

229. Sipas *tiparit të buzorëzimit* kemi kundërvënien e zanoreve të buzorëzuara e të pabuzorëzuara. Tipari i buzorëzimit është i vetmi mjet për t'i dalluar fonemat e çiftit /y ~ i/.

230. Pra, zanoret /y/ ~ /i/ formojnë një kundërvënie mohore, gjymtyrët e së cilës karakterizohen njëra nga prania, tjetra nga mungesa e tiparit të buzorëzimit. Këto dy fonema formojnë një çift korrelativ, i cili në sistemin e zanoreve të shqipes është i papërsëritshëm, paraqitet i veçuar; sepse tipari dallues i buzorëzimit që karakterizon këtë kundërvënie nuk përsëritet në asnjë nga kundërvëniet e tjera të këtij sistemi.

231. Grupi i të folmeve të gegërishtes qendrore që përfshin Krujën, Matin, Mirditën, Lurën, Lumën, Peshkopinë, Dibërën, Gostivarin, Tetovën, Kërçovën, Prilepin, Krushevën, të folmet gege të Strugës,¹⁵⁹ Shkupin e Kumanovën kanë zhvilluar disa risi (inovacione) fonetike, si: diftongimin e zanoreve të theksuara [i, u] në pozicione të caktuara fonetike; zhbuzorëzimin e [y]-së në [i] e më pas shpërbërjen e saj në diftongje dytësore; qiellzorizimin e [g]-së në [gj] (go:j > gjo:j, gisht > gjisht, gatuj > gjatu:j, magar > magjar etj.).

232. Zanorja /y/ ruhet në të folmen e Rekës së Epërme, në të folmet shqipe të Prilepit e Krushevës (me dallim se në këto të folme y-ja shpeshherë diftongohet, bile edhe në pozitë


¹⁵⁸ Parimi fonetik i drejtshkrimit synon vendosjen e një lidhjeje sa më të ngushtë midis trajtës së shkruar dhe trajtës së folur, d.m.th. shkruhet ashtu siç flitet në shqiptimin letrar dhe lexohet ashtu siç është shkruar. Parimi morfologjik kërkon që morfemat (rrenjë, parashitesat, prapashitesat, mbasesat) të shkruhen gjithnjë njëllë, pavarësisht se mund të shqiptohen ndryshe për shkak të ndërrimeve pozicionale a kombinatorë të fonemave. Shih: Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011, f. 53-56.

¹⁵⁹ Ajten Qamili, *E folmja shqipe e Strugës (në kontekstin ballkanik)*, arkivi i Fakultetit të Filologjisë "Bllazhe Koneski" (disertacioni doktorati), Shkup, 2012, f. 75-77.

nistore, në ây: âyll (< yll), âymër (< ymër) etj.¹⁶⁰

233. Në të folmen shqipe të Karadikut të Shkupit fonema /y/ nuk është pjesë përbërëse e inventarit vokalik të saj, meqë ajo është shndërruar në zanoren [i] e më rrallë në [u]. Në kushte të caktuara fonetike, pas monoftongimit në [i] të theksuar, kjo e fundit ka pësuar diftongim dytësor, duke ndjekur të njëjtën rrugë shpërbërjeje si edhe /i/-ja parësore.

234. Zhbuzorëzimi i [y]-së në [i] mund të shpjegohet me prirjen për lehtësimin e shqiptimit, meqë te [y]-ja nyjëtimet themelor (si e përparme, e mbyllur) i shtohet edhe buzorëzimi. Nga ana tjetër, ngarkesa funksionale e kundërvënies së fonemave /i/ ~ /y/ në gjuhën shqipe nuk është e madhe, sepse me këtë kundërvënie dallohen një numër jo i madh fjalësh. Të tilla janë: /mik/ ~ /myk/, /pika/ ~ /pyka/, /di/ ~ /dy/, /rrymë/ ~ /rrimë/, /ti/ ~ /ty/, /mbill/ ~ /mbyll/, /sitë/ ~ /sytë/, /si/ ~ /sy/, /shita/ ~ /shyta/, /krihet/ ~ /kryhet/, /hija/ ~ /hyja/, /ndrij/ ~ /ndryj/, /hiri/ ~ /hyri/, /pije/ ~ /pyje/, /shtihem/ ~ /shtyhem/, /lihet/ ~ /lyhet/, /lihej/ ~ /lyhej/, /lira/ ~ /lyra/, /kiç/ ~ /kyç/ etj. Kjo shpjegohet me faktin që fonema /y/ përdoret në një numër relativisht të vogël fjalësh (në shumicën e rasteve si zanore e theksuar). Por duhet thënë se, megjithëqë përhapja e kësaj foneme është më e vogël se ajo e fonemave të tjera, denduria e përdorimit të saj nuk është e parëndësishme, meqë /y/-ja bën pjesë në disa nga fjalët më të përdorshme të gjuhës sonë, si p.sh. *sy, dy, ynë, yt, aty, pyll, yll, mbyll, hyj, shtyj, thyej, lyej* etj. Grafikisht kundërvënien sipas tiparit të buzorëzimit mund ta paraqesim kështu:¹⁶¹



Skica 5. Kundërvënia e fonemave zanore të shqipes standarde sipas buzorëzimit

235. Zhbuzorëzimi i [y] > [i] është proces i përfunduar në të folmen shqipe të Karadikut të Shkupit, meqë [y]-ja është shndërruar plotësisht në [i], si në fjalët: *di* < *dy*, *ill* < *yll*, *dri* < *dry*, *ki* < *ky*, *irt* < *yrt*, *it* < *yt*, *çimir* < *qymyr*, *drishk* < *dryshk*, *mik* < *myk*, *bik* < *byk*, *gri:k* < *grykë*, *dilber* < *dylber*, *klissh* < *klysh*, *hin* < *hyn*, *tli:n* < *tëlyen*, *çish* < *çysh*, *çiçe* < *qyqe*, *babgjish* < *babagjysh*, *gji:mc* < *gjysmë*, *li:j* < *lyej*, *sinet* < *synet*, *dishek* < *dyshek* etj.

236. Pas delabializimit të [y]-së në [i] në rrethana të volitshme fonetike për shpërbërje (në të njëjtat rrethana që diftongohet edhe [i]-ja: në rrokje të theksuar, sidomos kur është e gjatë, në trup e në fund të fjalës, në rrokje të hapur, në fqinjësi me sonante etj.), fonema /y/ ka pësuar diftongim dytësor (sekondar) sikur /i/-ja.

237. Variantet e diftongjeve dytësore të zanoreve të mbyllura /y/ dhe /i/ janë plotësisht të njëjta. Pas zhvillimit fonetik të zhbuzorëzimit e të diftongimit, përkatësisht të shndërrimeve /y/ > /i/ > [âi], [êi], [ëi] në arealin gjuhësor të Karadikut të Shkupit janë përfutur format e fjalëve: *tâi*, *têi*, *tëi* < *ty*, *sâi* < *sy*, *tâim* < *tym*, *u thâi* < *u thye*, *nrâishe* < *ndryshe*, *fâill* < *fyell*, *frâi* < *fryej*, *e*

¹⁶⁰ Mustafa Ibrahim, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Shkup, 2005, f. 78.

¹⁶¹ Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011, f. 202-203.

pâiti < e pyeti, *ftâir* < fytyrë, *u thkâi* < u kthye (me metatezë), *pâik* < pykë, *frâim* < frymë, *krâie* < krye, *nâie* < nyje, *i thâim* < i thyem etj.

238. **Velarizimi i [y]-së në [u]**. – Në të folmen tonë, te pak fjalë, rëndom te huazimet orientale [y]-ja është velarizuar në [u], si: *shut* < shyt, *umut* < ymyt, *shuqur* (shiqir) < shyqyr, *duqan* < dyqan, *dunja* < dynja, *musafir* < mysafir, *musliman* < mysliman, *burek* < byrek etj.

2.4.11. DIFTONGIMI, MOSDIFTONGIMI DHE MONOFTONGIMI

239. Nga monografitë dhe skicat dialektore mund të nxirret si përfundim se në grupin e të folmeve të gegërishtes qendrore në pozita të caktuara fonetike në formë të diftonguar përdoren jo pak fjalë shqipe, huazime latine, greke si dhe huazime të hershme sllave e turke. Përgjithësisht, huazimet e vonshme sllave shqiptohen të padiftonguara, si *rakí*, *bolní:c* < bollnica ‘spital’, *staní:c* < stanica ‘stacion’, *graní:c* < granica ‘kufi’, *stolí:c* < stolica ‘karrige’ etj. Edhe te huazimet turke kemi forma të dyfishta, të padiftonguara, si *jeshil*, *katil*, *pestil*, *gjigjim*, *sifir*, *bitis*, *kurtalis*, *terezi* etj. dhe të diftonguara, si *xhamâi*, *munafâik*, *pazarllâik*, *begenâis*, *iqindâi*, *askerllâik*, *temcâi*, *çivâi*, *axhamâi*, *saballâik* etj. Edhe toponimet anase shqiptohen në formë të diftonguar, si p.sh. në Karadakun e Shkupit: *Haraçâin* ‘Haraçinë’, *Grushâin* ‘Grushinë’, *Traçêic* ‘Straçincë’ etj. Emrat e shteteve dhe të vendeve të tjera, folësit e kësaj ane i shqiptojnë në formë origjinale, pra të padiftonguar, si *Gjermani*, *Turki*, *Itali*, *Makedoni*, *Gërci*, *Sërbi*, *Shipni* etj.

240. Fillimet e dobësimit të diftongimit të zanoreve të mbyllura, si proces, në të folmet e gegërishtes qendrore i hasim që nga periudha e vonshme e sundimit turk në Ballkan, përkatësisht gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. Lidhur me këtë, një gjë është e sigurt: diftongimi në të folmet e gegërishtes qendrore ka pushuar së vepruari. Është e natyrshme që format e diftonguara të ruhen brez pas brezi, por fjalët e reja shqipe dhe huazimet e kohës edhe nga pjesëtarët e gegërishtes qendrore tani përdoren në formë të padiftonguar, si *liri*, *demokraci*, *parti*, *radi* etj.

241. Në të folmet e gegërishtes qendrore hetohet edhe prirja e monoftongimit të diftongjeve dytësore, të përfuara nga /i/-ja e theksuar, si p.sh. *calli* < *câilli* < *ca'lli* < *cilli* < *cili*, që dëgjohet në gjithë arealin e Karadakut të Shkupit dhe në pjesën më të madhe të gegërishtes qendrore. Monoftongim të diftongut [âi] kemi dëgjuar edhe në zonën e Shkupit: *mbëllshna* < *mbêllshna* < *mbillshna* (f. Straçincë), *she* < *shêi* < *shi* (f. Bllacë). Në këtë të folme te i njëjti folës dëgjohen dy format: *sêi* – *si*, *temcêi* – *tepsi*, *mullêi* – *mulli*, *mêi* – *mi*, *shpâi* – *shpi*, *kusâi* – *kusi* etj.

242. Edhe në të folmen e Malësisë së Sharrit të Tetovës e njëjta fjalë në disa lokalitete përdoret me zanore të diftonguar e në disa të tjera të padiftonguar, si *vâiç* – *viç*, *mâish* – *mish*, *mâiç* – *miç*, *mâiz* – *mi:z*, *atâi* – *ati(j)* etj. (Sulejmani, 2006 : 83-84). Në të folmen e Karshiakës (Ymeri, 1997 : 54), si edhe të folmen e Tetovës janë shënuar disa fjalë të monoftonguara, si *nep* < *nip* < *nip*, *mek* < *mêik* < *mik*, *trem* < *trêim* < *trim*, *fes* < *fêis* < *fis* etj. (Nesimi, 1997 : 87. Monoftongimi [êi > e] dëgjohet edhe në Lurë e në Mat (Beci, 1962/2, : 242), më pak në Krujë (Gjinari, 1964 : SF, 3, 4) e më shumë në Mirditë (Beci, 1982 : DSh, IV).

243. Në të folmen shqipe të Malit të Zi të Shkupit prirja e monoftongimit të diftongjeve

është shumë e shprehur, sidomos në të folmen e fshatit Brezë dhe Grushinë ku diftongu [âu] është monoftonguar plotësisht në [a:] të gjatë, sipas tipit *sha:m* < shumë, *trap* < trup, *call* < cullë 'fëmijë', *rra:sh* < rrush, *nase* < nuse, *ca:c* < cucë, *lakna:r* < laknur 'laktor', *fta:rk* < turk 'cfurk', *prrae* < përrue 'përrua', *shkra:j* < shkruaj 'shkruaj', *fërtan* < furtunë, *mashtae* < mashtrue, *çekshita*: < çekështu (çe+kështu 'ja+kështu'), *fta*: < ftue, (me) *puna*: < me punue, (me) *msa*: < me mësue, (me) *shtra*: < me shtrue etj.

244. Ky monoftongim duhet të jetë kryer shkallë-shkallë. Pas diftongimit të [u]-së në [âu], kjo [u] e konsonantizuar e diftongut (e ngjashme me shqiptimin e [v]-së) në pozitë të patheksuar në rrjedhë të kohës ka pësuar reduktim në cilësi dhe në gjatësi, duke u shqiptuar gjithnjë e më dobët, derisa të ketë humbur krejtësisht që tani të dëgjohet vetëm një [a:] e pastër, sipas tipit *shumë* > *shâum* > *sha^um* > *sha^um* > *sha^ëm* > *sha^ëm* > *sha:m*.

245. Në vëzhgimin tonë për të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit kemi vërejtur se te mosha e vjetër diftongjet ruhen më mirë sesa te gjenerata e mesme dhe e re. Një dallim tjetër lidhur me këtë dukuri vërehet edhe ndërmjet gjinive: burrat përdorin më dendur format me monoftong, ndërsa gratë forma të diftonguara. Kjo dukuri mund të shpjegohet me faktorët sociolinguistikë, me marrëdhëniet e folme – gjuhë e përbashkët kombëtare, duke shqyrtuar raportet e izoglosës së kufizuar të diftongimit ndaj shqipes tjetër dialektore e letrare pa diftongim dytësor, shkallës së arsimimit të popullatës etj.

246. Përgjithësisht mund të thuhet se femrat kanë qenë dhe në disa vende ende janë më ruajtëse sesa meshkujt: kanë qenë më shumë të lidhura për familjen dhe rrethinën, përkatësisht kanë lëvizur ose lëvizin më pak nga vendi dhe rrallë dalin nga areali i tyre gjuhësor, janë shkolluar më pak sesa meshkujt dhe njohin më pak ose nuk njohin gjuhë të huaja etj.

247. Procesin e monoftongimit e kanë ndihmuar dhe po e përshpejtojnë disa faktorë:

a) Grupi i të folmeve të gegërishtes qendrore me diftongje dytësore është një izoglosë e veçantë gjuhësore e dallueshme nga të folmet e tjera shqipe përreth dhe gjuhët e tjera joshqipe në takim.

b) Te të gjitha gjuhët standarde ballkanike nuk ka diftongje dytësore, prandaj krahas shqipes së përgjithshme dialektore dhe asaj standarde, edhe gjuhët e huaja (pa diftongje) kanë ndikim të madh në zvogëlimin e dendurisë së përdorimit të formave të diftonguara.

c) Dialektizmat fonetike që i shqiptojnë në formë të diftonguar pjesëtarët e gegërishtes qendrore kanë përhapje të ngushtë territoriale dhe si forma të dallueshme fonetike nga grupet e tjera të të folmeve shqipe, rrjedhimisht edhe jonormative, shpeshherë përqeshen e kritikohen nga të tjerët.

ç) Me shkollimin në masë të shqiptarëve, me ndikimin gjithnjë e më të fuqishëm të medieve, me lëvizjen tonë brendakombëtare gjithnjë e më të shpeshtë, me lidhje miqësore krahinash të ndryshme, me komunikimin më intensiv (sidomos tani nëpërmjet Internetit) etj.; format e diftonguara të fjalëve po zëvendësohen me ato të padiftonguara dhe si rrjedhojë: denduria e përdorimit të fjalëve të diftonguara në gegërishten qendrore gjithnjë e më tepër po zvogëlohet.

248. Monoftongimi i diftongjeve dytësore, bashkë me disa dukuri të tjera njësuere të përgjithshme të gegërishtes drejt shqipes standarde, siç janë: çhundorëzimi i zanoreve, zbehja e vlerës fonologjike të zanoreve të gjata, zvogëlimi i nuancave tingullore (alofoneve) të fonemave të njëjta, zëvendësimi i formave morfologjike lokale me format e shqipes standarde si dhe shumë

zhvillime të tjera rrafshuese, bashkë me ngritjen e përgjithshme të kulturës gjuhësore ndër ne (duke lënë anash disa thyerje të normës letrare në praktikën tonë gjuhësore), janë tregues të mirë se dialektet dhe gjuha shqipe përgjithësisht po ecën me hapa të shpejtë drejt njësimiit gjuhësor kombëtar. Ky konvergjim i dialekteve të gjuhës sonë çdo ditë e më tepër po intensifikohet.

2.4.12. TOGJET E ZANOREVE

249. Në gjuhën shqipe, në rrjedhën e të folurit ndodh që të shqiptohen njëra pas tjetrës dy a më shumë zanore (përrua, kuadër, kuotë, mësuese, diell, kau, punoi etj.). Po qe se dy zanore në kontakt shqiptohen veçmas, duke formuar secila rrokje më vete, kemi tog a grup zanoresh. Te togjet e zanoreve theksi bie në zanoren e parë. Kur njëra nga dy zanoret e njëpasnjëshme nuk e ruan mëvetësinë, përkatësisht nëse e humb aftësinë rrokjeformuese, nëse konsonantizohet, atëherë formohet diftong. Në këtë pikëpamje, shqipja ka togje të shumta zanoresh e diftongje fonetike.¹⁶² Diftongjet fonologjike janë të rralla në shqipe, shfaqen kryesisht te pak huazime latine (kuadër, kuarç, kuotë, akuarium, kolokuium, kuorum, sandviç (nga ang. sandwich)¹⁶³ e ndonjë tjetër.

250. Sipas babait të albanologjisë, prof. Eqrem Çabejt, diftongjet dhe togjet e zanoreve në gjuhën shqipe historikisht burojnë nga zanore të mirëfillta (të pastra).¹⁶⁴ Përgjithësisht dihet se te togjet e zanoreve varësisht se cila nga to ka qenë e theksuar, ajo është ruajtur deri në ditët e sotme, ndërsa zanorja e patheksuar e togut është reduktuar deri në rënie të plotë.

251. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, në bazë të materialit burimor, kemi ardhur në përfundim se grupet e zanoreve në gjendjen e sotme janë të larmishme: të ruajtura, të reduktuara, njëra nga zanoret e diftonguar e më vonë e monoftonguar. P.sh.:

a) togu zanor [ue] kryesisht ruhet: *grue, thue, ftue, krue* etj.;

b) [úe] > [u:] rëndom te pjesoret e reduktuara të foljeve, në shembujt që po japim tani edhe në format e paskajores, si *me shku:, me punu:, me gërku:, me laru:* etj.;

c) [úe] > [ú:] > [âu] > [au] > [á:] rregullisht në f. Brezë e Malinë, në disa fjalë në f. Grushinë, në format pjesores, rrjedhimisht edhe të paskajores *me puna:* 'me punu:', *me mca:* 'me msu:', *me mara:* 'me maru:', *me lavra:* 'me lavru:', *me lexu:* 'me lexu:' etj.

ç) [úe] > [âue] > [aue] > [áe]: në f. Brezë, Malinë, te disa fjalë edhe në Grushinë kemi vënë re se te disa fjalë [u]-ja është diftonguar në [âu], duke u ruajtur [e]-ja e grupit zanor, që ka dhënë grupin zanor [ae]. Në vrojtimin tonë, kemi arritur të regjistrujmë disa fjalë me togun zanor [ae]: *ftue > ftâue > ftae, thue > thâue > thae, krue > krâue > krae, përrue > prrâue > prrae, mashtrue > mashtrâue > mashtrae.*

252. Togjet e vjetra vokalike [ae, oe] ruhen: *pae, lae, thae.* Hetohet edhe përdorimi i togut zanor [ae] me [-v-]-në të ndërfitur (epetentike) për të zhdukur hiatin (a-v-e), veçmas në f. Grushinë: *e pave, e lave, thave* etj. Përgjithësisht, grupi [oe] shqiptohet i pandryshuar, si në fjalët: *voe, venroe;* por në f. Grushinë dëgjuam një fjalë pa zanoren e dytë: *vo:* 've-zë'.

253. Si togjet e tjera të zanoreve të mësipërme, ashtu edhe [ie]-ja në disa fjalë ruhet e

¹⁶² Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011, f. 129-133.

¹⁶³ Rami Memushaj, *Diftongjet e shqipes standarde*, Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare, Universiteti Eqrem Çabej, Gjirokastër, Tiranë, 2004, f. 233-244.

¹⁶⁴ Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1987, f. 122.

paprekur: *kie* (qe), *kie* (ke) si dhe në formë të monoftonguar:

a) [ie] > [i:] si te fjalët diell > *di:ll*, qiell > *çi:ll*, miell > *mi:ll*, e diel > e di:ll etj.;

b) [ie] > [je] > [e:]: pëshkë > pjeshk > *pe:shk*, mbiellë > mbjell > *mbe:ll*, dhietë > dhjet > *dhe:t*, i piekëm > i pjekëm > *i pekëm*, (me) vielë > vjel > *ve:l*, piellë > pje:ll > *pe:ll*, siellë > sje:ll > *se:ll*, viehërr > vjehërr > *vehërr*, miekërr > mjekërr > *mekërr*, *njekërr* (forma e fundit e regjistruar në katundet Brezë e Malinë).¹⁶⁵

254. Takime zanoresh të ndryshme, ndonjëherë edhe të njëjta, përftohen me rënien e një bashkëtingëlloreje midis dy zanoresh, veçmas me rënien e [h]-së, si: *preën* (< prehën), *kraën* (< krahën) në f. Straçincë; *laesh*, *laet* (< lahesh, lahet); *ktheesh*, *thkeesh* (kjo e fundit me metatezë të formës kthehesh) etj.

¹⁶⁵ Te shembujt e dhënë grupi [ie] ka kaluar në diftong ngjitës, e pastaj është monoftonguar në zanore të theksuar rrokjeformuese [e].

2.5. SISTEMI I BASHKËTINGËLLOREVE

1. Me synimin që të përcaktojmë inventarin e fonemave bashkëtingëllore të të folmes shqipe të Karadakut të Shkupit, raportet e tyre në këtë sistem, realizimet fonetike të tyre, ndërkëmbimet, frekuencën dhe distribuimin e tyre, do të përpiqemi të paraqesim veçoritë kryesore të çdo bashkëtingëlloreje e grupeve konsonantike veç e veç.

2. Në të folmen shqipe të Malit të Zi të Shkupit, nga pikëpamja nyjëtimore si dhe nga aspekti fonologjik, kemi dy areale gjuhësore:

a) areal me 30 fonema bashkëtingëllore, dhe

b) areal me 29 fonema bashkëtingëllore.

3. Këto dy nënareale dallohem vetëm me: a) mungesën e fonemës /η /, b) ndërsa areali i dytë me praninë edhe të kësaj bashkëtingëlloreje prapagjuhore, mbylltore, sonante, hundore e përfituar nga përngjashmimi i grupit /ng/, që e kanë shumica e të folmeve të gegërishtes verilindore si dhe shtrirje edhe më të gjerë.

- a) 5 buzore: /p/, /b/, /m /; /f/, /v/;
- b) 17 bashkëtingëllore paragjuhore: /t/, /d/; /l/, /ll/; /c/, /x/; /s/, /z/ ; /n/; /r/, /rr/; /ç/, /xh/; /sh/, /zh/, /th/, /dh/;
- c) 4 bashkëtingëllore mesgjuhore: /q/, /gj/; /j/, /nj/;
- ç) 3 bashkëtingëllore prapagjuhore: /k/, /g/, /η/;
- d) 1 bashkëtingëllore glotale: /h/.

4. Bashkëtingëlloret e këtij areali, mund t'i paraqesim jo vetëm sipas organit aktiv që formon pengesën, por edhe sipas organit pasiv ku formohet pengesa. Në bazë të organit pasiv bashkëtingëlloret e të folmes sonë, në përputhje me të arriturat e fonetikës, mund të emërtohen dhe të degëzohen në:

- 1. *alveolare-dhëmbore* (alveodentale): [t, d, ll].
- 2. *alveolare*: [c, x, s, z, n, l, r, rr].
- 3. *ndërdhëmbore* (interdentale): [th, dh].
- 4. *paraqiellzore* (alveolare-qiellzore, alveopalatale): [ç, xh, sh, zh].
- 5. *qiellzore* (palatale): [q, gj, j, nj] dhe
- 6. *prapaqiellzore* (postpalatale): [k, g, η, h].¹⁶⁶

5. Bashkëtingëlloret e dhëna mund të ndahen edhe në bazë të shkallës së zëshmërisë (pjesëmarrjes së zërit a të zhurmës, përkatësisht a janë të tingullta apo janë zhurma), në dy grupe përkatëse, në:

- a) sonante – të tingullta (8) : /j/, /nj/, /m/, /n/, /r/, /rr/, /l/, /ll/;
- b) obstruente (22) : /p/, /b/; /t/, /d/; /th/, /dh/; /k/, /g/, /η/; /q/, /gj/; /f/, /v/; /c/, /x/; /ç/, /xh/; /s/, /z/; /sh/, /zh/, /h/.¹⁶⁷

¹⁶⁶ Për [h]-në pengesa formohet në laring, në shtegthin e zërit, ndaj kjo quhet *glotale* ose *laringale*.

¹⁶⁷ Dihet se bashkëtingëlloret e tingullta (sonantet) ndahen në: hudore [m, n, nj]; dridhëse [r, rr] dhe lëngëzore [l, ll]. Obstruentet ndahen në a) bashkëtingëllore të zëshme dhe në b) të shurdhëta. Bashkëtingëlloret e shurdhëta janë zhurma të thjeshta, kurse të zëshmet janë tone të shoqëruara me zhurma. Pjesëmarrja ose mospjesëmarrja e tejzave

6. Bashkëlidhja sipas zëshmërisë përbëhet nga dhjetë çifte: bashkëtingëllore të zëshme ~ bashkëtingëllore të shurdhëta. Në njërin areal të kësaj të folmeje, bashkëtingëllorja e zëshme [ŋ] nuk ka korrespondues të shurdhët, ashtu siç nuk ka bashkëtingëllorja e shurdhët [h] përgjegjëse të zëshme jo vetëm në Karadakun e Shkupit, por as në mbarë shqipen. Kjo që u tha, po të paraqitet në tabelë do të duket si më poshtë:

të zëshme	b	d	dh	g	ŋ	gj	v	x	xh	z	zh	
të shurdhëta	p	t	th	k	-	q	f	c	ç	s	sh	h

7. Sistemi konsonantik i të folmes shqipe të Karadakut të Shkupit, po të paraqitet në tabelë fonologjike na del kështu:

		buzore	dhëmbo re	alveolar e	paragjuh ore	mesgjuh ore	prapagju hore
mbylltore	të shurdhëta	p	t	c	ç	q	k
	të zëshme	b	d	x	xh	gj	g
hundore		m		n		nj	(ŋ)
fërkimore	të shurdhëta	f	th	s	sh		h
	të zëshme	v	dh	z	zh	j	
anësore			ll	l			
dridhëse	të shurdhëta			r			
	të zëshme			rr			

2.5.1. BASHKËTINGËLLORET DYBUZORE

8. Kjo e folme, si edhe mbarë shqipja dialektore e standarde, njeh dy nëngrupe të bashkëtingëlloreve buzore, si: dybuzore (bilabiale): /p/, /b/, /m/ dhe buzore-dhëmbore (labiodentale): /f/ dhe /v/.

Dybuzorja e shurdhët [p]

9. Bashkëtingëlloret mbylltore dybuzore /p/ ~ /b/, të pranishme në të gjitha të folmet shqipe, janë trashëguar nga gjuha mëmë indoevropiane.¹⁶⁸

10. Bashkëtingëllorja [p] është **dybuzore, mbylltore, shpërthyesë dhe e shurdhët**. Ajo përdoret në të gjitha pozitat, në fillim, në mes dhe në fund të fjalës, si: *pupli pule, pe:s, pite, pë:, punto:r, pare, pra:j, prap; kollpite, pepën, shipe; krâip, rrâip, lip, trâup, dallap* etj.

11. Karakterizohet me përdorim të qëndrueshëm, stabil. Megjithëkëtë, nga materialet tona

të zërit në nyjetim përbën tiparin kryesor për ndarjen e bashkëtingëlloreve në të zëshme dhe në të zhurmëta. Në nyjetimin e bashkëtingëlloreve të zëshme tejtat e zërit tendosen dhe dridhen. Përkundrazi, te bashkëtingëlloret e shurdhëta tejtat e zërit nuk tendosen dhe nuk dridhen. Këto njohuri të përgjithshme fonetike, vlejné për të gjitha gjuhët e botës, përfshirë edhe mbarë shqipen (dialektore e standarde).

¹⁶⁸ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 205.


dialektore të mbledhura në terren kemi hasur shembuj ku [p]-ja ka kaluar në çiftin e saj të zëshëm [b], si te fjala *dhelbën* < dhelbën të regjistruara në Bllacë, Grushinë, Brezë dhe Straçincë. Në këtë areal, para [z]-së së zëshme, bashkëtingëllorja [p] zëshmohet në fjalën: *pubza* < pupëza. Në këtë të folme e njëjta kalon në /m/ te fjalët: *temcâi* < tepsî, *pumli* < pupli < pupël, pupli etj.

12. Për dialektologjinë e gjuhës shqipe interes të veçantë paraqesin zhvillimi i grupeve konsonantike [pl] dhe [pj]. Në lidhje me këtë, kemi hetuar se në shumë fshatra të kësaj të folmeje: Tanushë, Bllacë, Grushinë dhe Mojancë [pl]-ja ruhet, ndërsa [pj]-ja redukohet në [p]; kurse [pl]-ja dhe [pj]-ja në fshatrat Luboten dhe Straçincë qiellzorëzohen në [q]. Në të folmen e f. Brezë e Malinë [pl] > [q], ndërsa [pj] > [p]. Këto bashkëtingëllore palatale (gjatë zhvillimit të tyre historik si grupe konsonantike) nuk janë afrikatizuar. Rrjedhimisht, nga zhvillimi i grupeve [pl] në [pj] kjo e folme mund të ndahet në dy izoglosa (e folmja e f. Brezë e Malinë midis dy izoglosave). Në këtë kuptim kemi:

a) **Ruajtjen e grupit [pl] dhe reduktimin e [pj] > [p]**. - Në grupin e parë bëjnë pjesë (siç u tha edhe më lart) e folmja e Bllacës, Grushinës, Orllancës, Mojancës dhe Tanushës; ku grupin konsonantik [pl] e përdorin si të tillë: *plak, plesht, pla:çk, plep, pluhën, pleh, plum, plot, plasi, planc* etj. Po kështu, grupi [pj], përveç në të folmet e përmendura, përngjashmohet në [p] edhe në fshatrat Brezë e Malinë, si: *u pek buka, ka pe:ll, pepën, pe:shk* etj.

b) **Qiellzorizimin e grupeve [pl] dhe [pj] > [q]**. - Në të folmet e fshatrave Luboten, Straçincë, Malinë e Brezë grupi konsonantik [pl] është palatalizuar në [q]. Gjithsesi gjendja e sotme e palatalizimit të plotë është rezultat i zhvillimit që ka ecur nëpër disa faza: *pl > pj > pq > q*. Të gjitha fazat e këtij zhvillimi edhe sot gjallojnë nëpër të folmet e gegërishtes qendrore. Në këto fshatra grupi [pl] shqiptohet si një qiellzore e mirëfilltë. Për shembull: *qak, qesht, qep, quhën, qeh, qum, qot, qanc, qasi, qihu:r* etj. Te fjala *pla:nc* në fshatin Luboten dhe Straçincë, përveç formës në formë të palatalizuar (qanc), kemi dëgjuar edhe një formë fonetike të saj me [s]-në protetike: *sqanc*.

Në katundet Luboten dhe Straçincë [pj]-ja palatalizohet në [q]. Krahaso shembujt: *u qek buka* < *u pjek buka*, *qe:shk* < *pjeshkë*, *ka qe:ll* < *ka pjellë*, *qeglla* < *pjergulla* etj.; ndërsa në fshatin Brezë e Malinë reduktohet në /p/:



Skica 6. Ruajtja ose qiellzorëzimi i grupit bashkëtingëllor [pl]

13. Siç dihet, ruajtja e grupit [pl], [pj] etj. është karakteristike për të folmet e Kosovës (si përgjithësisht në nëndialektin verior të gegërishtes), ndërsa palatalizimi i tyre është tipar dallues i të folmeve të gegërishtes qendrore. Larmia e përdorimit të varianteve fonetike të grupeve [pl], [pj] në këtë areal gjuhësor (në katër katunde ruhet, ndërsa në tri të tjera është shndërruar në [q]), mendojmë se arsyetohet me shtrirjen gjeografike që ka Karadaku i Shkupit. Me fjalë të tjera, ruajtja e grupeve [pl] dhe [pj] në këtë të folme është rrjedhojë e ndikimit të të folmeve të gegërishtes verilindore. Në të vërtetë, edhe me dukuri të tjera gjuhësore, e folmja e Karadaku të Shkupit, duke u gjendur në kufijtë skajorë verilindorë të gegërishtes qendrore, përbën, si të thuash, një të folme ndërkaluese (të ndërmjetme) që i përket grupit të të **folmeve të gegërishtes qendrore**, por me disa elemente të të folmeve të gegërishtes verilindore.

14. Për të folmen e fshatrave Brezë e Malinë mund të themi se edhe pse mbizotëron qiellzorizimi i [pl] në [q], megjithëkëtë, [pj]-ja përngjashmohet edhe në [p], për shkak të prirjes së përgjithshme, në këto dy fshatra shumë më e shprehur sesa në fshatrat përreth, të rënies së [j]-së në grupet e bashkëtingëlloreve. Krahaso: mje:l > me:l, mjekërr > mekërr, vjehërr > vehërr etj. Kjo na jep të drejtën të mendojmë se [j]-ja në grupet [pj, mj, vj] ka rënë para procesit të qiellzorizimit të këtyre grupeve.

Dybuzorja e zëshme [b]

15. Në të gjitha të folmet shqipe, por edhe në të folmen tonë, varianti kryesor i kësaj bashkëtingëlloreje është *dybuzore, mbylltore, shpërthyesë dhe e zëshme*. Në përndarjen e bashkëtingëllores /b/ nuk ka kufizime. Ajo në fjalë shfaqet në të gjitha pozitat: në fillim, në mes e në fund të fjalës, si: *buk, bu:rr, be:shk, breshk, ba:b, bakër, be:s, bi:m, bilmet, bi:r; tabijat, tabëll, habi, gurubi, akraba, grabit; elb, korb, ço:rb, to:rb, vo:rb* etj.

16. *Shurdhimi i [b]-së në [p]*.- Ndonjëherë [b]-ja shurdhohet dhe kalon në çiftin e saj të pazëshëm [p]. Shurdhim i tillë nuk është dukuri e rregullt, meqë shfaqet vetëm në pozitën fundore te emrat vetjakë me burim oriental si dhe te pak fjalë turke.¹⁶⁹ Krahaso: *Raqip < Rakib, Taip < Taib, Dalip < Dalib, Hasip < Hasib, Ejup < Ejub, Vehap < Vehab* etj. (por nuk shurdhohet te patronimi Habib); *çita:p < qitab, sevap < sevab, sebeb < sebeb* etj. Kur ndonjë nga këto antroponime emërtojnë persona të gjinisë femërore, në fund marrin edhe një -e dhe me këtë /b/-ja meqë nuk është më në pozicion fundor, nuk shurdhohet, si në emrat *Taibe, Hasibe...*

17. *Njëjtësimi në zëshmëri*.¹⁷⁰ - Marrë në përgjithësi, në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit [b]-ja e ruan zëshmërinë edhe kur gjendet në pozitën fundore absolute, si: *elb, kelb* etj., por te mbiemrat e formuar nga këta emra në pozitë para /t/-së ajo shurdhohet në [p]: *buk t'elpta, t'kelpta*. Kjo dukuri fonetike paraqitet edhe në të folmen Dervenit,¹⁷¹ Karshiakës,¹⁷² të Manastirit,¹⁷³ të Kërçovës,¹⁷⁴ të Prilepit, Krushevës e Velesit¹⁷⁵ etj.

18. Para /d/-së te disa huazime turke /b/ > /v/, si në fjalët: *avdes < abdes, Avdi < Abdi, Avdulla < Abdulla, Avdil < Abdil* etj.

19. Te grupi [mb] bashkëtingëlloerja [b] bie në të folmen e fshatrave të këtij areali, përveç në fshatrat Luboten dhe Straçincë.

20. Për historinë e makro e mikro sistemeve të shqipes, interes të veçantë paraqet edhe zhvillimi i grupeve konsonantike [bl] dhe [bj], të cilat shfaqen në variante të ndryshme fonetike. Në arealin gjuhësor të Karadakut të Shkupit grupi [bl] na del në këto variante: [bl], [bj], [bgj] dhe [gj]. Ja se si na paraqiten këto grupe nëpër katundet e kësaj rrethine:

a) *Ruajtja e grupit [bl]*. – Grupi konsonantik [bl] përdoret si i tillë: *bli:, ble:t, ble:j, blu:j...* në të folmen e fshatrave Bllacë, Tanushë dhe Grushinë. Fshatrat që kanë pasur e kanë martesa e vajtje-ardhje më të shpeshta me banorët e Kosovës: Tanusha dhe Bllaca, grupin [bl] e

¹⁶⁹ Dr. Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Manastirit dhe e qarkut të tij*, Shkup, 1997, f. 49.

¹⁷⁰ Në gjuhën shqipe si dhe në gjuhë të tjera dihet se një bashkëtingëllore e shurdhët në kontakt me një të zëshme shqiptohen ose të dyja të shurdhëta ose të dyja të zëshme. Këto dukuri përfshihen në përngjashmim (asimilim). Për të emërtuar e dalluar veç e veç dy dukuritë, po përdoren termet zëshmim (sonorizim) dhe shurdhim (desonorizim). Nëse të dy termet do të përpiqeshim t'i përfshinim në një të vetëm, mund të përdorim termin **njëjtësim** (rrafshim, barazim, unifikim) në zëshmëri të bashkëtingëlloreve. Rëndom, në shumë gjuhë të botës bashkëtingëlloerja e dytë e bën si veten atë që gjendet para saj. Ky përngjashmim paravajtes ose prapavajtes shpjegohet me atë që kombinimi nyjëtitor bashkëtingëllore e zëshme + e shurdhët është i vështirë në të folurit, meqë është e pamundur të harmonizohet dridhja e tejzave (te të zëshmet) me mungesën e dridhjeve (te të shurdhëtat) për një kohë shumë të shkurtër (të qindtat e sekondës), prandaj të dy bashkëtingëlloret në takim njëjtësohen (unifikohen) për nga zëshmëria. Këtë dukuri e ka edhe maqedonishtja, por si duket duhet ta kenë edhe të gjitha gjuhët e botës, për shkak të vështirësive nyjëtimore, më mirë të themi për shkak të pamundësisë së aparatit të të folurit, përkatësisht tejzave të zërit për t'u tendosur e dridhur dhe shtendosur për një kohë shumë të shkurtër. Shih: Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011, f. 246-247.

¹⁷¹ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 182.

¹⁷² Haki Ymeri, *E folmja e Karshiakës*, Shkup, 1997, f. 98.

¹⁷³ Dr. Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Manastirit dhe e qarkut të tij*, Shkup, 1997, f. 49.

¹⁷⁴ Qemal Murati, *E folmja shqipe e rrethinës së Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialekt.), Prishtinë, 1989, f. 21.


¹⁷⁵ Mustafa Ibrahim, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Shkup, 2005.

ruajnë më mirë.

b) **Qiellzorizimi i /bl/ > /gj/**. - Në katundet e tjera të këtij areali (Mojancë, Orllancë, Brezë, Malinë, Luboten dhe Straçincë) ky grup konsonantik është qiellzorizuar në [gj], përmes disa fazave të zhvillimit: *bl* > *bj* > *bgj* > *gj*. Kemi regjistruar këto fjalë me qiellzorizim: *gjet* < *bletë*, *kam gje* < *kam ble*, me *gjue* < me *blue* (përveç *bgjet* në të folmen e Lubotenit) etj. Të gjitha këto variante të zhvillimit të grupit [bl] edhe sot e kësaj dite gjallojnë në të folmet e gegërishtes qendrore.

21. a) **Reduktimi i [bj] > [b]**. - E ngjashme është situata edhe me grupin bashkëtingëllor [bj], i cili përngjashmohet në [b] në fshatrat Grushinë, Tanushë, Bllacë, Mojancë dhe Orllancë, si: *be:shk* < *bjeshkë*.

b) **Palatalizimi i [bj] në [gj]**. - Në të folmet e f. Brezë, Malinë, Luboten dhe Straçincë grupi konsonantik [bj] qiellzorizohet në /gj/: *gje:shk*. Por, duhet vënë në pah se edhe në këto fshatra mund të gjenden raste sporadike të shmangies nga kjo shprehje e përgjithshme nyjetimore e banorëve të katundeve të saposhtënuara.



Skica 7. Ruajtja ose qiellzorëzimi i grupit bashkëtingëllor [bl]

Sonantja hundore [m]

22. Varianti kryesor¹⁷⁶ i [m]-së në mbarë shqipen dialektore e standarde shqiptohet si

¹⁷⁶ Për variant kryesor (themelor) i tingullit konsiderohet ai variant që nyjtohet si i vetëm, pa asnjë tingull tjetër shoqërues as para e as pas tij. Por, dihet se zanoret mund të shqiptohen më vete, ndërsa bashkëtingëlloret janë zhurma që nuk mund të shqiptohen pa ndonjë tingull tjetër paravajtës ose prapavajtës.

dybuzore, mbylltore, shpërthyesë, hundore dhe sonore. Karakterizohet me denduri të lartë përdorimi si dhe me përndarje të pakufizuar në kombinimin tingullor, si te fjalët anase, ashtu edhe te huazimet, në fillim në mes dhe në fund të fjalës: *mêik, man, muzat, mumrâim, mal, mish, motër, i madh, i mâir; kime, tërma:, hamamxhik; frâim; trâim, tâim, musha:m* etj.

23. Një nga përdorimet e veçanta të kësaj bashkëtingëlloreje në fillim të fjalës është përdorimi i saj si tingull protetik: asht *mplak*, asht *mtrash*, si edhe te jo pak të folme të tjera të gegërishtes qendrore.

24. Pozicioni fundor absolut i fjalës, që fonetikusht konsiderohet si pozitë e dobët, ka lejuar te pak fjalë shndërrimin e [m]-së në [n]: *taman* < tamam. Në f. Brezë kemi hasur ndryshimin e /m/ > /n/ edhe në pozicion nistor, si: *mje:kërr* > *nje:kërr*, *mja:lt* > *nja:lt*.

25. **Mosshqiptimi i [j]-së te grupi bashkëtingëllor [mj]**. - Shprehi nyjëtimore e folësve shqiptarë të këtij areali gjuhësor, si dhe përgjithësisht i pjesëtarëve të gegërishtes qendrore, është të mos shqiptojnë [j]-në në grupin [mj]. Krahaso format e fjalëve të Karadakut të Shkupit me ato të gegërishtes në përgjithësi: *me:kërr* < mjekërr, *me:l* < mjel, *me:gëll* < mjegull (*megjëll* në f. Brezë e Malinë) etj.


26. Kjo prirje e përgjithshme për lehtësimin e shqiptimit dhe ekonomizimin e ligjërimin të karadaklinjve, për rrjedhojë ka bërë që grupi [mb] të përngjashmohet në [m], në pak fjalë në [p], por në disa fshatra edhe ta ruajnë [mb]-në të pandryshuar. Ja si na paraqitet përdorimi i varieteteve fonetike të grupit [mb] në izoglosa:

27. a) **Reduktimi i [mb] > [m]**.¹⁷⁷ - Ndryshimet më të shpeshta të grupit konsonantik [mb] bëhen me thjeshtimin e tij në [m], përkatësisht me rënien e [b]-së. Këtu vepron “*ligji i të fortit*” (frengjisht: “loi du plus fort”), siç e quan fonetikani i njohur frëng Maurice Grammont. Sipas “ligjit të të fuqishmit”, kur dy fonema ndikojnë njëra në tjetrën në çfarëdo mënyre qoftë, më e dobëta (sipas vendit të saj në rrokje dhe forcës së artikulimit)¹⁷⁸ i nënshtrohet asaj që është më e fortë.¹⁷⁹ Nga kjo pikëpamje, [m]-ja është më e fuqishme se [b]-ja, prandaj ndodh ky përngjashmim hundor paravajtës në takim (asimilim nazal regresiv në kontakt) në dialektin e Veriut, përfshirë edhe të folmet e fshatrave Bllacë, Tanushë, Mojancë, Orllancë, Brezë, Malinë dhe Grushinë në të gjitha pozitat e fjalës. Krahaso: *maj* < mbaj, *mas* < mbas, *maroj* < mbaroi, *mrena* < mbrenda, brenda; *mrapa* < mbrapa, prapa; *mret* < mbret, *metën* < mbetën; *tamël* < tambël, *lloma* < llamba, *gjumëll* < grumbull, *dhami* < dhambi, *koma* < kamba, *tremdhet* < trembëdhjetë; *plum* < plumb, *shka:m* < shkamb, *krim* < krimb etj.

¹⁷⁷ Termi **reduktim**, po edhe **thjeshtim** (që e kemi përdorur shpeshherë në këtë monografi) mendoj se është e udhës të përdoret në rastet kur nga dy elemente tingullore njëri humbet pa lënë gjurmë të dukshme dhe mbetet vetëm njëri element (më i forti). Edhe termi **shkrirje** (krasis) është më mirë të përdoret në rastet kur nga dy tinguj përftohet një tingull i vetëm, që ka veçori të përbashkëta të të dy tingujve të tjerë në bashkëveprim (siç është rasti me [ng] që jep [ŋ]). Termi latin **asimilim** (shqip përngjashmim) që ka kuptimin ‘bëj të njëjtë a të ngjashëm dikë me vetveten’ jo që nuk mund të përdoret për të dyja dukuritë (për reduktim e për shkrirje), por mendoj se është shumë i përgjithshëm, nuk shpreh saktësisht dukurinë, siç e përcaktojnë më me saktësi termet reduktim e shkrirje.

¹⁷⁸ Është e njohur se edhe tingujt (fonemat) e gjuhës kanë shkallë të ndryshme force. Forca varet nga mënyra e nyjëtimin, vendi i nyjëtimin, zëshmëria etj. Bie fjala, zanoret janë më të fuqishme se bashkëtingëlloret, meqë zanoret shqiptohen me hapësirë të gjerë, ndërsa bashkëtingëlloret me shteg ose mbyllje; madje zanoret janë tone muzikore, ndërsa bashkëtingëlloret janë zhurma. Sa më e hapur dhe sa më e përparme është zanorja, po aq është më e fuqishme. Te bashkëtingëlloret: sonoret janë tingujt më të fuqishëm, më pas bashkëtingëlloret e zëshme e në fund të dhurdhëtat. Mendojmë se treguesi më i rëndësishëm i forcës (fuqisë) së tingullit është zëshmëria e tij. Pra, zëshmëria është në përpjesëtim të drejtë me forcën (dëgjueshmërinë) e tingullit. Në këtë kuptim, tingulli më i fuqishëm në shqipen është /a/-ja, ndërsa tingulli më i dobët është /h/-ja.

¹⁷⁹ Bertil Malmberg, *Fonetika*, Sarajevo, 1974, f. 103.



Skica 8. Përngjashmimi (asimilimi) dhe ruajtja e grupit bashkëtingëllor [mb]

b) **Ruajtja e grupit bashkëtingëllor [mb]**. – Në të folmet e fshatrave Straçincë dhe Luboten grupi [mb] përgjithësisht ruhet: *mbas, mbjell, e mbaj, mbe:s, mbush; tambël, dembel, i ambël, kumbëll; plumb* etj.

c) Mirëpo, edhe në këto fshatra ngandonjëherë grupi [mb] përngjashmohet në /m/, si p.sh.: *mrenda* < *mbrenda*, *qum* < *plumb* (f. Luboten), *po m'dhem dhomi* < *po më dhemb dhambi*; *i amël* < *i ambël* (f. Straçincë), numrat nga 11 deri më 19: *nimdhâit* '11', *dimdhâit* '12', *tremdhâit* '13', *katërmdhâit* '14',..., *nanmdhâit* '19' < njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, ... nëntëmbëdhjetë etj. Forma e fjalës *bin* < *mbin*, është regjistruar në të gjitha katundet e Karadakut. Ky asimilim regresiv i grupit [mb] në [b], përjashton ligjin e të fortit. Faktor vendimtar i fitores së të dobët ndaj të fortit mendojmë se është mosngartërimi kuptimor i foljes *mbin* me emrin *mi* (meqë do të kishim format *min - mi-n+in*). D.m.th. po të fitonte tingulli më i fortë nga forma *mbin* do të përfitohej forma *min*, që mund të ngatërrohej me kuptimin e leksemës *mi, miu*; që në gegërishte në trajtën e pashquar e kemi *mĩ* (historikisht *mĩn*) – në të shquarën *mĩni*.

ç) **Shkrirja e [mb] > [p]**. – Në pak fjalë, nga të dy bashkëtingëlloret e grupit fitohet një bashkëtingëllorë tjetër. Shkrirjen e /mb/ > /p/ e dëgjuam në tri raste: *hu:p* < *humb*, *prā:m* < *mbram*, *pruje* < *mbroje*.

2.5.2. BASHKËTINGËLLORET BUZORE-DHËMBORE

28. Shqipja dialektore e standarde ka dy bashkëtingëllore që nyjëtohen kur buza e poshtme u afrohet dhëmbëve të sipërm: [f, v]. Midis dhëmbëve dhe buzëve formohet një shteg i rrafshët, nga i cili del ajri, që drejtohet në spërfaqen e brendshme të buzës së sipërme. Pra, shtegu formohet ndërmjet majës së dhëmbëve të përparmë të sipërm dhe buzës së poshtme. Qiellza e butë është e ngritur, prandaj këto nuk janë hundore. Në shqiptimin e [f]-së, tejzat e zërit janë të labërguara dhe nuk dridhen, prandaj kjo është e shurdhët; ndërsa [v]-ja nyjëtohet me tendosjen dhe dridhjen e tejzave të zërit, ndaj kjo është e zëshme.

Shtegorja e shurdhët [f]

29. Në të folmen tonë, si dhe në shqipen dialektore e standarde, kemi dy bashkëtingëllore buzore-dhëmbore: /f/ dhe /v/. Këto shqiptohen me tendosje të dobët të organeve të të folurit. Shtegu formohet midis majës së dhëmbëve të përparmë dhe buzës së poshtme. Të dyja formojnë një çift që kundërvihen në zëshmëri: /f/ është e shurdhët (e pazëshme) ndërsa /v/-ja e zëshme.¹⁸⁰

30. Varianti kryesor i bashkëtingëllores [f] është **buzore-dhëmbore, shtegore, fërkimore dhe e shurdhët**. Përdoret në të gjitha pozitat e fjalës, si në fjalët burimore ashtu edhe në fjalët e huazuara: *fu:sh, fu:g fa:r, femën, frâig, fturk, fêill, ftêir, fortôun, fukara:; ka:fe, koftor, afion; qef, ça:f, llaf, gzof* etj.

31. Grupi bashkëtingëllor [fl] në të folmen e disa fshatrave të Karadakut ruhet, ndërsa te disa ajo jotizohet në /j/. Përndarja e formave fonetike të këtij grupi në këtë krahinë është:

a) **Ruajtja e [fl]-së**: *fla:k, flo:k, flutër, fle, flaron* në fshatrat Tanushë, Bllacë, Mojancë, Orllancë dhe Grushinë.

b) **Jotizimi i [fl] në [fj]**: *fja:k, fjo:k, fjutër, fjjet* (por edhe une *fe:; feta*), *fjaron* në f. Brezë, Malinë, Straçincë dhe Luboten.

32. a) **Ruajtja e grupit [fsh]**. - Grupi bashkëtingëllor [fsh] përdoret rregullisht në formimin e formave të mënyrës dëshirore te foljet e zgjedhimit të parë: *shkofsha, lafsha, punofsha, bafsha, larofsha* etj.

b) **Mosshqiptimi i [f]-së te grupi [fsh]**. - Te emrat /f/-ja e grupit /fsh/ rëndom bie. Krahaso: *mundash* < mëndafsh, *ko:sh* < kofshë por edhe *ko:fsh* (f. Luboten), *kashore* < kafshore, *kafshatë* etj.

Shtegorja e zëshme [v]

33. Si në shqipen standarde, ashtu edhe në të folmen e Malit të Zi të Shkupit, bashkëtingëllorja [v] është **labiodentale, shtegore, fërkimore dhe e zëshme**. /v/-ja etimologjike ruhet mirë në të gjitha pozitat e fjalës, si: *vesh, vo:rb, voj, vîn, votër, i vocërr, vën, vorr, vejushk, i vetëm; avli, evlad, hajvan, tavan, hajvar, livadh, lavd; meça:v, ta:v, bra:v, hashov* etj.

34. **Shfaqja e /v/-së dytësore**. - Përveç /v/-së parësore (primare) në gjuhën shqipe përdoret edhe një /v/ sekondare (dytësore). Në këtë kuptim, dihet se në një fazë më të vonshme të

¹⁸⁰ Anastas Dodi - Jorgji Gjinar, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 61, 83.

zhvillimit të shqipe, për të zhdukur hiatin,¹⁸¹ midis dy zanoresh është ndërftuar një /-v-/,¹⁸² e cila llogaritet si dytësore, jo parësore (jo primare, joetimologjike). Edhe në arealin tonë epetentike paraqitet bashkëtingëllorja [v] te foljet e zgjedhimit të parë në kohën e kryer të thjeshtë (aorist), sipas tipit: *la-v-a, la-v-e; shko-v-a, shko-v-e; puno-v-a, puno-v-e; mco-v-a, mco-v-e; ke-v-e, pa-v-e* etj.

Një [v] dytësore shfaqet edhe te trajta e shquar e disa emrave mashkullorë që mbarojnë me zanore të theksuar. P.sh.: *ka: > ka-i > ka-v-i, shêi > shêi-i > shêi-v-i, dhe: > dhe-i > dhe-v-i, sêi > sêi-i > sêi-v-i, thâi > thâi-v-i; i zi > i zi-i > i zi-v-i* etj.

35. **Desonorizimi i /u/ > /v/**. – Denduria (frekuenca) e përdorimit të /v/-së rritet edhe përmes rrugës së konsonantizimit të gjysëm-vokalit */u/.¹⁸³ Edhe në fazën e sotme, në këtë të folme kemi shembuj me desonorizim të këtij lloji, që tregojnë se kjo dukuri fonetike ende gjallon. Këtë dukuri e vëmë re te disa folje në kohën e kryer të thjeshtë në vetën e tretë njëjës, që në gjuhën standarde mbarojnë me -u. Duke u gjendur në këtë pozitë fundore absolute të fjalës, zanorja [u] desonorizohet, përkatësisht konsonantizohet në [v]: *e prev < e preu, e thav < e thau, e lav < e lau, e çav < e çau, e thev < e theu* etj.¹⁸⁴

36. **Thjeshtimi i [vj] > [v]**. – Grupi bashkëtingëllor [vj], në këtë të folme, thjeshtohet (përngjashmohet) duke mos e shqiptuar [j]-në, si p.sh.: *vehërr < vjehërr, vehrri < vjehrri, vesht < vjeshtë, me vel < me vjelë, vet < vjet* etj.

2.5.3. BASHKËTINGËLLORET NDËRDHËMBORE

47. Si te të folmet e tjera geqe e toske, në gjuhën standarde shqipe, ashtu edhe në të folmen shqipe të Malit të Zi të Shkupit inventarin e sistemit konsonantik e përbëjnë edhe dy bashkëtingëllore ndërthëmbore /th/ e /dh/. Mendohet që këto dy fonema interdentalë nuk kanë qenë pjesë e inventarit fonologjik të gjuhës mëmë indoevropiane, por thuhet që këto janë krijuar brenda shqipes gjatë zhvillimit historik të saj. Bashkëtingëllore ndërthëmbore ka edhe anglishtja e greqishtja.¹⁸⁵ Në shqipen identifikohen me veçoritë se janë **paragjuhore, ndërthëmbore, shtegore, frikative**. Tipar dallues i këtij çifti është mungesa ose prania e zëshmërisë: [th]-ja

¹⁸¹ Në gjuhën shqipe janë të shpeshta rastet e ndërftjes të një bashkëtingëlloreje midis dy zanoresh, si tingull eufonik (bukurtingëllues) ose kundëhiatizues (lat. hiatus - e çarë, grykë, hapje). Këta tinguj lindin për të zhdukur hiatin, d.m.th. për të mënjeluar shqiptimin e dy zanoreve të njëpasnjëshme për të cilat goja hapet dy herë. Me fjalë të tjera, këta tinguj shërbejnë për të lehtësuar ndërkalimin shqiptimor nga një zanore në tjetrën dhe për ta bërë fjalën më të këndshme për dëgjim. Shih: Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, f. 248-249.

¹⁸² Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 221.

¹⁸³ Shaban Demiraj, Po aty, f. 221.

¹⁸⁴ Edhe dukuria e desonorizimit (konsonantizimit) shpjegohet me ligjin e të fortit. Në togjet e zanoreve të dhëna, zanorja e parë është e theksuar, ndërsa e dyta e patheksuar. Dihet se të theksuarat shqiptohen me forcë, lartësi e gjatësi më të madhe sesa të patheksuarat. Zanoret e hapura janë më të zëshme sesa të mbyllurat. Në këtë kuptim, rezultojnë se /a/-ja është më e fuqishme sesa /u/-ja, prandaj ajo si më e fortë e nënshtron më të dobëtën. Një urti popullore thotë: Dy atllarë nuk lidhen në një mullar. Në grupet (kopetë) e kafshëve, njëri mbisundon, të tjerët janë vartës të tij.

¹⁸⁵ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 216.

është e shurdhët, ndërsa [dh]-ja është e zëshme. Në fakt, në sistemin konsonantik këto formojnë çiftin korrelativ sipas zëshmërisë: e shurdhët ~ e zëshme.¹⁸⁶ Funkzioni kuptimdalles, si në mbarë shqipen, ashtu edhe në këtë të folme, mund të provohet me çifte minimale fjalësh, si: *thi ~ dhi, thash ~ dhash, tha:m ~ dha:m* etj.

Ndërdhëmborja e shurdhët [th]

48. Për dialektologjinë e gjuhës shqipe kjo bashkëtingëllore nuk paraqet ndonjë interes të veçantë, meqë ka përdorim të qëndrueshëm. Ndodhet në të gjitha pozitat e fjalës, si: *thâik; thâj, thoj, the:rr, tham, thâirri, thes, thupër, thekën; lethâi, çethi, bërthang; vêtthe t'kalit, e shkriht, e djatht; ba:th, gjath, urêtth, fra:th* 'fruth' etj.

49. **Kalimi i [th]-së në [f].** - Te një numër i vogël fjalësh regjistruam edhe ndërrimin e [th]-së në [dh]: *uthull > ufëll, uftëll; i thell > i fe:ll; thëllanzë > flla:z* 'thëllëzë' etj.

Ndërdhëmborja e zëshme [dh]

50. Kjo bashkëtingëllore, si edhe çifti i saj i shurdhët, në këtë të folme ka përdorim të qëndrueshëm (stabil). Kështu, ajo pothuajse gjithkund i ruan veçoritë e veta nyjetimore dhe akustike. Gjendet në të gjitha pozitat e fjalës: *dha:m, dhâj, dhash, dhelpën, dha:llt, dhe:t, dhem; nimdhe:t, dimdhe:t, ..., nanmdhe:t; ndrâidhe, dhanërr, i shpërdhâjt; zgërdhaj, bërdhaj; mledhje, tradhtar, udhta:r, erdha; hedh, dredh, e ba:rdh, livadh, zgje:dh, gjardh, mledh, edh, lidh, zgjidh* etj.

51. **Bashkëtingëllorja [dh]e ruan zëshmërinë.** - Është e njohur se në shumë të folme, para së gjithash në të folmet e toskërishtes, por aty-këtu edhe tek ato të gegërishtes, në pozita dhe rrethana të ndryshme fonetike, bashkëtingëlloret e zëshme shurdhohen. Sipas vrojtimeve tona, na del se veçori e të folmes së Karadakut të Shkupit është ruajtja e zëshmërisë së kësaj bashkëtingëlloreje, në të gjitha pozitat e fjalës. Kështu, për një ruajtje të këtille dëshmojnë edhe shembujt e sipërsënuar. Madje edhe kur gjendet në pozitë fundore absolute të fjalës (edhe pse pozitë e dobët fonetike), në të folmen e këtij areali, marrë në përgjithësi, nuk kemi shurdhimin e [dh]-së.

52. **Njëjtësimi në zëshmëri.** - Në të folmen tonë kemi disa shembuj sporadikë të kalimit të [dh] > [th], përkatësisht të njëjtësimit (barazimit, unifikimit, harmonizimit, përputhjes, përqasjes) të zëshmërisë kur [dh]-ja ndodhet para bashkëtingëllores së pazëshme [t], si: *i itht < i idhët, gjashtthe:t < gjashtëdhjetë, shtatthe:t < shtatëdhjetë, tetthe:t < tetëdhjetë*; në pozitë fundore: *gjarth* por edhe *gjardh*.

53. **Ndërrim tejet i rrallë i [dh]-së në [v], në [n] ose në [r].** - Në këtë të folme kemi regjistruar dy-tre shembuj të këtyre ndërrimeve të shënuara. Kështu kemi: *dhjamë > vja:m* (në të folmet e gjitha fshatrave), edhe *> ene* (në të folmet e f. Luboten, Bllacë, Straçincë, Malinë dhe Brezë), edhe *> ere* në f. Grushinë.

¹⁸⁶ Anastas Dodi - Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 66.

2.5.4. BASHKËTINGËLLORET PARAGJUHORE

37. Më të shumënumërta dhe më të shumëllojta janë bashkëtingëlloret paragjuhore. Rikujtojmë se shqipja standarde ka 17 bashkëtingëllore paragjuhore, nga të cilat 13 majore (apikale) dhe 4 kulmore (kakuminale). Për nga mënyra e formimit, bashkëtingëlloret paragjuhore janë mjaft heterogjene, sepse ato nyjëtohen me katër llohe pengesash: mbyllje, shteg, mbyllje-shteg, dridhje. Kështu:

- 3 janë mbylltore: [t, d, n];
- 8 shtegore: [s, z, sh, zh, l, ll, th, dh];
- 4 afrikate: [ç, x, ç, xh], dhe
- 2 dridhëse: [r, rr].

Alveolaro-dhëmborja [t]

38. Kjo bashkëtingëllore artikulohe si *paragjuhore, alveolaro-dhëmbore* (ndonjëherë dhëmbore), *mbylltore dhe e shurdhët*.¹⁸⁷ Përdoret në të gjitha pozitat e fjalës dhe karakterizohet me shqiptim të qëndrueshëm, pa variante të shumta alofonike, si në fjalët: *ta mcosh, te ti, tre, trâi, trap, tâim, tërma:*, *trôull, tatli:*, *tërku:z; ftôue, motër, vakt, e gjeta, gjuetar; i ga:t, i na:lt, shtat, muzat, lot, dit, kunat* etj. Një numër i madh emrash në trajtën e shquar të shumësit mbarojnë me këtë bashkëtingëllore, si: *zogjt, mâiq, qeqt, dhent, shokt, uqt* etj. si dhe një numër i madh numërorësh, si: *nimdhet '11', dimdhet '12' ... nizat '20', tridhet '30', katërdhet '40'*. Përveç rasteve të përmendura, /t/-ja shqiptohet në fund të fjalës edhe te disa mbetje emrash të gjinisë asnjane: *ujt, dhallt, krâiet*.

39. *Rënia e bashkëtingëllores [t] në fundin absolut të fjalës*. - Si në shumë të folme të tjera të gegërishtes,¹⁸⁸ ashtu edhe në të folmen në fjalë hasen shembuj ku bashkëtingëlloret [t] bie rregullisht. Kështu, ajo nuk shqiptohet kur është në funksion të mbaresës vetore në vetën e dytë shumës, në të pakryerën e dëftores: *ju mcojshi* (< ju mësonit), *ju shkrajshi* (< ju shkruanit), *ju ardhshi* (< ju vinit). Në pozicion fundor bjerret edhe tek foljet në dëshirore, veta e dytë shumës, të tipit: *Shkofshi!, E gzofshi!, Ardhshi!, Kofshi!* etj.

Në pozicion fundor bie edhe tek përemri pyetës *kush?* në rasat e zhdrejta: gjinore, dhanore dhe rrjedhore, duke u përdorur në trajtat: *i, e kuj?*, (< i, e kujt?), *kuj?* (< kujt?), *prej kuj?* (< prej kujt?). Me rënien e [t]-së përdoret shpesh edhe përemri pyetës *xhi?* (< xhit?) si: *xhi ban?* (< ç bën?, çka bën?).

40. *Rënia e bashkëtingëllores [t] në trup të fjalës*. - Bashkëtingëlloret [t] në trup të fjalës nuk përdoret te disa folje në habitore në kohën e tashme në të gjitha vetat si në njëjës, ashtu edhe në shumës, si: *un dikam!* (< ditkam!), *tâi dike!* (< ditke!), *ai dike!* (< ditka!); *na dikmi!* ose *dikna!* (< ditkemi!), *ju dikni!* (< ditkeni!), *ata dikan!* (< ditkan!). Por e njëjta ruhet tek foljet, pjesorja e të cilave mbaron me [t], si p.sh.: *mâitkam!, prâitkam!, shâitkam!* etj.

Në shumicën e të folmeve gege, si edhe në vetë të folmen në fjalë, e shpesh të është dukuria e shkurtimit të fjalëve, përkatësisht e rënies jo vetëm të tingujve, por edhe të rrokjeve (në rastin tonë të rrokjes *të*), si p.sh.: *shpâi, shpi:* (< shtëpi), *shretâjn, shkreti:n* (< shkretëtirë),

¹⁸⁷ Anastas Dodi - Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 62.

¹⁸⁸ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997, f. 77; Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 139.

vetâim, *veti:m* (< vetëtimë), *shllâung*, *shllu:ng* (< shtëllungë) etj. Nga ana tjetër, me [t] shqiptohen fjalët: *kështu* > *kshtâu*, *kshta:*, ose *çekshtâu*, *çekshta:*, si edhe: *çekshtâune*. Me disa variante fonetike përdoret edhe ndajfolja e mënyrës: *ashatâu*, *ashta:*, *ashtâune* etj.

41. **Qiellzorizimi i grupit të bashkëtingëlloreve [tj] në [q]**. - Ky grup bashkëtingëlloresh në këtë izoglosë palatalizohet në mesgjuhoren [q], si te fjalët: *tjetri* > *qetri*, *mështje:rr* > *shqe:rr*, por në f. Brezë *mushtje:rr*. Fjalëforma **atje** në materialin burimor me të cilin disponojmë e hasim me palatalizimin e [tj] > [gj], si: *agje* ose *çagje*, të dalë nga përemri dëftor *qe* > *çe* (ja) + *agje* (ndajfolje vendi): *çe* + *agje* = *çagje* me apokopë të e-së. Qiellzorizimi i grupit bashkëtingëllor [tj] në [q], sipas Bozhidar Vidoeskit e gjejmë edhe në të folmen e Kumanovës si dhe në të gjitha të folmet maqedonase veriore në përgjithësi.¹⁸⁹ Një dukuri të tillë palatalizimi ka vënë re edhe prof. Peev në të folmen maqedonase të Kukushit (që gjendet në jugun e Maqedonisë).¹⁹⁰

42. **Shkrirja e [tsh]-së në [ç]**. - Në rastet kur këto bashkëtingëllore ndodhen afër njëra-tjetrës, përkatësisht kur te disa mbiemra shqiptohen njëra pas tjetrës, [t]-ja fundore e temës me prapashtesën *-shëm*, *-shme*; atëherë grupi bashkëtingëllor [tsh] shkrihet në [ç]. Të shkriret e gjejmë në fjalët: *i motshëm* > *i moçëm*, e *motshme* > *e moçme*; *i mendtshëm* > *i meçëm*, e *mendtshme* > *e meçme* etj. Kjo dukuri haset edhe te mënyre dëshirore e foljes ndihmëse *kam*, si në njëjës ashtu edhe në shumës, p.sh.: *kam* : *patsha* > *paça*.

Majegjuhorja [d]

43. Bashkëtingëllorja [d] është korresponduese e zëshme e [t]-së. Ajo është **paragjuhore**, **alveolare**, **mbylltore** dhe **shpërthyesë**. Karakterizohet me shqiptim të qëndrueshëm dhe të pandryshueshëm. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, si edhe në të gjitha të folmet e tjera shqipe, në dendurinë dhe shtrirjen e saj nuk ka kufizim (me përjashtim të ndërrimeve në grupe të caktuara bashkëtingëlloresh). Kështu, ajo është shumë frekvente dhe ndodhet në të gjitha pozicionet e fjalës, si: *di:*, *di:t*, *del*, *di:ll*, *do:r*, *da:rk*, *dre:k*, *drishk*, *dollap*, *da:j*, *de:r*, *da:rdh*, *dishek*, *dell* (< dyllë), *duhan*; *kodër*, *vend*, *mendja*, *hajde!*; *o:d*, *parmend*, *kataund*, *fund*, *vend*, *ngarend* etj. Ndërrimet më të shpeshta fonetike të bashkëtingëllores [d] janë:

44. **Shurdhimi i bashkëtingëllores [d]**. – Tek antroponimet me prejardhje orientale,¹⁹¹ në pozitë të dobët fonetike, d.m.th. në pozicion fundor absolut të fjalës, bashkëtingëllorja [d] shurdhohet, përkatësisht kalon në çiftin e saj të pazëshëm [t]. Krahaso: *Muhamed* > *Muhamet*, *Ahmed* > *Ahmet*, *Halid* > *Halit*, *Vahid* > *Vahit*, *Sahid* > *Sahit*, *Mehmed* > *Mehmet*, *Hamid* > *Hamit*, *Vaxhid* > *Vaxhit* etj.

45. Lidhur me ruajtjen apo asimilimin e grupit të bashkëtingëlloreve [nd], në arealin tonë gjuhësor hasim dysi formash fonetike: në pika të caktuara dialektore kemi përdorim të pandryshuar, derisa në të tjerat – reduktim të tij, si p.sh.:

a) **Ruajtja e grupit [nd]**. - Të folmet e f. Luboten dhe Straçincë, marrë në përgjithësi, e ruajnë të pandryshuar këtë grup bashkëtingëlloresh në të gjitha pozitat e fjalës, si: *ndër*, *nde:r*, *ndrâishe*, *ndrêishe*; *mundash*, *ndihëm*, *ndaj*; *mende*, *çindrova*; *mrenda*, *xhindem*, *xhindna*; *hund*, *nond*, *fund* etj.

¹⁸⁹ Божо Видоески, *Кумановскиот говор*, Скопје, 1962, f. 71.

¹⁹⁰ Коста Пеев, *Кукушкиот говор* (книга I), Скопје, 1987, f. 121-126.


¹⁹¹ Qemal Murati, *E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 21.

Nga ana tjetër, te një numër i kufizuar fjalësh ky grup bashkëtingëlloresh edhe në këto pika dialektore përngjashmohet. Shembuj të tillë të regjistruar kemi te numrat *nonmdhëit* '19', *nondhëit* '90'; *nime*, *përnime* (vërtet), *shne:t*, *knoj* < këndo, *ka:jk* < këngë, *faleminer!*, *munsëi* etj.

b) **Reduktimi i [nd]-së në [n]**. - Në të folmet e fshatrave Tanushë, Bllacë, Malinë, Brezë, Grushinë, Mojancë dhe Orllancë grupi bashkëtingëllor [nd] reduktohet në të gjitha pozitat e fjalës. Krahaso shembujt – në fillim: *nera* (< ndera); *e neça*, *e nreça* (< e ndreça); *nij*, *ngjoj* (< ndiej, ndëgjoj, dëgjoj); *me m`nimu*: (< ndihmuar), *nër* (< ndër); në trup të fjalës: *anërr* (< ëndërr), *shnet* (< shëndet), *munash* (< mëndafsh), *kna:s*, *knu:s* (< këndues), *menja* (< mendja); në pozicion fundor: *ven* (< vend), *gjazmen* (< gazmend), *parme:n* (< parmendë), *fun* (< fund), *e shkun* (< e shkundë), *hu:n* (< hundë), *katun* (< katund), *e përkun* (< e përkund), *e tu:n* (< e tundë) etj.

Vlen të theksohet se edhe në të folmet e këtyre katundeve dëgjuam ngandonjë shembull sporadik me përdorim të këtij grupi konsonantik, të tipit *ndi:m*, *qereminde* (me *n* epentike), *ku:ndra*, *andërr*, *qëndrova* etj. të regjistruara në f. Grushinë; pastaj *andërr*, *e ndreçt*, *kundër* etj. të regjistruara në f. Orllancë; *ndi:hm* në f. Tanushë.

c) **Reduktimi i [nd] në [d]**. – Krahas formave dominante të reduktimit të këtij grupi bashkëtingëllor në sonanten hundore [n], hetuam edhe një numër të vogël fjalësh ku [nd] > [d], si: *e dan mishin*; *doni di:t*; *doni he:r* etj.



Skica 9. Përngjashmimi (asimilimi) dhe ruajtja e grupit bashkëtingëllor [nd]

46. **Qiellzorizimi i grupit bashkëtingëllor [dj] në [gj]**. - Në të folmet e gegërishtes qendrore është njaft e përhapur dukuria fonetike e palatalizimit të grupeve [tj] e [dj] në mesgjuhoret [q], [gj].

Në të folmen shqipe të kësaj krahine, - përveç disa rastesh të rralla (dja:l, dja:th) paralelisht me përdorimin e fjalëformave të njëjta dhe me grupin e qiellzorëzuar, si dhe me një

shembull me kalimin e [dj] > [nj]: djersë > *nje:rs* (por *ngjers* në f. Straçincë dhe *gjerz* në f. Bllacë), - ky grup bashkëtingëlloresh ka kaluar në qiellzoren [gj]. Krahaso format fonetike të fjalëve të njëjta: djep > *gjep*, djeg > *gjeg*, djath > *gjath*, djalë > *gja:l*, dora e djathtë > dora *gja:tht*, dje > *gje*, pardje > *pargje* etj

Paragjuhorja afrikate [c]

54. Varianti kryesor i kësaj bashkëtingëlloreje është **paragjuhore, alveolare, afrikate dhe e shurdhët**. Dihet se mbyllja dhe shtegu të bashkëtingëlloret afrikate paraqesin një akt të vetëm artikulus. Çasti i ndërkalimit nga mbyllja në shteg është shumë i shkurtër, prandaj shtegoret merren si bashkëtingëllore të veçanta dhe përbëjnë në grup më vete.

55. Në krahasim me bashkëtingëlloret e tjera, paragjuhorja [c] përdoret më pak, por del në të gjitha pozitat e fjalës, si në fillim të fjalës: *cigare; cu:ll, ca:ll; côuc, cu:c; cap; çelli?, calli?; câung, conuk; ci:c, carrok, cik, cinga:ll* etj. Në mes të fjalës: *i vocërr, i vacërr; kacâi, pakërcej, kapërcej; kcej, kërcu* etj.

56. Më shpesh [c]-ja na del në fund të fjalës. Përdorimin më të madh të kësaj bashkëtingëlloreje në këtë pozicion e rrit prapashtesa sllave në fjalët me - **ica** (në të folmen tonë - **i:c** ose -**âic, -êic**), si *koc, spec, ma:c, dac, saki:c, magjari:c, çukari:c, bullâic, grani:c, stani:c, bollni:c, përli:c, azbac, cu:c, shkusovâic, shkusovêic* etj.

Veti karakteristike dhe specifike e të folmeve shqipe në Maqedoni përbën emërtimi i grave të martuara, të cilat emërtohen me emrin e bashkëshortit, duke ua shtuar prapashtesën -*i:c, -âic, -êic (-ica)* në formë të diftonguar apo të padiftonguar, sipas tipit, bashkëshorti: bashkëshorti Nazif – bashkëshortja e tij: *Nazif-i:c* ose burri - Hasan – gruaja - *Hasan-âic, Hasan-êic*, burri: Arif – gruaja – *Arifi:c* ose *Arifâic ...*, ku në dallim nga të folmet e tjera të cilat nuk e njohin këtë mënyrë të riemërtimit të grave të martuara me emrin e burrit, në të folmen tonë denduria e përdorimit të [c]-së në fund të fjalës rritet.

57. **Shprehia nyjetimore e shqiptimit të pandryshuar të [c]-së**. - Me përdorimin e saj të pandryshuar, bashkëtingëlloret [c] në të folmen tone dhe më gjerë bën pjesë në grupin e bashkëtingëlloreve me artikulum të qendrueshëm (stabil). Në fakt gjatë hulumtimeve tona dialektore kemi hetuar vetëm një shembull të shndërrimit të [c]-së në [x]: *cigare > xigare* (Bllacë).

Afrikatja alveolare [x]

58. Kjo bashkëtingëllore është korresponduese e zëshme e [c]-së. Bashkëtingëlloret [x] është **alveolare, paragjuhore, afrikate** ([d] + [z] = [x]) dhe e **zëshme**.

59. Si në shqipen standarde, ashtu edhe në atë dialektore, bashkëtingëlloret [x] ka përdorim të kufizuar.¹⁹² Gjatë hulumtimeve tona dialektore në terren kemi regjistruar fare pak

¹⁹² Në shqipen standarde fonema /x/ me 0.04% denduri përdorimi në ligjërimin e lidhur, është më e rralla, përkatësisht ajo zë vendin e 36-të. Shih: Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011; f. 216.

fjalë që kanë [x], si *xekërr*, *xegërr*; *xixllâim*; *i nxe:t*, *i nxeft*; *nxa:ns*.

60. **Shndërrimi i [z]-së në [x]**. – Vetëm te disa fjalë e kemi hasur kalimin e [z]-së në [x]: *zile* > *xile*, *kallëzoj* > *kallxoj*, *rrunzë* > *rru:nx*, *thëllzë* > *flla:nx*; E gëzofsh Bajramin! > E *gxofsh* Beramin! etj.

Paragjuhorja shtegore [s]

61. Në të folmen tonë, si edhe në të folmet e tjera shqipe, [s]-ja është **alveolare, fërkimore, paragjuhore dhe e shurdhët**. E gjejmë në të gjitha pozitat e fjalës. 1. Në pozitën nistore: *s'e di*, *s'un e kupton*, *s'asht ashtu...*¹⁹³ *sa?*, *sâi*, *sofër*, *samar*, *sokol*, *sabah*, *sahat*, *si:ll*, *salla:t*, *spec*, *sapun*, *saç*, *i sprehët*, *i smu:t*, *sqap* etj. 2. Në mes të fjalës: *masandej*, *bisedoj*, *asaj*, *darsëm*, *bostan*, *kusâi*, *malso:r*, *munsêi*, *nase*, *ha:sër*, *çasi*, *qeqsêja*, *i pasëm*. 3. Në pozicion fundor të fjalës: *mbes*, *mbe:s*, *shku:s*, *kna:s*, *pus*, (kam) *pa:s*,; *mas*, *mbas*, *me:s*, *ro:s*, *thes*, *çels*, *pe:s*, *gjiks*, *kos*, *ko:s*, *u sos*, *batkro:s* (formë metatetike e fjalës bretkosë) etj.

62. **Alternimi i [s] > [sh]**. – Dihet se */s/-ja indoevropiane, e fjalëve latine si dhe të greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe ka dhënë /sh/, si *Skupi* > *Shkupi*, *Skampa* > *Shkumbini*, *Scodra* > *Shkodra*, *Naisus* > *Nish*, *Astibo* > *Shtip*, *prason* > *presh* etj.¹⁹⁴ Ky konstatim para së gjithash gjen mbështetje në krahasimin e formave shqipe me ato latine e të greqishtes së vjetër. Te pak fjalë, si *shtof*, *po:sht*, *shpiun* në të folmen shqipe të kësaj krahine si edhe në të folmet e tjera shqipe në Maqedoni¹⁹⁵ kemi /sh/ e jo /s/, si në të folmet e tjera, meqë të njëjtat fjalë janë huazuar nga gjuhët sllave (serbishtja ose maqedonishtja). Në të folmen e Brezës [s]-ja shpesh nuk përdoret te pjesëza mohuese 'mos': *si mo t' rrâish*.

63. **Shndërrimi [s] > [c]**. – Në të folmen tonë te disa fjalë hetohet kalimi i [s] > [c], si p.sh.: *tepsi* > *temcêi* dhe *temsi* (f. Grushinë dhe Tanushë), *temcâi* (f. Brezë, Malinë); gjysmë > *gjimc* (f. Mojancë, Orllancë dhe Straçincë); *përgjimc* (f. Bllacë); *xanca* (f. Grushinë), *çelc* (f. Bllacë).

64. **Zëshmimi i [s] > [z]**. – Mjaft i përhapur në shqipen është përngjashmimi i bashkëtingëlloreve sipas shkallës së zëshmërisë. U kuptua se një bashkëtingëllore e zëshme dhe një e shurdhët në takim (kontakt) bëhen ose të dyja të shurdhëta, ose të dyja të zëshme. Rregull i përgjithshëm i përshtatjes në zëshmëri të shqipes (si edhe i shumë gjuhëve të tjera) është: kur vijnë njëra pas tjetrës, e shurdhëta para të zëshmes zëshmohet, ndërsa e zëshmja para të shurdhëtës shurdhohet. D.m.th. kemi ndërkalimin e e çifteve të bashkëtingëlloreve në kahjen e parë, ose në kahen e dytë ndërmjet [p] ↔ [b], [f] ↔ [v], [t] ↔ [d], [s] ↔ [z], [c] ↔ [x], [ç] ↔ [xh], [sh] ↔ [zh], [th] ↔ [dh], [q] ↔ [gj] dhe [k] ↔ [g]. Kalimin në tingullin a > b e quajmë zëshmim (sonorizim), ndërsa kalimin a < b e quajmë shurdhim (desonorizim).

65. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, bashkëtingëllorja [s] zëshmohet në funksion të pjesëzës mohuese **s'** kur gjendet para foljeve që fillojnë me ndonjë bashkëtingëllore të zëshme [b], [d], [gj] dhe [v], si për shembull *z'bân* (s'ban); *z'bi:n* (s'mbin); *z'di* (s'di) *z'du* (s'du); *z'do* (s'do); *z'gjan* (s'gjen); *z'vâi* (s'vi) etj. Sonorizimi i [s] rregullisht shfaqet edhe në mes të fjalës kur gjendet para një bashkëtingëlloreje të zëshme, si p.sh.: *mezdit* (mesditë), *mozdije*

¹⁹³ s' – në funksion të pjesëzës mohuese për formimin e formës mohuese te foljet, është e e barasvlershme me pjesëzën mohuese *nuk*.

¹⁹⁴ Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1987, f. 33, 47, 54; Shaban Demiraj, *Fonologjia ...*, f. 209.

¹⁹⁵ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 146.

(mosdije), *përzditi* (për së dyti, përsëris) etj. Në raste të rralla ajo zëshmohet edhe në pozicion fundor të fjalës [s] > [z]: *taz* (tas), *gaz* (gas), *gjerz* (djersë) etj.

Shtegorja e zëshme [z]

66. Varianti kryesor i bashkëtingëllores [z] ka të njëjtat veçori nyjetimore si edhe bashkëtingëllorja [s] me të vetmin dallim se [s]-ja është e shurdhët, ndërsa [z]-ja e zëshme. Bashkëtingëllorja [z] është **paragjuhore, alveolare, shtegore dhe e zëshme**.

67. Në të folmen tonë [z]-ja haset në të gjitha pozicionet e fjalës: *zã:*, *zogj*, *za:ll*, *zemër*, *e ze:z*, *zengin*, *i zoti*; *xheze*, *xhezve*; *muzat*, *gjazmend*; *hazër*, *fla:z*, *shkëlbaz* etj.

68. **Ruajtja e zëshmërisë së [z]-së në të gjitha pozitat** . – Shurdhimi i [z] > [s] është dukuri e rëndomtë në shumë gjuhë. Dihet se gegërishtja ruan bashkëtingëlloret e zëshme edhe në fundin absolut të fjalës, ndërsa toskërishtja shurdhon të zëshmet në korresponduesit e tyre të shurdhët.

69. Nga aspekti fonologjik, në fundin absolut të fjalës asnjëherë kundërvënja bashkëtingëllore e zëshme ~ e shurdhët.¹⁹⁶ Këtë larmi variantesh tingullore për të njëjtën fonemë nuk e pengon opozicioni funksional.¹⁹⁷

70. Materiali i vjelë dialektor na siguron dëshmi të mjaftueshme për të përfunduar se në folmen tonë nuk kemi shurdhim të [z]-së në fundin absolut të fjalës. Këtë e dëshmojnë shembujt: *brez*, *kallauz*, *grënz*, *tërku:z*, *shkëlbaz*, *flã:z*, *mãiz*, *kafez*, *Idriz*, *Abaz*, *Binaz*, *Ramiz*, *Rafiz*, *Elmaz*; *gjiz*, *blo:z*, *shko:z*, *kërthâiz*, *maz*, *ma:z*, *oriz*, *e ze:z* etj.

71. Në të vërtetë, zgjedhja e alofoneve gjatë përshkrimit të të folmeve ka karakter subjektiv: varet nga shprehjet gjuhësore të studiuesit...¹⁹⁸ Së këndejmi, edhe në të folmen tonë në fund të fjalës mund të dëgjohen variante fonemash të zëshme si të shurdhëta. Por, ato alofone të shurdhëta nuk janë të rregullta, por të rastit, të pakta e nuk kanë karakter të përgjithshëm. Shqiptimet e tilla janë pasojë e intensitetit të dobësuar të rrymës së ajrit ose të intonacionit zbritës që zakonisht shfaqet në fund të fjalës a të fjalisë. Nga kjo që u tha deri më tani, mund të përmbyllim se e folmja e Karadakut të Shkupit ruan bashkëtingëlloret e zëshme edhe në fundin absolut të fjalës.

Shtegorja e shurdhët [sh]

72. Bashkëtingëllorja [sh] shqiptohet si **paragjuhore, alveolare, shtegore, fërkimore dhe e shurdhët**. Në të folmen tonë kjo bashkëtingëllore karakterizohet me një shqiptim stabil dhe të

¹⁹⁶ Me shurdhimin dhe zëshmimin e tingujve fjala përkatëse nuk ndërron kuptimin, andaj edhe tingujt e tillë janë variante kombinatorë të të njëjtës fonemë, apo alofone të një fonemeje të vetme. Sipas fonologut të njohur N. S. Trubeckoi fonema e tillë është *arkifonemë*, e cila sipas vetive që ka, mund të jetë më e përfaqësues a) me të zëshmen ose b) me të shurdhëtën; por ndonjëherë, ka mundësi të jetë c) tingull i ndërmjetëm, disi i mesëm, mjedisi i dy tingujve. Shih: N. S. Trubeckoi, *Parime të fonologjisë*, Prishtinë, 1985, f. 278-292.

¹⁹⁷ Ирена Савицка – Људмил Спасов, *Фонологија на современиот македонски стандарден јазик*, Скопје, 1997, f. 92-111.

¹⁹⁸ По ату, f. 93.

pandryshuar. E gjejmë në të gjitha pozitat e fjalës. Ja disa shembuj: Në pozicionin nistor: *shpâi, shu:m, e shkriфт, shta:m, shâi, shoh, ship, shiptar, shkam, shpêirt, shkoj, shkra:j, shkrij, shpoj, shke:p, shkelmoj, shulla:, shkus, shtëi, shamâi, she:k* etj. Në pozicionin mesor: *mushtëill, la:sht, i jashtëm, be:shk, fshêi, përjasht, mshe:l, bisht, drishk, kshir, fishek, pushoj, mushk, peshk, pu:shk* etj. Në pozicion fundor të fjalës: *vesh, pa:sh, mëish, rrush, rrafsh, klish, arash, munash, ma:sh, lesh, çosh, e lash* etj.

73. Në funksion të parashtesës bashkëtingëllorja [sh] dëgjohe shumë pak, si: *shkarkoj, shkrâi, shkuli, shpërthej* etj. Përemri pyetës çka? në këtë të folme, si edhe në të folme të tjera geqe, shqiptohet me [sh]: *shka?*

74. **Shkriрja e grupit [tsh] > [ç].** - Gjatë shqiptimit të njëpasnjëshëm të [t]-së dhe të [sh]-së ndodh shkriрja e tyre në [ç], si i motshëm > *i moçëm, vjetsh > vjeç, patsh > paç.*

Shtegorja e zëshme [zh]

75. Në mbarë shqipen e në këtë të folme [zh]-ja shqiptohet ngjashëm si [sh]-ja. Pra, [zh]-ja është **majegjuhore, alveolare, shtegore dhe e zëshme**. Por, duhet theksuar faktin se këto dy bashkëtingëllore janë fonema të veçanta, i dallon tipari i zëshmërisë: ky çift kundërvihet me mungesën ~ praninë e zëshmërisë: **[sh]**-ja është e shurdhët, ndërsa [zh]-ja e zëshme.

76. Është e drejtë të mendohet se fonemat */sh/ dhe */zh/ nuk kanë qenë pjesë e inventarit konsonantik të gjuhës mëmë indoevropiane të rikonstruuar. Rrjedhimisht, shqipja nuk ka si t'i trashëgonte, por janë zhvillim i brendshëm i shqipes në rrjedhë të kohës, siç ka ndodhur edhe në disa gjuhë të tjera. Nga të dyjat, më e vjetër dhe me denduri më të lartë është /sh/-ja. Fonema /zh/ dikur është përdorur si alofon i /sh/-së në pozicion para bashkëtingëlloreve të zëshme. Natyrisht, në pozicion të tillë ajo është zëshmuar dhe me kalimin e kohës e ka fituar statusin e fonemës së veçantë, e cila sot paraardhëses së saj i kundërvihet me praninë e tiparit të zëshmërisë.¹⁹⁹

77. Bashkëtingëllorja [zh], si në shqipen dialektore, ashtu edhe në shqipen standarde ka përdorim mjaft të kufizuar. Nga materiali i vjelë në terren mund të sjellim vetëm pak fjalë (shqipe ose të huazuara) që në përbërjen fonematike të tyre kanë edhe [zh]: *zhdrop* 'zbrit', *zhegër, zhu:g* 'zgjebë', *zhgun, zhig, zhag* 'zvarrë', *zhi:v, zhapin, zha:b* 'bretkosë', *zhredh* (me [zh] si parashtesë), *go:zhd, dërzha:v* 'shtet', *pizhimuzh* 'kërmill'.

78. Në të folmen për të cilën po bëjmë fjalë nuk kemi hasur asnjë rast të shndërrimit fonetik që ka të bëjë me bashkëtingëlloren [zh].

Afrikatja [ç]

79. Varianti kryesor i bashkëtingëllores [ç] shqiptohet si **paragjuhore, alveolare, afrikate dhe e shurdhët**. Në fakt, afrikatet kanë njëtim të përbërë e të shkriрë në dy faza artikulesore: fillim mbylltor dhe mbarim shtegor. Bashkëtingëllorja [ç] në fazën e parë njëtohet si mbylltorja [t], ndërsa në fazën e dytë si shtegorja [sh]: [t] + [sh] = [ç]. Nisur nga kjo, ka mendime se sipas gjithë gjasash njëri nga burimet kryesore të përfutimit të afrikates /ç/, krahas afrikatizimit të /sh/-

¹⁹⁹ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 215-216.

së, është edhe shkrirja e grupit /tsh/ në /ç/, sidomos gjatë të folurit të shpejtë.²⁰⁰

80. Sa i përket dendurisë dhe përndarjes (frekuencës dhe distribuimit) së përdorimit të kësaj bashkëtingëlloreje mund të konstatohet se ajo ka shkallë të ulët përdorimi. Por, në përndarjen e saj nuk kemi as kufizime pozicionale e as kufizime kombinatorë: paraqitet në të gjitha pozitat e fjalës (në fillim, në mes e në fund) dhe mund të qëndrojë para dhe pas çdo zanoreje ose bashkëtingëlloreje. P.sh.: *çull, çatâi, çoban, çorb, çafk, çorr, çels, çifçâi, çish?, çaj, çinçan; koçak, kaçimak, ovçar, ni kaçêit buk* ‘një kafshatë (kafshore, kashore) bukë’, *terçi, maçek, pla:çk, baçe, mehaniçar* ‘mekanik, automekanik’; *vêiç, veç, çekiç, kovaç, saraç, truç, kapuç, vlla:ç, çarda:k, çauş* etj.

81. Është e qartë se këtë bashkëtingëllore nuk e gjejmë të huazimet latine, por e hasim të fjalët e shqipes, të huazimet sllave, të turqizmat etj.²⁰¹

Denduria e përdorimit të bashkëtingëllores [ç] në këtë të folme është zmadhuar dukshëm me shndërrimin e [q] > [ç]. Në fakt, afrikatizimi i bashkëtingëlloreve mesgjuhore si dukuri fonetike është i njohur në shumë të folme geqe. Nyjëtim më të përparmë të mesgjuhores [q] dëgjohet në të gjitha pozitat e fjalës dhe nuk ka kushtëzim fonetik: afrikatizohet para çdo zanoreje. Krahaso shembujt: *çaf* < qafë, *façe* < faqe, *keç* < keq, *u knaça* < u kënaqa, *çiçe* < qyqe, *çi:ll* < qiell, *miçt* < miqtë, *çip* < qyp, *çaj ç* punon ka: < ai që punon ka etj.

82. *Shndërrime tingullore të [ç]-së*.- Tani më u tha se grupi bashkëtingëllor [tsh] shkrihet në [ç]: *i moçëm, dardha lançe* ‘dardha langshe’ etj. Në të folmen e f. Grushinë kemi dëgjuar një shembull të shkrirjes së grupit [fsh] në [ç], proces që ka shkuar në disa faza ndryshimesh tingullore, me gjasë: [fsh] > [sh] > [ç]: *kaçore* < kashore < kafshore ‘kafshatë’; në f. Billacë - [ç] > [sh]: *diçka* > *dishka*; në f. Brezë e Malinë [gj] > [ç]: *kinç* < kingj ‘qengi’, *zoçt* < zogjtë.

Afrikatja [xh]

83. Afrikatet janë rezultat i zhvillimit të mëvetësishëm e të brendshëm të disa gjuhë indoevropiane. U mor vesh se edhe në gjuhën shqipe, në periudhën paslatine, së pari është shfaqur /ç/-ja e pazëshme dhe pas saj çifti përkatës i zëshëm /xh/. Mendohet se /xh/-ja në fillim ka qenë alofon i /ç/-së, i kushtëzuar fonetiki, që më pas në rrjedhë të kohës u dallua si fonemë më vete. Denduria e saj është shtuar nëpërmjet fjalëve të huazuara nga gjuhët e huaja, sidomos nga turqishtja dhe italishtja.²⁰²

84. Si në të folmet e tjera dhe në shqipen standarde, bashkëtingëllorja [xh] është **paragjuhore, alveolare, e zëshme dhe afrikate**: [xh] = [d] + [zh]. Gjatë artikulimit të [xh]-së mbyllja dhe fërkimi duhet të merren si një akt i vetëm e i pandarë artikules. Çasti i ndërkalimit është shumë i shkurtër, ndaj kjo bashkëtingëllore (si edhe afrikatet e tjera) është e thjeshtë dhe jo e përbërë.

85. Bashkëtingëllorja [xh] në këtë të folme ka përdorim të kufizuar.²⁰³ Marrë në

²⁰⁰ Po aty, f. 233.

²⁰¹ Po aty, f. 233-234.

²⁰² Shaban Demiraj, *Fonologjia ...*, f. 234.

²⁰³ Në shqipen standarde /xh/-ja me 0.04% denduri përdorimi në ligjërimin e lidhur, zë vendin e parafundit (të 35-të) në shkallën e përdorimit të fonemave. Shih: Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011; f. 216.

përgjithësi, ajo shfaqet në huazimet turke, si: *xhezve, e xhuma, xhenet; xhami:, xhamâj, xha:m, xha:de*; te emrat vetjakë me burim oriental: *Xhezmi:, Xheva:t, Xhevrije, Nexha:t, ...; oxha:k, filxha:n, baxhanak, tenxhe:re, tuxha:r, tuxharllêik, hamamxhêik, suxhuk, janxhêik, ho:xh, mi:xh, mâixh*; profesionet me prapashtesën turke *-xhi*, që është produktive edhe në formimin e fjalëve të reja, sidomos në të folmet popullore, si *papuçexhî, kunraxhî, strujaxhî, sharraxhî, sahatxhî, teneqexhî* etj., përdoret në formë të padiftonguar.²⁰⁴

86. **Afrikatizimi i qiellzores [gj] > [xh]**. Denduria (frekuenca) e përdorimit të [xh]-së në këtë të folme është rritur dukshëm si pasojë nyjetimit më të përparmë të mesgjuhores [gj]. Pra, nyjetimi i [gj]-së bëhet në një zonë të gjerë, që nga pjesa e prapme e trysave e deri në pjesën më të përparme të tyre. Veç alofoneve të ndryshme të [gj]-së (herë si qiellzore, herë si qiellzore më e përparme a gjysmafrikate, por edhe si afrikate) vlerësuam se afrikatizim të plotë të [gj] > [xh] kemi te fjalët *xharpën* (< gjarpën), *xhak* (< gjak), *i xha:ll* (< i gjallë), *xhu:m* (< gjumë), *xha:sht* (< gjashtë), *xhims* (< gjysmë), *xheth* (< gjeth), *e xheta* (< e gjeta) etj.²⁰⁵

Tingëlluesja hundore [n]

87. Varianti kryesor i kësaj bashkëtingëlloreje nyjtohet si **paragjuhore, alveolare, shtegore, sonante dhe hundore**.²⁰⁶ Karakterizohet me denduri të madhe përdorimi dhe mund të qëndrojë përpara ose pas çdo zanoreje, duke i shtuar së njëjtës timbër hundor. Sipas përndarjes, mund të haset në të gjitha pozitat e fjalës. Në fillim të fjalës: *ni, na:n, na:t, nimim, nxa:ns, nâip; nisa, nâisa, nishan, nase*,²⁰⁷ ...; si parafjalë (në me elizion të [ë]-së): *n'a:r, n'mal, n'fu:sh, n'gro:p, n'dhe*: ... Në trup të fjalës: *une, ânërr, punto:r, kunat, konak, u vanova, kna:t, konop, hanëz* etj. Në fund të fjalës: *çen, vi:n, pu:n, gjin, rre:n, gërshā:n, çuran, xhëlpā:n, emën, femën, dhe:n, çoban, kazan, gru:n, tlin, dhelpën, pepën, pllan, sahan, ā: kâ:n*...

88. Vështruar në pikëpamje diakronike, veçori e përgjithshme e të folmeve gege ka qenë rënia e [n]-së në fundin absolut të fjalës te një numër i konsiderueshëm fjalësh në trajtën e pashquar, te të cilat historikisht ka pasur një [n] organike, ndërsa në fazën e sotme të zhvillimit të njëjtat fjalë mbarojnë me zanore të theksuar. Krahaso format e dikurshme me ato të sotme: *drūn > drū:*, *hūn > hū:*, *frēn > frē:*, *pēn > pē:*, *mullīn > mullī:*, *mullâi* etj. Përkatësisht, rënia e një [n]-je të këtillë ka lënë gjurmë edhe mbi formën e pashquar, meqë në të folmen tonë zanorja e fundit është hundore dhe e gjatë. Në trajtën e shquar te të njëjtat fjalë rishfaqet [n]-ja, pas së cilës vihet nyja shquese -i. Për shembull (forma e pashquar - e shquar): *drū:* - *drū-n-i*, *hū:* - *hū-n-i*, *frē:* - *frē-n-i*, *pē:* - *pē-n-i*, *mullī:* - *mullī-n-i*, *mullâi-n-i* etj.²⁰⁸

89. Folësit gegë për lehtësim shqiptimi kanë prirje të përgjithshme të përngjashmojnë

²⁰⁴ Nga shembujt e dhënë vërejmë se mbaresa turke *-xhi*: në të folmen tonë, në aspektin fonetik përdoret në dy forma: në formë të padiftonguar (e cila mbizotëron) dhe në formë të diftonguar. Sipas gjithë gjasash, orientizmat e përfshirë nga diftongimi janë më të vjetër, ndërkaq format e padiftonguara janë më të reja.

²⁰⁵ Më gjerësisht për afrikatizimin e /gj/-së do të bëhet fjalë në pjesën kushtuar kësaj bashkëtingëlloreje.

²⁰⁶ Anastas Dodi - Jorgji Gjinar, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 63.

²⁰⁷ Haki Ymeri, *E folmja e Karshiakës*, Shkup, 1997, faqe 60 konstaton se “varianti kryesor i diftongut sekondar [âu], shpeshherë paraqitet me elementin e dytë të reduktuar [a_u] deri në [a_ε], si dhe me formë të monoftonguar [a:], si *nâuse, na_use, na_εse, na:se* etj.

²⁰⁸ Në dialektin toskë dhe në shqipen standarde kjo dukuri është e njëjtë me dallim që në dialektin gegë në vend të [n]-së ndërzanore kemi [r] (rotacizëm). Khs.: *dru* - *dru-r-i* (*drū:* - *drū-n-i*) *hu*: - *hu-r-i* (*hū:* - *hū-n-i*) etj. Shih: Dr. Eqrem Çabej, *Rotacizmi e ndalimi i tij*, Studime gjuhësore III, Prishtinë, 1987, f. 132-134.

(asimilojnë) grupet e bashkëtingëlloreve. Lidhur me këtë në të folmen shqipe të Malit të Zi të Shkupit paraqiten dy izoglosa: a) të folme që përngjashmojnë grupin [nd] dhe b) të folme që ruajnë të paprekur këtë grup bashkëtingëlloresh. Përkatësisht kemi:

a) **Përngjashmimi i grupit bashkëtingëllor [nd] në [n]**. - Në fqinjësi me një tingëlluese hundore ([n, m]) bashkëtingëllorja [d] bie plotësisht ose humbet në cilëndo qoftë pozitë të fjalës, në të folmen fshatrave Bllacë, Tanushë, Brezë, Grushinë, Orllancë dhe Mojancë, si në fjalët: *nër* (< ndër), *ner* (< nderë), *e nreça* (< e ndreça), *u nal* (< u ndal), *ngjoj* (< ndëgjoj, dëgjoj), *nij* (< ndiej); *mene* (< mendje), *katuna:r* (< katundar), *gjinmi* (< gjindemi, gjendemi), *mrena* (< mbrenda, brenda), *anërr* (< ëndërr), *shnet* (< shëndet), *munash* (< mëndafsh); *gazmen* (< gazmend), *vën* (< vend); *e tûn*, *e tån* (< e tundë), *fûn* (< fund), *parmën* (< parmendë), *katun* (< katund), *e shku:n* (< e shkundë) etj.

Dukuria e asimilimit të [nd]-së në [n] padyshim se mbisundon në të folmet e lartpërmendura. Megjithatë, gjatë analizës së materialit të vjelë dialektor, gjetëm edhe pak fjalë ku ky grup përdoret i pandryshuar në fshatrat Mojancë, Orllancë dhe Grushinë: *ndi:*, *kundër*, *ëndërr*, *e ndreqt* etj. Përkundrazi, në të folmet e fshatrave Tanushë, Bllacë, Brezë e Malinë nuk hetuam asnjë shembull me [nd] të ruajtur.

b) **Ruajtja e grupit [nd]**. - Izoglosën e dytë të kësaj të folmeje e përbëjnë fshatrat Luboten dhe Straçincë, në të cilat mbizotërojnë format e fjalëve që e ruajnë grupin e bashkëtingëlloreve [nd]. P.sh.: *ndër*, *na*; *nde:r*, *ndihëm*, *ndrêjshe*, *ndreq*; *mendje*, *mundash*, *mbrenda*, *katundar*; *vend*, *parmend*, *fund*, *nond*, *tound*, *hund*, *shkûnd*, *katâund*. Edhe te kjo izoglosë të pak fjalë [nd] > [n]: *shnet*, *munsêi*, *faleminer!*, *nime*, *përnime* etj.

90. **Përngjashmimi i rrallë i [nd] > [d]**. - Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, pak fjalë në përbërjen e të cilave përgjithësisht kemi [nd], na dalin me [d], si p.sh.: *daje mishin!* (< ndaje mishin), *doni dit* (< ndonjë ditë), *doni her* (< ndonjë herë).

91. Ruajtje e përngjashmim kemi edhe te grupi [ng]: [ng] = [ng]; [ng] > [□]; [ng] > [g]. Lidhur me këtë dukuri fonetike, në këtë të folme përvijohen katër izoglosa:

a) **Shqiptimi i pandryshuar i grupit të bashkëtingëlloreve [ng]**. - Në të folmen e fshatrave Straçincë, Luboten, Orllancë dhe Mojancë ky grup bashkëtingëlloresh ruhet rregullisht: *ngul*; *ngaj*, *ngarendi*, *ngushtoj*, *i ngat*, *ngrâ:n*, *ngarkoj*, *ngrej*; *hôngra*, *kungull*, *zengin*, *frengi derës*; *lang*; *caëng*, *cung*; *opang* etj.

b) **Përdorimi i dyfishtë i grupit [ng]: me ruajtje dhe me shkrirje në [ŋ]**. - Në të folmen e fshatit Grushinë dëgjuam përdorim të dyfishtë: ruajtjen e këtij grupi me shumë shembuj të shkrirjes së të njëjtit grup në një bashkëtingëllore prapagjuhore [ŋ]. P.sh.: *hongra*, *ngat*, *ca^ëng*, *ngas*, *ngul*, *nga!*; por *ŋreje!*, *e ngarkova*, *e ŋarkova*.

c) **Shkrirja e grupit [ng] në [ŋ]**. - Në fshatrat Tanushë dhe Brezë grupi [ng] rregullisht jep [ŋ], si në fjalët: *ŋat* 'ngat', *ã: ŋrâj* 'asht ngrâi, është ngrirë', *ŋrehs* 'ngrehs, ngrehës', *la:ŋ* 'lang, lëng', *opa:ŋŋ* 'opangë, opingë', *buŋ* 'bung', *shllu:ŋ* 'shllungë, shtëllungë' etj.

ç) **Rënie të elementit të parë: [ng] > [g]**. - Në fshatin Bllacë grupi bashkëtingëllor [ng] reduktohet në [g]. Krahaso shembujt: *garê:n* (< ngarend), *me grâ:n* (< me ngranë), *i ga:t* (< i ngatë), *i groft* (< i ngrohtë), *e greh* (< e ngreh), *u grêitën* (< u ngritën), *gat* (< i cekët, i ngatë), *e garkon* (< e ngarkon) etj. Te fjalët *lang* dhe *hongra* ruhet ky grup konsonantik; ndërsa te fjalët *meŋez* dhe *kunjëll* kemi shkrirjen e [ng] > [ŋ].

Sonantja alveolare [l]

92. Bashkëtingëllorja [l] në të folmen tonë, si edhe në të folmet e tjera shqipe, por edhe në të folmet toske e në shqipen standarde, shqiptohet si *paragjuhore, qiellzore, lëngëzore, anësore dhe e tingullt (sonante)*. Për nga përdorimi është e shpeshtë dhe gjendet në çdo pozitë të fjalës pa ndonjë kufizim: para ose pas çdo zanoreje ose bashkëtingëlloreje. Kjo përdoret më dendur se simotra e saj [ll], me të cilën shpeshherë krijon kundërvënie fonologjike, duke krijuar çifte minimale fjalësh.

93. Folësit e kësaj krahine qartazi i dallojnë të dyja bashkëtingëlloret, andaj edhe për këtë të areal gjuhësor i llogarisim si dy fonema të veçanta. Kundërvënia fonologjike midis tyre realizohet nëpërmjet tiparit dallues alveolare ~ velare: /l/ ~ /ll/. Do të japim disa fjalë, në të cilat pjesë e njërive vijore është edhe [l]-ja: a) në pozitë nistore *lo:p, lesh, laj, laroj, lu:j, lakën, liku:r, lu:g, largj, lot, u lodha*; b) në trup të fjalës: *plak, nalt, klish, zile, kalani:c, bilu:r, xhelpa:n, çels, delme, kulm*; c) në pozitë fundore: *ka:l, pu:l, gja:l, shul, fo:l, fa:l, i vogël, fja:l, mal...*

94. Kjo bashkëtingëllore karakterizohet me shqiptim të qëndrueshëm, pa shndërrime në tinguj të tjerë. Ky konstatim vlen sidomos kur bashkëtingëllorja [l] nuk është pjesë përbërëse e ndonjë grupi konsonantik.²⁰⁹ Megjithatë te pak fjalë vërehet shndërrimi i [l] > [ll].

95. *Velarizimi i [l] > [ll]*. - Te të gjitha format e përemrit pyetës (në njëjës e në shumës, për gjininë mashkullore e femërore) *cili* në të folmen tonë [l]-ja është shndërruar në [ll], si: *câlli* (< câlli < cili), *câlla* (< cailla < cila), *câllët* (caillët < cilat), *câllat* (< câllat < cilat) për shumësin e femërore.²¹⁰ Duke ruajtur format e fjalëve me [ll] (maq. л) nga maqedonishtja,²¹¹ në vend të formave të zakonshme të gjuhës shqipe me [l], te pak fjalë në rrethin e Karadakut, si edhe te të folmet e tjera të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut (por edhe në Kosovë nën ndikimin e serbishtes) dëgjohej [ll], si: *pllan, dipllo:m, fillozof, tunell, centra:ll* etj.²¹²

Anësorja alveolare-dhëmbore [ll]

96. Kjo bashkëtingëllore është *alveolare-dhëmbore, mbylltore, lëngëzore, anësore dhe sonante*. Me dendurinë dhe përndarjen e saj, si dhe nga pikëpamja e saj artikuluese, në të folmen në shqyrtim, ashtu si në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore, nuk paraqet ndonjë veçanti nga të folmet e tjera shqipe në përgjithësi, e as nga gjuha standarde shqipe. Kjo ka një përdorim më të kufizuar sesa simotra e saj [l], megjithatë haset si në fjalët e gurrës, ashtu edhe në fjalët e huaja. Përdoret në të gjitha pozitat e fjalës, si: *llo:m* (llambë), *llom, lloç, llastër, llasta:r, llaf, llaskuc, llagom, llu:ll; shulla, flā:z, vlla, plug, e dille, dollap* (dritare), *popllav* (vërshim), *filloj, kallamoq, i rrumllakt, dhallt; cu:ll, ca:ll; di:ll, mi:ll, ç:i:ll, si:ll* (drekë), *vetëll, petëll, setëll, ba:ll, za:ll, bu:ll, akëll, ufëll, kapru:ll, boll, kujëll, fâill, e ho:ll* etj.

97. *Mosqiellzorëzimi i /l/-së* te forma e shumësit të disa emrave. - Në gjuhën standarde shqipe, si dhe në të folmet toske, bashkëtingëllorja /ll/ palatalizohet, përkatësisht jotizohet në [j] gjatë formimit të shumësit të disa emrave, sipas shembullit në njëjës: *kungull > shumës: kunguj*. Në këtë areal gjuhësor /ll/-ja nuk qiellzorizohet, duke e formuar shumësin me prapashtesën -a:²¹³

²⁰⁹ Për grupet e bashkëtingëlloreve [pl], [bl], [fl] kemi bërë fjalë në përshkrimin e bashkëtingëlloreve [p], [b] dhe [f].

²¹⁰ Vërehet se te këto forma kemi diftongimin e [i]-së së theksuar në [âi], dhe pastaj monoftongimin në [a:] të gjatë.

²¹² Fjalët e këtyra folësit e këtij regjioni i kanë huazuar nga gjuhët sllave (maqedonishtja apo serbishtja).

²¹³ Formimi i shumësit të emrave me prapashtesën -a është forma më e shpeshtë në dialektin e Veriut.

kunëll ~ kunll-a (shqipja standarde e shumica e të folmeve të Veriut e të Jugut: kungull ~ kunguj), *kërmâill ~ kërmâill-a* (kërmill ~ kërmij), *portokall ~ portokall-a* (portokall ~ portokaj), *grumëll ~ grumll-a* (grumbull ~ grumbuj), *hamall ~ hamall-a* (hamall ~ hamej) etj.

Sonantja dridhëse [r]

98. Bashkëtingëllorja [r] është **paragjuhore, alveolare, dridhëse** dhe **sonante** si në gjuhën standarde shqipe, ashtu edhe në të folmen tonë. Lidhur me dendurinë e përdorimit (frekuencën) dhe përndarjen (distribuimin) mund të themi se kjo bashkëtingëllore është e shpeshtë dhe përdoret në të gjitha pozitat e fjalës. Megjithatë, po të krahasohet denduria e përdorimi të bashkëtingëllores [r] që ka në të folmen e Karadakut të Shkupit me dendurinë e saj në gjuhën standarde do të konstatohet se [r]-ja përdoret më rrallë në Karadak, si edhe në të gjitha të folmet e tjera të Veriut, sesa në toskërishte dhe në shqipen standarde.

99. Dihet se [n]-ja ndërzanore (dikur e mbarë shqipes) është ruajtur vetëm në gegërishte, ndërsa në toskërishte ajo është shndërruar në [r], që njihet me termin rotacizëm. Por, kjo dukuri nuk sjell as dallime në organizimin e fonemave, as dallime kuptimore. Si rrjedhim, ai është një dallim sasiar e jo cilësor, d.m.th. lidhet vetëm me përndarjen e fonemave /r/ dhe /n/, ose me dendurinë e përdorimit të njërës e të tjetrës fonemë, pa ndonjë kushtëzim fonetik. Këto fonema përdoren që të dyja në të dy dialektet, veçse si pasojë e rotacizmit të dikurshëm, në Jug ka denduri më të madhe /r/-ja, kurse në Veri ka denduri më të madhe /n/-ja.

100. Ja disa fjalë në të cilat është e pranishme sonantja [r]: *i ri, e re; (kam) ra:, e rân, e run; reze, radi, raki; largj; trap, trâup; krâip, tra:, dre:k, da:rk, vo:rb, brez, shpâirt, drapën, tërma:, bri:, i fo:rt, kapra:ll, ftark, mâir, gjur, nje:r, bakër, votër, qimir, zemër, do:r, fa:r, lakna:r, ba:r, magjar, de:r, ahër, u:r, sofër, bo:r* etj.

101. Në këtë të folme nuk vërejtëm ndonjë shndërrim fonetik të bashkëtingëllores [r], që do të thotë se ajo në përdorim është mjaft e qëndrueshme. Vetëm në të folmen e fshatit Grushinë lidhësen *edhe* e përdorin në formën *ere*, me ndërrimin e [dh] > [r].

Shumëdridhësja [rr]

102. Në shqipen e shkruar dridhësja alveolare /r/ dhe dridhësja qiellzore-alveolare /rr/ dëshmojnë si dy fonema të veçanta. Nga këto dy fonema /r/-ja është trashëguar nga gjuha mëmë indoevropiane, ndërsa /rr/-ja është përfutur gjatë zhvillimit të brendshëm të gjuhës shqipe, me rritjen permanente të dridhjeve.²¹⁴

103. Në këtë të folme [rr]-ja shqiptohet si bashkëtingëllore **vidridhëse (vibrante), tingëlluese (sonante), paragjuhore** dhe **qiellzore-alveolare**. Gjatë artikulimit të [rr]-së dhe [r]-së maja e gjuhës e cila është e ngritur përpjetë afrohet deri tek alveolat. Rryma e ajrit dridh majën e gjuhës, e cila ndonjëherë prek edhe qiellzën. Në gjuhën shqipe të vetmen kundërvënien midis bashkëtingëlloreve për nga gjatësia (e shkurtër e gjatë) e kemi tek çifti /r/ ~ /rr/.²¹⁵

²¹⁴ Shaban Demiraj, *Fonologjia ...*, f. 175-176.

²¹⁵ Parashtrohet pyetja: Çfarë dallimi ka ndërmjet [r]-së dhe [rr]-së? Të dyja janë majegjuhore, por [r]-ja është alveolare ndërsa [rr]-ja qiellzore-alveolare. Në pikëpamje fonologjike, fonemat /r/ dhe /rr/ i kundërvihen njëra-tjetrës me dy tipare: 1. Me numrin e dridhjeve të majës së gjuhës (1-2 te [r]-ja, 3-4 te [rr]-ja, dhe 2. Me ndemjen

104. Ngarkesa funksionale e kundërvënies së fonemave /r/ dhe /rr/ në të folmen tonë, si edhe në përgjithësi në shqipen standarde, nuk është shumë e madhe, meqë është tregues i vetëm për të dalluar kuptimin e një numri të vogël çifte minimale fjalësh, si: *ara ~ arra; ru:j, râuj, ra:j ~ rru:j, rrâuj, rra:j, mora ~ morra, kur ~ kurr, fur ~ fu:rr*. Megjithatë, këto dy fonema në këtë të folme i dallojnë qartë.

105. Për nga përdorimi, bashkëtingëllorja [rr] është më e rrallë se [r]-ja. Njëdridhësja [r] përdoret 12.56 herë më shumë se shumëdridhësja [rr].²¹⁶ Por, megjithatë haset në të gjitha pozitat e fjalës, si: *rrâush, rra:sh; rrogj, rrâip, rrai, rrunx, rre:n, rrotëll, rrem, i rra:ll, rra:j, rrênâim, rrak, rrogzi:n*; te emrat e përveçëm me prejardhje orientale: *Rrahim, Rrahman* etj; *krroç, carrok, prru:, thâirri, murrall, ndrroj; anërr, the:rr, bu:rr, vorr, so:rr, hi:rr, ko:rr, marr; i vacërr, i vocërr; mekërr, a:rr, vehërr, dhanërr* etj.

2.5.4. BASHKËTINGËLLORET QIELLZORE

106. Në të folmen e shqiptarëve të Malit të Zi të Shkupi si edhe përgjithësisht në të folmet e tjera, sigurisht se edhe në gjuhën standarde, grup të veçantë bashkëtingëlloresh krijojnë mesgjuhoret, përkatësisht palatalet: [q], [gj], [j] dhe [nj].

Mesgjuhorja mbylltore [q]

107. Mesgjuhoret mbylltore /q/ dhe /gj/ janë si rezultat i zhvillimit të brendshëm të gjuhës shqipe. Ato kryesisht janë përfutur nga palatalizimi i prapagjuhoreve /k/ dhe /g/.²¹⁷

108. Në të folmen tonë shqiptimi i [q]-së dallon nga fshati në fshat: **mesgjuhore** (shpeshherë paragjuhore), **qiellzore** (paraqiellzore, shpeshherë alveolare), **mbylltore** (shpeshherë afrikate) dhe **e pazëshme**. Duhet theksuar se bashkëtingëllorja [q] në këtë areal ka një artikulum më të përparmë, sesa në të folmet toske dhe në shqipen standarde. Shpeshherë kemi hasur në vështirësi dhe mëdyshje në përcaktimin e nyjetimor të saj: nëse është qiellzore, një variant i mesëm i paraqiellzores dhe afrikates, përkatësisht palatalo-frikativ [qʰ], apo afrikat mesgjuhor [cʰ] ose me nyjetim tërësisht të afrikatizuar në [ç].

109. Sipas vlerësimit tonë, edhe pse me një artikulum më të përparmë, mesgjuhorja /q/, së paku në pjesën më të madhe të të folmeve të këtij regjioni, duhet llogaritur si tingull i veçantë dhe si fonemë e veçantë, edhe krahas shembujve të shumtë të afrikatizimit të saj në shkallë të ndryshme: nga afrikatizimi i pjesshëm deri në afrikatizimin e plotë. Përkatësisht, edhe në përshkrimet e deritanishme dialektologjike të disa të folmeve të caktuara të gegërishtes qendrore

(tendosjen) e organeve të të folurit: [r]-ja shqiptohet pa ndemje, [rr]-ja me ndemje. Përgjithësisht, në të folmet toske dhe në disa të folme të gegërishtes jugore ngjashmëria nyjetimore dhe ngarkesa e vogël funksionale ka lejuar rrafshimin e kundërvënieve fonologjike të bashkëtingëlloreve /t/ dhe /rr/. Mirëpo, këto janë dy fonema të veçanta, gjë që provohet me çifte minimale fjalësh të tilla, si *ara ~ arra, ruaj ~ rruaj, ras; ~ rras;*, *deri ~ derri, rimë ~ rrimë* etj. Shih: Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011; f. 168.

²¹⁶ Anastas Dodi, *Shqipja si gjuhë ballkanike në vështrimin e gjuhësisë sasiore*, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tiranë, 1996, f. 759-765.

²¹⁷ Shaban Demiraj, *Fonologjia*, f. 196.

kemi mendime të ndryshme lidhur me qiellzoret /q/, /gj/ si edhe shkallën e afrikatizimit të tyre, përkatësisht alofoninë dhe përndarjen e tyre.²¹⁸ Në të vërtetë, zona e nyjetimit (fusha e përhapjes, champ de dispersion) të mesgjuhoreve [q, gj] në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit është mjaft e gjerë: nga pjesa e përparme e qiellzës së fortë e deri te pjesa e përparme e trysave. Përcaktimi i saktë i vendit të nyjetimit mund të bëhet vetëm me palatograf ose edhe më mirë me elektropalatograf.²¹⁹

110. Është e drejtë të pohojmë se mosdallimi i qartë i mesgjuhoreve /q, gj/ me afrikatet /ç, xh/ në të folmet e Veriut bëhet për shkak të ngarkesës së vogël funksionale të çifteve /q/ ~ /ç/ e /gj/ ~ /xh/. D.m.th. në shqipen ka pak çifte minimale fjalësh që dallohen për nga kuptimi vetëm me opozicionin që krijojnë mesgjuhoret me gjegjëset më të përafërta afrikate (me qe:n ~ me çen). Kjo është edhe arsyeja e afrikatizimit të plotë të mesgjuhoreve në disa të folme shqipe, sidomos të folmet e gegërishtes verilindore (kosovarishten).

111. Është e njohur se bashkëtingëlloret mesgjuhore afrikatizohen sidomos kur gjenden në fqinjësi me zanoret e përparme [i] dhe [e], për shkak të përshtatjes nyjetimore (akomodimit të tingujve), dhe pastaj me analogji ky shqiptim më i përparmë është zgjeruar jo vetëm në pozicion me zanoret e përparme, por edhe në rrethime tingullore të tjera, duke marrë karakter të përgjithshëm. Kështu mendojnë thuajse të gjithë dialektologët, si K. Tagliavini,²²⁰ K. Cipo,²²¹ B. Beci,²²² L. Mulaku,²²³ R. Nesimi,²²⁴ H. Imeri²²⁵ etj. Dukuria e afrikatizimit të mesgjuhoreve vepron edhe në maqedonishten dialektore.²²⁶

112. Në të folmen e kësaj krahine si mesgjuhore (të paafrikatizuara) ruhen tingujt që përftohen nga qiellzorizimi i grupeve të bashkëtingëlloreve [pl] e [tj] > [q], përkatësisht [g] > [gj]. Te huazimet turke zakonisht nuk kryhet afrikatizimi i [q]-së në [gj], si: *qef, qosh, qare, duqan, ashiqare; gjizllik, gjile, gjitirim* etj.

113. **Afrikatizimi i [q]-së në [ç].** - Mesgjuhoret [q] dhe [gj] te fjalët anase, si edhe te huazimet e moçme, veçmas latinizmat, janë afrikatizuar. P.sh.: *ça:f, çen, çeth, miç, i kuç, çu:ll, çl* (që); *çiçe* etj. pa përrjashtim, në çdo pozitë të fjalës e në çdo rrethim tingullor.

114. Shndërrimi i [q]-së në [ç], ose shprehia e përgjithshme nyjetimore e shqiptimit më të përparmë të mesgjuhoreve prek përbërjen dhe kundërvëniet brenda sistemit konsonantik, meqë

²¹⁸ Bahri Beci, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987, f. 33-36.

²¹⁹ Ne nuk kemi ende laborator të fonetikës eksperimentale (instrumentale, laboratorike). Me teknikën tradicionale të *palatografisë* përcaktohet vendi i prekjes së gjuhës me qiellzën gjatë nyjetimit të disa tingujve, ndërsa tani *elektropalatografia* mundëson që këto kontakte të ndiqen suksesivisht në rrjedhën e të folurit. Shih: Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011; f. 42.

²²⁰ Carlo Tagliavini, *Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore*, SGJ I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 126.

²²¹ Kostaq Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, f. 24.

²²² Bahri Beci, *Hulitime gjuhësore në Mat*, BUSH, SShSh, 1962/2 dhe 1963/3, f. 255.

²²³ Latif Mulaku, *Govor Albanaca Bajgorske Šalje* (fonetika i morfologjia), Priština, 1968, f. 89.

²²⁴ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 162-167.

²²⁵ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1998, f. 87 për palatalizimin e bashkëtingëlloreve [q, gj] konstaton se te fjalët anase, si edhe te huazimet e hershme latine dhe të gjuhëve të tjera kanë kaluar në grupin e afrikateve. Në këtë mënyrë është asnjansuar kundërvënien e kahmotshme /q ~ ç/ dhe /gj ~ xh/, si: *çi:ll* (qiell), *i xha:ll* (i gjallë), *i keq* (i keq), *i kuç* (i kuq), *kriç* (kryq), *ça:f* (qafë); *xhak* (gjak), *xho* (gjë), *i xha:ll* (i gjallë), *xhi:z* (gjizë), *xhum* (gjumë), *exhër* (egjër), *nxes* (ngjes), *nxi* (ngjyë) etj.

²²⁶ Afrikatizimin e [q]-së e ndeshim edhe në të folmen maqedonase të Kumanovës, ku “ky tingull paraqitet në dy variante themelore, si: q - afrikat paraqiellzor, i cili mund të shqiptohet me afrikatizim të dobët apo të fuqishëm, dhe k’ - tingull palatal, i cili mund të dëgjohet me shkallë të ndryshme palatalizimit. Shih: Божидар Видоески, *Кумановскиот говор*, Скопје, 1962, f. 70.

sjell zvogëlimin e sasisë së fonemave bashkëtingëllore, dhe si pasojë e saj bëhen ndryshime të caktuara në sistem. Megjithatë, edhe me procesin e afrikatizimit të mesgjuhoreve (nëse përjashtojmë fare pak çifte minimale fjalësh që ka shqipja me shënjes të vetëm kuptimdallues që realizohen me kundërvënien mesgjuhore ~ afrikate: /q, gj/ ~ /ç, xh/) akti komunikues nuk priset. Në fakt, funksioni kuptimdallues i vogël ka lejuar edhe shumëllojshmërinë e varianteve (kombinatorë, krahinorë e individuale) të fonemave /q, gj/, si alofone mesgjuhore e paragjuhore.

115. Me asnjësimin e kundërvënies /q/ ~ /ç/ edhe në këtë të folme, lind pyetja: A kemi në të folmen e Karadakut të Shkupit fonemë mesgjuhore mbylltore /q/ apo nuk kemi? Kësaj pyetjeje do t'i përgjigjemi me po. Nëse gjykojmë sipas asaj që kemi dëgjuar, shënuar e incizuar në këtë areal gjuhësor do të përgjigjemi se: edhe pse [q]-ja primare ka pësuar dy shkallë afrikatizimi, e folmja shqipe e Karadakut (si edhe të folmet e tjera të gegërishtes qendrore) ka krijuar /q/ mesgjuhore nga qiellzorizimi i grupeve [pl] e [tj], sipas tipit *qak* < plak, *qe:shk* < pjeshkë.

116. Si përfundim, konsonantet primare /q/ dhe /gj/ të trashëguara si dhe ato të latinizmave janë afrikatizuar, por në të folmen shqipe të Karadakut (sigurisht edhe në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore) në rrjedhë të kohës nëpërmjet palatalizimit të disa grupeve konsonantike janë përfutur bashkëtingëllore të reja mesgjuhore [q] dhe [gj].

117. **Palatalizimi i grupeve të bashkëtingëlloreve [pl], [pj] dhe [tj] në [q].** - Banorët e fshatrave Luboten, Straçincë, Brezë e Malinë (në dy katundet e fundit [pj] > [p]) kanë shprehur nyjëtimore që grupet e bashkëtingëlloreve [pl], [pj] dhe [tj] t'i qiellzorëzojnë në [q]. Mesgjuhoren [q] rregullisht e shqiptojnë si të tillë, nuk e afrikatizojnë. P.sh.:

- [pl] > [q]: plak > *qak*, pleh > *qeh*, plep > *qep*, pluhën > *quhën*, plum > *qum*, planc > *qanc*, plasi > *qasi*, plaq > *qa:q*, tërplotë > *tërqote*, plesht > *qesht*, pëlhurë > *qihu:r*, plot > *qot* etj.

- [tj] > [q]: pjeshkë > *qe:shk*, e pjekët > *qekt*; tjetri > *qetri*, shtjerra > *shqerra*, e tjerr > *qerr* etj.

118. Në të folmen e fshatit Tanushë, Bllacë, Grushinë, Mojancë dhe Orllancë këto togje bashkëtingëlloresh ruhen, përkatësisht nuk palatalizohen.²²⁷

Mesgjuhorja [gj]

119. Kjo bashkëtingëllore shqiptohet si *mesgjuhore* (palatale), *mbylltore* dhe si çift i zëshëm i të shurdhëtës [q]. [Gj]-ja primare, në përbërjen e fjalëve anase dhe te huazimet latine, në të folmen shqipe të Malit të Zi të Shkupit, marrë në përgjithësi, si edhe bashkëtingëllorja [q], afrikatizohet. Krahaso: gjysmë > *xhimc*, gjashtë > *xha:sht*, gjumë > *xhu:m*, gjak > *xhak*, i gjallë > *i xha:ll*, gjiz > *xhi:z*, gjarpën > *xharpën* etj. Mosdallimi i mjaftueshëm i kundërvënies /gj/ ~ /xh/ (si dhe i opozicionit /q/ ~ /ç/) gjen mbështetje në vlerën e vogël funksionale, d.m.th. rreziku nga homofonia e fjalëve është fare e vogël.

120. Është e kuptueshme se me procesin e afrikatizimit të [gj]-së, nga njëra anë zvogëlohet frekuenca e kësaj mesgjuhoreje, por nga ana tjetër denduria e saj rritet me palatalizimin e prapagjuhores [g], si edhe të disa grupeve bashkëtingëlloresh: [dj], [gl], [bl] në [gj] të mirëfilltë.

121. **Qiellzorizimi i prapagjuhores [g] > [gj].** - Ndër risitë fonetike shumë të përhapura

²²⁷ Grupi [pj] nuk palatalizohet as në fshatrat Brezë e Malinë.

në gegërishten qendrore janë: diftongimi i zanoreve të mbyllura në rrokje të theksuar /i/ dhe /u/; shndërrimi [g]-së në [gj]; palatalizimi i grupeve [tj] > [q] dhe [dj] > [gj].²²⁸

Në të folmen shqipe të Malit të Zi të Shkupit dukuri e përgjithshme është kalimi i [g]-së në [gj], e cila nuk është afrikatizuar por ruhet si e tillë. Krahaso format e fjalëve: gur > *gjur*, gardh > *gjardh*, gazmend > *gjazmend*, gojë > *gjo:j*, një pllug > ni *plugj*, paguaj > *pagju:j*, prag > *pragj*, larg > *largj*, gobë > *gjo:b*, gacë > *gja:c*, degë > *de:gj* etj.

122. **Palatalizimi i grupeve të bashkëtingëlloreve**²²⁹ [dj] dhe [bl] > [gj]. – Shprehi nyjetimore e folësve të këtij regjioni është palatalizimi i grupeve të lartshënuar.²³⁰ P.sh.: a) [dj] > [gj]: djalë > *gja:l*, djathë > *gja:th*, djep > *gjep*, e djathtë > *e gjatht*, djeg > *gjeg*, djersë > *gje:rs*, dje > *gje* etj.; b) [bl] > [gj]: blea > *gjeta*, kam *ble* > kam *gje*, e blova > *e gjujta* etj.²³¹

123. Në një numër të vogël fjalësh edhe grupet [bj], [tj] palatalizohen në [gj]: *bjeshkë* > *gje:shk*, *bjeri* > *gjeri*; *atje* > *aqe* > *agje* etj.

124. Disa fjalë me burim ndërkombëtar, të cilat në shqipen standarde në përbërjen fonematike kanë [gj], meqë në këtë të folme kanë hyrë nëpërmjet gjuhëve sllave (serbishtes ose maqedonishtes), shqiptohen me [g], si: *agent*, *generall*, *gimnaz*, *gips* etj. Kjo gjë është e përgjithshme për të gjitha të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut.²³²

Sonantja [j]

125. Varianti kryesor i kësaj bashkëtingëlloreje shqiptohet si *mesgjuhore*, *qiellzore*, *shategore* dhe *sonante*. Gjendet në të gjitha pozitat e fjalës, si te fjalët me burim anas, ashtu edhe te huazimet leksikore. Si p.sh.: *jo*, *ju*, *jap*, *je*, *je:m*, *jot-e*, *jo:n*, *juve*, *janâi*, *jangjêik*, *jorgan*, *je:t*, *ja:k*; *ajo*, *kjo*, *vejan*, *hajvan*, *mendje*; *luj*, *lij*, *huj*, *asaj*, *pej*, *i huj*, *mu:j*, *gërkoj*, *gja:j*, *punoj* etj.

126. Denduria e përdorimit të bashkëtingëllores [j] rritet nëpërmjet konsonantizmit të zanores së patheksuar [i], kur ajo vjen pas një zanoreje të theksuar dhe me të krijon sekuencë diftongore, të tipit ai > *aj*, punoi > *punoj*, mësoi > *mësoj*; lexi > *lexoj*; shkoj > *shkoj* (veta e tretë e foljeve të zgjedhimit të parë në aorist) etj.²³³

127. **Përdorimi i [j]-së antihiatizuese**. – Në të folmen tonë, si edhe në të folmet e tjera, sigurisht se edhe në shqipen standarde [j]-ja përdoret për të zhdukur hiatin, sidomos tek emrat që në trajtën e pashquar mbarojnë me zanore të theksuar. Në këtë krahinë kemi regjistruar fjalë të tilla, si: *gja*: > *gja-j-a*, *haxhi*: > *haxhi-j-a*, *Nuri*: > *Nuri-j-a*, *Basri*: > *Basri-j-a*, *Kadri*: > *Kadri-j-a*, e *re*: > *e re-j-a*, *kadi*: > *kadi-j-a*, *dunja*: > *dunja-j-a*, *hava*: > *hava-j-a* etj.

128. Antihijatizuesja [j] në të folmen tonë, si edhe përgjithësisht në izoglosën e diftongimit të [i]-së së theksuar, nuk përdoret në pozitë pas diftongjeve. Këtë e arsyejojmë me faktin se faza përfundimtare e artikulimit të këtyre diftongjeve (âi, êi, êi, ôi ~ aj, ëj, ej, oj) është shumë e ngjashme me [j]-në, prandaj edhe nuk krijohet hiati. Për shembull: *shpâi* > *shpâi-a* (<

²²⁸ Bahri Beci, *Mbi katër inovacione fonetike të të folmeve ...* f. 261-269.

²²⁹ Në këtë të folme edhe grupi i vjetër konsonantik [gl] është palatalizuar në [gj]: *gluhë* > *gju:h*, *glisht* > *gjisht*, i *glatë* > *i gja:t*, *gluni* > *gjuni* etj. (Shih: Grupet e bashkëtingëlloreve).

²³⁰ Këto grupe konsonantike janë palatalizuar thuajse në mbarë gegërishten qendrore: në të folmen e Tetovës, të Dervenit (Nesimi, monografi e cituar); në të folmen e Kashiakës (Ymeri, monografi e cituar), f. 88-89.

²³ Shih: Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 167-168.

²³¹ Në të folmet e fshatrave Tanushë, Bllacë, Mojancë, Orllancë dhe Grushinë grupi konsonantik [bl] ruhet.

²³³ Më gjerësisht shih kapitullin “Kosonantizimi i zanoreve të patheksuara [i, u].”

shpi-j-a), xhamâi > *xhamâi-a* (< xhami-j-a), kutâi > *kutâi-a* (< kuti-j-a), shamâi > *shamâi-a* (< shami-j-a), temcâi > *temcâi-a* (< tepsi-j-a), krâi > *krâi-a*, munsêi > *munsêi-a* (< mundësi-j-a), kusêi > *kusêi-a* (< kusi-j-a), lethêi > *lethêi-a* (< lejthi-j-a) etj.

129. Po qe se emri në trajtën e pashquar mbaron me diftongun dytësor (âi ose êi) dhe kur trajtën e shquar e formon me mbaresën -i, atëherë si tingull antihiatizues përdoret bashkëtingëllorja [v] ose [n], sipas tipit: shâi > *shâi-v-i*, thâi > *thâi-v-i*, sêi > *sêi-n-i*, mêi > *mêi-n-i*, kallêi > *kallêi-n-i* etj.

130. **Rënia e [j]-së në grupe bashkëtingëlloresh.** - Në pozitë pas dybuzoreve [p], [b], [m], si edhe pas buzore-dhëmboreve [f] dhe [v], folësit e këtij areali (Billacë, Grushinë, Tanushë, Mojancë, Orllancë, Brezë e Malinë), të cilët grupet [pj], [bj] dhe [fj] nuk i palatalizojnë; bashkëtingëlloren [j] nuk e shqiptojnë. Krahaso fjalëformat: pjeshkë > *pe:shk*, pjepën > *pe:pën*, pjekë > *pe:k*, pjellë > *pe:ll*; bjeshkë > *be:shk*, bjer > *be:r*, mbjell > *me:ll*; mjekërr > *me:kërr*, mjegull > *me:gëll*, mjelë > *me:l*; fjetë > *fe:t*; vjeshtë > *ve:sht*, vjelë > *ve:l* etj.

Hundorja [nj]

131. Varianti kryesor i kësaj bashkëtingëlloreje edhe në krahinën e Malit të Zi të Shkupit shqiptohet si *mesgjuhore*, *hundore* dhe *sonante*. Kjo në të folmen tonë ka përdorim të kufizuar. Ajo ruhet më mirë në pozitë nistore, ndërsa në trup dhe në fund të fjalës shumë shpesh shndërrohet në [j] ose [n]. Të folmet e gegërishtes në gjendjen e sotme thuajse nuk kanë [nj] në trup të fjalës në pozitë ndërzanore, si edhe në fundin absolut të fjalës.²³⁴ Megjithatë, edhe krahas kufizimeve të tilla të përndarjes, ajo ende mbijeton si tingull dhe si fonemë. Do të sjellim disa fjalë nga kjo izoglosë në përbërjen e të cilave kemi bashkëtingëlloren [nj]: *njeri*, *nje:rk*, *i njom*, *njã*: (afër, afro), *nja*: (numëror), *njof*, *njoftim*, *njers*, *njer te*; *menja*, *letheshnje* ‘lajthi’, *unjsêin* ‘vend i lagësht, moçalor’, *dunja*: etj.

132. **Shndërrimi i [nj] > [j].** - Në këtë të folme (si edhe në gegërishten në përgjithësi) kundërvënia fonologjike e bashkëtingëlloreve /nj/ ~ /j/ gjithmonë asnjansohet në fundin absolut të fjalës. Neutralizimi i tillë, jo rrallë ndodh edhe në trup të fjalës, dëgjohet në gjitha fshatrat e këtij areali, gjë që zvogëlon dendurinë e përdorimit të [nj]-së në të mirë të [j]-së. Kjo dukuri ndodh rregullisht në pozitë fundore të fjalës, si: zonjë > *zoj*, gjunj > *gjuj*, penj > *pëj*, hunj > *hÿj*, ftonj > *ftoj*, rranj > *rrāj*, patkonj > *patkoj*, thonj > *thoj* etj. Ky alternim tingullor vërehet edhe në trup të fjalës: e enjte > *e ejte*, shtrenjt > *shtrejt*, miell i grunjtë > *grujt* etj.

133. **Alternimi i [nj]-së në [n].** - Te një numër i konsiderueshëm fjalësh [nj]-ja këmbëhet në [n]. Nga materiali ynë i grumbulluar po sjellim disa shembuj: një > *ni* (përemër i pacaktuar dhe nyjë e trajtës së pashquar): *ni shoq*, *ni njer*, *ni mëik*, *ni sen*; te numërorët: *nimdhâit* '11', *nizet* '20', *niçin e nja* '101'; fjalët e përbëra (kompozitat): *niher*, *nidit* etj.

2.5.5. BASHKËTINGËLLORET PRAPAGJUHORE

134. Në inventarin e sistemit konsonantik të shqipës së Karadakut të Shkupit në gjendjen

²³⁴ Jorgji Gjinari, *Dialektet ...*, f. 171.

e tanishme marrin pjesë edhe tri bashkëtingëllore prapagjuhore: [k], [g] dhe [ŋ]. Dy bashkëtingëlloret e para i kanë të gjitha të folmet shqipe si dhe varianti standard, ndërsa bashkëtingëllorja e tretë ka përhapje të gjerë në të folmet e gegërishtes, sidomos në ato të nëndialektit të gegërishtes verilindore e veriperëndimore.

Mbylltorja e shurdhët [k]

135. Kjo bashkëtingëllore edhe në të folmen në shqyrtim është **prapagjuhore, mbylltore** dhe **e shurdhët**. Dëgjohe në të gjitha pozitat në fjalë dhe me denduri përdorimi të lartë, si: *ka:l, káfe, ka:sht, kam, kërkuj, ka:jk, krâie, krâip, krah, kumo:n, korb, kodër, kos, kufâi; fukara, vakt, takat, lakën, thekën, mekërr; plak, mâik, fturk, dushk, to:k, dishëk, oxhak, buk, dre:k, da:rk, lu:rk, bre:shk, mushk, be:shk, pe:shk* etj.

Prapagjuhorja [k] ndonjëherë kalon në tinguj të tjerë. Alternime më të shpeshta janë:

136. **Zëshmimi i [k]-së në [g]**: *gurbet, gërkoj, frâig* etj.

137. **Qiellzorizimi i /k/ > /q/**. Me qiellzorizimin e /k/-së në /q/ e formojnë shumësin disa emra që mbarojnë me bashkëtingëlloren /k/, si: *plak - qak > pleq - qeq, uk - uq, mêik - mêiq, bujk - bujq* e të ngjashme.

138. **Thjeshtësimi i grupit të moçëm bashkëtingëllor [kl] në [k]**.- Grupi i moçëm bashkëtingëllor [kl] thjeshtësohet, duke u reduktuar në [k], si te fjalët klish > *ki:sh*, klan > *ka:n* (në disa të folme *qan*), kam klen > jam *ka:n*, klumësht > *ku:sht* (në të folmen e fshatit Tanushë) etj. Fjala *ku:sht* sigurisht se rrjedh nga fjala e shqipes së moçme *klumësht*, por përveç ndryshimeve fonetike, kjo fjalë ka pësuar edhe ndryshim kuptimor, meqë me *ku:sht* banorët e kësaj krahine, si edhe e gjithë Kosova tani emërtojnë *hirrën* (lëngun që mbetet gjatë përpunimit të djathit apo gjizës, i cili tharohet e pihet për freskim, sidomos verës).²³⁵

139. **Shndërrimi i [q]-së në [k]**. – Përveç shembujve të shënuar më parë, ku denduria e përdorimit të [k]-së zvogëlohet, ka edhe shembuj të tjerë ku frekuenca e kësaj bashkëtingëllores rritet. Përkatësisht, takojmë raste kur në këtë të folme hetohet kalimi i [q]-së në [k], si p.sh.: *kime < qime, kingj < qengj, ko:ft < qoftë, shkepoj < shqepoj, hjek < heq, kie < qe* etj.

Prapagjuhorja e zëshme [g]

140. Bashkëtingëllorja [g] është korresponduese e zëshme e [k]-së. Ajo është **prapagjuhore** dhe **mbylltore**. Përdoret në të gjitha pozitat e fjalës, si: *gru:e, grôue, grusht, gru:n, gaz, gro:sh, gisht, gro:p, gërsha:n, griq; jargan, azgan, u laga, e egër, cigare, openg; de:g, zog, breg, larg, ibrig, gjeg, varg* e në fjalë të tjera.

Ndërrime më të rëndësishme fonetike të kësaj bashkëtingëllores janë:

141. **Qiellzorizimi i [g] në [gj]**. - Grupi i të folmes së gegërishtes qendrore dallohet nga të folmet e tjera të gegërishtes edhe me qiellzorizimin e [g]-së në [gj]. Në këtë kuptim, ky ndërrim tingujsh është shumë i shpeshtë, si *gjur < gur, gjardh < gardh, gjrumëll < grumbull, gjazmen < gazmend, gjisht < gisht, gjo:j < gojë, gjërsha:n < gërshan, e gjëzofsh < e gëzofsh, magja:r <*

²³⁵ Fjala *hirrë f.* në Fjalorin elektronik shpjegues jepet me kuptimin: 1. Lëng si ujë, në ngjyrë të gjelbër shumë të çelur, që del kur pritet qumështi a kur kullojmë djathin e njomë ose që e nxjerr kosi pasi mpikset. *Hirrë e zier. Hirrë qumështi. Hirra e djathit (e kosit, e gjizës).* Është bërë si *hirrë është holluar shumë, është bërë si ujë.*

magar, gomar; *argjat* < argat, *pagju:j* < paguaj, *me:gjëll* < mjegull, *largj* < larg, *pragj* < prag, *rro:gj* < rrogë, *e fu:gj* < e fugë, *bregj* < breg, *frâigj* < frikë, *largj* < larg, *lu:gj* < lugë, ni *zogj* < zog, ni *pllugj* < pllug etj.

Në lidhje me këtë, po qe se japim një pasqyrë të përgjithshme për të folmen shqipe të Karadakut, materiali i mbledhur dialektor na flet për faktin se ky lloj qiellzorizimi mbizotëron. Megjithatë, nga fshati në fshat, e ndonjëherë edhe në të njëjtin fshat, madje edhe te të njëjtët persona, jo rrallë takojmë edhe përdorim të dyfishtë të së njëjtës formë të fjalës, përkatësisht format herë me [g] e herë me [gj]: *gisht* - *gjisht*, *gardh* - *gjardh*, *de:g* - *degj*, *lu:g* - *lu:gj*, *fu:g* - *fu:gj*, *zog* - *zogj*, *breg* - *bregj*.

142. Të paraqitur sipas sasisë së fjalëve të qiellzorizuara, duke u nisur nga fshatrat me numër më të madh fjalësh të palatalizuara, do të kemi një renditje të tillë:

a) prinë e folmja e fshatit Bllacë, ku jo vetëm që gjejmë shumë fjalë të qiellzorizuara, por kemi edhe jo pak mikrotoponime që ka vepruar dukuria e kalimit të [g] > [gj], si: *n'Fu:sh t'Gjurrës*, *Rogja*, *Gjurra Ba:rdh*, *n'Lugj t'Oroshit*, *Lugji Vol*, *Gjurra e Katunit*;

b) fshatrat Brezë, Malinë, Orlancë, Mojancë, Straçincë, Luboten, Grushinë dhe në fund do të radhitej Tanusha, flasin me më pak fjalë të qiellzorizuara (katundi i fundit sipas gjithë gjasash për shkak të pozitës gjeografike që ka dhe lidhjeve familjare, ekonomike, kulturore e lidhje të tjera me popullatën e Kosovës).

143. **Ruajtja e zëshmerisë së [g]-së.** - Gjatë vështimit të materialit tonë kemi konstatuar se bashkëtingëllorja e zëshme [g] zakonisht nuk shurdhohet as kur është në pozitë fundore të fjalës. Përkatësisht, ashtu si edhe në të folmet e tjera fqinje, kemi takuar vetëm tre-katër shembuj të shurdhimit, si për shembull *ka(h)* < nga, *kado* < ngado, *kadale* < ngadale.

144. **Reflekse të ndryshme të grupit [ng]:** a) ruajtja e [ng], b) shkrirja në [ŋ], c) përngjashmimi paravajtës (asimilimi progresiv) në [n], ç) dhe përngjashmimi prapavajtës (asimilimi regresiv) në [g]. Grupi bashkëtingëllor [ng] në të folmen e fshatit Luboten, Straçincë, Orlancë dhe Mojancë në të shumtën e rasteve ruhet. Me formë fonetike të dyfishtë: si grup të paasimiluar [ng] dhe në formë të shkrirë [ŋ] e dëgjojmë në të folmen e f. Grushinë. Në të folmen e f. Brezë, Malinë dhe Tanushë ky grup përngjashmohet në [ŋ] me disa raste asimilimi në [n], ndërkaq në të folmen e f. Bllacë ky grup bashkëtingëllor në gjendjen e sotme jep [g].²³⁶

Sonantja hundore [ŋ]

145. Fonema [ŋ] është prapagjuhore, mbylltore, sonante, hundore e përfituar nga përngjashmimi i grupit [ng], që e kanë shumë të folme të gegërishtes (Shih hartën 29 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Gjatë shqiptimit të kësaj bashkëtingëlloreje, maja e gjuhës ulet dhe prek dhëmbët e poshtëm; ndërsa, pjesa e prapme e gjuhës ngrihet dhe prek pjesën e pasme të qiellzës së fortë. Qiellza e butë, duke qenë e ulur, mundëson që rryma e ajrit të kalojë nga zgavrat e hundës.

146. Prania e kësaj fonemeje në inventarin e sistemit bashkëtingëllor të të folmes shqipe të Malit të Zi të Shkupit është një risi e krijuar nga asimilimi i grupit bashkëtingëllor [ng] në [ŋ], si edhe në shumë të folme të tjera të gegërishtes. Për këtë arsye, këtë bashkëtingëllore asnjëherë

²³⁶ Më gjerësisht për këtë shih në shpjegimin e hundores [n], përkatësisht në shtjellimi e varianteve fonetike të grupit [ng], në nënpikat a, b, c, ç.

nuk e gjejmë në pozicion pas [k]-së ose [g]-së. Prapagjuhorja [ŋ] shqiptohet rregullisht në të folmet e nëndialektit të gegërishtes veriore,²³⁷ si dhe në të folme të caktuara të gegërishtes qendrore.²³⁸

147. Hundorja [ŋ] shfaqet në të gjitha pozitat në fjalë. Në fillim: *ŋat* (< ngat); *ŋaren* (< ngarend), *ŋaj* (< ngaj), *a: ŋrâi* (< ngri), *ŋrehs* (< ngrehës), *ŋarkoj* (< ngarkoj), *ŋran* (< ngranë); *u ŋrâita* (< u ngrita); *i ŋro:ft* (< i ngrohtë); *jam ŋi:* (< jam ngi), *e ŋula* (< e ngula) etj. Në mes të fjalës: *meŋez* (< mengez, mëngjes), *kunjëll* (< kungull), *frenji: derës* (< frengu i derës), *zeŋin* (< zengin), *kam haŋër* (< kam hangër), *meŋele* (< mengele) etj. Në fund të fjalës: *laŋ* (< lang), *buŋ* (< bung), *opaŋ* (< opengë, opingë), *shlluŋ* (< shllungë, shtëllungë), *cunŋ* (< cung), *ka:ŋ* (< kangë, këngë), por dhe *kajk* etj.




Figura 10. Ruajtja dhe përngjashmimi i grupit [ng]

148. Duke u mbështetur në materialin e vjelë dialektor konstatohet se fonemën [ŋ] e përdorin rregullisht të folmet e fshatrave Tanushë, Brezë e Malinë dhe pak më rrallë edhe folësit e f. Grushinë. Folësit e fshatrave Straçincë, Luboten, Mojançë, Orllancë e Bllacë nuk e njetojnë fare.

149. Kjo bashkëtingëllore në fshatra të caktuara të këtij areali gjuhësor, si edhe në shumë të folme të tjera geqe, ka vlerë fonologjike. Kjo vlerë kuptimdashmuese mund të hetohet përmes

²³⁷ Bahri Beci, *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, Tiranë, 1995, f. 65-66; 395-396. Mehmet Halimi, *Kërkime dialektologjike*, Prishtinë, 1985, f. 122; 310; 361.

²³⁸ Bahri Beci, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987, f. 39.

disa çifteve minimale leksikore. Nga materiali i vjelë do të sjellim disa fjalë me kundërvënie të fonemës bashkëtingëllore me ndonjë fonemë tjetër:

1) /ɲ/ ~ /k/: *ɲat* ~ *kat*, *ɲi:* ~ *ki*, *ɲaj* ~ *kaj*, *laɲu* ~ *laku*, *kūɲëll* ~ *kukëll*, *bu:ɲ* ~ *bu:k*;

2) /ɲ/ ~ /g/: *lāɲi* ~ *lagi*, *ɲat* ~ *gat*, *lū:ɲ* ~ *lu:g*;

3) /ɲ/ ~ /m/: *kā:ɲ* ~ *kā:m*, *kūɲëll* ~ *kumëll*, *lāɲ* ~ *lā:m*, *ɲat* ~ *mat*;

4) /ɲ/ ~ /n/: *ɲa:* ~ *na*, *lā:ɲ* ~ *lā:n*;

5) /ɲ/ ~ /t/: *hāɲër* ~ *hatër*, *ɲeli* ~ *teli*, *kuɲëll* ~ *kutëll*.

Glotalja [h]

150. Kjo bashkëtingëllore është *glotale, shtegore dhe e shurdhët*, pa korresponduese të zëshme. Për shkak të natyrës që ka (e shurdhët, shtegore) kjo bashkëtingëllore në shqipen dialektore është e paqëndrueshme. Në disa raste, varësisht nga pozicioni që ka një fjalë dhe nga natyra e tingujve përreth, kjo bashkëtingëllore ka rënë plotësisht pa lënë kurrfarë gjurmë, para së gjithash në të folmet toske.²³⁹ Në disa të folme mund të dëgjohet një element shtegor shumë i dobët që mezi dëgjohet. Në disa fjalë, në vend të kësaj bashkëtingëllores përdoret ndonjë tjetër tingull. Për këtë arsye, gati në të gjitha përshkrimet dialektologjike, qofshin ato toske ose geqe, kësaj foneme i kushtohet rëndësi e veçantë.

151. Për nga burimi, bashkëtingëllorja /h/ në gjuhën shqipe dihet se është fituar nga tinguj të tjerë të ndryshëm, ose nëpërmjet analogjisë, e krijuar si tingull antihiatizues. Denduria e kësaj fonemeje është rritur edhe me fjalët e huazuara, të cilat në përbërjen e tyre në formën burimore kanë pasur këtë bashkëtingëllore, para së gjithash me huazimet orientale.²⁴⁰

152. Në të folmen shqipe të Karadakut, glotalja [h], me disa përjashtime të rralla, përdoret në të gjitha pozicionet e fjalës, si te fjalët me burim vendës ashtu edhe te turqizmat ballkanikë. Për shembull: *hona*, *hānza*, *hongra*, *hekër*, *hīni*, *hūni*, *hūna*, *hipi*, *doni her*, *hi:rr*, *ha:p*, *hap*, *huka:m*, *hajva:n*, *ha:ll*, *he:c*, *hamall*, *hasëm*, *hajvar*, *huj*, *hastër*, *hut*; *sahat*, *duhan*, *uha:*, *sahan*, *tërhan*, *krahën*, *e mpreht*, *pluhën*, *prehën*, *vehërr*, *ndihëm*, *qihur*, *gjuha*, *filhall*; *leh*, *ah*, *krah*, *e njoh*, *e shoh*, *sabah*, *kreh*, *pleh*, *qeh*, *qilah*, *ngroh* etj.

153. *Mosshqiptimi i [h]-së në fundin absolut të fjalës*. – Në një numër të kufizuar fjalësh, e sidomos kur përdoret në fund të fjalës, laringalja [h] bie, si te fjalët *çeni le* (< leh), *kra* (< krah), *e njo* (< e njoh), *e sho* (< e shoh), *e nxe* (< e nxeh) etj. Tek emrat vetjakë me burim oriental, të tipit *Avdulla*, *Feta*, *Riza* etj. kur përdoren në trajtë të pashquar, zakonisht kjo bashkëtingëllore bie ose dëgjohet shumë dobët. Por, kur të njëjtët emra përdoren në trajtë të shquar, si *Avdullahi*, *Fetahi*, *Rizahi* bashkëtingëllorja [h] dëgjohet mirë.

154. *Rënia e [h] në trup të fjalës*. – Kemi takuar edhe raste të rënies së [h] në mes të fjalës, si: *gjazmou!* (< gëzohu!), *ktheu!* (kthehu!), *krai* (krahi), *preën* (prehën), *me m'nimu* (me më ndihmuar, të më ndihmohet), *janâi* (< jahni), *xhenem* (< xhehnen), *pelivan* (< pehlivan), *i rōushëm* (< i ruhësua), *gjua* (< gjuha) etj.

155. *Kalimi i [h] në [f]*. – Në disa fjalë, sidomos në pozicion para [t]-së, [h]-ja e shurdhët zëvendësohet me buzore-dhëmboren [f]. Për shembull: *i fto:ft* (< i ftohtë), *i mpre:ft* (< i

²³⁹ Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Prespës*, Shkup, 1996, f. 32.

²⁴⁰ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 226.

mprehtë), *i nxe:ft* (< i nxehtë), *i kre:ft* (< i krehtë), *iftibar* (< ihtibar), *Baftjar* (< Bahtijar); por edhe në pozicion fundor si *njof* (< njoh), *shof* (< shoh) etj.

2.5.6. PRIRJA PËR EKONOMIZIMIN E GJUHËS DHE LEHTËSIMIN E SHQIPTIMIT

156. Duke nyjëtuar tinguj, njeriu është i prirë që sa më me pak mund të arrijë efekte maksimale. Pikërisht për këtë, gjatë kombinimit të tingujve të të folurit përpiqemi që për sa është mundur t'u shmangemi atyre lëvizjeve nyjëtimore, të cilat nuk janë të domosdoshme për arritjen e efekteve të nevojshme akustike. Pra, ekonomizimi i ligjërimit udhëhiqet nga ligji “sa më pak mund.”²⁴¹

157. Shqiptimi është shumë më i lehtë kur kemi zanore + bashkëtingëllore ose anasjelltas bashkëtingëllore + zanore. Shqiptimi i njëpasnjëshëm i dy zanoreve apo i dy e më tepër bashkëtingëlloresh është i vështirë, prandaj në ligjërimit popullor, veçmas në gegërishte, në prirjen e ekonomisë së gjuhës dhe të lehtësimit të shqiptimit gjejnë shpjegim shumë dukuri fonetike, leksikore e sintaksore që lidhen me rënien e tingujve dhe të rrokjeve, përngjashmimin e grupeve, ndërfitjen e një bashkëtingëlloreje ndërmjet dy zanoresh e anasjelltas, shkurtimin e fjalëve, përdorimin e shpeshtë të fjalive të thjeshta, mungesore e të pagjymtyrëzueshme etj. Prirja e përgjithshme e gjuhës është që vështirësitë e krijuara në rrjedhën e të folurit, nga krijimi i grupeve të papajtueshme të tingujve, sidomos i grupeve të zanoreve dhe i grupeve të bashkëtingëlloreve, t'i mënjanojë me mënyra të ndryshme: me rënie të njërit tingull, me shkrirje, me ndërfitje tingujsh për lehtëshqiptim.²⁴²

158. Të folurit drejtohet nga kundërshtia e përhershme midis nevojave komunikative të njeriut dhe tendencës së tij për ta rrudhur në minimum veprimin mendor dhe fizik.²⁴³ Ekonomizimi i të folurit në gjuhë zbatohet sidomos në fushën e fonetikës, të leksikut e të sintaksës dhe veçmas në ligjërimit popullor, në ligjërimit e shkujdesur e bisedor, ndërsa më pak në ligjërimit letrar, në gjuhën e intelektualizuar.

159. Përgjithësisht është e njohur se në ligjërimit popullor shqiptimi ka shmangie, përngjashmime (asimilime) grupe zanoresh e bashkëtingëlloresh, rënie tingujsh: *s'un shkoj* < s'mund të shkoj, *shpi* < shtëpi, *fmi* < fëmijë, *shtir* < vështirë, *shtëllungë* < shllung; *tung, tungjat* < tungjatjeta etj.; shpesh përdoren shkurtimet e zvogëlimit dhe të përkëdhelisë, si: *kusho* < kushëri, *bush* < babush, *loke* < nënëloke; si dhe fjalë të tjera për zbunim (përkëdhelje, ledhatim, llastim): *nipçe, bablok, vëllaçko, babagjysh* etj; trajta të dyta zbutuese të emrave vetjakë: *Braho* < Ibrahim, *Is* < Ismail, Islam, Hysen; *Demo* < Demush etj.

160. Ndërtimi i ligjëratës a i bisedës në të folurit popullor bëhet me fjali të shkurtra, të përshtatshme për vetë natyrën e zhdërvjellët të bisedës: *Shkova n'pazar. Bleva ni k'mi:sh. Atje e*

²⁴¹ Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011; f. 237-240.

²⁴² Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 419.

²⁴³ Andre Martine, *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë, 1983, f. 229.

pash Islamin. Ju bani t'fala... Gjuha e folur popullore merr shpesh trajtën e dialogut dhe kërkon kontakt të afërt midis bashkëfolësve. Edhe pse nuk shprehen gjymtyrët kryesore të fjalisë, ato kuptohen nga konteksti ose nga situata. Forma pyetje-përgjigje bën që shumë herë thënia të jetë vetëm prej një fjale, pa strukturë të plotë të fjalisë a periudhës. P.sh.: Sa vjet i ke? – *Njizet*. I kujt je? – *I Bardhylit*; ose me fjali të pagjymtyrëzueshme, si: A po vjen? – *Po*. Folësit përdorin dendur edhe gjestet e mimikën, me anën e të cilave theksohet, përcaktohet ose kompletohet mendimi, ndjenja, ideja e shprehur me fjalë.

161. Në këtë kuptim, në fushën e fonetikës si më të vështira për shqiptim llogariten grupet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve, sidomos ato që përbëhen prej dy elementesh të njëjta ose të ngjashme.²⁴⁴ Pra, për shkak të vështirësive të këtilla ose të ngjashme si këto, në gjuhën e folur zgjidhet një rrugë më e lehtë: shkurtimi (rënia e njërit prej tingujve), asimilimi i tyre i përbashkët ose ndërfitja e një tingulli tjetër për lehtëshqiptim.²⁴⁵

162. Me qenë se jo pak dukuri fonetike, si rënia e tingujve dhe e rrokjeve, përngjashmimi i togjeve të zanoreve dhe grupeve të bashkëtingëlloreve, pjesorja e reduktuar etj., shfaqen më dendur dhe kanë përhapje më të gjerë në të folmet e Veriut, na japin të drejtë të pohojmë se te folësit gegë prirja për ekonomizimin e gjuhës dhe për lehtësimin e shqiptimit është më e spikatur. Me fjalë të tjera, gegët shquhen me prirje më të shprehur për të ekonomizuar të folurit, për të lehtësuar shqiptimin, me një shkallë më të lartë të përshtatjes nyjetimore (akomodimit) të tingujve sesa toskët, dhe përgjithësisht gegët janë më të kursyer në fjalë, ata flasin më pak e me ritëm më të ngadalshëm sesa toskët.

2.5.7. TOGJE BASHKËTINGËLLORESH

163. Me metodat bashkëkohore të fonetikës eksperimentale dëshmohet se tingujt janë shumë më tepër të varur njëri nga tjetri sesa që mendohej.²⁴⁶ Përkatesisht, është e njohur se organet e artikulimit gjatë të folurit bëjnë lëvizje të vazhdueshme nga një pikë drejt një tjetre në një interval të shkurtër kohor e me këtë faza e fundit e shqiptimit të tingullit paraprak paraqet njëkohësisht edhe fazën fillestare të tingullit tjetër pasues. Në këtë kuptim, njësitë vijore të fjalës e të fjalisë çdoherë janë në bashkëveprim, duke krijuar në këtë mënyrë alofone të ndryshme në

²⁴⁴ Bertil Malmberg, *Fonetika*, Sarajevë, 1974, f. 60.

²⁴⁵ Në gjuhën e folur shqipe, përveç dallimeve që hasen në sistemin zanor e bashkëtingëllor, vërehen edhe dallime në mënyrën e shqiptimit të grupeve të bashkëtingëlloreve. Përkatesisht, në disa të folme vërehet synimi që gjatë shqiptimit të ruhen grupet e bashkëtingëlloreve si të plota, të pandryshuara (ashtu siç përdoren edhe në gjuhën standarde shqipe, në të shumtën e rasteve në të folmet toske e në numër më të vogël edhe në të folmet gege). Në pjesën më të madhe të të folmeve gege grupet e bashkëtingëlloreve thjeshtësohen për shkak të shqiptimit më të lehtë. Zakonisht, thjeshtësimi i grupeve të bashkëtingëlloreve realizohet në tri mënyra: për shqiptim më të lehtë bie elementi i dytë i grupit me ç'rast shqiptimi përshtatet me me artikulimin e bashkëtingëllores së parë: 1. duke lënë gjurmë mbi të, ose, 2. duke rënë plotësisht pa lënë gjurmë; bie elementi i parë i grupit të bashkëtingëlloreve me mundësi për të lënë gjurmë mbi bashkëtingëlloren e dytë; nga dy bashkëtingëlloret, gjatë asimilimit të plotë të tyre, fitohet një bashkëtingëllore e vetme, plotësisht e re, me elemente të artikulimit të të dy bashkëtingëlloreve të grupit. Tingujt e tillë, si rezultat i bashkëveprimit të dy tingujve, përkatesisht i asimilimit të dyanshëm sjellin si rrjedhojë dallim në sistemin fonologjik të bashkëtingëlloreve, me ç'rast shtohet inventari i fonemave bashkëtingëllore.

²⁴⁶ Shih: Bahri Beci, *Të folmet ...*, f. 470-574. Ирина Савицка - Лјудмил Спасов, *Фонологија...*, 1997 etj. ²⁴⁶ Bertil Malmberg, *Fonetika*, Sarajevë, 1974, f. 60.

²⁴⁶ Jorgji Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 158

fushën e përhapjes së fonemës, e jo rrallë edhe me kalimin e kufirit të kësaj fushe, përkatësisht shpesh ndodh edhe shndërrim kualitativ i një tingulli në një tingull tjetër, e ndonjëherë edhe në fonemë tjetër.

164. Në rrjedhën e të folurit, tingujt ndikojnë mbi njëri-tjetrin, duke bërë që çdo fonemë në pozicione të caktuara të ketë realizime të ndryshme fonetike (alofone). Në pikëpamje nyjëtimore, alofonet na paraqiten si ndikim i nyjëtimimit të një tingulli mbi nyjëtimimin e tingullit tjetër, d.m.th. si përshtatje të ndërsjella nyjëtimesh. Këto modifikime të fonemave janë të domosdoshme për folësit, prandaj quhen edhe ndryshime automatike ose mekanike, që mund të jenë kushtëzime kombinatorë ose apozicionale. Të shumta janë larushitë e tingujve në kushtet e rrethimit fonetik: të kontekstit dhe të veçorive prozodike. Është përdëftuar se në gjuhë ka aq variante fonemash sa ka edhe kombinime të mundshme fonemore.²⁴⁷

165. Grupe më të shpeshta bashkëtingëlloresh nga të cilat përftohen dallime në sistemin bashkëtingëllor si dhe dallime në dendurinë e përdorimit dhe përndarjen (distribucionin) e bashkëtingëlloreve në shqipen dialektore janë: [kl], [gl], [lk], [lg] (grupe të moçme bashkëtingëlloresh), [mb], [nd], [ng]; [tj], [dj], [mj] dhe [pl], [bl], [fl].

166. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit reflektohen të tri mënyrat e mundshme të ndryshimeve të grupeve të bashkëtingëlloreve nga njëra anë si edhe ruajtja e tyre, nga ana tjetër. Përveç përshkrimit të deritashëm të disa grupe bashkëtingëlloresh që dëgjohen në të folmen tonë, vlen të shqyrtohen edhe grupet [pj] dhe [vj]. Për grupet konsonantike u bë fjalë edhe gjatë përshkrimit të gjendjes së sotme të sistemit bashkëtingëllor. Por, për të fituar një pasqyrë më të qartë, vlerësojmë se është e udhës përshkrimet e dhëna deri më tani të përgjithësohen e të thuhën në mënyrë të përmbledhur.

167. Mbështetur në materialin e vjelë dialektor, për sa u përket grupeve të bashkëtingëlloreve konstatojmë se gjendja është e shumëllojshme. Përkatësisht, në asnjë pikë gjuhësore të këtij areali nuk kemi gjendje plotësisht të pastër. Pothuaj se në të gjitha fshatrat dëgjojmë forma fjalësh me përdorim të ndryshëm të grupeve të bashkëtingëlloreve. Megjithatë, edhe pse kemi larmi, konstatojmë se mbizotëron njëra nga variantet e pranishme. Duke pasur para vetes një situatë të tillë dhe duke synuar që të japim një pasqyrë të përgjithshme për bazën nyjëtimore të këtij regjioni, për sa i përket grupeve të bashkëtingëlloreve, kemi qenë të detyruar të bazohemi në formën mbizotëruese. Me fjalë të tjera, përgjithësimi i mëtutjeshëm për artikulin e ndryshëm ose jo të ndryshëm të grupeve mbështetet në shprehinë e përgjithshme artikulative të folësve të këtyre vendbanimeve.

2.5.7.1. Reflektimi i grupeve të moçme [kl] dhe [gl]

168. Grupet e moçme të bashkëtingëlloreve [kl] e [gl] të gjuhës shqipe në formë të shkruar i gjejmë që nga shekulli XVI,²⁴⁸ dhe ende ruhen në të folmet më jugore të toskërishtes (në çamërishte) si dhe tek arbëreshët në Greqi, në Itali, në Ukrainë dhe në të folmen e arbneshëve të Zarës.²⁴⁹


²⁴⁷ Nuri Gokaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 125-126.

²⁴⁸ Eqrem Çabej, "Meshari" i Gjon Buzukut (1555) I, II; Tiranë, 1968.

²⁴⁹ Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1988, f. 109; Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1987, f. 97.

169. **Reduktimi i [kl] në [k]**. - Në të folmen e Malit të Zi të Shkupit grupi bashkëtingëllor [kl] reduktohet në [k], duke rënë elementi i dytë pa lënë asnjë gjurmë, për shembull: klishë > *ki:sh* (te Kisha - toponim, Bllacë), kam klenë > *jam ka:n*, klanë > *ka:n*, klumësht > *ku:sht* (në të folmen e f. Tanushë)²⁵⁰ etj.

170. **Qiellzorizimi i [gl] > [gj]**. - Grupi bashkëtingëllor [gl] reflektohet në bashkëtingëlloren palatale [gj] në të gjitha fshatrat, përveç në të folmen e f. Tanushë, si: *i*, *e* *gja:t*, *gluha* > *gluha*, *gluni* > *gjuni* e të ngjashme. Shikuar nga aspekti historik, përgjithësisht është pranuar se rruga e zhvillimit drejt qiellzorizimit ka shkuar nëpërmjet jotizimit të [l] në [j], përkatësisht: [gl] > [gi] > [gj]. Në të folmen tonë, si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore, është e mundur edhe një rrugë tjetër e zhvillimit të grupit [gl], si [gl] > [g] > [gi] > [gj]. Kjo rrugë e zhvillimit është po ajo që ka ndjekur grupi i vjetër [kl], ndërsa qiellzorizimi i [g] > [gj] është njëra nga katër risitë më të rëndësishme fonetike të të folmeve të gegërishtes qendrore.



Skica 11. Zhvillimi i grupit [gl]

Fjala *glisht* paraqitet me formën *gisht* dhe *gjisht* edhe në fshatrat ku grupi [gl] qiellzorizohet. Siç përmendëm edhe më parë, në të folmen e fshatit Tanushë grupi i moçëm bashkëtingëllor [gl] ka dhënë [g], si *i*, *e* *ga:t*, *guha*, *guni*, *gishti*, nën ndikimin e kosovarishtes.

²⁵⁰ Fjala e moçme shqipe klumësht > *ku:sht* në f. Tanushë si dhe në gjithë Kosovën është desemantizuar, d.m.th. tani nuk e ka kuptimin parësor për të emërtuar qumështin, siç e ka në toskërishte, por kuptimin *e hirrës* (lëng i bardhë në të verdhë që përftohet nga përpunimi i qumështit në djathë, me shije pak të thartë që pihet si pije freskuese, sidomos gjatë verës; pije e shëndetshme freskuese).

2.5.7.2. Grupet e bashkëtingëlloreve [mb], [nd] dhe [ng]²⁵¹

171. Përngjashmimi i plotë në takim (në kontakt) i grupeve të bashkëtingëlloreve në shqipen dialektore, veçmas në Veri, është dukuri e rregullt. Në arealin e Karadakut të Shkupit përdorimi i këtyre grupeve bashkëtingëlloresh është i ndryshëm. Përkatësisht, në disa të folme ato ruhen, diku na dalin me përngjashmim paravajhtës (asimilim progresiv), diku përngjashmim prapavajhtës (asimilim regresiv) e në disa të folme edhe me përngjashmim reciprok (asimilim të plotë, të dyanshëm, më saktë shkrirje, bashkëdyzim).²⁵²

172. **Përngjashmimi i grupeve të bashkëtingëlloreve [mb], [nd] në [m], [n].** - Ky asimilim progresiv hundor në takim mbizotëron në të folmet e f. Tanushë, Mojancë, Orllancë, Brezë, Malinë dhe Grushinë në të gjitha pozicionet në fjalë. Krahaso shembujt: *ma:j* (< mi < mbij), *mas* (< mbas), *maroj* (< mbaroj), *mrena* (< mbrenda, brenda), *mret* (< mbret), *tamël* (< tambël), *hamar* (< hambar), *dham* (< dhëmb), *kā:m* (< këmbë), *shkrum* (< shkrumb), *shku:m* (< shkumbë); *nreq* (< ndreq), *ne:r* (< nderë), *nrâishe* (< ndryshe) etj.

173. **Shkrirja e grupit [ng] në [ŋ]:** *ŋat* (< ngat), *ã: ŋraj* (< është ngrirë), *ŋrehs* (< ngrehës), *lãŋ* (< lëng), *opã:ŋ* (< opingë, opengë), *bũ:ŋ* (< bung), *shllũ:ŋ* (< shllungë, shtëllungë) etj. në f. Tanushë, Brezë e Malinë e pjesërisht edhe në f. Grushinë.

174. **Përngjashmimi prapavajhtës i grupit [ng].** – Në të folmen e fshatit Bllacë grupi [ng] krahas rasteve të herëpashershme të asimilimit të plotë në [ŋ], ose të ruajtjes së tij, ky grup në të shumtën e rasteve reduktohet vetëm në elementin e dytë, si: *gare:n* (< ngarend), *gra:n* (< ngranë), *i ga:t* (< i ngatë), *gat* (< ngat), *e garkon* (< e ngarkon) etj.

175. **Ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve [mb], [nd] dhe [ng].** – Në të folmet e fshatrave Straçincë dhe Luboten (deri diku edhe në f. Grushinë) hetojmë prirjen e përgjithshme që të njëtat grupe të shqiptohen të pandryshuara në të gjitha pozicionet e fjalës: *mbas; mbjell, mbe:s, mbaj, mbush; tambël, dembel, i ambël, kumbëll, krimb, shkamb, kā:mb, dhãmb, llã:mb; ndër, nde:r, ndrêishe, ndreq, ndihëm, ndêi, mundash, katundar, mendje, parmend, fund, tound, hund, shkund; ngul, ngaj, ngarend, ngushtoj, i ngat, ngarkoj, ngrãn, hãngra, kungull, zengin, câung, opãng, lãng* etj.

²⁵¹ Zhvillimi i këtyre grupeve të bashkëtingëlloreve është vështruar edhe më parë gjatë përshkrimit të elementit të parë të grupit bashkëtingëllor. Edhe pse jemi të vetëdijshëm se do të përsëritemi, e pamë të nevojshme që gupet më të rëndësishme dhe më të zakonshme të paraqiten përsëri me qëllim që të njëjtët të jepen në formë të sublimuar.

²⁵² Kur tingulli i parë ndikon mbi të dytin, dukurinë e quajmë përngjashmim paravajhtës (asimilim progresiv); ndërsa kur tingulli i dytë ndikon në të parin quhet përngjashmim prapavajhtës (regresiv). Përngjashmimi është reciprok, kur secili nga elementet ndikon mbi tjetrin dhe si rezultat fitohet një tingull që ndryshon nga të dytë, pra bëhet një shkrirje e tyre dhe fitohet një tingull i vetëm. Shembull tipik i përngjashmimit reciprok është shkrirja e grupit [ng] në [ŋ]. Nga shkrirja (bashkëdyzimi) e [n]-së dhe [g]-së është përfutur një bashkëtingëllore prapagjuhore, sonore, hundore [ŋ]; e cila për shkak të kundërvënies fonologjike në disa çifte minimale fjalësh është edhe fonemë më vete në inventarin bashkëtingëllor të disa të folmeve gege. Shih: Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011, f. 244.

2.5.7.3. **Togjet [tj] dhe [dj]**²⁵³

176. Në të folmen e shqiptarëve të Karadakut të Shkupit, si edhe në përgjithësi në grupin e të folmeve të gegërishtes qendrore e më gjerë, grupet e bashkëtingëlloreve të përbëra nga një bashkëtingëllore e shurdhët ose të zëshme mbylltore alveolare-dhëmbore [t] ose [d] dhe tingëllueses mesgjuhore [j] qiellzorizohen në [q] dhe [gj], të cilat ndonjëherë dëgjohen me elemente frikative.

177. **Qiellzorizimi i grupeve të bashkëtingëlloreve [tj] në [q] dhe [dj] në [gj].** - Grupet [tj], [dj] në të folmen tonë rregullisht qiellzorizohen. Këto qiellzore të përfutuara sipas vetive artikulative dhe akustike janë më të afërta me mesgjuhoret sesa me paragjuhoret. Përjashtim nga ky rregull i përgjithshëm bëjnë vetëm pak fjalë: *dja:l*, *dja:th*, *mushtje:rr*; ose me shqiptim më të përparmë: *gj'a:l*, *gj'a:th*, *shq'e:rr*. Krahaso format e fjalëve: [tj] > [q] tjetri > *qetri*, tjetërkush > *qetërkush*, e tjerrim > *e qerrim* etj. Te fjala atje > *agje*, *qagje* kemi kalimin e [tj] > [gj] në të gjitha fshatrat. [dj] > [gj]: *djep* > *gjep*, *djalë* > *gja:l*, *dje* > *gje*, *pardje* > *pargje*, e *djathtë* > *e gja:tht*, *djeg* > *gjeg* etj.

2.5.7.4. **Grupet [pj], [mj] dhe [vj]**²⁵⁴

178. **Asimilimi i grupeve [pj], [mj] dhe [vj] në [p], [m] dhe [v].** – Këto grupe bashkëtingëlloresh (me përjashtim të f. Luboten dhe Straçincë ku [pj] > [q]) në të folmen tonë përngjashmohen në bashkëtingëllore të rëndomta. Gjatë asimilimit progresiv në takim bie elementi i dytë, d.m.th. bashkëtingëllorja [j] nuk shqiptohet dhe nuk lë asnjë gjurmë mbi bashkëtingëlloren që vazhdon të ruhet, e me këtë procesi rezulton në bashkëtingëllore të thjeshta [p], [b], [m]. Për shembull:

a) [pj] > [p]: *pe:shk* < *pjeshkë*, *pepën* < *pjepën*, *u pek buka* < *u pjek buka*, *ka pe:ll* < *ka pjellë* etj.

b) [mj] > [m]: në të gjitha fshatrat, *mekërr* < *mjekërr*, *me:l* < *mjelë*, *meshtër* < *mjeshtër*, *megëll* < *mjegull* etj. Në të folmen e f. Brezë kemi hetuar ruajtjen e këtij grupi në dy shembuj, por me kalimin e [m] në [n], si *njekërr* < *mjekërr* dhe *nja:lt* < *mjaltë*. Ndërkaq te fjala *mja:lt* në të gjitha fshatrat e tjerë ruhet grupi bashkëtingëllor [mj], sipas të gjitha gjasave për shkak ruajtjes së kuptimit të fjalës.

c) [vj] > [v]: Ky lloj reduktimi është i rregullt në të gjitha fshatrat, si *vehërr* < *vjehërr*, *vehrrri* < *vjehrrri*, *ve:sht* < *vjeshtë*, *me ve:l* < *me vjelë*, *vet* < *vjet* etj.

179. **Qiellzorizimi i [pj] > [q].** - Në të folmet e f. Luboten e Straçincë grupi bashkëtingëllor [pj] > [q]. Krahaso shembujt: *u qek buka* < *u pjek buka*, *qe:shk* < *pjeshkë*, *ka qe:ll* < *ka pjellë*, *qeglla* < *pjergulla* etj.

2.5.7.5. **Togjet e bashkëtingëlloreve [pl], [bl] dhe [fl]**²⁵⁵

²⁵³ Përmbledhje nga përshkrimi i veçantë i paragjuhoreve [t] dhe [d].

²⁵⁴ Edhe për këto grupe kemi bërë fjalë te përshkrimi i bashkëtingëlloreve [p], [b], [m] dhe [v].

²⁵⁵ Këto i kemi trajtuar edhe gjatë përshkrimit të bashkëtingëlloreve [p], [b] dhe [f].

180. Për dialektologjinë e gjuhës shqipe interes të veçantë paraqet, përkrah grupeve të tjera të bashkëtingëlloreve, edhe përdorimi ose edhe zhvillimi [pl], [bl], [fl].

181. **Grupi [pl]**. – Për sa i përket këtij grupi, kemi konstatuar se e folmja e shqipe e Malit të Zi të Shkupit ndahet në dy izoglosa: [pl] = [pl] dhe [pl] > [q].

a) **Ruajtja e grupit bashkëtingëllor [pl]**. – Të folmet e fshatrave Bllacë, Grushinë, Orllancë, Mojancë dhe Tanushë grupin [pl] e përdorin si të tillë: *plak, plesht, pla:çk, plep, pluhën, pleh, plum, plot, planc, plasi* etj.

b) **Qiellzorizimi i grupit [pl] > [q]**. - Në të folmet e fshatrave Malinë, Brezë, Luboten dhe Straçincë grupin bashkëtingëllor [pl] e dëgjojmë të qiellzorizuar në [q]. Sipas gjithë gjasash, faza e sotme e qiellzorizimit të plotë është fituar përmes disa fazave zhvillimore, si: pl > pj > pq > q. Përkatësisht, të gjitha fazat e një zhvillimi të tillë janë të pranishme dhe ende gjallojnë në të folmet e gegërishtes qendrore. Në këto fshatra grupi [pl] shqiptohet si plotësisht i qiellzorizuar. P.sh.: *qak, qesht, qep, quhën, qeh, qum, qot, qanc, qasi, qihu:r* etj. Te fjala *planc* në fshatrat Luboten dhe Straçincë, përveç formës me qiellzorizimin e [pl], kemi dëgjuar edhe një [s] protetike: *sqanc*.

182. **Grupi [bl]**. – Në disa fshatra të Karadakut të Shkupit, grupin [bl] të ruajtur e dëgjojmë në pozitë nistore [bl] = [bl], ndërsa në fshatrat e tjera e dëgjojmë në fazën e fundit të zhvillimit, në formë të qiellzorizuar.

a) **Shqiptimi i pandryshuar i grupit [bl]**. - Grupi bashkëtingëllor [bl] nuk asimilohet në të folmet e fshatrave Bllacë, Tanushë dhe Grushinë. Për shembull: *bli:, ble:t, ble:j, blu:j* etj. Fshatrat që janë në takim me të folmet e Kosovës: Tanusha dhe Bllaca, këtë grup e ruajnë më së miri në formë të pandryshuar.


b) **Qiellzorizimi i [bl] > [gj]**. - Në fshatrat e tjerë të këtij areali (përveç në Bllacë, Tanushë, pjesërisht edhe në Grushinë) ky grup bashkëtingëllor qiellzorizohet në [gj] përmes këtyre fazave të zhvillimit: bl > bj > bgj > gj.²⁵⁶ Krahaso shembujt: *gje:t < bletë* (bgjet në të folmen e f. Luboten); *kam gje < kam ble, me gjue < me blue* etj.

183. **Grupi [fl]**. - Grupi bashkëtingëllor [fl] në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit në disa fshatra ruhet si i tillë, e në fshatra të tjerë [l]-ja jotizohet. Përkatësisht, gjendja është si më poshtë:

a) **[fl] = [fl]** - *fla:k, flo:k, flutër, fle, flaron* në fshatrat Tanushë, Bllacë, Mojancë, Orllancë dhe Grushinë.

b) **[fl] > [fj]** - *fja:k, fjo:k, fjutër, fjeta* (por edhe une *fe:, feta*), *fjaron* në f. Brezë, Straçincë dhe Luboten.

²⁵⁶ Të gjitha këto variante tingullore të fazave të zhvillimit të [bl]-së ende gjallojnë nëpër të folmet e gegërishtes qendrore.



Skica 12. Zhvillimi i grupit [fl]

Në monografitë dialektore është bërë praktikë që në përshkrimin e të folmeve të bëhet fjalë në një kapitull të veçantë për dukuritë fonetike (ose siç e gjejmë shpeshherë të shkruar si fenomene fonetike). Është e kuptueshme se edhe në këtë të folme shfaqen shumë dukuri fonetike që dëgjohen edhe nëpër të folmet e tjera të gegërishtes qendrore, si: këmbimi i tingujve, rënia e tyre, haplologjia, përngjitja, shtimi i tingujve, shkrirja e zanoreve dhe e bashkëtingëlloreve, metateza, qiellzorizimi, afrikatizimi, përngjashmimi, zëshmimi e shurdhimi, diftongimi, zhbuzorëzimi, buzorëzimi, konsonantizimi i zanoreve të patheksuara e ndonjë tjetër.

184. Gjykojmë se dukuritë fonetike të kësaj të folmeje meqë i kemi vënë në dukje gjatë përshkrimit të sistemit tingullor, të zanoreve e të bashkëtingëlloreve si dhe grupeve të tyre, nuk e ndjejmë të nevojshme që të njëjtat t'i paraqesim edhe një herë ose të mos përsërisim po të njëjta gjëra që tanimë janë thënë.

2.5.8. INVENTARI I FONEMAVE BASHKËTINGËLLORE

185. Nga përshkrimi i deritashëm në pikëpamje fonetike e fonologjike i sistemit të bashkëtingëlloreve në gjendjen e tanishme të të folmes shqipe të Karadakut të Shkupit, duke u ndalur në shqiptimin e variantit kryesor të çdo bashkëtingëlloreje, frekuencën dhe distribuimin e tyre, si dhe ndërrimet fonetike lidhur me to, mund të nxjerrim veçoritë themelore të sistemit konsonantik. Duke marrë parasysh vetëm opozicionet distinktive, na shfaqet edhe vlera funksionale e tyre dhe me këtë përftohet edhe inventari i fonemave bashkëtingëllore. Nëse gzykojmë sipas kësaj, mund të përmbyllim se në këtë areal kemi:

186. *Shqiptim më të përparmë të bashkëtingëlloreve*. – Shqiptimi më i përparmë i bashkëtingëlloreve, përkatësisht shqiptimi i tingujve në zonë nyjëtimore më të përparme e folësve të kësaj krahine në krahasim me zonën nyjëtimore të folësve toskë si dhe të shqiptimit letrar, është karakteristikë e përgjithshme jo vetëm e këtij mikrosistemi dialektor, por edhe e makrosistemit në përgjithësi, e të folmeve të Veriut.

187. *Prania e prapagjuhores /ŋ/*. - Duke u mbështetur në vlerën kuptimdalluese të kësaj fonemeje në disa çifte minimale fjalësh, vumë re se në të folmen e katundeve Tanushë, Brezë e Malinë, ndonjëherë edhe në f. Grushinë kjo bashkëtingëllore hundore, prapagjuhore, e zëshme është fonemë më vete.

188. Për fonemat e tjera, përkatësisht për vlerën fonologjike të tyre gzykojmë se nuk është e nevojshme të japim shpjegime plotësuese, meqë ato na dalin me vlerë fonologjike jo vetëm në këtë të folme, por përgjithësisht në mbarë shqipen dialektore (ma pak përjashtime) e në variantin standard të shqipes.

189. Duke përmbledhur atë që u tha deri më tani, përmbledhtas mund të thuhet se inventari konsonantik i të folmes shqipe të Karadakut të Shkupit përbëhet nga dy izoglosa: a) izoglosë me **29 fonema** dhe b) izoglosë me **30 fonema**, përkatësisht:

A. 29 fonema bashkëtingëllore, kanë të folmet e fshatrave Luboten, Straçincë, Bllacë, Mojancë dhe Orllancë:

/p/, /b/, /m/, /f/, /v/, /t/, /d/, /l/, /ll/, /c/, /x/, /s/, /z/, /n/, /r/, /rr/, /ç/, /xh/, /sh/, /zh/, /th/, /dh/, /q/, /gj/, /j/, /nj/, /k/, /g/ dhe /h/.

B. 30 fonema bashkëtingëllore (29 të izoglosës A + /ŋ/²⁵⁷) kanë të folmet e fshatrave Tanushë, Brezë, Malinë e Grushinë (pjesërisht kjo e fundit):

/p/, /b/, /m/, /f/, /v/, /t/, /d/, /l/, /ll/, /c/, /x/, /s/, /z/, /n/, /r/, /rr/, /ç/, /xh/, /sh/, /zh/, /th/, /dh/, /q/, /gj/, /j/, /nj/, /k/, /g/, /ŋ/ dhe /h/.

190. Sistemi i fonemave bashkëtingëllore të shqipes së Karadakut të Shkupit mund të paraqitet në mënyrë tabelore:

²⁵⁷ Fonema /ŋ/ është bashkëtingëllore prapagjuhore, mbylltore, sonante, hundore e përfitur nga përngjashmimi i grupit [ng].

Vendi i formimit		Buzore		Gjuhore					Glotalë		
				Paragjuhore			Mesgjuhore	Prapagjuhore			
		Ndërdhëmbor	dhëmbor	Alveolare	Alveolare	Palatoalveolare	Qellzore (palatale)	Grykore (velare)			
		p			t			q	k	të shurdhëta	
		b			d			gj	g	të zëshme	
						c	ç			të shurdhëta	
						x	xh			të zëshme	
			f	th		s	sh			h	të shurdhëta
			v	dh		z	zh				të zëshme
	<i>Hundore</i>	m				n		nj	η		
	<i>Anësore</i>				ll	l					
	<i>Mesore</i>							j			
						r					
						rr					

III. VEÇORITË MORFOLOGJIKE

1. Marrë në përgjithësi, e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit edhe në rrafshin morfologjik është e ngjashme me të folmet e tjera fqinje dhe me të folmet e gegërishtes qendrore në përgjithësi. Megjithatë, vihet re që kjo izoglosë paraqet një zone ndërkaluse a të ndërmjetme midis të folmeve të gegërishtes qendrore dhe të folmeve të gegërishtes verilindore. Kjo e folme në sistemin morfologjik është mjaft e ngjashme me të folmen e Dervenit (zonë midis Shkupit e Tetovës)²⁵⁸ dhe të folmen shqipe të Karshiakës së Shkupit.²⁵⁹

Gjatë përshkrimit të veçorive morfologjike të të folmes shqipe të Malit të Zi të Shkupit do të përqendrohemi në përshkrimin e tipareve themelore të saj.

3.1. EMRI

2. Njihet botërisht se emrat në gjuhën shqipe kanë kategoritë gramatikore të: gjinisë, numrit, shquarsisë dhe të rasës. Edhe në të folmet shqipe emri i ka të gjitha këto kategoritë gramatikore.

3. Për sa u përket emrave konkretë dhe abstraktë, vumë re që në të folmen në fjalë, sikurse edhe te të gjitha të folmet e tjera, ka më shumë emra konkretë sesa emra abstraktë.

3.1.1. GJINIA E EMRIT

4. Në shqipen e folur të rajonit të Karadakut të Shkupit, emrat janë të gjinisë mashkullore apo femërore, ndërsa për emrat e gjinisë asnjane gjëjmë vetëm gjurmët e tyre.

5. *Gjinia mashkullore dhe femërore e emrave.* - Në këtë të folme gjinia e emrave, te pjesa dërmuese e tyre, dallohet në bazë të formanteve gramatikore (mbaresave), në format emërore të njëjësit në trajtën e shquar.

6. Në dallim nga gjuha standarde shqipe ku përveç mbaresës **-i** për emrat të gjinisë mashkullore, përdoret edhe **-u**, ose **-t** (të) për emra të gjinisë asnjane, në të folmen në fjalë mbaresa **-u** nuk është e pranishme, ndërsa **-t** në një numër të kufizuar fjalësh. Kështu, emrat e gjinisë mashkullore marrin mbaresën **-i**, ata të gjinisë femërore **-a** (ja). Për shembull: *mal-i, gjur-i, çen-i, mâik-i; zog-i, zogji, krahi, fto-n-i, dhe-v-i, shâi-v-i; dor-a, moll-a, shpâi-a, kusâi-a, petll-a, zemr-a* etj.

7. Një pjesë e emrave kanë forma të veçanta leksikore për gjininë mashkullore dhe forma të veçanta për gjininë femërore. Dallimi i gjinisë së emrave në këtë të folme bëhet edhe nëpërmjet kundërvënies në gjatësi të zanores fundore (zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë).

8. *Format supletive të emrave të gjinisë mashkullore dhe femërore.* - Emrat që tregojnë

²⁵⁸ Prof. dr. Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008.

²⁵⁹ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997.

farefisni si dhe shumica e emrave të kafshëve, gjininë e shënojnë përmes formave supletive, të tipit: *ba:b - na:n, vlla: - motër, nâip - me:s, da:j - teze, mâixh - ha:ll, dash - dele, cap - dhâi, ka:l - pe:l, ka: - lo:p* etj.

9. Dallimi i gjinisë te disa emra nëpërmjet **kundërvënies së gjatësisë fonologjike të zanores fundore**. – Krahas formave supletive, disa emra në trajtë të pashquar në këtë të folme karakterizohen, jo për nga forma, por në bazë të opozicionit të gjatësisë së zanoreve (e shkurtër ~ e gjatë, d.m.th. gjini mashkullore ~ femërore), që realizohet në pozicionin fundor të fjalës. Krahaso: *qak ~ qa:k* ‘plak ~ plakë’, *kunat ~ kuna:t* ‘kunat ~ kunatë’, *krushk ~ kru:shk* ‘krushk ~ krushkë’ etj. Një dallim i tillë i gjinisë në fazën e sotme vjen si pasojë e bjerrjes së zanores [ë] në fund të fjalës tek emrat e gjinisë femërore, me çka është bërë zgjatja kompensatore e zanores paraprirëse.

10. **Formimi i gjinisë femërore të emrave me prapashtesa**. – Mënyra më produktive e formimit të fjalëve në shqipen standarde, por edhe në të folmet popullore, është prapashtesimi. Me ndihmën e formanteve që u shtohen temës së emrave të gjinisë mashkullore fitohen disa emra të gjinisë femërore. Prapashtesa të tilla më të shpeshta në gjuhën standarde janë: -e, -eshë, -ë, -ushë, -onjë, -icë.²⁶⁰

11. Në të folmet shqipe të Malit të Zi të Shkupit si më produktive na dalin këto prapashtesa: -e, -ke, -esh; -**âush** (-u:sh, -a:sh); -**oj**, -**i**; -**ic**, -**âic**, -**ovâic** etj. Po japim disa shembuj me emra të gjinisë mashkullore e emra të gjinisë femërore të përfutur nga mashkullorët: *msu:s - msus-e, nxa:ns - nxans-e, mâik - mâik-e, mik-e:sh, lubotenali: - lubotenali-ke, grushâinali-ke, goshâicali-ke; burr-n-e:sh, trâim-n-e:sh; aru:sh, arâush, ara:sh* etj. Një numër i caktuar emrash gjininë femërore e formojnë me prapashtesën sllave -**ica** (-i:c, -âic, shpesh edhe -ovi:c) në formë të diftonguar apo të pa diftonguar, si: *bu:ll – bullâic, magja:r - magjari:c, zagjar - zagjari:c* etj. Siç u tha edhe më parë, mënyrë karakteristike, e njohur vetëm te shqiptarët në Maqedoni,²⁶¹ është formimi i emrave të grave të martuara në bazë të emrit të burrit të saj, duke shtuar emrit të bashkëshortit prapashtesën -i:c, -âic e ngadonjëherë edhe -ov-âic, sipas tipit: *Nazif-i:c, Hasan-âic, Kamber-ov-âic ...*

12. Disa emra shtazësh e shpeshësh, sidomos i atyre që dallimi i gjinisë nuk paraqet ndonjë gjë të rëndësishme për njeriun, emërtohen me emra të vetëm të një gjinie gramatikore "genre comun", pa dallim të gjinisë së tyre natyrore. Të tillë janë emrat e gjinisë mashkullore: *vâiç-i, kinxh-i, klish-i, iriç-i, urith-i, lepr-i, xharpn-i, lelek-i, hut-i*; si dhe të gjinisë femërore si: *dhelpn-a, arash-a, breshk-a; ship-j-a, sorr-a, gugutk-a, dalldish-j-a, mâiz-a* etj.

13. Siç dihet, shumica e emrave të kafshëve të gjinisë femërore formohen nga emrat përkatës mashkullorë, kur këtyre të fundit u shtohet ndonjë prapashtesë. Është mjaft interesante të theksohet shumëllojshmëria e mënyrave të formimit të gjinisë femërore të fjalës ujk - ujkonjë. Për gjininë mashkullore kemi *uk, ôuk*; ndërsa për gjininë femërore *uki:n* dhe *ujki:n* (f. Grushinë), *uki*: (f. Tanushë, Orllancë dhe Mojancë), *liki*: dhe *luki*: (f. Bllacë), *lko:j* (f. Brezë dhe Malinë), *uki:c* (f. Straçincë).

14. **Mospërputhja e gjinisë natyrore me gjininë gramatikore të emrit**. – E dimë se te shumica e emrave në gjuhën shqipe kemi përputhje të gjinisë natyrore me gjininë gramatikore. Megjithatë, kemi edhe një numër të caktuar emrash ku hasim mospërputhje të tyre. Të tillë janë emrat, të cilët për nga natyra (seksi) janë të gjinisë mashkullore, ndërsa nga aspekti gramatikor

²⁶⁰ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (morfologjia), Tiranë, 1995, f. 92.

²⁶¹ Remzi Nesimi, *Diftongimi i i-së dhe i u-së së theksuar ...*, f. 97-98.

marrin tregues të gjinisë femërore. Për shembull: *bab-a*, *daj-a*, *mixh-a*, *hoxh-a* etj.; pastaj, emrat vetjakë që mbarojnë me zanore të theksuar: *Hamzí-j-a*, *Nurí-j-a*, *Samí-j-a*, *Qaní-j-a*, *Barí-j-a*, *Ruzhdí-ja*, *Baftí-j-a* etj. Pavarësisht kësaj, në fjali këtyre emrave u jepen përcaktorë të gjinisë mashkullore, të tipit: *Baba jem ...*, *Dajën tem e du shu:m*. *Hamzija asht i mâi:r* etj.

15. Sidoqoftë, te gjinia e emrit në të folmet shqipe nuk kemi dallime për sa i përket aspektit strukturor. Këto dallime të vogla vërehen në shkallën e ruajtjes së gjinisë asnjane. Kështu, është e pranishme prirja e kamotshme e kalimit të emrave të gjinisë asnjane në gjininë mashkullore apo në atë femërore. Gjuha standarde, nga ana tjetër, për nevojat e veta, emra të gjinisë asnjane ka formuar përmes shndërrimit të mbiemrave dhe të foljeve në emra, të ashtuquajtur emra prejmbiemërorë dhe prejfoljorë (prejpjesorë); ndërsa të folmet nuk e ndjekin këtë rrugë. Prandaj, në gjuhën dialektore gjinia asnjane si gjini neutrale, e cila nuk i kundërvihet as gjinisë mashkullore, e as asaj femërore, pothuajse është zhdukur. Në dialektin gegë kjo tendencë e përgjithshme për flakjen e gjinisë asnjane është më e theksuar sesa në dialektin toskë. Si rrjedhojë e kësaj, tani në dialektin gegë hasen vetëm disa gjurmë apo thënë ndryshe vetëm mbetje (fosile) të gjinisë asnjane të emrit.

16. *Mbetjet e gjinisë asnjane*. – Në të folmen tonë, gjithnjë duke u mbështetur në materialin e vjelë, kemi dy gjini: gjininë mashkullore dhe femërore me mbetje të gjinisë asnjane. Disa emra të cilët historikisht kanë qenë të gjinisë asnjane, tani më këtu nuk përdoren si të tillë, por kanë kaluar në emra të gjinisë mashkullore ose femërore. Krahaso format e dikurshme të gjinisë asnjane (të dhëna në kllapa) me format e sotme që kanë marrë në të folmen e Karadakut të Shkupit (të shënuara me shkronja të pjerrëta): (brumët >) *brumi* (gj. m.), (mjaltët >) *mjalta*, *njalta* (gj. f.) dhe *mjalti* (në gj. m. në f. Orllancë, Mojancë, Grushinë); (dyllët >) *dilla* (gj. f. në f. Grushinë), *delli* dhe *dilli* (gj. m. në f. Luboten), *dilli* (gj. m. në f. Straçincë, Bllacë, Brezë); (dhjamët >) *vjami* (gj. m. në të gjitha fshatrat); (grurët >) *gruni* (gj. m., në të gjitha fshatrat); (leshtë >) *leshi* (gj. m., në të gjitha fshatrat); (miellët >) *mâilli*, *milli*, *mëilli* (gj. m., në të gjitha fshatrat), (mishtë >) *mâishi*, *mishi*, *mêishi* (gj. m., në të gjitha fshatrat) etj.

17. Gjurmë të gjinisë asnjane hasen edhe tek emrat *ujt*, *dhallt*, *krâjet* në trajtë të pashquar, por duke iu përshtatur prirjes së përgjithshme për shuarjen e plotë të gjinisë asnjane, këta emra kur shquhen kalojnë në gjininë mashkullore apo femërore, si: *ujt-i*, *dhallt-i* (gj. m.); *krâjet*, *krâj-a* (gj. f.).

18. Në të folmen tonë ekzistojnë disa emra prejmbiemërorë të cilët përdoren në gjininë asnjane, si: *i ra t'fâikt*; *m'shkoj t'rit*; *po m'be t'pakt!* Ngjashëm është edhe me emrat prejmbiemërorë (mbiemra të substantivuar): *t'ba:rdht e voes*, *t'kuqt e voes*. Gjithashtu, në gjininë asnjane përdoren edhe dy emra për emërtimin e kemit për fytyrë apo buzëkuqin për femra: *Blema do t'ba:rdh // Ngjite do t'ba:rdh // ose: Blema do t'kuq // Ngjite do t'kuq //* të cilët gjithnjë përdoren në këtë formë dhe asnjëherë nuk kalojnë në gjini tjetër gramatikore.

19. Emrat prejfoljorë, më saktë emrat prejpjesorë (foljet e substantivuara) të tipit: *të ecurit*, *të kënduarit*, *të mësuarit*, të cilat në gjuhën standarde janë të gjinisë asnjane, në të folmen tonë përdoren në gjininë femërore në formën: *e hecmja*, *e këndâumja*, *e mcâumja* etj.

20. Ngjashëm me të gjitha të folmet e tjera shqipe, emrat me prejardhje sllave të gjinisë asnjane kanë kaluar në gjininë femërore. Për shembull: *кóрито* > *korítë* > *korí:t* > *korít-a*; *сѣто* > *sítë* > *sí:t* > *sít-a*, *дáлто* > *dáltë* > *dá:lt* > *dált-a*. Kjo dukuri vihet re edhe në të folmen e Dervenit,²⁶² të folmen e shqipe të Karshiakës,²⁶³ etj.

²⁶² Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit...*, f. 247.

21. **Emrat me dy gjini (ambigjenë).** - Si në gjuhën standarde shqipe, ashtu edhe në të folmen e Karadakut të Shkupit emrat e ruajnë gjininë e njëjtë si në njëjës, ashtu edhe në shumës. Megjithatë, emrat e gjinisë mashkullore që emërtojnë sende, dukuri abstrakte dhe nocione, që shumësin e formojnë me prapashtesat *-e* dhe *-na* (në shqipen standarde *-ra*), po në shumës e ndryshojnë gjininë, përkatësisht këta emra janë ambigjenë.²⁶⁴ Kjo dëshmohet me përcaktorët, ndajshimet që marrin këta emra. Për shembull: *mali nalt* (njëjës gj. m.) - *male t'nalta* (përcaktori është i gj. f.) ose: *ki mal* - *k'to male* (përemri dëftor është në gj. f.); *ki varg* (gj. m.) - *k'to vargje* (gj. f.); *veni mâir* (gj. m.) - *vene t'mâira* (gj. f.); *zakoni vetër* (gj. m.) - *zakone t'vetra* (gj. f.); *shteti madh* (gj. m.) - *shtete t'mdhoja* (gj. f.); *derti madh* (gj. m.) - *derte t'mdhoja* (gj. f.) etj. Ndërkalime gjinie kemi edhe tek emrat që shumësin e formojnë me mbaresën *-na* (*-ra* në gjuhën standarde dhe në të folmet toske), si: *ujna t'fkelta*, *druna t'dre:t*, *zana t'amël*, *mutâina t'vetër* etj.

3.1.2. NUMRI I EMRIT

22. Kategoria e numrit tek emri, siç dihet, tregon raportin e njërit ndaj më shumë sendeve ose personave. Shumica e emrave paraqiten në të dy format: në njëjës dhe në shumës. Një grup emrash kanë vetëm formë të njëjësit, ndërsa grupi tjetër vetëm formë të shumësit.

23. **Emra që përdoren vetëm në njëjës** (singularia tantum)

Përgjithësisht është e njohur se vetëm emrat e përgjithshëm kanë formën e shumësit. Emrat e përveçëm, emrat gjeografikë, një numër i konsiderueshëm emrash abstraktë, si dhe disa emra të përgjithshëm që emërtojnë ndonjë materie, nuk kanë formë për shumës, por përdoren vetëm në njëjës (singularia tantum). Vetëm në njëjës në këtë areal gjuhësor përdoren: a) disa emra abstraktë: *frâig*, *qeqsâi*, *ne:r*, *trimnâi*, *burrnâi*, *dijeni*; b) emra që shënojnë materie: *krâip*, *uftëll*, *tlin*, *kos*, *tamël*, *xhiz*, *breshën*, *bo:r*, *akëll*, *sheqer*, *kafe*, *gro:sh*, *benzin*, *çireç*, *dha:llt*, *mjalt*, *duha:n*; c) emra të disa sëmundjeve, dukurive atmosferike etj., si: *li-a*, *frâuth*, *zhu:g*, *shkepza*, *kolli*, *jarga*; *zheg*, *flad*, *hije* etj.

24. **Emra që përdoren vetëm në shumës** (pluralia tantum)

Edhe në të folmen e Karadakut të Shkupit disa emra përdoren vetëm në numrin shumës (pluralia tantum), si: *tâirçi*, *pantolle*, *gërshan*, *done*, *dimija*, *duqi*, *shallvare*. Gjithashtu, si edhe në të folmet e tjera shqipe,²⁶⁵ vetëm formë shumësi kanë edhe emrat: *krâunde*, *ethe*, *vâithe*, *jufka*, *makarona*, *fide*, *qirra*, *fjok*; *petka*, *tesha*; *dhen*; si dhe disa emra prejfoljorë lidhur me veprimtarinë bujqësore: *t'shimet*, *t'korrmët*, *t'laraumet*, *t'mellmet* etj.

Në këtë të folme vetëm në formë të shumësit përdoren edhe disa emra që shënojnë mëhallë, fise dhe mikrotoponime, si për shembull: *Memishalla:r*, *Hodalla:r*, *Qele* (f. Tanushë); *mahalla e Çajanve* (f. Orllancë), *Hoxht* (f. Brezë); *mahalla e Rrokve* (f. Straçincë); *N'rrafsha*, *N'ara t'Terzis*, *Te Vnesht*, *N'Qarra*, *N'ara t'Kacës*, *n'Hurdha t'Lekës* (f. Bllacë).

²⁶³ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*,..., f. 136.

²⁶⁴ Siç ka konstatuar prof. Shaban Demiraj, tek emrat e këtyre vëmendja e folësit përqendrohet më shumë në përcaktimin e sasisë, sesa në ruajtjen e gjinisë, që është diçka konvencionale. Shih: Shaban Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 36.

²⁶⁵ Remzi Nesimi, *Kategoria e numrit të emrave në të folmen e Dervenit*, Çështje gjuhësore, Shkup, 1997, f. 66.

25. **Shumësi i singularizuar.** - Në të folmen tonë, si dhe në disa të folme të gegërishtes qendrore, ekziston një numër i vogël emrash, të cilët njëjësën e shprehin me formën e shumësit. Të tillë janë, për shembull *shoç* (< shok); *fiç* (< fik) në të gjitha fshatrat e Karadakut.

Emra të singularizuar dhe mjaft karakteristik regjistruam në fshatrat Luboten dhe Straçincë, si: *ftoj* (< ftue), *kroj* (< krue), *thoj* (< thue), *prroj* (< prrue), *patkoj* (< patkue) etj. Emra të tillë hasim edhe në të folmen e Dervenit. Forma e shumësit e këtyre emrave në fshatrat e tjera të kësaj izoglose dallohen nga format e njëjësit. P.sh.: në f. Tanushë: ni *thue* - shu:m *thoj*; në f. Orllancë: ni *kra*: - sh. *krojna*, ni *tha*: - sh. *thojna*, ni *prru*: - sh. *prrojna*; në f. Bllacë: ni *prrue* - sh. *prrojna*; në f. Grushinë: ni *kra*: - sh. *krona*, ni *prra*: - sh. *prrona*, ni *thu*: - sh. *thona*; në fshatrat Brezë dhe Malinë: ni *prrae* - sh. *prrena*, ni *krae* - sh. *krojna*, ni *thae* - sh. *thojna*.

26. **Formimi i shumësit të emrit.** - Në të folmen e shqipe të Karadakut të Shkupit, sikurse edhe në gjuhën shqipe në përgjithësi, mjetet për formimin e shumësit të emrave janë të shumta. Emrat e gjinisë mashkullore kanë një shumës më të larmishëm në krahasim me emrat e gjinisë femërore. Nga pikëpamja e ndërtimit të trajtave të numrit shumës, emrat e gjuhës shqipe ndahen në dy grupe:

I. në emra që kanë vetëm një formë (si në njëjës ashtu edhe në shumës);

II. në emra me formë të veçantë në shumës.

27. **Emra që kanë vetëm një formë** (si në njëjës ashtu edhe në shumës). – Një numër i caktuar emrash në të folmen tonë, si edhe në mbarë shqipen dialektore e standarde, përdoren me formë të njëjtë, përkatësisht në formë të vetme a të përbashkët si për njëjësën, ashtu edhe për shumësin. Po japim disa shembuj të këtyre emrave: ni *mâi* – shâum (shu:m, sha:m) *mâi*, *murrall* - *murrall*, *mullâi* – *mullâi*, *kallâi* – *kallâi*, *lule* - *lule*, *lavërta:r* - *lavërta:r*, *hije* - *hije*, *fâille* – *fâille*, *punto:r* - *punto:r*, *katuna:r* - *katuna:r*, *udhta:r* - *udhta:r*, *shipta:r* - *shipta:r*, *gjoj* - *gjoj*, *zogj* - *zogj*, *ovça:r* - *ovça:r*, *magja:r* - *magja:r*, *u:dh* - *u:dh*, *çoban* - *çoban*, *bumba:r* - *bumba:r*, *hamall* - *hamall*, *la:m* - *la:m*, *vendali* - *vendali*, *dhâi* – *dhâi*, *grenze* - *grenze*, *fle:t* - *fle:t*, *ca:ll* - *ca:ll*, *nuse* (*nâuse*, *na:se*) - *nase*, *shoçe* - *shoçe*, *lo:p* – *lo:p*, *façe* - *façe*, *fletore* - *fletore* etj.

28. Emrat që kanë formë të veçantë për shumësin në Karadak, si edhe në gjithë Gegërinë, formën e shumësit e formojnë në katër mënyra, përkatësisht:

I. **me prapashtesa;**

II. **me ndërrime morfonologjike;**

III. **me ndërrime fonemash dhe prapashtesa;**

IV. **me kundërvënie fonologjike të gjatësisë së zanoreve.**

29. I. **Formimi i shumësit me prapashtesa.** – Mënyra më e shpeshtë e formimit të formës së shumësit tek emrat të gjinisë mashkullore dhe femërore është me anë të prapashtesave. Në të folmen në fjalë prapashtesa më produktive janë: **-a**, **-na**, **-e**; **-lla:r**, **-le:r**; **-i**: (**êi**), **-zi** etj.

a) Disa emra të gjinisë mashkullore e femërore shumësin e bëjnë me prapashtesën **-a**. Shumësi me prapashtesën **-a** është më produktivi në dialektin gegë, e rrjedhimisht edhe në këtë të folme: *mac-a*, *ftôurk-a*, *breshk-a*, *couc-a*, *gremz-a*, *bukall-a*, *grusht-a*, *shpatëll-a*, *gjisht-a*, *flet-a*, *msôus-a*, *nxans-a*, *fôush-a*, *gurubi-a*; *trëim-a*, *azgan-a*, *kraim-a*, *xhep-a*, *peshk-a*, *dhëpën-a*, *kërmaill-a* etj.

Pjesa më e madhe e emrave të gjinisë mashkullore shumësin e bëjnë me prapashtesën **-a**:. Si në gjuhën standarde shqipe, ashtu edhe në këtë të folme, prapashtesat e shumësit varen

shumë nga tingulli fundor i emrit në formën e njëjësit. Kështu, shumica e emrave të gjinisë mashkullore që mbarojnë me bashkëtingëllore (me disa përjashtime), shumësin e formojnë me prapashtesën **-a**. Të tillë janë ata që mbarojnë me *-p, -n, -m, -f, -s, -z, -ç, -c* etj. P.sh. nëse emri mbaron me bashkëtingëlloret:

-p: *plep-a, xhepa, nâip-a, trôup-a, top-a* etj.

-n: *bostana, filxhana, azgana, kazana, limana, majmuna, gajtana, sahana, jargana, sapuna, nallbana* etj.

-m: *xhama, hamama, çilima, krâima, trâima, kalema* etj.

-f: *gzofa, shtofa, çarshafa, esnafa, plafa* etj.

-s: *pusa, mcâusa, nxansa, lisa* etj.

-z: *murrâiza, filiza, breza, karpuza, gremza* etj.

-ç: *lomça, çekiça, kallamoça, kopaça* etj.

-c: *bubrrëca, turreca, specë, sqanca, memeca*; por *koc- kocâi* etj.

-k: *furka, bardaka, blloka, leleka, bika, janxhaika, jeleka*; por: *ni baxhanak - sh. baxhana:k, dishek - dishe:k, fishek - fishe:k* etj.

-g: *breg-a, pllug-a, prag-a, varg-a,*

-h: *krah - kraha, ah - aha; pleh, qeh - plehna, qehna* etj.

b) Një grup emrash që në trajtën e pashqar mbarojnë me zanore të theksuar shumësin e formojnë me prapashtesën **-na**, si p.sh.: *brî-na, drû-na, zã-na, frê-na, gjî-na, mullâi-na, mutâi-na, shullã-na* etj.

c) Një numër emrash shumësin e bëjnë me prapashtesën **-e**: *mal-e, vorr-e, bregj-e, katâun-e, inat-e, vend-e, kat-e, pllan-e, pazar-e, zakon-e, fâis-e, kanun-e, daull-e* etj.

ç) Me prapashtesat turke **-lla:r, -le:r** shumësin e formojnë një numër i caktuar emrash, si: *daja-lla:r, mixha-lla:r, hoxha-lla:r, baba-lla:r, hafëz-lla:r; haxhi-le:r, dervish-le:r, kadi-le:r, beg-le:r* etj.

d) Një numër i vogël emrash, shumësin e formojnë me prapashtesën **-î** (në formën fonetike si monoftong apo diftong), e cila zakonisht është e gjatë, e theksuar dhe hundore. Për shembull: *drapën - drapêi, drapnêi, drapni:*; *xharpën - xharpêi, xharpnêi; lepër - leprî:*; *peshk-peshki:*; *kungëll - kungî; kall - kallêi* (në fshatrat Bllacë dhe Straçincë).

dh) Në këtë të folme regjistruam edhe dy-tre shembuj të formimit të shumësit me prapashtesën **-zi**, si: *i:ll - illzi, ka:ll - kallzi, gju:r - gjurzi*.

30. II. **Formimi i shumësit me ndërrime morfonologjike.** – Siç është e ditur, një pjesë e emrave shumësin e formojnë me ndërrime fonemash në temën e fjalës, zakonisht me metafoini, qiellzorizim; me metafoini dhe palatalizim, si dhe me ndërrime të tjera të brendshme në vetë fjalën.²⁶⁶ Krahaso fjalët e dhëna në formën e njëjësit dhe të shumësit: *dash - desh; plak, qak - pleq, qeq; na:t - ne:t, uk - uq, mâik - mâiq, turk - turq, gjal - gjem, ka:l - ko:l, do:r - du:r, de:r - di:r* etj. Kundërvënia morfonologjike në ndërrimet e fonemave /k/ ~ /q/, /a/ ~ /e/, /a/ ~ /o/, /o/ ~ /u/ ~ /e/ ~ /i/, që na dalin në këta shembuj, janë të vetëmjaftueshëm për të dalluar formën e njëjësit nga forma e shumësit në mbarë shqipen si dhe në Karadakun e Shkupit.

31. II. **Formimi i shumësit me ndërrime fonemash dhe me prapashtesa.** – Një numër emrash në këtë të folme, sikurse edhe në gjuhën shqipe në përgjithësi, shumësin e formojnë me ndërrime të brendshme fonologjike në trup të fjalës si dhe me prapashtesim njëherazi, sipas tipit: *xhak - xhaqe, shat - shetni; prra: - prrona, prrae - prrena, prrae - prrojna; kra: - krona, krae -*

²⁶⁶ Ismet Osmani, *Ndërrimet morfonologjike në gegërishte*, Shkup, 2010, f. 55-99.

krojna; thu: - thona, prag - pragje, trull - troje, vâiç – veta etj. Ashtu si në eptimin e toskërishtes, ndërrimet morfonologjike luajnë një rol të madh edhe në të folmet e gegërishtes. Përgjithësisht, ato dalin krahas ndajshitesave eptimore, duke shërbyer kështu si mjete gramatikore plotësuese. Megjithatë, ekzistojnë edhe ndërrime që dalin si shënues të vetëmjaftueshëm të kuptimeve gramatikore.²⁶⁷

32. III. **Formimi i shumësit me kundërvënie fonologjike të gjatësisë së zanoreve.** Në të folmen shqipe të Malit të Zi të Shkupit si edhe në tërë dialektin e Veriut disa emra dallojnë numrin vetëm për nga gjatësia e njëres prej zanoreve, përkatësisht të zanores fundore (duke u nisur nga fillimi i fjalës). Kështu, zakonisht me zanore të shkurtër shqiptohen emrat në njëjës, ndërsa me zanore të gjatë forma e shumësit. Shikuar historikisht, opozicioni fonologjik zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë (= emër në njëjës ~ emri në shumës) shpjgohet me prirjen e përgjithshme të gegërishtes për bjerrjen e zanores [ë] në fundin absolut të fjalës, fillet e së cilës shihen qysh para tre shekujsh. Krahaso format e njëjësit me ato të shumësit: *dishek - dishe:k* (< dishekë), *fishek - fishe:k* (< fishekë), *burek - bure:k* (< byrekë), *lelek - lele:k* (< lejlekë), *dham - dha:m* (< dhambë, dhëmbë), *dallap - dalla:p* (< dollapë), *vesh - ve:sh* (< veshë) etj.

Ngjashmëri e larmi shumësi në katundet e Karadakut të Shkupit

33. Me interes për dialektologjinë është të vëzhgohet mënyra e formimit të shumësit te emrat që mbarojnë në bashkëtingëlloret -k, -g, -gj, -ll; si dhe ata me zanore të theksuar. Nga shkak i shumëllojshmërisë së mënyrës së formimit të shumësit, kemi regjistruar shumë të tillë, të cilët do t'i japim të pashpërndara nëpër mënyrat e formimit të shumësit, por veç e veç nëpër fshatrat shqiptare të Karadakut të Shkupit:

1. Në **Grushinë**: *fishek - fishe:k, plak - pleq, uk - uq, uç; pllug - plluga, prag - praga, shtek - shteka, varg - varga, kall - kallzi, ill - illzi, murall - muralla, faill - failla, hamall - hamalla, bakall - bakalla, shullã - shullãna; bri - brina, ka:ll - kallzi, mullai- mullaina, kra: - krona, thu: - thona.*

2. Në **Tanushë**: *mik - miç, shtek - shteqe, zog - zogj, varg - vargje, plak - pleç, uk - uç, trull - troje, filli - filla, illi - izlli, kunjëll - kuñi, shkam - shkamej, lum - lumej, kalli - kajzi, mulli - mulli, murall - murall, thue - thoj.*

3. Në **Brezë**: *ni bregj - sha:m bregje, ni pllugj - sham pllugja, prag - pragje, qak - qeq, gjak - gjaqe, uk - uq, fãill – fãilla, skërmãill – skërmãilla, brumagj - brumagja, kunjëll - kuñi:, ill - illzi, prrae - prrena, shkam - shkama, ka:ll - kallzi, ni mullãi - sh. mullãi, krae - krojna, thae - thojna, drapën - drapna, xharpën - xharpna.*

4. Në **Bllacë**: *breg - bregje, dishek- dishe:k, fishek - fishe:k, pllug - pllugja, lug - lugje, shtek - shteke, plak - pleq, uk - uq, fêill – fêilla, kërmãill-a, ill - illza, mullãi - mullai si dhe mullãina, ni ka:ll - kallzi, prrue - prrojna, drapën – drapêi, xharpën – xharpêi, vorr - vorre , grenze – grenze.*

5. Në **Luboten**: *breg-a, dishek-a, pllug-a, shtek-a, zog - zogj, varg-a, qak - qeq, uk - uq, fêill-a, kungull - kungi:, ill-zi, kallãi – kallãi, por edhe ka:ll – kallêi, shkam-a, ni sha:t - shetni, mullãi – mullãi, thoj - thoj, drapën – drapnãi, xharpën – xharpnêi; vâiç-a, veta (< vjeta).*

6. Në **Orllancë e Mojancë**: *dishek - dishe:k, fishek - fishe:k, pllug - plluga, prag - praga,*

²⁶⁷ Po aty, f. 184.

shtek-a, zog - zoga, varg - varga, plak - pleq, uk - uq, fêill - fêilla, kungull - kunglla, ill -zi, prru: - prrojna, shkam - shkama, ni ka:ll - sh. kalla, mullâi - mullâina, kra: - krojna, ni tha: - thojna, viç-a, gjisht-a, drapën - drapna, xharpën - xharpna.

7. Në **Straçincë**: *breg-a, dishek - dishe:k, fishek - fishe:k, plluga-a, prag-a, shtek-e, zog - zogj, varg-a, qak - qeq, ôuk - ôuq, fêill-a, kungull - kungi, ill - illa, ni prroj - sh. prroj, ni thoj - sh. thoj, ni kallêi - sh. kallêi, murrall - murrall, gisht-a, drapën - drapni:, xharpën - xharpnêi.*

Si përfundim mund të thuhet se:

34. Të folmet e gegërishtes ruajnë disa forma të vjetra të ndërmjetme të paqielzorëzuara të shumësit të emrave. Bie fjala, mund të nxirret një përgjithësim se emrat *peshk, kungull, lepur, mashkull, ka* etj. në shumë të folme geqe ende e ruajnë mbaresën e vjetër **-i**: *peshki, kungi, lepri, mashki, kie*. Kjo vërteton bindshëm pohimin se bashkëtingëlloret /q/ e /gj/ janë përfutur nëpërmjet qiellzorëzimit të prapagjuhoreve /k-/ dhe /g-/ nën ndikimin e zanores së përparme të mbyllur /-i/.²⁶⁸ P.sh. nga forma bazë *peshk* është kaluar te forma *peshq* nëpërmjet një faze të ndërmjetme *peshki*, pra: *peshk ~ peshki ~ peshq*.²⁶⁹ Njohja e shtrirjes gjeografike të formave morfologjike të fjalëve është e dobishme jo vetëm për gjeografinë gjuhësore të shqipes, por edhe për historinë e gjuhës.

35. Forma e shumësit me mbaresën **-a**: *zoga, plluga, shtega, brega, varga, barka, praga, blloka, briska, peshka* ende gjallon në disa të folme të veriut, krahas shumësit me qiellzorizimin e bashkëtingëllores fundore (zogj, shtigje, brigje, vargje, barqe, pregj, blloqe, brisqe, peshq).

36. Në të njëjtën të folme gjallojnë një, dy ose edhe më shumë forma shumësi: *breg ~ brega - bregje, brigje; bark ~ barka - barqe; bllok ~ blloka - blloqe; prag ~ praga, pragje*.

37. Në disa të folme geqe shumësi bëhet me metaforë, duke i shtuar edhe mbaresën **-ni**, si *dash - desh, vllah - vllah; kunat - kunet*, por edhe *kunet-ni, muzat - muzet dhe muzet-ni*.

38. Ruhet kundërvënia fonologjike e gjatësisë së zanoreve të tipit *plak ~ pla:k, kunat ~ kuna:t, kos ~ ko:s*. Marrë në përgjithësi, emrat në njëjës dhe ata të gjinisë mashkullore shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa shumësi i tyre dhe gjinia femërore përkatëse me zanore të gjatë.

39. Vlera fonologjike e hundorësisë së zanoreve në të folmet e Veriut po lëkundet. Në procesin e defonologjizimit të hundorësisë së zanoreve prijnë të folmet e skajshme të etnisë, veçmas ato të Maqedonisë së Veriut.

3.1.3. SHQUARSIA E EMRIT

40. Dihet që në gjuhën shqipe, si edhe në shumë gjuhë të tjera, emrat kanë dy trajta: trajtën e pashquar dhe trajtën e shquar. Edhe në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit kur duam të veçojmë një qenie të gjallë, një send etj. nga grupi që i përket, d.m.th. kur duam ta individualizojmë një emër të përgjithshëm, atë e përdorim të shoqëruar me një përemër dëftor (ki gja:l) ose në trajtën e shquar (gjali). Siç dihet, nyja shquese në gjuhët indoevropiane buron nga

²⁶⁸ Po aty, f. 196.

²⁶⁹ Shih: Eqrem Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, III*, Prishtinë, 1987, f. 218.

përemri dëftor.²⁷⁰

41. Në fakt, krahas rasteve të zakonshme të përdorimit të njëres apo të trajtës tjetër,²⁷¹ në këtë të folme regjistruam një dukuri shumë të shpeshtë dhe të rregullt të individualizimit të dyfishtë, përkatësisht shquarsinë e dyfishtë të emrit: me përdorimin e përemrit dëftor dhe me nyjën shquese, si në rastet: *ki gjali, aj burri, ki shoki, ajo gruja, çaj shoqi, çajo lopa, çiki ca:lli, çekjo caca, çiki kali* etj. Shquarsia e dyfishtë dëgjohej sidomos kur gjatë të folurit përsëriten emra të njëjtë njerëzish a kafshësh. Për shembull, në tregimet popullore: *Ish ka:n ni bu:rr e ni grue // Ajo gruja ni dit i tha ktâi burrit: O burri jem / shko laroje arën ... // Ki burri e ngjoj at gruen ene shkoj //*

42. Në variantin standard të shqipes trajta e shquar e emrit formohet mbi bazën e trajtës së pashquar të emrit në njëjës të rasës emërore,²⁷² duke ia prapavendosur nyjën shquese **-i** ose **-u** për gjininë mashkullore, **-a** (ja) për gjininë femërore, ndërsa **-t** (ë) për gjininë asnjane.

43. Në të folmen shqipe të Malit të Zi të Shkupit të gjithë emrat e gjinisë mashkullore në trajtën e shquar marrin mbaresën **-i**. Rrafshimi dhe përdorimi i nyjës shquese **-i** te të gjithë emrat e gjinisë mashkullore, pa marrë parasysh tingullin me të cilin mbarojnë, bashkëpërkon edhe me shumë të folme të tjera të gegërishtes, sidomos me ato të gegërishtes verilindore.²⁷³ Gjithashtu, marrë në përgjithësi, te kjo e folme nuk gjallojnë emrat e gjinisë asnjane (kemi vetëm mbetje emrash asnjane).

44. Mund të themi bindshëm se shquarsia e emrit në këtë të folme na paraqitet, si në shumicën e të folmeve të gegërishtes, në mënyrën më të thjeshtë të mundshme, përkatësisht nga katër format ekzistuese në të folmet e Jugut dhe në shqipen standarde [(-i, -u, -a(ja), -t(ë))²⁷⁴ këtu i kemi vetëm dy: **-i** dhe **-a** (ja). Në këtë kuptim, në të gjitha të folmet e fshatrave të këtij areali, pa përjashtim vlejné dy rregullat e mëposhtme:

a) emrat që në trajtën e shquar marrin mbaresën **-i** janë të gjinisë mashkullore;

b) emrat që në trajtën e shquar marrin mbaresën **-a** (ja) janë të gjinisë femërore.

45. **Shquarsia e emrave të gjinisë mashkullore.** - Siç u tha më sipër, emrat e gjinisë mashkullore në numrin njëjës emërore, trajtën e shquar e formojnë me mbaresën **-i**.²⁷⁵ Po japim disa shembuj: *gjal-i, katunar-i, çen-i, lis-i, shkus-i, dost-i, mcas-i, dash-i, gjep-i, kufâin-i, bar-i, zarm-i, shoq-i, kallamoq-i; qak-i, mâik-i, baxhanak-i, konak-i, xhak-i, uk-i, shnâik-i, breg-i, lang-i; prag-i, pragj-i, zog-i, zogj-i; câung-i, ah-i, krah-i, qeh-i, sheh-i* etj.

46. Disa emra të gjinisë mashkullore, të cilët në trajtën e pashquar mbarojnë me zanore të theksuar (të cilët dikur kanë mbaruar me bashkëtingëlloren /n/) në trajtën e shquar sërish rikthehet /n/-ja e dikurshme, që në trajtën e shquar na del në pozicion ndërzanor. Krahaso shembujt në trajtë të pashquar dhe në të shquar: *zâ: - zâ-n-i, frë: - frë-n-i, pë: - pë-n-i, hÛ: - hu-n-i, drÛ: - drÛ-ni, sâi - sâi-n-i*, e diku edhe *sâi-v-i; gjÛ: - gjÛ-n-i, mullâi - mullâi-n-i, mâi-n-i, kufâi-n-i*; por edhe *ftoj - ftoj-n-i, thoj - thoj-n-i, prroj - prroj-n-i, kroj - kroj-n-i* etj. ku historikisht nuk ka pasur /n/.

²⁷⁰ Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I dhe II), Prishtinë, 1980, f. 82.

²⁷¹ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), Tiranë, 1995, f. 121-131.

²⁷² Formë përfaqësuese (bazë) e emrit merret trajta e pashquar, numri njëjës, rasa emërore.

²⁷³ Bahri Beci, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987, f. 45.

²⁷⁴ Besim Bokshi, *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë, 1980, f. 108.

²⁷⁵ G. Majeri, Brugmmani, S. Riza, B. Bokshi, I. Ajeti vërtetojnë se nyja shquese **-i** në gjuhën shqipe është primare. Nën ndikimin e përngjashmimit paravajtës në takim, përkatësisht nën ndikimin e prapagjuhoreve **k, g, -i**-ja e radhës së përparme ka kaluar në zanore të prapme **-u**, që më pas të jetë përgjithësuar edhe tek emrat që mbarojnë me **-h** si dhe tek emrat që mbarojnë me zanore të theksuar.

Te pak emra të gjinisë mashkullore që mbarojnë me diftong (i përftuar nga diftongimi i zanores së theksuar /i/), ndërmjet temës dhe nyjës shquese, ndërfitet -v-ja epetentike si tingull antihiatizues, si: *sâi-v-i, shâi-v-i, thâi-v-i* etj.

47. **Shquarsia e emrave të gjinisë femërore.** - Emrat e gjinisë femërore kryesisht trajtën e shquar në njëjës in e emërorores e formojnë me mbaresën **-a** (ja), sipas tipit: *lop-a, cac-a, pul-a, grop-a, gjeshk-a, fjutr-a; kep-a, gjoj-a, çill-a, dor-a, der-a, petll-a, temcâi-a, kusâi-a, lethâi-a, dhâi-a, shpâi-a* ...

Shënim: Në këtë të folme, si dhe në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore, ku është i pranishëm diftongimi, tek emrat që në trajtën e pashquar mbarojnë me diftongjet *âi, êi*, pas tyre, në trajtën e shquar e përgjithësisht në paradigmen e lakimit nuk kanë nevojë të marrin -j-antihiatizuese: *shpâi-a; i, e shpâi-ës; shpâi-ës, shpâi-ën; i, e ni shpâi-e; shpâi-at; i, e shpâi-ave* etj., siç është e zakonshme në të folmet e tjera që nuk kanë diftongim zanorësh (shpi-j-a). Në këtë kuptim, duke u nisur nga fakti që tingulli [j] është pjesë përbërëse e diftongut *âi, êi* (≈ aj, ëj), folësit e këtij areali, si dhe folësit e gjithë izoglosës diftonguese të shqipes, nuk e kanë ndjerë të nevojshme të shqiptojnë njëpasnjëshëm dy bashkëtingëllore të njëjta a të ngjashme, përndryshe do të krijonin geminatën [jj].

48. Megjithatë, te disa emra të tjerë ndërmjet temës së emrit dhe nyjës shquese ndërfitet -j-ja antihiatizuese, me çka fitohet mbaresa **-ja**, siç ndodh tek emrat: *dele - del-j-a, bure - bur-j-a, raki - raki-j-a, radi - radi-j-a, kala: - kala-j-a, bela: - bela-j-a, sefa: - sefa-j-a, hata: - hata-j-a, dunja: - dunja-ja* ... Të njëjtën gjë e ndeshim edhe gjatë formimit të trajtës së shquar tek emrat vetjakë që mbarojnë me zanore të theksuar, të tipit: *Sadi-j-a, Kumri-j-a, Shukri-j-a, Fekri-j-a* ... Me mbaresën **-ja** trajtën e shquar e formojnë edhe emrat e tipit: *Mihane - Mihan-ja, Simrane - Simran-ja, Shukrane - Shukran-ja* ...

49. Disa emra me gjini natyrore (seks) mashkullore, nga pikëpamja gramatikore marrin mbaresat e emrave femërorë **-a** (ja): *mixh-a, hoxh-a, daj-a, haxhi-ja, kojshi-ja, sudi - sudi-j-a, kadi - kadi-j-a*; mbaresën e gjinisë femërore e marrin edhe disa emra njerëzish meshkuj që mbarojnë me zanore të theksuar, si *Hamzi-ja, Nuri-ja, Bari-ja, Lutfi-ja, Shefki-ja, Medi-ja, Nazli-ja* ...

3.1.4. RASAT E EMRIT

50. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit në gjendjen e sotme përdoren pesë rasa sintetike: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore në trajtë të pashquar dhe të shquar të emrit, si në njëjës ashtu edhe në shumës. Thirrora tashmë nuk merret si rasë e veçantë,²⁷⁶ nga shkak që është me formë të njëjtë me emëroren, kurse dallohet vetëm nga pjesëzat thirrora *o, oj* (o Bujar, Bujar-o; oj Hanife, Hanif-jo) të cilat mund të qëndrojnë para ose pas emrit, ose me përdorim të dyfishtë, edhe para edhe pas emrit (o Bujar-o, oj Hanif-jo).

Megjithatë, duhet të theksohet se si në gjuhën standarde shqipe, ashtu edhe në këtë të folme, edhe pse për nga funksioni kemi pesë rasa, për nga forma kemi përputhje ndërmjet disave prej tyre, e rrjedhimisht edhe zvogëlimin e formave rasore. Në këtë kuptim, forma e rasës

²⁷⁶ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), Tiranë, 1995, f. 107.

emërore është e njëjtë me kallëzoren e emrave të pashquar (në njëjës e në shumës). Shpeshherë me forma të njëjta janë edhe dhanorja dhe rrjedhorja në njëjës dhe në shumës. Gjnjorja dhe dhanorja zakonisht dallohen vetëm për nga prania ose mungesa e nyjës së përparme (i, e; të, së). Zvogëlimi, rrafshimi dhe integrimi i trajtave rasore në gjuhën shqipe është shkaktuar nga përdorimi i parafjalëve, nga evoluimi i tingujve fundorë, nga veprimi i analogjisë për rrafshimin e formave etj.²⁷⁷

Për të parë se në sa forma gramatikore (trajtë, gjini, numër, rasë) del emri në gjuhën shqipe, kemi lakuar për një kohë të gjatë shumë emra lakimesh të ndryshme, qoftë me studentë, qoftë në shtëpi. Në këtë kuptim, kemi ardhur në përfundim se: në mbarë shqipen (në shqipen dialektore e standarde) mund të na shfaqen gjithsej jo më shumë se tetë forma emrash në paradigmen e lakimit, si: *libër, libri, librit, librin, libra, librat, librave, librash; fletore, fletorja, fletoren, fletoret, fletoresh, fletoreve, fletoreje, fletores*.

51. Në gjuhën shqipe është e ditur që emri përdoret pa parafjalë dhe me parafjalë. Parafjalët, në rastet më të shpeshta ndodhen para emrave në rasat kallëzore, rrjedhore dhe emërore. Kur emri përdoret me parafjalë, funksioni i tij shprehet njëkohësisht edhe me rasë edhe me parafjalë. Por shpesh parafjalët kanë edhe funksion të veçantë për plotësimin apo saktësimin e emrit që e shoqëron.²⁷⁸

52. Emri në rasën emërore shërben për të shënuar personin që e kryen veprimin, përkatësisht kryefjalën, ndërsa mund të quhet edhe rasë e subjektit. Gjnjorja kryesisht tregon përkatësi apo pjesë të tërësisë. Dhanorja ka rol përcaktori, përkatësisht në rastet më të shpeshta në fjali është kundrinë e zhdrejtë, atribut. Kallëzorja sipas funksionit është kundrinë e drejtë; ndërsa rrjedhorja tregon gjenezë, largim ose afrim nga ndonjë vend etj.

53. Siç duhet, funksioni themelor i rasave mund të identifikohet me parashtrimin e pyetjeve të caktuara, si:

Emërore (nominativ)	përgjigjet në pyetjet	kush?, cili?, cila? cilët?
Gjinore (genitiv)	-----	i, e kujt?, të kujt?
Dhanore (dativ)	-----	kujt?
Kallëzore (akuzativ)	-----	kë?, cilin?
Rrjedhore (ablativ)	-----	prej kujt? prej cilit?

54. Siç u tha më parë, meqë në këtë të folme nuk kemi emra që trajtën e shquar e formojnë me -u, e as emra të gjinisë asnjënjës [(me t(ë)], prandaj kemi vetëm dy lakime:

I. **Lakimin e parë** e përbëjnë emrat e gjinisë mashkullore, të cilët trajtën e shquar e formojnë me mbaresën -i.

II. **Lakimin e dytë** e përbëjnë emrat e gjinisë femërore, të cilët trajtën e shquar e formojnë me -a. Këtu bëjnë pjesë edhe një numër i caktuar emrash të gjinisë mashkullore, që shquarsinë e formojnë me po këtë mbaresë, p.sh.: *mixh-a, daj-a, hoxh-a, Hamzi-ja, Gani-ja, Bari-ja* etj.

55. Që të kemi një pasqyrë më të qartë të lakimit të emrave në të folmen tonë, gjegjësisht për mbaresat e tyre rasore në njëjës dhe shumës, po japim në vazhdim disa paradigma emrash për të dy lakimet:

²⁷⁷ Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I dhe II), Prishtinë, 1980, f. 63.

²⁷⁸ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), ..., f. 107.

Lakimi I - emra të gjinisë mashkullore (-i)

njëjës				
rasat	trajta e pashquar		trajta e shquar	
emërore	(ni) mal	gjel	mali	gjeli
gjinore	i, e (ni) mali	gjeli	i, e malit	gjelit
dhanore	(ni) mali	gjeli	malit	gjelit
kallëzore	(ni) mal	gjel	malin	gjelin
rrjedhore	(ni) mali	gjeli	malit	gjelit

shumës				
rasat	trajta e pashquar		trajta e shquar	
emërore	(do) male	gjela	malet	gjelat
gjinore	i, e (do) maleve	gjelave	i,e maleve	gjelave
dhanore	(do) maleve	gjelave	maleve	gjelave
kallëzore	(do) male	gjela	malet	gjelat
rrjedhore	(do) malesh	gjelave	maleve	gjelave

Lakimi II - emra të gjinisë femërore [-a (ja)]

njëjës				
rasat	trajta e pashquar		trajta e shquar	
emërore	(ni) pu:l	lo:p	pula	lopa
gjinore	i, e (ni) pule	lope	i, e pulës	lopës
dhanore	(ni) pule	lope	pulës	lopës
kallëzore	(ni) pu:l	lo:p	pulën	lopën
rrjedhore	(ni) pule	lope	pulës	lopës

shumës				
rasat	trajta e pashquar		trajta e shquar	
emërore	(do) pula	lo:p	pulat	lo:pt
gjinore	i, e (do) pulave	lopve	i, e pulave	lo:pve
dhanore	(do) pulave	lo:pve	pulave	lo:pve
kallëzore	(do) pula	lo:p	pulat	lo:pt
rrjedhore	(do) pulave	lo:pve	pulave	lo:pve

3.2. MBIEMRI

1. Mbiemra quhen fjalët që shënojnë se çfarë lloji është ose çfarë vetie ka emri (qen i zi, qen i vogël, ushtria shqiptare, qeveria italiane).²⁷⁹ Mbiemrat, siç dihet, emërtojnë një cilësi a tipar të sendit që e përcaktojnë. Ai përshtatet në gjini, në numër e rasë me emrin të cilin e përcakton. Në këtë kuptim, mbiemri merr gjininë, numrin dhe rasën e emrit të cilit i përket. Mbiemri ka kategorinë e gjinisë e të numrit; ndërsa mbiemrat e nyjshëm edhe kategorinë e rasës. Veç kësaj, mbiemri ka edhe kategorinë e shkallës, të cilën emri nuk e ka. Mbiemri është mjeti kryesor për të përshkruar një frymor, një gjë ose një pamje. Mbiemrat, përshkrimin e bëjnë të pasur, të qartë, sepse shprehin ngjyrën, formën, cilësinë, lëndën etj. Derisa në pikturë përdoren ngjyra, vija e forma; në fjali përdoren mbiemrat.²⁸⁰

2. Në të folmen tonë dhe në të folmet e tjera, si dhe në mbarë shqipen, një numër i mbiemrave janë fjalë të parme: *i mâir, i madh, i kuç, i keç, i amël* etj., ndërsa disa të tjerë janë mbiemra jo të parmë a të prejardhur, të përfutur nga pjesë të tjera të ligjëratës, si:

a) mbiemra **të përbërë** (emër + mbiemër): *barkmadh, sâize:z, krâiemadh, zemërxhan, kamgjat, leshkuç;*

b) **emra**: *punto:r, katuna:r, besnâik, i drunit, i hekrit, i popllit, i kokrrizt, i helmâum;* c) **folje**: *i hapt, i mshelt, i kullum, i msâum;*

ç) **ndajfolje**: *i nalt, i hershëm, i sotshëm, i dikurshëm, i ktushëm, i la:rgt, i mrenshëm, i jashtëm; numëror: i par, i dit, i pe:st* etj. Kur mbiemri përdoret i pavarur, ai emërzohet (substanzohet).²⁸¹ Për shembull (në fjalinë e parë si mbiemër e në fjalinë e dytë si mbiemër i emërzuar): *Ai asht xha:l i mâir (i keç) / I mâiri duhet t'lavdohet, i keçi t'keshët // Njer barkmadh / Barkmadhi erdh // Njer puntor / Puntori punon // M'u ka shpërthâi guma mrenshme / E mrenshmjia nxhitët //*²⁸²

Në vazhdim do të paraqesim mënyrat më të shpeshta të formimit të mbiemrave në arealin gjuhësor të Karadakut të Shkupit.

3.2.1. FORMIMI I MBIEMRAVE

a) Nga **nyja e përparme** + **pjesorja** + **prapashtesa -m, -me**: *i la:m - e lame, i hecëm - e hecme, i pekëm - e pekme, i pasëm - e pasme, i xhetëm - e xhetme, i lazdrâum - e lazdrâume, i këndâum - e këndâume, i gjazmâum - e gjazmâume* etj.

b) Nga **nyja e përparme** + **pjesorja** + **prapashtesa -t**: *i shâisht - e shâisht, i lisht - e lisht, i prâisht - e prâisht.*

c) Një pjesë e mbiemrave formohen **me prapashtesën -shëm** (për gj. m.) dhe **-shme** (për

²⁷⁹ <http://gjuhashqipe.com/albanologji/albanologji.aspx?id=196>; shkarkuar më 05. 07. 2020.

²⁸⁰ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), Tiranë, 1995, f. 153.

²⁸¹ Me emërzim të mbiemrit kuptohet kalimi i tij në klasën e emrit, pa ndryshim të jashtëm, pa ndajshitesa. Mbiemrat lakohen vetëm në bashkëvjatje me emrat, ose më vete si të emërzuar. Pra, kur emërzohet, mbiemri fiton kuptimin e emrit.

²⁸² Ndërmjet mbiemrave të mirëfilltë dhe mbiemrave të emërzuar (emrave prejmbiemërorë) ka një tregues të rëndësishëm që dallon dhe identifikon ata: forma e pashquar dhe e shquar. Dihet se mbiemrat në gjuhën shqipe përdoren vetëm në trajtën e pashquar, ndërsa mbiemrat e sustantivizuar (emrat prejmbiemërorë) përdoren në trajtën e shquar.

gj. f.), si: *i ngjâushëm - e ngjâushme, i dashëm - e dashme, i heshëm - e heshme.*

ç) Ka dhe një sasi mbiemrash - emrash me prejardhje orientale, si *tamaqar, zullumqar, hizmeqar* etj. Të shpeshta janë formimet e mbiemrave me prapashtesa turke, që janë bërë produktive -*li*-, -*xhi*-, si *pareli*-, *namuzli*-, *sheherli*-, *belaxhi*-, *dallaveraxhi*: etj.

d) Prapashtesat -*tar*-, -*ar*-, -*ik*-, -*ist*-, -*iv*-, -*or*-, -*tor*-, -*ues*-, -(*ë*)s, që janë mjaft produktive në formimin e mbiemrave në shqipen standarde,²⁸³ në të folmen tonë janë të rralla, si: *lajkata:r, hokata:r, haberta:r* etj.

Mbiemrat e përbërë

3. Në të folmet popullore më të shumënumërt janë mbiemrat jo të përbërë. Megjithatë, edhe mbiemrat e përbërë janë të pranishëm në shqipen dialektore. Më së shumti i hasim mbiemrat e përbërë, të tipit: *emër + emër; emër + mbiemër, numëror + emër*. Për shembull: *zemërgju:r, krâiekujëll, krâiehudër, ftâirha:n, gojçera:p, kamlepër; barkmadh, krâiemadh, veshgja:t, kamshpejt, kammadh, sâizi, sâize:z, vetëllzi, vetëlltrash, vetëllho:ll, sâishtremt, kamshtremt, sâimshelt, ballxha:n, sâikuç, ftâirzi, gojamël, gojshtremt, buz'ho:ll, buztra:sh, çafgja:t, veshmadh, shtat'ho:ll, gojli:r, likurtrash; dordha:nt, gojhapt* etj.

3.2.2. FORMAT E MBIEMRAVE NËPËR RASA

4. Dihet mirëfilli se shqipja ka dy tipa mbiemrash: të nyjshëm dhe të panyjshëm. Numri më i madh i mbiemrave në shqipen janë të nyjshëm, por ka edhe të panyjshëm. Mbiemrat e nyjshëm i kanë nyjat **i**, **e**, **të** në rasën emërore, kurse mbiemrat e panyjshëm nuk kanë asnjë nyjë të paravendosur. Nyja te mbiemrat e nyjshëm është pjesë përbërëse e tyre dhe nuk mund të mungojë në asnjë rast. Nyja të përparme edhe në Karadakun e Shkupit janë: **i**, **e**, **t'** (< të), **s'** (< së). Nyja **i** përdoret para emrave të gjinisë mashkullore, nyja **e** përdoret para emrave të gjinisë femërore. Nyjat **t'** dhe **s'** përdoren në rasat e zhdrejta:²⁸⁴ **t'** për gjininë mashkullore dhe **s'** për gjininë femërore. Për shembull:

	<i>njëjës</i>		<i>shumës</i>
<i>rasat</i>	<i>gjinia mashkullore</i>	<i>gjinia femërore</i>	
E.	(ni) dash i bardh	(ni) dele e bardh	(do) dhen t' bardha
Gj.	i dashit t' bardh	e deles s' bardh	i dhenve t' bardha
Dh.	dashit t' bardh	deles s' bardh	dhenve t' bardha
K.	dash t' bardh	delen e bardh	dhen t' bardha
Rr.	dashi t' bardh	deles s' bardh	dhensh t' bardha

5. Mbiemrat në të folmen tonë, si dhe në mbarë gjuhën shqipe, kanë dy gjini: mashkullore dhe femërore. Gjinia femërore e mbiemrave krijohet nga gjinia mashkullore. Në vijim do të

²⁸³ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), Tiranë, 1995, f. 159.

²⁸⁴ Rasa të drejta janë emërorja dhe kallëzorja, ndërsa rasa të zhdrejta janë gjinorja, dhanorja dhe rrjedhorja.

sjellim rregullat kryesore të formimit të mbiemrave të gjinisë femërore në shqipen e Karadakut:

a) Mbiemrat që në shqipen standarde mbarojnë me *-ë, -ël, -ër* dhe *-ët*; gjininë femërore e bëjnë duke ndryshuar vetëm nyjën e përparme **i** në **e**, sipas tipit: *i mâir - e mâir, i amël - e amël, i ba:rdh - e ba:rdh, i shpejt - e shpejt, i gja:t - e gja:t, i u:rt - e u:rt, i vogël - e vogël, i smu:t - e smu:t, i poshtër - e poshtër, i ra:n - e ra:n, i ka:ft - e ka:ft, i trash - e trash, i nxe:t - e nxe:t, i ftoft - e ftoft, i vetër - e vetër* etj.

b) Të gjithë mbiemrat që mbarojnë me *-ëm* dhe *-shëm*, si dhe mbiemrat prejfoljorë, gjininë femërore e bëjnë duke ndryshuar nyjën e përparme si dhe duke marrë mbaresën **-e** (i > e + e): *i pasëm - e pasme, i knâushëm - e knâushme, i hershëm - e hershme, i la:m - e lame* etj. Me këtë rrugë gjininë femërore e bëjnë edhe mbiemrat: *i madh - e madhe, i kuç - e kuçe, i keç - e keçe, i shkrâum - e shkrâume* etj.

c) Disa mbiemra gjininë femërore e bëjnë me ndërrimin e nyjës së përparme si dhe me shndërrimin në gjatësi të zanores fundore, nga zanore e shkurtër në zanore të gjatë. Te mbiemri i gjinisë femërore zanorja është më e gjatë sesa te mbiemri përkatës mashkullorë. P.sh.: *i lig - e li:g, i plak - e pla:k, i par - e pa:r, i dit - e di:t* 'i dytë – e dytë', *i tret - e tre:t* 'i tretë – e tretë', *i shkret - e shkre:t* etj.

ç) Te mbiemrat e panyjshëm (që janë më të paktë sesa të nyjshmit), gjinia femërore formohet duke marrë mbaresën **-e**, ndonjëherë prapashtesën **-e:sh**, si: *trâim – trâime*; por edhe *trâimne:sh, mâik – mâike, mâike:sh; besnâik – besnâike, zavrak - zavrake, habdall - habdalle, llaskuc - llaskuce, bu:rr – burrne:sh* etj.

Shënim: Disa mbiemra dallohen nga ndajfoljet. Mbiemrat përdoren gjithmonë me nyje të prapme, ndërsa ndajfoljet nuk kanë nyje të prapme. Krahaso mbiemrat nga ndajfoljet përkatëse: *i mâir, e mâir – mâir; i na:lt, e na:lt - nalt, i shpe:jt, e shpe:jt – shpejt; i ba:rdh, e ba:rdh - bardh; i ho:ll, e ho:ll – holl; i ke:ç, e keçe - keç; i nga:t, e nga:t – ngat* etj. Në përgjithësi te mbiemrat zanorja fundore është e gjatë, ndërsa te ndajfoljet e shkurtër.

3.2.3. NUMRI I MBIEMRIT

6. Si gjinia ashtu edhe numri i mbiemrave është i kushtëzuar nga numri i emrit që e përcakton. Pra, numri i mbiemrit varet nga numri i emrit të cilit i përket. Kjo do të thotë se kur emri është në njëjës, edhe mbiemri duhet të jetë në njëjës. Kur emri është në shumës, edhe mbiemri duhet të përdoret në shumës. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, si edhe në mbarë shqipen, mbiemrat shumësin e bëjnë në disa mënyra:

a) Duke bërë shumës vetëm nyjën e përparme **i** në **t'** (< të). Krahaso formën e njëjësit nga forma e shumësit të mbiemrave: *i ri - t'ri, i zi - t'zi, i mâir - t'mâir, i bardh - t'bardh, i kuç - t'kuç, e kuçe - t'kuçe, i heshëm - t'heshëm, e heshme - t'heshme, i hershëm - t'hershëm, e hershme - t'hershme, i nga:t - t'nga:t, i paçt - t'paçt, e zoja - t'zoja, i amël - t'amël, i sert - t'sert, i u:rt - t'u:rt, i nershëm - t'nershëm', e nershme - t'nershme, i zi:m - t'zi:m, e zime - t'zime, i shno:sh - t'shno:sh* etj.

b) Shumë mbiemra të panyjshëm kanë formë të njëjtë si për njëjësin ashtu edhe për shumësin. Për shembull: *ni burr besnâik - do burra besnâik, ni gru: puntore - do gra puntore, ni lepër kamshpejt – shâum lepri: kamshpejt, ni njer ftâirzi - do xhin ftâirzi, ni njer gojli:r - do xhin gojli:r, ni njer likurtra:sh - do likurtra:sh, ni njer dordhant - do dordhant, ni njer shpâirtmâir -*

do shpâirtmâir etj.

Megjithatë, ka mbiemra që në shumës marrin mbaresën **-a**, ose ndryshojnë ndonjë fonemë në temën e fjalës, sipas tipit: *ni burr trâim - do burra trâima, ni grue trâimnesh - do gra trâimnesh, ni njer barkmadh - do barkmdhoj, ni câull krâiemadh - do krâiemdhoj.*

c) Një sasi e konsiderueshme mbiemrash shumësin e bëjnë me ndërrimin e nyjës së përparme **i > t'** dhe me ndërrime fonemash; disa emra të gjinisë femërore duke marrë edhe mbasesën **-a**: *i madh - t'mdhoj, e madhe - t'mdhoja, e re - t'reja, e ze:z - t'zeza, e keçe - t'kçija, e nga:t - t'ngata, e paçt - t'paçta, i zoti - t'zott, i amël - t'amla, e mâir - t'mâira, e sert - t'serta, e u:rt - t'urta, e shnosh - t'shnosha etj.*

3.2.4. PËRSHTATJA E MBIEMRIT ME RASËN E EMRIT

7. Në funksionin e përcaktorit, mbiemri në gjuhën shqipe, përfshirë edhe të folmen tonë, rëndom rri pas emrit dhe atëherë është i pashquar: *dja:l i mâir*. Dihet mirëfilli se mbiemri merr gjininë, numrin dhe rasën e emrit të cilit i përket. Në këtë kuptim, lidhshmëria e ngushtë gramatikore e mbiemrit me emrin, përveç në gjini dhe numër, vërehet edhe në përshtatshmërinë e mbiemrit me rasën e emrit.

8. Në fakt, mbiemrat e panyjshëm kur vendosen pas emrit që e përcaktojnë, nuk pësojnë ndonjë ndryshim në rasë, domethënë nuk lakohen. Edhe mbiemrat e nyjshëm nuk lakohen në shqipen, por ndryshon vetëm nyja e tyre e përparme. Mbiemrat lakohen vetëm në bashkëvajtje me emrat, ose më vete si të emëruar. Në fakt, në fjali në topikë të zakonshme: emër + mbiemër forma të ndryshme nëpër rasi merr vetëm emri dhe nyja e përparme e mbiemrit, por mbiemri mbetet i pandryshuar. Për ta parë këtë, do të japim paradigmen e lakimit të një sintagme me emër dhe mbiemër:

<i>njëjës</i>		
<i>rasat</i>	<i>gjinia mashkullore</i>	<i>gjinia femërore</i>
E.	gjali i mâir	câuca e mâir
Gj.	i gjalit t' mâir	i câucës s' mâir
Dh.	gjalit t' mâir	câucës s' mâir
K.	gjalin e mâir	câucën e mâir
Rr.	pej gjalit t' mâir	pej câucës s' mâir
<i>shumës</i>		
<i>rasat</i>	<i>gjinia mashkullore</i>	<i>gjinia femërore</i>
E.	gjemt e mâir	câucat e mâira
Gj.	i gjemve t' mâir	i câucave t' mâira
Dh.	gjemve t' mâir	câucave t' mâira
K.	gjemt e mâir	câucat e mâira
Rr.	pej gjemve t' mâir	pej câucave t' mâira

3.2.5. KATEGORIA E SHKALLËS SË MBIEMRIT

9. Cilësia e sendeve mund të shprehet në mënyrë të shkallëzuar (Liqeni është *i madh*. Deti është *më i madh*. Oqeani është *shumë i madh*). Pra, mbiemri ka tri shkallë: shkallën pohore, krahasore dhe sipërore. Cilësia e gjallesave, e sendeve mund të jetë në shkallë të ndryshme pozitive ose negative. Rrjedhimisht, mbiemri ka shkallë të sipërisë dhe shkallë të ultësisë. Këto kategori gramatikore që ka mbiemri në mbarë shqipen si dhe shqipen standarde, i ka edhe e folmja e Karadakut të Shkupit. Pra, shkallëzimi i mbiemrave në shqipen e kësaj krahine bëhet njësoj si në të folmet e tjera popullore dhe në shqipen standarde:

	<i>shkalla e mbiemrit</i>	
	shkalla sipërore	shâum i mâir
	shkalla krahasore	ma i mâir
	shkalla pohore	i mâir
	shkalla krahasore	ma i keç
	shkalla sipërore	shâum i keç

10. Shkallëzimi i mbiemrave në gjuhën shqipe, siç dihet, shprehet nëpërmjet formave analitike: me mjete leksikore të cilat përdoren para mbiemrave. Në të folmen tonë fjalë të tilla më të shpeshta që përdoren para mbiemrave janë: *se, sa, sesa, pej, ma, shâum, shâum ma, tepër, për s'tepër* etj.

11. **Shkalla krahasore** tregon se cilësia e dhënë krahasohet me vetveten ose me një cilësi tjetër. Kjo shkallë përbëhet prej dy pjesësh. Lidhja e dy gjymtyrëve të krahasimit bëhet me lidhëza krahasore: para formës themelore mbiemërore përdoret pjesëza **ma**, e në pjesën e dytë përdoret lidhëza **se, sesa, pej** + një emër, përemër ose mbiemër. P.sh.: *Aj asht ma j madh se Dalipi. Aj asht ma j knâushëm sesa û. Për kit pu:n ije ma i gjazmâum se i idhnâum* etj. Edhe në shkallën e ultësisë krahasimi bëhet në të njëjtën mënyrë: *Tâi ije ma j keç se Hasani*.

12. **Shkalla sipërore** e mbiemrit tregon se cilësia e dhënë është në një shkallë shumë të lartë jashtë çdo krahasimi. Ajo ka formë analitike dhe ndërtohet me ndajfolje sasive, të cilat vendosen përpara formës pohore të mbiemrit. Në të folmen tonë rëndom përdoren ndajfoljet e sasisë: *shâum, tepër, për s'tepër*, sipas tipit: *Ajo asht shâum e mâir. Kjo asht tepër e madhe. Aj asht për s'tepër i urt*.

13. Për të shprehur shkallë shumë të lartë të cilësisë, përdoren edhe disa emra me kuptim të fytyruar, të cilët në rastin e dhënë nuk emërtojnë më sende, por tipare karakteristike të këtyre sendeve, p.sh.: *akëll i ftoft, korb i zi, plum (qum) i ra:n, pelim i idht, va:l e nxet, zarm i nxet, gjuri i fo:rt, hekër i fort, pe: i ho:ll, penël i le:t, bo:r e ba:rdh, u:j i lagt, çu:ll i lagt, shkrum i gjegt, liman i sariht, xhak i kuç, ufëll e thart* etj.

14. Për mbiemra në shkallën sipërore, në të folmen tonë i konsiderojmë edhe ndërtimet që sipas formës janë në shkallën krahasore, por duke i krahasuar me veti gjërash në shkallën më të lartë të mundshme, shprehin shkallë shumë të lartë të cilësisë, si p.sh.: *i rân si plum (qum), i le:t si penël, i kuç si xhaki, i amël si sheçer, e idht si pelimi, i dre:t si çiri, i trash si thâi, i ho:ll si gjisht, i dret si konopi n'thes, i shpejt si vetâima, i kadalshëm si breshka, i u:nt si u:k* etj.

3.3. NUMËRORI

1. E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit nuk dallohet nga të folmet e tjera të dialektit të Veriut në çështjen e numërorit. Për nga mëyra e formimit edhe në këtë të folme, si në mbarë shqipen, numërorët mund të jenë: fjalë të parme, të përngjitura, fjalë të përbëra dhe shprehje. Në vazhdim do të japim disa numërorë nga kjo e folme:

- **Fjalë të parme janë numërorët:** o - *xerro*, 1- *nja*, *njo*; 2 - *di*, 3 - *tre* (gj. m.) dhe *trâi* (< tri, gj. f.); 4 - *katër*, 5 - *pe:s*, 6 - *xha:sht*, 7 - *shta:t*, 8 - *te:t*, 9 - *na:n*, *nond*; 10 - *dhâit*, *dhe:t*.
- **Fjalë të përngjitura:** 11 - *nimdhâit*, *nimdhe:t*, 12 - *dimdhâit*, *dimdhe:t*, 13 - *tremdhâit*, *tremdhe:t*, 14 - *katërmdhâit*, *katërmdhe:t*, 15 - *pesmdhâit*, *pesmdhe:t*, 16 - *xhashtmdhâit*, *xhashtmdhe:t*, 17 - *shtatmdhâit*, *shtatmdhe:t*, 18 - *tetmdhâit*, *tetmdhe:t*, 19 - *nanmdhâit*, *nanmdhe:t*, 20- *nizet*.
- **Fjalë të përbëra janë numërorët:** 30 - *tredhâit*, *tridhe:t*, 40 - *katërdhâit*, *katërdhet*, 50- *pesdhâit*, *pesdhe:t*, 60 - *xhashtdhâit*, *xhashtdhe:t*, 70 - *shtatdhâit*, *shtatdhe:t*, 80 - *tetdhâit*, *tetdhe:t*, 90 - *nandhâit*, *nandhe:t*, 100 - *niçin*, 200 - *diçin*, 300- *treçin*, 400 - *katërçin*, 500 - *pesçin*, 600 - *xhashtëçin*, 700 - *shtatçin* etj.
- **Shprehje janë numërorët:** 21 - *nizet e nja*, 22 - *nizet e di*, 23 - *nizet e tre*, 24 - *nizet e katër*, 25 - *nizet e pe:s*, ..., 29 - *nizet e na:n*; 31 - *tridhâit e nja*, 32 - *tridhâit e di*, 33 - *tridhâit e tre*, 34 - *tridhâit e katër* ...; 41 - *katërdhâit e nja*, 42 - *katërdhâit e di* 49 - *katërdhâit e katër*; 51 - *pesdhâit e nja*, 52 - *pesdhâit e di* ...; 59 - *pesdhâit e na:n*; 61 - *xhashtdhâit e nja*, 62 - *xhashtdhâit e di* ..., 101 - *niçin e nja*, ... , 109 - *niçin e nan*; 299 - *diçin e nandhâit e na:n*; 1000 - *ni mi*, 2000 - *di mi* etj.

2. Numërorët e kësaj të folmeje sipas strukturës fjalëformuese si dhe sipas kategorive morfologjike nuk dallohet nga të folmet e tjera dialektore e as nga shqipja standarde. Dallimet që shfaqen, janë vetëm të natyrës fonetike. Në këtë kuptim, edhe nga numërorët e dhënë mund të nxjerrim disa dukuri fonetike më të shprehura. Po përmendim disa sosh:

a) Numri *njã*, *njo* (një) dallohet në formë nga nyja e trajtës së pashquar, meqë numërori përdoret në formën *njã* ose *njo*; ndërsa nyja e trajtës së pashquar në formën *ni*: *ni nje:r*, *ni dele*, *ni lepër* (një njeri, një dele, një lepur) etj.

b) Numri 10-të si fjalë e parme si dhe numrat e tjerë të prejardhur me dhjetëshe dëgjohen në dy forma fonetike: *dhe:t* dhe *dhâit*. Te forma e parë kemi rënien e [j]-së dhe [ë]-së në fund të fjalës, ndërsa te forma e dytë kemi diftongimin e /i/ > [âi]. Në fonologjinë historike të shqipes është i njohur evoluimi i /-e-/ në /-ie-/ , /-ie-/ , /-ia-/ dhe /-ye-/.²⁸⁵ Forma *dhâit* sipas gjithë gjasash është përfutur nga *dhietë* (dhjetë). Zanozja [e] e patheksuar ka rënë dhe është përfutur forma *dhi:t*, e cila është diftonguar, si edhe /i/-të e tjera të theksuara, duke dhënë formën e sotme *dhâit*.

c) Rënia e rregullt e zanores së patheksuar në fundin absolut të numërorëve, si edhe te të gjitha fjalët e tjera, ka bërë zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse, por edhe mosshqiptimin e [ë]-së në trup të numërorëve, si *pe:s* (< pesë), *shta:t* (< shtatë), *te:t* (< tetë); *nimdhâit* (njëmbëdhjetë), *pesmdhâit* (< pesëmbëdhjetë), *shtatmdhâit* (< shtatëmbëdhjetë) etj.

ç) Dukuri fonetike shumë të shpeshta që vërehen te numërorët janë edhe: zh buzorëzimi i /y/ > /i/: *di* (< dy), *dimdhâit* (< dymbëdhjetë); diftongimi i /i/-së në /âi/: *trâi* (< tri); afrikatizimi i mesgjuhoreve [q, gj] në [ç, xh]: *niçin* (< njëqind), *xha:sht* (< gjashtë); këmbimi i /nj/ > /n/: *ni mi* (< një mijë); qiellzorizimi i [ë]-së në [i]: *ni mi e niçin* (< njëmijë e njëqind); përngjashmimi i

²⁸⁵ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 105.

grupeve [mb] e [nd] në [m] e [n]: *nimdhait, nimdhet* (< njëmbëdhjetë) ...²⁸⁶

3. Numri i përafërt shprehet me përdorimin e fjalës **nja** para të dy numrave: 3-4 - *nja tre-katër*; 10-15 - *nja dhâit-pesmdhâit*; 200-300 - *nja di-tre çin* etj. Ndonjëherë, për të lidhur ndërmjet vete dy numra, ndërfitet *a-ja*, si: 5-6 -*nja pes-a-xhasht*; 7-8 -*nja shtat-a-te:t*; *nja katra-pe:s* etj.

4. Numërorët thyesorë në këtë të folme, si përgjithësisht në të folmet popullore,²⁸⁷ nuk përdoren. Në vend të tyre përdoren vetëm fjalët: *xhims* ose *xhimc* (gjysmë) dhe *çerek* (një e katërta) me të cilat thuhet pjesë e caktuar e një tërësie: *ni xhimc, di xhimca; ni çerek, tre çerek* etj.

5. Numërorët edhe në të folmen tonë mund të emërzohen, si p.sh.: *nja, di, tre* '1, 2, 3' emërzohen me prapashtesën *-sh*: *nish, dish, tresh* etj.

6. Nga numërorët themelorë, siç dihet, formohen mbiemra prejnumërorë, mbiemra marrëdhaniore, sipas tipit: *i pa:r - e pa:r, i di:t - e di:t, i tre:t - e tre:t* ...

7. Mendojmë se do të ishte me interes për lexuesit e vëmendshëm të shënojmë si shprehën folësit e arealit gjuhësor të Karadakut të Shkupit gjatë operacioneve themelore matematikore: mbledhje, zbritje, shumëzim, pjesëtim. P.sh.:

$4 + 5 = 9$	thuhet	: <i>katër edhe pe:s ba:jn na:n.</i>
$12 - 7 = 5$: <i>prej dimdhâitve mi he:k shta:t jesin pe:s.</i>
$5 \times 4 = 20$: <i>pe:s here katër ba:jn nizet.</i>
$32 : 8 = 4$: <i>tridhet e di pjestu: për te:t ba:jn katër.</i>

3.4. PËREMRI

1. Sipas kuptimit që kanë, në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, po edhe në shqipen standarde, dallojmë shtatë lloje përemrash:²⁸⁸

1. përemra vetorë;
2. përemra vetvetorë;
3. përemra dëftorë;
4. përemra pronorë;
5. përemra pyetës;
6. përemra lidhorë dhe
7. përemra të pacaktuar.

3.4.1. PËREMRA VETORË

²⁸⁶ Edhe pse në disa katunde të caktuara grupet [mb] dhe [nd] rëndom ruhen (si në f. Straçincë, në Luboten, pjesërisht edhe në Mojancë dhe Orllancë), te numërorët (veçmas kur janë fjalë të gjata, por gjatë numërimit të shpejtë edhe te numrat e shkurtër) grupet [mb] e [nd] zakonisht reduktohen në [m] e [n].

²⁸⁷ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997, f. 151.

²⁸⁸ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), Tiranë, 1995, f. 219.

2. Përemrat vetorë (në rasën emërore) në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit janë:

	<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>
Veta I:	une	na
Veta II:	tâi, têtî, ti	ju
Veta III:	aj (gj. m.), ajo, aja (gj. f.)	ata, ato

Nëpër fshatrat e kësaj izoglose, dëgjojmë këto forma të përemrave vetorë:

Brezë, Malinë: une, tâi, aj (gj. m.), ajo (gj. f.); na, ju, ata (gj. m.), ato (gj. f.)

Tanushë: une, ti, aj (gj. m.), ajo (gj. f.); na, ju, ata (gj. m.), ato (gj. f.)


Straçincë: une, têtî, aj (gj. m.), aja (gj. f.); na, ju, ata (gj. m.), ato (gj. f.)

Bllacë: une, têtî, aj (gj. m.), aja (gj. f.); na, ju, ata (gj. m.), ata (gj. f.)

Orllancë e Mojançë: une, têtî, aj (gj. m.), ajo (gj. f.); na, ju, ato (gj. m.), ato (gj. f.)

Grushinë: une, têtî, aj (gj. m.), ajo (gj. f.); na, ju, ato (gj. m.), ato (gj. f.)

Luboten: une, tâi, aj (gj. m.), aja (gj. f.); na, ju, ata (gj. m.), ata (gj. f.)



Skica 13. Përemrat vetorë ata/ato në Karadakun e Shkupit

3. Te përemrat vetorë të vetës së tretë, njëjës dhe shumës, si edhe ata të vetës së parë njëjës, mendojmë se duhet ndalur për të dhënë pak shpjegime. Përemrat e vetës së tretë shumës në disa katunde të këtij areali gjuhësor, dallojnë forma të veçanta për gjininë mashkullore dhe

femërore; ndërsa në disa fshatra të tjerë një formë e vetme përdoret për të dy gjinitë. Në këtë kuptim, në të folmet e fshatrave Brezë, Malinë dhe Tanushë dallohen përemrat: **ata** (veta e tretë shumësi për gjininë mashkullore) dhe **ato** (për gjininë femërore); ndërsa në f. Bllacë dhe Luboten dëgjohet vetëm forma **ata** (për të dy gjinitë), ndërsa në f. Orllancë, Mojancë dhe Grushinë **ato** (për të dy gjinitë). Forma dyshe kemi edhe për vetën e tretë njëjës të gjinisë femërore: **ajo**, në f. Tanushë, Mojancë, Orllancë, Brezë, Malinë dhe Grushinë, por **aja** në f. Bllacë, Straçincë dhe Luboten.

4. Përemri vetor i vetës së pare njëjës përdoret në tri variante fonetike: si formë e plotë **une**, ose si e reduktuar në **ū:n**, ndonjëherë edhe vetëm **ū**: P.sh.: *Une jam katuna:r. T'vâish ni dit te ū:n e t'kallxoj për kit pu:n. Për kit pu:n mos hajde ma te ū*.

Lakimi i përemrave vetorë

5. Përemrat vetorë të kësaj të folmeje sipas rasave dalin në disa forma:

N j ë j ë s			
Rasa	Veta I	Veta II	Veta III
E.	ũne, u:n	tâi, têi	aj, aja, ajo
Gj.	-----	-----	i atâi, i atêi+ne, i asaj+ne
Dh.	mu:, m'	tâi, têi t'	atâi, i; atêi i; asaj, i
K.	mu:, m'	tâi, têi t'	a:t, e; ata, e
Rr.	pi -pej mue, meje	pi -pej tâie, têie, teje	pi -pej atâi; asaj

S h u m ë s			
Rasa	Veta I	Veta II	Veta III
E.	na	ju	ata, ato
Gj.	-----	-----	i atâine; i atêine
Dh.	neve, na	juve, ju	atâine, u; atêine, u
K.	neve, na	juve, ju	ata, i; ato, i
Rr.	pi -pej neve, nesh	pi -pej juve, jush	pi -pej atâinve

6. Nga pasqyra e dhënë e lakimit të përemrave vetorë, mund të vijmë në përfundim se e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit s'paraqet ndonjë veçanti. Ajo si mikrosistem gjuhësor është pjesë përbërëse e makrosistemit dialektor, e gegërishtes qendrore.

7. Megjithatë, nëse gjykojmë sipas asaj që paraqitet në këto të folme, mund të nxirren disa veçori më karakteristike, kryesisht të karakterit fonetik.²⁸⁹

²⁸⁹ Te shumica e përemrave vetorë vërejmë ndryshime të caktuara fonetike: a) diftongimin e zanores së theksuar **i**, si: *tâi, têi* (< ti); *atâi, atêi* (< atij); zhburorëzimin e [y] në [i] dhe diftongimin: *tâi, têi* (< ty); *atâine, atêine* (< atyre) etj. b) Shkurtimin e fjalëve, përkatësisht rënien e tingujve: te parafjala e rrjedhore *pi, pej* (< prej). c) Shtimin e tingujve në fund të fjalës, në këtë rast, prapangjithjen e të përemrit vetor + *ne*. Pra, krahas formave *atâi, asaj* në gjinore dhe dhanore të vetës së tretë shumës kemi edhe format paralele: *atâine; i atêine; atâine, u; atêine*; dhe në gjinore veta e tretë njëjës: *i atâine, e asajne*. ç) Rrafshimin (njëjtësimin, unifikimin) e paradigmave të dhanores me të kallëzores për vetën e parë e të dytë të shumësit: dhanore *neve, na* - kallëzore: *neve, na* (< ne, na); *juve, u - juve, u* (< ju, ju).

8. Siç shihet nga lakimi i mësipërm, krahas trajtave të plota, trajta të shkurtra të përemrave kanë vetëm format e kundrinave të zhdrejta (të dhanores) dhe format e kundrinave të drejta (të kallëzores) për të gjitha vetat, njëjës dhe shumës. Ato trajta janë: njëjës, veta I: **m'**; veta II: **t'**; veta III: **i, e**; në shumës: veta I: **na**; veta II: **ju**; veta III: **u, i**;

9. Këto trajta të shkurtra të përemrave, gjatë përdorimit në fjali, meqë shqiptohen të patheksuara (proklitike ose enklitike) shpesh bashkohen, si në shumë të folme popullore dhe në gjuhën standarde shqipe. Për të fituar një pasqyrë më të qartë të tyre, do të paraqesim bashkimet e tyre:

Dhanorja e tri vetave njëjës e shumës + kallëzorja e vetës së tretë njëjës		
	në Karadak	në formën standarde
1. m' + e = ma	<i>Ma kallxoj t'dre:tën.</i>	Ma tregoi të drejtën.
2. t' + e = ta	<i>Ta dhash kacâiën.</i>	Ta dhashë lopatën.
3. i + e = ja	<i>Ja dhash do pare.</i>	Ia dhashë disa para.
1. na + e = naj	<i>Naj dha besën.</i>	Na i dha besën.
2. ju + e = jav	<i>Jav thash ner sâi.</i>	Ua thashë ndër (në) sy.
3. u + e = va	<i>Va laroj arën.</i>	Ua lëvroi arën.
Dhanorja e tri vetave njëjës e shumës + kallëzorja e vetës së tretë shumës		
1. m' + i = m'i	<i>M'i prev dru:t.</i>	M'i preu drutë.
2. t' + i = t'i	<i>T'i kallxojsh atâi.</i>	T'i tregosh atij.
3. i + i = ja	<i>Ja kish shâit lopën.</i>	Ia kishte shitur lopën.
1. na + i = naj	<i>Naj qethi dhent.</i>	Na i qethi dhentë.
2. ju + i = jav	<i>Jav di:n hallet.</i>	Ua dinë hallet.
3. u + i = va	<i>Aj va ep kolt.</i>	Ai ua jep kuajt.

Shënim: Te trajtat e shkurtra të përemrave, në dallim nga format e shqipes standarde, vërehet se zanoret e patheksuara [i] dhe [u] shndërrohen në [j], përkatësisht në [v]: *ja* (< ia), *naj* (< na i), *va* (< ua). Forma *naj* (< na e) si duket është formuar me analogji të *na + i = naj*. Te forma *jav* (< jua = ju + i si dhe ju + i) kemi metatezë (inversion) të [u]-së me [a]-në, të shoqëruar me konsonantizmin e shndërrimin e [u] > [v].

10. Trajtat e shkurtra të përemrave vetorë, të pabashkuara apo të bashkuara, kanë përdorim të dendur. Ato, detyrimisht përdoren në funksionin e kundrinës së zhdrejtë para foljes-kallëzues, si: *I thash ni shoqit. I thash shoqit.* Rimarrje (përsëritje) të kundrinës në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën maqedonase, kemi në rastet kur emri në funksion të kundrinës së drejtë është në trajtë të shquar. P.sh.: *E ngarkova kalin. E pa:sh dajën* etj.

11. Trajtat e shkurtra **m', i, e** si edhe format e bashkuara **ma, m'i, ja, naj, jav** dhe **va** përdoren si fjalë enklitike pas foljeve të mënyrës urdhërore, duke krijuar në këtë mënyrë një formë të përngjitur, fonetikusht kemi vetëm një fjalë të vetme, duke u shqiptuar vetëm me në theks kryesor (një theks të vetëm, një tërësi e vetme theksore). P.sh.: *Kallxóm!* (*M' kallxó!*), *Béri!* (*Mos i ber!*), *Dáje!* (*Mos e dáj!*), *Fálma!*, *Ma ép!* (*Mos ma ép!*), *Shkrâumi!* (*Mos m'i shkrâuj!*); *Çoja!* (*Mos ja ço!*), *Bernaj!* (*Mos naj ber!*), *Mshójav!* (*Mos jav mshó!*), *Lípva!* (*Mos va líp!*) etj.

3.4.2. PËREMRRAT VETVETORË

12. Përemra vetvetorë janë një numër i vogël i fjalësh (3-4 fjalë) që tregojnë veta të cilët e kryejnë veprimin dhe po i njëjti veprim bie mbi ta. Të tilla në të folmen tone janë **vetja** dhe **vetvetja**. P.sh.: *Vetja ja ka ba;*; ose: *Vetvetja ja ka ba.*

13. Përemrat vetvetorë kanë kuptime mbiemërore dhe strukturë emërore.²⁹⁰ Përdoren me dhe pa parafjalë, si: *I dhimet shâum vetja*. Përemri vetvetor mund të përdoret edhe në funksionin e çdo përemri vetor.

Shënim: Përemrat vetvetorë *vetja* dhe *vetvetja* janë të barasvlershëm (ekuivalentë). Këta përemra lakohen nëpër rasi si emrat e trajtës së shquar të gjinisë femërore: E. *vetja* (vetvetja); Gj. *i vetës* (*i vetvetës*); Dh. *vetës* (*vetvetës*); K. *vetën* (*vetvetën*); Rr. *pej vetës* (*vetvetës*).

3.4.3. PËREMRRAT DËFTORË

Të rikujtojmë se përemri dëftor shërben për të treguar frymorë ose sende që ndodhen afër ose larg folësit. Ata përdoren bashkë me emrin ose e zëvendësojnë atë.

14. Përemrat dëftorë në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit janë: **ki**, **kjo**, **kja** (*kija* Straçincë) ose **çiki**, **çikjo** (*çekjo*), **çikja**,²⁹¹ forma që shërbejnë për të treguar veta ose sende që ndodhen afër nesh (folësit): **aj**, **aja**, **ajo**; **ata**, **ato** ose **çaj**, **çaja**, **çajo**; **çata**, **çato** për të treguar veta ose sende që ndodhen larg folësit.

15. Fjalët **aj**, **aja**, **ajo**; **ata**, **ato** në të folmen tonë, përveç që përdoren si përemra dëftorë (si në mbarë shqipen), përdoren edhe si përemra vetorë. Megjithatë, jemi të mendimit se në këtë të folme, përemrat dëftorë më shumë përdoren në formë aglutinative (të përngjitur): **çaj** (çe+aj), **çaja** (çe+aja), **çajo** (çe+ajo); **çata** (çe+ata), **çato** (çe+ato), sesa pa pjesëzën dëftore **çe** (< qe, ja) + përemër, përkatësisht në trajtë të njëjtë me përemrat vetorë. D.m.th. në të folmen tonë, marrë në përgjithësi, ka dallim formal ndërmjet përemrave vetorë dhe përemrave dëftorë. Në të vërtetë, të folmet e gegërishtes qendrore me këto trajta të përngjitura (të përbëra, të bashkuara) të përemrave dëftorë, dallohen nga gjuha standarde shqipe dhe nga të gjitha të folmet e tjera. Me këto trajta të përngjitura të përemrave dëftorë (me pjesëzën çe + përemër dëftor: çe+ki, çe+kjo, ...) krijohet një formë që tregon në mënyrë më të saktë, më konkretisht, më bindshëm veta ose sende.²⁹² P.sh.: krahaso fjalinë: *Ki është gjali jem.* me fjalinë: *Çiki është gjali jem.* (në shqipen standarde: Ky është djali im. Ja ky është djali im).

16. Përemrat dëftorë ndryshojnë sipas gjinisë, numrit dhe rasës. Do ta paraqesim lakimin e përemrave: **ki** (**çiki**), **kjo** (**çikjo**):

njëjës		
	gjinia mashkullore	gjinia femërore
E.	ki - çiki	kjo, kja - çikjo, çekja

²⁹⁰ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), Tiranë, 1995, f. 219.

²⁹¹ Te trajta e përngjitur e përemrave dëftorë *çiki*, *çikjo*, *çikja* mendojmë se kemi të bëjmë me një shqiptim më të mbyllur të /e/-së, përkatësisht [e]-ja është shndërruar në [i] për shkak të ndikimit prapavajtes të bashkëtingëllores prapagjuhore /k/.

²⁹² Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1975, f. 130.

Gj.	i ktâi - i çiktâi (+ne)	i ksaj - i çiksaj, çeksaj (+ne)
Dh.	ktâi – çiktâi, çektâi (+ne)	ksaj - çiksaj, çeksaj (+ne)
K.	ket - çeket, çiket	ket - çiket, çeket
Rr.	pi ktâi - çektâi, çiktâi (+ne)	pi ksaj - pi çiksaj (+ne)

<i>shumës</i>		
	<i>gjinia mashkullore</i>	<i>gjinia femërore</i>
E.	kta - çikta	kto, kta - çikto, çikta
Gj.	i ktâinve - i çiktâinve	i ktâinve - i çiktâinve
Dh.	ktâinve – çiktâinve, çektâinve	ktâinve – çiktâinve, çektâinve
K.	kta - çikta	kto, kta - çikto, çikta
Rr.	pi ktâinve - pi ç(e)ktâinve	pi ktâinve - pi ç(e)ktâinve

17. Përemrat dëftorë (që janë të shumtë në gjuhën standarde shqipe) të tipit: *i këtillë - e këtillë, i atillë - e atillë, i tillë - e tillë, të tillë - të tilla* nuk përdoren. Megjithatë, ekuivalente me ato që përmendëm më lart, në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit janë përemrat dëftorë **ksi, çisi; asi, çasi**. Këta përemra dëftorë kanë vetëm një trajtë, për të dy gjinitë, njëjës dhe shumës. P.sh.: *Ksi (çisi) burri nuk ka kurkun. Ksi (çisi) gruje nuk ka kurkun. Ksi (çisi) burrash nuk ka kurkun. Ksi (çisi) grash nuk ka kurkun. Asi (çasi) burri ..., Asi (çasi) burrash. Asi (çasi) gruje ... Asi (çasi) grash ...* etj.

3.4.4. PËREMRRAT PRONORË

Në të folmen tonë përkatësia tregohet si në mbarë shqipen: *shati jem, kacâia jeme; kali jot, lopa jote; shati jo:n, kacâia jo:n; kali juv; lopa juve* etj.

18. Dihet që përemrat pronorë janë të afërt me përemrat vetorë, por midis tyre ka dallime strukturore dhe sematike (kuptimore): përemrat pronorë nuk tregojnë veta, por përkatësi të diçkaje që zotëron dikush.²⁹³

19. Përemrat pronorë në të folmen tonë, qëndrojnë vetëm pas emrit,²⁹⁴ asnjëherë para tij.

20. Përemrat pronorë mund të përdoren edhe me vete, d.m.th., kur përemri shndërrohet në emër, emërzohet. Por, në dallim nga mbiemri, përemri i emërzuar çdoherë është i kushtëzuar nga konteksti. D.m.th., kur një gjë e tillë përmendet për herë të parë, atëherë duhet të përdoret togfjalëshi emër + përemër pronor, ndërsa më pas në kontekst mund të përdoret përemri pronor i emërzuar, si: *Lopa jeme asht ma e mâir se lopa jote* (ose *e jotja*). për shkak se emri: *lo:p* kuptohet nga konteksti. *E jemja i çet 10 kille tamël, a e jotja 5 kille*.

21. Në përgjithësi, si në gjithë shqipen, fjala e njëjtë në funksionin e një përemri pronor është në trajtë të pashquar, ndërsa në funksionin e emrit del në trajtë të shquar. P.sh.: *gjali jem = i jemi, motra jeme = e jemja; gjemt e mai = t'mâit, motrat e mâia = t'mâiat; gjemt e ton = tont, motrat e tona = tonat; gjemt e tuj = tujt, motrat e tuja = tujat* etj.

²⁹³ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), ... f. 232-233.

²⁹⁴ Në toskërishte si edhe në shqipen standarde përemrat pronorë të vetës I dhe II njëjës përdoren para emrave të farefisnisë, si: *im vëlla, im atë, ime motër, yt vëlla ...*

22. Për dialektologjinë shqiptare, interes të veçantë paraqet përdorimi nyjës e në të gjitha fshatrat e këtij areali gjuhësor, kryesisht kur togfjalëshat e tillë paraqiten të veçantë (veç nga fjalja), si: *puna e jote, motra e jeme, motra e jo:n, motra e juve, motra e atâine; gjemt e mâi, motrat e mâia, gjemt e ta:, gjemt e tuj, motrat e tuja, motrat e tava, gjemt e atâi, motrat e ataj, gjemt e ton, motrat e tona, gjemt e ju:v, motrat e juve, gjemt e atâi, motrat e atâi* etj.

23. Nga ana strukturore, trajtat e përemrave pronorë, në rrafshin dialektor s'kanë ndonjë dallim thelbësor. Megjithatë, edhe te ky lloj i përemrave vërehen varietete, si dhe mbulim të njërit me tjetrin, përkime e rrafshime sipas analogjisë të një trajte me tjetrën, përkatësisht sinkretizmin e trajtave.²⁹⁵

24. Te përemrat pronorë të së folmes sonë, dallojmë këto kategori gramatikore: tre veta, dy gjini, dy numra dhe lakim sipas rasave të shqipes. Andaj, kemi: a) përemra pronorë që tregojnë pronë të një vete (veta I, II, III njëjës), dhe b) që tregojnë pronë të më shumë vetave (veta I, II, III shumës). D.m.th., ka forma të veçanta kur pronari është në njëjës ose shumës, për gjininë mashkullore dhe për femëroren (gjinia e përemrit varet nga emri që varet).²⁹⁶

25. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, trajtat e përemrave pronorë në emërore janë:

<i>prona në njëjës</i>			
<i>pronari në njëjës</i>		<i>pronari në shumës</i>	
<i>emër i gjinisë mashkullore</i>	<i>emër i gjinisë femërore</i>	<i>emër i gjinisë mashkullore</i>	<i>emër i gjinisë femërore</i>
gjali (i) jem	motra (e) jeme	gjali (i) jo:n	motra (e) jo:n
- it, jot	- jote	- juv, juve	- juv, juve
- atâi, atij	- atâi (ne), atij	- atâine, atine	- atâine, atine
- asaj (na)	- asaj (ne)	- atâinve, atine	- atâinve, atine

<i>prona në shumës</i>			
<i>pronari në njëjës</i>		<i>pronari në shumës</i>	
<i>emër i gjinisë mashkullore</i>	<i>emër i gjinisë femërore</i>	<i>emër i gjinisë mashkullore</i>	<i>emër i gjinisë femërore</i>
gjemt e mi, mâi	motrat e mia, mâia	gjemt e ta:n, to:n	motrat e tona
- tu, tuj,	tua, tuja, tôuja	- tuj, juv	- juve
- atai, atij	- atâi (ne), atij	- atâine, atine	- atâine, atine
- asaj (na)	- asaj (ne)	- atâinve, atine	- atâinve, atine

26. Përemrat pronorë në shqipen standarde kanë edhe kategorinë gramatikore të lakimit. Në të folmen tonë, në të vërtetë, pesë trajtat e lakimit janë sintetizuar në dy forma të njëjta: njëra për emëroren (shih tabelën paraprake) dhe tjetra për katër rasat e tjera (gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore). Përveç kësaj, shumë shpesh në këtë të folme përdoret një trajtë për të gjitha rasat:

Veta I

²⁹⁵ Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1975, f. 131.

²⁹⁶ Disa përemra në numrin shumës kanë formë të njëjtë për të dy numrat.

gjinia mashkullore

E.	jem, jo:n, ta:n
Gj.	tem, to:n, ta:n
Dh.	tem, to:n, ta:n
K.	tem, to:n, ta:n
Rr.	tem, to:n, ta:n

gjinia femërore

jeme, jo:n, tona
teme, to:n, tona
teme, to:n, tona
teme, to:n, tona
teme, to:n, tona

27. **Lakimi i gjymtë** (lakim i pjesshëm, jo i plotë). – Përemrat pronorë në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit mund të themi se nuk ndryshojnë nëpër rasi, por pësojnë një “lakim të gjymtë” (defektiva casibus, pronomina indeklinabilia),²⁹⁷ ose thënë më mirë, në këtë rast ndryshon emri që gjendet para pronorit, ndërsa pronori i përshtatet (duke ndryshuar nyjën e përparme) rasës së emrit dhe e cila del në dy forma, ndonjëherë vetëm në një formë të vetme, sipas tipit:

- E. *dashi jot, delja jote, desht e mâi, dhent e mâia, kali ju:v*
Gj. *i dashit ta:n, i deles tane, i deshve t'mâi, i dhenve t'mâia, i kalit t'ju:v*
Dh. *dashit ta:n, deles tane, deshve t'mâi, dhenve t'mâia, kalit t'ju:v*
K. *dashin ta:n, delen tane, desht e mâi, dhent e mâia, kalin e ju:v*
Rr. *pi dashit ta:n, pi deles tane, pi deshve t'mâi, pi dhenve t'mâia, pi kalit t'ju:v*

3.4.5. PËREMRRAT PYETËS

28. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, përemrat pyetës janë: **kush?**, **calli?**, **câilli?**, si edhe format e monoftonguara ose të diftonguara të tyre: **callët?**, **câillët?** (për gjininë mashkullore); **calla?**, **câilla?**; **callat**, **câillat** (për gjininë femërore); **shka?**, **xhit?** ‘çka?’ dhe **sa?**.

29. Përemri **kush** përdoret kur pyesim për njerëz. Ka vetëm një formë të vetme, si: *Kush asht?*. *Te kush po shkon?*. *Kush jan ata xhin?*. *Kush erdh?*. *Kush erdhën?* etj. Megjithatë, ky përemër ndryshon nëpër rasi, si: E. *kush?*, Gj. *i kuj?*, Dh. *kuj?*, K. *ka:?* dhe Rr. *pi (pej) kuj?*. Ky përemër përdoret edhe si përemër i pacaktuar: *Kush punon, ka:.*

30. Përemri pyetës **calli** (< cili) ka kategoritë gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës. Përdoret për të pyetur për njerëz dhe qenie të tjera si edhe për sende. Pas këtij përemri, gjatë formimit të fjalive pyetëse, në dallim nga përemri pyetës **kush**, mund të përdoret emri, d.m.th., mund të përdoret i shoqëruar me një emër. P.sh.: *Calli asht ki?* *Calli gja:l asht ki?* *Kush asht ki?* *Kush gja:l asht ki?*

31. Te të gjitha format e këtij përemri (**calli?**, **calla?**, **câilli?**, **câilla?**; **câillët?**, **câillat?**, **callët?**, **callat?**) në krahasim me format normative të shqipes, vërejmë tri ndryshime fonetike: velarizimin e [l] > [ll], diftongimin e /i/ > [âi], e në disa raste edhe monoftogimin e dyzëshit [âi] > [a:]. Pra, kemi:

²⁹⁷ Fatmir Agalliu, *A ka lakim të gjymtë dhe emra të palakueshëm në gjuhën shqipe?*, Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1988, f. 109.

- a) për gjininë mashkullore, njëjës: *calli* < *câilli* < cili;
 b) për gjininë femërore, njëjës: *calla* < *câilla* < cila;
 c) për gjininë mashkullore, shumës: *callët* < *câillët* < cilët;
 ç) për gjininë femërore, shumës: *callat* < *câillat* < cilat.

99. Në vijim po japim paradigmen e lakimit të përemrave pyetës **calli?** dhe **calla?**:

rasa	gjinia mashkullore		gjinia femërore	
	<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>	<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>
E.	calli	callët	calla	callat
Gj.	i callit	i callve	i callës	i callave
Dh.	callit	callve	callës	callave
K.	callin	ca:llt	callën	callat
Rr.	pi callit	pi callve	pi callës	pi callave

32. Në formë të pandryshueshme përdoren përemrat pyetës *shka?* dhe *xhit?*, me kuptim të njëjtë me përemrat *ç'* ose *çfarë* në shqipen standarde. P.sh.: *Shka po punon?* - *Xhit po punon?* *Shka bon?* - *Xhit bon?* *Shka thu?* - *Xhit thau?* etj. Këta përemra pyetës të kësaj të folmeje janë të barasvlershëm edhe me përemrin *se* + një parafjalë, si: *me se, për se, nga se.*²⁹⁸ P.sh.: *Nuk e marr vesh për shka m'fol?* - *Nuk e marr vesh për xhit m'folën?*; në shqipen standarde: *Nuk e marr vesh për se më flet?* *Me shka erdhe?* - *Me xhit erdhe?*, në shqipen standarde: *Me se erdhe?* etj.

3.4.6. PËREMRRAT LIDHORË

33. Në dallim nga shqipja standarde, ku përdoren disa përemra lidhorë (që, i cili, çka, kush, çfarë, sa), të cilët në periudhë kanë funksion sintaksor të lidhjes së një fjalisë përcaktore me një fjali tjetër, ose me një fjalë në fjalinë tjetër, në këtë të folme, tipik është përemri lidhor *çi* (< q'i < që), me shqiptim më të përpamë të të dy tingujve (përkatësisht qiellzorizimin e [ë] > [i] dhe afrikatizimin e [q] > [ç]). Ky përemër ka trajtë të pandryshueshme (formë të ngurtë) dhe s'ka kategori gramatikore. P.sh.: *E pa:sh mcâusin ç'i m'ka mcâu. Shâum xhin ka ç'i bojn keç. Aj ç'i ban mâir, xhan mâir. Kum ardh për at pun ç'i t'thash. Ni uj ç'i hec, pâiet* etj.

34. Funksionin e përemrit lidhor *çi* (por edhe të përemrave të pacaktuar), ndonjëherë e kryejnë përemrat pyetës: *kush?*, *shka?* dhe *calli?*, *calla?* (vetëm në f. Luboten dhe Straçincë), si: *Aj ç'i fol shâum, gabon.* - *Aj shka fol sha:m, gabon.* - *Kush fol shâum, gabon.* - *Calli fol shâum, gabon.* *Aj ç'i punon, ka.* - *Aj shka punon, ka.* - *Kush punon, ka.* *Calli punon, ka.* *Calla punon, ka.*

3.4.7. PËREMRRAT E PACAKTUAR

35. Dihet se përemrat e pacaktuar janë fjalë që tregojnë frymorë ose sende në mënyrë të

²⁹⁸ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), Tiranë, 1995, f. 245.

pacaktuar. Të tillë në këtë folma janë: *kush, dikush, ndokush, nakush, çetërkush, shamkush; krejt, do, donja, donjani, donjana; dika;*, *kërka; callido, callado, kurcalli, kurcalla, kurkush, kurxha;; ni, asni, kurrni; dishka*. Një përemër të pacaktuar, karakteristik, që rrallë se mund ta dëgjosh në ndonjë të folme tjetër e kemi në katundet Brezë e Malinë: ***dixhit*** (diçka, diç + xhit < diçka).

36. Një numër i madh i përemrave të pacaktuar të të folmes sonë përdoren edhe në shqipen standarde, por është e kuptueshme, jo në variante fonetike të të folmes së Karadakut të Shkupit.

3.5. FOLJA

1. Sistemi i foljes në gjuhën shqipe ka ruajtur shumë veçori arkaike indoevropiane të trashëguara nga periudha e hershme. Të tilla janë si për shembull, supletivizmi, apofonia, aoristi sigmatik, kategoritë gramatike të vetës, mënyrës, kohës etj.²⁹⁹ Megjithatë, me kalimin e kohës janë krijuar edhe ngjashmëri të përbashkëta me gjuhët e tjera ballkanike,³⁰⁰ por janë zhvilluar edhe dukuri të veçanta, siç janë habitorja dhe dëshirorja.³⁰¹

2. Edhe në fushën e sistemit foljor hetohen dallime të caktuara në shtrirjen territoriale të gjuhës shqipe. Dallimi ka të bëjë me format e ndryshme fonetike për të njëjtat mënyra etj.,³⁰² me praninë ~ mungesën e një forme foljore dhe zëvendësimit të saj me formë tjetër; si edhe me dendurinë dhe përndarjen (frekuencën dhe distribuimin) e tyre.

3. Në gjuhën standarde janë kodifikuar trajtat e foljeve, por në përdorimin e përditshëm ruhet ende një laramani e madhe e trajtave dialektore. Të tilla janë paskajorja e gegërishtes (me + pjesorja e shkurtuar: *me punue*), e barasvlershme në toskërishte paskajorja *për të punuar* ose lidhorja *të punoj*; e pakryera asigmatike e mënyrës dëftore në diatezën veprorë në toskërishte *punoja* dhe sigmatike në gegërishte *punojsha*, forma sintetike joveprorë e toskërishtes *lahesha* dhe *u lajsha / u lajshna* në të folmet gege; ekzistimi i trajtave të dyta të mbipërbëra për kohën e shkuar në dialektin Verior (*kam pas punu.*; *kisha pas punu*, *pata pas punu.*), si dhe shumë forma të tjera foljore.

4. Përkundër këtyre dallimeve të krijuara në rrjedhë të kohës, mikro e makrosistemet dialektore në pikëpamje strukturore në sistemin foljor kanë bazë të gjerë të përbashkët.³⁰³

5. Përshkrimi i sistemit foljor përbën një nga detyrat më të vështira për gramatikën e shqipes, pasi folja, pas emrit,³⁰⁴ është një nga klasat më të mëdha të fjalëve në leksikun e saj. Veç kësaj, me 251 format paradigmatishtë, folja nuk mund të krahasohet jo vetëm me asnjë pjesë vjetër të ndryshueshme të ligjëratës të shqipes, po as me foljen e mjaft gjuhëve të tjera me eptim shumë të zhvilluar.³⁰⁵

6. **Kategoritë gramatike të foljes.** – Në gjuhën shqipe, siç dihet,³⁰⁶ folja ka këto kategori gramatike: mënyrën, kohën, numrin, vetën dhe diatezën. Edhe në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, folja ka të gjitha këto kategori gramatike.

7. **Mënyrat e foljes.** – Duke nisur nga vlerësimi subjektiv, me mënyrën e foljeve shprehet marrëdhënia jonë ndaj veprimit që shpreh folja në fjali. Gjuha shqipe në përgjithësi është e pasur me mënyra të foljes.

Në të folmen tonë janë të pranishme pesë forma të ndryshueshme të foljes:³⁰⁷

1. *mënyra dëftore*;

²⁹⁹ Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I dhe II), Prishtinë, 1980, f. 192.

³⁰⁰ Shaban Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, f. 119-136.

³⁰¹ Prof. Shaban Demiraj, vepër e cituar, f. 192.

³⁰² Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1988, f. 78.

³⁰⁴ Emri në shqipen shfaqet në 8 forma paradigmatishtë: libër, libri, librit, librin, libra, librat, librash, librave.

³⁰⁵ Rami Memushaj, *Studime gjuhësore*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2017, f. 47.

³⁰⁶ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), Tiranë, 1995, f. 267-276.

³⁰⁷ Në shqipen standarde folja ka gjashtë mënyra të ndryshueshme (të shtjelluara): dëftore, lidhore, kushtore, habitore, dëshirore, urdhërore dhe tri mënyra të pandryshueshme (të pashtjelluara): pjesore, paskajore dhe përcjellore.

2. *mënyra lidhore;*
3. *mënyra urdhërore;*
4. *mënyra dëshirore* dhe
5. *mënyra habitore.*

Shënim: Në gjuhën standarde shqipe kemi edhe *mënyrën kushtore* (potencial, kondicional). Megjithatë, në të folmen tonë kjo mënyrë foljore nuk dëgjohet.

8. Përveç mënyrave të shtjelluara, në shqipen, përfshirë edhe arealin gjuhësor të Karadakut, përdoren edhe tri forma të pashtjelluara, të cilat nuk kanë as kohë, as vetë, as numër:

1. *pjesorja;*
2. *paskajorja* dhe
3. *përcjellorja.*

9. Në të folmen e Karadakut të Shkupit për kohën e tashme dhe për të ardhmen dëgjuam këto kohë të foljeve:

1. **koha e tashme;**
2. **E shkuara** ka këto nënkohë:
 - a) e pakryera (imperfekti),
 - b) e kryera e thjeshtë (aoristi),
 - c) e kryera (perfekti),
 - ç) më se e kryera (pluskuamperfekti) dhe
 - d) e kryera e tejshkuar (pluskuamperfekti II).
3. **E ardhmja** ka dy forma:
 - a) kohën e ardhme (futurin),
 - b) kohën e ardhme të dytë (futurin e dytë).

10. Mbështetur në materialin e vjelë dialektor, në të folmen e Malit të Zi të Shkupit foljet klasifikohen në tri zgjedhime:

a) Në *zgjedhimin e parë* bëjnë pjesë foljet që në trajtën përfaqësuese mbarojnë me temë në zanore ose në diftong, ndërsa në vetën e parë të kohës së tashme të mënyrës dëftore marrin mbaresën **-j**. Në këtë grup hyjnë pjesa më e madhe e foljeve, sipas tipit: *la-j*, *puno-j*, *laro-j* ‘lëvroj’, *mco-j* ‘mësoj’, *shko-j*, *garko-j* ‘ngarkoj’, *kallxo-j*, *kno-j* ‘këndo’, *msho-j* ‘mëshoj, i bie (diçkaje)’...

Me qenë se në këtë të folme togjet e zanoreve, në përgjithësi, janë monoftonguar, nuk ka folje që mbaron me grup zanoresh, në dallim nga shqipja standarde dhe jo pak të folme të tjera. Krahaso: *shkra:-j* (< shkruaj, shkruaj), *li:-j* (< lyej), *blu:-j* (< bluej, bluaj), *zi:-j* (< ziej), *gju:-j* (< gjuaj, gjuaj) etj. Por, për shkak të risisë fonetike të diftongimit të zanoreve të mbyllura të theksuara, në këtë grup bëjnë pjesë edhe foljet, tema e të cilave mbaron me diftongun *âi* ose *âu*, si *frâi* (< frij, fryj, fryej), *fshâi* (< fshij), *shkrâu-j* (< shkruaj, shkruaj) etj. Foljet me /i/ të diftonguar fundore, të tipit *frâi*, *fshâi* në vetën e parë nuk marrin **-j**-në si mbaresë, meqë [i]-ja e diftongut nyjëtohet ngjashëm me [j]-në, dhe diftongu *âi* shqiptohet si *aj*.

b) *Zgjedhimi i dytë* përfshin foljet që në trajtën përfaqësuese mbarojnë me temë në bashkëtingëllore. Të tilla janë foljet: *dal*, *ha:p*, *hip*, *zdrip* ‘zbret’, *marr*, *nxerr* ‘nxjerr’, *qerr* ‘tjerr’, *shes*, *pres*, *ves*, *ik*, *gjeg* ‘djeg’, *pek* ‘pjek’, *hek* ‘heq’, *fug* ‘hedh’ etj.

c) **Zgjedhimin e tretë** e përbëjnë foljet e parregullta, të cilat mund të jenë me forma supletive dhe josupletive, si foljet ndihmëse *kam* (pata) dhe *jam* (kesh, ishna); si dhe disa folje të tjera të tipit: *bi - pruna – prâu, jap - dhash, rrâi - nejta, vâi - erdha, a:rdh* etj.³⁰⁸

MËNYRAT E SHTJELLUARA TË FOLJES

11. Kuptimi i asaj që shprehet nga folja mund të paraqitet prej folësit në mënyra të ndryshme. Trajtat e ndryshme që merr folja për të shprehur kuptimin e saj quhen mënyra. Në gjuhën shqipe folja ka gjashtë mënyra të ndryshueshme (të shtjelluara): dëftore, lidhore, kushtore, habitore, dëshirore, urdhërore dhe tri mënyra të pandryshueshme (të pashtjelluara): pjesore, paskajore dhe përcjellore.

Në vijim do të përpiqemi të përshkruajmë sistemin foljor të të folmes shqipe të Karadakut të Shkupit.

3.5.1. MËNYRA DËFTORE

12. **Koha e tashme** (prezenti) ka vetëm një formë. Forma e kohës së tashme formohet duke shtuar temës së foljes mbaresat vetore. Për të pasur një pasqyrë të qartë të mbaresave vetore të foljeve të kohës së tashme do të japim paradigmen e foljeve për tri zgjedhimet, në formën veprorë dhe joveprorë:

zgjedhimi I				
veta	forma veprorë		forma joveprorë	
une	la- j	li- j	la-h- na (- ëm)	li-h- na (- ëm)
tâi (tëi)	la- n	li- n	la-h- ësh	li-h- ësh
aj (ajo, aja)	la- n	li- n	la-h- ët	li-h- ët
na	la- jm (- jna)	li- jm (- jna)	la-h- mi	li-h- mi
ju	la- ni (- jni)	li- ni (- jni)	la-h- ni	li-h- ni
ata (ato)	la- jn	li- jn	la-h- ën	li-h- ën

Shënim: Në vetën e parë dhe të dytë shumës në formën veprorë kemi dy mbaresa paralele: **-jm** dhe **-jna**; **-ni** dhe **-jni**. Në zgjedhimin joveprorë në vetën e parë njëjës në këtë të folme më shpesh përdoret mbaresa **-na**, por ndonjëherë dëgjohet edhe mbaresa e vjetër **-ëm**.³⁰⁹

³⁰⁸ Në shqipen standarde a) në zgjedhimin e parë përfshihen foljet me temë në zanore dhe që në trajtën përfaqësuese marrin mbaresën -j (puno-j); b) në zgjedhimin e dytë – foljet me bashkëtingëllore (hap, mat, vendos); c) në zgjedhimin e tretë foljet që dalin me zanore dhe nuk marrin asnjë mbaresë në numrin njëjës (vë, zë, shpie) dhe ç) në një zgjedhim më vete foljet e parregullta (jap, bie, ha, jam, kam etj.). Meqë në të folmen tonë zakonisht foljet njërrrokëshe në analogji me foljet e zgjedhimit të parë në vetën e dytë e të tretë njëjës marrin po ato mbaresë (une di, tâi din, aj din), ose veta e parë dallon nga dy vetat e tjera (une zâ:, tâi ze:, aj ze::; une flej, tâi flen, aj flen) apo për folje të tjera kemi edhe raste të veçanta.

³⁰⁹ Shaban Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1968, f. 659.

Siç është vërejtur edhe në të folme të caktuara dhe shpjeguar e pranuar nga studiues të tjerë,³¹⁰ sipas gjithë gjasash forma e sotme e vetës së parë shumë **lajna** është përftuar me përngjitjen (siç e quajnë disa gjuhëtarë kontaminim) e formës foljore **lajm** me përemrin vetor **na**, në rrugën e zhvillimit fonetik të lehtësimit të shqiptimit me përngjashmimin e grupit [mn] > [nn] > [n]: lajm + na > lajmna > lajnna > **lajna**; *shkojna, msojna, lijna, punojna, larojna, bojna...*

zgjedhimi II				
veta	forma veprore		forma joveprore	
une	hap- i	dal	hap- na	lidh- na
tâi (têi)	hap	del	hap- ësh	lidh- ësh
aj (ajo, aja)	hap	del	hap- ët	lidh- ët
na	hap- im	dal- im (- ëm)	hap- mi	lidh- mi
ju	hap- ni	dil- ni	hap- ni	lidh- ni
ata (ato)	hap- in	dal- in	hap- ën	lidh- ën

zgjedhimi III			
veta	forma veprore		forma joveprore
une	za:	fje	zi-h- na
tâi (têi)	ze	fje	zi-h- ësh
aj (ajo, aja)	ze	fje	zi-h- ët
na	za:- m	fje- m	zi-h- mi
ju	zi- ni	fi- ni	zi-h- ni
ata (ato)	za:- n	fje:- n	zi-h- ën

13. Foljet ndihmëse **jam** dhe **kam** në kohën e tashme përdoren në disa forma fonetike e morfologjike. Ja paradigma e zgjedhimit të foljeve **jam** dhe **kam** në kohën e tashme në arealin gjuhësor të Karadakut të Shkupit:

koha e tashme		
veta	jam	kam
une	jam	kam, kom
tâi (têi)	je, ije	kie, ki
aj (ajo, aja)	ãsht, ã:	ka
na	imi, jemi, jena, ena	kimi, kena
ju	ini, jeni	kini
ata (ato)	ja:n	ka:n

14. **Forma sintetike dhe analitike e kohës së tashme.** – Siç dihet, për nga struktura, në shqipen dhe në gjuhë të tjera, kohët e foljes janë të thjeshta (sintetike) dhe të përbëra (analitike). Fjalëformat e thjeshta të foljeve formohen kryesisht me mbaresa që i shtohen foljes, ndërsa kohët

³¹⁰ Latif Mulaku - Mehdi Bardhi, *Mbi të folmen shqipe të Peshterit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 312; Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 289; Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997, f. 161.

e përbëra formohen me foljen ndihmëse *kam* ose *jam* dhe pjesoren e foljes.

15. Vlen të përmendet fakti se koha e tashme në të folmen e shqiptarëve Karadakut të Shkupit përdoret pa pjesëzën **po** ose me të: **punoj** dhe **po punoj**. Përdorimi i së tashmes dhe i së pakryerës pa ose me pjesëzën *po* ka përhapje në mbarë shqipen dialektore dhe është normuar edhe në shqipen standarde. Zakonisht, kur folja përdoret me pjesëzën **po** dëshmohet se puna apo veprimi kryhet para syve tanë, në çastin kur flasim. Me thënien: *Nora punon në kopsht*, veprimi nuk përcaktohet saktësisht, meqë puna e Norës mund të ndodhë kur flasim, veprimi mund të përsëritet etj. Thjesht, kështu vetëm pohojmë një të vërtetë që bashkëbiseduesit i lihet mundësia ai vetë ta kuptojë si të dojë, në disa nuanca kuptimore. Por, kur themi: *Nora po punon në kopsht*, atëherë plotësisht bëhet e qartë se në momentin kur po flasim, Nora është duke punuar në kopsht, edhe pse ndoshta kurrë nuk ka punuar më parë në kopsht e as që do të punojë më.

16. Në këtë mënyrë shqipja ka krijuar dy forma për të njëjtën kohë: një formë sintetike (punoj) dhe një formë të dytë analitike (po punoj) për të dalluar a saktësuar kuptimin e shprehur nga folja. Në Karadak të Shkupit për formën analitike: **po punoj** shpeshherë përdoret edhe forma e barasvlershme (ekuivalente) **jam tu punâu** (jam tu punu:, jam tu puna:), përkatëse me formën e shqipes standarde *jam duke punuar*. Forma *po punoj* është më e vjetër, gjeografikisht më e përhapur dhe që ka përdorim më të dendur sesa format e tjera të përbëra (jam duke punuar, jam kah punoj).³¹¹

17. Në një mënyrë me këto dy forma analitike e sintetike (punoj, po punoj) shqipja plotëson mungesën e aspektit të foljes (aspektin perfektiv dhe imperfektiv të foljeve), me anë të së cilës shprehet rrjedha e zhvillimit të veprimit, si diçka që ka përfunduar apo që nuk ka përfunduar. Në një fazë të hershme të zhvillimit, kategorinë gramatikore të aspektit të foljes e kanë pasur të gjitha gjuhët indoevropiane, por shumica prej tyre aspektin e kanë përfshirë në kohët e foljeve dhe tani më nuk e njohin si kategori gramatikore më vete. Aspektin perfektiv dhe imperfektiv të foljes e kanë ruajtur mirë gjuhët sllave, përfshirë edhe maqedonishten (свршени ~ несвршени глаголи).³¹² Krahaso: në maqedonisht në kohën e tashme në aspektin imperfektiv folja *јадам (jadam)* – e ka kuptimin ‘ha’ (diçka, por nuk e kam sosur krejt, vazhdoj të ha, veprimi përsëritet), ndërsa *изедам (izedam)* – e ka kuptimin ‘kam ngrënë’ diçka të tërën, nuk ka mbetur më asgjë nga ajo). Dallimi kuptimor i këtyre dy formave foljesh na del edhe më i qartë në kohën e ardhme: *ке јадам леб* ‘qe jadam leб’ e ka kuptimin do të ha një copë bukë ose deri sa të ngopem, por *ке изедам леб* ‘qe izedam леб’ do të thotë do ta ha një bukë të tërë, nuk do t’ia lë as një copë. Po kështu, aoristi parapëlqen folje perfekte, ndërsa imperfekti folje imperfektive.

18. Mund të përfundojmë se forma analitike me pjesëzën **po** (po punoj) në gjuhën shqipe shpreh kuptime të përafërta me foljet imperfektive në gjuhët sllave; ndërsa folja në formën sintetike, pa pjesëzën *po* (punoj) është mjaft e përafërt me foljet imperfektive. Me pjesëzën *po* para foljes tregohet një veprim që është duke u bërë, që vazhdon të bëhet, që përsëritet; përkatësisht veprim a ngjarje që nuk ka përfunduar deri në momentin kur flasim. Ndërsa forma sintetike **punoj** përdoret kryesisht për të treguar një veprim apo ngjarje që ka përfunduar ose një veprim suksesiv, por me të jepet edhe një konstatim, pohim a mohim.

³¹¹ Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I dhe II); Prishtinë, 1980, f. 192-198.

³¹² Në maqedonishten disa folje dallojnë edhe në gjini (te I (л)-forma e foljeve: Зоран работел – Zorani ka punuar. Мара работела – Mara ka punuar (*rabotel* për gjininë mashkullore ~ *rabotela* për gjininë femërore), ndërsa foljet në shqipen nuk dallojnë gjini, por kanë një formë të vetme për të dy gjinitë. Veç kësaj, po në maqedonishte foljet kanë edhe kategorinë e aspektit (мақ. свршен ~ несвршен вид на глаголот ‘svrshen ~ nesvrshen vid na glagolot’). Shih: http://mk.wikipedia.org/wiki/Глаголски_вид.

3.5.1.1. KOHA E SHKUAR

19. Koha e shkuar ka pesë nënkohë: 1. kohën e pakryer, 2. të kryerën e thjeshtë, 3. të kryerën, që shprehin veprime të kryera para çastit kur flasim; 4. më se të kryerën dhe 5. të kryerën e tejshkuar, që shprehin veprime para një çasti të caktuar të së shkuarës, përkatësisht të një të kaluare të largët.

20. **Koha e pakryer** (imperfekti) tregon një veprim të zgjatur a të përsëritur herë pas here brenda një kohe të caktuar të së shkuarës, që ka përfunduar para çastit të ligjërit pa ditur fillimin dhe mbarimin e tij. Kjo kohë ka formë të thjeshtë dhe formohet kur temës së foljes i shtohen mbaresat përkatëse. Të gjitha foljet, duke përfshirë edhe foljet e parregullta, përveç foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam*, temat e foljeve (puno-, shko-, mâill-, lodh-, rrâi-, vâi-...) në të pakryerën e veprores në arealin gjuhësor të Karadakut të Shkupit marrin këto mbaresa vetore:

koha e pakryer e veprores	
veta	mbaresat vetore
une	la- jshna , vâi- shna , - sha ³¹³
tâi (têi)	la- jshe , vâi- she
aj (ajo, aja)	la- jke , vâi- ke
na	la- jshmi , vâi- shmi (- jshna)
ju	la- jshi , vâi- shi , - shni
ata (ato)	la- jshin , vâi- shin ³¹⁴

21. Për dialektologjinë shqiptare me interes është të shënohet se e pakryera e diatezës veprorë në të folmen shqipe të Karadakut (që është karakteristikë e përgjithshme e të folmeve gege) del në formën sigmatike (me *-sh-* në mbaresë: punojshna), në dallim nga forma asigmatike (pa sh: punoja) e të folmeve toske.

22. Në formën joveprorë (në diatezën pësore e vetvetore) foljet në këtë të folme marrin të njëjtat mbaresa si edhe në formën veprorë. Dallimi i vetëm është se në joveproren para foljes të të gjitha vetat, si në njëjës ashtu edhe në shumës, d.m.th. pa përjashtim, përdoret pjesëza **u**. Në këtë mënyrë, veprorja del me formë të thjeshtë (njëpjesëshe, sintetike), ndërsa joveprorja na del me formë të përbërë (dypjesëshe, analitike). Krahaso foljet e dhëna në formën veprorë dhe joveprorë:

³¹³ Në të folmen e f. Orllancë dhe Mojancë ndonjëherë na del edhe mbaresa vetore **-sha**.

³¹⁴ Në të folmen tonë tingëlluesja [j] ndonjëherë dëgjohej, por shpeshherë ajo nuk dëgjohej fare. Zakonisht dëgjohej mirë te foljet e zgjedhimit të parë, të cilat në formën e tyre përfaqësuese (mënyra dëftore, veta e parë, numri njëjës, diateza veprorë) e kanë këtë bashkëtingëllore, por te foljet e dy zgjedhimeve të tjera ajo rëndom nuk shqiptohet. Për më tepër, ka edhe të folme të këtij regjioni që për analogji nuk e përdorin këtë mesgjuhore as te foljet e zgjedhimit të parë, si në f. Brezë në formën pakryer të veprores: *lajshna*, *lashe*, *lake*; *lashmi*, *lashi*, *lashin*. Te foljet që mbarojnë me diftongun *ai*, *ei* folësit e këtij areali nuk ndejnë të nevojshme që të shqiptojnë [j]-në, për shkak të nyjetimit të ngjashëm të gjysmëzanores [i] me [j]-në ([i] ≈ [j]), si pjesë përbërëse e diftongut, sipas tipit *vêishna*, *vêishhe*, *vêike*; *vêishmi*, *vêishi*, *vêishin*.

koha e pakryer		
veta	forma veprore	forma joveprore
une	punojshna	u lajshna
tâi (têi)	punojshe	u lajshe
aj (ajo, aja)	punojke	u lajke
na	punojshmi (-jshna)	u lajshmi (-jshna)
ju	punojshi	u lajshi
ata (ato)	punojshin	u lajshin

23. Foljet ndihmëse *jam* dhe *kam* në kohën e pakryer kanë këtë paradigmë:

koha e pakryer		
veta	jam	kam
une	ishna	kishna
tâi (têi)	ishe	kishe
aj (ajo, aja)	ishte, ish	kishte
na	ishmi (ishna)	kishmi (kishna)
ju	ishi	kishi
ata (ato)	ishin	kishin

24. **Koha e kryer e thjeshtë** (aoristi). – Pjesa dërmuese e foljeve (përfshirë edhe foljet e parregullta) në këtë të folme në kohën e kryer të thjeshtë dalin me këto mbarese: **-a**, **-e**, **-j** ose **-v** (dy të fundit (*j*-ja e *v*-ja), të përfuara nga konsonantizimi i /i/-së, gjegjësisht i /u/-së); ndërsa për shumës: **-m** (-ëm), **-t** (-ët) **-n** (-ën); sipas tipit: *la-va*, *la-ve*, *la-v*; *la:-m*, *la-j-tëm*; *la:-t*, *la-j-tët*; *la:-n*, *la-j-tën*....

koha e kryer e thjeshtë		
veta	punoj	pi
une	punova	pâiva
tâi (têi)	punove	pâive
aj (ajo, aja)	punoj	pâiv
na	punu:m, punâum, puna:m	pâivëm ³¹⁵
ju	punu:t, punâut, puna:t	pâitët
ata (ato)	punu:n, punâun, puna:n	pâitën

25. Në formën joveprore para foljes përdoret pjesëza **u**, si u *mqak-a*, u *mqak-e*, u *mqak*; u *mqak-ëm*, u *mqak-t*, u *mqak-ën* (f. Brezë); u *gjazmov-a*, u *gjazmov-e*, u *gjazmu-u*; u *gjazmu-m*, u *gjazmu-t*, u *gjazmu-n* (e njëjta folje dëgjohet varësisht nga e folmja edhe si: u *gjazmâun*, u *gjazma:n*).³¹⁶

³¹⁵ Te format e tilla /v-ja/ e ndërfutur midis temës së foljes dhe mbaresës është tingull antihijatizues.

³¹⁶ Kryesisht dihet se te foljet e tilla veta e tretë njëjës del pa mbarese, ndërsa në shembullin e dytë, mbarese për

26. Disa folje të parregullta dallohen nga foljet e rregullta vetëm me mbaresën e vetës së parë njëjës -sh: une *pa:sh, thash, lash* etj.; ndërsa në vetat e tjera zakonisht i marrin të njëjtat mbaresa. Krahaso shembujt: *ra:sh, rae, ra:; ra:m, ra:t, ra:n* me *mora, more, mu:r; murëm, murët, murën*.

27. Në këtë pasqyrë të përgjithshme të formës foljore në kohën e kryer të thjeshtë do të ishte e udhës të paraqesim edhe paradigmen e foljeve ndihmëse **kam** dhe **jam**:

koha e kryer e thjeshtë		
veta	kam	jam
une	pat- a	ke- sh
tâi (têi)	pat- e	ke: (ke e , ke ve)
aj (ajo, aja)	pat	ke
na	pat- ëm	ke- m
ju	pat- ët	ke- t
ata (ato)	pat- ën	ke- n

28. **Koha e kryer** (prefekti). – Siç dihet, foljet në kohën e kryer tregojnë një veprim të përfunduar në të shkuarën që nuk i ka shkëputur lidhjet me çastin e ligjërit. Për shembull: *A e ki larâu arën?* - *Po, e kam larâu*. Pra, me këtë formë foljore kuptohet që folësi e ka lëvruar arën, por kur saktësisht nuk mund të dihet. Koha ose çasti i kryerjes së veprimit edhe në këtë të folme, si në mbarë shqipen, rëndom përcaktohet me ndajfolje kohe ose me shprehje ndajfoljore. Për shembull: nëse përgjigjet në të njëjtën pyetje me *Po, gje e kam larâu*; atëherë saktësisht kuptojmë edhe kohën kur është kryer puna.

29. Si në të gjitha gjuhët, ashtu edhe në gjuhën shqipe për nga struktura kjo kohë është e përbërë (analitike). Forma veprorë ndërtohet me foljen kam + pjesore (kam la:); ndërsa forma joveprorë formohet me foljen jam + pjesore e foljes (jam la:).³¹⁷ Për shembull:

koha e kryer		
veta	<i>forma veprorë</i>	<i>forma joveprorë</i>
	<i>kam pirë</i>	<i>jam larë</i>
une	kam pâi	jam la:
tâi (têi)	ki pâi	je la:
aj (ajo, aja)	ka pâi	ã: la:
na	kimi pâi	imi la:
ju	kini pâi	ini la:
ata (ato)	kan pâi	jan la:

vetën e tretë është -u.

³¹⁷ Përveç formave të dhëna, foljet ndihmëse *kam* dhe *jam* në kohën e tashme në këtë të folme përdoren, siç e kemi përmendur më parë, edhe në disa forma (kryesisht të dallueshme nga përbërja fonetike e tyre, si: *kom, kie; kena; ije, i; asht; jemi, jena, ena, jeni*. Paskajorja në këtë të folme, përgjithësisht si në të gjitha të folmet e tjera të gegërishtes, përdoret e reduktuar, kryesisht në formë të shkurtuar (khs. *pi* > *pâi* më e shkurtër se *pimun, pirë; la:* më e shkurtër se *lamun, larë*).

30. Paradigma e zgjedhimit të foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam* në kohën kryer në arealin gjuhësor të Karadakut të Shkupit është si më poshtë:

kam		jam	
njëjës	shumës	njëjës	shumës
v. I: kam pa:s	kimi pa:s	jam ka:n	imi ka:n
v. II: ki pa:s	kini pa:s	je ka:n	ini ka:n
v. III: ka pa:s	kan pa:s	â: ka:n	jan ka:n

31. **Më se e kryera** (pluskuamperfekti). – Kjo kohë e cila në të folmen tonë ka përdorim të shpeshtë së bashku me kohët e tjera të shkuara, ndërtohet me foljet ndihmëse *kam* (kishna) ose *jam* (ishna) në kohën e pakryer (imperfekt) dhe pjesoren e reduktuar të foljes. Më se e kryera ka këtë paradigmë zgjedhimi:

njëjës	shumës	njëjës	shumës
v. I kishna frâi	kishmi (kishna) frâi	ishna lo:dh	ishmi (ishna) lo:dh
v. II kish frâi	kishi frâi	ishe lo:dh	ishi lo:dh
v. III kishte frâi	kishin frâi	ishte lo:dh	ishin lo:dh

32. **Koha e kryer e tejshkuar** (pluskuamperfekti II). – Koha e kryer e tejshkuar në të folmen tonë përdoret shpesh. Ajo ndërtohet me foljet ndihmëse *kam* ose *jam* në kohën e kryer dhe pjesoren e foljes themelore, si:

njëjës	shumës	njëjës	shumës
v. I pata da:l	patëm da:l	kesh mcâu	kem mcâu
v. II pate da:l	patët da:l	ke:(keve) mcâu	ket mcâu
v. III pat da:l	patën da:l	ke mcâu	ken mcâu

33. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit për rrëfyer ndonjë veprim a ngjarje që është kryer në një të kaluar shumë të largët (më herët nga ajo që tregojnë kohët deritashme të shkuara) përdoren edhe dy kohët e tjera. Në fakt, nga koha më se e kryer dhe koha e kryer e tejshkuar ndërtohen forma të dyta të mbipërbëra dhe me to tregohen veprime që kanë ndodhur në kohë të lashta, në kohët më të errëta të historisë së tyre fare pak të njohur, përkatësisht në kohën e panjohur e më të lashtë që mund të mbajë mend njerëzimi ose diçka që është bartur brez pas brezi në formën e folur, si në përralla, legjenda, gojëdhëna etj. Për shembull: ***Ish pas kã:n ni bu:rr e ni gru: // Ata nuk kishin pas asni ca:ll // Ish pas kãn ni arap i zi // Për dit e kish pas lip me ngrãn ka ni njer ...// Zakonisht me këto kohë të dyta të mbipërbëra të së shkuarës fillojnë përrallat, ndërsa më pas përdoren kohë të tjera foljesh që tregojnë kohë më afër të sotmes.***

34. Sipas strukturës që kanë, foljet e mbipërbëra janë analitike. Ndërtohen nga koha më se e kryer si dhe nga e kryera e tejshkuar me ndërfitjen e foljes **pas** ndërmjet foljes ndihmëse

³¹⁸ Pjesorja e kësaj foljeje në disa fshatra dëgjohej edhe në formën fonetike *msu:* ose *mca:*.

dhe pjesores, sipas tipit: *kishna shku*: (koha më së e kryer) - **kishna pas shku**: (më se e kryera II), gjegjësisht *pata dal* (koha e kryer e tejshkuar) - **pata pas da:l** (e kryera II e tejshkuar) etj.

Këto kohë të dyta të mbipërbëra, që tregojnë të shkuarën më të largët të mbamendjes kolektive, në të folmen tonë kanë përdorim të kufizuar. Në fakt, këto kohë janë karakteristike për të folmen e gegërishtes verilindore (kosovarishten) e jo për të folmet e gegërishtes qendrore.³¹⁹

35. Ndryshimet që po bëhen në shoqëri, në mënyrën e jetesës, sidomos me zhvillimit e teknikës e të teknologjisë, sjellin me vete edhe ndryshime në gjuhën e njerëzve. Te ne rrallëkund rrëfehen përralla, legjenda e gati më askund nuk ka oda të dikurshme kuvendesh, bile as në malësi. Njerëzit gjithnjë më pak flasin e evokojnë të kaluarën e largët. Pjesën më të madhe të kohës së lirë e kalojnë para televizorit, kompjuterit apo edhe gjithë ditën e kalojnë me telefon në dorë, duke këmbyer porosi ose duke surfuar në internet. Në gjuhën e komunikimit të përditshëm fare pak gjejmë kohët e shkuara, aspak të mbipërbërat. Më nuk tregon kush e as që dëgjon kush përralla e legjenda. Rrjedhimisht edhe këto dy kohë të mbipërbëra, edhe ashtu fare pak të ruajtura në të folmet e Veriut, do të humben, treten e shuhën plotësisht.

3.5.1.2. KOHA E ARDHME

36. Siç dihet, foljet që tregojnë një veprim i cili pritet të kryhet pas çastit të ligjëritimit, janë të kohës së ardhme. Në shqipen standarde veprimet që pritet të kryhen në të ardhmen shprehen me tri kohë të foljeve: me kohën e ardhme (futur), me të ardhmen e përparme (futur II), si dhe me të ardhmen e përparme e së shkuarës.³²⁰ Në të folmen e Karadakut të Shkupit koha e ardhme tregohet nëpërmjet dy kohëve të foljeve, përkatësisht me:

a) **kohën e ardhme** dhe një kohë tjetër që mund ta quajmë

b) **e ardhme e dytë** (futur II), që me terminologjinë e standardizuar gramatikore vështirë se mund ta quajmë *e ardhme e përparme* për shkak të strukturës dhe funksionit që ka kjo kohë e përbërë (analitike) e foljes në arealin gjuhësor të Karadakut të Shkupit.

37. Dihet mirëfilli se e ardhmja (do të mësoj) shpreh një veprim që pritet të kryhet pas çastit kur flasim ose që do të kryhet në të ardhmen; ndërsa e ardhmja e përparme (do të kem mësuar) shpreh një veprim që pritet të kryhet para një veprimi tjetër në të ardhmen. E ardhmja e dytë e të folmes sonë: *kam për t'shkrâu* ose *kam për me msu*: nuk lidhet me asnjë veprim që pritet të kryhet në të ardhmen, por shpreh një punë, veprim a gjendje që pritet të kryhet pavarësisht kushteve e rrethanave. Ajo për nga kuptimi që shpreh si dhe për nga përbërja është e ngjashme me kohën e ardhme të dytë (kam për të shkruar).

38. **Përdorimi paralel i të ardhmes së domosdoshme (futurum necessitatis) dhe i të ardhmes së dëshiruar (futur volitiv, futurum voluntatis).**- Duke u mbështetur në materialin e vjelë në terren, erdhëm në përfundim se në të folmen e Malit të Zi të Shkupit koha e ardhme shprehet me dy forma të përbëra. Në fakt, njëra është karakteristike dhe mbizotëruese në të folmet e gegërishtes, ndërsa tjetra në të folmet e toskërishtes. Megjithatë, siç dihet, në folmet e

³¹⁹ Për këto dy forma të dyta të mbipërbëra edhe prof. Haki Imeri në monografinë e tij "*E folmja shqipe e Karshiakës*", Shkup, 1997, f. 168 thotë se "kanë përdorim të kufizuar."

³²⁰ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, 1995, f. 290-291.

gegërishtes qendrore kemi përdorimin e dyfishtë të të dy formave, me shtrirje më të gjerë të formës së dytë të lartshënuar (futur volitiv). Në arealin gjuhësor për të cilin po shkruajmë, janë të pranishme edhe njëra edhe forma tjetër, por sipas vlerësimit tonë, forma **do + lidhore** (do t'fshâi) gjen përdorim të më shpeshtë.

39. Njëra formë (kushtimisht e thënë toske) ndërtohet me pjesëzën **do** (e desemantizuar nga folja due, du, dua) + **folja** themelore në mënyrën lidhore, sipas tipit: *do t'shkoj, do t'punoj, do t'laroj...* Forma tjetër gege formohet nga folja ndihmëse **kam + paskajorja**, apo kam + me + pjesore: *kam me shku:, kam me punu: (punâu, puna:), kam me laru: (larâu, lara:)*...

40. Në studimet albanologjike përgjithësisht është pranuar se **këto dy forma të veçanta foljore** të së ardhmes **dallojnë** jo vetëm në **pikëpamje strukturore**, por edhe në **pikëpamje kuptimore**, ose së paku tregojnë nuanca me vlerë kuptimore (semantike).

41. Në fakt, forma gege e kohës së ardhme (kam me a:rdh), e quajtur në shqip **e ardhme e domosdoshme** a **e detyrimit** (futurum necessitatis), është konstatuar se tregon veprime që duhen patjetër të kryhen, që janë të domosdoshme, të detyrueshme për t'u bërë, apo parashikimet e premtimet për t'u realizuar diçka thuhet me një siguri shumë të lartë, premtimet janë bindëse, folësi zotohet për atë që e thotë se do ta bëjë.

42. Ndërkaq, me formën tjetër toske (standarde 'do të vi'), e emërtuar në shqip **e ardhme e dëshiruar** (futur volitiv), shprehet një siguri më e ulët për atë që pritet të realizohet, një mëdyshje për atë që do të kryhet, diçka që është mirë të bëhet, por nuk është e domosdoshme.³²¹ Me fjalë të tjera, me futur necessitatis tregohet një veprim që me të vërtetë do të kryhet, ndërsa me futur volitiv shprehet një veprim që duam të kryhet.

Kjo kundërvënie (dyshe) binare: e vërtetë, e sigurt ~ e mundshme, e pritshme apo e domosdoshme, e patjetërsueshme ~ e dëshirueshme, e parapëlqyeshme shihet edhe në përbërjen (strukturën) e tyre: forma foljore gege (kam me a:rdh) ndërtohet me mënyrën dëftore (indikativin), ndërsa forma toske (do të vi) me mënyrën lidhore (konjunktivin). Të rikujtojmë se me mënyrën dëftore shënjohejt një e vërtetë, diçka reale; ndërsa me mënyrën lidhore – e dëshirueshmja, e pritshmja.

43. Mua si banor i krahinës së Karadakut të Shkupit, kur më thotë dikush: *Kam me a:rdh, jam i bindur se ai vërtet 'ka me ardhë'* dhe bëj përgatitjet për ta pritur; ndërsa kur dikush më thotë: *Do tvâi, atëherë nuk ndërmarr asgjë për ta pritur, meqë nuk jam i bindur se ai 'ka me ardhë'*.

44. Zgjedhimi i foljeve në kohën e ardhme të domosdoshme dhe në të ardhmen e dëshiruar në këtë areal gjuhësor është:

e ardhme e domosdoshme		e ardhme e dëshiruar	
njëjës	shumës	njëjës	shumës
v. I: kam me da:l	kimi me da:l	do t'dal	do t'dalim
v. II: ki me da:l	kini me da:l	do t'dalsh	do t'dilni
v. III: ka me da:l	kan me da:l	do t'dale	do t'dalin ³²²

³²¹ Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe ...*, f. 285-286.

³²² Pjesëza t (< të) e lidhores në të folmen tonë rëndom përdoret gjatë të folurit. Megjithatë, prirja e ekonomisë së gjuhës dhe e lehtësimit të shqiptimit ka përfshirë edhe të folmen e Karadakut. Edhe këtu ka raste kur pjesëza t (< të) shpesh nuk shqiptohet, si në të folmen e f. Straçincë: *do shkoj, do shkojsh, do shkoje; do shkojm, do shkoni, do shkojn...* Por, në të njëjtën të folme regjistruam edhe ruajtjen e pjesëzës t': *do t'mbëilli, do t'punoj'*.

Pjesëza **të** (> t') zakonisht përdoret në këtë të folme, përkundër asaj se në shumë të folme të gegërishtes qendrore³²³ si dhe në gegërishten në përgjithësi është hetuar rënia e saj, siç nuk shqiptohet as në të folmet toske të Manastirit,³²⁴ Prespës³²⁵ në Maqedoninë e Veriut etj.

45. Hetuam raste ku në vend të pjesëzës **do** të përdoret folja **due**, në vetën e parë të njëjësit. Për shembull, në të folmen e f. Malinë dhe Brezë kemi:

due me da:l	dojm me da:l
do me da:l	dojni me da:l
do me da:l	dojn me da:l

Shikuar në pikëpamje historike, pjesëza **do** rrjedh nga folja **due** (du, dua), e cila është desemantizuar në **do**.³²⁶ Në të njëjtat fshatra kjo pjesëz mund të dëgjohet edhe si **de**, e përfutur nga **do** + e, ku zanorja /e/ ka funksionin e kundrinorit të drejtë. Kjo formë (de) sipas analogjisë është e përgjithësuar edhe te foljet që përdoren pa kundrinor të drejtë: *de m'dhome* 'do të më dhemb', *de shoshet* 'do të shëndoshet, shërohet', *de helmona* 'do të helmohem', *de vâie* 'do të vijë' etj. Por, pjesëza **de** nuk është e shpeshtë në këtë izoglosë gjuhësore, aq sa është e shpeshtë në disa të folme të tjera të gegërishtes qendrore, si në të folmen e Dervenit,³²⁷ të folmen shqipe të Karshiakës,³²⁸ të Kërçovës³²⁹ etj. Në të folmen e Strugës kemi format *do dal* (në të folmet toske), *dë dali* (në të folmet gege dhe ato të ndërmjetmet, ndërkalueset, kalimtare).³³⁰

46. Si përfundim mund të themi se në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit kemi përdorim paralel të të dy formave foljore: a) të ardhmes së sigurt dhe b) të ardhmes së mundshme. Në këtë kontekst, do të përmendim një shembull interesant të përzierjes së të dy formave. Në të folmen e f. Tanushë konstatuam dhe vërtetuam se i njëjti informator përzien të dy format e kohës së ardhme, përkatësisht kalon nga një formë në një tjetër, madje kur zgjedhon të njëjtën folje:

une du t'shkoj	na do t'shko:jm
ti don me shku:	ju do t'shkoni
aj don me shku:	ata do t'shko:jn

³²³ Në kohën e ardhme thuhet nuk përdoret fare pjesëza të, pasi si tregues i kësaj kohe mjafton pjesëza *do: do shkojm, do punojm* etj. Shih: Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 467.

³²⁴ Dr. Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Manastirit dhe e qarkut të tij*, Shkup, 1997, f. 115.

³²⁵ Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Prespës*, Shkup, 1996, f. 93.

³²⁶ Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I dhe II), Prishtinë, 1980, f. 283.

³²⁶ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 329.

³²⁷ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997, f. 169.

³²⁸ Lulzim Aliu, *E folmja shqipe e rrethit të Kërçovës*, Tetovë, 2011, f. 95.

³³⁰ Ajten Qamili, *E folmja shqipe e Strugës (në kontekstin ballkanik)*, Arkivi i Fakultetit të Filologjisë "Bllazhe Koneski" (disertacioni doktorati), Shkup, 2012, f. 156.

3.5.1.3. KOHA E ARDHME E DYTË

47. **Koha e ardhme e dytë** (e ardhmja e përparme). - Në të folmen tonë përdoret, por shumë rrallë, edhe një formë për kohën e ardhme, e cila, siç u tha edhe më parë, më e drejtë është të quhet e ardhme e dytë sesa e ardhme e përparme, meqë ka përdorim të mëvetësishëm dhe nuk nënkupton lidhje e sa me ndonjë veprim tjetër në kohë. Rëndom, përdoret në fjali të thjeshta e jo në periudha, siç ndodh në gjuhën e intelektualizuar, letrare e standarde (Kur do të ktheheni ju, unë do t'i kem mbaruar detyrat), meqë gjuha popullore karakterizohet me përdorim fjalish të shkurtra e me bashkërenditje.

Sidoqoftë, më e rëndësishme është që kjo kohë formohet me foljen ndihmëse **kam** në kohën e tashme + paskajorja **për t'shku**: (e quajtur toske: për të shkuar) ose paskajorja gege (me shku:), sipas gjedhes: kam + për me shku:. Në të vërtetë, në këtë paradigmë foljore të kohës së ardhme të dytë na dalin të gërshetuara elemente tipike gege me ato toske, që rrallëkund mund të dëgjohet. Nga zgjedhimi që do të sjellim në kohën e ardhme të dytë, del në shesh kjo ndërthurje e paparë e paskajores gege (me + pjesore e reduktuar) me paskajoren toske (për + lidhore):

v. I. kam për t'msâu	kimi për t'msâu	kam për me msu:	kimi për me msu:
v. II. ki për t'msâu	kini për t'msâu	ki për me msu:	kini për me msu:
v. III. ka për t'msâu	kan për t'msâu	ka për me msu:	kan për me msu:

48. Kjo paradigmë është me shumë rëndësi për dialektologjinë dhe për gjuhësinë shqiptare në përgjithësi. Ajo mund të vëzhgohet nga shumë pikëpamje gjuhësore e sociolinguistike. Fjala vjen, në të vërehet se te forma e paskajores toske (kam për t'msâu) /u/-ja e pjesores gege na shfaqet e diftonguar, ndërsa te paskajorja gege (me msu:), zanorja /u/ ruhet e pashpërbërë. Kjo formë hibride si edhe shumë forma të tjera dyshe, qofshin ato edhe përzierje me elemente tipike gege ose toske, që janë më të pranishme veçmas në gegërishten qendrore e atë të Shqipërisë së Mesme, dëshmojnë për lashtësinë e shqipes, autoktoninë e shqiptarëve, marrëdhëniet intensive ndërmjet folësve krahinash të ndryshme, argumentojnë se elementet e përbashkëta të shqipes dialektore janë të shumta e në fund të fundit se në shqipen dialektore nuk kemi kufij të prerë dialektesh, nëndialektesh e të folmesh, por përkundrazi kemi izoglosa, me përhapje dukurish dialektore shumë të ndërthurura etj., etj. Por, mendoj se çështjet e tilla të gërshetimeve dialektore meritojnë një vrojtim të veçantë e më të thelluar.

3.5.2. MËNYRA LIDHORE

49. Lidhorja shpesh përdoret edhe në fjalitë e varura qëllimore.³³¹ Për shembull: *Kimi ardh t'rrâim* 'Kemi ardhur për të ndenjur'.

50. Sipas formës së saj, lidhorja është më e përfaqësuar me dëftoren. Në fakt, foljet e kësaj mënyre në kohën e tashme kanë formë të njëjtë me kohën e ardhme të mënyrës dëftore. Dallimi qëndron në faktin se:

³³¹ Ремзи Несими – Ѓустина Шушка, *Учебник по албански јазик*, Shkup, 1989, f. 159.

- a) Koha e ardhme e dëftores përdoret me pjesëzën *do*, ndërsa lidhorja del pa këtë pjesëz: *do t'punoj - t'punoj*.
- b) Lidhorja zakonisht përdoret pas foljeve gjysmëndihmëse,³³² të cilat së bashku (si një tërësi) formojnë një kallëzues të vetëm të përbërë: *duhet t'shkoje, nâisa t'mcoj, zuni t'këndoje* etj.

51. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit lidhorja dhe paskajorja përdoren paralelisht. Për shembull: *Duhet t'shkoj ta shoh arën dhe Duhet me shku: me pa arën. Njeri duhet t'punoje sa t'jete xha:ll - Njeri duhet me punu: sa t'jete xhall.. Mâikin lipet ta dush e t'i bash sajgi - Mikin duhet me da:sht e mej ba: sajgi* etj.

52. Sipas vlerësimit tonë, edhe pse kemi përdorim paralel të të dy formave, paskajorja përdoret më dendur sesa lidhorja.³³³

53. Lidhorja në këtë të folme ka katër kohë të foljes, ashtu si edhe shqipja standarde: a) një për *kohën e tashme* dhe tri për kohën e shkuar: b) *e pakryera* (imperfekti), c) *e kryera* (prefekti) dhe ç) *më së e kryera* (pluskuam perfekti).

54. **Koha e tashme.** – Sipas rregullit, foljet në mënyrën lidhore kohën e tashme e formojnë me pjesëzën *t'* (< të) para foljeve të mënyrës dëftore të kohës së tashme (me pak përjashtime). Shpeshherë, ashtu siç kemi thënë edhe më parë, para formës së lidhore përdoren foljet gjysmëndihmëse *duhet* (duhet t'dal). Krahaso paradigmen e mënyrës dëftore me ato të lidhore së foljeve *dal* dhe foli 'flas':

<i>mënyra dëftore</i>		<i>mënyra lidhore</i>	
		<i>folja</i>	<i>dal</i>
v. I:	dal dalim, dalëm, dalmi	t'dal	t'dalim, t'dalëm, t'dalmi
v. II:	del dilni	t'dalish, t'dal(ë)sh	t'dilni
v. III:	del dalin	t'dale	t'dalin
		<i>folja foli</i> (< flas)	
v. I:	foli folim, folmi	t'foli	t'folim, t'folmi
v. II:	fol folni	t'folish, t'fol(ë)sh	t'folni
v. III:	fol folin	t'fole	t'folin

55. Ashtu siç mund të shihet nga paradigma e zgjedhimit të foljeve të dhëna, në këtë të folme, dallimi ndërmjet dëftores dhe lidhore në mbaresat vetore të foljeve është në vetën e dytë dhe vetën e tretë njëjës. Në fakt, në vetën e dytë njëjës foljet në lidhore marrin njërin nga mbaresat: **-ish**, **-ësh** ose vetëm **-sh**.³³⁴ Të gjitha foljet në vetën e tretë të njëjësit dalin me mbaresën **-e** (në gjuhën standarde **-ë**).

³³² Folje gjysmëndihmëse në të folmen tonë janë: a) foljet modale *duhet* ose *lipet*, *mund* (*mun*) etj. Si dhe në fjalinë: *Duhet t'vâish. Mun t'rrâish sa t'dush*. b) foljet që tregojnë fillimin e veprimit: *nâisa, zâ.*; si *Nâisi t'punoje.*; *Zuni t'kallzoje se sa u gjazmâu për darsmën e gjalit* etj.

³³³ Në të folmet toske, siç është e njohur, në vend të paskajores (me punue), çdoherë kemi lidhoren (të punojë ose paskajoren toske (për të punuar). shih: Jorgji Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 44; Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1988, f. 88; Dr. Bahri Beci, *Marrëdhëniet e hershme shqiptaro-sllave në dritën e të dhënave të dialektologjisë sonë historike*, Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994, f. 40 etj.

³³⁴ Te foljet e zgjedhimit të parë përveç temës ruhet edhe mbaresa -j, si *t'punojsh, t'lajsh* etj. Te foljet që mbarojnë me diftongun *âi, ëi* (t'pâish, t'vâish, t'rrâish etj.) pas diftongut nuk shqiptohet -j-ja.

56. Zgjedhimi i foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam* në kohën e tashme të mënyrës lidhore në këtë të folme është si më poshtë:

veta I:	t'kem	t'kimi, t'kemi, t'kena	t'jem, t'jam	t'jena, t'jemi
veta I:	t'kesh, t'kise	t'kini, t'keni	t'jesh, t'jeshe	t'jeni, t'ini
veta III:	t'kese, t'ke:t, t'kete;	t'ke:n	t'jese, t'je:t, t'jete	t'je:n

57. Disa folje që në gjuhën standarde shqipe në vetën e tretë njëjës, si në dëftore, ashtu edhe në lidhore që mbarojnë me -të, në disa fshatra të këtij areali gjuhësor të njëjtat dalin me -se, si (aj) *t'kese, t'shese, t'jese* etj. (gjegjësisht $s > t$, ndërsa mbaresa e rregullt (-e) për të folmen mbetet). Megjithatë, në të folmet e f. Luboten dhe Brezë kemi *t'ke:t, t'jete*; ndërsa në f. Bllacë kemi përdorim të dyfishtë: *t'kese* dhe *t'ke:t*.³³⁵

58. **Koha e pakryer** (imperfekti). - Kjo kohë foljore e lidhore në të folmen e Karadakut të Shkupit, si dhe në të folme të tjera të gegërishtes qendrore, përdoret për të treguar veprime të mundshme në të kaluarën, por që lidhen me ndonjë kusht. Për shembull: *T'punojshna ashtâu, ke t'um dal mâir. T'vâike sod t'um kish ndihmôu t'i çethshmi dhent* etj.

59. Foljet në këtë kohë, pa përjashtim, kanë formë të njëjtë me kohën përkatëse të mënyrës dëftore. Dallohet vetëm në atë që në lidhoren para foljes përdoret pjesëza **t** (< të). Krahaso foljet në paskajore dhe në lidhore:

punoj		
njëjës		
	<i>mënyra dëftore</i>	<i>mënyra lidhore</i>
veta I	punojsha, punojshna	t'punojsha, t'punojshna
veta II	punojshe	t'punojshe
veta III	punojke	t'punojke
shumës		
veta I	punojshmi, punojshëm, punojshna	t'punojshmi, t'punojshëm, t'punojshna
veta II	punojshi	t'punojshi
veta III	punojshin	t'punojshin

60. Forma joveprore formohet mbi bazë të formës përkatëse veprore, duke vendosur para foljes, përkatësisht pas pjesëzës **t'** (< të) pjesëzën **u**, si (forma veprore - joveprore): *t'lajshna, t'lajsha - t'u lajshna, t'u lajsha; t'lajshe - t'u lajshe; t'lajke - t'u lajke* etj.

61. **E kryera dhe më së e kryera e mënyrës lidhore**.- E kryera e mënyrës lidhore në të folmen tonë ndërtohet me foljen ndihmëse *kam* (t'kem) në kohën e tashme të lidhore + pjesoren e foljes. P.sh.: *t'kem thā:n, t'kesh (t'kise) thā:n, t'kese (t'ke:t, t'kete) thā:n; t'kimi (t'kemi, t'kena) thā:n, t'kini (t'keni) thā:n; t'ken thā:n* etj.

Më së kryera formohet me formën e paskajores së foljes ndihmëse *kam* (kishna) + pjesorja e foljes themelore, sipas tipit: *t'kishna frâi, t'kise frâi, t'kish frâi; t'kishmi (kishna) frâi, t'kishi frâi, t'kishin frâi* etj.

³³⁵ Te format *t'ke:t, t'je:t* zanorja është e gjatë për shkak të rënies së /ë/-së në fundin absolut të fjalës. Vërehet gjithashtu se te këto forma nuk e kemi mbaresën -e, që është e zakonshme për këtë të folme, përveç në të folmen e f. Luboten: *t'jete*.

62. **Format joveprorë.**- Forma joveprorë në këtë të folme kanë e pakryera, koha e tashme dhe më se e kryera. Format joveprorë të lidhore janë të ngjashme (identike) me format përkatëse të dëftores joveprorë (lahëm, lahna), por para tyre përdoret pjesëza t' (t'lahëm, t'lahna). Për shembull, koha e tashme e lidhore: t'lahëm (t'lahna); t'lahësh, t'lahët; t'lahmi (t'lahna), t'lahni, t'lahën.³³⁶ Ashtu siç shihet edhe nga zgjedhimi i foljes së dhënë, mbaresat vetore të foljes janë: -**ëm** (-na), -**ësh** (-sh), -**ët**; -**mi** (-na), -**ni**, -**ën**.

63. Në më së të kryerën foljet kanë këtë strukturë: t' + folje ndihmëse *jam* në kohën e pakryer + pjesorja e foljes themelore, si: t'*isha* (t'*ishna*) la:, t'*ishe* la:, t'*ish* (t'*ishte*) la:, t'*ishëm* (t'*ishmi*, t'*ishna*) la:, t'*ishi* la:, t'*ishin* la:.

3.5.3. MËNYRA URDHËRORE

64. Me foljet e mënyrës urdhërore shprehet një urdhër, kërkesë, lutje, nxitje, ndalesë etj.³³⁷ Ka dy mënyra: imperativ (urdhër) dhe prohibitiv (ndalesë). Për shembull: *Hec ma shpejt! Gjutu pak! Fshâie odën! Kalle zarmin! Berma pak u:j! Hajdi sonte t'rrâim!* etj. Format e ndalesës para foljes kanë pjesëz mohuese mo (mos), sipas gjedhës: *Mo luj! Mos e kall zarmin!* etj.

65. Format e mënyrës urdhërore edhe në të folmet tonë janë shumë të ngjashme me mënyrën dëftore, por urdhri thuhet me intonacion ngjites, në dallim nga foljet e dëftores dhe fjalitë dëftore që shqiptohen me intonacion të rrafshët.

66. Si në shumë gjuhë të tjera, për shembull në gjuhën maqedonase,³³⁸ ashtu edhe në gjuhën shqipe, urdhri mund të tregohet edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, të tërthortë (urdhër direkt dhe indirekt). Urdhër direkt kemi vetëm në vetën e dytë njëjës dhe shumës.

67. Urdhër i tërthortë jepet për vetat e tjera, pra me mënyra të tjera të foljeve, si për shembull, me mënyrën lidhore: *T'hecim ma shpejt!, Ma mâir t'kishim shku: nesër!, Thuj t'punoje ma shâum! Thuj le t'vâie!, Le t'shkoje (ne t'shkoje) te dhent!*

Shënim: Në tri fjalitë e fundit urdhri jepet për vetës së tretë njëjës me ndërmjetësimin e vetës së dytë (ndërsa ai e ka për detyrë ta përcjellë urdhrin). Në dy fjalitë e fundit para lidhore është e përdorur edhe pjesëza le (ne).³³⁹ Marrë në përgjithësi, urdhri i tërthortë jepet me intonacion të rrafshët.

68. Nga kjo del se mënyra urdhërore ka forma përkatëse foljore vetëm për vetën e dytë njëjës dhe vetën e dytë shumës. Për vetat e tjera nuk ka forma përkatëse foljore të urdhërores, por shprehet me nëpërmjet mënyrave foljore të tjera, më së shpeshti me lidhoren: *le t'shkoje* (veta III njëjës); *t'puno:jm* (veta I shumës); *le t'mcojn* (veta III shumës).

69. **Format e mënyrës urdhërore.**- Mënyra urdhërore ka vetëm një kohë foljore për

³³⁶ Te disa folje që mbarojnë me temë në zanore para mbarsës së foljes ndërputet edhe [-h-]-ja për të zhdukur hiatin.

³³⁷ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), Tiranë, 1995, f. 330.

³³⁸ Блаже Конески, *Грамматика на македонскиот литературен јазик (I, II дел)*, Скопје, 1976, f. 416.

³³⁹ Gjendja e tillë është edhe në të folmen e shqipe të Karshiakës, si dhe në përgjithësi në gjithë shqipen dialektore si dhe në gjuhën standarde. Shih: Haki Imeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997, f. 177-178; Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe*, ..., f. 330 etj.

kohën e tashme në veprorë dhe joveprorë. Kjo kohë, sipas funksionit, në stilin rrëfimit shpesh përdoret për të treguar edhe të shkuarën, ose veprime që kanë vazhduar, a janë përsëritur në të kaluarën:³⁴⁰ *Hec e hec, hec e hec, dikur mrrâin*. Në raste të tilla, në vend të mënyrës urdhërore (ec e ec), mund të përdoret aoristi i dëftores (heci e heci ose hecën e hecën në shumës).³⁴¹

70. Foljet në mënyrë urdhërore ngjashmëri më të mëdha kanë me mënyrën dëftore përkatëse të kohës së tashme. Megjithatë, disa folje, përveç intonacionit, karakterizohen edhe me forma të ndryshme gramatikore. Format e mënyrës urdhërore në këtë të folme janë:

a) Foljet që mbarojnë me -o (puno-j), si dhe me diftongun *âi*, *êi* në vetën e dytë të njëjësit dalin pa mbaresa, si *puno!*, *mso!*, *shko!*, *kno!*, *laro!*, *përgjo!* etj.; por në vetën e dytë të shumësit marrin mbaresën -ni (-j-ni): *punoni!*, *msoni!*, *shkoni!*, *knoni!*, *laroni!*, *përgjojni!*. Të gjitha këto folje dëgjohen edhe me mbaresën e vetës së parë të njëjësit -j, si *punojni!*, *msojni!*... , *hajni!* etj. Sipas rregullit, edhe foljet që mbarojnë me diftongun *âi*, ose me variantin tjetër *êi* në vetën e dytë të njëjësit nuk kanë mbaresë: *fshâi!*, *frâi!*, *grâi!*, etj. ndërsa në vetën e dytë të shumësit kanë -ni: *fshâini!*, *frâini!*, *grâini!* etj.; por edhe pa zanore të diftonguar: *rri!*, *pi!* (veta e dytë shumës *rrini!*, *pini!*; ndërsa më shpesh në formë të diftonguar *rrâini!* *pâini!*).

b) Foljet që mbarojnë në -a, në vetën e dytë të njëjësit kanë mbaresën -j: *kaj!*, *shaj!* *vraj!*, *çaj!*; ndërsa në vetën e dytë të shumësit mbaresën foljore -ni: *kajni!*, *shajni!*, *çajni!*; por nga folja bāj ‘bëj’ në vetën e dytë të njëjësit kemi *bân!* – shumës, *bojni!*

c) Foljet që mbarojnë me bashkëtingëllore zakonisht kanë formë të njëjtë me formën përkatëse të dëftores, si: *ngarend!* - *ngarendni!*; *dil!* - *dilni!*, *hin!* - *hini!*, *fol!* - *folni!*, *lip!* - *lipni!*, *hip!* - *hipni!*, *vikat!* - *vikatni!* etj. (nga djeg) *dixh!* - *dixhni!*, (nga me:ll ‘mbjell’) përmes mill në *mâill!* - *mâillni!*, (nga ze) – *zene!*, (nga pret) *pre!* - *prene!*, (nga hek) *hiç!* - *hiçni!*, (nga shet) *shit!* - *shitni!*, (nga del) *dil!* - *dilni!*; *hajde!* - *hajdi!*³⁴² (nga non, vnon ‘vendon, vëndon, vendos’) *noje!* - *none!* etj.

71. Duhet të përmendet në këtë kontekst se foljet në mënyrë urdhërore në të folmen tonë përdoren edhe me trajta të shkurta të përemrave vetorë, të cilat i prapangjiten pjesës fundore të foljes, pra shndërrohen në fjalë enklitike. Për shembull: *epja!*, *thëirr!* – *thëirre!*, (*vikate!*, *fkate!*), *biri!*, *vraje!*, *vrâitne!*; *zene!*, *bane!*, *preje!*; *briti!*, *bërtâiti!*; *britvu!*, *bërtâitu!*; *mite!*, *mâite* etj.³⁴³

72. Me interes për dialektologjisë është edhe forma joveproe e foljeve. Foljet në këtë formë marrin pjesëzën -u, pa përjashtim, si *laj-u!* - *lajn-u!*, *vâish-u!* – *vâishn-u!*, *frâi-u!* – *frâin-u!*, *kesh-u!* - *keshn-u!*, *gjazmo-u!* - *gjazmon-u!*, *thke-u!*, *kthe-u!* - *thken-u!*, *kthen-u!* etj.³⁴⁴

3.5.4. MËNYRA DËSHIRORE

³⁴⁰ Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I dhe II), Prishtinë, 1980, f. 295.

³⁴¹ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 341.

³⁴² Në gjuhën popullore përdoret edhe forma e rrejshme e urdhërores së foljes *hajde!*, *hajde-ni!*, e huazuar në shqipen nga turqishtja. Shih: Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I dhe II), Prishtinë, 1980, f. 299.

³⁴³ Forma e trajtës së shkurtë më mirë dëgjohet kur folja pohuese vendosen në formë përkatëse si *epja!*, *epva!* - *mos ia jep!*, *mos ua jep!*, *thëirre!* - *mos e thëirre!*, *bërtaitu!* - *mos u bërtait!* ...

³⁴⁴ Në të folmen e f. Luboten dhe Bllacë regjistruam edhe *hunxhu!* - *huxhni!*, *thkeu!* - *thkeni!*, *gjazmov!* - *gjazmoni!* (shembulli i fundit vetëm në f. Bllacë).

73. Dëftorja, lidhorja, dëshirorja dhe habitorja e gjuhës shqipe konsiderohen si mënyra të trashëguara nga gjuha mëmë indoevropiane.³⁴⁵ Përveç disa gjuhëve indoevropiane, këtë mënyrë e ka edhe gjuha shqipe. Por, përderisa në gjuhët e tjera indoevropiane dëshira shprehet me lidhoren, në gjuhën shqipe është krijuar një formë e veçantë sintetike foljore për shprehjen e dëshirës, sipas tipit *hapsh-a*, *punofsh-a*, të cilën sipas strukturës nuk e ka asnjë gjuhë tjetër indoevropiane. Në këtë të folme, mënyra dëshirore formohet si edhe në mbarë shqipen: *E gzoftsh Beramin dajko! Kofsh shnosh ene tât e gzoftsh! Shkofsh shnosh e mâir!*

74. Ndonjëherë edhe në gjuhën shqipe vërehet marrja ose mbulimi i funksionit të dëshirores nga format e lidhores, përkatësisht shprehja e dëshirës nëpërmjet dy formave: me dëshiroren ose me lidhoren. Me fjalë të tjera, format e posaçme të foljes për mënyrën dëshirore (Rroftë rinia!) zëvendësohen me format e lidhores në kohën e tashme (Të rrojë rinia!).³⁴⁶ Në gjuhën maqedonase dëshirorja përkthehet me lidhoren, ndërsa në gjuhën serbe dhe kroate quhet pjesore aktive.

75. Me anë të optativit shprehet modaliteti i dëshirës në formë urimi ose mallkimi. Në gjuhën standarde shqipe, si dhe në këtë të folme, dëshirorja ka dy kohë: kohën e tashme dhe të kryerën³⁴⁷ (kjo e fundit është shumë e kufizuar).

76. Formanti karakteristik me të cilin ndërtohet forma foljore e dëshirores është **-sh-** për foljet të cilat mbarojnë në zanore dhe **-fsh-** për foljet të cilat mbarojnë në bashkëtingëllore. Në të shumtën e rasteve, forma foljore e dëshirores është e njëjtë me format përkatëse të së kryerës së thjeshtë të dëftores, ndonjëherë edhe me pjesoren, duke ua shtuar mbaresat **-sh-** ose **-fsh-**.

77. Mbaresat vetore të dëshirores në të folmen shqipe të Karadakut janë:

- (f)sha	- (f)shmi, - (f)shna
- (f)sh	- (f)shi
- (f)t	- (f)shin. ³⁴⁸

78. Te foljet apofonike, habitorja ndërtohet kur temës së pjesores i shtohen mbaresat:³⁴⁹ *-sha*, *-sh*, *-t*; *-shmi* (*-shna*), *-shi*, *-shin*; si *dal-sha*, *dal-sh*, *da:l-t*; *dal-shmi* (*-shna*), *dal-shi*, *dal-shin*. Kohën e tashme të dëshirores në këtë mënyrë e formojnë edhe foljet *vras* - *vrafsha*, *pres* - *prefsha*, *njoh* - *njofsha*; si dhe pak folje të parregullta, si *vâi* (vi), që në dëshirore bën: *ardhsha*, *ardhsh*, *ardht*; *ardhshmi* ose *ardhshna*; *ardhshi*, *ardhshin*.

79. Si në gjuhën letrare, po ashtu edhe në të folmen popullore te folja ndihmëse *kam* në dëshirore, kur [t]-ja gjendet në kontakt të drejtpërdrejtë me [sh]-në, shkrihet në [ç], si *patsha* > *paça*, *patsh* > *paç*, *pa:st*; *patshmi* > *paçmi*, *patshi* > *paçi*, *patshin* > *paçin*. Në këtë të folme, folja ndihmëse *jam* në dëshirore përdoret në këto forma:

I. kofsha	I. kofshmi, kofshna
II. kofsh	II. kofshi
III. ko:ft	III. kofshin

³⁴⁵ Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I dhe II), Prishtinë, 1980, f. 200.

³⁴⁶ Vepër e cituar, f. 313.

³⁴⁷ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), Tiranë, 1995, f. 329.

³⁴⁸ Bashkëtingëllorja buzore-dhëmbore /-f-/ te foljet e zgjedhimit të parë të cilat mbarojnë në zanore, sipas shumë gjuhëtarëve është përftuar nga bashkëtingëllorja e pazëshme epentetike /-v-/ para bashkëtingëllores së pazëshme /-sh-/: *puno-v-a* > *punovsha* > *punofsha*, *shko-v-a* > *shkovsha* > *shkofsha* etj.

³⁴⁹ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 338; Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997, f. 176.

80. Një pjesë e foljeve në dëshirore që mbarojnë me temë në /-sh/, si *çe:sh*, *mu:sh*, *nxhe:sh*, me të shtuar të mbaresës foljore të dëshirores për vetën e parë dhe të dytë në njëjës dhe shumës krijojnë geminatën /shsh/. Për shembull: në njëjës, veta I: *çeshsha*, veta II: *çeshsh* (veta III: *çesht*); në shumës, veta I: *çeshshmi*, veta II: *çeshshi* (veta III: *çeshin*).

81. Forma joveprore formohen kur para formës veprare të foljes përdoret pjesëza **u**, si *U bafsh qak me mekërr!*; *U shnoshsh sa ma shpejt!*; *U rrâitsh me ba:b e me na:n!*; *U kthefsh sa ma shpejt!*

82. Format foljore **të së kryerës** së dëshirores ndërtohen në mënyrë të njëjtë si në gjuhën letrare. Pra, forma veprare formohet me kohën e tashme të foljes ndihmëse *kam* në dëshirore (paça) dhe pjesoren e foljes (punâu, puna:). Forma joveprore formohet me foljen ndihmëse *jam* + pjesoren. Për shembull:

<i>forma veprare (aktive)</i>		<i>forma joveprore (pasive)</i>	
paça a:rdh	paçmi a:rdh	kofsha la:	kofshmi la:
paç a:rdh	paçi a:rdh	kofsh la:	kofshi la:
pa:st a:rdh	paçin a:rdh	ko:ft la:	kofshin la:

3.5.5. MËNYRA HABITORE

83. Habitorja (admirativi) është mënyrë e veçantë në gjuhën shqipe. Sipas ndërtimit të kësaj mënyre, gjuha shqipe dallon nga të gjitha gjuhët e tjera indoevropiane. Sipas modalitetit, kjo mënyrë është e përafërt me mënyrën dëftore, sepse shpreh një veprim të kryer ose është duke e kryer në formë habie.³⁵⁰ Me fjalë tjera, habitorja përdoret për të shprehur habi për ndonjë ngjarje të papritur. Kur folësi shpreh habi për moskryerjen e veprimit në të kaluarën ose në momentin kur flet, atëherë formave të habitores ju paraprijnë pjesëzat *s'* ose *nuk*.³⁵¹

84. Në gjuhën standarde ekziston një formë foljore për kohën e tashme dhe tri forma foljore për të shprehur habi në të kaluarën: të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën. Në të folmen e Karadakut mënyra habitore ka vetëm kohën e tashme dhe të kryerën.

85. Kjo mënyrë e foljes ka formë sintetike, aglutinative dhe formohet nga tema e pjesores së foljes themelore + folja ndihmëse *kam* në kohën e tashme e formës veprare. Për shembull, në Karadak kemi:

<i>punoj</i>	<i>dal</i>	<i>mbâill</i>
un punâu-kam, -kna	dil-kam, -kna	mbâill-kam, -kna
tâi punâu-ke	dil-ke	mbâill-ke
aj punâu-ka	dil-ka	mbâill-ka
na punâu-kmi, -kna	dil-kmi, -kna	mbâill-kmi, -kna
ju punâu-kni	dil-kni	mbâill-kni
ata punâu-kan	dil-kan	mbâill-kan

³⁵⁰ Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I dhe II), Prishtinë, 1980, f. 324.

³⁵¹ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), ... , f. 318.

86. Interes të posaçëm për dialektologjinë e gjuhës shqipe paraqesin format e habitores së foljeve *kam* dhe *jam*. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, folja ndihmëse *kam* në habitore në kohën e tashme përdoret në forma të ndryshme, si:

<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>
Ûn paskëm, pahna, paskna, pasna	na paskna, pahna, paskmi, passhmi
tâi paske, pahe, passhe	ju paskni, paski, pahi, passhni
aj paska, paha	ata paskan, pahan

87. Në vazhdim po japim një larushi formash të foljes ndihmëse *kam* në mënyrën habitore nëpër të folmet e fshatrave të këtij rajoni:

- në Luboten: *paskëm, paske, paska; paskna, pahi, pahan;*
- në Brezë e Malinë: *pahna, pahe, paha; pahna, pahi, paha;*
- në Straçincë e Bllacë: *paskëm, paske, paska; paskna, paski, paskan;*
- në Grushinë: *pasna, paske, paska; paskna - paskmi, paskni - paski, paskan;*
- në Tanushë: *pasna, paske, paska; paskmi, paski, paskan;*
- në Orllancë e Mojançë: *paskna, passhe, paska; passhmi, passhni, paskan.*

88. Në forma të ndryshme, gjithashtu e hasim edhe foljen ndihmëse *jam* në kohën e tashme. Në bazë të materialit të mbledhur, zgjedhimi i kësaj foljeje në disa fshatra del kështu:

- Në të folmen e fshatit Straçincë: *kanëm, kane, kana; kanmi, kanni, kanën.*
- Në fshatin Grushinë: *kanam, kane, kana; kenna, kanni, kanan.*
- Në fshatin Bllacë: *kenem, kene, kana; kenmi, kenni, kanan.*
- Në fshatrat Mojançë e Orllancë: *kanam, kane, kana; kenmi, kenni, kanan.*
- Në fshatin Tanushë: *kokna, koke, koka; kokmi, kokni, kokan* (ngjashëm me të folmet e Kosovës).

89. Për këtë larushi formash (shumica forma të njëjta, por me një përbërje të ndryshme fonematike), mund të jepet një pasqyrë e përgjithshme e të gjitha formave të mundshme të kohës së tashme të habitores, që dëgjohej në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit:

<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>
un kanëm, kanam, kenem, kokna	na kanmi, kenna, kenmi, kokmi
tâi kane, kene, koke	ju kanni, kenni, kokni
aj kana, koka	ata kanën, kanan, kokan

90. E kryera e habitores në këtë të folme, si dhe në gjuhën standarde ndërtohet me foljen ndihmëse *kam* në kohën e tashme të habitores + pjesoren e foljes, sipas tipit: *paskëm punûu*. Duke pasur parasysh larminë e formave të foljes ndihmëse *kam*, rrjedhimisht në këtë areal gjuhësor na dalin një mori formash për të kryerën e mënyrës habitore:

- | | | |
|-----------------------------------|---|-------------------------------|
| un paskëm, pahna, paskna, pasna | + | la:, a:rdh, shku:, da:l, msa: |
| tâi paske, pahe | + | la:, a:rdh, shku:, da:l, msa: |
| aj paska, paha | + | la:, a:rdh, shku:, da:l, msa: |
| na paskna, pahna, paskmi, passhmi | + | la:, a:rdh, shku:, da:l, msa: |

ju paskni, paski, pahi, passhni + la:, a:rdh, shku:, da:l, msa:
ata paskan, pahan + la:, a:rdh, shku:, da:l, msa:

91. Forma joveprorë formohet me pjesëzën **u**, e cila përdoret para foljes, sipas gjedhës: *u gjazmokam, u pakam, u nxekam, u forcokam, u msokam, u shoshkam*.

MËNYRAT E PASHTJELLUARA TË FOLJES

92. Veç gjashtë mënyrave të shtjelluara (dëftore, lidhore, kushtore, habitore, dëshirore, urdhërore), gjuha shqipe ka edhe tri forma foljore të pashtjelluara (të pandryshueshme, implicite). Mënyra të pashtjelluara të foljes janë: pjesorja a participi (shpreh një veprim në formë tipari dhe zotëron tiparet e foljes dhe të mbiemrit), paskajorja a infinitivi (shpreh emërtim të veprimit dhe zotëron kryesisht tiparet e foljes dhe emrit) dhe përcjellorja a gerundivi (shpreh një veprim dytësor pranë një veprimi kryesor dhe zotëron kryesisht tiparet e foljes dhe të ndajfoljes). Mënyrat e tilla foljore nuk kanë vetë, numër dhe kohë. Këto mënyra i ka edhe e folmja e Karadakut të Shkupit.

3.5.6. PJESORJA

93. Tema e pjesores (participit) në të shumtën e rasteve përkon me temën e së kryerës së thjeshtë ose me temën e kohës së tashme të dëftores, por jo gjithmonë.³⁵² Në gjuhën standarde shqipe, pjesorja përdoret në bashkëvajtje me foljet ndihmëse *kam* dhe *jam*, duke qëndruar gjithnjë pas tyre: (jam) larë, (kam) larë dhe me mbiemra (në këtë rast ato, duke u përdorur zakonisht në kuptim figurativ, janë larguar kuptimisht, marrin nyjat e përparme i, e të, së dhe mund të shkallëzohen), për shembull: i larë, i zgjuar.

94. Në këtë të folme pjesorja (participi) që ka vetëm një formë të ngurosur përdoret si folje. Nga pjesorja përftohen mbiemra prejpjesorë (mbiemra prejfoljorë) me ndihmën e paranyzimit dhe prapashtesimit.

95. *Mbiemrat prejpjesorë*. – Edhe në këtë izoglosë gjuhësore nga pjesorja formohen mbiemra prejpjesorë; duke u dalluar mbiemri prejpjesor nga pjesorja përkatëse me nyjën e përparme dhe me prapashtesat **-m** (për gj. m.) dhe **-me** (për gj. f.). P.sh.: nga cilado pjesore, po marrim pjesoren *la*: 'larë' formohet mbiemri prejpjesor: në njëjës *i la:m* 'i larë' (për gj. m), *e lame* 'e larë' (për gj. f.); në shumës *t'la:m* (për gj. m), *t'lame* (për gj. f.) 'të larë'.

96. Pjesorja në gjuhën shqipe, sidomos në variantin dialektor, më tepër përdoret për të sajuar forma kohore analitike apo të përbëra sesa si formë e veçantë. Edhe në të folmen e Karadakut të Shkupit, si edhe në të folmet e tjera, pjesoren e gjejmë shumë rrallë të përdorur më vete, por ajo shfaqet kryesisht si fjalë e ndajfoljezuar, si e xhetëm *rat* < e gjetëm të shtrirë; mos rrâi *hunxhët* xhith ditën < mos rri ulur gjithë ditën etj.³⁵³ Me pjesoren e foljes formohen kohët e

³⁵² Prof. dr. Fatmir Agalliu, dr. Engjëll Angoni, prof. Shaban Demiraj, prof. dr. Ali Dhrimo, as. prof. dr. Enver Hysa, prof. dr. Emil Lafe, prof. dr. Ethem Likaj; *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), Tiranë, 1995, f. 299.

³⁵³ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 346.

përbëra, si perfekt - *kam punâu* 'kam punuar', pluskuamperfekti - *kishna punâu* 'kisha punuar'; pluskvamperfekt II - *pata punâu* 'pata punuar' etj. Me pjesoren, po kështu ndërtohet edhe paskajorja gege: pjesëza *me* + pjesorja e foljes, si *me punâu*, *me ngra:n*, *me he:c*, *me da:l* ...; si dhe përcjellorja: *tu punau*, *tu ngran*, *tu he:c*, *tu da:l* ... (duke punuar, ngrënë, ecur, dalë)...

97. Lidhur me format e pjesores, e folmja e Karadakut të Shkupit, si edhe të gjitha të folmet e tjera të gegërishtes (krahasuar me format e shqipes standarde dhe të toskërishtes) ka pjesore të cunguar, të reduktuar, të shkurtuar, pa prapashtesa.³⁵⁴ Siç dihet, pjesorja në shqipen standarde ka forma të larmishme, meqë grupe të veçanta foljesh kanë edhe prapashtesa të veçanta. Formantet, që shërbejnë për të formuar formën e pjesores së foljes në shqipen standarde janë: -rë / -r, -ur, -ë i -në.³⁵⁵

Lidhur me prapashtesat e pjesores, e folmja jonë nuk paraqet ndonjë veçanti nga të folmet e tjera të gegërishtes qendrore, as edhe nga tipi i përgjithshëm gegë. Në këtë kuptim, rënia e tingujve fundorë të pjesoret (rënia e prapashtesave) ka përfunduar pothuajse në të gjitha të folmet gege.

98. Për të fituar një pasqyrë të përgjithshme për format e pjesores në këtë të folme, do të përpiqemi t'i paraqesim gjërat më të rëndësishme në formë të përmbledhur:

a) Foljet që dalin me temë në sonantet (në të tashmen të dëftores dhe që formën e të kryerës së thjeshtë e bëjnë me apofoni) -l, -ll, -rr **nuk kanë prapashtesa**. P.sh.: (kam) *da:l*, *ve:l*, *se:ll*, *pe:ll*, *me:ll*, *ve:ll*, *ma:rr*, *ko:rr* ³⁵⁶ etj.

b) Pjesa dërmuese e foljeve të zgjedhimit të dytë (që në shqipen standarde dalin me prapashtesën e pjesores -ur (hapur, matur, nisur, pjekur, folur, falur, ardhur, fjetur ...) në këtë të folme dalin pa prapashtesa, përkatësisht edhe në pjesore mbarojnë me bashkëtingëllore. Krahaso format e kësaj të folmeje me ato të shqipes standarde *ha:p* 'hapur', *ma:t* 'matur', *nâis* 'nisur', *pe:k* 'pjekur', *fo:l* 'folur', *fa:l* 'falur', *a:rdh* 'ardhur'; *fje:t*, *fle:t* dhe *fe:t* 'fjetur' etj.

c) Foljet që në shqipen standarde kanë prapashtesat -rë / -r, në të folmen tonë, i dëgjojmë **pa prapashtesë**. Pjesoret e këtij grupi mbarojnë me zanore të gjatë ose me diftong, si p.sh.: (kam) *la:* 'larë', *pre:* 'prerë', *tha:* 'tharë', *li:* 'lyer', *gje:* 'blerë', *pa:* 'parë', *pâi* 'pirë', *fshâi* 'fshirë'; *punâu*, *punu:*, *puna* 'punuar'; *mcâu*, *msu:*, *mca:* 'mësuar'; *shkrâu*, *shkru:*, *shkra:* 'shkruar' etj.

ç) Foljet që në shqipen standarde pjesoren e bëjnë prapashtesën -në, në këtë të folme dalin me -n.³⁵⁷ Krahaso pjesoret: *dha:n* 'dhënë', *tha:n* 'thënë', *la:n* 'lënë', *ngra:n* 'ngrënë', *ka:n* 'qenë', *za:n*, *përza:n* 'zënë', *përzënë* etj.³⁵⁸

d) Në krahasim me formën bazë a përfaqësuese të foljes (veta e parë njëjës, koha e tashme, mënyra dëftore), një sasi e caktuar foljesh pjesoren e formojnë me prapashtesën -t. Krahaso: (un) *di* - (kam) *dit* '(unë) di – kam ditur'; *pagjuj* - *pagjujt* 'paguaj - paguar', *ru:j* – *ru:jt* 'ruaj - ruajtur'; *mbaj*, *maj* - *mbajt*, *majt* 'mbaj - mbajtur', *lu:j* – *lu:jt* 'luaj - luajtur', *bu:j* – *bu:jt* 'buj - bujtur' etj. Me -t formën e pjesores e bëjnë edhe një numër i kufizuar foljesh, të cilat kemi ndërrimin e s / t: *shes* – *shâit*, *bërtas* – *bërtâit*, *çes* – *çit*, *pres* – *prâit* etj., si në të folmen e

³⁵⁴ Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptere*, Tiranë, 1988, f. 96

³⁵⁵ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), ... , f. 300.

³⁵⁶ Format e tilla të pjesores gjithnjë shqiptohen me zanore fundore të gjatë për shkak rënies së /ë/-së fundore që ka shkaktur zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse. Krahaso: në shqipen standarde dhe në toskërishte pjesorja e këtyre foljeve bën me fundoren e patheksuar -ë: *dalë*, *mbjellë*, *marrë*.

³⁵⁷ Edhe kjo prapashtesë në të folmen e Karadakut, si dhe në të gjitha të folmet gege na del pa -ë fundore, për shkak të rënies së saj, që ka lënë gjurmë në zgjatjen e zanores që është ruajtur e që gjendet para saj.

³⁵⁸ Në vend të zanores /ë/ të theksuar, në të folmet toske, në të folmen tonë, si dhe në gjithë Gegërinë kemi hundoren e shqipes së moçme, që e ka ruajtur mbarë gegëgishtja /ã/.

Dervenit.³⁵⁹

99. Nëse para pjesores përdoret pjesëza **pa** formohet një formë analitike e pandryshueshme mohuese, e tipit: *pa ma:rr* 'pa marrë', *pa me:ll* 'pa mbjellë', *pa he:c* 'pa ecur', *pa mca:* 'pa mësuar', *pa ma:t* 'pa matur', *pa shâit* 'pa shitur', *pa prâit* 'pa pritur' etj., me të cilën zakonisht tregohet moskryerja e ndonjë veprimi në të kaluarën ose në të ardhmen. Përdoret për të formuar periudha me fjali të nënrenditura kohore, qëllimore ose periudha me fjali të tjera: *U nis pa da:l dilli. Pa ardh aj, ene na nuk shko:jm.*

3.5.7. PASKAJORJA

100. Paskajorja (infinitivi) është mënyrë e pashtjelluar (e pandryshueshme, e ngurosur) e foljes që ka përbërje analitike.

Forma e pashtjelluar analitike e paskajore së tipit me + pjesore ka përhapje mjaft të gjerë në shqipen e folur sot. Sipas disa dijetarëve (Gabinski, Sh. Demiraj, S. Riza, B. Bokshi etj.) ajo kishte shtrirje në mbarë shqipen e lashtë, mirëpo tashti ajo ka mbetur si tipar dalluese i dialektit të gegërishtes, por nuk është formë e panjohur edhe për disa të folme të toskërishtes.³⁶⁰

101. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit **kemi dy forma** të paskajores: **një paskajore geqe dhe një paskajore toske**, që formohen me:

a) pjesëzën **me + pjesoren: me shku:** (që quhet edhe pjesore geqe, e që nuk e gjejmë në të folmet toske) dhe

b) **për t' + particip: për t'shku:** (< për të shkuar) (karakteristik për të folmet toske dhe që nuk e gjejmë në të folmet e nëndialektit të gegërishtes veriore). Në këtë të folme, pjesorja gjithnjë është e cinguar.

Në të folmen tonë, në ndërtime e funksione të ndryshme sintaksore përdoren paralelisht:

a) **paskajorja e mbarë gegërishtes** (me punu:);

b) **paskajorja toske** (për t'punâu), dhe

c) **lidhorja** (t'punoje).

102. Paskajorja përdoret kryesisht në fjalitë e nënrenditura qëllimore, kushtore, krahasore etj. P.sh.:

Kimi a:rdh me punâu // Kimi ardh për t'punâu //

Ka shku: me livru: // Ka shku: për t'larâu //

Hajde me nejt sante // Hajde t'rrâim sante //

Shkova n'Shkup me ble ni kusai // Shkova n'Shkup për t'gje ni kusâi //

Kesh n'mullâi me blu // Kesh n'mullâi për t'gju: //

Ra me fje:t // Ra për t'fe:t //

103. Infinitivi, gjithashtu, përdoret për të formuar kohën e ardhme (me foljen ndihmëse kam + paskajorja), sipas tipit: *Nesër kam me shku: te daja - Nesër kam për t'shku: te daja //* *N've:sht kam me mell gru:n - N'vesht kam për t'mell gru:n //* *Kimi me ba: shum ishim për xha: - Kimi për t'ba: shûam ishim për xha: //*

³⁵⁹ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 348.

³⁶⁰ Nuhi Veselaj, *Paskajorja – çështje e shqipes standarde*, Prishtinë, 2000, f. 21.

3.5.8. PËRCJELLORJA

104. Përcjellorja (gerundivi) është formë e pashtjelluar analitike që përbëhet nga *pjesorja* dhe pjesëza *tue, tu, tuj* (tu he:c, në të folmet e Veriut) dhe *duke* (duke ecur, në të folmet e Jugut). Edhe në të folmen tonë, me përcjelloren tregohen veprime që zgjasin dhe që janë duke u bërë edhe në momentin kur flasim, si: *jam tu punâu* (jam duke punuar), e ngjashme me kuptimin që shprehet nga forma analitike e mënyrës dëftore me pjesëzën *po punoj*. Krahaso: *Xhit ban? - Jam tu me:ll*, e barasvlershme (ekuivalente) me *Po melli*.

105. Përcjellorja, si në mbarë shqipen, edhe në të folmen tonë, përdoret edhe si kallëzues i fjalive të varura kohore dhe mënyrore. Në periudha të tilla, përcjellorja në krahasim me veprimin që shpreh folja themelore, mund të ketë kuptimin e kohës së tashme, të së shkuarës.³⁶¹ Për shembull: *Tu shetâit, e zateka ni shok // Kesh tu ko:rr kur erdhe tâi //*

106. Gerundivi përdoret edhe në funksione të tjera, si:

a) për të treguar **mënyrën** e kryerjes së veprimit (në funksionin e ndajfoljes së mënyrës): *Shkon tu kundâu // Hec tu gjimâu // Fol tu kesh //*; b) **shkakun**: *Tu pa keç, jam smu: // Jam lodh tu kosâit //*; c) **kohën**: *Tu lidh du:j e pash ni xharpën // Kesh tu larâu me parmen / kur trap mu thâi umi //*

Në këtë kuptim, përcjellorja në këtë të folme, si edhe në mbarë shqipen, shërben për të ndërtuar fjali të nënrenditura qëllimore, mënyrore e kohore, për të formuar kohë të përbëra të foljeve etj. Në kuadrin e këtyre funksioneve të shumanshme të përcjellores, ajo në këtë të folme ka përdorim më karakteristik e më të shpeshtë për të shprehur mënyrën e kryerjes së veprimit (ndajfolje mënyre), të tipit: *Shkon tu kcâi*.

107. Si në mbarë shqipen, edhe në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, përcjellorja ka formë të përbërë (analitike). Ajo ka pjesëzën *tu + pjesoren e foljes: tu punâu, tu punu:, tu puna:* (në shqipen standarde: *duke + particip (duke punuar)*).

108. Kur para pjesores përdoret trajta e shkurtër e përemrit vetor **e** (< atë e), në funksion të përsëritjes së kundrinës (kundrinorit të dyfishtë), si *asht tu e këndâu, jam tu e lexa:, jie tu e dasht, jan tu e kshir* etj., të barasvlershme me *po e këndon ...*, në të dëgjuar na duket sikur kemi pjesëzën e njëjtë por në formën *tue*. Megjithëkëtë, mendojmë se kjo është një përngjitje e pjesëzës *tu me trajtën e shkurtër e: tu + e = tue*, meqë përdoret vetëm në rastet kur kemi *e*-në në funksionin e përsëritjes (rimarrjes) së kundrinës.

109. Për formën joaktive (pasive) të përcjellores, para pjesores përdoret pjesëza *u*, si: *tu u la:* (duke u larë), *tu u rrâit* (duke u rritur), *tu u ngrâit* (duke u ngritur) etj. Në të folur, nga dy /u/-të e njëpasnjëshme (u + u = u:) përftohet një /u:/ e gjatë: *tu: la:, tu: rrâit, tu: ngrâit*.

PJESËT E PANDRYSHUESHME TË LIGJËRATËS

1. Të folmet popullore kanë veçori të përbashkëta si dhe dallime të caktuara edhe te pjesët pandryshueshme të ligjëratës. Dallimet kryesisht janë të natyrës fonetike dhe fonologjike, ndërsa më të rralla janë dallimet në fushën e morfologjisë e të sintaksës. Ndaj, do të përpiqemi t'i paraqesim disa tipare të veçanta të pjesëve të pandryshueshme të kësaj të folmeje, përkatësisht

³⁶¹ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, ..., f. 336.

do të përshkruajmë: ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrat.

3.6. NDAJFOLJA

2. Ndajfoljet përdoren rregullisht pranë foljeve, si dhe i plotësojnë ato: sipas vendit, kohës, mënyrës dhe sasisë. Përveç foljeve, ato mund të plotësojnë edhe mbiemrat, emrat dhe ndajfolje të tjera. Ndajfoljet merren si pjesë të pandryshueshme e ligjëratës. Megjithatë pandryshueshmëria e ndajfoljeve nuk është absolute. Për shembull, disa nga ndajfoljet e sasisë, të formuara nga mbiemrat mund të shkallëzohen.

3. Sipas kuptimit edhe në të folmen tonë kemi: 1. **ndajfolje përcaktore**: a) ndajfoljet e mënyrës, b) ndajfoljet e sasisë dhe 2. **ndajfolje rrethimore**: a) ndajfolje kohe, b) ndajfolje vendi, c) ndajfolje shkaku.³⁶²

a) Ndajfoljet e mënyrës

4. Ndajfoljet e mënyrës në këtë të folme janë të shumta. Pa bërë ndonjë klasifikim dhe analizë të mëtutjeshme, do të japim disa ndajfolje mënyre: *mâir, keç, amël, idht, nxeft, ftoft, vokt thart, xhelpt, xhegs, trash, holl, dre:t, shtremt, gat, shkurt, shpejt, kadale, kshtâu, ashtâu (kshtâuene, ashtâuena), fell, plitko, javash* etj.

Vërejtje: Shumica e këtyre ndajfoljeve kanë edhe forma përkatëse edhe si mbiemra nëse para tyre përdoret nyja shquese i (për gjininë mashkullore njëjës), e (për gjininë femërore njëjës) dhe t' (< të) për të dy gjinitë në shumës. Për shembull: *i mâir - e mâir, t'mâir - t'mâira; i ke:ç - e keçe, t'kçi - t'kçija; i amël - e amël, t'amël - t'amla*. Përveç me nyje, fjalëforma e ndajfoljeve nga mbiemri në këtë të folme dallohet edhe nga gjatësia e zanores së theksuar, meqë zanorja të ndajfoljet është më e shkurtër sesa te e njëjta formë e mbiemrit. Krahaso: *nalt - i na:lt, gat - i ga:t (gjat - i gja:t), shkurt - i shku:rt, fort - i fo:rt, trash - i tra:sh, holl - i ho:ll, dret - i dre:t* etj.

5. Ndajfoljet me prapashtesat *-shëm*, të tipit *fuqishëm*, janë të shumta në gjuhën standarde shqipe. Megjithatë, këto forma janë relativisht të reja, ashtu që rrallë takohen në shqipen dialektore.³⁶³ Gjatë analizës së materialit dialektor me të cilin disponojmë gjetëm 4-5 ndajfolje mënyre, me të cilat përcaktohet gjendja shpirtërore dhe psikike e atij që e kryen veprimin: *idhnâushëm, gzâushëm, mendâushëm, habitshëm, i knâushëm* 'për njeri që ka lexuar shumë, që është i shkolluar' etj., si në fjalitë: *Ramizi rrâika dishka idhnâushëm (mendâushëm). Aj asht i knâushëm*.

6. Edhe në këtë të folme kemi shprehje ndajfoljore, si për shembull: *lara-lara, copa-copa, grima-grima, dur-dur, mâiza-mâiza* etj.

7. Ndajfoljet e mënyrës me mbaresën *-thi* të tipit *fluturimthi, kalimthi* nuk janë të njohura në këtë të folme. Funksionin e tyre e kryejnë, si në të folmen shqipe të rajonit të Karshiakës,³⁶⁴ format me përcjellore: *tu fluturu, tu fjarâu; tu kapërcâi* etj.

8. Një sasi e vogël e ndajfoljeve në shqipen standarde formohen me prapashtesën *-as (-azi)*, si *barkas, majtas, fshehuras* ose *fshehurazi* etj., ato në këtë të folme shqiptohen me metatezë

³⁶² Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, 1995, f. 359-360.

³⁶³ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 357.

³⁶⁴ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997, f. 185.

të prapashtesës -as > -sa ose -za: *barkza, tinëz* ose *tinza, gjunjza* etj.

b) Ndajfoljet e sasisë

9. Këto ndajfolje kryesisht përcaktojnë foljen, duke shprehur intensitetin a shkallën e veprimit. Përveç foljes, ato mund të përcaktojnë edhe foljet emërore, mbiemrat ose ndajfolje të tjera.³⁶⁵ Ndajfoljet e sasisë zakonisht i përgjigjen pyetjes *sa?*

10. Në këtë të folme ndajfolje sasive mjaft të përdorshme janë: *shâum, tepër, fort, boll, pak, aç, çaç, hala* etj. Ka edhe disa shprehje ndajfoljore, gjegjësisht shkallëzim ndajfoljesh: *shâum ma tepër, ma shâum, shâum ma shâum, ma pak, shâum ma pak, di he:r, trâi he:r*

c) Ndajfoljet e kohës

11. Në të folmen e Karadakut të Shkupit si ndajfolje të kohës më së shpeshti përdoren: *sod, dje, pardje; nesër, masnesër; vjet, parvjet, sivjet, moti, n'mot, herët, vo:n, shtâi, tash, përhe:r, përdit, najher, kaniher, doniher, at'her, shpesh, rra:ll, dikur, sabah, drek, aksham, pranverës, verës, vjeshtës, dimnit, ditën, natën* etj.

12. Ka edhe disa shprehje ndajfoljore, si: *dit për dit, nat për nat, sabah për sabah, vet për vet, dimën për dimën, shtâi për shtâi, ati për ati, prej shtâit*³⁶⁶ etj.

ç) Ndajfoljet e vendit

13. Ndajfoljet e vendit tregojnë vendin ku kryet një veprim a ku ndodh një ngjarje, ose ku gjendet diçka në bazë të pikës së orientuar. Më të shpeshta në këtë të folme janë: *ngat, gat, nat; k'tau, kta:, ati, largj, kurkun, përpara, mbas, mas, nalt, ne:r, po:sht, n't'shmajt, n't'xhatht, mbâi, sipri; mrena, mbrenda; jasht, n'midis, n'fun, n'çosh, kudo* etj.

14. Si ndajfolje të vendit shërbejnë edhe emrat që emërtojnë vend, të përdorura në rasën kallëzore me parafjalën **n'** (< në), si dhe në rrjedhore pa parafjalë, të tipit *n'a:r, n'fâush, n'shpâi, n'shkole, n'xhamâi, n'Shkup*; emrat në rasën rrjedhore: *maleve, gjeshkve, udhës, arave, livadheve, kullosave* etj.

15. Gjithashtu, si ndajfolje vendi shërben edhe ndonjë emër i shquar në njëjës ose në shumës, nëse para saj përdoret parafjala **te**, të tipit: *te ara, te shpâia, te stani, te xhamâia, te shkolla, te vorret* etj.: *Zatetmi te shkolla. Po shkoj te vorret.*

d) Ndajfoljet e shkakut

16. Edhe në të folmen tonë ka një numër të konsiderueshëm ndajfoljesh shkakut. Të tilla janë: *se, pse, se pse, për shka, se shka, xhit, se xhit*, si dhe disa ndajfolje me prejardhje të huaj. Për shembull: *Kish ardh me e lip plugin se po ju dashke. A po ven me mu se po shkoj n'Shkup.*

³⁶⁵ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), Tiranë, 1995, f. 362.

³⁶⁶ Shtâi < shti < tashti (tani)

Nuk e di pse m'tha ashtâu. Nuk e di pse s'po ven me m'nimu ? Se pse asht ashtâu, zoti e di. Kallxom për shka je idhnâu? ili Kallxom xhit je idhnâu? Nuk e di se xhit ki me mu:?. Se shka do t'dale nuk e di. Se xhit do t'dale nuk e di etj.

17. **Ndajfolje shkaku me prejardhje të huaj.** – Një pjesë e ndajfoljeve në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit janë të huazuara nga gjuhë të tjera. Shumë sosh janë me prejardhje orientale dhe sllave. Për shembull: *stallno* (gjithnjë), *okolla*, *okoll m'okoll* (rreth, rreth e përçark), *pogreshno*, *dallash* (gabimisht), *stallno*, *dajma*, *ni dajm* (rregullisht); *apet*, *tekra:r* (përsëri), *kollaj* (leht), *bajagi* (mjaft), *kallaballak*, *gu:zhv* (shumë, rrëmujë), *privremeno* (përkohësisht) etj.

18. **Shkallët e ndajfoljeve.** - Si mbiemrat, ashtu edhe një sasi e konsiderueshme ndajfoljesh mund të përdoren në shkallën pohore, krahasore dhe sipërore. Zakonisht shkallëzohen ndajfoljet e mënyrës, të vendit dhe të kohës. Për shembull: *mâir - ma mâir – shâum mâir*, *keç - ma keç – shâum keç*, *shpejt - ma shpejt – shâum shpejt*; *ngat - ma ngat – shâum ngat*, *largj - ma largj – shâum largj*; *herët - ma herët – shâum herët*, *vo:n - ma vo:n – shâum vo:n* etj.

3.7. PARAFJALA

19. Në përgjithësi, parafjalët në të folmen tonë kanë të njëjtin funksion si dhe në shqipen standarde.³⁶⁷ Por, nënkuptohet se shumica prej tyre dallohen në përbërjen tingullore nga format e shqipes standarde. Parafjalët, siç dihet, dallohen sipas prejardhjes (fjalë të parme dhe të prejardhura: grupi i fundit në parafjalë ndajfoljore dhe parafjalë emërore); sipas strukturës morfologjike: fjalë të thjeshta, të përbëra dhe shprehje parafjalore; sipas karakterit sintaksor dhe sipas funksionit kryesor etj.³⁶⁸

20. Parafjalë më të shpeshta në këtë të folme janë: *për*, *pi*, *pej* (< prej), *ka* (< nga); *me*, *n'* (< në); *m'* (< më); *për n'* (< për në); *përmi:*, *mbâi*, *përmbâi* (< mbi, përmbi); *nër*, *ndër*; *pa*, *te*, *nëpër*; *ma:s*, *mbas*, *përmas*, *përmbas*, *simas*, *simbas* (< sipas); *para*, *përpara*; *ngat*, *at*, *mrena*, *mrenda*; *larg*, *largj*; *midis*, *n'midis*; *mata:n*, *natan*, *karshi*; *saipri*, *përsaipri*; *okolla*, *okoll m'okoll*; *tej e përtej*; *knej*; *anej* etj.

21. Sipas funksionit sintaksor, parafjalët e kësaj të folmeje nuk dallohen nga funksioni që kanë në shqipen standarde. Ato përdoren para emrave, përemrave vetorë ose fjalëve të tjera të emëruara në katër rase: emërore, gjinore, kallëzore dhe rrjedhore (përveç në dhanore) dhe tregojnë marrëdhënie të llojllojshme.

3.8. LIDHËZA

³⁶⁷ Parafjalët, siç dihet, janë pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që shprehin marrëdhënie sintaksore varësie midis grupeve të fjalëve dhe togfjalëshave. Parafjalët qëndrojnë para emrave, foljeve, mbiemrave, përemrave, numërorëve ose ndajfoljeve, por më së shpeshti para emrave dhe foljeve.

³⁶⁸ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), Tiranë, 1995, f. 381-396.

22. Për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme për lidhëzat në këtë të folme, do të mbështetemi në funksionin e tyre. Ato mund të jenë lidhëza bashkërenditëse dhe nënrenditëse.

23. **Lidhëzat bashkërenditëse.** – Këto lidhëza lidhin fjalë ose fjali të së njëjtës natyrë ose të të njëjtit funksion. Do të paraqesim ato që kanë përdorim më të shpeshtë dhe për të cilat mendojmë se kanë vlerë më të madhe dialektore.

a) **Lidhëza shtuese** janë: *e, dhe, ene < edhe > ere*. Ka edhe lidhëza që përsëriten: *ene ... ene < edhe ... edhe > ere ... ere, hem ... hem, as .. as, si ... ashtâu edhe ...* Është e rëndësishme të thuhet se lidhëza *edhe* në të folme të caktuara të këtij areali gjuhësor përdoret me shndërrimin e [dh] > [n] ose [r]. Kështu, në të folmen e f. Tanushë, Mojançë e Orllancë kemi formën *edhe*. Në të folmet e f. Luboten, Bllacë, Straçincë dhe Brezë rregullisht dëgjohet *ene*, derisa në f. Grushinë *ere*.

Në grupin e lidhëzave disa gjuhë dallojnë edhe një grup më vete, që i quajmë *lidhëza të shkallëzimit*.³⁶⁹ Në gramatikat e shqipes këtë grup lidhëzash e inkuadrojnë në grupin e lidhëzave shtuese. Të tilla në të folmen e Karadakut të Shkupt janë: *jo veç ç'i ... po ene ..., jo veç ç'i ... po as..., leje ç'i nuk ... po ene nuk* Më e rëndësishmja e këtyre lloj lidhëzave është ajo që fjala a fjalja e dytë vihet në pah më shumë se e para. Pra, theksi logjik bie mbi elementin e dytë të fjalisë a të periudhës.

Në planin historik, lidhëzat e shkallëzimit janë më të reja se lidhëzat e tjera bashkërenditëse, por këto sot kanë përdorim të gjerë.³⁷⁰ Do të japim disa shembuj nga e folmja jonë: *Aj jo veç ç'i punon, po ene mcon. Jo veç ç'i nuk di, po as nuk ngjon. Leje ç'i nuk fol, po ene hik.*

b) **Lidhëza veçuese** në këtë të folme janë: *a, a ... a, ha: ... ha:, ja ... ja, n'dash ... n'dash*. P.sh.: *A po mco:n a po ven me puna: (punâu). A po punon mâir a po shkon n'shpâi. Ha: u bane merak ha: su bane, nisoj e ki. Ja luj ja mo luj! N'dash hajde n'dash shko!*

c) **Lidhëza kundërshtore** janë: *kurse, po, veç, veçse, ama, mâirpo*. Për shembull: *Ditën punon, kurse natën pushon. Krejt erdhën, po Ramizi nuk erdh. U sosën kampâirat, veç pak kan me:t. Shko, veçse mos u gjut!. Mâir asht, ama ka mund ene ma mâir. Tu larâu m'u thâi parmenda, mâirpo e kishna hazër ene ni çetër.*

ç) **Lidhëza përmbyllëse** janë: *për kit, për at; për ata:, për çata:, dometha:n, del se ...; si* në periudhat: *Aj asht idhnâu, për kit edhe nuk ka a:rdh. Asht tu kosit, për at asht çu herët. Ki puna:u shu:m, për ata: (për çata:) je lo:dh. Kjo pu:n, dometha:n u bitis. Prej ksaj del se une i pahna fajet.*

24. **Lidhëzat nënrenditëse.** – Këto janë të shumta. Vlen të theksohet se e njëjta lidhëz sipas formës mund të ketë funksione të ndryshme. Ndahen në: **filluese**: *se, ç'i; vendore*: *ku, te, ka, teri; kudo, kudo ç'i; pi, pej, pi ku, pej ku; pi ka, pej ka; kohore*: *kur, sa, si, masi, para se; terisa; kurdo ç'i; sa here ç'i; shkakore*: *se, si, masi; qëllimore*: *ç'i, se, për t', për me; krahasore-mënyrore*: *sa; se, sesa; si, sikurse, ashtâu çish, ashtâu ç'i; kushtore*: *sikur; po, n'koft se; rrjedhimore*: *kshtu ç'i, sa ç'i; lejore*: *ene pse, sado ç'i, ene po.*

3.9. PJEZËZA

³⁶⁹ Në maqedonishte lidhëzat e shkallëzimit i llogarisin si grup më vete e nuk i fusin në grupin e lidhëzave shtuese. Ato i quajmë stepenuvački svrznici (степенувачки сврзници).

³⁷⁰ Vepra e cit., f. 407.

25. Në shqipen standarde ka shumë pjesëza, të cilat nuk i dëgjojmë në të folmen e Karadakut të Shkupit. Disa pjesëza të mbarë shqipes, në të folmen tonë janë hequr nga përdorimi, duke i zëvendësuar ato me fjalë të huazuara nga gjuhët e huaja, sidomos nga turqishtja dhe gjuhët në takim shumëshekullor (maqedonishtja e serbishtja).

26. Për pjesëza disa gjuhëtarë i konsiderojnë edhe jo pak formante me prejardhje fjalësh të ndryshueshme, të cilat i kanë humbur vetitë leksiko-gramatikore dhe që moti kanë kaluar në grupin e mjeteve ndihmëse, jokuptimplota, në fjalë shërbyese të desemantizuara, që shërbejnë për formimin e kategorive të caktuara gramatikore.³⁷¹

27. Duke pranuar këtë, në të folmen tonë kemi dy lloj pjesëzash: 1. pjesëza me karakter gramatikor dhe 2. pjesëza me karakter modal. Pjesëzat e nëngrupit të parë shërbejnë për formimin e formave të përbëra foljore (formave analitike). Pjesëza të tilla në këtë të folme janë: **t'** (< të), që përdoret para lidhores, të tipit *du t'shkoj*. Me pjesëzën **me** formohet paskajorja e gegërishtes: *du me shku*. Pjesëza **do** shërben për formimin e kohës së ardhme dhe për mënyrën kushtore: *do t'punoj* dhe *do t'punojshna*. Pjesëza **për** përdoret para lidhores dhe paskajores gege: *për t'ngra:n*, *për me hangër*. Pjesëza **po** shërben për formimin e formës sintetike të foljeve në kohën e tashme, si *punoj - po punoj* (jam tu punâu). Fjalëza **tu** para pjesores hy në funksion për formimin e përcjellores: *tu punâu*. Pjesëza **u** për formimin e formave foljore pasive: *krahaso laj - u lava*, *laj-u*. Fjalëza **ma** (< më) shërben për formimin e shkallës krahasore të mbiemrat dhe ndajfoljet: *i madh - ma i madh*, *nalt - ma nalt*.

28. Pjesëza më karakteristike për shprehjen e nuancave kuptimore, për të përforcuar, për të mohuar ose pohuar diçka etj., në të folmen tonë janë:

- Për sforcimin e kuptimit: *de, be, barem, bash, bile, pale, mu*. P.sh.: *Hajde, de, pse s'po ven !. O bir, be, jam i smu:t.. Ti, barem, hajde ma shpesh !. Nuk e kam dit, bash, ç'i asht ashtâu. I kam than, bile, se niher nuk e ngushtoj për vade. Ta shofim se, pale, ku do t'dale. Ka rrâit mu atâi.*

- Pjesëza pohuese: *po*, si në fjalitë: *A e korre grunin ? - Po, e korra*. Pjesëza mohuese: *jo, nuk, s', mo* (< mos).

- Pjesëza me funksion sasiore: *rrash, qot, afër, gati, thujse, ati-ktâu, nja* për numra të përafërt: *nja 5-6 ve:t*. P.sh.: *Tash jan mush rrash pes vet. (I kam mush qot (afër, gati, thujse, ati-ktâu) shtatthet vet..*

29. Ka edhe disa lloje pjesëzash, siç janë, për shembull, ata me kuptim dëftues: *çe* (çaj < çe+ai), çashtu (< çe+ashtu); pjesëza pyetëse: *a, kushedi, nashta, noshta*; me kuptim të caktuar: *bezbeli, paçetër, ta merr menjâ, u murr vesh*; me kuptim të pacaktuar: *kushdo, kushdo ko:ft, çish do ko:ft* etj.

30. **Fjalët modale**.³⁷² – Fjalë modale që përdoren më shpesh në këtë të folme janë: *u murr vesh, besoj se, paçetër, shifet, nashta, për çudi, kishe, ajo asht, për shemëll, ma n'fîn, pa çare* etj.

³⁷¹ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Morfologjia), Tiranë, 1995, f. 425-426.

³⁷² Shpeshherë pjesëzat dhe fjalët modale ndërthuren edhe sipas formës edhe sipas kuptimit. Megjithatë, dallimi më kryesor mes tyre është ajo që me fjalët ose shprehjet modale marrim qëndrim personal, subjektiv ndaj asaj që thuhet.

3.10. PASTHIRRMA

31. Dihet se pasthirrmat (eksklamacionet) janë tinguj, grupe tingujsh, fjalë ose togje fjalësh të pandryshueshme. Me anën e pasthirmës shprehim ndjenja shumë të fuqishme shpirtërore: gëzim, kënaqësi, habi, dëshpërim, pikëllim, dhembje, frikë etj.

32. Pasthirrma më të shpeshta në arealin gjuhësor të Karadakut të Shkupit janë: *Uf!, Of!, Ah!, A!, O!, Oj!, Moj!, Ej!, Aha!, Ai!, Au!, Oho!, Ëhë!, Fërr!, Kërr!, Bum!, Pllap!, Fiu!, Trrak!, Hej!, Mori!, More!, Hopa!, Bravo!, Sikter!, Mazalla!, Pusto!, Shiqir!, Mashalla!, Aman!, Hallall!* etj.

33. Për pasthirrma merren edhe shprehjet për përshëndetje, mirënjohjet dhe falënderimet. Të tilla në të folmen tonë janë: *Merhaba!, Selam alejkum!, Alejkum selam!, Mâir meç!, Udha mar!, Mar paç!, Puna ma:r!, Mar paç!, T'baft mâir!, Bujrun!, E gzofsh!, E bajsh me shnet!, E shkefsh!, E shterrsh!, Për hajr!, Hajr paç!*. Shumica e këtyre shprehjeve me prejardhje orientale mund të dëgjohen edhe me forma përkatëse në gjuhën shqipe, veçanërisht te gjenerata e re, para së gjithash te shkollarët, si *Tungjatjeta!* ose *Tungatjeta!, Urdhno!, Mirmrama!, Mirdita!, Mirmëngjes!, Ditën e mi:r!* etj.

IV. VEÇORITË FJALËFORMUESE

1. Fjalët në gjuhën shqipe formohen përmes tipave dhe mënyrave të ndryshme. Fjalëformimi lidhet ngushtë me leksikologjinë, nga njëra anë, dhe me morfologjinë, nga ana tjetër. Si në çdo të folme tjetër dhe në shqipen standarde, edhe në këtë areal gjuhësor kemi fjalë të parme dhe fjalë të prejardhura.

2. Gjatë përshkrimit të mënyrës së formimit të fjalëve në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit do të ndalemi vetëm në mënyrat më prodhimtare (produktive) të formimit të fjalëve, përkatësisht në: a) fjalëformimin me ndihmën e parashtesave, b) me prapashtesim, c) me mënyrën e dyfishtë (të përzier): me paranyjëzim dhe prapashtesim, ç) me kompozim dhe përngjitje.

4.1. FORMIMI I FJALËVE ME PARASHTESIM

3. Një sasi e konsiderueshme fjalësh në këtë të folme, si dhe në mbarë shqipen dialektore e standarde, formohen me parashtesim. Parashtesa (prefikse) më produktive janë:

- **sh-**: krahaso: *frâij - shfrâi* 'fryj - shfryj', *ngarkoj - shkarkoj*, *ngul - shkul*, *ngrij - shkrij* ke:p - *shke:p* 'qep - shqep', *ngatroj - shkatroj*; *lij - shlij* 'lyej - shlyej', *paloj - shpaloj* etj. Kjo parashtesë, në shumicën e rasteve foljes i jep kuptim të kundërt. Por, ka fjalë ku nuk ka funksion të tillë, si p.sh.: *shkallmoj, shpoj, shliroj* 'çliroj', *kokrroj* > *kokloj - shkokloj* 'heq kokrrat nga kalliri i misrit' etj.

- **kaca-**: *kacadré*: 'kapruall i vogël', *kacavâirem, kacafâitem* etj.

- **kala-**: *kalavesh, kalavarem, kalamen, kaladredh, shkalafe:n* 'shkatërrua, prish' etj.

- **nër-** (-ndër): *nërbarke* 'ndërbarke, rrip samari që rri nën barkun e gomarit', *nërbishte* 'ndërbishte, rrip i samarit që shkon ndër bishtin e gomarit, rreth kofshëve', *nërskamc* 'ndërkëmbëz', *nerlik* 'dhëmb i parregullt', *nërmen* 'ndërmend', 'nërmjet' 'ndërmjet' etj.

- **pa-**: *i pashpâirt, i pamartum, i pala:m* 'i palarë', *i paknaçëm* 'i pakënaqur', *i pamsâum* 'i pamësuar', *i pahecëm* 'i padalë, që nuk ka lëvizur shumë', *i panjofshëm* 'i panjohur', *i pafé* 'ateist', *i pahajrit* 'i padobishëm', *i pamarëm vesh* 'i padëgjueshëm, kokëfortë', *i pafâtair* 'i pafytyrë' etj.

- **para-, par-**: *paradite, paradreke, parvjet, pargje* 'pardje' etj.

- **mbas-** (mas-): *mbasdite, masdarke, masanej, mbasnesër* etj.

- **për-**: *përgjime* 'përgjysmë', *përvjet, përnat, përneher, përxha:k, përllaç* 'përbalt', *i përllomt* 'i bërë me baltë, pis', *i përllott* 'i përllotur', *përxhoj* 'pres dikë për të ardhur', *përbij* 'kapërdij', *përcjell, përtâip* 'përtyp', *përdredh, përgjaj* 'përngjaj', *përmen* 'përmend', *i përllallum* 'i përllalluar', *përpla:s* etj.

- **po-**: kjo parashtesë me prejardhje sllave bashkë me fjalët e huazuara përdoret si i tillë. Për shembull: *poja:t* 'pullaz', *poka:n* 'ftesë, thirrje', *porez* 'tatim' etj.

- **stër-**: *stërnâip, stërmbes, stërpi:k* 'spërkat', *stërdham* 'stërdhëmb, dhëmb i parregullt' dhe *stërdhamç* 'keq. njeri me dhëmbë të parregullt', *stërçel* 'keq. i bezdisshëm, i padurueshëm' etj.

- **tër-**: krahaso fjalët: *tërfurk* (fu:rk) 'cfurk', *tërçote* (qot, pqot, plot) 'terplote, lopatë druri',

tërma(le) (mal) 'përpjetë, në ngjitje lart', *tërthâur* (thore) 'tërthurë, shtrembët, jo drejt'.

4.2. FORMIMI I FJALËVE ME PRAPASHTESIM

4. Formimi i fjalëve me parashtesa në këtë të folme është më produktive sesa me anë të parashtesave. Gjatë formimit të fjalëve me prapashtesim në gjuhën shqipe në përgjithësi, përfshirë edhe të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, krijohen fjalë të reja me theks në prapashtesë. D.m.th. te fjalët e formuara me prapashtesim, theksi bie në prapashtesë, përkatësisht në zanoren e fundit të parrëgjuar të temës fjalëformuese (por jo në treguesit gramatikorë).

5. Dihet se në gjuhën shqipe, fjalët e prejardhura, të formuara me anë të prapashtesimit (me prapashtesat -ár, -tár, -ór, -tór, -íst, -í, -ít, -iót, -sí, -rí, -ím, -úk, -éshë, - úshë, -ác, -ác, -ák, -án (-ján), -ér (-iér), -ó-, -só, -zó, -ós; -átë, -óre, -tóre, -íshte, -íshtë, -ájë, -nájë, -ícë, -ízëm, -ázëm, -ítet, -imisht, -avec etj., të cilat marrin mbi vete theksin e fjalës) shqiptohen me theks fundor:³⁷³ *fshát - fshatár, qytét - qytetár, détt - detár, údhë - udhëtár, lúftë - luftëtár, lákër- lakrór, dásëm - dasmór, mál - malór, ákull - akullóre, rrégull - rregullóre, bótë - botëror; púnë - puním, punëtór, punëtorí; árt - artíst, futbóll - futbollíst, spórt - sportíst, mjéshtër - mjeshtrí, drejtór - drejtorëshë, zónjë - zonjúshë, i ëmbël - ëmbëlsí, djálë - djalëri, rrúgë - rrugáč, Dúrrës - durrsák, Rómë - romák, Díbër - díbrán, Shkódër - shkodrán, ménd - mendój, flákë - flakëroj, shtég - shtegtój, fríkë - frikësój, dórë - dorëzój, fúnd - fundós, hékur - hekurós, fjálë - fjalós, alkoól - alkoolík etj.*³⁷⁴

6. Por theksi nuk kalon te prapashtesat: -më (-ëm), -je, -ës, -të, -as, -e, -shëm. Krahaso: *klíth - klíthmë, dál - dálje, mblédh - mblédhës, flákë - i fláktë, fýt - fýtas, mík - míke, kënáq - i kënáqshëm, vénd - véndas, Maqedóni - maqedónas, Gjilán - gjilánas; nxë - nxënës, prés - prítës, bléj - blérje, ndjék - ndjékje, përcjéll - përcjéllje etj.*

7. Sufikset më të shpeshta që shërbejnë për formimin e fjalëve në këtë të folme janë:

a) Prapashtesa **-án**: Kjo prapashtesë u prapaviihet emrave e mbiemrave, duke ruajtur kuptimin themelor që ka rrënja e fjalës apo duke i dhënë asaj kuptim përçmues, keqësues (pejorativ). Me prapashtesën -an formohen edhe emra gjeografikë, vetjakë apo etnikë.³⁷⁵ Për shembull: *vejan* (i ve), *breshkan* (bre:shk), *çiçan* (çiçe, qyqe), *breznjan* (Bre:z) 'banor i Brezës', *shkupnjan* (Shkup) 'shkupjan', *belban* (i belbt), *zezan* (i zi), *shurdhan* (i shurdhët), *çirran* (çirra, qurra); formimi i emrave femërore nga emrat mashkullorë: *shotan* (sho:t), *çuran* (çu:r) 'misiroke' etj.

³⁷³ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe, vëllimi I, Morfologjia*, Tiranë, 1995, f. 100; Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 130.

³⁷⁴ Ndonjëherë, fjalët e formuara me prapashtesim merren si shembull për të mbështetur pohimin se përveç karakterit bazë të palëvizshmërisë së theksit në gjuhën shqipe, ai shpeshherë është i lëvizshëm. Kjo nuk na duket e drejtë, sepse gjatë fjalëformimit përfitohen njësi leksikore e semantike të ndryshme, megjithëse të një rrënje (khs. shembujt e dhënë më lart: *fshát - fshatár, ..., spórt - sportíst*). Palëvizshmëria dhe lëvizshmëria e theksit duhet të trajtohet në kufijtë e paradigms së të njëjtës fjalë, përkatësisht në format e ndryshme që merr e njëjta pjesë emërore gjatë lakimit ose e njëjta folje gjatë zgjedhimit. Lëvizshmëri të theksit në gjuhën shqipe kemi vetëm në një numër të vogël fjalësh me lëvizshmëri gramatikore, të cilat në numrin njëjës theksin e kanë në temë, kurse në shumës theksi zhvendoset në mbaresë (shih shembujt e tipit *dhëndër - dhëndurë, ...*) ose me lëvizshmëri fonologjike, kur theksi gjatë lakimit ose zgjedhimit bie në rrokje të ndryshme ose në tinguj të ndryshëm të së njëjtës morfemë (të tipit *njeri - njërez, ...*).

³⁷⁵ Vepër e cituar, f. 201.

b) Prapashtesat **-á:r, -tá:r**: *katuna:r* (katun), *shipta:r* (ship) 'shqiptar', *udhta:r* (u:dh), *koshta:r* (kosh) 'kotec', *goveda:r* (govedo) 'lopar', *zllatar* (zlato) 'artar', *morna:r* (more) 'marinar', *hizmeça:r* (hizmet) 'shërbëtor', *haberta:r* (haber) 'lajmës, lajmëtar, parashikues', *knizha:r* (kniga) 'librari', *cimenta:r* (cement) 'cementarë' etj.

c) Prapashtesa **-ú:s** (e pëftuar nga -ues, si dhe në variantet fonetike **-âus, -á:s**): *mcâus*, *msu:s*, *msa:s* (msoj) 'mësues', *shku:s* (shkoj) 'shkues', *knu:s*, *kna:s* (knoj) 'këndes, gjel' etj.

ç) Prapashtesa sllave **-í:c** (e pëftuar nga -icë, -ица (ica); me variantet fonetike **-âic, -ovâic**): Me këtë sufiks me prejardhje sllave, përveç fjalëve të huazuara me të, kjo prapashtesë në këtë të folme është produktive, duke ia prapavënë jo vetëm fjalëve sllave, por edhe atyre josllave. P.sh.: *krali:c* (kral) 'mbretëreshë', *koçni:c* (koçit) 'fre (makine)', *bullâic* (bivol) 'buallicë', *bolnâic* (bolen) 'spital', *stani:c* (stani) 'stacion', *prodavni:c* (prodava) 'shitore, dyqan' etj. Karakteristikë e kësaj të folmeje, si dhe në përgjithësi e të gjitha të folmeve shqipe në Maqedoni³⁷⁶ është formimi i emrit të gruas së martuar në bazë të emrit të bashkëshortit, në mënyrë që emrit të burrit të saj i shtohet njëri prej varianteve fonetike të prapashtesës **-icë** (-i:c, -âic, -ovâic) sipas tipit: Arif - *Arifi:c*, *Arifâic*, *Arifovâic*; Daut – *Dauti:c*, *Dautâic*, *Dautovâic*; Zenel – *Zeneli:c*, *Zenelâic*, *Zenelovâic*.

d) Prapashtesa turke **-xhí**: Me këtë prapashtesë me prejardhje orientale, rëndom formohen emra profesionesh: *kunraxhí* (kunër) 'këpucar', *sahatxhí* (sahat) 'ortar', *kompâiraxhí* (kompir) 'patatexhi', *laknaxhí* (lakën) 'lakraxhi', *sharraxhí* (sha:rr) 'avxhi' 'gjuetar', *teneçexhí* (teneqe) 'llamarinas', *çimirxhí* (çimir) 'qymyrxhi', *dahirexhí* (dahire) 'dairexhi', *belaxhí* (bela), *samarxhí* (samar), *dallaveraxhí* (dallavere) etj. Shumica e emrave të tillë sot përdoren me kuptim përçmues, pezhorativ.

dh) Prapashtesa turke **-llá:r** (prapashtesë turke që përdoret për formimin e shumësit të disa emrave): *dajalla:r* (da:j) 'daja-t', *hoxhalla:r* (ho:xh), *agalla:r* (agë), *ustalla:r* (ustah, mjeshtër) etj. E gjejmë edhe te emrat e mëhallëve: *Memishalla:r* (Memish), *Hodalla:r* (Hoda) në f. Tanushë etj.

e) Prapashtesa **-lé:r** (me prejardhje turke): *begle:r* (beg), *shehle:r* (sheh) etj.

ë) Prapashtesa turke **-llâik (llík)**: *askerllâik* (asker), *cigarllâik* (cigare), *sefallâik* (sefa), *dunjallik* (dunja:), *pazarllâik* (pazar), *tuxharllâik* (tuxha:r), *hasretllâik* (hasret), *kallaballâik* (kallaballak), *saballâik* (sabah), *haxhillâik* (haxhi), *azganllâik* (azgan), *jemishllâik* (jemish), *fukarallâik* (fukara), *sunetllik* (synet) etj.

f) Prapashtesa **-lí** (prapashtesë orientale): *borçli*: (borç), *gurbetli*: (gurbet), *dertli*: (dert), *pareli* (pare), *straçincali*: (Straçi:nc), *hasanbegali*: (Hasanbeg), *mojancali*: (Moja:nc), *Grushinali*: (Grushi:n) etj.

g) Prapashtesa **-âim** (< -i:m): Me këtë prapashtesë që zakonisht u pasvihet foljeve formohen emra abstraktë të gjinisë femërore, që zakonisht emërtojnë dukuri atmosferike apo ndonjë zhurmë, si *bubllâim* (bubullij) 'bubullimë', *vetâim* (vetëtij) 'vetëtimë', *hingllâim* (hingëllij) 'hingëllimë', *rrokllâim* (rrokullej) 'rrokullimë', *ulurâim* (ulurij) 'ulurimë' etj.

gj) Prapashtesa **-é:sh** (< -eshë): si *mâike:sh* (mâik) 'mikeshtë, mike', *profesore:sh* (profesor) 'profesoreshtë', *drejtore:sh* (drejtor) 'drejtoreshë' etj.

h) Prapashtesa **-í:sht** (< -ishtë): *ahi:sht* (ah) 'ahishtë', *zalli:sht* (za:ll) 'zallishtë' etj.

i) Prapashtesa **-nâik** (< -nik): *besnâik* (be:s) 'besnik', *flanâik* (flad, hllad) 'vend i freskët për ruajtjen e bulmetit, turshive e gjërave të tjera' etj.

³⁷⁶ Remzi Nesimi, *Diftongimi i i-së dhe i u-së së theksuar në të folmen e Dervenit ...*, f. 97-99.

j) Prapashtesa **-shëm**: *i hishëm* (hije) 'i hijshëm, simpatik', *i nershëm* (ne:r) 'i ndershëm', *i shishëm* (shije) 'i shijshëm', *i besu:shëm* (be:s) 'i besueshëm', *i knâushëm* (knoj) 'i lexuar, i ditur', *i ngjushëm* (ngjoj) 'i dëgjueshëm', *i lezetshëm* (lezet) 'i shijshëm', *i mërzitshëm* (mërzi) 'i bezdisshëm' etj.

4.3. FORMIMI I FJALËVE ME PARANYJËZIM DHE PRAPASHTESIM

8. Formimi i fjalëve me formante fjalëformuese të dyfishta (me të ashtuquajturën mënyrë e përzier), respektivisht me paranyjëzim dhe me prapashtesim njëherazi është mjaft produktiv në të folmen tonë, si dhe në të folme të tjera, por edhe në gjuhën standarde. Siç dihet, kur **pjesores** (participit) së foljes i paravihet nyja e përparme **i** për gjininë mashkullore, **e** për gjininë femërore dhe i shtohen prapashtesat **-m**, **-ëm** (për gj. m.) apo **-me** (për gj. f.); atëherë folja, përkatësisht pjesorja kalon në **mbiemër**, përkatësisht në mbiemër foljor, më saktësisht në mbiemër prejpjesor. Kuptohet se mbiemra të tillë prejpjesorë në gjuhën shqipe ka shumë. Do të sjellim disa nga ta: pjesore (kam, jam) *la*: 'larë' → mbiemër: *i la:m* - *e lame* 'i larë – e larë'; *me:ll* 'mbjellë', *i mellëm* - *e mellme* 'i mbjellë – e mbjellë'; *fshâi* 'fshi', *i fshâim* - *e fshâime* 'i fshirë – e fshirë'; *ko:rr* 'korrë', *i korrëm* - *e korrme* 'i korrur – e korrur'; *pe:k* 'pjek', *i pekëm* - *e pekme* 'i pjekur – e pjekur'; *a:rdh* 'ardhur', *i ardhëm* - *e ardhme* 'i ardhur – e ardhur'; *pre*: 'prerë', *i pre:m* - *e preme* 'i prerë - e prerë'; *gje:*, *gji*: 'blerë', *i gje:m* - *e gjeme* 'i blerë – e blerë', *li*: 'lyer', *i li:m* - *e lime* 'i lyer – e lyer'; *msâu* 'mësuar', *i msaum* - *e msauime* 'i mësuar – e mësuar, *shâit* 'shitur', *i shâitëm* - *e shâitme* 'i shitur – e shitur' etj.³⁷⁷

9. Nyja te mbiemrat prejpjesorë ka rol të dyfishtë: ajo ka edhe rol fjalëformues, edhe rol gramatikor. Pra, nyjëzimi te ky lloj fjalësh funksionon edhe si tregues gramatikor i gjinisë (përveç mbaresave), tregues i rasës dhe i numrit. Me fjalë tjera, nyja e përparme, para së gjithash, është element gramatikor, megjithatë këtu bëhet fjalë për shndërrimin e një foljeje në mbiemër falë nyjës dhe prapashtesës, pa të cilat nuk do të ishte i mundur ky konvertim. Në të vërtetë, në të folmen e Karadakut të Shkupit, fjalëformimi vetëm me ndihmën e nyjëzimit nuk mund të konsiderohet si mënyrë e veçantë, sepse krahas nyjëzimit, njëherazi kemi edhe prapashtesimin.

10. Mënyra e dyfishtë (e përzier: nyjëzim + prapashtesim, me të cilat arrihet edhe konverzimi) është produktive edhe gjatë formimit të emrave prejfoljorë, më saktësisht të emrave prejpjesorë,³⁷⁸ si folje → emër prejpjesor: *dal* - *e dalmja* 'të dalurit', *pâi* 'pi' - *e pâimja* 'të pirët', *heci* 'ec' - *e hecmja* 'të ecurit', *knoj* 'këndoj' - *e knâumja* 'të kënduarit', *mcoj* 'mësoj' - *e mcâumja* 'të mësuarit', *ke:shi* 'qesh' - *e keshmja* 'të qeshurit', *kosâiti* 'kosit' - *e kosâitmja* 'të kosuturit', *ha*: 'ha' - *e hangmja*, *e ngranmja* 'të ngrënët' etj. Këta emra prejfoljorë të gjinisë femërore, përveç me nyjëzim, formohen edhe me prapashtesën **-mja**. Siç mund të shihet edhe nga shembujt e sjellë, emrat prejfoljorë në këtë të folme çdoherë përdoren vetëm në trajtën e shquar.

³⁷⁷ Siç u tha edhe në përshkrimin e pjesores, në dallim nga shqipja standarde ku pjesorja dhe mbiemri prejpjesor na dalin me formë të njëjtë (ato dallojnë vetëm nga mungesa ~ prania e nyjes së përparme, sipas tipit: (kam, jam) *larë* - *i larë*, *mësuar* - *i mësuar*), shih: *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, 1995, f. 69, në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit pjesorja dhe mbiemri prejpjesor, përveç me nyjen e përparme (**i** për gj. m. dhe **e** për gj. f.) dallojnë edhe në atë që mbiemrat prejpjesorë na dalin me prapashtesën **-m**, **-ëm** për gjininë mashkullore dhe **-me** për gjininë femërore.

³⁷⁸ Vepër e cituar, f. 69.

4.4. KOMPOZIMI DHE PËRNGJITJA

11. Në shqipen standarde, kompozimi (përbërja) dhe përngjitja (aglutinimi) paraqesin mënyra të posaçme të fjalëformimit.³⁷⁹

12. Pasi në të folmen tonë këto dy mënyra të fjalëformimit nuk janë aq të shpeshta, të dyja mënyrat do t'i paraqesim si një mënyrë të formimit të fjalëve të përbëra.

13. Kompozita të shpeshta, nga pikëpamja e strukturës leksiko-gramatikore janë:

a) **emër** + **emër**: *bithpule* (bi:th pu:l), *babgjish* (ba:b gjish, babë gjysh), *komkriç* (kom kriç, këmbëkryq), *babaqak* (ba:b qak, plak), *nanaqa:k* (na:n qak, plak), *Shinxherxh* (Shën Gjergji); *Shmitër* (Shën Mitër); *krâiekungëll* (krâie kungull, kryekungull), *krâiehudër* (krâie hudër, krye hudhër), *krâieçekiç* (krâie çekiç) 'kokëfortë', *luledilli* (lule di:ll) 'lule dielli', *sofrabez* (tur. sofër bez) etj.

b) **emër** + **mbiemër**: *krâiemadh* 'kryemadh, kokëmadh', *veshgja:t*, *barkmadh*, *menjemadh*; *menjele:t*, *menjeho:ll*, *menjetra:sh*; *floggja:t*, *xhaknxë:t*, *xhakfto:ft*, *vetëllho:ll*, *sâize:z* 'syzezë' etj.

c) **mbiemër** + **emër**: *Karadak* 'nga turqishtja kara – i zi, dag – mal, maq., serb. Crna Gora', *karabash* 'turq. kara - i zi, bash – vërtet, shumë i zi, qen i zi', *karabiber* 'i zi biber, biber i zi' etj.

14. Me përngjitjen e shprehjeve janë formuar disa kompozita, të cilat në gjendjen e sotme shqiptohen e dëgjohen si një fjalë e vetme dhe kanë një theks kryesor (themelor, parësor) të vetëm. Të tilla janë fjalët e përngjitura: *farefâis* (fa:r e fâis) 'farefis', *thashethana* (tha:sh e tha:n) 'thashethënë', *kurdohe:r* (kur do he:r) 'gjithnjë, përherë', *sive:t* (si vjet) 'sivjet', *dixhit* (dishka xhit) 'diçka' në f. Brezë e Malinë; *xhithka* (xhith kah) 'çdokund, gjithkah', *përmbâi* (për mbâi) 'përmbi, mbi', *nëpër* (në për) 'nëpër', *câillido* (câilli do) 'cilido, kushdo' etj.

15. Në këtë të folme, si dhe në përgjithësi në dialektin e Veriut,³⁸⁰ pjesëza treguese **çe** (< ja, shihe vetë dhe bindu në atë që po ta them) që shpesh dëgjohej edhe si **çi** përngjitet me disa përemra dëftorë apo ndajfolje, duke u dhënë po të njëjtave fjalë kuptim më të sforcuar, të tipit *ky* dhe *pikërisht* (bash, mu) *ky* (ky - ja ky). P.sh.: *çaj* (çe aj) 'ja ai', *çiki* (çe ki, ky) 'ja ky', *çajo* (çe ajo) 'ja ajo', *çikta* (çe kta) 'ja këta', *çeket* (çe ket) 'ja këtë'; ndajfolje: *çagje* (çe agje) 'ja atje', *çekha* (çe kha) 'ja këtu, kënde', *çashtâu* (çe ashtâu) 'ja ashtu, pikërisht ashtu', *çekshtâu* (çe kshtâu) 'ja kështu, mu kështu', *çiktâu* (çe ktâu) 'ja këtu, mu këtu' etj. Këtyre formave ndënjëherë u passhtohet edhe përemri vetor i vetës së parë njëjës *une*, sipas tipit: *çe* + *kshtâu* + *une* (ja + kështu + unë), sidomos në fshatin malor Brezë, për të përfutur format e përngjitura *çekshtâune*, *çashtâune* (çe + ashtu + unë), që janë të rralla në shqipen dialektore.

³⁷⁹ Në gramatikën e shqipes standarde kompozimi dhe përngjitja trajtohen si dy forma të veçanta fjalëformimi: kompozimi llogaritet si bashkim i dy ose më shumë temash (rënjësh) të fjalëve, si rezultat i të cilave fitohet një fjalë tjetër e re; ndërsa përngjitje zakonisht llogaritet bashkimi i sintagmave ose i shprehjeve. Shih: Grup autorësh, *Gramatika ...*, f. 70-77.

³⁸⁰ Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1987, f. 175.

V. TIPARET LEKSIKORE

1. Materialin dialektor të Karadakut të Shkupit, përfshirë edhe atë leksikor, e mblodhëm nëpër të gjitha fshatrat e kësaj krahine të banuara me shqiptarë, me pyetje të tërthorta në bazë të një pyetësi dhe me biseda të lira e tematike me informues tipikë të moshuar e të paarsimuar, të cilët nuk kanë munguar për një kohë të gjatë nga vendi i lindjes.

2. Si në çdo të folme tjetër shqipe, ashtu edhe në këtë të folme dallohen fjalë me etimologji të ndryshme, që nga fjalët me prejardhje indoevropiane e deri te disa neologjizma bashkëkohorë. Pra, kemi:

a) **fjalë të gurrës vetjake a vendëse**, të cilat mbizotërojnë, dhe

b) **fjalë me prejardhje nga gjuhë të huaja**.

Edhe përkrah ndikimeve të huaja në rrjedhë të kohës, kjo e folme si edhe mbarë shqipja e ka ruajtur mëvetësinë e saj, me strukturë fonetike e fonologjike, gramatikore e leksikore të veçantë.

3. Si të gjitha të folmet e tjera, edhe e folmja jonë është mjaft e pasur me fjalë dhe me shprehje të ndryshme. Relievi malor i Karadakut të Shkupit (regjion i pasur me botën bimore dhe shtazore) ka mundësuar zhvillimin e blegtorisë e më pak të bujqësisë. Për të emërtuar tërë këtë shumëllojshmëri të florës dhe të faunës, banorët e këtij vendi kanë fjalë përkatëse. Rrjedhimisht, e folmja jonë është e pasur me fjalë nga sfera e pjesëve të trupit të njeriut, sëmundjeve, veçorive psikike dhe fizike; me emra farefisnie, veshjesh, ushqimesh; me fjalë të fushës së bujqësisë, blegtorisë, botës bimore, relievit, emra ujërash të vogla (përrenj, burime) dhe të tjera. Përkundër kësaj, ka pak fjalë nga sfera e detarisë, lundrimit, peshkatarisë, zejtarisë, sportit (përveç disa nga sportet popullore), administratës, shkencës, politikës, artit etj.

5.1. SINONIMIA LEKSIKORE

4. Marrë në përgjithësi, e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit për shkak të përdorimit paralel të krahinorizmave të gegërishtes qendrore dhe të gegërishtes verilindore është shumë e pasur me sinonime. Tipike për leksikun e kësaj të folmeje është **përdorimi i çifteve sinonimike fjalësh dhe formash fonetike karakteristike për gegërishten qendrore, që mbizotërojnë dhe jo pak fjalë të gegërishtes verilindore**. Me fjalë të tjera, këtu kemi dysh krahinorizmash të gegërishtes qendrore dhe të gegërishtes verilindore. Madje, ka edhe fshatra ku përdoren të dy format: njëra e cila është karakteristike për gegërishten qendrore, ndërsa tjetra për gegërishten verilindore. Konstatimin e tillë e kemi mbështetur në bazë të:

a) çifteve të caktuara sinonimike të dallueshme se i takojnë njërit apo tjetrit grup të folmesh, dhe

b) sipas dallimeve fonetike të së njëjtës leksemë.

5. Për të dëshmuar këtë, po sjellim disa sinonime:

- **çatai** në të folmen e fshatrave Luboten, Brezë dhe Malinë; **kulm** në fshatin Tanushë, Bllacë, Orllancë dhe Mojancë; ndërsa të dy format dëgjohen në fshatin Grushinë **kulm**, **çatai**.
- **ra:b** në fshatin Luboten – **ke:rr** në fshatrat e tjera ‘makinë, veturë’.
- **tërk:z** në të folmen e të gjitha fshatrave, përveç në fshatin Tanushë: **konop** ‘litar’.
- **câuc** (*ca:c*, *cu:c*) në fshatrat Luboten, Orllancë, Mojancë, Bllacë; ndërsa **çi:k** në fshatin Tanushë, si dhe format dyshe: **ca:c**, **çi:k** në fshatin Grushinë ‘vajzë’.
- **gjel** në fshatrat Luboten, Brezë, Malinë dhe Bllacë; kurse **knu:s** në fshatin Tanushë, **kna:s** në Mojancë dhe Orllancë ‘këndez’.
- **shku:s** në të gjitha fshatrat, përveç në fshatrat Tanushë, Brezë e Malinë: **msit** ‘shkues’.
- **brez** në fshatrat Bllacë, Luboten dhe Brezë, ndërsa **sho:k** në fshatrat e tjera ‘brez’.
- **gro:sh** në fshatrat Luboten dhe Bllacë, ndërsa **ba:th** në të gjitha fshatrat e tjera ‘fasule.’
- **çeçe** (keçe) në fshatrat Brezë, Malinë dhe Straçincë, ndërsa **kapuç** në fshatrat e tjera ‘kapelë, plis’.
- **çinçan** në të gjitha fshatrat, përveç në fshatrat Tanushë dhe Bllacë ku përdoret sinonimi **dimija** ‘dimia’.
- **ndraidhe** (ndrëidhe, ndridhe) në fshatrat Luboten, Straçincë, Bllacë, Brezë dhe Malinë, ndërsa **krela:n** në fshatrat Grushinë dhe Tanushë ‘lloj i gatesës me miell në formë qulli e që përvëlohet me gjalpë ose vaj, filhalle’.
- **hi:rr** në të gjitha fshatrat, përveç në fshatin Tanushë: **ku:sht** ‘lëng që mbetet nga qumështi gjatë nxënies së djathit ose gjizës, që pasi të tharohet, pihet si lëng freskues.’ Fjala **ku:sht** si për nga rregullsitë e ndryshimeve fonetike, ashtu edhe për nga ndërlikdhja kuptimore me **qumështin** mund të shpjegohet me formën e vjetër **klumësht** > **kumësht** > **kumsht** > **ku:sht**. Siç dihet, grupi i vjetër bashkëtingëllor **kl** në gegërishten veriore ka dhënë **k**, rënia e **ë-së** ka krijuar grupin e papajtueshëm bashkëtingëllor **msht** dhe për pasojë ka shkaktuar zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse (nga **u** të shkurtër në **u:** të gjatë), grupi prej tri bashkëtingëlloresh **msht** për lehtëshqiptim është përngjashmuar në **sht** dhe ka dhënë fjalëformën e sotme **ku:sht**, tipike për gegërishten verilindore.

Përveç këtyre që i përmendëm, çifte të këtitilla leksikore janë edhe përemri pyetës **xhit?** – **shka?** ‘çka?’, përemri i pacaktuar **dixhit** (Brezë) – **dishka** (< diçka, në fshatrat e tjera), fjalët **pupli** – **penël** ‘pupël’, **netëll** – **fshi:s** ‘fshesë’, **ni:j** – **ngjoj** ‘dëgjoj’ dhe të tjera.

6. Nga kjo lehtë mund të nxirret vlerësimi i përgjithshëm se **fjalësi i të folmes së Karadakut të Shkupit është ndër më të pasurit me sinonime**. Fondin leksikor me sinonime e ka pasuruar nëpërmjet disa rrugëve:

- a) me përdorim paralel të krahinorizmave të gegërishtes qendrore dhe të gegërishtes verilindore;
- b) me një ose dy fjalë krahinore dhe një fjalë të huazuar nga gjuhët sllave (kryesisht nga maqedonishtja ose serbishtja);
- c) me ndonjëren nga këto që u përmendën dhe një fjalë orientale;
- ç) me sinonimet dialektizëm a krahinorizëm - fjalë e huaj a barbarizëm – fjalë e leksikut të përbashkët letrar.

7. Siç mund të vërehet edhe nga shembujt e sjellë, në këtë areal fjalë të veçanta sinonimike kanë denduri përdorimi e përhapje të ndryshme. Kjo varet shumë nga rrethimi

gjeografik i fshatit, lidhjet familjare, ekonomike dhe kulturore, si dhe nga një varg faktorësh të tjerë jashtëgjuhësorë. Mirëpo, dysitë e shumësitë sinonimike: fjalë tipike vendore – fjalë e të folmeve përreth - fjalë e huaj etj. e bëjnë arealin gjuhësor të Karadakut të Shkupit një ndër të folmet shqipe më të pasura me sinonime.

8. Veçori tjetër e kësaj të folmeje është edhe ajo se një leksemë e njëjtë shpeshherë përdoret në formë të diftonguar apo të padiftonguar. Për shembull: **mâik** – **mik** ‘mik’, **nâuse** – **nuse** ‘nuse’, **dhâit** – **dhe:t** ‘dhjetë’, e të ngjashme; në formë të qiellzorizuar apo të paqiellzorizuar: **gjur** – **gur** ‘gur’, **gjist** – **gisht** ‘gisht’, **deg** – **degj** ‘degë’, **plak** – **qak** ‘plak’, **pleh** – **qeh** ‘pleh’, **pla:nc** – **qanc** ‘plëndës’, **gjo:j** – **go:j** ‘gojë’ etj.

9. Te një numër i caktuar fjalësh shfaqet sinonimia e një fjale krahinore me një tjetër të huazuar nga maqedonishtja a serbishtja apo nga turqishtja. Dukuria e formave të shumta dyshe, madje disa herë edhe forma triplete (zakonisht edhe me turqizma), është karakteristike për këtë izoglosë, si dhe për të folmet e tjera shqipe në Maqedoni.³⁸¹ Edhe në të folmen e një fshati si dhe te i njëjti folës mund të dëgjojmë fjalë me kuptim të përafërt a të ngjashëm. Për shembull: **bretko:s** ‘bretkosë e tokës’ dhe **zha:b** ‘bretkosë e ujit’ (në fshatin Tanushë); **skërmill** ‘kërmill pa samar, shtëpizë’ dhe **pizhimuzh** ‘kërmill me samar, me shtëpizë’ (në fshatin Tanushë); **go:zhd** ‘gozhdë me kokë dhe trup të rrumbullakët’ dhe **baski** ‘gozhdë me trup dhe kokë katrore’ (në fshatin Tanushë); **kumo:n** ‘zile e madhe për bagëti, këmbanë’, dhe **ciçare**³⁸² ‘zile e vogël për bagëti’ (në fshatin Tanushë); **tamaqar** ‘koprrac i cili ka dhe nuk jep’, **temerrut** ‘koprrac i cili vetëm mashtron, ndërsa nuk jep’ dhe **i shtre:jt** ‘koprrac në skajshmëri’ (në fshatin Tanushë); **lum** ‘lumë i madh’ dhe **re:k** ‘lumë i vogël, përrua’ (në fshatin Tanushë); **o:d** ‘odë, dhomë për mysafirë, dhomë për burra’ dhe **so:b** ‘dhomë, zakonisht për gra’ (në fshatin Tanushë); **mec**, **pangj**, **kudër** ‘bushtër, qen femër’ (në fshatrat Brezë dhe Malinë; **conuk** ‘trup druri mbi tokë, cung’ dhe **kërcu:** ‘trup druri në tokë’ (në fshatin Bllacë); **buçil** ‘pus i cekët’ dhe **buna:r** ‘pus i thellë’ (në fshatrat Orllancë e Mojancë); **fshi/ja** ‘grumbull i madh sane apo kashte’ dhe **kabëz/a** ‘grumbull i vogël’ (në fshatin Tanushë) dhe shumë sinonime të tjera të ngjashme.

10. Te folësit e gjeneratës së mesme, e veçanërisht te gjenerata e re vërehet edhe pasurimi i fondit leksikor me fjalë dhe shprehje të reja të shqipes standarde, që kanë hyrë kryesisht nëpërmjet shkollës dhe mjeteve të informimit. Të këtilla janë shprehjet për përshëndetje: **Mirdita!** ‘Mirëdita!’, **Mirmrama!** ‘Mirëmbërma!’, **Tungjatjeta!**, **Ditën e mi:r!** ‘Ditën e mirë!’, **Mirupafshim!**, **Urime!**, **Me fat!** dhe të tjera, që dëgjojnë me modifikim fonetik sipas shprehive nyjëtimore të folësve të kësaj ane.

11. **Tautologjia.** Përsëritja e fjalëve me kuptim të njëjtë a të ngjashëm (qofshin ato sinonime krahinore ose krahinorizëm + fjalë e huaj) si mjet për shprehshmëri më të qartë dhe bindshmëri, për përforcimin e të shprehurit është dukuri e përgjithshme e të folmeve popullore. Edhe në këtë të folme, që të arrihet shprehshmëri më e fuqishme e më bindëse, shpeshherë sinonimet përdoren njëra pas tjetrës, duke krijuar një tautologji, si në fjalitë: **M’i dha:n shta:t di:t fa:l, nagradno. Di kile i kish fitu:, dobit. Dikur na liraun, sloboditën. Ajo asht e nalume, zabran** dhe të ngjashme. Nga ana tjetër, përveç fjalës burimore apo të huazuar nga gjuhët sllave, shpeshherë si fjalë sinonimike përdoren edhe turqizmat, të tipit: **Pogreshno jam i shkra:m,**

³⁸¹ Qemal Murati, *Huazimet maqedonase në gjuhën shqipe*, Jehona 2, Shkup, 1985.

³⁸² Me shkronjën <ŋ> kemi shënuar fonemën bashkëtingëllore hundore, prapagjuhore, të zëshme që e kanë shumica e të folmeve të gegërishtes verilindore e disa të asaj veriperëndimore, e cila është përfutur nga përngjashmimi i grupit [ng] > [ŋ], si në fjalët *ngusht* > *ŋusht*, *ngat* > *ŋat*, *jam ngi:* > *jam ŋi:*, *kā:ng* > *kā:ŋ* etj.

dallash (Gabimisht jam i shkruar). **Krejt k'ta gjin, ki millet ha: buk** (Gjithë këta njerëz hanë bukë). **Poplli, narodi do me rrna: mair** (Populli do të jetojë mirë). **Tekrar ishin mle:dh, prap, apet** (Përsëri ishin mbledhur). **Te na e ki derën çel kur t'dush, stallno, ni dajm** (Te ne gjithnjë e ke derën e hapur). **Xhith ditën fshain, çista:t** (Gjithë ditën fshinë, pastron). **Aj punon, radi:t** (Ai punon, punon) dhe të tjera.

12. Me këtë shtjellim duam të dëshmojmë se edhe brenda një të folmeje, siç është areali gjuhësor i Malit të Zi të Shkupit, sinonimia leksikore është mjaft e shpeshtë. Ky është edhe një tregues i fuqishëm se edhe shqipja dialektore ka pasuri të pashtershme me fjalë që shprehin nuanca të ndryshme kuptimore e stilistike.

5.2. DYGJUHËSIA DHE HUAZIMI LEKSIKOR

13. Në Karadakun e Shkupit fliten disa gjuhë: shqipja, maqedonishtja, serbishtja, turqishtja, gjuha rome dhe të tjera. Popullata shqiptare në këtë regjion komunikon në gjuhën amtare, si edhe në gjuhën maqedonase dhe serbe, ndërsa ka edhe të tillë që njohin edhe një gjuhë të tretë.

14. Të jetuarit shumëshekullor në një territor të përbashkët, kontaktet e vazhdueshme gjuhësore, rrethanat e njëjta historike, ekonomike, politike, shoqërore dhe kulturore në zhvillimin e shqiptarëve dhe të maqedonasve në Karadakun e Shkupit janë parakusht për zhvillimin konvergjent gjuhësor. Një pjesë e madhe e fondit leksikor e banorëve të kësaj zone mund të konsiderohet si e përbashkët.³⁸³

15. Huazimet janë rezultat i kontakteve dhe marrëdhënieve të përhershme ekonomike, politike, kulturore etj. me pushtuesit si dhe me popujt fqinjë. Nevoja për të komunikuar njerëzit ndërmjet vete, e veçanërisht në mjediset shumëgjuhësore, është arsyeja kryesore për ngjashmëri si dhe për ndërndikimin gjuhësor.³⁸⁴ Në këtë kuptim, mjafton që të përmendim se në këtë areal shumëgjuhësor kemi ballkanizma të shumtë, turqizma të përbashkët, greqizma, fjalë të njëjta me prejardhje latine, fjalë nga gjuhët neolatine, nga gjuha angleze, gjermanizma, ndërkombëtarizma, maqedonizma në të folmen shqipe,³⁸⁵ fjalë shqipe në të folmen maqedonase³⁸⁶ dhe të tjera.

³⁸³ Agim Poloska, *Interferenca gjuhësore e maqedonishtes dhe e shqipes dialektore* (disertacion doktorati), Shkup, 1996.

³⁸⁴ Asllan Hamiti, *Ndikimi reciprok i maqedonishtes dhe i shqipes në fjalorët e Pulevskit*, Македонскиот јазик во XIX век, Shkup, 1996, f. 215.

³⁸⁵ Оливера Јашар – Настева, *Влијанието на македонскиот јазик врз албанските и турските говори во Македонија*, Македонски јазик VIII, libri i 2-të, Shkup, 1957.

³⁸⁶ Qemal Murati, *Huazimet shqipe në maqedonishten*, Gjurmime albanologjike, (SShF) 14-1984, Prishtinë, 1985; Оливера Јашар – Настева, *Албански зборови во македонските тајни јазици*, Македонски јазик, viti IV, libri 3, 4, 5-6, Shkup, 1953; Agim Poloska, *Interferenca leksikore e maqedonishtes dhe e shqipes dialektore të Prespës* (punim magjistrature), Shkup, 1988; Agim Poloska, *Interferenca gjuhësore e maqedonishtes dhe e shqipes dialektore* (disertacion doktorati), Shkup, 1996.

5.2.1. HUAZIMET SLLAVE

16. Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, si edhe në të folmet e tjera shqipe në Maqedoninë e Veriut, dëgjojmë mjaft sllavizma, kryesisht të huazuara nga serbishtja ose maqedonishtja. Ndikimi i gjuhës serbe në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, si dhe në të folmet veriore maqedonase është mjaft i fuqishëm.

17. Pjesa më e madhe e huazimeve janë fjalë kuptimplota: emra, mbiemra, ndajfolje dhe folje. Sllavizmat aq thellë janë futur në këtë të folme, si edhe në të folmet e tjera të shqiptarëve të Maqedonisë Veriut, sa që ndonjëherë një sasi jo e vogël e fjalëve në fjali kanë etimologji sllave e që mund të trajtohen si barbarizma. Për shembull: **Po shkoj ta nxe:rr ni potfrd n'opshtain** (Po shkoj ta nxjerr një vërtetim në komunë). **Poshtari gje ma pruni ni pokan për n'sud** (Postieri ma sollti një thirrje për në gjyq). **E çistata oborrin** (E pastrova oborrin). **Une, jam opshte rabotnik me ni gragjevi:n** (Unë jam punëtor krahu me një ndërmarrje ndërtimore). **Lip t'vodite raçun** (Duhet të mbajë llogari), **Ma dha uputin pod hitno me shku: n'bollni:c** (Ma dha udhëzimin urgjentisht të shkoj në spital). **Pa e marr dërzhavlanstfën nuk ma japin izvodin mu vençat** (Pa e marrë shtetësinë nuk ma japin ekstraktin e lindjes për t'u kurorëzuar) dhe të ngjashme.

Vlen të themi se folësit e kësaj zone, përdorin sllavizma kryesisht për tri shkaqe:

- a) nuk e dinë fjalën shqipe përkatëse,
- b) e dinë fjalën e shqipes së përbashkët, por mendojnë se fjala e huazuar ka fuqi më të madhe shprehëse ose emocionale,
- c) fjala e huaj përdoret si fjalë sinonimike e fjalës anase.

18. Marrë në përgjithësi, mosnjohja e jo pak fjalëve të shtresës së leksikut të shqipes së përbashkët dhe përdorimi i fjalëve të huaja lidhet ngushtë me fushën e ligjërimit. Kështu, kur biseda lidhet me veprimtari të veçanta shoqërore e politike, ku shqipja nuk përdoret fare, atëherë ata mund të shprehen vetëm me terme sllave, sepse nuk e dinë fjalën shqipe. P.sh. kur flasim për jetën e tyre në shërbimin ushtarak (në ish-Jugosllavinë ku gjuhë zyrtare ishte serbokroatishtja), atëherë ata përdorin vetëm fjalët: *peshadi* 'këmbësori', *deseta:r* 'tetar', *vodni:k* 'rreshter', *graniça:r* 'kufitar', *stroj* 'rresht', *mirno* 'gatitu', *obu:k*, *ve:zhb*, 'trajnim, stërvitje, ushtrim', *gagjanje* 'gjuajtje, çitje me armë', *zakleft* 'betim', *stra:zh* 'roje' dhe të tjera; në fushën administrative dhe politike, si: *reshenje* 'vendim', *dogovor* 'marrëveshje, kontratë', *su:d* 'gjyq', *mo:llb* 'lutje', *zha:llb* 'ankesë', *porez* 'tatim', *taksena ma:rk* 'pullë administrative', *poka:n*, *pozif* 'ftesë, thirrje', *izvo:d* 'certifikatë e lindjes, ekstrakt lindjeje', *opshti:n* 'komunë', *kancellari* 'zyrë, kabinet', *dërzha:v* 'shtet' dhe të tjera; në sferën teknike, si: *stru:j* 'korent, rrymë', *voz* 'tren', *sejali:c* 'poç elektrik', *soobraçaj* 'polic trafiku', *autoput* 'autorrugë', *prikoli:c* 'rimorkio' dhe të ngjashme; në sferën e shëndetësisë, si: *bollovanje* 'pushim mjekësor', *uput* 'udhëzim', *bollni:c* 'spital', *pritisak* 'tension, trysni' etj.

19. Në bazë të të arriturave të deritashme, lidhur me huazimet sllave në gjuhën shqipe është konstatuar se inventari absolut³⁸⁷ i sllavizmave në gjuhën shqipe arrin në 1000 fjalë, kuptohet se pjesa më e madhe e tyre kanë përhapje të ngushtë krahinore a dialektore, por ka edhe

³⁸⁷ Me inventar absolut të huazimeve leksikore sllave nënkuptohet sasia e përgjithshme e tyre në mbarë shqipen (dialektore dhe standarde).

të tilla që janë shtrirë në mbarë shqipen dhe rrjedhimisht janë bërë pronë e leksikut të shqipes standarde.³⁸⁸

20. E folmja e shqipe e Malit të Zi të Shkupit lidhur me sllavizmat nuk paraqet ndonjë veçanti nga të folmet e tjera shqipe në Maqedoninë e Veriut. Marrë në përgjithësi, huazimet e njëjta sllave kanë përhapje të përgjithshme në të gjitha të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut, aty-këtu me ndonjë dallim në sasinë dhe dendurinë e përdorimit. Që të jepet inventari relativ i sllavizmave i kësaj të folmeje do të duhej një punë afatgjate në terren dhe një trajtim tematik i veçantë.

21. Do të mjaftohemi me paraqitjen e disa sllavizma më të shpeshtë, të ndarë në lëmi tematike, nga:

- **Jeta familjare:** *domaqin* ‘nikoqir’, *domaqi:nk* ‘nikoqire, shtëpiake’, *domazet*, *vërsnik* ‘moshatar’, *imenja:k* ‘emnak’, *ga:zd* ‘zotëri, i pasur, pronar’, *zemla:k* ‘bashkëvendas’ dhe të tjera.

- **Emërtime të pjesëve të trupit të njeriut dhe të kafshëve, veshjes dhe stolive:** *grusht*, *gërkla:n*, *memeç*, *openg*,³⁸⁹ *patku:* ‘patkua’, *jadec*, *slepo cre:v* ‘zorrë qorre’, *posta:v* ‘shtroje’, *vunêic* ‘lesh’, *navllak* ‘mbështjellës’, *gërb* ‘shpinë’, *rrogzi:n* ‘rrogoz’ e të tjera.

- **Shtëpia dhe enët:** *stre:h*, *zid* ‘mur’, *sku:t* ‘skaj, kënd’, *zgra:d* ‘ndërtesë, pallat’, *kupati:ll* ‘banjo’, *prag*, *oborr*, *grazhd*; *pegëll* ‘hekur, ujti’, *netull* ‘fshesë’, *kolibe* ‘kasolle’, *stan*, *poli:c* ‘dollap’, *stoli:c* ‘karrige’, *nameshtaj* ‘mobilitë’, *sudoper* ‘enëlarëse’, *dvozed*, *trosed* ‘kanape’ e të ngjashme.

- **Fjalë nga lëmi i ushqimit:** *masli:nk* ‘ulli’, *kompair* ‘patate’, *pi:v* ‘birrë’, *slladolet* ‘akulllore’, *przhi:t* ‘fërgoj, skuq, tiganis’, *sok* ‘lëng’, *rre:p* ‘panxharsheqeri’, *shargare:p* ‘karrotë’, *varanaic* ‘kaqamak’ etj.

- **Bujqësia dhe blegtoaria:** *kosh*, *kori:t* ‘lug, govatë, koritë’, *ko:s* ‘kosë’, *kosait* ‘kosit’, *si:t* ‘sitë’, *sa:n* ‘sanë’, *vlla:ç* ‘branë, lesë’, *vllaçait* ‘lesoj’, *prashi:t*, *vadi:t* ‘ujit’, *prasadi:t* ‘rimbjell’, *gradel* (pjesë parmende), *re:k* ‘lumë’, *izvo:r* ‘burim’, *bra:z* ‘hulli’, *poplla:v* ‘vërshim, përmytje’, *tijak* ‘lym’, *kopaç* ‘kazmë’, *dell* ‘pjesë, copë’, *pustanai* ‘shkretëtirë’, *cërve:nk* (lloj gruri), *llubenaic*, *bostan* ‘shalqir’, *tërsk* ‘kallam’, *zha:b* ‘bretkosë’, *goveda:r* ‘lopar’, *deteli:n* ‘jonxhë’, *sha:tk* ‘patë’, *bu:ll*, *bullaic*, *jazbac* ‘vjedull’, *ku:çk* ‘bushtër’, *gollub* ‘pëllumb’, *pijavâic* ‘ushejzë’ e të tjera.

- **Profesione:** *tërgovac* ‘tregtar’, *ovça:r* ‘delmer, bari’, *strazha:r* ‘rojtar’, *vozaç* ‘shofer’, *struçnjak* ‘profesionist, ekspert’, *çistaç* ‘pastrues, punëtor higjiene’, *slluzhbenik* ‘nëpunës’, *novina:r* ‘gazetar’, *shuma:r* ‘pylltar’, *polak* ‘rojtar fushash’, *prodavaç* ‘shitës’, *matiça:r* ‘ofiçar’, *zida:r* ‘murator’, *kuva:r* ‘gjellëbërës, kuzhinier’, *soobraçaj* ‘polic rrugor - trafiku’, *sudi* ‘gjyqtar’, *lima:r* ‘llamarinës’, *farba:r* ‘ngjyrosës’ etj.

- **Fjalë nga fusha e teknikës:** *voz* ‘tren’, *pru:g* ‘binarë’, *tërka:ll* ‘rrotë’, *sijali:c* ‘poq elektrik’, *grejali:c* ‘ngrohëse’, *vodovod* ‘ujësjellës’, *prikoli:c* ‘rimorkio’, *koli:c* ‘karrocë’, *pojaça:ll* ‘zëzmadhues’, *sli:k* ‘fotografi’, *cre:v* ‘zorrë’ etj.

- **Fjalë nga fusha e shëndetësisë:** *uput* ‘udhëzim’, *pritisak* ‘tension, shtypje, trysni’, *bollovanje* ‘pushim mjekësor’, *mast* ‘melhem’, *bërzi pomoq* ‘ndihma e shpejtë, urgjenca’, *medicinska sestër* ‘infermiere’, *pregled* ‘kontroll mjekësor’, *nesvest* ‘alivanosje’, *zavoj* ‘fashë’, *sni:mk* ‘incizim, rëntgen’ dhe të ngjashme.

³⁸⁸ Xhelal Ylli, *Rreth inventarit absolut dhe relativ të huazimeve leksikore sllave në gjuhën shqipe*, Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tiranë, 1995, f. 186.

³⁸⁹ Eqrem Çabej, *Huazimet sllave*, Studime gjuhësore III, Prishtinë, 1987, f. 61.

- **Fjalë nga jeta ekonomike dhe shoqërore:** *zheleza:r* ‘hekuranë’, *pretprijati* ‘ndërmarrje’, *mleka:r* ‘qumështore’, *kozha:r* ‘lëkurore’, *sllatkarni:c* ‘ëmbëltore, pastiçeri’, *nadni:c* ‘mëditje’, *spisak* ‘listë’, *redovnost* ‘vijimësi, rregullsi’, *plla:t* ‘pagë, rrogë’, *deçki dodatok* ‘kompensim në para për fëmijët’, *mo:llb* ‘lutje’, *zha:llb* ‘ankesë’, *potfërd* ‘vërtetim’, *kni:shk* ‘librezë’, *knizha:r* ‘librari’, *porez* ‘tatim’, *cari:n* ‘doganë’, *grani:c* ‘kufi administrativ’, *sfedok* ‘dëshmitar’, *potpis* ‘nënshkrim, firmë’, *popujt* ‘zbritje çmimi’, *prenos* ‘transfer, bartje pronësie’, *izvod* ‘ekstrakt, çertifikatë’, *vençani:c* ‘fletëkurorezim’, *peçat* ‘vulë’, *reshenje* ‘vendim’, *zapisnik* ‘procesverbal’, *dozvo:ll* ‘leje, patent shoferi’, *prija:v* ‘fletëparaqitje’, *upra:v* ‘drejtori’, *vllast* ‘pushtet’ etj.

- **Fjalë lëmish të ndryshme:** *javit* ‘lajmëroj, paraqitem’, *shetit*, *dosadit* ‘bezdis’, *kazmit* ‘dënoj, gjobit’, *pratit* ‘përcjell’, *çudit*, *raspravit* ‘grindem’, *produzhit* ‘vazhdoj afatin’, *prekina:t* ‘ndërprej’, *çista:t* ‘pastroj’, *zate:k* ‘takoje’, *greshâit* ‘gaboje’, *vërtit* ‘sjell, rrotulloj’, *koçâit* ‘frenoj’, *fali:t* ‘mungoj’, *prima:t* ‘marr, pranoj’, *snima:t* ‘incizoj’, *rok* ‘afat’, *përvak* ‘i parë’, *gollgan* ‘portier’, *igrač* ‘lojtar’, *igralishte* ‘fushë loje’, *utakmi:c* ‘përballje sportive’, *tërk* ‘vrapim’, *vodit* ‘udhëheq’, *mre:zh* ‘rrjetë’, *stallno* ‘gjithnjë’, *greshait* ‘gaboje’, *gotovo* ‘gati’, *mora* ‘doemos’, *apet* ‘përsëri, rishtas’, *strog* ‘i rreptë’, *llud* ‘i çmendur’, *razni-razni* ‘lloj-llojesh’, *kri:ll* ‘krah’, *cello* ‘i tërë, i plotë’, *okoll m’okoll* ‘rreth e përçark’, *raçun* ‘llogari’ etj.

5.2.2. HUAZIMET TURKE

22. Huazimet sllave dhe orientale përbëjnë pjesën më të madhe të fjalëve të huaja në shqipen e Karadakut të Shkupit. Ato paraqiten në të gjitha sferat e jetës materiale dhe shpirtërore. Numri i tyre duhet të jetë i njëjtë sikurse në të folmet tjera rurale në Maqedoninë Veriore. Është e njohur se në këto krahina ku kontaktet me turqit kanë qenë më të shpeshta, më të gjalla... (e veçanërisht në qytetet dhe në fshatrat e afërta) depërtimi i turqizmeve ka qenë më intensiv.

23. Turqizmat si në mbarë shqipen dialektore, ashtu edhe në këtë të folme shpjegohen me faktorët jashtëgjuhësorë, si me sundimin pesëshekullor të perandorisë osmane në Ballkan, islamizimin e shqiptarëve, prestigjin e derivonshëm të turqishtes si gjuhë e kulturës (sidomos në qytete) etj. Për t’u përmendur është edhe fakti se një pjesë e kësaj popullsie kanë pasur dhe kanë lidhje familjare me të shpërngulurit në Turqi nga ky rajon, kontaktet e shpeshta tregtare e vizitat e ndryshme në Turqi etj. Gjithashtu, turqishtja ballkanike dhe shqipja, së bashku me gjuhët e tjera, janë gjuhë në takim.

24. Vlerësimi ynë i përgjithshëm është se pjesa më e madhe e turqizmeve që përdoren në të folmen shqipe të Karadakut janë të përhapura edhe në të folmet e tjera në Maqedoninë e Veriut, respektivisht nuk hetuam turqizma me karakter të ngushtë regjional. Po kështu, si edhe në të folmet e tjera, një pjesë e madhe e fjalëve nga sfera e administratës turke, nga jeta juridike dhe tregtare që kanë mbijetuar edhe në ditët e sotme janë arkaizma.

25. Fjalët dhe shprehjet orientale më shpesh përdoren në lutjet dhe ceremonitë fetare, në formulat përshëndetëse të përditshmërisë, në emërtimin e orendive shtëpiake, në kuzhinë, në veshje, në zeytari, në tregti, në sferën e jetës shpirtërore dhe thuajse në të gjitha sferat e jetës.

26. Siç mund të konstatohet edhe nga shembujt e sjellë, shumica e orientalizmeve të huazuara janë fjalë kuptimplota. Por, në këtë të folme ka edhe një numër të caktuar huazimesh, që janë fjalë shërbyese. Huazimi jo vetëm i emrave, mbiemrave e i foljeve, por edhe i pjesëve të

tjera të ligjëratës (ndajfoljeve, lidhëzave, pjesëzave, pasthirmave etj.) janë një tregues i rëndësishëm për shkallën e lartë të ndikimit të një gjuhe në gjuhën tjetër.³⁹⁰ Për shembull, e folmja në fjalë ka huazuar ndajfoljet: *barabar, kollaj, hazër, karshâi, bash, badihava, boll, dajma, sefte, sagllam, hiç* e të ngjashme; lidhëza: *bile, ama, hem...hem, demek, mazalla, berem, dilmi* e të tjera; pasthirmat: *mashalla:, ama:n, hajde be, jazik, shiqir* dhe të tjera; pjesëza: *xhanëm, amin* etj.

27. Përveç huazimeve leksikore, kjo e folme ka edhe jo pak kalke sipas modelit të turqishtes e të gjuhëve sllave. Kalket i krijojnë folësit që dinë dy e më tepër gjuhë, në veçanti në ato mjedise gjuhësore ku dygjuhësia ka përfshirë gjithë popullatën.³⁹¹ Prof. O. J. Nasteva ka arritur që të dallojë rreth 400 fjalëforma dhe shprehje në gjuhën maqedonase të kalkuara nga turqishtja...³⁹² Numri i kalkeve sipas gjedhes së turqishtes e të serbishtes apo maqedonishtes në këtë të folme është i madh.

28. Prania e kalkeve, si dhe e fjalëve shërbyese të huazuara, paraqet një dëshmi serioze për interferencë gjuhësore, kur folësi nuk arrin që ta ruajë të papërzier kodin e gjuhës amtare nga kodi gjuhësor i gjuhës tjetër...³⁹³

Të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut me numër më të madh orientalizmesh sesa të folmet e tjera

29. Po të krahasojmë sasinë e orientalizmeve në shqipen e Maqedonisë së Veriut me të folmet e tjera shqipe mund të konstatojmë se numri i fjalëve të huazuara orientale përgjithësisht është më i madh në këto të folme sesa në të folmet e tjera shqipe. Kjo arsyetohet me disa faktorë gjuhësorë e jashtëgjuhësorë:

1. Në Maqedoninë e Veriut ka një numër të konsiderueshëm turqish që kanë raporte shumë të mira me shqiptarët dhe nuk janë të rralla edhe martesat e përziera turko-shqiptare. Gjithashtu, turqishtja ballkanike dhe shqipja, së bashku me gjuhët e tjera, janë gjuhë në takim.
2. Shumë shqiptarë nga Kosova e veçmas nga Maqedonia e Veriut kanë migruar në Turqi dhe ata mbajnë lidhjet farefisnore, duke bërë vizita të shpeshta njëri te tjetri. Edhe vajtje-ardhjet tregtare janë të shpeshta.
3. Në disa qytete të këtij vendi, si në Shkup, Tetovë, Gostivar, Ohër e gjetiu qytetarët turq kanë hapur objekte afariste (gjelltoare, ëmbëltoare, dyqane tekstili etj.) dhe kusht i punësimit në to krahas njohjes së shqipes e maqedonishtes është edhe njohja e turqishtes.
4. Pjesa më e madhe e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut janë të besimit islam dhe praktikimi i ceremonive fetare është shumë i shprehur, ndoshta më shumë se gjithkund tjetër në trojet shqiptare. Jo vetëm pleqtë e plakat, por edhe një numër i madh të rinjsh falin namazet, agjërojnë, shkojnë në haxhillëk. Nga përvoja jonë pedagogjike kemi vërejtur se jo pak studente na vijnë të mbuluara e kjo nuk është e ndaluar me dispozitat

³⁹⁰ Блаже Конески, *Историја на македонскиот јазик*, Скопје, 1986, f. 121.

³⁹¹ Оливера Јашар – Настева, *Македонските калки од турскиот јазик*, Македонски јазик, XIII – XIV, Shkup, 1962/63, f. 111.

³⁹² Коста Пеев, *За малупознатото калкирање на службени зборови во југоисточните периферни македонски говори*, Зборник на Филолошки факултет посветен на проф. Угринова, Shkup, f. 213.

³⁹³ Вепër e cituar, f. 231.

- ligjore. Në kohën e faljes së drekës së xhumasë studentët na kërkojnë të mos mbajmë mësim, por ta zhvendosim orën e mësimin para ose pas këtij vakti.
5. Pothuajse pranë çdo xhamie funksionojnë mejtepet dhe krahas shkollimit të rregullt zyrtar, jo pak fëmijë ndjekin edhe mësim-besimin fetar. Disa prej tyre vazhdojnë e mbarojnë edhe medresenë si dhe më pas Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup ose jashtë vendit. Në disa qytete, si në Shkup, Strugë e gjetiu ka edhe kolegje private turke, ku mësojnë edhe shumë shqiptarë. Numri i hoxhallarëve është i madh dhe prestigji i tyre është më i madh sesa i njerëzve të tjerë të shkolluar. Thjesht, në oda hoxha e ka fjalën kryesore. Ligjërimi i tyre me plot terme orientale ndikon dukshëm në përhapjen e orientalizmave. Në fshatin Grushinë të Karadakut të Shkupit, fjala vjen, thuhet “ra n’ruqu” për ra në gjunj. Po në Karadak kemi regjistruar fjalën avxhi “për gjuetar” etj.
 6. Deri vonë turqishtja te ne është konsideruar si gjuhë e kulturës dhe si tregues i një shtrese më të ngritur të shoqërisë. Qytetarët kanë ditur edhe turqisht, ndërsa katundarët vetëm shqip.
 7. Në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Shkupit jo pak shqiptarë studiojnë turqishten jo vetëm si gjuhë të huaj, por edhe në studimet katërvjeçare në degën e përkthimit e të interpretimit.
 8. Denduria e përdorimit të orientalizmave është mjaft e madhe edhe në maqedonishten dialektore, dhe siç dihet, disa prej tyre kanë depërtuar edhe në maqedonishten standarde. Shqiptari i Maqedonisë Veriore shumë fjalë orientale i dëgjon jo vetëm kur flet shqip, por edhe kur flet e kur dëgjon maqedonisht. Gjykojmë se përdorimi në dy gjuhë rrit dendurinë e përdorimit të këtyre huazimeve.
 9. Ndikimi i kulturës orientale vërehet dukshëm në kulturën materiale e shpirtërore të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, mbase në mënyrë më të theksuar se te shqiptarët e tjerë në Ballkan. Ne bëjmë një jetë pothuajse orientale. Kjo vërehet edhe në mënyrën e jetesës, në objektet e banimit, në interier, në kuzhinë, në veshmbathje, në artizanate, në doke e zakone, në ceremonitë e fejesës, të dasmës e ato mortore etj.
 10. Gjurmë të fuqishme të kulturës orientale te ne shprehen edhe në toponimi e në antroponimi. Përveç disa emrave vetjakë kombëtarë, mbizotërojnë emrat orientalë. Pothuajse 80% e emrave personalë të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut janë me prejardhje orientale.
 11. Ka disa vjet që në televizionet e Maqedonisë së Veriut në shqip e në maqedonisht po emetohen shumë seriale filmike turke. Ato përcillen me një interesim shumë të madh saqë edhe në ndeja, në punë me kolegët e gjithkund po komentohen. Me përcjelljen e këtyre serialeve janë përditësuar e po përhapen shumë fjalë turke aq sa disa kanë arritur edhe të mësojnë shumë fjalë të reja turke, mbase edhe pak turqisht.

5.3. PËRSHTATJA E HUAZIMEVE SLLAVE E TURKE

30. Në të folmen e Karadakut të Shkupit, si edhe në të folmet e tjera dhe përgjithësisht në të gjitha gjuhët, fjalët e gjuhës dhënëse i janë përshtatur rregullave të përgjithshme të gjuhës marrëse.

31. Përgjithësisht, turqizmat dhe sllavizmat në të folmen tonë e ruajnë kuptimin themelor

që e kanë edhe në gjuhën dhënëse. Në të vërtetë, regjistri i atyre fjalëve ndonjëherë ngushtohet apo zgjerohet varësisht nga konteksti. Së këndejmi, kuptimi i fjalës së huazuar mbetet i pandryshuar, mirëpo huazimet në të shumtën e rasteve përshtaten ndaj rregullave fonetike, morfologjike dhe sintaksore të kësaj të folmeje. Për shembull, të përmendim se përbërja fonematike e fjalës mbetet e pandryshuar (përveç disa ndërrimeve të posaçme fonetike e theksore); fjalët përshtaten ndaj sistemit morfologjik: foljet e huazuara i marrin mbaresat foljore të shqipes si fjalët e gurrës shqipe... Kjo mund të shpjegohet me atë që:

a) është huazuar nëpërmjet rrugës së drejtpërdrejtë, pa ndërmjetësimin e ndonjë gjuhe të tretë;

b) folësit shqiptarë nga ky areal janë dygjuhësh dhe se fjalën e njëjtë e përdorin kur flasin shqip dhe maqedonisht; dhe

c) gjuhët e njëjta janë në kontakt të drejtpërdrejtë dhe intensiv.³⁹⁴

Përmbledhtas, përshtatja e sllavizmave dhe e orientalizmave në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit mund të paraqitet si në vijim:

32. Sllavizmat emra që në gjuhën dhënëse janë të gjinisë asnjësore më së shpeshti janë integruar në gjininë femërore, ndërsa më rrallë në gjininë mashkullore. Krahaso shembujt: *da:lt* (< dalto) ‘daltë’, *si:t* (< sito) ‘sitë’, *kori:t* (< korito) ‘koritë’ etj. në variantin e gjuhës shqipe në emra të gjinisë femërore. Kjo tregon se në kohën e huazimit të këtyre fjalëve, emra asnjës të pamë kjo e folme më nuk kishte.

33. Diftongimi i /i/-së së theksuar te një numër i caktuar i huazimesh (te sllavizmat dhe te orientalizmat e vjetra) kur ka kushte fonetike për shpërbërje. Në formë të diftonguar shqiptohen orientalizmat: *xhamâi*, *iqindâi*, *tepsâi*, *begjenâis*, *çivâi* e ndonjë tjetër; sllavizmat: *bullâic*, *greshâit*, *llubenâic*, *vunâic*, *kalanâic* e shumë fjalë të tjera.

34. Rënia e [ë]-së së patheksuar në fundin absolut të fjalës dhe zgjatja kompensatore e zanores paraprirëse. Emrat e gjinisë femërore të maqedonishtes që në të pashquarën mbarojnë në **-a** (të tipit: *pokana*, *mollba*, *zhallba*,... në shqip në krye të herës *pokanë*, *mollë*, *zhallbë*) në këtë të folme, si dhe në të gjitha të folmet e tjera gege, për shkak të mospërdorimit të [ë]-së së patheksuar fundore, emrat e këtillë mbarojnë me bashkëtingëllore (*poka:n*, *mo:llb*, *zha:llb*...) dhe me zanore të gjatë në trup të fjalës. Si rrjedhojë e kësaj, të gjithë emrat e gjinisë femërore, të gurrës shqipe apo joshqipe, në trajtën e pashquar dalin me zanore të gjatë në rrokjen fundore dhe pa [ë]-në fundin absolut të fjalës.

35. Përshtatja theksore e fjalëve të huazuara. Në maqedonishten theksi është i ngulitur në rrokjen e tretë nga fundi i fjalës dhe i lëvizshëm në paradigmat që merr ajo. Në këtë të folme edhe sllavizmat shqiptohen me theks në rrokjen e fundit (më rrallë në të parafundit). Khs. слаткарница > *sllatkarni:c*, продавница > *prodavní:c*, водовод > *vodovód*, домаќин > *domaqín*, грејалица > *grejalí:c*, опасно > *opásno* etj. Marrë në përgjithësi, edhe te theksimi parafundor i fjalëve sllave dyrrokëshe kemi zhvendosje të theksit në rrokjen e fundit, si: шумар > *shumá:r*, браваp > *bravá:r*, предлог > *predló:g* e të ngjashme. Numri më i madh i turqizimave e ruajnë theksin fundor, ndërsa te një numër i vogël dëgjohet zhvendosja e theksit nga rrokja fundore në rrokjen parafundore. Khs. кафе > *káfe*, тенеќ > *tenéqe*, хезвэ > *xhézve*, Fatimé >

³⁹⁴ Оливера Јашар – Настева, *Влијанието на македонскиот јазик врз албанските и турските говори во Македонија*, Македонски јазик 2, Shkup, 1957, f. 145-164.

Fatáime, Fatíme etj.³⁹⁵

36. Shtimi i zanores [ë] si rrokjeformuese te sllavizmat para ose pas rrokjeformueses [r], si: трл > *tërll*, грб > *gërb*, ‘р’ > *ërrgj*, срб > *sërb*, штрк > *shtërk* etj.

37. Dëgjohen edhe disa ndërrime fonetike të tingujve, si: buzorëzimi, zhbuzorëzimi, zëshmimi, shurdhimi, përngjashmimi, shpërngjashmimi, rënia e tingujve, metateza e ndërrime të tjera tingujsh, që janë pjesë e shprehisë nyjetimore të folësve të kësaj krahine.

5.4. FJALOR I TË FOLMES

Nga fondi i pasur leksikor i të folmes së Karadakut të Shkupit kemi përzgjedhur një sasi fjalësh që mendojmë se paraqesin interes për leksikologjinë dialektore, dialektologjinë dhe përgjithësisht për gjuhën shqipe e gjuhësinë shqiptare. Në të kemi regjistruar fjalë me karakter krahinor, që rrallë dëgjohen në të folmet e tjera; fjalë që kanë përhapje të gjerë në shqipen që të dëshmohet uniteti i shqipes në rrafshin leksikor, por kemi sjellë edhe fjalë që dallojnë nga përbërja fonetike. E njëjta fjalë është shënuar me variante fonetike autentike nëpër fshatrat përkatëse, duke dhënë në kllapa edhe emrin e fshatit ku e kemi dëgjuar fjalën. Aty-këtu kemi dhënë edhe ndonjë mikrotoponim.

Shkurtime

keq. - me kuptim keqësues, pezhorativ

kund. - fjalë me kuptim të kundërt, antonim; e kundërta

lidh. - lidhëz

emër m. - emër i gjinisë mashkullore

emër f. - emër i gjinisë femërore

nj. - njëjës

sh. - shumë

fol. - folje

ndajf. - ndajfolje

mb. - mbiemër

përem. - përemër

num. - numëror

parafj. - parafjalë

pasth. - pasthirmë

pj. - pjesëz

vjet. - fjalë ose shprehje e vjetruar

* shenja pas së cilës jepet frazeologjia ose fjala përkatëse në fjali

stand. - në shqipen standarde

³⁹⁵ Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, f. 259.

A

adet/i *emër m.* zakon, adet.
agje ndajf. vendi atje.
ahër/i *emër m.* ahur.
akëll/i *emër m.* akull.
aksham/i *emër m.* 1. mbrëmje; 2. lutja e mbrëmjes: *U fal akshami.
a:j fol. enjtur: *M'asht a:j dora.
aligjin/i *emër m.* alyxhyn. Ëmbëlsirë shumë e ngjashme me bakllavanë.
alltan/i *emër m.* ar; 2. (fig.) I vlefshëm, i çmuar, i rëndësishëm: *ti ie alltan (*stand.* Ti je ar).
alluçe/ ja *emër f.* lopë me qime të kuqe.
am/ a (Tan.) *emër f.* 1. ama e bletës; 2. nëna, mamaja (në sharje): *Ta çifsha t'amën e s'amës (në të gjitha fshatrat e Karadakut të Shkupit e në Kosovë).
ambuli/ ja *emër f.* jamulli, mbulesë e leshtë, flokëse; batanije.
amerika:nk/ a *emër f.* 1. amerikanase, banore e Amerikës; 2. lloj gruri (Str.).
anërr/a (Bll.), *emër f.* onërr/ a (Gr., Str.) ëndërr.

angjâik/ i *emër f.* 1. kacek, shakull, calik; 2. *keq.* bark i fryrë, stomak: *E ki ba barkin si angjaik.
ap folje. jap, dhuroj, fal (dikujt diçka).
apa: / a, opa:ng/ a, ope:ñ/ a *emër f.* opingë.
arnoj folje (Bll.) arnoj, qep.
arap/ i (Lub.) *emër m.* kalë i zi.
arâush/a, arush/a, arash/a *emër f.* arushë.
asker/i *emër m.* ushtar.
askerllâik/ i, askerllêik/ i *emër m.* 1. ushtri; 2. shërbim ushtarak: *Askerllâikin e kam kri n'Serbi.
atâi, atêi; 1. *për. dëftor* atij; 2. *ndajf.* vendi aty, atje; çatâi, çatâine *për. dëft.* dhe *ndajf.* vendi (ja+atij, ja+aty); pikërisht atij, pikërisht aty.
avxhi/ ja (Lub.) *emër m.* gjuetar.
azgan/ i (Gr., Tan.) *emër m.* trim, i guximshëm.
azbac/ i (Bll.) *emër m.* azavec/ i (Lub.) vjedull, baldosë.

B

babgjish/ i *emër m.* gjysh, vjehërr.
babic/ a (Tan.) *emër f.* pjesë e mullirit.
baçe/e, - ja *emër f.* kopsht, bahçe.
bagërdar/ i *emër m.* kaçamak, mëmëligë, përvëlak.
bajrak/ i *emër m.* flamur, bajrak.
bakall/ i *emër m.* bokall, vegël uji.
ba:j (Bll.) *folje* mbaj, bart, mbart.
ballkan/ i *emër m.* 1. ballkon, pjesë e shtëpisë; 2. lloj gruri (Gr.).
baski:/ ja *emër f.* gozhdë; në f. Tanushë dallojnë fjalët baski/ ja – kunj metali me

kokë të rumbullakët, ndërsa go:zhd/ a – kunj metali me kokë katrore, zakonisht për të mbathur kafshët thundrake (kuajt, qetë).

ba:th/ a e pasul (Moj.) *emër f.* fasule; gro:sh/ a (Orll., Br., Mal.)
bardak/ i *emër m.* gotë, bardhak.
bardakçi/ ja (Str.) *emër f.* mjeshtër për ndreqjen e gotave, gotëndreqës, gotëbërës, bardhakës.
bardha:nk/ a (Gr.) *emër f.* lopë me qime të bardha, bardhanë, bardhoshe.

ba:rr/ a *emër f.* (Bll.) barrë, ngarkesë, një tok sendesh që i ngarkohen një kafshe ose që i mbart një njeri për t'i çuar nga një vend në një tjetër.

balldëz-e/ ja *emër f.* motra e bashkëshortes.

batkro:s/ a (Str.); **bretko:s/ a** (Br., Orll., Moj.) *emër f.* bretkosë.

baxhanak/ i *emër m.* baxhanak, secili nga burrat që i kanë gratë motra; i shoqi i motrës së gruas.

begron (Gr.) *folje* blegëron, blegërin (zakonisht delja): *delja begron.

be:shk/ a *emër f.* bjeshkë, mal i lartë.

bellçe/ ja (Gr.) *emër f.* lopë krejt e bardhë, bardhonjë.

bellç/ i; bellço (Str.) *emër m.* ka krejt i bardhë, bardhok.

bellu:shk/ a (Lub.) *emër f.* tokë me ngjyrë të bardhë.

bërcello:z/ a (Gr.) *emër f.* brucelozë, sëmundje kafshësh. Sëmundje ngjitëse e bagëtisë që shkaktohet nga disa baktere dhe që nëpërmjet kafshëve u ngjitet edhe njerëzve.

bërdic/ a *emër f.* pjesë e parmendës.

bërdha:j/ a (Str.), bërthang/ a (Lub.), zgërdhâi/ a (Orll., Gr.) *emër f.* gërdhajtë. Pjesë e brendshme e butë e një frute ku gjenden farat, që zakonisht nuk hahet. *Bërdhaja (bërthanga, zgërdhâia) e mollës, e dardhës etj.

bërzak/ i (Str.) *emër m.* misër që rritet dhe piqet shpejt, brenda një kohe të shkurtër, më përpara se llojet e tjera të misrit.

bi:n (Bll.) *folje* mbin; nis e nxjerr krye mbi tokë, nxjerr biskun, del (një farë e mbjellë); mugullon (bari etj.): *ka bi: gruni.

bitisa (Orll., Moj.), **bitrisa** (Bll.) *folje* mbarova, përfundova, kreve, sosa (një punë).

bilur/ i (Bll.) *emër m.* gotë.

bilik/ i (Bll.) *emër m.* 1. bylyk, tufë,

kope, turmë, grumbull. 2. *fig.* Është bërë i moshës madhore, është pjekur (për çupat e çunat): Ka hi n'bilik (dikush), d.m.th. ka arritur pjekuri fizike, e kapërceu moshën e miturisë dhe arriti moshën madhore, u bë për t'u martuar.

bilmet/ i (Br.) *emër m.* bulmet; qumështi dhe prodhimet që nxirren nga përpunimi i tij (djathi, gjalpi, gjiza, kosi etj.).

birini/ ja (Br.) *emër f.* fereuxe; rrobë e zezë, me të cilën disa gra muslimane mbulojnë fytyrën kur dalin nga shtëpia.

bishta *emër sh.* (Tan.) gërshet, bishtalec; tufë flokësh si bisht, që vajzat e gratë e bëjnë duke thurur tri tufëza së bashku.

bli:gj/ a (Tan., Gr.), **blig/ a** (Tan.) *emër f.* pjesë e qerres, e parmendës, e plugut; shkop i trashë, i drejtë e i gjatë i ngjitur për pjesën e përparme të qerres, ndërsa në skajin tjetër mbrehen qetë, kuajt etj.

blla:t/ a (Gr.) *emër f.* moçal; vend a fushë me ujë të ndenjtur e me baltë; ligatë, ligatinë, çeptirë.

bo:j/ a *emër f.* bojë, ngjyrë.

bojadis (Gr.) *folje* ngjyros.

boll *ndajf.* *sasie* mjaft, kënaqshëm, mesatarisht, mjaftueshëm.

bostan/ i (Orl., Moj., Tan.) *emër m.* shalqi.

bo:llz/ a, bozëll/ a (Tan.) *emër f.* pjesë e sajës dhe e avlëmendit (vegjës, tezgjahut, vekut).

bra:n/ a (Br.) *emër f.* pendë, digë; cfrat i ngritur me gardh e me dhe, me zhavorr ose me gurë anës lumenjve a përrenjve ose gjatë bregut të detit, të liqenit etj. për të penguar vërshimin e ujërave.

bra:z/ a (Tan.), **hulli** (Moj.) *emër f.* hulli, brazdë.

bre:n/ a (Bll., Br., Lub.) *emër f.* lesë, trinë; vegël bujqësore, që bëhet me disa drurë, të thurur me thupra e zakonisht me kunjat të vegjël nga poshtë dhe që përdoret për të copëtuar plisat, për të

shtruar dheun ose për të mbuluar farën në arë.

Brenêic/ a *emër f.* (Bll.) *mikrotoponim* – arë në f. Bllacë.

brenoj (Bll., Br., Lub.) *folje* lesoj, trinoj.

brim/ a (Str., Tan.) *emër f.* brymë. *Ra bri:m e i prâishi pemt.

e britht, e shkrihët (Gr., Tan.) *mbiemër* e shkrifët; që është kokrriza-kokrriza, që thërrmohet lehtë; që nuk është i ngjeshur, jo i rrasët; që mund të shtypet a të ngjishet; kund. i ngjeshur. *To:k e britht, e shkrihët.

buba:lk/ a (Gr.) *emër f.* zool. insekt, bubë.

Bub-ël/ a (Gr.) *emër f.* zool. krimb mëndafshi.

buçil/ i (Orl., Moj.) *emër m.* pus i cekët, gropë me ujë, moçal.

buka re (< e përfutuar me shkrirjen e

ë+e=a nga forma *bukë e re*, me arsyen se xixëllonja endet dhe shndrit natën grurin kur fillon të piqet dhe me këtë fshatarët gëzoheshin se po siguronin bukën e re, pra bukën e atij viti) (Gr.) *emër f.* zool. xixëllonjë, shkëndijëz, bukurezë.

bukël/ a (Bll.) *emër f.* zool. bukël, nuselalë, bishtafurkë.

bull/ i *emër m.* buall.

bullâic/ a *emër f.* buallicë.

bumba:r/ i (Str.), brumagj/ i (Br., Mal.) *emër m.* zool. brumbull; kandërr me ngjyrë të zezë a të murrme etj., me krahë të fortë e me brirthe të gjatë, që rron nëpër drurë, në pleh etj.

butur/ i (Str.) *emër m.* butër, sëmundje ngjitëse e kafshëve njëthundrake (kryesisht e mëzave), që shfaqet me pezmatimin e mukozave të hundës ose me qelbëzimin e grykëve.

C

ca:ll/ i (Br., Gr.), câull/ i (Lub.), cull/ i (Tan.) *emër m.* fëmijë.

calli, calla (Br., Mal.), cëlli, cëlla (Tan., Gr., Str., Bll., Lub.) *për. pyetës* kush, cili, cila.

ca:c/ a (Br.), câuc/ a *emër f.* vajzë, cucë.

carrok/ i (Or., Moj.) *emër m.* fëmijë.

cakat/i (Bll.) *folje* cokat, kalit me çekiç (kosën ose gurin e mullirit): E cakat kosën me çakiç.

cap/ i (Gr., Orl., Moj.) *emër m.* cjap.

cërve:nk/ a (Lub.) *emër m.* lloj gruri (me ngjyrë të kuqe).

cifun/ i (Tan.) *emër m.* cifund; gyp druri a metali, që vjen duke u ngushtuar në një anë dhe që vihet në fund të lugut të mullirit për të rënë uji me forcë mbi fletët e rrotës.

cik/ i (Tan.) *emër m.* lëng.

cinga:ll/ a (Lub.) *emër f.* zile; mjet prej tunxhi, si kabanë fare e vogël dhe me gjuhëz, që nxjerr tinguj dhe që zakonisht u varet bagëtime në qafë; tingulli që nxjerr ky mjet.

ciqar/e -ja (Tan.) *emër f.* 1. cigare; 2. kabanë, zile.

cofi (Tan., Lub.) *folje* ngordhi.

conuk/ i (Bll.) *emër m.* cung; pjesa e trungut që mbetet në tokë kur presim një dru; kërcu, kërcëp. *Conuk i vjetër. Pres dru n'conuk.

cukël/ a *emër f.* 1. cukël; fundërrinat e leshit, të pambukut ose të mëndafshit, që mbeten si tufa të vogla pas shkriftimit. Cukël leshi. 2. Copë e vogël, që mbetet kur presim një rrobë ose diçka tjetër; reckë.

Ç

çajët (Orl., Moj.) *folje* çënjtet, antonim i ënjtet: *m'u ka çaj dora.

ça:fk/ a (Str.) *emër f.* sorrë, stërqokë.

çâuure/ ja (Str.) *emër f.* gëzhjojë.

çark/ i (Tan.) *emër m.* çark, pjesë e mullirit.

ça:rt (Tan.) *folje* tërbohem, luaj mendsh, shkalloj, marrosem.

çanak/ i (Gr.) *emër m.* pjatë, çanak.

çarr/ i (Tan.) *emër m.* bot. bung, çarr.

çashtëu, çashtëune *ndajf. mënyre* (Br.), çeshtu (Gr.) ashtu, pikërisht ashtu (nga çe+ashtu): Bash çashtëune asht.

çatâi/ a (Bll.), çatêi/ a (Str.) *emër f.* çati.

çe (në të gjitha fshatrat e Karadakut të Shkupit) *pjesëz ja*. Përdoret shumë shpesh si pjesë përforcuese (deiktike) e përemrave dëftorë, e ndajfoljeve të mënyrës etj.: çeki (çe+ky), çekjo (çe+kjo), çekshtëu (çe+kështu) etj.

çef/ i (Br.) *emër m.* dëshirë, zell, çejf, vullnet.

çerep/ i (St., Tan., Gr., Bll.) *emër m.* çerep (enë balte si tepsi e thellë, në të cilën dikur pjeknin bukën).

çerek/ i (Lub.) *numëror: thyesë* një e katërta e një tërësie, çerek.

çes *folje* hedh, vë, fut brenda, shtoj.

çeskin (Str.) *mbiemër* i shkathët, i zhdërvjellët, i shpejtë.

çeshëm/ a (Str.) *emër f.* çezmë.

çetfor/ i (Tan.) *emër m.* qerre që tërheqin qetë, buajt a kuajt me katër rrota, karrocë me katër rrota.

çethi (Tan., Str., Gr.) *folje* 1. qeth (flokët); 2. (fig) marr mjaltin nga hojet e bletës: e çethin bletën.

çëroj (Gr.) *folje* zhvoshk, zhvesh: *çëroj

mollën.

çfrâi (Gr.) *folje* shfryj.

çi (Gr.) *përemër* që (i cili, e cila): aj ç i punon, ka.

çifçâi/ a (Gr.) *emër f.* çifçi (bujk pa tokë, që punonte një copë nga pronat e çifligarit dhe që mbante për vete vetëm një pjesë të vogël të prodhimit).

çik/ a (Tan.); çik/ a, cac/ a (Gr.) *emër f.* vajza, vasha, çupa, goca.

çinçan (Str., Br., Orl., Moj.), çicjan (Gr.) *emër vetëm në shumës* dimi, çitjane.

çink/ a (Br., Bll.) *emër f.* tenxhere.

çimet/ i (Br.) *emër m.* sobë, koftor, shporet.

çimez/ i (Lub.) *emër m.* kotec, qymez.

çish (Tan.) *përemër* pyetës si?, çysh?

çoj (Gr.) *folje* dërgoj, bart, mbart.

çorb/ a (Tan.) *emër f.* gjellë, çorbë.

çorr/ i *emër m.* i verbër, qorr

çu *folje* ngrihu.

çukar/ i (Str., Gr., Br., Lub.) *emër m.* i vogli i buallicës, kotorr, kishk.

çukari:c/ a (Str., Lub.), çukark/ a (Gr.) *emër f.* e vogla e buallicës, kishkë.

çull/ i (Tan., Str.) *emër m.* qull (gatesë e përgatitur me miell të zier me ujë, me gjalpë e me kos).

çu:ll (Tan., Str.) *mbiemër* qullë, shumë i lagur, shumë i njomur, ujë: *U bana çu:ll (nga shiu).

çu:r/ a (Tan.) *emër f.* zool. 1. pulë deti, femra e gjelit të detit, bibë, misëroke. 2. keq. (për femrat) e paaftë (nga mendja), e ngathët, e hutuar, e shpërqendruar: *Oj çur ...

çura:n/ i (Tan.) *emër m.* zool. gjel deti, mashkulli i pulës së detit; gjeldet,

misërok. 2. keq (për meshkujt), i shpërqendruar, i paaftë (nga mendja), i hutuar, i ngathët, i marrë.

D

da:j (Br.) folje ndaj, shpërndaj: *Daje bukën! (Ndaje bukën!) *Daje mishin! (Shpërndaje mishin!).

i da:lt (Bll.) *mbiemër, fig.* 1. i kërkuar, që ka shëtitur e parë shumë vende; 2. i dalë jashtë normave a kontrollit: *Aj asht i da:lt.

dallap/ i (Bll.) *emër m.* dritare, penxhere.

da:llg/ a (Bll.) *emër f.* valë e madhe, dallgë.

dallëk/ i *emër m.* sëmundje kafshësh.

dam/ i (Orll., Moj.) *emër m.* dëm, humbje, dëmtim, e keqe; antonim me dobi.

de:g/ a (Bl.); de:gj/ a (Gr., Br.) *emër f.* degë.

dell/ i (Lub.) *emër m.* 1. dyllë;

dell/ i (Tan.) *emër m.* 2. asht i butë, dell.

derm/ a (Lub.) *emër f.* sëmundje kafshësh.

dert/ i *emër m.* brengë, shqetësim, hall; gajle, merak.

dilber/ i (Br.) *emër m.* 1. ylber (hark i ndritshëm në qiell, që ka shtatë ngjyrat e spektrit të dritës dhe që krijohet zakonisht pas shiut nga thyerja e rrezeve të diellit e nga pasqyrimi i tyre në pikat e ujit të reve. 2. shumë e/i bukur: * E kish ni ca:c (gja:l) dilber.

di:ll/ i (Lub., Br., Bl.) *emër m.* 1. diell; 2. dyllë.

dimija (Bll.) *emër f.* (pluralia tantum) dimi.

diko:llt/ a (Bl.) *emër f.* kanotierë (veshje e brendshme te gratë e ngjashme me kanotierën e meshkujve), fanellë e hollë trikotazhi prej pambuku, pa mëngë e pa jakë, që vishet në mish.

dixhit (Br., Mal.) *përemër i pacaktuar* diçka (dixhit = di+xhit) ↔ diçka = di+çka), xhit = çka: *xhit ban? – Çka (çfarë) ban?; *Dixhit nuk jam mâir – Diçka nuk jam mi:r.

domazet/ i *emër m.* dhëndër shtëpie.

done/ t (pluralia tantum) *emër m.* brekë të gjata, të mbathura, mbathje (të gjata deri në këmbë).

doni (dit), doni (he:r) (Br.) *përemër i pacaktuar* ndonjë (ditë, herë).

dorëz/ a (Bll.) *emër f.* dorezë; 2. Doreza (e një mjeti, parmendës, plugut, kosës etj.).

dre:dh/ a *emër f.* shakullinë, shtjellë; vorbull ajri, rrotullame ajri, stuhi, furtunë.

dredhëi/ a *emër f.* dredhi, mashtrim, dhelpëri, dinakëri.

dret *ndajfolje mën.* drejt.

drishk/ i *emër m.* ndryshk.

dru:gëz/ a (Bll.) *emër f.* drugë, pjesë e avlëmendit; bosht i vogël e i hollë prej druri, që mbledh fillin e tjerë me furkë.

Dh

dhâi/ a *emër f.* dhi.

dhâit (Br., Mal., Bll.), dhe:t (Gr., Lub),

dhe:t, dhi:t (Bll.) *numëror* dhjetë.

dhallt/ i (Lub., Bll., Br.) *emër m.* dhallë.

dham/ i *emër m.* dhëmb.
dhanërr/ i *emër m.* dhëndër.
dhelbën/ a (Bll., Gr., Br.) *emër f.*
dhelbër.

dhen *emër* (pluralia tantum) dhen, dele.
dhe:/ vi *emër m.* dhe-u, toka.

E

edh/ i (në të gjitha fshatrat) *emër m.*
edh, kec.
edhe (Moj., Orl., Tan.); **ene** (Str., Bll.,

Br.), **ere** (Lub., Gr.) *lidhëz* edhe, dhe, e.
e **ejte**, e ejtja *emër f.* e enjte.
eshti, eshtja (Moj., Orl.) *emër f.* etje.

Ë

ërrnoj (Str.) *folje* rroj, jetoj.
ërrsk/ a *emër f.* rrësk, risk.

F

façe/ ja (Lub.) *emër f.* faqe, anë.
fâi/ ni (Lub.), **fêi/ ni** (Tan.) *emër m.*
finjë; ujë i valuar, ku është tretur një sasi
hiri i situr, që përdorej për të larë rroba,
enë etj.; hiri i drurit të djegur i tretur në
ujë.
fâill/ i (Lub., Gr., Br.), **fill/ i** (Tan.),
fëill/ i (Bl., Str.) *emër m.* fyell.
fallak/ i (Gr.) *emër m.* 1. dash prijës i
kopesë: *dashi fallak (i kumonës). 2. *fig.*
e rrahën mirë, e torturuan: *E shtinën
n'fallak (fallaka; mjet torture: një copë
dru ku një të dënuari i lidhnin këmbët që
t'i binin shputave me shkopinj).
fâit/ i (Br.) 1. *emër m.* fyt; 2. *folje* e fâiti
– e futi, e vuri.
fell (Lub) 1. *ndajfolje* thellë. 2. i fe:ll
mbiemër i thellë.
fertâun/ a (Lub.), **fortun/ a** (Moj.,Orll.),
fërtan/ a (Br.) *emër f.* furtunë.
Feri:sht mikrotoponim në f. Bllacë.

fêis/ i (Str., Bll.), **fâis/ i** (Br., Gr.), **fis/ i**
(Tan.) *emër m.* fis, farefis, që ka lidhje
gjaku (dikush me dikë).
fëmâi (Lub.), **fmêi** (Tan.) *emër* (genre
comun) fëmijë.
fja:k/ a (Lub., Br., Mal.) *emër f.* flakë.
fjaroj (Br., Lub.) *folje* fluturoj.
fjej (Br., Lub.) *folje* flej.
fjet/ a (Br.) *emër f.* fleta, pjesë e mullirit.
fjo:k (Lub., Br.) *emër pl. tan.* floku.
fjutër/ a (Lub., Br.) *emër f. zool.* flutur.
fkellt (Br., Orll., Gr., Lub., Bll.)
ndajfolje mënyre kthjellët.*Aj fol fkellt.
fkellt i, e (Br., Orll., Gr., Lub., Bll.)
mbiemër i kthjellët.*Çiki u:j asht i
fkellt.
fli:/ ja (Gr., Br.) *emër f.* fli-a; gatesë
brumi që përgatitet me miell të tretur në
ujë, gjalpë, kos e kajmak e që shtrohen e
piqen palë-palë me saç. Specialitet i
përhapur shumë ndër shqiptarët, sidomos

në Gegëri.

fla:z/ a *emër f.* thëllëzë.

frâig/ a (Lub.), frâigj/ a (Br.) *emër f.* frikë.

fraik, filhall (Lub.) *ndajfolje* shpejt.

frâim/ a (Lub.) *emër f.* frymë, ajër, erë.

frâuth/ i (Lub.), frath/ i (Br.), fruth/ i (Orl., Tan.) *emër m.* fruth-i, li-a.

frej/ i (Br., Str.) *emër m.* dorezë e derës.

fshi:/ ja (Tan.) *emër f.* grumbull sane ose kashte, stog i vogël: *fshija e sanës.

Si duket emrin e ka marrë nga *fshij lamën*, pra gjithë kashta e bërë grumbull (stog) nga një e fshirë e lamës.

ftâir/ a (Br.) *emër f.* fytyrë.

ftere/ ja (Br.) *emër f.* tigan, fultere.

ftêin/ i (Tan.) *emër m.* tundës, tpi.

fturk/ i (Lub.), ftark/ i (Br.) *emër m.*

sfurk.

ftu:j/ a (Br.) *emër f.* ftujë, kec femër nga një vit deri në dy vjeç.

fug/i (Lub.), fugji (Br., Bll.) *folje* hudh, hedh (diçka).

fukara:/ ja (Lub., Str., Bll.) *emër f.* i varfër, i vobektë, skamnor.

fun/ i (Tan.) *emër m.* 1. fund; 2. dërrasë e rrumbullakët që shërben për të bartur bukën për pjekje.

fu:rk/ a (Lub.) *emër f.* furkë; shkop me dërrasë në majë, ku vihet shtëllunga e leshit për ta tjerrë.

Fushrrumllake *mikrotoponim* në f. Bllacë.

Fusha Bajrakit *mikrotoponim* në f. Bllacë.

G

gat (Bll.) *ndajfolje* cekët.

gaz/ i (Bll.) *emër m.* vajguri.

gërkoj (Lub., Bll.) *folje* kërktoj.

gërshêi/ a (Str.) *emër f.* qershî.

gërvan/ i (Lub., Str.) *emër m.* sorrë.

gështe:j/ a (Lub.), gushtej/ a (Orll.) *emër f.* gështenjë.

gllavêin/ a (Tan.) *emër f.* pjesë e rrotës së qerres, koka e rrotës.

gollub/ i (Orll., Moj.) *emër m.* gugushe, guguçe, kumri, pëllumb.

goveda:r/ i (Str.) *emër m.* lopar.

grani:c/ a (Str.) *emër m.* kufi.

gredel/ i (Lub.), greden/ i (Tan.) *emër m.*

pjesë e parmendës.

greh (Bll.) *folje* tërheq, ngreh.

gre:nz/ a (Br., Str.), gremz/ a (Orll., Moj.) *emër f.* grerëz.

grik/ a (Br.) *emër f.* grykë.

i groft (Bll.) *mbiemër* i ngrohtë, i vakët (për ujën).

gro:sh/ a (Lub.) *emër f.* fasule, groshë.

grumëll/ i (Lub.) *emër m.* grumbull.

gurbet/ i (Lub.) *emër m.* kurbet.

gu:sk/ a (Lub.) *emër f.* patë, rosë.

gxo: j (Br.) *folje* gëzoj.

gxof/i, cerk/a (Moj.) *emër në m. e f.* gëzof.

Gj

gja/ ja *emër f.* kafshët.

gjaj (Str.) *folje* ngjaj, përngjaj.

gja:j (Gr.) *folje* gjej (diçka).

gjajtî (Str.) *ndajfolje* gati.

gjamaz/ i (Bll., Str.) *emër m.* 1. tregtar bagëtish, xhambaz. 2. *keq.* njeri që bën punë të paligjshme, dallavere.

gjardh/ i (Bll., Str., Gr., Lub.) *emër m.* gardh-i.

gjazmen/ i (Bll., Str., Gr.), gjazmim/ i (Str., Gr.) *emër m.* gazmend, aheng.

i, e **gjatht** (Bll.) *mbiemër* i, e djathtë.

gje:j (St., Br.) *folje* blej.

gjeftëi (Bll., Br.) *folje* lodh, rraskapit.

gje:shk (Orll., Moj.) *mbiemër* i ngathtë, i ngadalshëm.

gje:g (Bll.) *folje* djeg. 2. *fraz.* m'ka me:t gje:g – në kuptimin i ka pëlqyer shumë (diçka), ose nuk i hiqet mendsh ndonjë gjë e porealizuar.

gjegëz/ a (Lub.) *emër f.* zool. zekth.

gjel/ i (Bll., Str., Br.) *emër m.* gjel, këndes.

gjep/ i (Bll., Br.) *emër m.* djep; shtrat i vogël dërrase për foshnja.

gje:shk/ a (Br., Lub.) *emër f.* bjeshkë.

gje:t/ a (Str., Br., Bll., Moj.) *emër f.* bletë.

gjerz/ a (Bll., Lub.) *emër f.* djersë.

gjërshâi/ a (Bll.) *emër f.* qershi.

gjërsha:n (Bl.) *emër plural. tant.* gërshërë.

gjij (Str., Br.) *folje* blej.

gjiks/ i (Str., Lub.) *emër m.* gjoks.

gjim/ i (Br.) *emër m.* gjym.

gjimc/ a (Gr.) *numëror* gjysmë.

gjimlek/ i (Br.) *emër m.* xhemper, pulovër.

gjin/ ja (Bll., Tan., Br.) *emër pluralia tantum* njerëz.

gjisht/ i (Bll., Str., Br.) *emër m.* gisht.

gjo:b/ a (Bll., Str., Br., Gr.) *emër f.* dënim, ndëshkim, dëm, humbje.

gjok/ i *emër m.* kalë i mirë, at.

gjo:j/ a (Bll., Str., Br.) *emër f.* gojë-a..

grih/ a (Bll.) *emër f.* grih. *Spreh thikën, briskin, sakicën, kosën me gri:h.

gjrumbull/ i (Bll.) *emër m.* grumbull.

gjrush/ i (Bll.) *emër m.* grusht.

gjuatar/ i (Bll.), gjujtar/ i (Gr.) *emër m.* gjuetar.

gjuj (Br., Gr.) *folje* 1. hedh, gjuaj poshtë (diçka), 2. gjuaj (në gjah). 3. bluaj (Str.).

Gjuri Zi *mikrotoponim* në f. Brezë.

gjurr/ a (Bll.) *emër f.* gurrë, burim.

Gjurra Katunit *mikrotoponim* në f. Bllacë.

Gjurra Ba:rdh *mikrotoponim* në f. Bllacë.

H

hafëzali (Lub.) *emër m.* lloj rrushi.

hajvan/ i *emër m.* kafshë.

hallak/ i (Lub.) *emër m.* dashi prijës i kopësë: dashi hallak.

hamamxhik/ i (Bll., Br.) *emër m.* banjë turke, zakonisht një gropë e vogël që gjendej në një skaj të dhomës ku rrinin ose flinin njerëzit, mbulohej me dërrasa kur nuk përdorej.

hanëmshar/ i (Lub.) *emër m.* mëz njëvjeç.

hanxhi/ ja (Bll.) *emër m.* hanxhi.

hanëz/ a (Bll.) *emër f.* hënë.

hasëm/ i *emër m.* armik, jodashmirës.

hasër/ a, (Bll.) hastër (Moj.) *emër f.* hasër.

hazër (Bll.) *ndajfolje* gati.

hashure (Lub.) *emër plur. tant.* ashure (ëmbëlsirë që përgatitet me grurë të zier e me sheqer, me arra, bajame, rrush të thatë, kanellë etj.).

her (Bll.) *pjesëz* herë: *di her - dy herë.

hi (Br.) *folje* hyj.

hiram/ i (Br.) *emër m.* mbulesë e disa muslimaneve.

hirr/ a (Bll.) *emër f.* hirrë; lëng si ujë, në ngjyrë të gjelbër shumë të çelur, që del kur pritët qumështi a kur kullojmë djathin e njomë ose që e nxjerr kosi pasi mpikset. Në kosovarishte *ku:sht* që rrjedh nga klumësht.

hizëll *emër m.* shumëshumës hizlli (Str.) *emër m.*

yll, yje.

hoj/ i (Bll.) *emër m.* hoje (e bletës), dyllë.

huj/ i (Str.) *emër m.* shprehi, ves.

i hu:j (Bll.) *mbiemër i* huaj .

hulli/ja *emër f.* (Moj.) hulli.

hukam/ a (Bll.) *emër f.* 1. hukamë; fryma e ngrohtë që nxjerr dikush nga goja kur hukat; frymëmarrje e thellë; zhurma që dëgjohet

kur hukat dikush a kur merr frymë thellë. 2.

Fraz. *Ma ka ni hukamën – Është i vetëdijshëm (dikush) për vlerat e mia.

hu:ngj (Bll.) *ndajfolje i, e* ulur.

Hurdhat e Lekës *mikrotoponim në f.* Bllacë.

I

ibrig/ i (Tan., Bll., Gr.) *emër m.* ibrik; enë e lartë zakonisht prej bote ose metali, me përmasa të ndryshme, me grykë të ngushtë, me vegjë e me lëfyty, që shërben për të mbushur ujë a për të pirë me të, për të zier kafe, çaj etj.

ilaç/ i (Str.) *emër m.* ilaç.

ill/ i *emër m.* shumë illzi (Tan., Br., Moj.,

Orll., Gr.) yll, yje.

i, e **i:m** *mbiemër i, e* imtë.

iqindâi/ a (Lub.), iqinâi (Bll.) *emër f.* iqindi, falje e pasdites te muslimanët.

irt/ i (Gr.) *emër m.* oborr; kopsht ose arë që gjendet pranë shtëpisë; tokë e thurur përreth shtëpisë.

izmeça:r/ i (Gr.) *emër m.* shërbëtor.

J

jacêi/ a (te të gjitha fshatrat) *emër f.* jaci, falje e mbrëmjes te muslimanët.

jahni/ ja (Tan.), janâi/ a (Orll.) *emër f.* jahni; gjellë me lëng, që bëhet me copa mishi të kaurdisura, me perime sidomos me qepë), me salcë domatesh dhe me erëza të ndryshme.

jambuli/ ja (Lub., Mal., Br., Str.) *emër f.* jamulli.

jan/ i (Lub., Bll., Br., Gr.) *emër m.* shtrojë, shtrojsë.

janxhik/ i (Tan.), jenxhik/ i (Lub.), janxhêik/ i (Orl., Moj., Bll.) *emër m.* kacek, shakull, kaçup, janxhik.

jaz/ i (Tan., Orl., Bll.) *emër m.* jaz; vijë a

hendek i vogël, që shpie ujin në mulli, në arë etj.; rrjedhë uji; vend a gropë e madhe ku grumbullojnë ujë për ujitje etj. *Jazi i mullâinit.

jelek/ i (Br., Orl., Moj., Gr.) *emër m.* jelek.

jem, jeme *përemër pronor im, ime.*

jemish, jemishllik (Orll., Moj., Bll.) *emër përmbledhës* gjelbërimë, pemë e perime.

jergan/ i (Br.) *emër m.* jorgan.

i, e **jeshilt** *mbiemër* 1. i, e gjelbër. 2. i paarrirë, i papjekur, axhami.

K

kajk/ a (Br.) *emër f.* këngë.

kajmaçin/ i (Br.) *emër m.* kajmaçin;

ëmbëlsirë që përgatitet me vezë e sheqer, përzierja hidhet në tepsi dhe piqet deri sa të ngjizet.

kalavar/ i (Str.), kalavesh/ i (rrushi) (Gr.) *emër m.* kalavesh, vesh (rrushi).

kalamand/ i (Str.) *emër m.* man, dudë, man i zi.

kallauz/ i (Str., Br.) *emër m.* ama e bletës.

kallâi/ ni *shumës* kallâi (Str.) *emër m.* kalliri (i grurit).

e **kallamojt** (Tan., Br.) *mbiemër* e misrit (zakonisht për bukën). *Buk e kallamojt – Bukë misri.

kampir/ i (Br., Mal., Moj.) *në shumës* kampira *emër m.* patate.

kapuç/ i (Gr.) *emër m.* kapelë, kësulë, qeleshe.

kaproll/ i (Gr.), kaprall/ i (Br.) *emër m.* kaproll.

kastravâic/ a (Br.) *emër f.* trangull, kastravec.

karpuz/ i (Str.), bostan/ i (Moj.) *emër m.* shalqi.

katan/ i (Br., Moj.), katôund/ i (Str.) *emër m.* katund, fshat.

kâun/ i (Str., Br.) *emër m.* pjepër.

e **kastêisa** (Str.) *folje:* e fik, e zvoqëlon, e ndal (llambën): *E kastêis llambën – Ia ul flakën, e ndal llambën e vajgurit.

ket (Gr., Str.) *përemër dëftor* këtë.

kerr/ i (Br.) *emër m.* qerre, karrocë.

kep/ i (Str., Br.) *emër m.* kep, shkëmb i madh e i thepisur.

Kepi Shipes mikrotoponim në f. Bllacë.

kërcu/ ni (Bll.) *emër m.* trup, kërcu, cung (druri) zakonisht që mbetet në dhe pas prerjes së lisit a pemës.

kërhan/ i (Str.) *emër m.* krehër avlëmend, pjesë e vekut.

kërsêi (Str.) *folje* kursej.

kërshlak/ i (Str.) *emër m.* lepurush, këlysh leपुरi, lepur i vogël.

ki:j (Str.) *folje* krasit: *E ki:n rrôushin.

kingj/ i (Br., Moj., Orll., Lub., Str.) *emër m.* qengj.

klish/ i *emër m.* (Moj, Br., Mal. etj.) këlysh.

klish trolli (Br.) *emër m.* zool. këlysh dheu.

kllaçe/ ja (Br.), klluçe (Gr., Moj.), klloukçe (St.) *emër f.* kllukë, klluçkë (pula).

knus/ i (Tan., Gr.) *emër m.* gjel, këndes.

koçak/ i, koshtar/ i (Br.) *emër m. m.* kotec (pulash).

kollpite/ ja *emër f.* (Tan.), korbllak/ i *emër m.* (Str.) gatesë me petë të holluara një nga një që u hedhet mish i grirë ose djathë, vezë, presh, patate, spinaq etj., të mbështjella si rrotullamë në tepsi dhe që piqet në furrë.

konak/ i (Br.) *emër m.* konak.

komare/ ja (Moj.) grumbull me kashtë ose sanë, me një mullar në mes: *komare me kasht.

korb/ i (Br., Str.) *emër m.* korb; zog me trup të madh e me pendë të zeza. 2. *fig.* shumë i zi: *Ish ba: korb i zi.

kosh/ i, kroshe – kosh i vogël apo shportë (Br., Moj.) *emër m.* kosh, shportë.

kot (Str.) *ndajfolje* asgjë, hiçgjë.

kotar/ i *emër m.* (Moj.) zgjua (bletësh): *kotari bletve.

kravabec/ i (Br.) *emër m.* sëmundje pulash.

krâip speci (Br.) *emër m.* biber i kuq, specia të kuq të tharë e të thërrmuar imët.

krroç/ i (Tan.) *emër m.* garuzhdë.

kshiri (Br., Str.) *folje* shikoj.

kuçk/ a (Str.), kudër/ a (Br.), kudër, kuçk (Moj.) *emër f.* 1. bushtër, buçe, shakë, femra e qenit. 2. *keq.* për femrat: *A moj ku:çk!

kufâi/ ni (Br.) *emër m.* kufi.

kujn/ i (Str.) *emër m.* kunj, hu.

kuk/ i (Str.) *emër m.* kofshë.

kumbon/ a (Str.) *emër m.* kambanë.
kundër/ a (Str., Gr.) *emër f.* këpucë.
kundraxhi/ ja (Str.) *emër f.* këpucar.
kurrgja (Str.) *për. i pacaktuar* asgjë.
kurpnâi/ a (Br., Mal.) *emër f.* bot. vend ku rriten drunj kacavarës.

kusâi/ a (Br.) *emër f.* kusi.
kup/ a (Str.) *emër f.* kupë (enë).
kuprece/ ja (Bll.) *emër f.* kupac; kupë e drunjte me kapak që puthitet mirë, të cilën e marrin zakonisht barinjte me vete të mbushur me gjizë, me djathë etj.

L

lagji (Br., Gr.) *folje* lag, bëj me ujë.
laknar/ i (Br.), laknur/ i (Tan.) *emër m.* lakror.
lang/ i (Gr.), lanj/ i (Tan.) *emër m.* 1. lëng, 2. gjizë e tëholluar me ujë.
langshe (dardha) (Bll.) *mbiemër* lloj dardhe shumë e lëngshme (dardha më e lëngshme, më e ëmbël e më e shijshme në Karadak aq sa kur e kafshon pikon ujë), dardhë ujtëse.
lap/ a (Br.) *emër f.* gjeth, gjethe.
largj (Gr., Br.) *ndajfolje* larg.
laroj (Br.) *folje* lëroj, lëvroj.
lasht/ a (Bll.) *emër f.* lagështi-a.
legjen/ i (Gr.) *emër m.* legen.
ler/ a (Tan.) *emër f.* grumbull, tog: *Ni le:r me gjur.
lesk/a (Br.) *emër f.* lesë me thupra të thurura për të bartur pleh.

liç/ i (Br.) *emër m.* pjesë e avlëmendit.
like/ ni (Bll.) *emër m.* liqen, moçal, pus i cekët që mban rregullisht ujë.
lip/ a (Str.) *emër f.* bot. bli-ri.
liqore/ ja (Tan.) *emër f.* shuli i derës.
lkoj/ a (Br., Mal.), liki/ ja (Bll.), ukic/a (Str.), ujkin/ a (Gr.), ukoj/ a dhe ulukoj/ a (Lub.) *emër f.* ujkonjë.
lnâur/i (Br.) *folje* lënur (lesh).
lugj/ i (Br.) *emër m.* lug-u, koritë, govatë (e përftuar me qiellzorizimin e [g] > [gj]).
Lugji Vol *mikrotoponim* në f. Bllacë.
Lugj t'Oroshit *mikrotoponim* në f. Bllacë.
lugjovâin/ a (Br., Bll.) *emër f.* luginë.
lumâishk/ i (Bll.) *emër m.* bot. lëmyshk.
lurk/ a (Br.) *emër f.* jakuce, lurkë.

LI

llaf/i *emër m.* fjalë, bisedë, tregim.
llam/a (Orll., Moj., Gr.); llambe, llombe/ ja (Str.); llom/ a (Tan.) *emër f.* llambë.
llastar/ i *emër m.* (Br.), llastër/a *emër f.*

(Tan.) *bot.* syth, bulë.
lloç/ i *emër m.* baltë.
llobonâic/ a (Gr.) *emër f.* shalqi.

M

maçek/ i (Bll., Orll., Br.) *emër m.* dac, maçok, maçorr.

majstor/ i *emër m.* mjeshtër.

malok/ i (Orll., Moj., Br.) *emër m.* njeri me përkatësi nacionale të përzier shqiptaro-rom.

manësh (Gr.) *ndajfolje* anash, përskaj.

man/ i (Bll.), manëz/ a (Br.), kalamand/ i (Str.) *emër m.* man, dudë.

masall/ a (Br., Gr., Orll., Moj.), musall/ a (Str.) *emër f.* tregim popullor, përrallë. 2. *keq.* fjalim a të folur i panevojshëm, i padobishëm e i pavend.

Mashën / mashna (Bll., Lub.) *emër f.* pleme, plevicë.

mashtrape/ ja (Br., Str.) *emër f.* mashtrapë; enë me një vesh, zakonisht prej metali, që përdoret për të pirë ujë, qumësht etj.

mat-mat (Br.) *pasthirrmë* kështu ndjellin bletët.

matan (Bll., Lub.) në atë anë, përtej, në skajin tjetër (e përfutur fonetikiisht nga: më atë anë > matanë > mata:n).

magjar/ i (Br., Mal., Moj.) *emër m.* gomar.

magjari:c/a (Br., Mal., Moj.) *emër f.* gomare.

magje/ ja (Br.) *emër f.* magje; mobile e dikurshme në formë arke, ku ngjishej e punohej brumi për të bërë bukë; ku mbahej edhe një sasi e miellit e nevojshme për gatim, por edhe buka.

mazujk/ a (Tan., Bll.), mazojk/a (Moj.) *emër f.* mëz femër.

mbashtroj (Lub.) *folje* mashtroj.

mec/ a (Br., Bll.) *emër f.* arushë.

meçav/ a (Bll. Br.) *emër f.* ortek.

men/ ja (Bll., Orll., Gr.), mendje/ ja (Str., Lub.) *emër f.* mend, mendtë.

meshtër/ i (Bll.) *emër m.* mjeshtër.

mejez/ i (Tan.) *emër m.* 1. mëngjes; 2. periudha e paradites kur lëshojnë bagëtinë të kullosin.

misirk/ a (Lub., Br.) *emër f.* pulë deti.

mishmoll/ a (Str.) *emër f.* mushmollë.

mitan/ i (Bll.) *emër m.* mitan; veshje e sipërme prej shajaku, prej doku etj., si jelek me mëngë që kopsitet përpara.

motmot/ i (Bll.) *emër m.* motmot, një vit.

mqa:k u (Br.) *folje* u plak, mplak (dikush).

mrapa (Bll.), mbas (Lub.) *ndajfolje*, *parafjalë* pas, prapa, mbas.

mtra:sh (asht) (Br.) *folje* shëndoshë, trashë, ka shtuar peshë.

mullak/ i (Bll.) *emër m.* kënetë, vend i lagët.

mullisk/ a (Tan.) *emër f. zool.* mullizezë.

mumrâim/ a (Bll.) *emër f.* murmurimë.

murall/ i (Orll., Moj., Str.), murrall/ i (Tan.), mullar/ i (Br.) *emër m.* 1. stok a grumbull kashte, sane (e paluar mirë në formë të konit); 2. mullar, strumbullar, me kuptimin: hu i drejtë e trashë që ngulet thellë në tokë rreth të cilit ngjishej e palohet sana për ta ruajtur nga erërat e forta e për ta përdorur dimrit për të ushqyer bagëtinë. 3. *fig.* qendra, gjëja më e rëndësishme, më e qëndrueshme, më e palëvizshme e diçkaje. *Burri asht muralli i shpâiës.

mushallak/ i (Orll., Moj.) *emër f.* pështjellak, përparëse (në kosovarishte pshallak).

mushjtjerr/ a (Moj., Orll.) *emër f.* mëshjtjerrë.

mutaf/ i (Orll.) *emër m.* cergë, shtrojë me lesh dhish.

mutâi/ ni (Bll., Moj.) *emër m.* tundës (në geg. verilindore tpi:)

muzat/ i *emër m.* (në të gjitha fshatrat)

mëzat, dem.

N

nalle/ ja *emër f.* nallane; lloj heqlash prej një cope druri të latuar sa shputa e këmbës dhe me rrip përsipër, që mbahen nëpër shtëpi a nëpër oborr.

nallexhi/ ja *emër f.* nallanepunues, nallanendreqës, ndreqës i nallaneve, nallanexhi.

nâi (Gr.), ndêi (Str.), nij dhe ngjoj (Bll.) *folje* dëgjoj, ndjej.

nama (Tan., Bll., Lub.) *folje në urdhërore* ma jep!, jepma!, ama!

namazbez/ i (Bll.) *emër m.* mbulesë grash muslimane për të mbështjellë kokën (e domosdoshme gjatë faljes, namazit, pra pëlhurë namazi).

ndim/ a (Gr., Bll.), ndihëm/ a (Tan.),

na:j (Br.) *emër f.* ndihmë: *Duhët m'i na:j atâi - Duhet t'i ndihmojmë atij.

ndrêishe (Str.), nrâishe (Br.) *ndajfolje* ndryshe, tjetër fare.

negjëll/a (Bll.) *emër f.* mjegull.

netëll/a (Bll., Orll., Moj.) *emër f.* fshesë.

nërbarke/ ja (Br., Bll.) *emër f.*

ndërbarke, rrip samari që rri nën barkun e gomarit.

nërbishte/ ja (Bll., Br.) *emër f.*

ndërbishte, rrip i samarit që shkon ndër bishtin e gomarit, rreth kofshëve.

nërskamce/ ja (Br., Tan.), nërkamc/ a (Bll.) *emër f.* ndërkëmbje, pjesë e avlëmendit; vendi ku vihen këmbët në tezgjah për të lëvizur liqtë.

ngas (Gr.) *folje* 1. vrapoj; 2. ngas, drejtoj (qerren).

ngarendi (Lub.) *folje* vrapoj, ngarend, rend.

ngrêiti (Str.) *folje* ngre, çoj përpjetë.

ngjij (Gr., Orll., Moj.) *folje* lyej (bukën) me diçka të lëngshme.

ngjoj (Tan., Lub.) *folje* dëgjoj.

ni *përemër i pacaktuar* një: *ni nje:r – një njeri.

nishan/ i *emër m.* 1. shenjë; 2. cak (në gjuajtje).

noj (Gr.) *folje* vendoj, vë, vendos.

nort/ a (Br.) *emër f.* opinga lëkure të punuara me dorë.

nrâidhe/ ja, nrêidhe/ ja (Bll.) *emër f.* gatesë me brumë të dendur që piqet në furrë e që përvëlohet me gjalpë; *krahinore* ndrydhe, krelanë, filhalle (që përgatitet shumë shpejt, filhall = shpejt).

Nj

nja *numëror* një.

njalt/ a (Br.) *emër f.* mjaltë.

njekërr/ a (Br.) *emër f.* mjekër.

njek (Br.) *folje* 1. ndjek, shkoj pas, përzë. 2. *për kafshët* ndërzohet: *Po

njeket lopa – Po ndërzohet lopa. I çon kiet.

njer te parafjalë deri te.

njerk/ a (Str., Lub.) *emër f.* njerkë.

njers/ a (Gr.) *emër f.* djersë.

njoj (Br.) *folje* dëgjoj.

O

od/ a *emër f.* odë, dhomë burrash (enkas për mysafirë).

ogërshak/ i (Orll., Moj.) *emër m.* pjesë e avlëmendit.

ogiç/ i (Tan., Bll.), **ogjiq/ i** (Br., Mal., Moj.) *emër m.* ogiç, dash prijës.

ondërr/ a (Lub., Str.) *emër f.* ëndërr.

oposhtâin/ a (Str.), **opshtin/ a** (në formën e fundit në të gjitha fshatrat e tjera të Karadakut) *emër f.* komuna, bashkia.

opeņ/ a (Br., Str.) *emër f.* opingë.

ortake/ ja *emër f.* shemër, gratë që kanë një burrë të përbashkët.

oriç/ i (Bll.), **iriç/i** (Moj.) *emër m.* iriç.

orith/ i (Bll.) **urth/i** (Moj.) *emër m.* urith.

os/ i, os/ ki *emër m.* bosht.

ôudh/ a (Str.) *emër f.* udhë, rrugë.

ôuk/ i (Str.) *emër m.* ujk.

ovçar/ i (Gr.) *emër m.* delmer, bari (dhensh).

oxhak/ i *emër m.* tymtar, oxhak.

P

pagjuj (Gr., Bll.) *folje* paguaj.

paha (Br.), **paska** (Str.) *folje* paska.

pakërcej (Lub., Str., Gr.), **kapërcej** (Tan.) *folje* kapërcej, kaloj, tejkaloj..

panike/ ja (Tan.) *emër f.* lopatë për miell.

parmen/ a (Tan.) *emër f.* parmendë.

pasëm (i) (Tan.) *mbiemër* i pasur.

pasul/ i (Tan.) *emër m.* fasule, groshë.

pelte/ ja (Lub.) *emër f.* një lloj ëmbëlsire; ëmbëlsirë si qull i trashë, që përgatitet me niseshte e sheqer, paluze; lëng pemësh a perimesh që lihet të trashet duke zier në zjarr.

pesak/ i (Br.) *emër m.* rërë, rëra.

peshk/ i *emër m.* peshk.

pet/ a (Br.) *emër f.* pite, lakror.

peqe/ ja (Br.) *emër f.* hiram i zi, mbulesë e zezë e grave muslimane.

përza: (Lub.) *folje* përzë, dëboj.

përfuni (Tan., Bll.) *ndajfolje* nën, përfund.

përnime (Br., Tan.) *ndajfolje* vërtet, me të vërtetë, përnjëmend.

përlak/ i (Br., Tan.), **përrlak/i** (Moj.)

emër m. kërraç, pulisht, gomar i ri, visk, i vogli i gomaricës.

përlic/ a (Str., Gr.) *emër f.* e vogla e gomaricës, kërraçe.

përpeç/ i (Tan.) *emër m.* përpeç; lloj qumështori me një petë, me vezë të rrahura me qumësht dhe me djathë të njomë, që piqet në tepsi; lloj byreku me qumësht e me djathë të njomë.

përgjims (Str.) *ndajfolje* përgjysmë, në gjysmë.

përlant (i) (Gr.), **i pëllomt** (Bll.) *mbiemër* i përlyer, i papastër, i baltosur, i fëlliqur. .

përplasi (Gr.) *folje* gjuajti, hodhi, shkundi.

pilaf/ i (Bll.) *emër m.* pilaf; gjellë e përgatitur vetëm me oriz, i cili zihet në ujë a në lëng mishi, bëhet i thatë e i shkrifët e përvëlohet me gjalpë.

pikaderdhi (Bll.) *folje* stërpik, spërkat, derdh pika-pika (diçka).

pihati (Str.) *folje* lodh: *U pihata – U

lodha.

plac/ i (Bll.), plënc/ i (Tan.), planc/ i (Gr.) *emër m. anat. plëndës.*

pllat/ a (Str., Gr.) *emër f. pagë, rrogë, të ardhura mujore.*

pllan/ i *emër m. plan. *Aj punon me pllan – Ai punon me plan.*

pogaçe/ ja (Tan.) *emër f. pogaçe, kulaç i grunjtë.*

postat (Lub.) *folje lodh. *Jam postat – Jam lodhur.*

potpore/ ja (Tan.) *emër f. shtyllë mbështetëse, përforcuese (e diçkaje).*

pop/ i *emër m. prift.*

pra: (Br.) *folje në pjesore pru > prâu > pra^u > pra:* (në shqipen standarde: prurë, sjellë).

prag/ i (Br., Tan., Str.), pragj/ i (Orll.) *emër m. prag.*

pra:p (i) (Orll., Moj., Bll.) *mbiemër njeri që punon keq, i mbrapsht,*

ngucakeq, keqbërës.

presh/ i (Lub.) *emër m. presh.*

pregëll/a (Moj.) *emër f. pjergull.*

primati (Br.) *folje pranoj, marr.*

prroj/ ni (Bl.) *emër m. përrua.*

Prroj Livadheve *mikrotoponim në f. Bllacë.*

Prroj Cakullave *mikrotoponim në f. Bllacë.*

pshallak/ i (Tan.) *emër m. përparëse.*

pubëz/ a (Tan., Lub.) *emër f. zool. pupëz.*

pupli/ ja (Orll., Str., Bll.) *emër f. pendël (pule).*

pveti (Br.) *folje pyes (e përftuar me shndërrimin e [y]-së në [v], me përngjashmim grupesh të bashkëtingëlloreve për të lehtësuar shqiptimin në këtë rrugë: pyeti > pveti > në disa të folme deri në formën veti.*

Q

qanc/ i (Br., Str., Lub.) *emër m. plëndës.*

qe (Orll. Moj.) *emër m., shumësi i emrit ka ~ qe (në disa të folme ka ~ kie).*

qeqni/ ja (Br.), pleqnâi/ a (Bll.), qeqsâi/ a (Lub.), qeqsêi/ a (Str.) *emër m.*

pleqëria, pleqësia.

qegëll/ a (Lub.) *emër f. pjergull (rrushi).*

qef/ i (Bll.) *emër m. qejf, dëshirë.*

qeh/ i (Br., Str.) *emër m. pleh.*

qeki (Lub.) *folje pjek, poqa.*

qell (Lub.) *folje pjell, lind (dikush dikë).*

qepi (Br., Str., Lub.) *folje qep (me gjilpërë).*

qep/ a (Lub.) *emër f. bot. qepë.*

qilah/ i (Tan.) *emër m. kungull i bardhë (në disa të folme: hotin, vidim).*

qosh/ i (Orl., Br., Str.) *emër m. skaj, kënd.*

qot (Br., Str., Lub.) *ndajfolje plot.*

quhën/ i (Br., Str., Lub.) *emër m. pluhur.*

qum/ i (Br., Str.) *emër m. plumb.*

R

rab/ a (Lub.) *emër f. qerre.*

rabush/i (Br., Str.) *emër m. vjet. 1.*

çetele, shkop i shkurtër për identifikim

(me një, dy e më shumë prerje si thellim në rabush) zakonisht të thasëve me grurë kur i dërgonin në mulli për të bluar. 2.

fig. keq. njeri i trashë nga mendja, karabush, dudum.

raj (Br.) *folje* ruaj (ruej > ru:j > râuj > ra^uj > raj).

raki/ ja *emër f.* raki, alkool.

re/ ja *emër f.* nusja e shtëpisë për vjehrrin e vjehrrën.

rek/ a (Str.) *emër f.* lum, përrua.

rez/ a (Orll., Moj.) *emër f.* doreza e

derës.

ro/ e (Str.) *folje kalim.* ma zë syri, më bie në sy; e shoh, e vëj re, e vërej.

ros/ a (Str.) *emër f.* patë, rosë.

rude/ ja (Str.) *emër f.* rudë, dele me lesh të butë, të dendur, të shkurtër e të dredhur të cilësisë shumë të mirë: *delja rude.

Rr

rrâi (Lub., Str., Br.), rrêi (Bll.) *folje* rri. i **rra:ll** (Str.) *mbiemër* i rrallë, jo i shpeshë.

rranëz/ a (Br.) *emër f.* rrunë, qengj motak femër, qengj njëvjeçar femër.

rrâiçën/ a (Lub.), rriçën/ a (Str.), rrâiçën/ a (Br.), rrêiçën/ a (Bll.) *emër f.* zool. rriqër, këpushë.

rrake (Str., Br., Orll.) *emër pl.* tant. gjëra, plaçka, tesha, grumbull sendesh.

rrakataçe/ ja (Tan.) *emër f.* pjesë e mullirit, çakalle; copë dërrase, që përplasët mbi gurin e sipërm të mullirit, kur ky rrotullohet dhe që rregullon rënien e kokrrave të drithit midis mokrave pak nga pak prej lugut të koshit; trazë.

rrafsh (Bll.) *ndajfolje* 1. plot, përplot, deri në majë, në grykë (e mbushur diçka); 2. *emër* rrafsh, sheshinë, rrafshinë.

rrash/ i (Br., Orll.), rrôush/ i (Str.), rrush/ i (Tan.) rrësh/ i (Gr.) *emër m.* rrush.

rrah/ a (Br.) *emër f.* shteg i hapur në borë.

rranëim/ i (Str.), rrênâim (Lub.), rrenim (Orll., Moj.) *emër m.* 1. përmytje,

vërshim; 2. rrënim, shembje e madhe (dheu, gurësh etj.).

rre:j (Br., Str., Lub., Bll., Moj.) *folje* gënjej.

rréh/i (Bll.) *folje* rrah (dikë).

rrëgzin/ a (Tan.), rrogzin/ a (Br., Mal.) *emër f.* zhallogë; copë prej lëkure ose prej leshi që vihet në tabanin e opingës, zakonisht nga brenda, për të mbrojtur putrën e këmbës; copë e vogël lëkure që përdoret për të arnuar këpucët.

rrogtar/ i (Tan., Orll., Moj.) *emër m.* shërbëtor, njeri që punon në shërbim të dikujt e që paguhet, merr rrogë+tar = rrogëtar > rrogtar.

rrogj/ a (Orll., Moj.) *emër f.* rrogë, pagë.

rroj (Orll., Lub., Br.) *folje* jetoj, rroj.

rrep/ a (Str.) *emër f.* bot. rrepë.

rrumâisht (Lub.) *ndajfolje* me rrëmbim, rrëmbyeshëm, me tërbim, fuqishëm: *po be shâi rrumâisht – po bie shi rrëmbyeshëm.

rrupim (Orll., Moj.) *ndajfolje* me rrëmbim, rrëmbyeshëm, me tërbim, fuqishëm, rrumâisht: *po be shâi me rrupim – po bie shi i rrëmbyeshëm (*si mbiemër*).

S

sabah/ i (Tan., Bll., Gr.) *emër m.* 1. mëngjes, 2. lutja e mëngjesit të muslimanët.
saballëik/ i (Bll.) *emër m.* 1. shujta, të ngrënë e mëngjesit, vakti i mëngjesit, i paradites. 2. veshje e grave (zakonisht e nuseve) si fustan që veshin paradite kur bëjnë punët e shtëpisë.
saç/ i (Str.) *emër m.* 1. saç. 2. *fig.* të keqen, e shtrëngoi, e ngushtoi (dikë shumë): *ja ka pra saçin m'atë krëie.
sâi/ ni (Br., Gr., Lub.), *sêi/ ni* (Bll., Str.), *si/ni* (Tan.) *emër m.* sy.
sahat/ i *emër m.* orë, sahat.
sakic/ a (Tan., Br.) *emër f.* sëpatë.
sallat/ a (Bll., Gr.) *emër f.* kastravec, trangull.
samar/ i *emër m.* samar.
sahan/ i (Br., Tan.) *emër m.* pjatë.
sefte (Bll.) *ndajfolje* për herë të parë, në fillim, në nismë.
setëll/ a (Br.), *sjetëll/ a* (Tan.) *emër f.* sqetull.
senik/ i (Tan.), *snëik/ i* (Bll.) *emër m.* arkë, sënduk.
sepet/ i (Tan.) *emër m.* sepete, arkë e vogël, shportë.
sipri (Br.), *sâipri, sêipri* (Lub.) *ndajfolje* mbi, lart, përmbi, nga ana e epërme, nga

ana e sipërme.
skërmill/ i (Tan.), *skërmâill/ i* (Br., Mal.) *emër m.* kërmill.
skifter/ i (Bll.) *emër m.* zoo. skifter, sokol.
skutaqe/ ja (Bll.) *emër f.* përparëse.
slluzhbenik/ i (Gr.) *emër m.* nëpunës.
smonic/ a (Tan.) *emër f.* lloj toke.
sofër/ a (Str., Lub.) *emër f.* sofër.
sqanc/ i (Str.) *emër m.* plëndës.
sqap/ i (Br., Str., Lub., Moj.) *emër m.* cjap.
struj/ a *emër f.* rrymë elektrike.
strofëll/ a, *strofkëll/ a* (Str.), *strofle/ strofla* (Bll.) *emër f.* strofull, qerthull, çerdhe.
stërnâip/ i (Br.) *emër m.* stërnip.
stërpâiki (Br.) *folje* stërpikë, spërkat.
strajc/ a (Tan.) *emër f.* strajcë, trastë, torbë.
sosi (Bll. Orll., Moj.) *folje* kryej, mbaroj, përfundoj (një punë, diçka).
sorr/ a (Bll.) *emër f.* sorrë.
soh/ a (Tan.) *emër f.* hunjtë, drunjtë e gardhit të thurur me thupra; *në shumës* sohat (e gardhit).

Sh

shâi/ vi (Br., Gr.), *shêi/ vi* (Tan., Str.) *emër m.* shi-u.
sha:j (Gr.) *folje* shij (drithin, grurin).
shajk/ a (Br., Gr.) *emër f.* gozhdë.
sha:m (Br.), *shôum* (Tan.) *ndajfolje* shumë.
shamâi/ a (Bll., Br., Gr.), *shamêi/ a* (Tan.) *emër f.* shami.

shapth/ i (Bll.), *shap/ i* (Gr., Str., Lub.) *emër m.* shap, sëmundje kafshësh; sëmundje e rëndë ngjitëse, që zë kryesisht gjedhin dhe që shfaqet me disa flluska në gojë, në gji e në thundër.
sharlagan/ i (Gr.) *emër m.* *vjet.* vaj që dikur e përdornin në kuzhinë.
shek/ a (Br., Gr.) *emër f.* sheke; enë

druri e rrumbullakët e me madhësi të ndryshme, që bëhet me dërrasa të ngushta të shtrënguara me r Rathë ose duke bashkuar dy gjysma të një trungu të gdhendur përbrenda dhe përdoret për të mbajtur në të bulmet ose turshi.; vedër.

shem/ i (Lub.) *emër m.* prag.

shermen/ ja (Orll., Moj., Lub.) *emër f.* shermend, pjergull e vjetër rrushi.

ship (Bll.) *ndajfolje* shqip.

shipe/ ja (Lub., Str., Tan.), *shipojn/ a* (Gr.), *shiponj/ a* (Bll.) *emër f.* shqiponjë.

Shingjergj/ i *emër m.* Shën Gjergji (dita e Shën Gjergjit).

shim (Bll., Gr.) *folje* shuan, fik: *e shim zarmin – e shuan zjarrin.

i **shkrihët** (Tan.), i **shkrëift** (Lub.) *mbiemër e shkrifët, që thërrmohet lehtë, që nuk është i ngjeshur (toka etj.)*

shkra:j (Br.) *folje* shkruaj.

shkus/ i (Lub.), *msit/i* (Moj.) *emër m.* shkues, mësit, lajmës, mblesës.

shkusovâic/ a (Br., Gr., Str.) *emër f.* shkuese, mësite, lajmëse, mblesëse.

shkeps/ a (Bll., Str., Lub.) *emër f.* sëmundje kafshësh që manifestohet me të shqepuar, me çalim.

shkëlbaz/ i (Orll., Gr., Bll.), *gëlbaz/ i* (Tan.) *emër m.* këlbazë.

shlluj / a (Tan.) *emër f.* shtëllungë.

Shmitër/ i (Tan., Br.) *emër m.* Shën Mitër, Shmitër.

shloj (Bll.) *folje* lëshoj, lë.

shot/ a (Bll.), *shat/ a* (Br., Gr., Lub.) *emër f.* patë, rosë.

shotan/ i (Bll.), *shator/ i* (Gr., Orll.,

Moj.) *emër m.* patan, patok, rosak.

shok/ a (Tan.) *emër f.*; *ilber/i* (Moj.) 1. brez (pëlhurë si shalli që meshkujt e lidhin në mes të trupit, në bel për të mbrojtur nga të ftohtit). 2. diçka e ngushtë, me ngjyra dhe e gjatë: *shoka ilberit.

sho:k *emër* (Tan.) 1. gjeneratë njerëzish sipas moshës, grupmoshë. 2. shokë, miq, dashamirës.

shprëishi *folje* shprish, kreh: *e shprëish leshin me kërhan.

i **shpërdhâit** (Lub.) *mbiemër i* shkathët, i shpejtë, i zhdërvjellët.

shport/ a (Lub., Str.) *emër f.* shportë, kosh.

shullâ/ ni (Tan., Br., Bll., Gr., Str.) *emër f.* shullë/ri (nga lat. solinum); vend që e zë dielli mirë e që nuk e rreh era.

shul/ i *emër m.* shul; dru i drejtë e i gjatë, i pastruar nga degët, që përdoret për punë të ndryshme, hu i gjatë.

shtam/ a (Br., Moj.) *emër f.* shtambë; enë balte për ujë, e gjerë në mes, me grykë të ngushtë dhe me një a dy veshë. **shtëi** (Str., Orll., Moj.) *ndajfolje* tani, tash, tashti.

shterp/ a (Tan.) *emër f.* shterpë, sterile, që nuk lind. 2. *Mbiemër* shterp. Që nuk pjell fare ose që nuk është mbarsur një vit (për femrat e rritura të disa kafshëve shtëpiake si delja, dhia, lopa etj.). *Dele (dhâi, lo:p) shte:rp.

shqerr/ a (Lub., Moj., Orll.) *emër f.* mëshjtjerrë, shtjerrë, shqerrë.

T

taban/ i (Tan.) *emër m.* pjesë e rrotës së qerres që e tërheqin kafshët.

tabëll/ a (Bll.) *emër f.* 1. tabelë. 2.

tabaka.

takrëim/ i (Bll.) *emër m.* pjesë e mullirit me ujë.

tamam (Bll., Gr., Str.), **taman** (Br., Mal.) *ndajfolje* 1. tamam; aq sa duhet, as më shumë e as më pak; ashtu si duhet, në rregull. 2. krejt njëjloj, pikë për pikë, njësoj, barabar.

tartakut/ i (Bll.) *emër m.* sëmundje kafshësh që u bie kuajve ose gomarëve e që shfaqet me të dridhura.

tat/ a (Gr., Br., Mal., Moj.) *emër f.* frikë, tutë (tutë > tâut > ta^ut, ta:t).

tav/ a (Gr.) *emër f.* tavë: tava për pasul.

tavli/ ja (Gr.) *emër f.* enë, shportë thuprash zakonisht për rroba.

tâi/ ni (Gr., Orll., Moj.), **mutêin/ i** (Bll.) *emër m.* tundës: e tun tamlin n'tâi – e tund qumështin në tundës.

tas/ i (Lub.) *emër m.* tas; enë e thellë dhe e rrumbullakët, në madhësi të ndryshme, prej balte, prej metali etj., që përdoret për gjëra të lëngshme.

tekne (Bll.) *ndajfolje, parafjalë* këndeje, nga kjo anë, në këtë anë.

tersa (Bll.) *lidhëse* derisa.

tejepërtej, përtej (Gr.) *ndajfolje* tejpertej, nga kjo anë në tjetrën, në tërësi, krejt.

teshk/ a (Tan.) *emër f.* sqepar.

temcâi/ a (Bl., Str.), **tepsâi/ a** (Gr.) *emër*

f. tepsi.

Te Kisha *mikrotoponim* në f. Bllacë.

Te Kulla *mikrotoponim* në f. Bllacë.

Te Vnesht *mikrotoponim* në f. Bllacë.

tërkuz/ a (Gr., Br., Lub.) *emër f.* litar, konop, tërkuzë.

tërhan/ i (Bll., Lub., Tan.) *emër m.* trahana, bollgur.

tërll/ a (Br.) *emër f.* vend i thurur me hunj e thupra ku mbahen bagëtia verës.

tërves/ a, sofër/ a (Gr.) *emër f.* sofër, tryezë e rrumbullakët dhe e ulët.

tërfuk/ i (Gr., Orll.) *emër m.* sfulk.

tërma: (Br., Tan.) *ndajfolje* përpjetë, në ngjitje, *kund.* tatëpjetë.

tërthur (Tan.) *ndajfolje* tërthorazi, shtrembër, jodrejt.

tërgovi/ ja (Br.) *emër f.* tregti.

tromak/ i (Str.) *emër m.* kalli misri, tamak, kallamoç.

tu (Bll.) *pjesëz.* duke (tu + pjesore e foljes = përcjellore): tu punau – duke punuar.

tuxhar/ i (Gr., Str.) *emër m.* tregtar (kafshësh).

tlin/ i (Bll., Str.) *emër m.* tëlyen, gjalpë.

tub/ a (Str.) *emër f.* 1. tufë, grumbull, tok: tuba e dhëve.

Th

than/ a (Str.) *emër f.* bot. thanë.

i **tha:t** (Gr.) *mbiemër* i thatë, i terur, i palëng.

thâi/vi (Moj., Br., Mal.) *emër m.* derr, thi.

therr/ a (Gr., Str., Orll., Tan.) *emër f.* ferrë.

thes/ i (Gr.) *emër m.* thes.

thekën/ a (Orll.) *emër f.* thekër.

themërr/ a (Br.) *emër f.* thembër.

thërrmi/ a (Bl.) *emër f.* thërmi, grimcë, diçka shumë e vogël.

e **thêime** (Bll.) *mbiemër* e përhime, e përhitur, ngjyrë hiri, e përthime: lo:p e thêime – lopë e përhitur.

thêik/ a (Tan.) **thâik/a** (Br., Mal., Moj.) *emër f.* thikë.

thkej (Bll., Gr., Lub., Str., Br.) *folje* kthej, sjell diçka nga ana tjetër.

U

ugurolla (Gr.) *pasthirrmë* përshëndetje, tungjatjeta.

uha/ ja (Br., Lub., Gr.) *emër f.* hua.

uj/ a (Tan.), *unsâi/ a* (Lub., Bll.) *emër f.* uri.

unjsêin/ a (Str.) *emër f.* tokë e lagësht,

lagështirë, vend moçalor.

urëith/ i (Str., Orll.), uri (Tan.), urth/i (Moj.) *emër m.* urith.

ufëll/ a (Tan., Br., Orll., Bll.) *emër f.* uthull.

V

va (Tan., Br., Str., Orll., Moj.) *formë e shkurtër e përemrit* (atyre) ua: va di – ua di (me konsonantizmin e /u/ së në /v/: ua > va).

vaiç/ i (Br., Lub.), *vêiç/ i* (Str., Bll.), *viç/ i* (Tan.) *emër m.* *viç, në shumës* veta.

vargj/ i (Br.), *varg/ i* (Tan.) *emër m.* varg; radhë sendesh të një lloji, që janë shkuar në pe, në tel etj. ose që janë lidhur a gërshetuar njëri me tjetrin: vargj duhani – varg duhani.

varanâic/ a (Br.) *emër f.* kaçamak, mëmëligë me miell misri; përvëlak.

vakt/ i (Str., Orll., Lub., Bll.) *emër m.* kohë, mot.

vap/ a (Gr.), *vapin/ a* (Bll.) *emër f.* vapë, zagushi, bulçim, ufëm.

val/ a (Gr., Bll.) *emër f.* 1. dallgë, shkulum. 2. *mbiemër* i valuar, që është nxehur deri në pikën e valimit, që ka marrë valë; i zier: *u:j i vlu:m – ujë i valuar.

valavic/ a (Tan.) *emër f.* valanicë, dërstilë.

vdor/ a (Br., Bll., Moj.) *emër f.* borë, dëborë.

vdeshi (Str.) *folje* zhvesh, heq rrobat, lakuriqësoj.

vegj/ a (Bll.) *emër* dorezë, vesh, vegë

(me qiellzorizimin e [g]-së në [gj]).

vegsh/ i (Tan.) *emër m.* vegsh; enë prej balte të pjekur; zakonisht me një vesh, që përdoret për të zier gjellë; poçe balte, vorbë: *vegsh për ba:th.

vezvese/ ja (Orl.) *emër f.* sugjestion.

verr, begron (Gr.) *folje* 1. blegëron, bjerr, bërtet: *delja po verr – delja po blegëron. 2. Tanushë: *keq.* *ki mi ja ni t'vermën – do t'ia dëgjosh britmën (piskamën, ofkëllim).

venali/ ja (Orll., Moj.) *emër m.* vendës, autokton, banor i lashtë.

venroj (Orll., Moj.) *folje* shikoj, vërej, më bie në sy, vëzhgoj.

veti (Str., Tan.), veti dhe pëiti (Bll.) *folje* pyes (e përfutur me këto zhvillime fonetike: pyeti > pveti > ^Pveti > veti).

i **vetëm** (Orll., Moj., Lub., Bll., Str.), i vetën (Lub.) *mbiemër* 1. i vetëm, i vetmuar, i panjeri; 2. *fīg.* i pakrah: *aj asht i vetëm – ai është i vetmuar, pa askënd (që ta përkrahë).

vetan/ i (Tan.) *emër m.* motak, qengj njëvjeçar, që ka mbushur një vit: *kingj veta:n – qengj motak.

vllaç/ a (Tan.) *emër f.* lesë.

Vlla:ç Tetove (Gr.) *fraz.* shkel e shko, përciptas, sipërfaqësisht, jo rrënjësisht,

vetëm sa për të kaluar (diçka).
voj/ i (peshki) (Br., Lub., Bll.) *emër m.*
vaj peshku.
vorb/ a (Tan., Br., Orll., Lub., Bll.),
vûorb/ a (Str.) *emër f.* vegsh, poçe,

vorbë.
voe/ voja (Br., Lub., Bll., Tan., Str.,
Orll., Moj.) *emër f.* ve, vezë.
i vogël, i vocërr, i vacërr (Tan.)
mbiemër i vogël, i papjekur, i paarrirë.

X

xanc/ i (Gr.) *emër m.* nxënës.
xegëz/ a (Gr.), xegërr/ a (Br.), xigërr/
xigri (Orll., Moj.) *emër f.* dhe *emër m.*
zool. zekth.

xigare/ ja (Bll.) *emër f.* cigare.
xile/ ja, xivon/ a (Gr.) *emër f.* zile,
kambanë.

Xh

xhaket/ a (Tan., Gr., Br.) *emër f.*
xhaketë.
xham/i *emër m.* qelq, xham.
i **xha:ll** (Tan., Str., Br., Gr.) *mbiemër i*
gjallë.
xhezve/ ja (Bll., Tan., Gr.), xhevze/
xhevzja (Orll., Moj.), xheze - xhezja
(Br.) *emër f.* xhezve.
xhigim/ i (Tan., Gr., Br.) *emër m.* gjym.

xhigallk/ a (Gr.) xhangall/a (Moj.) *emër*
f. zool. gjinkallë.
xhims/ a (Tan., Gr., Br.) *numëror*
gjysmë.
xhiz/ i (Tan., Gr., Br.) *emër m.* gjizë.
xhit *përemër pyetës* çka?, çfarë?
e **xhuma/ ja** *emër f.* 1. e premtë (dita) 2.
falja e drekës të myslimanët çdo të
premtë.

Z

zagjar/ i (Br., Mal., Moj.), zagar/ i
(Tan., Str.) *emër m.* zagar, qen gjahu,
langua.
zagllavâiti (Br.) *folje* ngatërroj, ngel në
një vend.
zall/ i (Tan., Gr.) *emër m.* rërë.
zadrug/ a *emër f.* shitore, dyqan,
kooperativë.

zapari/ ja (Br.), zapuri/ ja (Str.),
zapallim (Moj.) *emër f.* zagushi, zagushi,
bulçim, ufëm.
zarm/ i (Str.) *emër m.* zjarr.
zarmi:/ ja *emër f.* zjarrmi, temperaturë
e trupit.
zegëz/ a (Str.) *emër f.* zool. zekth.
zeqin/ i (Br., Gr.) *emër e* mbiemër

pasanik, i pasur.

zejtin/ i *emër m.* vaj kuzhine.

zgërdhaj/ a (Gr.) *emër f.* gërdhajë, bërthamë (fruti).

zgjedh/ a (Str.), zhgedh/a (Moj.) *emër f.* zgjedhë; dru i punuar, me dy kularë ose me një dru tjetër poshtë tij e të bashkuar

me hunj, ku mbrehen qetë a buajt dhe ku kapet shtiza e qerres, e parmendës etj.

zogj/ i (Br., Gr. për njëjës e për shumës), zog/ i (Tan.) *emër m.* zog, shpend.

e zoja (shpi:s, Tan.; shpâis, Br.) *emër f.* e zonja (e shtëpisë), nikoqirja.

Zh

zhab/ a (Tan., Moj.) *emër f.* bretkosa.

zhuga *emër f.* zgjebë.

zhdripi (Tan., Moj.) *folje* zbres.

D (< ng)

ɳareni (Br.) *folje* vrapoj, *krah.* ngaj, rendi (ɳareni = ngaj + rendi).

ɳat (Br., Tan.) *ndajfolje* afër, ngat.

ɳarkoj (Br., Tan.) *folje* ngarkoj.

ɳrâi (Br., Tan.) *folje* grirë, pjesore e foljes ngrij: *jam ɳrâi – jam ngrirë.

ɳrej (Br., Tan.) *folje* ngre, çoj përpjetë: ɳreje krâiet – ngrite kokën.

ɳrehs/ i (Br., Tan.) *emër m.* pjesë e avlëmendit.

i ɳroht (Br.) *mbiemër* i ngrohtë, i nxehtë.

ɳihna (Tan.) *folje* ngihem, ngopem, fryhem (me ushqim ose me diçka tjetër).

ɳuli (Tan.) *folje* nguli (hurin).

VI. VEÇORITË SINTAKSORE

6. TIPARET SINTAKSORE TË SË FOLMES SË KARADAKUT TË SHKUPIT

Materialin për sintaksën dialektore e mblodhëm gjatë vitit 2016, nëpër fshatrat e kësaj krahine të banuar me shqiptarë me ekspedita të drejtpërdrejta, në bazë të pyetësorit të përshtatur nga “Udhëzuesi për kërkime në fushën e sintaksës popullore” botuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë në vitin 1987.³⁹⁶ Të anketuarit tanë janë nga brezi i vjetër, pak ose aspak të arsimuar, që rrallë kanë lëvizur nga fshati apo krahina e tyre dhe, natyrisht, duke mos pasur kontakte intensive me të folmet e tjera dhe gjuhët e huaja, në mënyrë më autentike kanë ruajtur të folmen e tyre deri në gjendjen e sotme.

Pasi merrnim gjithë përgjigjet e planifikuara nga pyetësi, atëherë materialin gjuhësor e vilnim edhe përmes bisedës së lirë, nëpërmjet rrëfimeve për përjetime të ndryshme, përrallave, ngjarjeve historike, legjendave, bisedave për punën e tyre të përditshme etj.

Për qëllime praktike, si dhe për të qenë më lehtë të krahasueshme tiparet sintaksore a morfosintaksore të këtij areali gjuhësor me veçoritë sintaksore (më saktë morfosintaksore) të arealeve të tjera dialektore të shqipes, në vënien në pah të veçorive sintaksore të kësaj të folmeje jemi udhëhequr nga pyetjet e Pyetësorit për variacionin sintaksor në të folmet e shqipe, duke u dhënë përgjigje atyre sipas radhës.

1. Si përshtatet folja-kallëzues: në njëjës apo në shumës, kur kryefjala është emër përmbledhës

“Midis emrave të përgjithshëm dallohen si një grup i veçantë, për veçoritë e tyre leksikore e gramatikore, *emrat përmbledhës*. Emrat përmbledhës emërtojnë një tërësi vetash, kafshësh ose sendesh të një fare, në formën e numrit njëjës. Ndryshe nga emri i numrit shumës, emri përmbledhës emërton një shumicë sendesh të njëllorja si një tërësi të pandarë dhe, nga pikëpamja sasiore, të panumërueshme. Në të dyja rastet kemi të bëjmë me shumësi, por, ndërsa te forma e numrit shumës shumësia paraqitet e diferencuar, e ndashme në njësi, tek emrat përmbledhës ajo merret si një e tërë e pazbërthueshme. Kjo del e qartë kur krahasojmë format e numrit shumës të disa emrave me emrat përmbledhës që janë formuar prej tyre: *djemtë, dy djem, tre djem – djalëria; gratë, dy gra, tri gra – graria; proletarët, dy proletarë, tre proletarë – proletariati*.“³⁹⁷

Siç dihet, kallëzuesi përshtatet në numër me kryefjalën: vihet në njëjës, në qoftë se kryefjala është në njëjës, vihet në shumës, në qoftë se kryefjala është në shumës... Kallëzuesi vihet zakonisht në shumës, kur kryefjala është një emër përmbledhës; po si në gjuhën e folur, edhe në të shkruarën, mund të vihet edhe në njëjës...³⁹⁸

Kur kryefjala është një emër përmbledhës, folja mund të përdoret edhe në vetën e tretë shumës, në rast se synohet të vihet në dukje shumësia e atyre që e kryejnë veprimin e shprehur prej saj: *U çudit gjithë bota. Bota thonë ashtu, se kanë inat. – E ç’inat do të kenë bota? – pyeti*

³⁹⁶ Pyetësor për variacionin sintaksor në të folmet e shqipes (përshtatur nga “Udhëzuesi për kërkime në fushën e sintaksës popullore”, IGjL, Tiranë, 1987).

³⁹⁷ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe, Vëllimi I (Morfologjia)*, AShRSh, IGjL, Tiranë, 1995, f. 85.

³⁹⁸ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe, Vëllimi II (Sintaksa)*, AShSh, IGjL, Tiranë, 2002, f. 199.

Hakui. – *Di unë ç'inat kanë?*³⁹⁹

Nga materiali i vjelë me metodën e vëzhgimit të drejtpërdrejtë në të folmen e Karadakut të Shkupit, mund të konstatohet se në këtë areal gjuhësor kur kryefjala është një emër përmbledhës, kallëzuesi vihet në shumës, si në fjalitë:

- a) *Xhinja u çun. Xhinja ishin çu. Xhint ishin çu.* (Br.)
- b) *Gjemt u nisën.* (në të gjitha katundet e Karadakut).
- c) *U mlodhën kah jan e kah s'jan djemnia.* (Lub.)

2. Vihet në trajtën e shquar a të pashquar emri i rasës kallëzore me parafjalë “në”, “mbi”, që ndiqet nga një emër tjetër në rasën gjinore ose nga një mbiemër?

E përdorur me parafjalë, rasa kallëzore merr kuptime të ndryshme. Me parafjalën *në, mbi, përmbi, nëpër* tregon kryesisht vend: *në shtëpi, mbi tavolinë, nëpër male ...*; me parafjalën *me, pa* mund të përdoret për të konkretizuar një send: *mur me gur, njeri me vullnet, gjellë me kripë*⁴⁰⁰

Në arealin gjuhësor të Malit të Zi të Shkupit emri i rasës kallëzore me parafjalën “në”, “mbi”, që ndiqet nga një emër tjetër në rasën gjinore ose nga një mbiemër, vihet në trajtën e pashquar, si në fjalitë:

- a) *Ra n'breg t'detit. Ra n'grop t'kampirav.* (Br.)
- b) *Hipi n'kala t'Shkupit.* (Orll.) *Hipi n'kodër t'Cenës.* (Br.)

3. Cila është forma që përdoret në folmen tuaj?

Rrjedhorja njëjës e pashquar e tipit *dru lisi*, që për nga forma është identike me dhanoren dhe për nga funksioni e afërt me gjinoren e shquar, kur kjo ka kuptim të përgjithësuar: *dru (= druri) i lisit* (në përgjithësi) ka kuptim të përgjithësuar dhe afron me mbiemrin, kurse përcaktori në gjinore përdoret më shpesh në kuptim të individualizuar. Të krahasohet: *drejtor shkollë* (në përgjithësi) me *drejtori i shkollës* (i kësaj ose i asaj shkollë të njohur).⁴⁰¹

Rrjedhorja pranemërore përdoret kryesisht pa parafjalë, në funksione përcaktuese të ngjashme me ato të gjinores. Ajo njihet vetëm trajtën e pashquar dhe mund t'i shërbejë si përcaktor vetëm një emri të pashquar. Pra, si emri i përcaktuar, ashtu edhe përcaktuesi, të cilët përbëjnë gjymtyrët e një togfjalëshi, duhet të jenë patjetër në trajtën e pashquar, përndryshe në vend të rrjedhores del gjinorja. Sikurse shihet, për rrjedhoren pranemërore, ka kufizime strukturore: *dru lisi, këngë dasme, shushurimë gjethesh* (me rrjedhore) edhe në anën tjetër: *druri i lisit, këngët e dasmës, shushurima e gjetheve* (me gjinore).

Rrjedhorja pa parafjalë, si përcaktor i emrit, duke pasur gjithmonë trajtën e pashquar, e karakterizon sendin sikur të ishte një mbiemër. Në ndonjë rast, në funksione të tilla ajo mund të marrë edhe parafjalën *prej*, sidomos kur jep një karakteristikë lëndore: *raki thane – raki prej thane, tuba gize – tuba prej gize* etj.⁴⁰²

Në të folmen tonë përdoret rrjedhorja pa parafjalë si përcaktor i emrit, përkatësisht togfjalëshat emër + emër në rasën rrjedhore ku shprehin lëndë: P.sh.:

- a) *ni thes gru:n* (në të gjitha katundet);
- b) *lu:g druni* (Lub.); *lu:gj druni* (Orll., Br.).

³⁹⁹ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe, Vëllimi I (Morfologjia)*, AShRSh, IGJL, Tiranë, 1995, f. 269.

⁴⁰⁰ Po aty, f. 110.

⁴⁰¹ Po aty, f. 107.

⁴⁰² Po aty, f. 111.

4. Rrethanori i kufizimit a ndërtohet me parafjalën “nga” apo me rrjedhore pa parafjalë?

Rrethanori i kufizimit në të folmen e Karadakut të Shkupit ndërtohet me rrjedhore herë me parafjalë, herë pa parafjalë, si në fjalitë: *Ka lujt pi menve. Ka lujt mensh* (në gjithë arealin gjuhësor të Karadakut të Shkupit).

5. Në ndërtimet: *Gjyshi me të birin u nis/ u nisën, në ç’numër vihet folja-kallëzues?*

Kategoria gramatikore e numrit të folja ka karakter thjesht sintaksor, sepse kushtëzohet nga numri i kryefjalës së shprehur ose të nënkuptueshme. Kategoria gramatikore e numrit të folja, ashtu si të mbiemri, nuk sjell ndonjë ndryshim në kuptimin leksikor të saj. Një folje e përdorur në numrin shumës nuk emërton shumë veprime, por një veprim që e kryejnë shumë njerëz.

Siç dihet, “në fjalinë me kryefjalë të shprehur me togfjalësh të tipit *unë me vëllanë* ose me emër përmbledhës, gjymtyra emërore e shprehur me mbiemër vihet në formën e njëjësit ose të shumësit po ashtu si këpuja.”⁴⁰³

Në të folmen e Malit të Zi të Shkupit kur kryefjala shprehet me një togfjalësh: emër në emërore të shquar + parafjalën *me* + emër në rasën kallëzore, folja-kallëzues vihet në numrin shumës, sipas tipit:

Gjishi me t’birin u nisën. (Lub.)

Baba plak me gjalin jan nâis. (Orll.) Ose në variantin:

Baba qak me gjalin u nisën. (Br.)

6. Përshtatje kryefjalë-kallëzues, sipas rendit të fjalëve:

Kur kryefjala shprehet me dy mbiemra të emëruar (në trajtën e shquar), të paraprirë me lidhëzën bashkërenditëse këpujore *si... si* (të tipit: *si i miri si i keqi*), si gjymtyrë homogjene, atëherë kallëzuesi në arealin tonë dialektor përdoret në numrin shumës. P.sh.:

a) *Si i mâiri si i keqi fundin e ka:n nisoj.* (Lub.) *Si i mâiri si i keqi barabar e kan pas hakin.* (Orll.) *Si fukaraja si i pasmi isto*⁴⁰⁴ *e kan pagju hoxhën.* (Br.)

b) *Mbas mu: kan ardh ene i mâiri ene i keqi. Mbas mu: kan ardh edhe i mâiri edhe i keqi.* (Lub) *Mas meje kan ardh i mâiri ene i keqi.* (Orll.) *Mas meje kan ardh i mâiri e i keqi.* (Br.)

7. A përdoret rrethanori i vendit që shënon drejtimin e një lëvizjeje pa parafjalë?

Rrethanori i vendit që shënon drejtimin e një lëvizjeje përdoret me parafjalë:

a) *Rash n’Shkup* (në të gjitha katundet).

b) *Shkova n’Shkup. Shkova n’pazar* (në të gjitha katundet).

8. A përdoret rrethanori i shkakut pa parafjalë?

Rrethanori i shkakut, përveç me ndajfolje, shprehet edhe me emër në rasën emërore me parafjalën *nga*; në rasën kallëzore zakonisht të pashquar, me parafjalën *për* ose *me*, sidomos pas foljesh që tregojnë procese psikike e në radhë të parë ndjesi; në rasën rrjedhore me parafjalën *prej* ose pa parafjalë; me emër të prirë nga lokucionet parafjalore *nga shkak* (*i*), *për shkak* (*të*), *për arsye* (*të*), *nga puna* (*e*), *për punë* (*të*), *për hir* (*të*) etj.⁴⁰⁵

⁴⁰³ Po aty, f. 200.

⁴⁰⁴ *isto* – sllavizëm, që ka kuptimin *njësoj, njëlloj*.

⁴⁰⁵ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe, Vëllimi II (Sintaksa)*, AShSh, IGjL, Tiranë, 2002, f. 275.

Rrethanori i shkakut në të folmen në spikamë përdoret gjithnjë me parafjalë: më dendur me parafjalën *për* + një emër në rasën kallëzore ose me parafjalën *prej* (< pi) dhe një emër në rasën rrjedhore:

- a) *Vdiq për buk.* (Lub.) *Vdiq pi s'uni.* (Orll.) *Vdiç pi s'uni.* (Br.)
b) *Qasa pi s'nxetit.* *Qasa pi nxetit.* (Lub.) *U doxha pi zaparis.* (Orll.) *Qasa pi zaparis.* (Br.)

9. Cilën rasë kërkon parafjala “tej”, “përtej”: rrjedhoren apo kallëzoren?

Në këtë të folme parafjala “tej”, “përtej” nuk përdoret. Në vend të tyre përdoren lokucionet parafjalore “tej përtej”, “tej m'tej”, “qosh m'qosh” (< qosh ëm qosh) etj. Këto gjithnjë përdoren me rrjedhoren, si p.sh.:

- a) *Tej përtej udhës.* (Lub.) *Qosh ëm⁴⁰⁶ qosh udhës.* (Orll.) *Tej m'tej udhës.* (Br.)
b) *Tej përtej malit.* (Lub.) *Qosh ëm qosh malit.* (Orll.) *Tej m'tej malit.* (Br.) etj.

10. Përdoren me rasën kallëzore dhe me rasën vendore parafjalët: “për”, “me”, “në/ndë”, “nën”, “mbi/mbë”:

Në të folmen e Karadakut të Shkupit parafjalët: “për”, “me”, “në/ndë”, “nën”, “mbi/mbë” (me variante të caktuara fonetike: *për*, *me*, *n'*, *nër*) përdoren rregullisht me rasën kallëzore. Sipas vëzhgimeve tona, në gjendjen e sotme kjo e folme nuk ka rasë vendore dhe funksionin e saj e ka marrë rrasa kallëzore me parafjalë, si në shembujt:

- a) *Shkoj n'mal.*
b) *Hipi n'da:rdh.*
c) *N'u:dh* (në të gjitha fshatrat).

11. A ka raste kur nuk e përsërit trajta e shkurtër kundrinën?

Trajtat e shkurtra të përemrave vetorë, të pabashkuara apo të bashkuara, kanë përdorim të dendur në të folmen e Karadakut të Shkupit si dhe përgjithësisht në të gjitha të folmet shqipe në Maqedoni. Ato, detyrimisht përdoren në funksionin e kundrinës së zhdrejtë para foljes-kallëzues, si:

I thash ni shoqit. I thash shoqit. Aj e kshirke librën. (Lub., Orll.) ose *defterin* (Br.). *I gjiva di bilu:r, i gjiva di barda:k.* (Lub.) *I kam gji di bardaka.* (Orll.) *I blev di shishe gaz.* (Br.) *Um⁴⁰⁷ murr mu:, Mue um murr.* (Lub.) *M'ka ma:rr mu: .* (Orll.) *Um mur mu: e shku:m.* (Br.) *T'ka la:n ti.* (Lub.) *T'ka la:n tâi.* (Orll.) *T'ka lan tâi, m'ka marr mu:.* (Br.)

Rimarrje (përsëritje) të kundrinës kemi edhe në rastet kur emri në funksion të kundrinës së drejtë është në trajtën e shquar. P.sh.: *E ngarkova kalin. E pa:sh dajën* etj. Pra, në të folmen e Malit të Zi të Shkupit, si dhe përgjithësisht në të gjitha të folmet shqipe në Maqedoni rimarrja e kundrinës me anë të trajtave të shkurtra është e domosdoshme, d.m.th. ajo gjithnjë përsëritet. Përsëritja e kundrinës është e domosdoshme edhe në maqedonishte.

12. Trajta e shkurtër “më” e vetës së parë numër njëjës me folje të mënyrës urdhërore, e ka përdorimin proklitik apo edhe enklitik?

Trajtat e shkurtra *m'* (< më), *i*, *e* si edhe format e bashkuara *ma*, *m'i*, *ja*, *naj*, *jav* dhe *va* në Karadakun e Shkupit përgjithësisht përdoren si fjalë enklitike pas foljeve të mënyrës

⁴⁰⁶ Trajta e shkurtër e vetës së parë njëjës *ëm* është formë metatetike e formës *më*.

⁴⁰⁷ Trajta e shkurtër e përemrit vetor e vetës së parë njëjës *um* fonetikiisht duhet të jetë përfutur nga buzorëzimi i [ë]-së në [u] dhe nga metateza. Pra, nga *më* > *mu* > *um*..

urdhërore, duke krijuar në këtë mënyrë një formë të përngjitur, fonetiki kemi vetëm një fjalë të vetme, duke u shqiptuar vetëm me theks kryesor (një theks të vetëm, një tërësi e vetme theksore). Në format mohore trajtat e shkurtra kanë përdorim proklitik. P.sh.: *Kallxóm!* (*Mo m'kallxó!*); *Béri!* (*Mos i ber!*); *Dáje!* (*Mos e dáj!*); *Fálma!*, (*Mos ma fál!*); *Ma ép!* (*Mos ma ép!*); *Shkrâumi!* (*Mos m'i shkrâuj!*); *Çoja!* (*Mos ja ço!*); *Bernaj!* (*Mos naj ber!*); *Mshójav!* (*Mos jav mshó!*); *Lípva!* (*Mos va líp!*) etj.

Trajta e shkurtër “më” e vetës së parë numër njëjës me folje të mënyrës urdhërore në të folmen e Kradakut të Shkupit ka përdorim enklitik:

Fugma! (Lub.) *Fugjma!* (Orll.), *Çitma!* (Br.); *Çoma!* (në të gjitha fshatrat), *Kapma* dorën, *nimom* t'dal! (në të gjitha fshatrat); *Përgjom!* (Lub.), *Prâitëm!* (Orll., Br.); *Bema!* (Lub.), *Berma!* (në katundet e tjera).

13. Përemri pronor në fjalinë e varur “i/e vet” i referohet kryefjalës apo kundrinës së fjalisë drejtuese?

Siç dihet, për të shprehur marrëdhëniet e përkatësisë për vetën e tretë, kemi pronorët vetorë *i (e) tij*, *i (e) saj*, *i (e) tyre* dhe pronorin vetvetor *i (e) vet*, *e vet / e veta*. Midis këtyre pronorëve ka një dallim kuptimor të qartë: a) pronori vetor mund t'i referohet çdo gjymtyrë të fjalisë ku bën pjesë (në vend të tij): b) ndonjë gjymtyrë të ndonjë fjalie tjetër. Pronori vetvetor i referohet, siç u tha, kryefjalës së fjalisë ku bën pjesë (*Zana ... zëri i vet*).

Përdorimi edhe i pronorëve vetorë, edhe i pronorit vetvetor është një domosdoshmëri, sepse mënjanon keqkuptimin, kur në të njëjtën fjali a frazë kemi të bëjmë me dy veta të treta dhe duam të dallojmë se cilës prej të dyjave i përket prona e dhënë...⁴⁰⁸

Në të folmen në shqyrtim pronori vetvetor “i/e vet” në fjalinë e varur mund t'i referohet herë kundrinës e herë kryefjalës së fjalisë drejtuese. Kështu, në periudhat e tipit:

a) *Sadrija i tha Xhemës t'shkoje n'katunin (n'katanin) e vet. Alia i tha Sadis t'shkoje n'katan t'vet*; pronori vetvetor (*e vet*, *t'vet*) i referohet kundrinës, ndërsa në frazat e tipit:

b) *Anila ja kallxoj Vjollcës librin e vet*. (në të gjitha katundet) pronori vetvetor (*e vet*) i referohet kryefjalës.

14. Përemri pronor në fjalinë e varur “i tij/e saj” i referohet kryefjalës apo kundrinës së fjalisë drejtuese?

Përemri pronor në fjalinë e varur “i tij/e saj” në këtë të folme i referohet kryefjalës, si p.sh.:

a) *Gena i tha Blertës t'i kshire slika e asaj*.

b) *Beni i kallxoj Gonit arat e atâi*. (Lub.)

Shënim: Pronori vetvetor “i/e vet” përdoret dendur, ndërsa përemri pronor “i tij/e saj” përdoret rrallë. E folmja e Karadakut të Shkupit, si dhe shumica e të folmeve shqipe në Maqedoni,⁴⁰⁹ nuk i njih format *e tij*, *e saj*, *e tyre*, por vetëm *i*, *e atâi*; *i*, *e asaj*, *i*, *e atâine*.

15. Përemrat dëftorë shoqërohen me emra të shquar apo të pashquar?

Shumica e të folmeve gege (të gegërishtes veriore, por disa edhe të gegërishtes qendrore) dallohen prej variantit standard, të folmeve toske dhe arealit tjetër të gegërishtes (Shqipëri e Mesme e më gjerë) për faktin se përemrat dëftorë në to shumë më tepër përdoren në formën e përngjitur: *qeky/çeky*, *qekjo/çekjo*, *qekta/çekta*, *qaj/çaj*, *qajo/çajo*, *qata/çata*, *qeto/çeto* etj. sesa

⁴⁰⁸ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, 1995, f. 235.

⁴⁰⁹ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 310.

në formën me shtrirje në të dy dialektet *ky, kjo, këta, këto, ai, ajo, ata, ato*. Me forma të këtitilla të përbëra nga pjesëza e patheksuar treguese (deiktike, gr. *deixis* – dëftoj, tregoj me gisht) **qe** (çe) ‘ja’ dhe një përemër dëftor *ky: çe+ky, çe+kjo* ‘ja+ky, ja kjo’... veçohet ose dallohet më mirë frymori, objekti apo sendi që ndodhet afër ose larg folësit. Krahasoni variantet e fjalive: *Ky është gjali jem. – Çeky është gjali jem. ‘Ky është djali im. – Ja, ky është djali im’.* *Ajo a:r është ma e mâira. – Çajo a:r është ma e mâira. ‘Ajo arë është më e mira. – Ja, ajo arë është më e mira.’*⁴¹⁰

Edhe në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit kur duam të veçojmë një qenie të gjallë, një send etj. nga grupi që i përket, d.m.th. kur duam ta individualizojmë një emër të përgjithshëm, para tij përdorim një përemër dëftor dhe një emër në trajtën e shquar (ki gjali). Siç dihet, nyja shquese në gjuhët indoevropiane buron nga përemri dëftor.⁴¹¹

Në fakt, krahas rasteve të zakonshme të përdorimit të përemrave dëftorë të shoqëruar me emra të shquar apo të pashquar në shqipen standarde,⁴¹² në këtë të folme, si dhe në shumë të folme të tjera shqipe në Maqedoni,⁴¹³ regjistruam një dukuri shumë të shpeshtë dhe të rregullt të individualizimit të dyfishtë, përkatësisht shquarsinë e dyfishtë të emrit: me përdorimin e përemrit dëftor dhe me nyjën shquese, si në rastet: *ki gjali, aj burri, ki shoki, ajo gruja, çaj shoqi, çajo lopa, çiki ca:lli, çekjo caca, çiki kali*, etj. Përgjigjet e marra nga pyetësori i përshtatur nga “Udhëzuesi për kërkime në fushën e sintaksës popullore” na dalin në formën:

Ai gjali po ven. Ki gjali tha. (në të gjitha katundet e Karadakut)

Ajo çika u nis. (Lub.) *Ajo çika u nâis. Ajo caca u nis* me ardh. (Br.)

Shquarsia e dyfishtë dëgjohej sidomos kur gjatë të folurit përsëriten emra të njëjtë njerëzish a kafshësh. Për shembull, në tregimet popullore edhe të kësaj krahine: *Ish ka:n ni bu:rr e ni grue // Ajo gruja ni dit i tha ktâi burrit: O burri jem / shko laroje arën... // Ki burri e ngjoj at gruen ene shkoj* //⁴¹⁴

16. Po kur emrat janë të shoqëruar me emra, në ç’formë del mbiemri?

Mbiemrat në të folmen tonë, si dhe në mbarë gjuhën shqipe, kanë dy gjini: mashkullore dhe femërore. Gjinia femërore e mbiemrave krijohet nga gjinia mashkullore. Në vijim do të sjellim rregullat kryesore të formimit të mbiemrave të gjinisë femërore në shqipen e Karadakut:

a) Mbiemrat që në shqipen standarde mbarojnë me *-ë, -ël, -ër* dhe *-ët*; gjininë femërore e bëjnë duke ndryshuar vetëm nyjën e përparme **i** në **e**, sipas tipit: *i mâir – e mâir, i amël – e amël, i ba:rdh – e ba:rdh, i shpejt – e shpejt, i gja:t – e gja:t, i u:rt – e u:rt, i vogël – e vogël, i smu:t – e smu:t, i poshtër – e poshtër, i ra:n – e ra:n, i ka:ft – e ka:ft, i trash – e trash, i nxe:t – e nxe:t, i ftoft – e ftoft, i vetër – e vetër* etj.

b) Të gjithë mbiemrat që mbarojnë me *-ëm* dhe *-shëm*, si dhe mbiemrat prejfoljorë, gjininë femërore e bëjnë duke ndryshuar nyjën e përparme si dhe duke marrë mbaresën *-e* (i > e + e): *i pasëm – e pasme, i knâushëm – e knâushme, i hershëm – e hershme, i la:m – e lame* etj. Me këtë rrugë gjininë femërore e bëjnë edhe mbiemrat: *i madh – e madhe, i kuç – e kuçe, i keç – e keçe, i shkrâum – e shkrâume* etj.

c) Disa mbiemra gjininë femërore e bëjnë me ndërrimin e nyjës së përparme dhe me shndërrimin në gjatësi të zanores fundore, nga zanore e shkurtër në zanore të gjatë. Te mbiemri i gjinisë femërore zanorja është më e gjatë sesa te mbiemri përkatës mashkullor. P.sh.: *i lig – e*

⁴¹⁰ Asllan Hamiti – Ajten Qamili, *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, UIShM, Shkup, 2014, f. 172.

⁴¹¹ Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I dhe II), Prishtinë, 1980, f. 82.

⁴¹² Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, 1995, f. 121-131.

⁴¹³ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkupi, Shkup, 1997, f. 154-155.

⁴¹⁴ Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014, f. 255-256.

li:g, i par – e pa:r, i dit – e di:t ‘i dytë – e dytë’, *i tret – e tre:t* ‘i tretë – e tretë’, *i shkret – e shkre:t* etj.

Shënim: Disa mbiemra dallohen nga ndajfoljet. Mbiemrat përdoren gjithmonë me nyje të përparme, ndërsa ndajfoljet nuk kanë nyje të përparme. Krahaso mbiemrat nga ndajfoljet përkatëse: *i mâir, e mâir – mâir; i na:lt, e na:lt – nalt, i shpe:jt, e shpe:jt – shpejt; i ba:rdh, e ba:rdh – bardh; i ho:ll, e ho:ll – holl; i ke:ç, e keçe – keç; i nga:t, e nga:t – ngat* etj. Në përgjithësi te mbiemrat zanorja fundore është e gjatë, ndërsa te ndajfoljet e shkurtër.

Kur në të njëjtën fjali kemi dy e më tepër emra, atëherë mbiemri përshtatet në gjini e në numër me emrin e fundit. Mbështetur në pyetësonin për variacionin sintaksor në të folmet e shqipes nga informatorët e Malit të Zi të Shkupit kemi marrë këto përgjigje:

- a) *Tre burra e tre gra t'thâirta.* (Lub., Orll.) *Tre burra e tre gra t'grâishta.* (Br.)
- b) *Tre çika ene tre gjem t'regjistrâum.* (Lub., Orll.) *Tre caca e tre gjem t'shkra:m* (Br.)
- c) *Tre gjem e tre çika t'regjistrâume.* (Lub., Orll.) *Tre gjem e tre caca t'shkrame.* (Br.)⁴¹⁵

17. A përdoret me vlerë të një fjalie kohore të njëkohësisë, forma e pashtjelluar e tipit “me të ardhur” apo vetëm fjalia kohore me lidhëzat “sa, sapo, posa”?

Forma e pashtjelluar e tipit “me të ardhur” nuk përdoret në këtë të folme, por vetëm fjalia kohore me lidhëzën “sa”:

a) *Sa mrrâini agje/aj e mur* (në të gjitha katundet).

b) *Sa hini katund/ thâiri met'madhe.* (Lub.) *Sa hini n'katan, bërtâiti sha:m.* (në të gjitha katundet)

18. A përdoret ndërtimi me formë të pashtjelluar i tipit “një të thënë” apo vetëm një fjali kohore lidhëzore?

Në të folmen e Malit të Zi të Shkupit nuk përdoret asnjëherë ndërtimi me formë të pashtjelluar të tipit “një të thënë”, por vetëm fjalia kohore lidhëzore e tipit:

Sa e tha/ u nis. Sa shkoj, erdh//Sa e pa/e thâirri//Sa e pa, i tha: bujrrëm// (në të gjitha katundet).

19. A përdoret ndërtimi me emra 8rejfoljorë asnjëherë në trajtë të shquar pa parafjalë apo vetëm një fjali kohore lidhëzore?

Emrat prejfoljorë, më saktë emrat prejpjesorë (foljet e substantivuara) të tipit: *të ecurit, të kënduarit, të mësuarit*, të cilat në gjuhën standarde janë të gjinisë asnjëherë, në të folmen tonë përdoren në gjininë femërore në formën: *e hecmja, e këndâumja, e mcâumja* etj.

Rrjedhimisht, në këtë të folme nuk kemi ndërtime me emra prejfoljorë asnjëherë në trajtë të shquar pa parafjalë (të zbritunit poshtë u vra), por vetëm me fjali kohore lidhëzore:

Sa zdripi posht/ u vra:// (në të gjitha fshatrat).

Sa hini mrenda/ u shim drita// (Lub.)

⁴¹⁵ Numërori *tre/tri* (për gjininë mashkullore/për gjininë femërore) në shumë fshatra të arealit gjuhësor të Malit të Zi të Shkupit e ka humbur kundërvënien e gjinisë, përkatësisht përdoret forma **tre** për të dy gjinitë. Edhe përemrat e vetës së tretë shumës në disa fshatra të kësaj zone gjuhësore kanë një formë të vetme për të dy gjinitë. Në këtë kuptim, në të folmet e fshatrave Brezë, Malinë dhe Tanushë dallohen përemrat: **ata** (veta e tretë shumësi për gjininë mashkullore) dhe **ato** (për gjininë femërore); ndërsa në f. Bllacë dhe Luboten dëgjohet vetëm forma **ata** (për të dy gjinitë), ndërsa në f. Orllacë, Mojancë dhe Grushinë **ato** (për të dy gjinitë). Forma dyshe kemi edhe për vetën e tretë njëjës të gjinisë femërore: **ajo**, në f. Tanushë, Mojancë, Orllacë, Brezë, Malinë dhe Grushinë, por **aja** në f. Bllacë, Straçincë dhe Luboten. Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014, f. 279.

Sa hini mrena/ u nal drita// (Orll.)

Çim hini mrena, u nal drita// (Br.)

Sa dul dilli/ lehi çeni// (në të gjitha pikat e kësaj izoglose).

20. Në togjet foljore në të cilat përbërësi i parë shpreh fillimin e veprimit (zë, nis, filloj, hyj), përdoret forma parataktike apo hipotaktike?

Në të folmen e Kartadakut të Shkupit si dhe në pjesën më të madhe të të folmeve shqipe në Maqedoni⁴¹⁶ pas foljeve modale si dhe foljeve që tregojnë fillimin e veprimit përdoret edhe mënyra lidhore, edhe forma e pashtjelluar e paskajores, sipas tipit: *duhet t'shkoj* dhe *duhet me shku*:. P.sh.:

a) *Zu t'bërtase*. – *Zuni me bërtâit*. *Ja nisi t'bërtâise*. – *Ja nisi me bërtâit*. *Nâisi t'bërtase*. – *Nâisi me bërtâit*.

b) *Hini t'haje buk*. – *Hini me hangër buk*.

c) *Nisi / nâisi me fol*. *Ja nisi me kajt*. *Nis e kan*. *Ja nisi me thâirr*. *Nis e thâirr* (në të gjitha katundet e kësaj izoglose).

21. Në ndërtimet e mëposhtme kallëzuesi foljor shprehet me formë të shtjelluar apo të pashtjelluar?

Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit lidhorja dhe paskajorja përdoren paralelisht.⁴¹⁷ Për shembull: *Duhet t'shkoj ta shoh arën* dhe *Duhet me shku: me pa arën*. *Njeri duhet t'punoje sa t'jete xha:ll* – *Njeri duhet me punu: sa t'jete xhall*.. *Mâikin lipet ta dush e t'i bash sajgi* – *Mikin duhet me da:sht e mej ba: sajgi* etj. Edhe në të folmen e Karshiakës format e mënyrës lidhore përdoren më dendur sesa format e paskajores gege.⁴¹⁸

Lidhorja zakonisht përdoret pas foljeve gjysmëndihmëse,⁴¹⁹ të cilat së bashku (si një tërësi) formojnë një kallëzues të vetëm të përbërë: *duhet t'shkoje, nâisa t'mcoj, zuni t' këndoje* etj. P.sh.:

a) *Zu me kundâu*. (Lub.). *Zu me kërku*: (Orll.)

b) *Sa u rrâit, nisi t'kërkoje nase*. (Br.)

c) *Nisi me kajt*. (Lub.). *Nis t'kaje* (Br.)

ç) *Ja nisi me pâi, kundâu*. (Lub.) *Nâisi me kajt* (Orll.)

d) *Sa i bani di muj, nisi me pâi tamel lope*. (Br.)

dh) *Ja nisi me kundâu, pâi, kna*:. (Lub., Orll., Br.)

e) *Kur i bani ni vet, nisi t'fole*. (Br.)

Përdorimi paralel i të ardhmes së domosdoshme (futurum necessitatis) dhe i të ardhmes së dëshiruar (futur volitiv, futurum voluntatis)

Duke u mbështetur në materialin e vjelë në terren, erdhëm në përfundim se në të folmen e

⁴¹⁶ Kallëzuesi foljor i përbërë me një folje gjysmëndihmëse modale apo që tregon fillimin e veprimit dhe me një folje themelore përdoret paralelisht edhe në mënyrën lidhore edhe në formën e paskajores, jo vetëm në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, por edhe në të folmen e Dervenit: *Zu t'bërtase*. *Nâiset t'vaje*. *Zun t'larojn*, por edhe: *Duhet me punâu*. *Nâisi me hongër* etj. Shih: Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 379.

⁴¹⁷ Në të folmet toske, siç është e njohur, në vend të paskajores gege (me punue), çdoherë kemi lidhoren (të punojë ose paskajoren toske (për të punuar). shih: Jorgji Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 44; Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1988, f. 88; Dr. Bahri Beci, *Marrëdhëniet e hershme shqiptaro-sllave në dritën e të dhënave të dialektologjisë sonë historike*, Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994, f. 40 etj.

⁴¹⁸ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkupi, Shkup, 1997, f. 168-169.

⁴¹⁹ Folje gjysmëndihmëse në të folmen tonë janë: a) foljet modale *duhet* ose *lipet*, *mund* (*mun*) etj., si dhe në fjalinë: *Duhet t'vâish*. *Mun t'rrâish sa t'dush*. b) foljet që tregojnë fillimin e veprimit: *nâisa*, *zâ*:, si *Nâisi t'punoje*. *Zuni t'kallzoje se sa u gjazmâu për darsmën e gjalit* etj.

Karadakut të Shkupit koha e ardhme shprehet me dy forma të përbëra. Në fakt, njëra është karakteristike dhe mbizotëruese në të folmet e gegërishtes, ndërsa tjetra në të folmet e toskërishtes. Megjithatë, siç dihet, në folmet e gegërishtes qendrore kemi përdorimin e dyfishtë të të dyja formave, me shtrirje më të gjerë të formës së dytë të lartshënuar (futur volitiv). Në arealin gjuhësor për të cilin po shkruajmë, janë të pranishme edhe njëra edhe forma tjetër, por sipas vlerësimit tonë, forma **do + lidhore** (do t'fshâi) gjen përdorim të më shpeshtë.

Njëra formë (kushtimisht e thënë toske) ndërtohet me pjesëzën **do** (e desemantizuar nga folja due, du, dua) + **folja** themelore në mënyrën lidhore, sipas tipit: *do t'shkoj, do t'punoj, do t'laroj* Forma tjetër gege formohet nga folja ndihmëse **kam + paskajorja**, apo kam + me + pjesore: *kam me shku:, kam me punu: (punâu, puna:, kam me laru: (larâu, lara:))...*

Në studimet albanologjike përgjithësisht është pranuar se këto dy forma të veçanta foljore të së ardhmes dallojnë jo vetëm në pikëpamje strukturore, por edhe në pikëpamje kuptimore, ose së paku tregojnë nuanca me vlerë kuptimore (semantike).

Në fakt, forma gege e kohës së ardhme (kam me a:rdh), e quajtur në shqip **e ardhme e domosdoshme** a **e detyrimit** (futurum necessitatis), është konstatuar se tregon veprime që duhen patjetër të kryhen, që janë të domosdoshme, të detyrueshme për t'u bërë, apo parashikimet e premtimet për t'u realizuar diçka thuhet me një siguri shumë të lartë, premtimet janë bindëse, folësi zotohet për atë që e thotë se do ta bëjë.

Ndërkaq, me formën tjetër toske (standard 'do të 'i'), e emërtuar në shqip **e ardhme e dëshiruar** (futur volitiv), shprehet një siguri më e ulët për atë që pritet të realizohet, një mëdyshje për atë që do të kryhet, diçka që është mirë të bëhet, por nuk është e domosdoshme.⁴²⁰ Me fjalë të tjera, me futur necessitatis tregohet një veprim që me të vërtetë do të kryhet, ndërsa me futur volitiv shprehet një veprim që duam të kryhet.

Kjo kundërvënie (dyshe) binare: e vërtetë, e sigurt ~ e mundshme, e pritshme apo e domosdoshme, e patjetërsueshme ~ e dëshirueshme, e parapëlqyeshme shihet edhe në përbërjen (strukturën) e tyre: forma foljore gege (kam me a:rdh) ndërtohet me mënyrën dëftore (indikativin), ndërsa forma toske (do të vi) me mënyrën lidhore (konjunktivin). Të rikujtojmë se me mënyrën dëftore shënjohej një e vërtetë, diçka reale; ndërsa me mënyrën lidhore – e dëshirueshmja, e pritshmja.

Mua si banor i krahinës së Karadakut të Shkupit, kur më thotë dikush: *Kam me a:rdh, jam i bindur se ai vërtet 'ka me ardhë'* dhe bëj përgatitjet për ta pritur; ndërsa kur dikush më thotë: *Do t'vâi*, atëherë nuk ndërmarr asgjë për ta pritur, meqë nuk jam i bindur se ai 'ka me ardhë'.⁴²¹

22. Në fjalitë e pavarura pyetëse, me se shprehet kallëzuesi, me formë të shtjelluar apo të pashtjelluar?

Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit kemi dy forma të paskajores: një paskajore gege dhe një paskajore toske, që formohen me:

a) pjesëzën **me + pjesoren: me shku:** (që quhet edhe pjesore gege, e që nuk e gjejmë në të folmet toske) dhe

b) **për t' + particip: për t'shku:** (< për të shkue) (karakteristik për të folmet toske dhe që nuk e gjejmë në të folmet e nëndialektit të gegërishtes veriore). Në këtë të folme, pjesorja gjithnjë është e cinguar.

Në të folmen tonë, në ndërtime e funksione të ndryshme sintaksore përdoren paralelisht:

⁴²⁰ Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe, ...*, f. 285-286.

⁴²¹ Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014, f. 310-312.

- d) **Paskajorja e mbarë gegërishtes** (me punu:);
- e) **paskajorja toske** (për t'punâu), dhe
- f) **lidhorja** (t'punoje).⁴²²

Paskajorja përdoret kryesisht në fjalitë e nënrenditura qëllimore, kushtore, krahasore, etj.

P.sh.:

Kimi a:rdh me punâu // Kimi ardh për't'punâu //
Ka shku: me livru: // Ka shku: për't'larâu //
Hajde me nejt sante // Hajde't'rrâim sante //
Shkova'n'Shkup me ble ni kusai // Shkova'n'Shkup për't'gje ni kusâi //
Kesh'n'mullâi me blu // Kesh'n'mullâi për't'gju: //
Ra me fje:t // Ra për't'fe:t //

Infinitivi, gjithashtu, përdoret për të formuar kohën e ardhme (me foljen ndihmëse kam + paskajorja), sipas tipit: *Nesër kam me shku: te daj- - Nesër kam për't'shku: te daja // 'N've:sht kam me mell gru:n - 'N'vesht kam për't'mell gru:n // Kimi me ba: shum ishim për xha: - Kimi për't'ba: shûam ishim për xha: //*

Mbështetur në “Udhëzuesin për kërkime në fushën e sintaksës popullore” kemi vjelë këto ndërtime:

- a) *Shtëi a dimen, ku t'shkoj une* (në të gjitha katundet).
- b) *Xhit t'boj* (Lub.). *Mrrâina, xhit t'punoj* (Br.), *Shka t'baj* (Orll.)
- c) *Pse me ardh?* (Lub., Tan., Bll.). *Pse t'vâi?* (Orll.)
- ç) *Pse t'vêish têi, kur shkoj une?* (Br.) etj.

23. Fjalitë bashkërenditëse kundërshtore a shprehen edhe në mënyrën jolidhëzore?

Fjalitë bashkërenditëse kundërshtore në të folmen në fjalë shprehen edhe në mënyrën jolidhëzore:

- a) *T'mdhojat i prev, t'voglat i râiti (irâujti).*
- b) *Mos ja kshir setren, po kshirja pu:nt.*
- c) *Aj tha e mar une, ki tha e mar une* (në të gjitha katundet).

⁴²² Po aty, f. 333-334.

PËRMBYLLJE

Kjo monografi dialektore i kushtohet të folmes shqipe të Karadakut të Shkupit. Karadaku është krahinë kodrinore e malore që shtrihet në pjesën veriore të Maqedonisë dhe pjesën jugore të Kosovës. Malet ngrihen përpjetë nga fushëgropa e Shkupit (në jug), lugina e Kumanovës (në lindje), lugina e Gjilanit (në veri) si dhe rrjedha e lumit Lepenec. Në ultësitrat e Karadakut gjenden katër qytete: Shkupi (në jug), Kumanova (në lindje), Kaçaniku (në perëndim) dhe Gjilani (në veri).

Me këtë libër përshkruhet gjendja e sotme e të folmes së fshatrave Tanushë, Brezë, Malinë, Bllacë, Luboten, Straçincë, Orllancë, Mojancë dhe Grushinë. Ndërkaq, pjesën dërmuese të popullsisë së fshatrave Haraçinë dhe Hasanbeg e përbëjnë banorë të shpërngulur nga fshatrat e sipërpërmendur, gjë që bën, që e folmja e këtyre dy fshatrave nga pikëpamja dialektore të jetë e ngjashme me të folmen e dy fshatrave të sapopërmendur.

Në këtë trevë jeton popullsi me përkatësi nacionale të ndryshme: shqiptarë, maqedonas, serbë, muslimanë, turq, romë etj. Në katundet e Karadakut të Shkupit (Malit të Zi të Shkupit) afërsisht jetojnë 8.600 banorë shqiptarë, pa llogaritur katundet Haraçinë (që me regjistrimin e 2002 kishte 7.351 banorë) e Hasanbeg që ka afër 2700 shtëpi dhe 9000 banorë, ku kanë zbritur e tani jetojnë një numër i madh i karadakinjve. Nga këto të dhëna del se numri i përgjithshëm i popullatës rezidente në katundet e Karadakut si dhe në fshatrat e kësaj zone (Haraçinë e Hasanbeg), pa përfshirë të shpërngulurit në Turqi si dhe në vende të tjera të Maqedonisë, Kosovës, Evropës e botës është mbi 25.600 veta. Pra, mbi 25.600 veta që nuk kanë migruar jashtë krahinës së tyre flasin shqipen e Karadakut të Shkupit.

Me këtë punim synojmë të përshkruajmë gjendjen e sotme të të folmes shqipe të Karadakut të Shkupit, duke bërë fjalë për tiparet fonetike e fonologjike të saj, për veçoritë morfologjike dhe ato leksikore. Gjatë përshkrimit jemi përpjekur jo vetëm të pasqyrojmë e të shpjegojmë veçoritë gjuhësore të këtij areali gjuhësor, por ndonjëherë edhe të krahasojmë atë me të folmet e tjera përreth si dhe me të folme të tjera të gegërishtes qendrore, të mbarë gegërishtes e shqipes dialektore e standarde në përgjithësi.

Monografia që e kemi në dorë mbështetet në versionin e botuar me të njëjtin titull nga shtëpia botuese Logos-A, Shkup, 2014, me mbështetjen financiare të Ministrisë së Kulturës të Republikës së Maqedonisë, por versionin për ribotim e kemi ripunuar, rishikuar, plotësuar me gjëra e vepra të reja të botuara edhe pas vitit 2014 e deri më sot, pra atë e kemi përditësuar.

Edhe pas daljes në dritë të kësaj monografie dialektore (2014), kemi shkëputur e ripunuar tema të veçanta për të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit, duke marrë pjesë e më pas botuar në përmbledhjet e punimeve të konferencave shkencore në Maqedoninë e Veriut, Kosovë e Shqipëri. Pjesën e hyrjes së kësaj monografie në ribotim e kemi pasuruar edhe me dy tema të reja, përkatësisht hyrjen me trajtesën “Të folmet shqipe dhe emërvendet në Maqedoninë e Veriut – dëshmi për autoktoninë tonë në këto troje” dhe pjesën e fundit me kumtesën “Tiparet sintaksore të së folmes së Karadakut të Shkupit.”

Materialin dialektor e mblodhëm me ekspedita gjatë viteve 1996-1997, por edhe më vonë, përkatësisht materialin për sintaksën dialektore e mblodhëm gjatë vitit 2016 nëpër të gjitha fshatrat e kësaj krahine të banuara me shqiptarë, me pyetje të tërthorta të mbështetura në pyetësor dhe me biseda të lira e tematike me informues tipikë të moshuar e të paarsimuar, të cilët kanë lindur, jetojnë dhe nuk kanë lëvizur shumë nga vendbanimi i tyre.

Shpeshherë është thënë e po thuhet jo rrallë se: shqiptarët në Maqedoninë e sotme nuk janë vendës, por kolonë të ardhur pas shekullit XVI me dyndje të herëpashershme në shekujt

XVII, XVIII, XIX e deri në shekullin XX. Me këtë monografi si edhe me studimet e tjera për të folmet shqipe në Maqedoninë e Veriut dhe me toponiminë, veçmas me mikrotoponiminë dëshmohet qartas se shqiptarët janë anas. Faktet historike, arkeologjike, onomastike e gjuhësore të shtrirjes dialektore të shqipes në Ballkan dëshmojnë se nuk ka pasur shpërngulje shqiptarësh nga një zonë në tjetrën, as nga Shqipëria në Maqedoninë e Veriut, meqë nuk kemi përzjerje gjuhësore, por izoglosa me unitet, me vijimësi, me vazhdimësi dialektore e ndërkalim të shkallëshkallshëm.

Inventari i fonemave zanore

Tri shkallët e hapjes, tri radhët e formimit dhe mungesa ose prania e buzorëzimit të zanoreve në gjuhën shqipe përbëjnë tipare dalluese të qëndrueshme, që nuk varen as nga pozicioni as nga p[rrindarja e tyre. Në mënyrë të përgjithësuar, vështruar nga pikëpamja fonetike dhe fonologjike, kjo e folme ka një sistem zanoresh me kundërvënie fonologjike të gjatësisë (zanore e shkurtrë ~ zanore e gjatë) dhe të hundorësisë (zanore gojore ~ zanore hundore). Rrjedhimisht, kjo e folme ka një inventar me 14 fonema zanore të theksuara (10 gojore dhe 4 hundore), nga të cilat:

a) fonema zanore të shkurtra (5):	/ ǎ /	/ ẽ /	/ ǒ /	/ ĩ /	/ ũ /
b) fonema zanore të gjata (5):	/ aː /	/ eː /	/ oː /	/ iː /	/ uː /
c) fonema zanore hundore (4):	/ ǎ /	/ ẽ /		/ ĩ /	/ ũ /

Në rrokje të patheksuar përdoret edhe zanorja e shkurtrë [ɛ] (ə) që ka statusin e tingullit, por jo edhe të fonemës.

Këto 14 fonema zanore kanë fushë të gjerë përhapjeje, përkatësisht realizohen nëpërmjet modifikimeve të ndryshme si alofone, deri sa edhe si diftongje gjatë shpërbërjes së /i/-së dhe të /u/-së në dyzanorësh: /i/ në [âi], [êi], [êi]: *shpâi*, *shpêi* (< shpi, shtëpi), dhe të /u/-së në [âu]: *nâuse* si dhe në formë të monoftonguar *naːse* (< nuse); diftongoide [a^ë]: *ca^ëng* (< cung), *rra^ësh* (< rrush); [u^o]: *ku^odër* (< kodër), *mu^otër* (< motër), *i vu^ogël* (< i vogël); sekuenca diftongore [iɛ]: *gjieth*, *liɛpër*, *liɛtër*, *viɛga* (< gjeth, lepur, letër, vegë) etj.

Këto fonema në rrokje të theksuar në trekëndëshin akustik mund të paraqiten kështu:

a) të shkurtra

/i/	/u/
/e/	/o/
/a/	

b) të gjata

/iː/	/uː/
/eː/	/oː/
/aː/	

c) hundore

/ĩ/	/ũ/
/ǎ/	/ã/

Zanoret e theksuara janë afërsisht dy herë më të gjata sesa të patheksuarat. Këtu na dalin 6 zanore në rrokje të patheksuar:

[a], [e], [ɛ], [o], [i] dhe [u].

Përgjithësisht, si në të gjitha të folmet e gegërishtes, ashtu edhe në të folmen e Karadakut të Shkupit, në rrokje të theksuar në pikëpamje fonetike dallojmë tri gjatësi zanoresh: të shkurtra,

të mesme dhe të gjata. Por, vetëm të shkurtrat krijojnë kundërvënie fonologjike me zanoret e gjata, ndërsa zanoret e gjatësisë së mesme nuk krijojnë kundërvënie, ato nga pikëpamja e gjatësisë janë asnjënjë. Gjatësia e zanoreve në këtë të folme, si edhe në të gjitha të folmet e tjera gege ka vlerë kuptimdalluese (semantike), si në çiftet minimale të fjalëve: *kos* ~ *ko:s* 'kos-i – kos-a', *çaj* ~ *ça:j* 'çaj-i për pije - shqyej', *boll* ~ *bo:ll* 'mjaft – bollë, lloj gjarpri' ose funksion gramatikor: që të bëjë dallimin e gjinisë së emrit (mashkullor – femëror): *plak* ~ *pla:k* 'plak - plakë', *kunat* ~ *kuna:t* 'kunat - kunatë'; dallimin e numrit (njëjës – shumës): *dishek* ~ *dishe:k* 'dyshek - dyshekë', *dham* ~ *dha:m* 'dhëmb - dhëmbë', *dollap* ~ *dolla:p* 'një dritare – shumë dritare' etj.

Edhe pse zanoret hundore janë pjesë e shprehisë nyjetimore të shqiptarëve të Karadakut të Shkupit, ekzistenca e një numri të vogël të çifteve minimale fjalësh që dallohen nëpërmjet opozicionit fonologjik zanore gojore ~ zanore hundore dëshmon për prirjen e kësaj të folmeje, si edhe e të folmeve të tjera gege (në jug më shumë e në veri më pak) për humbjen e vlerës fonologjike të hundorësisë, përkatësisht prirjes për defonologjizimin e hundorësisë (që thuaja se gjendet në fazën e fundit) dhe të gjatësisë së zanoreve (që ka filluar të lëkundet, por ende ruhet). Nga materiali i vjelë dialektor e kemi pasur shumë vështirë të veçonim çifte të tilla fjalësh të cilat hundorja i kundërvihet zanores përkatëse gojore për të krijuar fjalë me kuptim të ndryshëm. Çifte të tilla minimale fjalësh kemi mundur të gjenim pak:

kundërvënie fonologjike zanore gojore ~ zanore hundore				
<i>zanore gojore</i>	<i>kuptimi</i>	~	<i>zanore hundore</i>	<i>kuptimi</i>
rraj	rri	~	rrã:j	rrënjë
lam (na)	(ne) lamë	~	lã:m	lëmë
jan	jan-i	~	jã:n	(ata) janë
(gjemt) tan	djemt tanë	~	e tã:n	e tundë
(ata) kan	(ata) kan	~	kã:n	kën/ë,-a

Theksi

Lidhur me theksin, e folmja shqipe e Malit të Zi të Shkupit, si edhe përgjithësisht të folmet e tjera, nuk përfaqëson izoglosë më vete, por përfshihet në makrosistemin dialektor.

Rrjedhimisht, ndër tiparet themelore të theksit të shqipes, përfshirë edhe të folmen e Karadakut të Shkupit, janë:

- lidhur me llojin e theksit: *shqipja ka theks dinamik*;
- lidhur me lëvizshmërinë e tij: *shqipja ka theks të ngulitur në paradigmat e eptimit*;
- lidhur me vendin e theksit brenda fjalës: *shqipja nuk thekson mbaresat dhe ka prirje të theksojë zanoret parafundore*.

Edhe në të folmen shqipe të Karadakut theksi është dinamik, i palëvizshëm në paradigmat e eptimit dhe i ngulitur në njërin nga dy rrokjet e fundit të fjalës, rëndom në rrokjen parafundore ose në rrokjen fundore, si p.sh.: *fú:sh* - *fúsha* - *fúshat* - *fúshave*; *lúle* - *lúlje* - *lúlja* - *lúles* - *lúlen* - *lúlet* – *lúleve* etj.

Përrjashtim nga ky rregull i përgjithshëm paradigmatic për ruajtjen e theksit të palëvizshëm në një rrokje të caktuar në këtë të folme, bëjnë pak (dhjetëra) emra gjatë formimit të shumësit. Kështu, në fjalëformën e njëjësit theksi bie mbi zanoren e temës, ndërsa në formën e shumësit theksi bartet mbi prapashtesën e shumësit. Krahaso shembujt:

<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>
xharpën	xharpëi, xharpnëi
drápën	drapëi, drapnëi
lépër	leprí, leprâi
kállli	kallí, kallëi
dhánërr, dhándërr	dhanú:r, dhandú:r

Edhe në këtë të folme, theksi është dinamik, i palëvizshëm në paradigmën e eptimit dhe i ngulitur në njërin nga dy rrokjet e fundit të fjalës, rëndom në rrokjen parafundore ose në rrokjen fundore.

Në këtë areal gjuhësor, si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore, kur diftongohen zanoret e mbyllura të theksuara /í/ ose /ú/, atëherë theksi rregullisht qëndron mbi të njëjtën rrokje, përkatësisht në zanoren e mirëfilltë të diftongut. Krahaso shembujt: *kusí* > *kusâi*, *burrním* > *burrnëim*, *stërníp* > *stërnâip*, *koleshník* > *koleshnëik*; *núse* > *nâuse*, *arúshë* > *arâush*, *katún* > *katâun*, *kërcúng* > *kërcâung* etj. Theksi bie mbi rrokjen e njëjtë edhe kur diftongu dytësor monoftongohet, sipas tipit: *arúshë* > *arâush* > *ara^ush*, *ara:sh*; *núse* > *nâuse* > *na^use* > *na:se*; *katund* > *katâun* > *kata^uun* > *kata:n*...

Në këtë krahinë (si në të gjitha të folmet e tjera të gegërishtes) disa emra që në toskërishte shqiptohen me theks në rrokjen fundore *verí*, *qirí*, *njerí* etj., të njëjtë shqiptohen me theks parafundor, si *véri*, *qirí*, *njé:r*.

Prirja e përgjithshme për të theksuar emrat në rrokjen e dytë në këtë të folme del në shesh edhe te disa huazime orientale, të cilat edhe këtu shqiptohen me theks në rrokjen parafundore, si: *káfe*, *páre*, *xhézve*, *tenxhére*, *tenéqe*, *téqe*, *mináre*, *matáre*, *çáre*, *kadífe*, *déve*, *feréxhe*, *xháde*, *zérde*, *zahíre* etj, sikurse dhe disa emra vetjakë me burim oriental: *Fatíme*, *Makfíre*, *Zahíde*, *Naíle*, *Hatíxhe*, *Halíme*, *Ájshë* etj. Kjo zhvendosje e theksit nga rrokja fundore në atë parafundore bëhet për shkak të përshtatjes së fjalëve të huazuara me tipin më të përhapur të theksimit të fjalëve në shqipen (që diku rreth 54% e fjalëve shqiptohen me theks parafundor).

Edhe te sllavizmat (para së gjithash maqedonizmat dhe serbizmat) si dhe tek huazimet e tjera josllave, të huazuara kryesisht me ndërmjetësimin e gjuhës maqedonase, bëhet rregullimi mekanik i theksit, gjegjësisht përshtatja me natyrën e theksit të shqipes. Këto fjalë në trajtën e pashquar më së shumti përdoren si oksitonë. Krahaso shembujt: *koçnicë* > *koçní:c*, *kolicë* > *kolí:c*, *bollnicë* > *bollní:c*, *bullicë* > *bullí:c* > *bullâic*, *kováč*, *varanicë* > *varanâic*, *slluzhbeník*, *opshtinë* > *opshtí:n*, *flanáik*, *popllavë* > *popllá:v*, *direktór*, *sekretá:r*, *çuvá:r*, *shumá:r*, (mesna) *zaední:c* etj.

Inventari i fonemave bashkëtingëllore

E folmja e fshatrave Luboten, Straçincë, Bllacë, Mojancë dhe Orllancë ka një inventar me 29 fonema bashkëtingëllore, ndërsa e folmja e fshatrave Tanushë, Brezë, Malinë dhe Grushinë kanë 30 fonema bashkëtingëllore, sepse kanë më tepër bashkëtingëlloren prapagjuhore /ŋ/, që është përfutur nga përngjashmimi i grupit /ng/:

/ p /, / b /, / m /, / f /, / v /, / t /, / d /, / l /, / ll /, / c /, / x /, / s /, / z /, / n /, / r /, / rr /,
/ ç /, / xh /, / sh /, / zh /, / th /, / dh /, / q /, / gj /, / j /, / nj /, / k /, / g /, (/ ŋ /), / h /.

Ndër tipare fonetike-fonologjike më të rëndësishme të kësaj të folmeje janë edhe:

1. Diftongimi i zanoreve të mbyllura të theksuara /i/ dhe /ú/ në diftongje dytësore, përkatësisht i /i/-së në [âi, êi] dhe i /ú/-së në [âu, ôu], si shpí: > *shpâi, shpêi*; núse > *nâuse, nôuse*.

2. Përdorimi i shpeshtë i të njëjtave fjalë në dy forma fonetike: të diftonguar dhe të padiftonguar, si *mullêi* dhe *mulli*; *kusâi* - *kusi*; *sêi* - *si* 'sy', *temcêi* - *tepsi*; *katâun* - *katu:n*, *fortâun* - *fortu:n*, *ftâurk* - *ftu:rk* etj.

3. Zhbuzorëzimi i [ý] > [í] dhe zberthimi i mëtutjeshëm në diftong dytësor (*sy:* > *sí:* > *sâi, sêi*), si dhe shndërrimi i /y/-së në [u]: *shyt* > *shut*, *dynja:* > *dunja:*, *ymyt* > *umut*.

4. Monoftongimi i diftongjeve në zanore të mirëfillta (arú:sh > arâush > ara^ush > ara^esh, *ara:sh*; rru:sh > rrâush > rra^ush > rra^esh > *rra:sh* etj.

5. Labializimi i hundores së përgjithshme gege [ã] në [o] (hã:n > *ho:n*, nã:n > *no:n*, kãma > *koma*, bãna > *bona*).

6. Mospërdorimi i zanores [ë] në pozitë të theksuar, por vetëm në pozitë të patheksuar (me pak përjashtime).

7. Rënia e [ë]-së në fundin absolut të fjalës dhe zgjatja kompensatore e zanores paraprirëse, si *a:r* < arë, *do:r* < dorë, *bu:rr* < burrë, *pla:k* < plakë, *dishe:k* < dyshekë.

8. Mossqiptimi i shpeshtë i [ë]-së në pozitë të patheksuar edhe në mes të fjalës: *tlin* < tëlyen, *malsâi* < malësi, *udhta:r* < udhëtar, *lku:r* < lëkurë, *knu:s* < këndues etj.

9. Shndërrimi i zanores /u/ të patheksuar në [ë]: *flutër* < flutur, *kumëll* < kumbull, *hekër* < hekur etj.

10. Konsonantizimi i [i]-së dhe i [u]-së së patheksuar në [j], respektivisht në [v] në fund të fjalës, si: *aj shkoj* (< ai shkoi), *ja* (< ia), *vllaj ma j madh* (< vllai ma i madh); *e piv*, *e dav*, *e prev*, *e thav* (< e piu, e ndau, e preu, e thau) etj.

11. Ruajtja e grupeve e zanoreve [æ] dhe [œ]: *pae*, *lae*, *voe*.

12. Monoftongimi i togjeve të zanore [ie] dhe [ue] në zanore të gjata [i:] dhe [u:]: *diell* > *di:ll*, *kam punue* > *kam punu:*, por edhe diftongimi dytësor i /u/-së gjatë në [âu] (*punau*) si dhe monoftongimi i të njëjtit diftong (në fshatrat Brezë e Malinë) në zanore të gjatë [a:]: *puna:* etj.

13. Qiellzorëzimi i [g]-së dhe i grupit të vjetër konsonantik [gl] në [gj]: *gisht* > *gjisht*, *gur* > *gjur*, *gojë* > *gjo:j*, *prag* > *pragj*, *larg* > *largj*; nga forma e vjetër gluha > *gjuha*, *gluni* > *gjuni*; *i*, *e* glatë > *i*, *e* *gja:t* etj.

14. Palatalizimi i grupit të bashkëtingëlloreve [dj] > [gj]: *dja:l* > *gja:l*, *dje* < *gje* dhe i [pl] > [q], si *plak* > *qak*, *plesht* < *qesht*, *pleh* < *qeh*, *plep* < *qep*.

15. Afrikatizimi i bashkëtingëllores qiellzore [q] > [ç]: *qen* > *çen*, *qafë* > *ça:f*, *faqe* > *façe*, *qiell* > *çi:ll* si dhe i [gj] > [xh], si në fjalët *gjak* > *xhak*, *gjumë* > *xhu:m*, *gjarpën* > *xharpën*, *gjysmë* > *xhimc*.

16. Shndërrimi i [nj] > [j]: *zo:j* < zonjë, *pej* < penj, *rra:j* < rrënjë, *e ejte* < e enjte, *i shtre:jt* < i shtrenjtë etj. e më rrallë në [n], si *ni* < një, *nizet* < njëzet.

17. Përngjashmimi (në Tanushë, Bllacë, Mojancë, Orllancë, Brezë, Malinë dhe Grushinë) dhe ruajtja (në fshatrat Luboten dhe Straçincë) e grupeve të bashkëtingëlloreve [mb], [nd] dhe [ng]: *dhamb* - *dham*, *vend* - *ven*, *ngat* - *nat*, *gat*.

18. Rënia e [j]-së në grupet e bashkëtingëlloreve [pj], [mj], [vj]: *pje:shk* > *peshk*, *kam mje:l* > *kam mel*, *vjehërr* > *vehërr*).

19. Ruajtja e grupit [fl] në fshatrat Tanushë, Bllacë, Mojancë, Orllancë dhe Grushinë: *fla:k*, *flo:k*, *flutër* etj. dhe jonizimi i tij në fshatrat Brezë, Malinë, Straçincë dhe Luboten: *fja:k*, *fjo:k*, *fjutër*.

Përgjithësisht dihet se dallimet fonetike e fonologjike ndërdialektore janë më të mëdha sesa dallimet morfologjike, leksikore e sintaksore. Me fjalë të tjera, gramatika dialektore është më unike në krahasim me fonetikën dhe fonologjinë. Dallimet morfologjike vërehen më shumë në pjesët e ndryshueshme të ligjëratës, përkatësisht në kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, përemrit, foljes; ndërsa më pak në pjesët e pandryshueshme, si në ndajfolje, parafjalë, lidhëza etj.

Tiparet morfologjike

Veçori kryesorë morfologjike të të folmes shqipe të Karadakut të Shkupit janë:

Emrat janë të gjinisë mashkullore ose femërore, ndërsa nga emrat e gjinisë asnjane i gjejmë vetëm gjurmët, sepse ata janë integruar në gjininë mashkullore ose femërore. Rëndom, në gjininë asnjane përdoren emra mbiemëror të tipit *m'shkoj t'rit*, *i ra t'fikt*, *t'kuqt e voes*. Përveç formave supletive të emrave të gjinisë mashkullore dhe femërore (vlla: - motër, nâip - mes, ka: - lo:p, dash - dele etj.), që i ka mbarë shqipja; disa emra në trajtën e pashquar dallojnë gjininë nëpërmjet gjatësisë së zanores së fundit, si: *qak - qa:k*, *kunat - kuna:t*, *krushk - kru:shk* etj. Megjithatë, mënyra më e shpeshtë e formimit të emrave të gjinisë femërore është kur emrave të gjinisë mashkullore u shtohen prapashtesat: *-e*, *-ke*, *-e:sh*; *-ush*, (*-âush*, *-a:sh*), *-oj*, *-i*., *-ic* (*-âic*, *-ovâic*), si *mcâus-e*, *grushinali-ke*, *maik-e*, *mike:sh*, *trâm-n-esh*; *ar-u:sh* (*ar-âush*, *ar-a:sh*). Gjinia femërore e emrit 'ujk' (në këtë të folme uk, ôuk) formohet në disa mënyra: *uki:n* dhe *ujki:n* (f. Grushinë), *uki*: (f. Tanushë, Orllancë), *ulko:j* (në f. Mojancë), *liki*: dhe *luki*: (f. Bllacë), *lko:j* (f. Brezë, Malinë), *uki:c* (f. Straçincë).

Shquarsia e emrave na paraqitet në mënyrën më të thjeshtë të mundshme: emrat e gjinisë mashkullore marrin mbaresën *-i*, ndërsa ata të gjinisë femërore *-a* (*-ja*), si *lis-i*, *shoq-i*, *plak-i*, *breg-i*, *krah-i*, *shi-v-i*, *dhe-v-i*; *za-n-i*, *pe-n-i*, *ftoj-n-i*; *cac-a*, *dor-a*, *del-j-a*, *Shukri-j-a*, *gjoj-a*, *shpâi-a* etj. Në këtë të folme, si edhe në të folme të tjera geqe, kemi vërejtur një dukuri të shpeshtë të shquarsisë së dyfishtë të emrit: me përemër dëftor dhe me nyjën e prapme shquese, sipas tipit: *ki* (*çiki*) *shoq-i*, *çajo lop-a*.

Në këtë areal gjuhësor të shqipes, kemi hetuar jo pak emra karakteristik të singularizuar, sidomos në të folmet e f. Luboten dhe Straçincë: (ni) *ftoj* - (shâum) *ftoj*, (ni) *kroj* - (shâum) *kroj*, (ni) *thoj* - (shâum) *thoj*, (ni) *prroj* - (shâum) *prroj*, (ni) *patkoj* - (shâum) *patkoj* etj. Emrat e tillë janë të pranishëm edhe në të folmet e tjera shqipe të rrethinës së Shkupit, si në Derven etj. Fshatrat e tjera të këtij areali dallojnë format e njëjësit nga format e shumësit të emrave të mësipërm. Do të japim formën e njëjësit e të shumësit të emrave *thua*, *krua*, *përrua* në fshatrat ku bëjnë dallimin e formës së njëjësit nga forma e shumësit: në f. Tanushë thuhet: (ni) *thue* - (shu:m) *thoj*; f. Orllancë (ni) *kra*: - (sh.) *krojna*, (ni) *tha*: - (sh.) *thojna*, (ni) *prru*: - (sh.) *prrojna*; f. Bllacë (ni) *prrue* - (sh.) *prrojna*; f. Grushinë (ni) *kra*: - (sh.) *krona*, (ni) *prra*: - (sh.) *prrona*, (ni) *thu*: - (sh.) *thona*; f. Brezë (ni) *prrae* - (sh.) *prrena*, (ni) *krae* - (sh.) *krojna*, (ni) *thae* - (sh.) *thojna*.

Për shkak të qiellzorizimit të [g]-së në [gj] disa fjalë të kësaj të folmeje përdoren me një formë të vetme si për njëjësin ashtu edhe për shumësin: (ni) *zogj* - (shâum) *zogj*, (ni) *pllugj* - (shâum) *pllugj* etj.

Megjithëkëtë, format më të zakonshme të formimit të shumësit janë po ato të gegërishtes qendrore, të të folmeve të tjera të Veriut (shumë prej tyre edhe të toskërishtes e të shqipes standarde). Pra, shumësi në këtë areal gjuhësor formohet në disa mënyra: *me mbaresa*, *me ndërrime morfonologjike*, *me ndërrime fonemash e me mbaresa si dhe me kundërvënie*

fonologjike të gjatësisë së zanoreve.

Mbaresa më prodhimtare janë: **-a, -na, -e, -lla:r, -le:r, -i** (êi), **-zi** etj., si *breg-a, mac-a; brî-na, mullâ-na; mal-e, fâis-e; daja-lla:r, hoxhall-a:r; haxhi-le:r, beg-le:r; kûngëll - kûngi; drapën – drapêi; ill-zi, gjur-zi* etj.

Si edhe në të folme të tjera, një pjesë e emrave shumësin e formojnë me metafoini, qiellzorizim (palatalizim); metafoini dhe qiellzorizim njëherazi si dhe me disa ndërrime morfonologjike. Për shembull: *dash - desh, mâik - mâiq; plak, qak - pleq, qeq; kal - kol, de:r - di:r* etj. Në çështjen e formimit të shumësit me ndërrime fonologjike, duke shtuar edhe mbaresa, si dhe me kundërvënie fonologjike të gjatësisë së zanoreve, areali gjuhësor i Karadakut të Shkupit nuk dallohet nga të folmet tjera geqe.

Lidhur me mbiermat dhe numërorët në këtë të folme nuk vërehet ndonjë tipar i posaçëm.

Përemrat vetorë në të folmen e shqiptarëve të Malit të Zi të Shkupit janë: njëjës: veta I *une, u:n*; veta II. *tâj, têtj*; veta III. *aj* (gj. m), *ajo, aja* (gj. f.); shumë: veta I. *na*; veta II *ju*; veta III *ata* (gj. m), *ato* (gj. f.).

Me interes dialektor janë edhe përemrat vetorë të vetës së tretë si për shumësin, po ashtu edhe njëjës; por edhe veta e parë njëjës. Në këtë areal gjuhësor te përemrat vetorë të vetës së tretë shumë, në disa fshatra bëhet dallimi i gjinisë me forma të posaçme, kurse në fshatrat e tjerë, po kjo formë përdoret për të dyja gjinitë. Kështu, në të folmet e fshatrave Brezë, Malinë dhe Tanushë dallohen këto përemra vetorë: **ata** (për vetën e tretë shumë të gjinisë mashkullore) dhe **ato** (për gjininë femërore); ndërsa në fshatrat Bllacë dhe Luboten dëgjohet vetëm përemri vetor **ata** (për të dyja gjinitë), kurse në fshatrat Orllancë, Mojancë dhe Grushinë vetëm përemri vetor **ato** (për të dyja gjinitë). Format dyshe i hasim edhe për vetën e tretë njëjës për gjininë femërore: **ajo** në fshatrat Tanushë, Mojancë, Orllancë, Brezë, Malinë dhe Grushinë; ndërsa **aja** në fshatrat Bllacë, Straçincë dhe Luboten.

Përemrat vetorë në këtë të folme, si në mbarë shqipen, kanë forma rasore. Përveç formave **atâi, asaj** në vetën e tretë shumë, vërehen edhe format paralele **i atâine, i atêine; atâine, u; atêine u**; dhe në gjinore veta III njëjës **i atâine, e asajne**, që janë formuar nëpërmjet të parave, duke shtuar fjalëzën **ne** (khs. atâi, asaj me i atâine, e asajne).

Në këtë të folme vërehet rrafshimi a njëjtësimi i paradigmave të dhanores dhe të kallëzores për vetën e parë dhe të dytë shumë; dhanore **neve, na** dhe kallëzore **neve, na** (< ne, na); **juve, u** dhe **juve, u** (< ju, ju).

Te format e shkurtra të përemrit, në krahasim me format standarde, hetohet se zanoret e patheksuara [i] dhe [u] konsonantizohen në [j], përkatësisht në **v: ja** (< ia), **naj** (< na i), **va** (< ua). Forma **naj** (< na e) duket se është krijuar me analogji të **na + i = naj**. Te forma **jav** (< jua = ju + i, si dhe ju + i) kemi metatezën e *u*-së me *a*-në, bashkë me konsonantizimin e *u* > *v*.

Shumica e të folmeve geqe (të gegërishtes veriore, por disa edhe të gegërishtes qendrore) dallohen prej gjuhës standarde, të folmeve toske dhe arealit tjetër të gegërishtes (Shqipëri e Mesme e më gjerë) për faktin se përemrat dëftorë shumë më tepër përdoren në formën e përngjitur: *qeky/çeky qekjo/çekjo, qekta/çekta, qaj/çaj, qajo/çajo, qata/çata, qeto/çeto* etj. sesa në formën me shtrirje në të dy dialektet *ky, kjo, këta, këto, ai, ajo, ata, ato*.

Përemrat dëftorë në të folmen shqipe të Karadakut janë: **ki, kjo, kja** (kija në Straçincë) ose **çiki, çikjo (çekjo), çikja** si forma për njerëz, gjallesa e gjësende të afërta dhe **aj, aja, ajo; ata, ato, çaj, çaja, çaj; çata, çato**, për njerëz, gjallesa e gjësende të largëta me folësin.

Në këtë të folme, përemrat dëftorë zakonisht përdoren në formë aglutinative: **çaj** (çe+aj), **çaja** (çe+aja), **çajo** (çe+ajo); **çata** (çe+ata), **çato** (çe+ato), e rrallëherë pa pjesëzën përforcuese (deiktike) **çe** (< qe, ja) + përemri, në formë të njëjtë me përemrin përkatës vetor. Madje, të folmet

e nëndialektit të gegërishtes veriore me këto forma të përngjitura (të aglutinuara) të përemrave dëftorë (çaj < çe+ai) dallohen nga shqipja standarde dhe nga të gjitha të folmet e tjera të shqipes.

Me forma të këtilla të përbëra nga pjesëza e patheksuar treguese (deiktike, gr. *deixis* – dëftoj, tregoj me gisht) **qe** (çe) ‘ja’ dhe një përemër dëftor *ky*: *çe+ky*, *çe+kjo* ‘ja+ky, ja kjo’... veçohet ose dallohet më mirë frymori, objekti apo sendi që ndodhet afër ose larg folësit. Krahasoni variantet e fjalive: *Ky është gjali jem.* - *Çeky është gjali jem.* ‘Ky është djali im. – Ja, ky është djali im’. *Ajo a:r është ma e mira.* – *Çajo a:r është ma e mira.* ‘Ajo arë është më e mira. – Ja, ajo arë është më e mira.’

Në të folmen shqipe të Karadakut përemrat pyetës më të përdorur janë: **kush?**, **calli?**, **câilli?** dhe përemrat e përfutur nga ta (në formë të monoftonguar ose të diftonguar) **calla?**, **câilla?**; **callët?**, **câillët?** për gjininë mashkullore; **callat?**, **câillat?** për gjininë femërore; **shka?**, **xhit?** ‘çka’, **sa?**.

Përemrat e pacaktuar me përdorim më të dendur në këtë të folme janë: *kush*, *dikush*, *ndokush*, *nakush*, *çetërkush*, *shamkush*; *krejt*, *do*, *donja*, *donjani*, *donjana*; *dika*., *kërka*; *callido*, *callado*, *kurcalli*, *kurcalla*, *kurkush*, *kurxha*.; *ni*, *asni*, *kurni*; *dishka* etj. Një përemër të pacaktuar karakteristik e kemi dëgjuar në fshatin Brezë e Malinë: **dixhit** (di+xhit < çka, di+çka, ‘diçka’) etj.

Mbaresat foljore të mënyrës dëftore të zgjedhimit të parë të kohës së tashme janë të llojllojshme: forma aktive në njëjës, veta I -**j**, veta II -**n**, veta III -**n**; në shumës, veta I -**jm** dhe -**jna**, veta II -**ni** dhe -**jni**, veta III -**jn**. Forma pasive: në njëjës, veta I -**na** dhe -**ëm**, veta II -**ësh**, veta III -**ët**; në shumës: veta I -**mi**, veta II -**ni**, veta III -**ën**. Në kohën e tashme përdoren dy forma foljore: forma sintetike **punoj** dhe forma analitike e tipit **po punoj** (e barasvlershme me *jam tu punau*, *jam duke punuar*), forma e dytë (po punoj) për të treguar veprime që kryhen në momentin e ligjërit, që nuk kanë përfunduar, që përsëriten.

Në këtë të folme, si edhe në të folmet e tjera gege, e pakryera është sigmatike (me -sh-). Të gjitha foljet, përfshirë edhe të parregulltat (përjashtuar foljet ndihmëse *kam* dhe *jam*); temës së foljes (puno-, shko-, mëll-, lodh-, rrâi-, vâi- ...) në formën veprorë i prapavihen këto mbaresa: njëjës veta I -**jshna**, -**shna** (në të folmen e fshatrave Orllancë dhe Mojancë ndonjëherë edhe -**sha**), veta II -**jshe**, -**she**; veta III -**jke**, -**ke**; kurse për shumësin: veta I -**jshmi**, -**shmi** (-jshna), veta II -**jshi**, -**shi**, -**shni**; veta III -**jshin**, -**shin**.

Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit për rrëfyer ndonjë veprim a ngjarje që është kryer në një të kaluar shumë të largët (më herët nga ajo që tregojnë kohët deritashme të shkuara) përdoren edhe dy kohë të tjera. Në fakt, nga koha më se e kryer dhe koha e kryer e tejkshuar ndërtohen forma të dyta të mbipërbëra dhe me to tregohen veprime që kanë ndodhur në kohë të lashta, në kohët më të errëta të historisë së tyre fare pak të njohur, përkatësisht në kohën e panjohur e më të lashtë që mund të mbajë mend njerëzimi ose diçka që është bartur brez pas brezi në formën e folur, si në përralla, legjenda, gojëdhëna etj. Për shembull: **Ish pas kã:n ni bu:rr e ni gru:** // *Ata nuk kishin pas asni ca:ll* // **Ish pas kãn ni arap i zi** // *Për dit e kish pas lip me ngrãn ka ni njer ...* // Zakonisht me këto kohë të dyta të mbipërbëra të së shkuarës fillojnë përrallat, ndërsa më pas përdoren kohë të tjera foljesh që tregojnë kohë më afër të sotmes.

Sipas strukturës që kanë, foljet e mbipërbëra janë analitike. Ndërtohen nga koha më se e kryer si dhe nga e kryera e tejkshuar me ndërfitjen e foljes **pas** ndërmjet foljes ndihmëse dhe pjesores, sipas tipit: *kishna shku*: (koha më se e kryer) - **kishna pas shku**: (më se e kryera II), gjegjësisht *pata dal* (koha e kryer e tejkshuar) - **pata pas da:l** (e kryera II e tejkshuar) etj.

Këto kohë të dyta të mbipërbëra, që tregojnë të shkuarën më të largët të mbamendjes kolektive, në të folmen tonë kanë përdorim të kufizuar. Në fakt, këto kohë janë karakteristike për

të folmen e gegërishtes verilindore (kosovarishten) e jo për të folmet e gegërishtes qendrore.

Në të folmen e kësaj krahine koha e ardhme tregohet nëpërmjet dy kohëve të foljeve, përkatësisht me: a) **kohën e ardhme** dhe një kohë tjetër që mund ta quajmë b) **e ardhme e dytë** (fatur II).

Për arealin gjuhësor të Karadakut të Shkupit është karakteristik **përdorimi paralel i të ardhmes së domosdoshme** (*futurum necessitatis*) dhe i **të ardhmes së dëshiruar** (*fatur volitiv, futurum voluntatis*). Njëra formë (kushtimisht e thënë toske) ndërtohet me pjesëzën **do + folja** themelore në mënyrën lidhoret: *do t'shkoj, do t'punoj, do t'laroj ...* Forma tjetër gege formohet nga folja ndihmëse **kam + paskajorja** (apo kam + me + pjesore): *kam me shku., kam me punu: (punâu, puna:), kam me laru: (larâu, lara:)*... Sipas vlerësimit tonë, forma **do + lidhore** (do t'fshâi) gjen përdorim të më shpeshtë.

Forma gege e kohës së ardhme (kam me a:rdh), e quajtur në shqip **e ardhme e domosdoshme** a **e detyrimit** (*futurum necessitatis*), është konstatuar se tregon veprime që duhen patjetër të kryhen, folësi zotohet për atë që e thotë se do ta bëjë; ndërkaq, me formën tjetër toske (standarde 'do të vi'), e emërtuar në shqip **e ardhme e dëshiruar** (*fatur volitiv*), shprehet një siguri më e ulët për atë që pritet të realizohet, një mëdyshje për atë që do të kryhet, diçka që është mirë të bëhet, por nuk është e domosdoshme.

Kjo kundërvënie (dyshe) binare: e vërtetë, e sigurt ~ e mundshme, e pritshme shihet edhe në përbërjen (strukturën) e tyre: forma foljore gege (kam me a:rdh) ndërtohet me mënyrën dëftore (indikativin), ndërsa forma toske (do të vi) me mënyrën lidhore (konjunktivin). Të rikujtojmë se me mënyrën dëftore shënjohej një e vërtetë, diçka reale; ndërsa me mënyrën lidhore – e dëshirueshmja, e pritshmja. Zgjedhimi i foljeve në kohën e ardhme të domosdoshme dhe në të ardhmen e dëshiruar në këtë areal gjuhësor është:

e ardhme e domosdoshme		e ardhme e dëshiruar	
njëjës	shumës	njëjës	shumës
v. I: kam me da:l	kimi me da:l	do t'dal	do t'dalim
v. II: ki me da:l	kini me da:l	do t'dalsh	do t'dilni
v. III: ka me da:l	kan me da:l	do t'dale	do t'dalin

Në këtë kontekst, do të përmendim një shembull interesant të përzierjes së të dy formave. Në të folmen e f. Tanushë konstatuam dhe vërtetuam se i njëjti informator përzien të dy format e kohës së ardhme, përkatësisht kalon nga një formë në një tjetër, madje kur zgjedhon të njëjtën folje:

une du t'shkoj	na do t'shko:jm
ti don me shku:	ju do t'shkoni
aj don me shku:	ata do t'shko:jn

Edhe në paradigmen foljore të kohës së ardhme të dytë na dalin të gërshetuara elemente tipike gege me ato toske, që rrallëkund mund të dëgjohej. Nga zgjedhimi, del në shesh kjo ndërthurje e paparë e paskajores gege (me + pjesore e reduktuar) me paskajoren toske (për + lidhore):

veta I. kam për t'msâu	kimi për t'msâu	kam për me msu:	kimi për me msu:
veta II ki për t'msâu	kini për t'msâu	ki për me msu:	kini për me msu:
veta III ka për t'msâu	kan për t'msâu	ka për me msu:	kan për me msu:

Foljet në mënyrën lidhore, urdhërore dhe dëshirore janë të ngjashme me ato të të folmeve tjera të gegërishtes qendrore.

Interes të posaçëm për dialektologjinë e gjuhës së shqipe paraqesin foljet ndihmëse *kam* dhe *jam* në habitore. Folja ndihmëse *kam* në kohën e tashme të mënyrës habitore në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit përdoret në forma të ndryshme:

kam në kohën e tashme të mënyrës habitore	
njëjës	shumës
Ûn paskëm, pahna, paskna, pasna	na paskna, pahna, paskmi, passhmi
tâi paske, pahe, passhe	ju paskni, paski, pahi, passhni
aj paska, paha	ata paskan, pahan

Në forma të ndryshme, gjithashtu, del edhe folja ndihmëse *jam*. Në bazë të materialit të vjelë, zgjedhimi i kësaj foljeje ndihmëse në kohën e tashme të habitores bën kështu: në të folmen e fshatit Straçincë: *kanëm, kane, kana; kanmi, kanni, kanën*. Në fshatin Grushinë: *kanam, kane, kana; kenna, kanni, kanan*. Në fshatin Bllacë: *kenem, kene, kana; kenmi, kenni, kanan*. Në fshatin Mojancë dhe Orllancë: *kanam, kane, kana; kenmi, kenni, kanan*. Në fshatin Tanushë: *kokna, koke, koka; kokmi, kokni, kokan* (si dhe në të folmet e Kosovës).

Nga format e pashtjelluara, kjo e folme, si edhe të folmet e tjera geqe, ka formën e pjesores (particip), paskajores (infinitiv) dhe përcjellores (gerundiv).

Marrë në përgjithësi, kjo e folme ka pjesore të reduktuara (të cinguar), si (kam) *da:l, ve:l, me:ll, ha:p, ma:t, nâis, pe:k, pre:, gje:, pa:, thâi...* Një dukuri interesante e kësaj të folmeje është se ka dy forma të paskajores, që formohen me:

- a) pjesëzën **me + pjesorja e foljes: me shku:** (paskajore geqe) dhe
- b) **për t' + pjesorja: për t'shku:** (< për të shkue, për të shkuar, paskajore toske)

Përcjellorja është analitike dhe përbëhet nga pjesëza **tu + pjesorja: tu punâu, tu punu:, tu puna:** [(krahaso me formën standarde: duke + pjesorja (duke punuar)]. Për formën pasive të përcjellores para pjesores përdoret pjesëza **u**, si: *tu u la:, tu u rrâit, tu u ngrâit* etj.; që në të folurit nga dy u-të [u + u] geminate krijohet një zanore e gjatë [u:], si *tu: la:, tu: rrait, tu: ngrâit*.

Të folmet popullore kanë veçori të përbashkëta, por edhe dallime jo vetëm në fjalët e ndryshueshme, por edhe te fjalët e pandryshueshme. Dallimet te fjalët e pandryshueshme: ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrmat në këtë të folme janë kryesisht të natyrës fonetike dhe fonologjike, ndërsa më të rralla janë të fushës së morfologjisë dhe të sintaksës.

Fjalëformimi

Areali gjuhësor i Karadakut të Shkupit nuk dallon nga të folmet e tjera të gegërishtes në përgjithësi në mënyrën e formimit të fjalëve. Edhe këtu kemi fjalë të parme dhe fjalë të prejardhura. Ndër mënyrat më prodhimtare të fjalëformimit janë: a) fjalëformimi me parashtesim, b) me prapashtesim, c) në mënyrë të përzier: me paranyjëzim dhe prapashtesim, ç) me kompozim dhe përngjitje.

Tiparet leksikore

Si në çdo të folme tjetër shqipe, ashtu edhe në këtë të folme dallohen fjalë me etimologji të ndryshme, që nga fjalët me prejardhje indoevropiane e deri te disa neologjizma bashkëkohorë.

Pra, kemi:

a) **fjalë të gurrës vetjake a vendëse**, të cilat mbizotërojnë, dhe

b) **fjalë me prejardhje nga gjuhë të huaja**.

Edhe përkrah ndikimeve të huaja në rrjedhë të kohës, kjo e folme si edhe mbarë shqipja e ka ruajtur mëvetësinë e saj, me strukturë fonetike e fonologjike, gramatikore e leksikore të veçantë.

Si të gjitha të folmet e tjera, edhe e folmja jonë është mjaft e pasur me fjalë dhe me shprehje të ndryshme. Relievi malor i Karadakut të Shkupit (regjion i pasur me botën bimore dhe shtazore) ka mundësuar zhvillimin e blegtorisë e më pak të bujqësisë. Për të emërtuar tërë këtë shumëllojshmëri të florës dhe të faunës, banorët e këtij vendi kanë fjalë përkatëse. Rrjedhimisht, e folmja jonë është e pasur me fjalë nga sfera e pjesëve të trupit të njeriut, sëmundjeve, veçorive psikike dhe fizike; me emra farefisnie, veshjesh, ushqimesh; me fjalë të fushës së bujqësisë, blegtorisë, botës bimore, relievit, emra ujërash të vogla (përrenj, burime) dhe të tjera. Përkundër kësaj, ka pak fjalë nga sfera e detarisë, lundrimit, peshkatarisë, zejtarisë, sportit (përveç disa nga sportet popullore), administratës, shkencës, politikës, artit etj.

Marrë në përgjithësi, e folmja shqipe e Karadakut të Shkupit për shkak të përdorimit paralel të krahinorizmave të gegërishtes qendrore dhe të gegërishtes verilindore është shumë e pasur me sinonime. Tipike për leksikon e kësaj të folmeje është **përdorimi i çifteve sinonimike fjalësh dhe formash fonetike karakteristike për gegërishten qendrore, që mbizotërojnë dhe fjalësh të gegërishtes verilindore**. Me fjalë të tjera, këtu kemi dy krahinorizmash të gegërishtes qendrore dhe të gegërishtes verilindore. Madje, ka edhe fshatra ku përdoren të dy format: njëra e cila është karakteristike për gegërishten qendrore, ndërsa tjetra për gegërishten verilindore. Konstatimin e tillë e kemi mbështetur në bazë të:

a) çifteve të caktuara sinonimike të dallueshme se i takojnë njërit apo tjetrit grup të folmesh, dhe

b) sipas dallimeve fonetike të së njëjtës leksemë.

Nga analiza e materialit dialektor të Karadakut të Shkupit kemi nxjerrë si vlerësim të përgjithshëm se **fjalësi i të folmes së Karadakut të Shkupit është ndër më të pasurit me sinonime**. Fondin leksikor me sinonime e ka pasuruar nëpërmjet disa rrugëve:

a) me përdorim paralel të krahinorizmave të gegërishtes qendrore dhe të gegërishtes verilindore;

b) me një ose dy fjalë krahinore dhe një fjalë të huazuar nga gjuhët sllave (kryesisht nga maqedonishtja ose serbishtja);

c) me ndonjëren nga këto që u përmendën dhe një fjalë orientale;

ç) me sinonimet dialektizëm a krahinorizëm - fjalë e huaj a barbarizëm – fjalë e leksikut të përbashkët letrar.

